



**RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT
“FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRISË”
TË USHTRUAR NË BASHKINË BERAT**

KORRIK 2022

Shkurtime

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit.
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli.
NA	Nëpunës Autorizues.
NZ	Nëpunës Zbatues.
GSM	Grupi i Menaxhimit Strategjik.
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm.
AB	Auditi i Brendshëm
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm.
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara.
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave.
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak.
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit.
INOTSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit.
ISA	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
IFAC	Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve
IPSAS	Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
IT	Teknologjia e Informacionit.
NjA	Njësi Administrative.
ShA	Shoqëri Anonime.
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë.
OE	Operator Ekonomik.
TVSh	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar

Nr.	Përmbajtja	Faqe
	Legjenda dhe shkurtimet	1-3
I.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	
1.	Përshkrim i shkurtër i projektit të auditimit	4-4
2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	4-8
3.	Konkluzioni i përgjithshëm dhe opinioni i auditimit	9-9
II.	HYRJA	
1.	Objekti i auditimit	10-13
2.	Qëllimi i auditimit	
3.	Identifikimi i çështjes	
4.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	
5.	Përgjegjësitë e audituesve	
6.	Kriteret e vlerësimit	
7.	Standardet e auditimit	
8.	Metodat e auditimit	
9.	Dokumentimi i auditimit	
	III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	
	-Informacion i përgjithshëm mbi subjektin	13-13
	-Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit	
	1. Auditim mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm	14-23
	2.1. Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit	24-49
	2.2. Burimi i krijimit të të ardhurave, vlerësimi i mbledhjes së tyre	49-59
	3. Vlerësimi i raportimit financiar	60-77
	4.1. Mbi planifikimin, realizimin, zhvillimin e procedurave të prokurimeve	78-185
	4.2. Mbi zbatimin e kontratave të punëve publike	186-195
	5. Mbi planifikimin dhe zhvillimin e territorit	195-200
	6. Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Mbrojtjes së	200-202
	7. Zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm	202-209
	8. Të ndryshme të dalave gjatë auditimit	209-213
	IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET	214-238
	V. ANEKSE	239-284

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1.Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Në zbatim të Programit të Auditimit nr. 55/1, datë 18.01.2022 i ndryshuar, miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 18.01.2022 deri në datën 15.04.2022 në institucionin Bashkia Berat u krye në teren auditimi “Financiar dhe i përputhshmërisë”.

Auditimi mbuloi periudhën nga data 01.10.2019 deri më datën 31.12.2021 dhe u shtri mbi çështjet kryesore të veprimtarisë së institucionit si: menaxhimi financiar dhe kontrolli i brendshëm, planifikimi dhe zbatimi i buxhetit, vlerësimi i pasqyrave financiare, prokurimet publike, zbatimi i kontratave të punimeve etj.

Për përfitimin e rezultateve të auditimit, grupi i auditimit u mbështet mbi dy elementë: në sistemin e kontrollit të brendshëm dhe në punën konkrete mbi evidencat e auditimit, por kryesisht mbi këtë të fundit. Audituesit janë kujdesur që evidencat me të cilat kanë punuar për të argumentuar rezultatet e auditimit, të plotësonin tre cilësi: të ishin të përshtatshme (të kishin lidhje me çështjen që auditohet), të besueshme (burimi nga vjen evidenca të ketë besueshmëri) dhe të mjaftueshme (sasia e evidencës të jetë e mjaftueshme për arritjen e konkluzioneve të auditimit). Në përfundim të punës audituse në terren, nga grupi i auditimit janë mbajtur dhe protokolluar në subjekt 14 akt konstatime dhe 3 akt verifikime dhe pas kryerjes së takimit përmbjllës mes palëve nga subjekti u paraqitën kundërshtitë për aktet e mbajtura. Pas hartimit të akteve të konstatimit dhe projektraportit, nga subjekti i audituar janë bërë kundërshti, të cilat janë trajtuar nga grupi i auditimit dhe janë bërë pjesë e materialit në projektraport dhe në raportin përfundimtar të auditimit.

Në datën 04.07.2022 në ambientet e KLSH është realizua takimi përmbjllës midis përfaqësuesve të Bashkisë Berat dhe KLSH, për të cilin është mbajtur protokollu përkates.

2.Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

NR.	Përmbledhje e gjetjes	Referenca me raportin përfundimtar	Rëndësia	Rekomandimi
I	Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Ndërtim i linjës kryesore dhe shpërndarjes së furnizimit me ujë të Njësisë Administrative Velabisht”, Bashkia Berat, u konstatua se ky objekt me vlerë të situacionuar 154,991,516 lekë me TVSH, edhe pasi janë miratuar ndryshimet në volume (shtesa/pakësimi) në vlerën 139,591,298 lekë me TVSh, ose 90% të vlerës totale, përsëri nuk e kryen funksionin për të cilën është planifikuar të kryhej ky investim. Mos funksionimi i objektit ka sjellë mos furnizimin me ujë të komunitetit, si dhe përdorimin pa eficientë dhe efektivitet të fondeve publike prej 154,991,516 lekë me TVSH			Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Berat, nëpërmjet stafit inxhiniero-teknik, të marrë masa që në të ardhmen të miratojë ndryshimet e projekt preventivit, vetëm në rast se ato janë të argumentuara teknikisht, në mënyrë që të mos ndryshojnë në thelb kushtet kryesore të projektit, të përmirësojnë treguesit e veprës, duke i bërë ato sa më eficiente, për t’i shërbyer komunitetit në kohë. Të marrë masa për vendosjen në funksionim të linjës kryesore dhe shpërndarjes së furnizimit me ujë

2	<p>Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezulton se Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, nuk ka marrë masa të plota për arkëtimin e debitorëve, pasi në datën 31.12.2021 rezulton një vlerë e pa arkëtuar prej 236,557 mijë lekë, e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Berat, e krijuar nga mos pagesa e kategorisë së taksapaguesve familjarë dhe privat.</p> <p>Vlera e detyrimit nga taksapaguesit familjar është 132,259,090 lekë, nga e cila detyrimi për taksën e tokës bujqësore është 62,722,750 lekë, ndërsa vlera e detyrimit nga taksapaguesit privat është 104,298,029 lekë.</p> <p>Veprimet e mos veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Pikat 3,4, 5 dhe 5, të nenin 45 – “Çregjistrimi i subjekteve tatimore” dhe Kreun XI-Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshimet dhe Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshime; ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, me ndryshimet e mëvonshme, neni 181 -Mospagimi i taksave dhe tatimeve.</p>		<p>Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimore për debitorët duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve në vlerën 236,557 mijë lekë, si më poshtë vijon:</p> <p>a- Tu dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhrat e bllokimit të llogarive bankare.</p> <p>b- Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në AKSH (për pasuritë e paluajtshme).</p> <p>c- Në rast se bizneset private edhe pas njoftimeve zyrtare dhe dërgimit të urdhër bllokimeve në bankë nuk kryejnë pagesën e detyrimeve, pasi të merren masat administrative apo sekuestro, të bëhet kallëzim penal, bazuar në Kodin Penal të RSH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 me ndryshimet e mëvonshme, neni 181 “Mospagimi i taksave dhe tatimeve”.</p> <p>d- Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Berat, në bashkëpunim me Njësitë Administrative, të evidentojë listat emërore të debitorëve familjarë në mënyrë elektronike, duke të njoftojë nëpërmjet postës (dhe jo vetëm) familjet të cilët nuk kanë paguar detyrimet për taksën e tokës/ tarifën e pastrimit, ndriçimit, banesave dhe gjelbërimit.</p>
3	<p>Gjetje nga auditimi:Nga auditimi i dokumentacionit që disponon Drejtoria e PZHT, Bashkia Berat në lidhje me legalizimet e ndërtimeve pa leje dhe listave që disponon për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, konstatohet se nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNIT Berat janë dërguar zyrtarisht me shkresë lista e qytetarëve shoqëruar me leje legalizimi dhe destinuar për regjistrim në ZVRPP (ASHK)</p>		<p>Rekomandim: Drejtoria e Planifikim Urban në bashkëpunim me Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për</p>

	<p>Berat.</p> <p>Për periudhën nga 01.01.2017 deri më 31.12.2021, sipas listave të vëna në dispozicion me leje legalizimi dhe kryqëzimi i tyre me personat që kanë bërë të mundur likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturës, rezultojnë se detyrimi për këtë taksë është në vlerën 43,115,950 lekë për 1291 persona, nga e cila kanë paguar detyrimet 381 persona me vlerë 12,996,634 lekë dhe kanë mbetur për likuidim deri datë 31.12.2021 gjithsej 910 persona me vlerë 30,119,316 lekë, e cila konsiderohet e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Berat.</p>			<p>arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet pa leje në vlerën 30,119,316 lekë ndaj 910 personave si dhe t'i kërkojnë Drejtorisë Rajonale Vendore AShK Berat, vendosjen e urdhër kufizimit mbi pasurinë, deri në pagesës e taksës së ndikimit në infrastrukturë.</p>
4	<p>Gjetje nga auditimi: Bashkia Berat për zbatimin e vendimeve gjyqësore për vitin 2020 ka shpenzuar vlerën 25,244,853 lekë, nga e cila vlera 16,211,833 i përket vendimeve gjyqësore me objekt dëmshpërblim page për largime nga puna të punonjësve për 22 raste, ndërsa vlera 9,033,020 lekë për 6 raste i përket vendimeve për çështje të tjera gjyqësore, si konstatim i pavlefshmërisë absolute të procesit të shpronësimit, dëmshpërblim dëmi etj.</p> <p>Për zbatimin e vendimeve gjyqësore për vitin 2021 është shpenzuar vlera 10,342,530 lekë, nga e cila 10,064,661 lekë i përket vendimeve gjyqësore me objekt dëmshpërblim page për largime nga puna të punonjësve për 9 raste, ndërsa vlera 277,869 lekë për 3 raste i përket vendimeve për çështje të tjera gjyqësore, si shfuqizim akti e anulim vendimi.</p> <p>Për vitin 2020 dhe 2021 nga Bashkia Berat për zbatimin e vendimeve gjyqësore pavarësisht objektit të dëmshpërblimit, është shpenzuar vlera 35,587,383 lekë, e cila konsiderohet efekt financiar negativ në buxhet.</p>			<p>Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Berat të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatohen, me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kanë sjellë humbjen e çështjes gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për çështjen e largimit të punonjësve nga puna dhe çështje të tjera, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet</p>
5	<p>Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi në terren të objektit “Ndërtim i linjës kryesore dhe shpërndarjes së furnizimit me ujë të Njësisë Administrative Velabisht”, Bashkia Berat, rezultojnë se tubacioni i situacionuar me DN 200 mm dhe t=14.7 mm, është vendosur jo sipas preventivit të ripunuar, por me t=11.9 mm. Gjithashtu edhe tubacioni i situacionuar me DN 63 mm dhe t= 4.7 mm, është vendosur jo sipas preventivit të ripunuar, por me t=4 mm. Nga sa sipër, vlera e tyre prej 36,698,392 lekë me TVSH, përbën shpenzim jo me efektivitet të fondeve të Bashkisë Berat</p>			<p>Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Berat, nëpërmjet strukturave teknike të bashkisë, të marrë masa për eliminimin e rasteve të mësipërme në të ardhmen, duke ushtruar kontrolle periodike gjatë realizimit të kontratave të realizuara me fondet publike, në mënyrë që të realizohen objekte që ti shërbejnë komunitetit me efektivitet, për një kohë sa më të gjatë dhe në mënyrë cilësore</p>
6	<p>Gjetje nga auditimi Nga auditimi i përllogaritjes së fondit limit të objektit “Studim Projektimi KUZ Lagjja Uznovë, Rajoni nr.3 dhe fshatit Duhanas”, zhvilluar në vitin 2021, rezultojnë se është marrë pa asnjë referencë teknike të dokumentuar kostoja e llogaritshme 199,904,106 lekë pa TVSH për lagjen Uznovë dhe 98,158,293 lekë pa TVSH për fshatin Duhanas, duke bërë llogaritjen e fondit limit të projektimit veçmas për secilin nën objekt respektivisht</p>			<p>Rekomandim: Nga Bashkia Berat të merren të gjitha masat e duhura ligjore për arkëtimin e vlerës prej 3,394,267 lekë pa TVSh nga z. L. B., në cilësinë e hartuesit të fondit limit të objektit “Studim Projektimi</p>

	<p>9,285,473 lekë pa TVSH për KUZ Uznovë dhe 6,645,647 lekë pa TVSH për fshatin Duhanas, ose 15,931,120 lekë gjithsej. Llogaritja e fondit limit si dy objekte të ndara, është e paargumentuar teknikisht dhe ka rritur fiktivisht fondin limit të këtij objekti prokurimi. Nga rillogaritja e fondit limit, sipas rrugës së ndjekur nga hartuesi i fondit limit, fondi limit i këtij objekti do të jetë 12,195,733 lekë, ose 3,735,387 lekë më shumë se fondi i planifikuar i projektimit. Për sa më sipër, diferenca prej 3,394,267 lekë midis ofertës ekonomike fituese 15,590,000 lekë me vlerën e fondit limit që duhet të ishte llogaritur në fakt 12,195,733 lekë, është dëm ekonomik ndaj buxhetit të Bashkisë Berat</p>			<p>KUZ Lagjia Uznovë, Rajoni nr.3 dhe fshatit Duhanas”, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e llogaritjes së gabuar të fondit limit</p>
7	<p>Gjetje nga auditimi:Në tenderin me objekt “Blerje mjet zjarrfikës për MZSH”, me vlerë të fondit limit 9,247,500 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2019 kanë marrë pjesë 7 operatorë ekonomik, midis të cilëve edhe operatori ekonomik “A... G...” ShPK , i renditur i pari, me vlerën më të ulët të ofertës ekonomike prej 6,950,000 lekë pa TVSh , i cili plotëson kriteret e vendosura në DST, por nga KVO ky operatorë ekonomik është skualifikuar padrejtësisht. Nga Autoriteti Kontraktor është shpallur fitues operatori ekonomik “T...” ShPK , me vlerë të ofertës ekonomike 8,480,000 lekë pa TVSh. Skualifikimi i operatorit ekonomik “A... G...” ShPK , i cili plotëson kriteret e vendosura në DST dhe kualifikimi dhe shpallja fitues e operatorit ekonomik “T...” ShPK , me vlerë të ofertës ekonomike më të lartë, ka sjellë dëm ekonomik në vlerën 1,530,000 lekë pa TVSh, si diferencë midis dy ofertave të operatorëve ekonomik.</p>			<p>Rekomandim:Kryetari i Bashkisë Berat të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për arkëtimin e vlerës prej 1,530,000 lekë pa TVSh nga anëtarët e KVO: znj.A. Zh., ekonomiste, me detyrë specialiste e prokurimeve z.G. B., me detyrë ish specialist i prokurimeve, ndërprerë marrëdhëniet e punës me urdhrin n.80, datë 26.12.2019, z.L. B., me detyrë zv/kryetar i Bashkisë Berat</p>
8	<p>Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se në procedurat e prokurimit me objekt: “Ujësjetësi i fshatit Duhanas, fshati Lapardha 1, Otlak dhe Orizaj”, me vlerë të fondit limit 372,286,076 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2020, “Ndërtimi i linjës kryesore dhe shpërndarjes së furnizimit me ujë të Njësisë Administrative Velabisht Bashkia Berat”, me vlerë të fondit limit 131,138,064 lekë pa TVSh , zhvilluar në vitin 2020, “Blerje mjet zjarrfikës për MZSH”, me vlerë të fondit limit 9,247,500 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2019, “Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete te varfëra dhe te pa favorizuara”, me vlerë të fondit limit 9,942,305 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2020, “Rikonstruksion i rrugës “Inerte”, ndërtim ure b/a, Njësia Administrative Otlak”, me vlerë të fondit limit 18,497,975 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2020”, në procesverbalin e mbajtur nga njësia e prokurimit, nuk është bërë argumentimi i kriterëve të veçanta për kualifikim të DST që lidhen me kapacitetin teknik, në kundërshtim me kërkesat e pikës 2, neni 61, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar. Gjithashtu në këto procedura prokurimi janë vendosur kriteret të cilët nuk janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, elementë të cilët kanë efekt në kufizimin e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomik</p>			<p>Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Berat të analizojë arsyet dhe të nxjerrë përgjegjësitë e anomalive të konstatuara në hartimin e kriterëve të veçanta të DST. Njësia e prokurimit në çdo procedurë të jap argumentim për çdo kriter të veçantë për kualifikim që lidhen me kapacitetin teknik dhe jo vetëm, të vendosur në DST dhe argumentet të dokumentohen me procesverbal. Të gjitha kriteret e vendosura, të kenë lidhje të ngushtë me përmasat e natyrën e kontratës</p>

<p>Gjetje nga auditimi: jatë vitit 2020 janë marrë angazhime të reja buxhetore pa pasur fonde në dispozicion, duke krijuar detyrime të reja të prapambetura në vlerën 86,004,848 lekë, duke e çuar vlerën e detyrimeve të prapambetura me burim financimi të ardhurat e veta në datën 31.12.2020 në 142,082,430 lekë, pothuaj përsëri në vlerën e tyre në fillim të vitit. Vlera e detyrimeve të prapambetura me burim financimi të ardhurat e veta në datën 31.12.2020, krahasuar me këtë vlerë në fillim të këtij viti ushtrimor është ulur me 6,812,707 lekë, ose në masën prej 5%, një vlerë shumë e vogël.</p> <p>Vlera e detyrimeve të prapambetura me burim financimi të ardhurat e veta në datën 01.01.2021 është 142,082,430 lekë. Nga kjo vlerë në planin e buxhetit vjetor 2021 është planifikuar për likuidim vlera 112,947,611 lekë, nga e cila është likuiduar 104,762,695 lekë, ose 93% e vlerës së planifikuar, diferenca prej 37,319,735 lekë e pa likuiduar gjatë vitit 2021. Por gjatë vitit 2021 janë krijuar përsëri detyrime të reja të prapambetura në vlerën 58,207,485 lekë, duke e çuar në 31.12.2021 vlerën e detyrimeve të prapambetura me burim financimi të ardhurat e veta në 95,527,220 lekë.</p> <p>Pra në total, gjatë vitit 2021 vlera e detyrimeve të prapambetura me burim financimi të ardhurat e veta në datën 31.12.2021, krahasuar me këtë vlerë në fillim të vitit ushtrimor, është ulur me 46,555,210 lekë, ose në masën prej 33%. Peshën kryesore të detyrimeve që kanë si burim financimi të ardhurat e veta e zënë ato për investime prej 75,938,443 lekë, të ndjekura nga detyrime për mallra në vlerën 11,002,467 lekë, detyrime për zbatimin e vendimeve gjyqësore në vlerën 4,954,630 lekë, detyrime për shërbime në vlerën 3,380,140 lek. U konstatua një numër i konsiderueshëm i urdhërave të prokurimit të pa vulosur në degën e thesarit, përpara se të zhvillohet procedura e prokurimit publik.</p>		<p>Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Berat dhe Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave, të marrin masa për likuidimin e vlerës së kontratave të lidhura midis Bashkisë Berat dhe kontraktorëve, sipas afateve të përcaktuara në kontratë, duke eliminuar në këtë mënyrë shkakun e krijimit të detyrimeve të prapambetura. Lidhja e kontratës të bëhet vetëm pasi fondi që parashikon procedura e prokurimit do të jetë në dispozicion (në llogarinë e thesarit) të autoritetit kontraktor. Për çdo procedurë prokurimi, urdhri i prokurimit të depozitohet menjëherë në degën e thesarit përpara zhvillimit të procedurës. Gjithashtu të marrë masa që gjatë zbatimit të buxhetit, prioritet të kenë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës</p>
---	--	---

3. Konkluzioni dhe opinionin i auditimit

OPINIONI I AUDITIMIT

Opinionin mbi pasqyrat financiare të vitit 2021

Ne kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të konsoliduara të Bashkisë Berat për vitin ushtrimor 2021, ku përfshihet pasqyra e pozicionit financiar, performancës financiare, pasqyra e flukseve monetare, ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto etj., si dhe shënimet shpjeguese që shoqërojnë pasqyrat.

Sipas mendimit tonë, pasi kemi marrë evidenca të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të besueshme të auditimit, mbështetur në standardet ISSAI 1700 , ISSAI 1705 dhe ISSAI 1200, shprehim një opinion të modifikuar (kualifikuar) për llogaritë vjetore të vitit ushtrimor 2021 të Bashkisë Berat, duke arritur në përfundimin se anomali të konstatuara apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale por jo të përhapura në llogaritë vjetore të konsoliduara të vitit 2021, të cilat justifikojnë dhënien e **opinionit të modifikuar**¹. Këto anomali janë të shprehura te baza për opinionin e auditimit.

Baza për opinionin mbi pasqyrat financiare

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik. Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare”, pjesë e raportit tonë përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare të një institucioni ndërkombëtar, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 5000- Auditimi i Institucioneve Ndërkombëtare- Udhëzues për SAI-n. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë vlerën e materialitetit prej 20.9 milion lekë, si dhe anomali të konstatuara gjatë auditimit, si më poshtë:

- Për llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm”, nuk disponohen dokumente analitike justifikuese për të vërtetuar vlerën e pasqyruar në pasqyrat e pozicionit financiar prej 62,019,852 lekë;
- Llogaria 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” është pasqyruar më pak për vlerën 572,787,000 lekë në mbyllje të vitit ushtrimor 2021;
- Llogaria 202 “*Studime dhe kërkime*” është pasqyruar më shumë në vlerën 52,591,860 lekë në mbyllje të vitit ushtrimor 2021;
- Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” është pasqyruar më shumë në vlerën 63,016,632 lekë në mbyllje të vitit ushtrimor 2021;
- Mos sistemimi në llogaritë përkatëse të aktivitetit, i llogarisë 231, e cila paraqitet në vlerën 1,666,664,462 lekë, për investimet e përfunduara dhe marra në dorëzim.

II. Opinionin mbi përputhshmërinë

Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion, kemi konstatuar se në veprimtarinë e Bashkisë Berat, janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin”, të cilat në gjykimin profesional të audituesit të pavarur, janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinionit të modifikuar (kualifikuar) të përputhshmërisë.

¹ “Opinion i modifikuar”, jepet në raste kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomali të, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë vjetore.

Baza për dhënien e opinionit

- Bashkia Berat nuk ka ngritur një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash të shkruara për këtë qëllim.

-Investimet nga të ardhurat e veta kanë një nivel të ulët të realizimit krahasuar me planifikimin. Për vitin 2020 investimet janë planifikuar në vlerën 174,671 mijë lekë, realizuar 89,288 mijë lekë, ose në masën 51 %, ndërsa për vitin 2021, vlera e planifikuar është 282,200 mijë lekë, realizuar 155,906 mijë lekë, ose në masën 55 %.

-Nuk janë marrë masa të plota për uljen e detyrimeve të prapambetura. Edhe pse janë likuiduar gjatë vitit buxhetor detyrime të prapambetura, nga ana tjetër si gjatë vitit 2020 dhe 2021 janë krijuar detyrime të reja të prapambetura, duke çuar në 31.12.2021 vlerën e tyre, me burim financimi të ardhurat e veta në 95,527,220 lekë.

-Janë konstatuar anomali në hartimin e kritereve të veçanta të DST në procedurat e prokurimit publik, pasi janë vendosur kritere të cilat nuk kanë lidhje të ngushtë me natyrën dhe madhësinë e kontratës.

-Janë konstatuar anomali në procesin e kualifikimit dhe vlerësimit të ofertave të operatorëve ekonomik, si dhe në zbatimin e kontratave të punimeve, si pasojë e të cilave është konstatuar një dëm ekonomik në vlerën 8,686,164 lekë.

-Për vitin 2020 dhe 2021 nga Bashkia Berat për zbatimin e vendimeve gjyqësore pavarësisht objektit të dëmshpërblimit, është shpenzuar vlera 35,587,383 lekë, e cila konsiderohet efekt financiar negativ në buxhet, për të cilat nuk është kryer analizë dhe nuk janë nxjerrë përgjegjësitë administrative nga Titullari.

- Për taksën e ndikimit në infrastrukturë, është konstatuar një vlerë e pa arkëtuar prej 30,119,316 lekë, e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Berat.

- Nuk janë marrë masa të plota për arkëtimin e debitorëve, pasi në datën 31.12.2021 rezulton një vlerë e pa arkëtuar prej 236,557 mijë lekë, e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Berat, e krijuar nga mos pagesa e kategorisë së taksapaguesve familjarë dhe privat.

Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë Berat:

Drejtimi i njësisë vendore, është përgjegjës për përgatitjen dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi të raportimit financiar. Drejtimi është përgjegjës për ngritjen dhe monitorimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, me qëllim shmangien e gabimeve apo mashtrimet e mundshme, për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e miratuara, për kontrollin e procesit të raportimit financiar dhe realizimit të të ardhurave nga taksat e tarifave vendore, planifikimin dhe realizimin e buxhetit dhe të gjithë veprimtarisë që zhvillon Bashkia Berat.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH-së:

Përgjegjësia e audituesit të KLSH-së është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijojme bindje, të cilat do të shprehen në opinionin e grupit të auditimit mbi saktësinë, vërtetësinë dhe besueshmërinë e hartimit të pasqyrave financiare dhe raportimit financiar, nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale në përputhje me kuadrin e rregullator të raportimit financiar, si dhe nëse hartimi i kritereve të DST, vlerësimi i ofertave dhe zbatimi i kontratave të punimeve janë në përputhshmëri me kriteret e fushës së prokurimeve publike dhe kriteret e kontratave të lidhura. Audituesi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare dhe fushave të tjera të auditimit dhe i përshkruan ato në raportin e auditimit. Siguria që jepet nga audituesi është një siguri e arsyeshme e cila është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet, mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë.

Përgjegjësia e audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme për shkallën e përputhshmërisë së aktivitetit të institucionit të audituar me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi dhe të jap opinion për këtë.

II. Hyrja (Të dhëna mbi Projektin e Auditimit)

Mbështetur në Ligjin 154/2014 Datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH”, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 55/1, datë 18.01.2022 i ndryshuar, miratuar nga Kryetari i KLSH, në institucionin Bashkia Berat është kryer auditimi “Financiar dhe i përputhshmërisë”, i cili ka mbuluar periudhën nga data 01.10.2019 deri më datën 31.12.2021 Auditimi u krye nga grupi i auditimit me përbërje:

1. B. M., përgjegjës grupi
2. H. I., anëtar grupi
3. A. Z., anëtar grupi

Auditimi u krye me zgjedhje, mbi bazën e riskut

OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA

1. Objekti i auditimit. Objektivat specifike të auditimit ose pohimet për marrjen e garancive për besueshmërinë e pasqyrave financiare janë:

- Pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim si përkatësia, plotësia, saktësia, periudha, klasifikimi, ligjshmëria dhe rregullsia.
- Pohimet rreth gjendjeve të llogarive në fund të periudhës si ekzistenca, të drejtat dhe detyrimet, plotësia etj.

- Marrja e garancive nëse veprimtaria e institucionit sipas fushave të përcaktuara në programin e auditimit, është zhvilluar në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi,

2. Qëllimi i auditimit. Për pasqyrat financiare: të rrisim shkallën e besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinionit nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë financiare.

Kjo përgjegjshmëri ka të bëjë drejtpërdrejt me menaxhimin e shëndoshë financiar si dhe me faktin që rezultatet e përdorimi i burimeve janë të paraqitura drejt dhe në përputhshmëri me kornizën e raportimit financiar.

Për auditimin e përputhshmërisë, qëllimi i auditimit është të kuptohet se deri në çfarë shkalle subjekti zbaton kuadrin rregullator në fuqi, zbulimi i shkallës së devijimeve nga standardet e pranuar dhe identifikimi i rasteve të shkeljes së parimeve të ligjshmërisë, efikasitetit, efektivitetit dhe ekonomicitetit të menaxhimit financiar, me qëllim që për rastet individuale të identifikuar të detyrohen personat përgjegjës të mbajnë përgjegjësi, si dhe të merren masa për parandalimin e shkeljeve në të ardhmen.

3. Identifikimi i çështjes.

Raporti i Auditimit synon të identifikojë përmbushjen e rolit të strukturave të Bashkisë Berat dhe përgjegjësitë, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi.

Çështjet mbi të cilat është shtrirë auditimi: menaxhimi financiar, kontrolli dhe auditimi i brendshëm, planifikimi dhe zbatimi i planit të buxhetit, vlerësimi i raportimit financiar, planifikimi, realizimi, zhvillimi i procedurave të prokurimeve publike dhe zbatimin e kontratave të punëve publike, planifikimi dhe zhvillimi i territorit, aktiviteti i IMT, zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese:

Titullarët e njësive publike, përgjigjen për vendosjen e përmbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të njësive publike, nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe përdorimit të fondeve publike, në mënyrë të

ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe eficiency, sigurimin, nëpërmjet akteve të brendshme administrative, të zbatimit të rregullave për kontrollin e brendshëm.

Nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare, për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar.

Strukturat drejtuese të Bashkisë Berat, për problematikat e trajtuara lidhur me çështjet nën auditim për hartimin dhe zbatimin e buxhetit, mbi organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit, hartimin e pasqyrave financiare dhe inventarizimin e pasurisë; mbi prokurimet me fonde publike dhe zbatimin e kontratave, lejet e ndërtimit etj., mbajnë përgjegjësi në lidhje me mangësitë, në shkelle të dispozitave ligjore të përcaktuara nga ligjet nr. 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; nr. 10296, datë 08.07.2010 i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”; nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të akteve të tjera ligjore e nënligjore në aktivitetin financiar dhe përputhshmërisë. Problematikat dhe përgjegjësitë lidhur me to, të konstatuara gjatë procesit të auditimit, janë evidentuar në akt-konstatimet dhe aktverifikimet e mbajtura, në projektraportin e auditimit dhe në këtë raport përfundimtar.

5. Përgjegjësitë e audituesve

Përgjegjësia e audituesve të KLSH-së, është që nëpërmjet auditimit të mund të shprehë një opinionin mbi saktësinë, vërtetësinë dhe besueshmërinë e raportimit të pasqyrave financiare si dhe çështjet që lidhen me përputhshmërinë për fushat e tjera të aktivitetit të njësisë vendore si procedurat e prokurimit me fonde publike, buxheti, të ardhurat dhe shpenzimet, administrimin e territorit etj.

Në këtë funksion, auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, sipas INTOSAI.

Këto standarde kërkojnë që ne t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme, për faktin nëse Pasqyrat Financiare, nuk kanë gabime materiale, qoftë nga mashtrimi ose gabimi.

Siguria e arsyeshme i referohet një niveli të pranueshëm sigurie, por nuk garanton asnjëherë sigurinë absolute. Auditimi në pajtueshmëri (apo në përputhje) me standardet nuk presupozonë që të zbulojë gjithnjë një gabim material kur ai ekziston. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi auditimi rreth shumave dhe raportimit të shifrave në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi profesional i audituesit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Gjatë procesit të vlerësimit të rrezikut, audituesi vlerëson nivelin e kontrollit të brendshëm në entitet, në mënyrë që të programojë procedura auditimit që janë të përshtatshme për kushtet e entitetit.

Ne besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin tonë në lidhje me pasqyrat financiare dhe përputhshmërinë për fushat e tjera të audituara.

6. Kriteret e vlerësimit.

Kriter vlerësimi është i gjithë kuadri rregullator në fuqi (baza ligjore, aktet e brendshme të institucionit, kushtet e kontratës etj., me të cilat krahasohet aktiviteti i njësisë vendore që auditohet) dhe kryesisht:

Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2017 “Për vetëqeverisjen vendore”; ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” si dhe ligjet e udhëzimet vjetore

të Ministrisë së Financave për buxhetin; ligji nr. 147/2015 “Për buxhetin e vitit 2016”; ligji nr. 130/2016, datë 17.12.2016 “Për buxhetin e shtetit të vitit 2017”; ligji nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar; UMF nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar; ligji nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar; UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Menaxhimi i aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar; legjislacioni për administrimin e territorit etj.

-Rregullore e Brendshme e Organizimit dhe Funksionimit të Këshillit Bashkiak dhe aparatit administrativ të Bashkisë.

7. Standardet e auditimit

Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI) të INTOSAI-t.

Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) të IFAC.

Praktika të mira të fushës si: Manuali i Auditimit Financiar dhe të

Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të adituesve;

Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI "Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë", etj.

Manualet e Auditimit Financiar dhe Përputhshmërisë të miratuar nga Kontrollit i Lartë i Shtetit, Rregullat, Udhëzimet e KLSH-së etj.

Gjatë zhvillimit të auditimit nga grupi u patën parasysh dhe u zbatuan:

-Qasjen e auditimit mbi bazë risku (rreziku), sipas së cilës të gjithë përpjekjet dhe burimet drejtohen në fushat dhe çështjet më të rëndësishme dhe ku vlerësimi i riskut është në nivelet më të larta;

-Përdorimin e gjykimit profesional duke u bazuar në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, Manualin e auditimit financiar dhe të përputhshmërisë.

Gjithashtu auditimi është kryer në zbatim të:

Ligjit organik i KLSH-së nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;

Rregullores së Brendshme “Mbi organizimin dhe funksionimit administrativ të KLSH-së”, miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 85, datë 30.06.2015;

-Rregullores “Mbi Procedurat e auditimit në KLSH”, miratuar me vendimin nr. 63, datë 22.06.2020 të Kryetarit të KLSH-së.

8. Metodat (Procedurat) e auditimit.

Përcaktimi i procedurave të auditimit nga grupi i auditimit u bë duke pasur parasysh parimet themelore të auditimit si më poshtë:

Procedurat e auditimit kanë për qëllim të sigurojnë evidenca të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të besueshme cilat do të përbëjnë një bazë të arsyeshme për vlerësimet dhe përfundimet e auditimit (ISSAI 300, 3.5.1).

Audituesit përzgjedhin ato procedura auditimi të cilat sipas gjykimit të tyre profesional janë më të përshtatshme në varësi të rrethanave (ISSAI 300, 3.4.5)

Për arsye se në bazë të vlerësimi sistemi i kontrollit të brendshëm është përcaktuar jo në nivelin e duhur, grupi i auditimit u mbështetet më shumë në procedurat thelbësore dhe më pak në qasjen e mbështetur në sistemin e kontrollit të brendshëm. Siguria e auditimit është marrë më shumë nga procedurat thelbësore.

1. Kontrolli aritmetik.

Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në

llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim. (Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve)

2. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese.

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë asnjë gabim aritmetik, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (Urdhër shpenzimeve) konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar. UMF nr. 30, dt. 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

3. Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese.

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoj përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt.

4. Kontrolli i vlerësimit.

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

5. Konfirmim nga të tretët

Nëse subjekti që auditohet ka të konfirmuara (Rakorduara) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave ose të çdo regjistrimi tjetër.

6. Kontrolli sipas një treguesi.

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “*jashtë normales*”, që përbëjnë tregues të parregullsive kontabël. Mund të përmendim nëse ka mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.

7. Intervistimi

8. Raporte dhe Informacione

9. Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit (akt-konstatimet, akt-verifikimet dhe letrat e punës), i cili është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur konkluzionet e auditimit. Në përfundim të auditimit, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, u përgatit Raporti i Auditimit.

Nga subjekti i audituar kanë ardhur kundërshti lidhur me çështjet e auditimit të cilat janë trajtuar nga grupi i auditimit.

9. Dokumentimi i auditimit

Është bërë mbështetur në kërkesat e Manualeve të Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë, si dhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit, ISSAI 1230 “Dokumentimi i Auditimit”. Nga grupi i auditimit është përgatitur dokumentacioni i duhur mbi bazën e të cilit mbështeten konkluzionet e auditimit. Për këtë janë përgatitur 10 akte konstatimit, 2 akte verifikimi, projektraporti i auditimit dhe ky raport përfundimtar i auditimit. Puna e dokumentuar në këto dokumente është mbështetur mbi bazën e evidencave konkrete, të mara nga subjekti i audituar, të cilat kanë plotësuar tre cilësitë e duhura: kanë qenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të besueshme. Procedurat e ndjekura të auditimit janë përshkruar nga secili auditues në aktet e konstatimit, gjatë trajtimit të çështjes sipas ndarjes së detyrave, ku janë evidentuar edhe evidencat të cilave ju jemi referuar. Një pjesë e evidencave të cilat duhet të mbështesin konkluzionet kryesore të auditimit janë pjesë e dosjes së auditimit. Gjatë fazës së auditimit në teren grupi i auditimit ka dokumentuar në informacionet periodike gjetjet kryesore të auditimit. Për çështjet e kundërshtuara nga subjekti prej tij janë bërë kundërshti të cilat janë trajtuar nga grupi i auditimit. Gjithashtu është kryer takimi ballafaques me subjektin pranë zyrave të KLSH.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

Informacion i përgjithshëm mbi subjektin e audituar. Bashkia Berat kufizohet në veri me bashkitë Kuçovë dhe Dimal (Ura Vajgurore), në lindje me bashkinë Gramsh dhe Skrapar, në jug me bashkinë Poliçan, ndërsa në perëndim me bashkinë Mallakastër. Qyteti shtrihet përgjatë lumit Osum dhe rrëzë malit Tomor. Sipas Censurit të vitit 2011, bashkia numëron 60.031 banorë, ndërsa sipas Regjistrimit Civil ajo numëron një popullsi prej 98.875 banorë.

Bashkia ka një sipërfaqe prej 379.98 km².

Qyteti i Beratit, për shkak të historisë së tij mijërvjeçare si zonë e banuar, mbart vlera historike dhe arkitektonike të rralla, duke u përfshirë kështu në vitin 2008 dhe në listën qyteteve muze të mbrojtur nga UNESCO. Qendra Historike e qytetit, ku bëjnë pjesë tre lagjet muze “Kala”, “Mangalem”, “Goricë” dhe Qendra Mesjetare, përfshijnë rreth 490 monumente kulture.

Bashkia e Beratit pas ndarjes së re territoriale është një bashkim mes qytetit dhe katër ish-komunave në afërsitë të tij, pra në total ka 5 njësi administrative si vijon: Njësi administrative Berat (qyteteti), njësi administrative Velabisht, Otlak, Sinjë, Roshnik.

Për vitin 2020, planifikimi i buxhetit për zërin e shpenzimeve me të ardhurat e veta vendore dhe transfertën e pa kushtëzuar, ka vlerën 1,134,803 mijë lekë, ndërsa realizimi në vlerën 816,589 mijë lekë, ose në masën 72%.

Për vitin 2021, planifikimi i buxhetit për zërin e shpenzimeve me të ardhurat e veta vendore dhe transfertën e pa kushtëzuar, ka vlerën 1,256,645 mijë lekë, ndërsa realizimi në vlerën 979,512 mijë lekë, ose në masën 78%.

Gjatë vitit 2020 janë marrë angazhime të reja buxhetore pa pasur fonde në dispozicion, duke krijuar detyrime të reja të prapambetura në vlerën 86,004,848 lekë, duke e çuar në 31.12.2020 vlerën e detyrimeve të prapambetura me burim financimi të ardhurat e veta në 142,082,430 lekë, pothuaj përsëri në vlerën e tyre në fillim të vitit (me diferencë 6,812,707 lekë më pak më 31.12.2020 krahasuar me 31.12.2019).

Gjatë vitit 2021 janë krijuar detyrime të reja të prapambetura në vlerën 58,207,485 lekë, duke e çuar në 31.12.2021 vlerën e detyrimeve të prapambetura me burim financimi të ardhurat e veta në 95,527,220 lekë.

Për vitin 2020, planifikimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore është në vlerën 528,209 mijë lekë dhe realizimi në vlerën 333,588 mijë lekë ose 63 %.

Për vitin 2021 planifikimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore është 500,173 lekë të dhe realizimi 412,173 mijë lekë ose 82 %.

Përshkrimi i auditimit, sipas pikave të programit

1. Auditim mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe Auditin e Brendshëm

Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK.

Në drejtim të vlerësimit të implementimit të komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm në Bashkinë Berat, nga grupi i auditimit janë kryer verifikimet për implementimin dhe plotësimin e kërkesave në lidhje me funksionimin, përgjegjshmërinë menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit për të gjithë komponentët si: “*Mjedisi i kontrollit*”, “*Menaxhimi i riskut*”, “*Aktivitetet e kontrollit*”, “*Informimi dhe Komunikimi*” si dhe “*Monitorimi*”, në referim të nenit 19 të Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*” i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015 “*Për disa shtesa dhe ndryshime*”, ku titullari i njësisë në sektorin publik krijojnë dhe vlerësojnë sistemet e MFK-së nëpërmjet këtyre komponentëve të lidhur me njëri-tjetrin. Thelbi i MFK-së ka të bëjë me menaxhimin dhe kontrollin e të ardhurave, shpenzimeve, aktiveve, detyrimeve, procedurave të tenderimit dhe kontraktimit si dhe mënyrës së funksionimit të njësisë.

1. **Titulli i gjetjes:** *KLSH ka konstatuar se në Bashkinë Berat ngritja dhe funksionimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, nuk është në nivelin e kërkuar sipas dispozitave ligjore.*

Situata:

I-Mjedisi i kontrollit. (Në zbatim të kërkesave të nenin 20 të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010) -Bashkia e Berat, me vendimin e Kryetarit të Bashkisë z. P. S. me shkresën nr. 737 prot., datë 07.02.2018, **ka miratuar rregulloren** për nivelin menaxhues dhe për punonjësit e tjerë të njësisë.

Për vitin 2019 numri i punonjësve është miratuar me Vendim të Kryetarit të Bashkisë nr.925, datë 26.11.2018 “Për miratimin e strukturës së administratës së bashkisë dhe të njësive shpenzuese në varësi të Bashkisë Berat për vitin 2019”, i ndryshuar.

Për vitin 2020 numri i punonjësve është miratuar me Vendim të Kryetarit të Bashkisë nr.120, datë 20.02.2020 “Për miratimin e strukturës së administratës së bashkisë dhe të njësive shpenzuese në varësi të Bashkisë Berat për vitin 2020 “, i ndryshuar.

Për vitin 2021 numri i punonjësve është miratuar me Vendim të Kryetarit të Bashkisë nr.827, datë 15.12.2020 “Për miratimin e strukturës së administratës së bashkisë dhe të njësive shpenzuese në varësi të Bashkisë Berat për vitin 2021.

Konstatohet se struktura organizative ka pësuar ndryshime nga viti në vit, ndryshime të cilat janë miratuar me Vendimet respektive të sipërcituara në të cilat janë krijuar shumë drejtori/ sektorë dhe agjenci ku është punësuar një numër i lartë punonjësish në këto sektorë, por të panevojshëm pasi në asnjërën prej tyre nuk janë përcaktuar detyrat konkrete ligjore që do kryhej dhe përcaktuar punën e secilës strukturë në veçanti.


Këto drejtori/ sektorë dhe agjenci nga ana e tyre nuk kanë hartuar rregullore të veçantë të funksionimit të tyre çka bie në kundërshtim me kërkesat e nenit 20, të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, pasi rregullorja aktuale që qarkullon në bashki nuk i ka të përcaktuara detyrat për funksionet e reja që i janë deleguar nga qeverisja qendrore, njësit administrative të krijuar në zbatim të reformës territoriale, pavarësisht se në rregulloren aktuale që përdoret ka përshkrim të detyrave për disa nga drejtorit kryesores si financën Taksat, Burimet Njerëzore, Planifikim e Zhvillim Territorin, Shërbimet Publike, etj.

➤ **Politikat menaxheriale dhe stili i Punës**

Punësimi në Bashkinë e Berat bëhet në zbatim të Ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe Ligjit nr.7961 /1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, VKM nr.243/2015 i ndryshuar me VKM nr.746/2018 Kreu I pika 1,2. Kjo procedurë rregullohet nga vet Strukturat e Bashkisë së Berat: - Drejtoria e Burimeve Njerëzore [DBNJ] është përgjegjëse për zbatimin e hapave të procedurës së punësimit sipas nenit 10 pika 1 e Ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe VKM nr.243/2015 i ndryshuar Kreu II;

- Komiteti i Përhershëm i Pranimit [KPP] në zbatim të përcaktimeve në Kreun III të VKM nr.243/2015 i ndryshuar ;

- Kryetari i Bashkisë në zbatim të nenit 64 pika e,ë,f,g të Ligjit nr.139/2015 “Per Vetëqeverisjen Vendore”.



Skema e procedurës së punësimit

Strukturat përgjegjëse të Bashkisë së Berat hartojnë në fillim të çdo viti Planin vjetor të pranimit në shërbimin civil konform Ligjit nr.152/2015 “Për nëpunësin civil” neni 18, VKM nr. 108/2014 “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”, VKB “Mbi miratimin e numrit maksimal të punonjësve dhe nivelit të pagave të tyre” si dhe Vendimeve të Kryetarit “Për miratimin e strukturave organizative të Bashkisë Berat” për çdo vit ushtrimor.

Planet vjetore janë miratuar me vendimet e sipërcituara dhe janë hartuar mbi nevojat e institucionit për vitin e ri ushtrimor, duke detajuar emërtimin e pozicionit dhe të njësive përbërëse në strukturë. Publikimi i vendeve vakante nga ana e Bashkisë Berat bëhet në faqen zyrtare të saj, konform VKM nr.243/2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive” i ndryshuar Kreu II pika 6.

Përshkrimin e punës të çdo pozicioni si dhe kriteret që duhet të plotësohen nga kandidatët duhet të jenë të përshkruara në Rregulloren e brendshme të Bashkisë. DBNJ nga ana e saj pasi njihet me planin vjetor, ndjek procedurën nga shpallja e njoftimit deri në përfundimin e saj, duke zbatuar përcaktimet ligjore në fuqi, Ligjin nr.152/2015 “Për nëpunësin civil”, VKM nr.108/2014 “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”, VKM nr.243/2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive” i ndryshuar.

-Referuar kërkesave të VKM nr. 177 datë 08.03.2017, struktura e Bashkisë Berat është miratuar me Vendimet të Kryetarit të Bashkisë nr.925 , datë 26.11.2018 “Për miratimin e strukturës së administratës së bashkisë dhe të njësive shpenzuese në varësi të Bashkisë Berat për vitin 2019 “, i ndryshuar ,

Nga 77 vende pune me statusin e nëpunësit civil, nga të cilat;:

- 1 (një) pozicion i kategorisë së lartë,
- 8 (tetë)pozicione të kategorisë së mesme drejtues,
- 8 (tetë)pozicione të kategorisë së ulët drejtuese
- 60 (gjashtëdhjetë) pozicione të kategorive ekzekutive.

Nga 5 vende pune të lira të paplotësuara me statusin e nëpunësit civil, si vijon;

- 1 (një) pozicion i kategorisë së lartë
- 1 (një) pozicione të kategorisë së mesme drejtues,
- 0 (zero) pozicione të kategorisë së ulët drejtuese
- 4 (katër) pozicione të kategorive ekzistuese

Sipas strukturës së miratuar me Vendim të Kryetarit të Bashkisë nr.120 , datë 20.02.2020 “Për miratimin e strukturës së administratës së bashkisë dhe të njësive shpenzuese në varësi të Bashkisë Berat për vitin 2020 “, i ndryshuar

Nga 94 vende pune me statusin e nëpunësit civil, nga të cilat;:

- 1 (një) pozicion i kategorisë së lartë,
- 10 (dhjetë)pozicione të kategorisë së mesme drejtues,
- 8 (tetë)pozicione të kategorisë së ulët drejtuese
- 75 (shtatëdhjetë e pesë) pozicione të kategorive ekzekutive

Nga 13 vende pune të lira të paplotësuara me statusin e nëpunësit civil, si vijon;

- 0 (zero) pozicion i kategorisë së lartë
- 5 (pesë) pozicione të kategorisë së mesme drejtues,
- 1 (një) pozicione të kategorisë së ulët drejtuese
- 7 (shtatë) pozicione të kategorive ekzistuese

Sipas strukturës së miratuar me Vendim të Kryetarit të Bashkisë nr.827 , datë 15.12.2020 “Për miratimin e strukturës së administratës së bashkisë dhe të njësive shpenzuese në varësi të Bashkisë Berat për vitin 2021 “,

Nga 91 vende pune me statusin e nëpunësit civil, nga të cilat;:

- 1 (një) pozicion i kategorisë së lartë,
- 10 (dhjetë) pozicione të kategorisë së mesme drejtues,
- 10 (dhjetë) pozicione të kategorisë së ulët drejtuese
- 70 (shtatëdhjetë) pozicione të kategorive ekzekutive

Nga 11 vende pune të lira të paplotësuara me statusin e nëpunësit civil, si vijon;

- 0 (zero) pozicion i kategorisë së lartë
- 3 (tre) pozicione të kategorisë së mesme drejtues,
- 2 (dy) pozicione të kategorisë së ulët drejtuese
- 6 (gjashtë) pozicione të kategorive ekzistuese

Nga auditimi rezulton se vendet vakante në Bashkinë e Berat janë krijuar jo vetëm si rezultat i ristrukturimeve, por edhe si rezultat i funksionimit të kontrolleve të brendshme. Një pasqyrim më i detajuar i numrit dhe arsyes së krijimit të vendeve vakante, si vijon;

Nr.	Arsyeja e lirim të vendeve	2019	2020	2021
1	KMCAP	0	0	0
2	Pension	5	2	2
3	Largim me Dëshirë	20	16	17
4	Shkurtime	24	7	5
5	Kontrate	1	5	6
6	Largim për mosparaqitje ne pune	1	0	0
7	Nderuar jete	0	0	0
8	Mase disiplinore	0	7	0
9	Ngritje ne detyre	2	2	1
10	Lirim pa motivacion (për funksionet me karakter politik)	15	0	0
TOTALI		68	39	31

Burimi i të dhënave: Drejtoria e Burimeve Njerëzore

Konstatohet se numri i personelit në Bashkinë e Berat referuar strukturave organizative, ka ardhur në rritje, por i paplotësuar sipas planit ndonëse edhe numri faktik i tyre ka ardhur në rritje. Në rregulloren e Bashkisë së Berat përshkrimet e punës së çdo pozicioni në strukturën organizative, nuk shoqërohen me përcaktimin e kriterëve të përgjithshme dhe atyre specifike të nevojshme/të domosdoshme, sipas përcaktimeve të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

Konstatim se në strukturën e Bashkisë së Berat nuk janë planifikuar pozicione me status “ekselent” në mos zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr.164 datë 05.10.2017; si dhe pozicione me status të “Grup i veçantë” ku përfshihen 17 (shtatëmbëdhjetë) nënkategori të ndryshme si: persona me aftësi të kufizuar, jetimë, komuniteteve të ndryshme (romë, egjiptianë etj) si personel administrativ, në kundërshtim kjo me Ligjin nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil” i ndryshuar neni 5; Ligjin nr.93/2014 “Për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara” neni 1/a; neni 2 pika a/b; neni 4 pika a/ b/ ë; Ligjin nr.15/2019 dt.13.03.2019“ Për Nxitjen e Punësimit” neni 3 pika 4 “Grupe të veçanta” (17 kategori sociale); neni 20 pika 1/a e 1/b; pika 2; pika 3.

➤ ***Mbi trajnimin e punonjësve në Bashkinë e Berat.***

Stafi administrativ ka zhvilluar trajnime sipas programeve (të detyrueshëm dhe fakultativ) ofruar nga ASPA nëpërmjet Platformës ZOOM, për njohuritë e tyre në lidhje me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, për Procedurat e Prokurimit Publik, Auditit i Brendshëm etj. Por nga Bashkia e Berat nuk rezulton të jenë hartuar Plane vjetore trajnimesh për punonjësit e saj, por përzgjedhja e personelit për trajnim është realizuar nga Drejtoria e burimeve njerëzore ose nga vet punonjësit. Trajnimi i punonjësve është i nevojshëm për të garantuar minimizimin e akteve të parregullta, gabimeve dhe shpërdorimeve, si dhe për të

kuptuar se direktivat e dhëna prej menaxherëve të njësisë kuptohen dhe arrihen nga punonjësit.

Përgjegjësia e menaxhimit në garantimin e profesionalizmit të punonjësve të tij fillon me miratimin e politikave dhe praktikave të duhura që lidhen me burimet njerëzore dhe që reflektojnë angazhimin për: • Caktimin e nivelit të njohurive dhe aftësive që kërkohen për çdo pozicion pune; • Verifikimin e kualifikimeve të kandidatëve për vendet e punës; • Marrjen në punë dhe ngritjen në detyrë vetëm të atyre personave që kanë njohuritë dhe aftësitë në nivelet më të larta; • Futjen e programeve të trajnimit që ndihmojnë punonjësit të zgjerojnë njohuritë dhe aftësitë e tyre. • Kryerjen e analizave periodike për njohuritë dhe aftësitë e kërkua për çdo pozicion pune dhe mbështetur në këto analiza, hartimin e planeve periodike për trajnimin e punonjësve; • Zhvillimin e profesionalizmit menaxherial nëpërmjet trajnimeve dhe marrjes në konsideratë të aftësive menaxhuese gjatë procesit.

Konstatohet se Drejtoria e Burimeve Njerëzore në bashkinë Berat nuk janë hartuar plane / programe vjetore për trajnimin e detyrueshëm të punonjësve, të cilat ndihmojnë në zgjerimin e njohurive të tyre për proceset e punës dhe të aftësive për t'i kryer me efikasitet ato, në kundërshtim me Ligjin nr. 10296 datë 8.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe “Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.

2- Menaxhimi i riskut (Në zbatim të kërkesave të nenin 21 të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010).

Nga Bashkia e Berat janë hartuar dhe miratuar Regjistrat e Riskut, ku identifikohen risqet që vijnë nga burime të brendshme dhe risqe që vijnë nga burime të jashtme:

Regjistri i Riskut për periudhën objekt auditimi 01.10.2019 deri 31.12.2022 janë miratuar konform Ligjit 10296 dt.08.07.2010, Kreu III, neni 10 ndryshuar me Ligjin nr.110/2015 si dhe Udhëzimit nr.16 dt.20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të MFK dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”. Ky regjistër është i konsoliduari, bazuar në analizën e riskut të çdo drejtorie dhe si *Synim* “Planifikimi dhe Përdorimi me efikasitet, efikasitet dhe transparencë të fondeve buxhetore në përputhje me misionin e Bashkisë së Berat, për arritjen e objektivave”. Në këtë Regjistër është paraqitur përshkrimi i risqeve për çdo drejtori, niveli i risqeve, kontrollet ekzistuese, veprimet e ndërmarra për të adresuar risqet, zotëruesi i riskut si dhe situatën e riskut pas detyrës së fundit, por nuk është pasqyruar mënyra apo rrugëzgjdhja e situatës në rastin e ndodhjes apo konstatimit të dukurisë.

Për vitin 2019, Me urdhrin nr. 207 datë 07.03.2019, ndryshuar me shkresën nr. 3859 datë 25.07.2019, është miratuar GMS, në bashkinë Berat ku është hartuar regjistri i riskut sipas drejtorive.

Për vitin 2020, Me urdhrin nr. 491 datë 17.07.2020, është miratuar GMS si dhe është emëruar koordinatori i riskut, në bashkinë Berat znj. A. T. me detyrë sekretari i Përgjithshëm, me shkresat përkatëse ju është kërkuar drejtorive hartimi i regjistrat të riskut sipas drejtorive. Me shkresën nr. 432/1 prot datë 26.02.2021 është dërguar “Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Drejtorisë së Përgjithshme të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik” regjistri i riskut për vitin 2020, **në përputhje me kërkesat e neni 21 të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010.**

Për vitin 2021, Me urdhrin nr. 383 datë 02.07.2020, është miratuar GMS si dhe është emëruar koordinatori i riskut, në bashkinë Berat znj. A. T., me shkresat përkatëse ju është kërkuar drejtorive hartimi i regjistrat të riskut sipas drejtorive, **në përputhje me kërkesat e neni 21 të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010.**

Me urdhrat e sipërcituar është ngritur Grupi i menaxhimit strategjik ku kryetar i GSM është Kryetari i Bashkisë dhe Koordinaore znj. A. T.

Edhe pse është përcaktuar koordinatori i riskut nuk janë miratuar gjurmët e auditimit në pajtueshmëri me kërkesat e UMF nr. 2, datë 6.02.2012 “Për procedurat standart të zbatimit

të buxhetit” pika 40 dhe ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010, neni 4 pika 19 “Gjurma e auditimit” përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to. Ajo përfshin mbajtjen e dokumentacionit, raportimin, kontabilitetin dhe sistemin e mbajtjes së dosjeve” dhe neni 16 pika 2.

-Konstatohet se urdhër shpenzimet nënshkruhen nga nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatuar si dhe nuk është deleguar e drejta e nënshkrimit të urdhër shpenzimeve për kryerje e transaksioneve, në referencë të nenit 21, pika 1,2 dhe 3, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.

Nga Kryetari i Bashkisë, nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues është punuar për te përmbushur qëllimet Bashkisë, siç janë parashtuar në raportin për menaxhimin financiar dhe Kontrollin, në pyetësorin e plotësuar “Për Menaxhimin financiar dhe kontrollin”, “Deklaratën e funksionimit të kontrollit brendshëm financiar publike”.

Bashkëpunimin e auditimit e Brendshëm, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, nëpërmjet veprimtarive efektive, eficientë dhe me ekonomi, pajtueshmërisë me legjislacionin dhe me aktet e brendshme e kontratat, informacioneve operative e financiare të besueshme e të plota dhe mbrojtjes së informacionit e të aktiveve.

3-Veprimtaritë e kontrollit (Në zbatim të kërkesave të nenin 22 të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010).

Nga dokumentacioni që na u vu në dispozicion lidhur me takimet e detyrueshme vjetore të GMS, që referuar Ligjit nr.10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe “Manualit të Menaxhimit financiar dhe kontrollin” citohet se “Grupi për Menaxhimin Strategjik duhet të mbledhet të paktën katër herë në vit. Vendimet e Grupit duhet të merren në mënyrë kolegjiale dhe objektive duke patur në vëmendje interesin publik dhe në përputhje me standardet etike të sektorit publik. Vendimet e Grupit duhet të pasqyrohen në dokumente dhe t’i vihen në dispozicion menaxhimit të njësisë”

Konstatohet se Bashkia Berat nuk ka miratuar një plan pune vjetor të GMS lidhur me aktivitetet dhe çështjet që do të analizohen, si dhe grafikon e takimeve që do të zhvillohen nga ana e këtij grupi si dhe referuar procesverbaleve vendimeve të takimeve nuk ka të dokumentuar takimet e GMS nuk ka asnjë dokument ku të vërtetoje mbi takimet e GMS për vitet 2020 e 2021 në kundërshtim të Ligjit nr.10296/2010 “Për Menaxhimin financiar dhe Kontrollin” dhe “Manualit të menaxhimit financiar dhe Kontrollin”

Strategjia e riskut përcakton mënyrën se si sillet institucioni ndaj risqeve dhe vendos kuadrin e përgjithshëm të procesit të menaxhimit të riskut. Strategjia e riskut e një njësie duhet të miratohet nga titullari i njësisë, e cila përgatitet nga NA dhe duhet t’u vihet në dispozicion punonjësve dhe të njihet prej tyre.

Duhet theksuar se në procesin e miratimit të planeve vjetore të punës, duhet të merren parasysh risqet më të rëndësishme që mund të ndikojnë në arritjen e objektivave të përcaktuara. Gjithashtu e rëndësishme është që të ketë një lidhje në mes të planeve vjetore të punës me planin strategjik të njësisë publike. Lidhjet e qarta midis planit strategjik, planit vjetor të punës dhe buxhetit vjetor shërbejnë si pikënisje për procesin e menaxhimit të riskut në çdo nivel të njësisë publike.

Nga auditimi rezulton se në lidhje me *identifikimi i riskut, vlerësimi i riskut, adresimi i riskut dhe shqyrtimi i riskut*: Nuk është hartuar asnjë strategji për menaxhimin e riskut, në kundërshtim me nenin 21, pika 2 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, ku citohet se; “Titullari i njësisë publike miraton një strategji risku, e cila përditësohet çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut”.

4- Informacioni dhe komunikimi (Në zbatim të kërkesave të nenin 23 të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010).

Informimin dhe komunikimi, realizohet sipas shkallës së strukturave, bazuar edhe në rregulloren e funksionimit të brendshëm.

Përveç kësaj mënyre, informimi realizohet edhe nëpërmjet publikimeve dhe njoftimeve të adresuara për publikun veçanërisht lidhur me vjeljen e detyrimeve për tatim taksat lokale, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 9920, datë 19.04.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

5-Monitorimi (Në zbatim të kërkesave të nenin 24 të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010).

Monitorimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit në përgjithësi, realizohet nëpërmjet organizimit të grupeve të punës ose komisionet përkatëse si për marrjen në dorëzim të punimeve të kontraktuara, në rastet e indentifikimit të detyrimeve për tatim taksat lokale etj.

Një formë e monitorimit, është deklarata e vetëvlerësimit të sisteme të kontrollit të brendshëm.

Kriteri:

Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 20, 21.

Shkaku:

Neglizhencë e drejtorive/sectorëve për hartimin e rregulloreve, përditësimin e regjistrimit të riskut si dhe hartimin e strategjisë së riskut

Ndikimi/Efekti:

Mungon ndarja e qartë e detyrave sipas drejtorive/sectorëve, mos identifikim i shkallës së riskut, mos trajnim efektiv për rritjet profesionale të stafit.

Rëndësia: *E mesme*

Rekomandimi:

- Kryetari i Bashkisë Berat, në cilësinë e Nëpunësit Autorizues, të marrë masa për njohjen dhe menaxhimin nga stafi të ligjit për MFK dhe manualit përkatës të tij, për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit si dhe miratimin e gjurmëve të auditimit.

- Drejtorja e Burimeve Njerëzore të marrë masa për përditësimin e rregullores duke përcaktuar qartë detyrat dhe funksionet për çdo pozicioni pune, të hartojë programe të trajnimeve për ngritjen profesionale të stafit si dhe vendosjen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.

1.2. Organizimi i njësisë së Auditit të Brendshëm

Titulli i gjetjes: KLSH ka konstatuar së sektori i Auditit të Brendshëm funksionon me një auditues dhe jo me tre auditues sipas përcaktimeve të VKM nr.83 datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësisë së Auditimit të Brendshëm në sektorin Publik” si dhe mos auditimi i sektorëve me risk të lartë.

Situata:

Njësitia e auditimit të brendshëm NJAB është e organizuar në nivel sektori dhe me Vendim të Kryetarit të Bashkisë nr. 925, date 26.11.2018 është “Miratuar struktura e administratës së bashkisë dhe të njësive shpenzuese të saj” për vitin 2019; me Vendim të Kryetarit të Bashkisë nr. 120, date 21.02.2020 është “Miratuar struktura e administratës së bashkisë dhe të njësive shpenzuese të saj” për vitin 2020 si dhe me Vendim të Kryetarit të Bashkisë nr. 827, date 15.12.2020 është “Miratuar struktura e administratës së bashkisë dhe të njësive shpenzuese të

saj” për vitin 2021, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe pikat 3 dhe 6 të, VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”, me emërtesën “Njësia e Auditimit të Brendshëm” dhe ka si funksion kryesor mbështetjen e menaxhimit të lartë në zbatimin e objektivave, për Bashkinë e Berat, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni 10, germa “c” si dhe nenit 64, germa “a” të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”.

1.a Situata e strukturës së NJAB në Bashkinë e Berat nga data 01.10.2019 deri më 31.12.2021 paraqitet në tabelën si vijon;

Nr	Nga data e krijimit deri me 31.12.2021	Funksioni	Arsimimi	Vjetërsi ne pune	Vjetërsi në auditim/vite	Çertifikimi	Trajnime të vijueshme
Për vitin 2019							
1	Xh. M.	P.Sektori	I Larte	39	16	Nr 039, v.2005	40 ore
2	O. H.		I Larte	11	3	Nr 1945,v.2018	40 ore
3...	A. B.		I Larte	11	5	Nr 1252,v.2012	40 ore
Për vitin 2020							
1	Xh. M.	P.Sektori	I Larte	40	17	Nr 039, v.2005	40 ore
2	O. H.		I Larte	12	4	Nr 1945,v.2018	40 ore
Për vitin 2021							
1	Xh. M.	P.Sektori	I Larte	41	18	Nr 039, v.2005	40 ore
2	O. H.		I Larte	13	5	Nr 1945,v.2018	40 ore

Burimi i të dhënave: Njësia e Auditimit të Brendshëm

Nga auditimi u konstatua se struktura organizative e Bashkisë Berat për vitet 2020 dhe 2021” është përcaktuar që NJAB të ketë në përbërjen e saj 3(tre) punonjës, por që për periudhën nën auditim rezulton se kjo njësi ka funksionuar me 2 (dy) punonjës (1 përgjegjësi i njësive dhe 1 specialist audit), në kundërshtim me ligjin nr. 114/2015, “Manualit të Auditimit të Brendshëm” miratuar nga Ministër i Financave nr.100/ 2016 dhe VKM nr.83/2016, përcaktohet qartë që në strukturën e [AB] mund të punësohen deri në 1/3 e punonjësve të pa certifikuar si auditues të brendshëm dhe gjatë afatit 2 vjeçar zhvillon trajnimet e mjaftueshme për tu certifikuar.[NJAB].

➤ **Trajnimet e [NJAB] dhe certifikimet**

Referuar ligjit nr.10296/2010, Manualit të MFK miratuar me urdhrin e Ministrit të Financave Nr.8980, dt. 15.07.2010, Manuali i Ri me Urdhrin e Ministrit të FE nr.108/2016 të MFK, Ligjit nr.114/2015 “Mbi Auditimin e Brendshëm” dhe “Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”, rëndësi i është kushtuar trajnimeve të audituesve të [NJAB] sipas planit të trajnimeve, përpiluar nga Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik. Për vitet 2019, 2020 dhe 2021 trajnimet e audituesve të NJAB për Bashkinë Berat pasqyrohen në tabelën e mësipërme:

Konstatohet se [NJAB] në Bashkisë Berat, ka respektuar trajnimet e detyrueshme vjetore planifikuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar në MFE/Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, në kundërshtim me Ligjin nr.114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, “Manualin e Auditimit të Brendshëm të Sektorit Publik”

➤ **Hartimi dhe zbatimi i planeve të Auditit të Brendshëm;**

Nga Sektori i Auditit të Brendshëm janë hartuar dhe miratuar për çdo vit në zbatim të ligjit nr. 114/2015 “Për Auditimin e brendshëm ne sektorin Publike”, Planet strategjike dhe vjetore sipas formateve të dërguar në Njësine e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm (Ministria e Financave) dhe të miratuara nga Kryetari i Bashkisë. Nga auditimi rezultoi se :

Për vitin 2019 NJAB ka planifikuar 9 (nëntë) auditime sipas shkresës nr. 127 prot datë 08.01.2019 është miratuar plani vjetor i Njësive të Auditit të Brendshëm dhe me shkresën nr. 932 datë 14.02.2020 është dërguar pran Drejtorisë së Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm në Ministrinë e Financave, raporti i veprimtarisë së NJAB për vitin 2019.

Për vitin 2020 NJAB ka planifikuar 10 (dhjetë) auditime sipas shkresës nr. 931 prot, datë 08.01.2019 është miratuar plani vjetor i Njesisë së Auditit të Brendshëm por në fakt janë realizuar 9 (nëntë) auditime konfirmuar me shkresën nr. 924 datë 12.02.2021 dërguar pran Drejtorisë së Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm në Ministrinë e Financave, raporti i veprimtarisë së NJAB për vitin 2020.

Për vitin 2021 NJAB ka planifikuar 8 (tetë) auditime sipas shkresës nr. 5036 prot., datë 15.10.2021 është miratuar plani vjetor i Njesisë së Auditit të Brendshëm ndryshuar me shkresën nr. 5588 prot, date 05.11.2021. Për vitin 2021 nuk është dërguar pran Drejtorisë së Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm në Ministrinë e Financave, raporti i veprimtarisë së NJAB për vitin 2021. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me kërkesat e nenit 14, të ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”.

Në mënyrë të përmbledhur auditimet e planifikuara dhe të realizuara paraqiten si vijon:

Nr	Periudha	TË DHËNA SIPAS RAPORTIMIT						
		Auditime të planifikuara	Auditime të realizuara	Nga të realizuarat, sipas llojit				
				Përputh	Financiar	Kombinuar	Performa	Tjera
1	Viti 2019	9	9	4	2	3	-	-
2	Viti 2020	10	9	4	1	4	-	-
3	Viti 2021	8	8	5	1	2	-	-

Burimi i të dhënave: Njesisë e Auditimit të Brendshëm

➤ **Vlerësimi i procedurave dhe standarteve të kryerjes së auditimit të brendshëm**

Nga auditimi i dokumentacionit të dosjeve u konstatua se:

- Përgjithësisht janë zbatuar kërkesat e ligjit nr.114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik, ”Manuali i Auditimit të Brendshëm (MAB).
- Sektori i A.B në zbatim të planit vjetor ka përfshirë në grup pune specialist të sektorëve të ndryshëm, për kryerjen e auditimit sipas programeve të miratuara nga Titullari i Bashkisë.
- Subjektet e audituara edhe pse i kanë pranuar rekomandimet e dhëna nga AB dhe në përgjithësi i kanë zbatuar ato, nuk kanë paraqitur Planin e Veprimit për zbatimin e rekomandimit, në përputhje me ligjin 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, dhe me Kap. IV, pika 4.1.12, Hapi 11, të MAB.

Vlerësojmë se sipas përcaktimeve të bëra në Manualin e Auditimit të Brendshëm, (Kapitulli VI, ”Evidentimi dhe dokumentimi i punës audituese”), në përgjithësi programet kanë përmbledhur orientimet kryesore të veprimit në përputhje me rrisqet dhe problematikat e subjekteve, dhe përmbajnë në mënyrë të qartë emërtimin e subjektit, llojin e auditimit, periudhën dhe afatin e auditimit, drejtimet që do të ndiqen, dhe grupin e auditimit. Vend të veçantë në program zënë edhe ndjekja e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditimet e mëparshme. Në përgjithësi referencat ligjore të vëna në programet e auditimit reflektojnë kuadrin ligjorë në fuqi.

➤ **Sigurimi i cilësisë në auditimet e kryera dhe kontrolli i zbatimit të detyrave të lëna.**

Për veprimtarinë e Sektorit të AB për periudhën nga data 01.10.2019 deri në 31.12.2021 është raportuar në mënyrë sistematike Kryetarit të Bashkisë Berat.

Nga auditimi i raportimit vjetor 2019-2021, konstatojmë se janë dhënë 265 rekomandime gjithsej, nga të cilat janë zbatuar 124 rekomandime, në proces 130 rekomandime si dhe nuk janë zbatuar 11 rekomandime. *Auditimet e realizuar dhe rekomandimet e realizuara për vitin 2019-2021 paraqiten ne tabelën nr. 2 si vijon;*

Nr	PERIUDHA	TË DHËNA SIPAS RAPORTIMIT							
		Rekomandime te shprehura ne numër				Rekomandime te shprehura ne vlerë (shpërblim demi)			
		Gjithsej ne numër	Zbatuar	Ne proces	Pazbatuar	Gjithsej ne Leke	Zbatuar	Ne proces	Pa zbatuar
1	Viti 2019	107	65	42	0	2695	154	2541	
2	Viti 2020	84	31	49	4	3576	1651	1925	
3	Viti 2021	74	28	39	7	2110	364	1746	

TOTALI	265	124	130	11	6481	2169	4312
--------	-----	-----	-----	----	------	------	------

Burimi i të dhënave: Njësia e Auditimit të Brendshëm

Konstatohet se - Nga sa më lart grupi i auditimit thekson se NJAB në të gjitha angazhimet të kryera gjatë periudhës objekt auditimi në punën e tyre pavarësisht dhënies së rekomandimeve nuk janë treguar këmgulës në auditimin e zbatimit të rekomandimeve dhe nuk është bere në afatin e përcaktuar në manualin e auditimit pas 6- muajsh.

-Konstatohet se mungesa e personelit, të Bashkisë si dhe lëvizja e vazhdueshme e punonjësve nga pozicioni i punës përbën një pengese në mirëfunksionimin e të gjithë strukturës së NJAB. Konstatohet se NJAB për periudhën objekt auditimi nuk ka të miratuar një program auditimi në ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të lëna në subjektet e audituara, veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me ligjin 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”.

Kriteri: Baza ligjore mbi të cilën është vlerësuar situata e cila paraqet parregullsi janë; ligji nr. 114/2015 “ Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, neni 10, germa “c” e VKM nr.83 datë 03.02.2016 “Për Miratimin e Krieteve të Krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik si dhe nenit 64, germa “a” të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”.

Shkaku: Mungesë e kapaciteteve për kryerjen e gjitha angazhimeve, neglizhenca e drejtuesit për plotësimin e Strukturës Organizative të Auditit të Brendshëm.

Ndikimi/Efekti: Nuk jep garanci në mbështetje të menaxhimit të lartë për zbatimin e objektivave, në Bashkinë Berat.

Rëndësia: E Lartë

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Berat, të marrë masa për plotësimin e organikës së Auditimit të Brendshëm, sipas standardeve dhe metodologjisë së miratuar në përputhje me ligjin nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditim e brendshëm publik” neni 10, “Organizimi i shërbimit të auditimit të brendshëm” dhe VKM nr. 83, datë 3.2.2016 “Për miratimin e krieteve të krijimit të njësive të Auditimit të Brendshëm”.

Në hartimin e planeve vjetore të planifikohen sektorë me fusha me risk, siç janë zbatimi i procedurave të prokurimit, dhënia e lejeve të ndërtimit/zhvillimit, administrimi i taksave e tarifave vendore, si dhe institucionet e varësisë në Bashkisë Berat.

Për sa është trajtuar në Akt Konstatimin nr.7 datë 15.04.2022, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni nga z. Xh. M. në cilësinë e përgjegjësit të sektorit të auditimit dhe znj. O. H., protokolluar në KLSH me nr.55/5 datë 26.04.2022, ku janë shprehur komentet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: Ne nuk jemi dakort me paragrafin e fundit tek “Hartimi dhe zbatimi i planeve të Auditit të Brendshëm”, fund të faqes 2, ku citohet: “Për vitin 2021 nuk është dërguar pran Drejtorisë së Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm në Ministrinë e Financave, raporti i veprimtarisë së NJAB për vitin 2021. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me kërkesat e nenit 14, të ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “ Për auditimin e brendshëm në sektorin publik””.

Sqarojmë se : Raporti i veprimtarisë së Auditimit të Brendshëm është dërguar në Drejtorinë e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm në Ministrinë e Financave me shkresën nr. 840, date 11.02.2022, brenda afatit kohor, dokumentacioni i kërkuar nga ana juaj ishte para këtij afati.

- Ne nuk jemi dakort me paragrafin e fundit tek “Vlerësimi i procedurave dhe standarteve të kryerjes së Auditimit të Brendshëm” faqe 3 në fund, ku thuhet: Konstatohet se NJAB për periudhën objekt auditimi nuk ka miratuar një program auditimi në ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të lëna në subjektet e audituara.

Sqarojmë se: Në Programin e Auditimit për Vitet 2020 dhe 2021 janë programuar Auditim

Tematik “Zbatimi i Rekomandimeve për të gjitha njësitë e audituara”, kërkesë dhe e DAB e M. Financave, për të cilat është programuar zbatimi i rekomandimeve dhe është kryer Zbatimi i Rekomandimeve që ka qene baze si për raportimet vjetore dhe një kopje u është dërguar DAB në M. Financave me shkresën nr. 1898 prot date 07.04.2021 dhe për vitin 2020 dhe me shkresën nr. 1783 prot date 06.04.2022 për vitin 2021.

Oëndrimi i grupit të auditimit: Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, janë të argumentuara si dhe kanë mbështetje ligjore dhe për këtë arsye merren në konsideratë.

2.1. Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit

2.1. Programimi PBA dhe programimi i buxhetit vjetor për vitin 2020 dhe 2021;

2.2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fonde të çelura;

2.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit.

Fondet e shpenzuara nga njësia vendore për shkak të situatës COVID -19, miratimi i këtyre fondeve sipas kuadrit rregullator në fuqi.

2.4. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve; (Faturat e palikujduara të shoqërohen me listë analitike, të detajuara me numër fature dhe datë krijimi etj, sipas raportimit në MF, ku të evidentohen detyrimet nga mungesa e burimeve të veta dhe detyrimet nga mungesa e alokimit të granteve si FZHR, Ministrinë e linjës etj.).

2.5. Çelja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZHR, saktësia e raportimit buxhetor të tyre;

Mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Berat, në bazë të programit të auditimit nr. 55/1, datë 18.01.2022 “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë”, për periudhën 01.10.2019–31.12.2021”, mbajtur në datën 15.04.2022.

Në zbatim të programit të auditimit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

Situacioni i shpenzimeve rakorduar me Degën e Thesarit;

- Situacioni i të ardhurave rakorduar me Degën e Thesarit’;

- PBA dhe buxheti vjetor;

- Raportet e monitorimit;

- Vendimet e Këshillit Bashkiak “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Berat”;

- Vendime të tjera të Këshillit Bashkiak, në lidhje me ndryshimet buxhetore;

- Dokumente të bankës etj.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet :

2.1. Programimi PBA dhe programimi i buxhetit vjetor për vitin 2020 dhe 2021;

Me urdhrin nr. 491, datë 17.07.2020, nga Kryetari i Bashkisë z. E. D. është ngritur grupi për menaxhimin strategjik dhe ekipet për menaxhimin e programeve për përgatitjen e PBA për vitin 2021-2023.

Nga auditimi i procedurave për përgatitjen PBA 2020-2022 dhe 2021-2023, u konstatua se janë realizuar fazat e përgatitjes, duke filluar që nga ngritja e grupit të punës (Grupi i Menaxhimit Strategjik) me urdhër të Titullarit të institucionit, është bërë marrja e kërkesave për nevojat për punë, mallë e shërbime, llogaritja e planifikimit për të ardhurat e veta, përcaktimi i taveve të shpenzimeve sipas programeve, etj.

Për hartimin e programeve buxhetore afatmesme dhe projektbuxhetet vjetore janë kryer konsultime me komunitetin dhe grupet e interesit në njësinë e vetëqeverisjes vendore, nëpërmjet procesit të “Buxhetimit me pjesëmarrje”. Buxhetet janë hartuar mbi bazën e kërkesave shkresore nga njësitë administrative, drejtoritë e shkollave, sektorët e bashkisë,

ujsjellsi, etj, gjë që vërteton se prej tyre janë marrë kërkesat për nevojat reale e mbi bazën e tyre dhe të buxhetit faktit të mundshëm janë përzgjedhur ato më prioritare. Për buxhetin e vitit 2021 janë zhvilluar dëgjesa publike online për shkak të pandemisë së COVID -19.

Buxheti vjetor është miratuar brenda afateve që përcakton pika e nenit 41 të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” (brenda datës 25 dhjetor)

PBA (faza fillestare dhe përfundimtare) janë miratuar në Këshillin Bashkiak me vendimet:

a-PBA 2020-2022, miratuar respektivisht me VKB nr. 96 , datë 19.06.2019, me VKB nr. 66 , datë 26.12.2019.

b-PBA 2021-2023 miratuar respektivisht me VKB nr. 50 , datë 03.08.2020 me VKB nr. 81 , datë 28.12.2020.

Të dhënat për PBA dhe projekt buxhetet për vitin 2020 dhe 2021 sipas tabelave në vijim:

	Emërtimi	Buxheti Faktik 2019	Faza e I PBA 2020	Faza e II PBA 2020	Projekt Buxhet 2020
600	Paga	411,407	441,502	441,502	441,315
601	Sigurime Shoqërore	68,380	70,725	70,725	72,972
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	150,533	245,322	245,322	344,388
603	Subvencione	23,000	25,550	25,550	25,000
604	Transferta Korrente të Brendshme	1,458	3,955	3,955	3,060
605	Transferta Korente të Huaja				
606	Trans për Buxh. Fam. & Individ	4,267	15,090	15,090	15,081
I	Shpenzime Korrente	659,046	802,144	802,144	901,816
230	Kapitale të Patrupëzuara	256	8,200	8,200	14,381
231	Kapitale të Trupëzuara	245,005	259,521	259,521	159,073
	Shp. Kapitale me financim të brendshëm	245,261	267,721	267,721	173,454
230	Kapitale të Patrupëzuara				
	Shpenzime Kapitale me financim të huaj				
II	Shpenzime Kapitale	245,261	267,721	267,721	173,454
III	Shpenzime nga Të ardhurat jashtë limiti	137			
	I+II +III Totali I Shpenzimeve	904,444	1,069,865	1,069,865	1,075,270

Burimi: Bashkia Berat

	Emërtimi	Buxheti Faktik 2020	Faza e I PBA 2021	Faza e II PBA 2021	Projekt Buxhet 2021
600	Paga	399,350	442,251	442,251	447,209
601	Sigurime Shoqërore	66,536	73,127	73,127	73,947
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	227,314	286,770	286,770	301,249
603	Subvencione	25,000	25,500	25,500	27,000
604	Transferta Korrente të Brendshme	3,944	3,060	3,060	3,060
605	Transferta Korente të Huaja				
606	Trans për Buxh. Fam. & Individ	5,155	15,700	15,700	42,307
I	Shpenzime Korrente	727,302	846,408	846,408	894,772
230	Kapitale të Patrupëzuara	10,319	5,000	5,000	20,170
231	Kapitale të Trupëzuara	78,967	212,809	212,809	150,474
	Shp. Kapitale me financim të brendshëm	89,287	217,809	217,809	170,644
230	Kapitale të Patrupëzuara				
	Shpenzime Kapitale me financim të huaj				
II	Shpenzime Kapitale	89,287	217,809	217,809	170,644
III	Shpenzime nga Të ardhurat jashtë limiti	9,962	1,064,217		
	I+II +III Totali I Shpenzimeve	826,551	2,128,434	1,064,217	1,065,416

Burimi: Nga Përpunimi i të dhënave sipas planeve të paraqitura nga subjekti

Realizimi i të ardhurave dhe shpenzimeve për periudhën 2018-2020

Në 000 lekë

Emërtimi	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021
Të ardhurat faktike	371,280	333,490	297,831	332,028	402,274

Shpenzimet faktike	822,710	872,817	904,307	816,588	979,485
--------------------	---------	---------	---------	---------	---------

Burimi: Nga Përpunimi i të dhënave sipas planeve të paraqitura nga subjekti

Për vitin 2020, buxheti bazë/fillestar vjetor (në bazë të vlerësimit të të ardhurave dhe të transfertave të pakushtëzuara, të përcaktuara në ligjin e buxhetit vjetor), është miratuar me VKB nr. 66 datë 26.12.2019, konfirmuar nga Institucioni i prefektit Qarkut Berat me shkresën nr. 1580/4 datë 13.01.2020. Në këtë VKB, të ardhurat nga burimet e veta të planifikuara për vitin 2020 kanë vlerën **528,209 mijë lekë**, transfertat e pakushtëzuar ka vlerën 293,099 mijë lekë, transfertat specifike ka vlerën 253,961 mijë lekë.

Gjatë vitit 2020 janë marrë gjithashtu edhe disa vendime të tjera të këshillit bashkiak të cilat kanë bërë që të ndryshojnë vlerat e buxhetit bazë. Këto ndryshime paraqiten si vijon:

- Me VKB nr. 14, datë 27.02.2020 është marrë vendim nga këshilli bashkiak Berat për miratimin e buxhetit shtese për alokimin e fondeve të trashëguara nga viti 2019, duke planifikuar të ardhura dhe shpenzime shtesë në vlerën 58,316,662 lekë. Sipas aktit të rakordimit më thesarin fondet e trashëguara në 31.12.2019 për përdorim në vitin 2020 (Llog. 520 në bilanc pa pjesën e llog 466) kanë vlerën 69,104,877 lekë. Diferenca prej 10,788,213 lekë (69,104,877 - 58,316,662) është planifikuar për blerjen e mjetit zjarrfikës (pjesa e sponsorizimit nga Ambasada Japoneze në vlerën 9,247,500 lekë, çelur në thesar 7.3.2019, diferenca është bashkëfinancim nga Bashkia Berat).

- Me VKB nr. 58, datë 30.09.2020 është marrë vendim nga këshilli bashkiak Berat për miratimin e buxhetit shtesë për vlerën e garancisë së punimeve të objektit Rikonstruksion i shkollës “Thimi Tane”, duke planifikuar të ardhura dhe shpenzime shtesë në vlerën 1,216,741 lekë. Subjekti ka hequr dorë nga vlera e garancisë së punimeve dhe vlera e mësipërme ka kaluar për përdorim të njësisë vendore.

Buxheti i vitit 2020 është miratuar i balancuar dhe pa defiqite. Për vitin 2020 të ardhurat dhe shpenzimet **fillestare** të miratuara si planifikim janë në shumën **1,075,270** mijë lekë, ndërsa pasi janë bërë ndryshimet gjatë vitit, zërat e planifikuar të buxhetit për të ardhurat dhe shpenzimet kanë vlerën **1,134,803 mijë lekë**.

Rishpërndarja e fondeve mes zërave të shpenzimeve është miratuar me VKB si më poshtë :

- Me VKB nr. 14, datë 27.02.2020 është marrë vendim nga këshilli bashkiak Berat për shtesë në artikullin 602 Shpenzime operative shuma 70 mijë lekë dhe pakësim i art 231 Investime shuma 70 mijë lekë.

- Me VKB nr. 17, datë 20.03.2020 është marrë vendim nga këshilli bashkiak Berat për përdorimin e Fondit të Mbrojtjes Civile të Bashkisë Berat në shumën 2,000 mijë lekë për shpenzime operative për të mbështetur shtresat në nevojë, për mbulimin e shpenzimeve bazike për jetesë, për përballimin e situatës emergjente të krijuar prej pandemisë Covid-19.

- Me VKB nr. 20, datë 31.03.2020 është marrë vendim nga këshilli bashkiak Berat për përdorimin e Fondit të Mbrojtjes Civile të Bashkisë Berat në shumën 6,500 mijë lekë për shpenzime operative, për të ndihmuar 1,200 familje në nevojë , sipas përcaktimit të VKM nr. 236 datë 19.03.2020, si edhe familjet në varfëri ekstreme të evidentuara nga shtabet koordinuese në terren të drejtuara nga Administratorët, me produkte ushqimore dhe jo ushqimore, për përballimin e situatës emergjente të krijuar prej pandemisë Covid-19.

- Me VKB nr. 48, datë 03.08.2020 është marrë vendim nga këshilli bashkiak Berat për përdorimin e Fondit të Mbrojtjes Civile të Bashkisë Berat në shumën 118.8 mijë lekë për shpenzime operative për Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike.

Planifikimi i shpenzimeve kapitale nga te ardhurat vendore për vitin 2020 është bërë si vijon:

-Detyrime me fature për investimeve nga viti 2019 në vlerën 72,985 mijë lekë;

-Investime në proces dhe të kontraktuara, në vlerën 35,714 mijë lekë.

-Investime të reja në vlerën 64,755 mijë lekë, sipas tabelës në vijim:

-Total, planifikimi i shpenzimeve kapitale për vitin 2020 është parashikuar në vlerën 173,454 mijë lekë.

Gjatë vitit janë bërë 3 ndryshime në buxhet në vlerën 1,217 mijë lekë dhe plani përfundimtar (plani i rishikuar vjetor) ka vlerën 174,671 mijë lekë.

Planifikimi i shpenzimeve kapitale nga te ardhurat vendore për vitin 2021 (planifikimi fillestar) është bërë si vijon:

Investime të përfunduara, fatura të palikujduara & shpronësime në vlerën 42,963 mijë lekë;

Investime në proces dhe të kontraktuara në vlerën 39,591 mijë lekë;

Investime të reja në vlerën 88,089 mijë lekë;

Total, planifikimi fillestar i shpenzimeve kapitale për vitin 2021 është parashikuar në vlerën 170,643 mijë lekë.

Gjatë vitit 2021 janë bërë 23 ndryshime në buxhet dhe pas ndryshimeve të bëra gjatë vitit, pra pas shtesave dhe pikësimeve që janë kryer me vendimet përkatëse të këshillit bashkiak, planifikimi përfundimtar i shpenzimeve ka vlerën 282,200 mijë lekë, me ndryshim nga planifikimi fillestar me vlerën 111,557 mijë lekë, ose në masën 65%. Realizimi i buxhetit me të ardhurat e veta për vitin 2021 ka vlerën 155,906 mijë lekë, ose në masën 55% të planifikimit përfundimtar, si dhe një pjesë e këtyre ndryshimeve nuk janë realizuar, të dhëna të cilat tregojnë se shtesat e kryera gjatë vitit janë bërë të pa studiuar mirë. Gjithashtu ndryshimet e shpeshta në buxhet gjatë vitit tregojnë për një performancë jo të mirë të punës së bërë për planifikimin buxhetor fillestar, planifikim cili nuk është mbështetur si duhet në nevojat reale. Pasqyrë përmbledhëse për planifikimin e buxhetit për vitin 2020 dhe 2021 sipas VKB përkatëse paraqiten në aneksin nr. 1, bashkangjitur projektraportit të auditimit.

Për vitin 2021, buxheti bazë/fillestar vjetor (në bazë të vlerësimit të të ardhurave dhe të transfertave të pakushtëzuara, të përcaktuara në ligjin e buxhetit vjetor), është miratuar me VKB nr.81 datë 29.12.2020, konfirmuar nga Institucioni i prefektit Qarkut Berat me shkresën nr. 1123/2 datë 06.01.2021.

Në këtë VKB, të ardhurat nga burimet e veta të planifikuara për vitin 2021 kanë vlerën 500,173 mijë lekë, transfertat e pakushtëzuar ka vlerën 298,960 mijë lekë, transfertat specifike ka vlerën 266,283 mijë lekë.

Në total të ardhurat kanë vlerën 1,065,417 mijë lekë, po ashtu edhe shpenzimet kanë vlerën . 1,065,417 mijë lekë.

- Me VKB nr. 79 , datë 29.12.2020 është marrë vendim nga këshilli bashkiak Berat për miratimin e mbulimit të shpenzimeve të projekteve me financim të huaj, fonde të rimbursueshme nga financuesit e projekteve, duke planifikuar të ardhura dhe shpenzime shtesë në vlerën 47,606,532 lekë.

Gjatë vitit 2021, janë marrë gjithashtu edhe disa vendime të tjera të këshillit bashkiak të cilat kanë bërë që të ndryshojnë vlerat e buxhetit bazë (miratuar në dhjetor 2020). Këto ndryshime paraqiten si vijon:

- Me VKB nr. 8, datë 12.02.2021 është marrë vendim nga këshilli bashkiak Berat për miratimin e buxhetit shtesë për alokimin e fondeve të trashëguara nga viti 2020, duke planifikuar të ardhura dhe shpenzime shtesë në vlerën 120,818,808 lekë.

- Me VKB nr. 88 , datë 18.12.2021 është marrë vendim nga këshilli bashkiak Berat për miratimin e buxhetit shtesë në zbatim të Aktit Normativ nr. 34 datë 03.12.2021 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 137/2020 “ Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, dërguar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr. 21918/3 datë 07.12.2021, Bashkisë Berat i është akorduar si **transfertë specifike fondi 16,440,440 lekë për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura**, duke nisur nga detyrimi më i vjetër i papaguar, duke planifikuar të ardhura dhe shpenzime shtesë në vlerën 16,440,440 lekë.

Me shkresë të Ministrisë së Financave nr. 2987 datë 11.02.2021 Bashkisë Berat i është dërguar rritje e tansfertës specifike për paga e sigurime për arsimin, fondi 8,934 mijë lekë. Shkresa nuk ka mbërritur në Institucion, për rrjedhojë kjo transfertë rezulton e pashpërndarë dhe e papërdorur në mbyllje të vitit 2021. Fondi është trashëguar për përdorim në vitin 2022.

- Me VKB nr 38, datë 26.05.2021 është marrë vendim nga këshilli bashkiak Berat për miratimin e pakësimit të të ardhurave të planifikuara të vitit 2021 në shumën 2,571 mijë lekë, për faljen e një pjese të detyrimeve për subjektet e transportit.

2.2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fonde të çelura.

-Krahasimi planeve buxhetore me PBA respektive:

PBA 2020-2022 me planin buxhetor 2020, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Në 000/lekë

Nr.	Emërtimi	Plan përfundim 2020	Sipas PBA 2020-2022	Ndryshimi
1	Shpenzime për pagat (600+601) (nga te ardhur e grant i pakkush e spec)	513,937	514,287	(350)
2	Shpenzime (602.604.609) (nga ardhura e grant i pakushtez e specif)	446,196	387,529	58,667
3	Investime Bashkia (nga te ardhura e grant i pakushtez)	174,671	173,454	1,217
4	Investime nga FZSH			
	Total I planit fillestar	1,134,804	1,075,270	59,534
	Shtesat nga Pushteti Qendror	638,703		638,703
5	Investime grant i kushtëzuar	168,219		168,219
6	Shpenzime për pagat (600+601)	10,117		10,117
7	Shpenzime (602.604.609)	460,367		460,367
	<i>Grant i kushtëzuar (230-231)</i>			
	Gjithsej	1,773,507	1,075,270	698,237

Burimi: Nga Përpunimi i të dhënave sipas planeve të paraqitura nga subjekti

Plani buxhetor vjetor 2020 është më i lartë se plani vjetor 2020 në PBA, në shumën 698,237 mijë lekë për arsye se :

- Në planin përfundimtar të vitit 2020 janë pasqyruar shpenzimet e financuara me fondet nga pushteti qendror, Investime nga grant i kushtëzuar, shpenzime për paga dhe operative, në shumën 638,703 mijë lekë. Në fazat e përgatitjes së PBA fondet e kushtëzuara nuk janë të njohura/akorduara dhe nuk janë të llogaritura/të përfshira në planin buxhetor.

- Në planin përfundimtar të vitit 2020 janë pasqyruar shtesat e ndryshimet e bëra në buxhet gjatë vitit 2020, me burim financimi fondet e veta, në total shtesë 59,534 mijë lekë. Konkretisht: shtesat në shpenzimet operative në shumën 58,667 mijë lekë, si rezultat i shtesës së burimeve të financimit me të ardhurat e trashëguara nga viti paraardhës, në shumën 58,317 mijë lekë. (VKB nr. 14, dt. 27.02.2020), dhe shtesës për investime në shumën 1,217 mijë lekë (VKB nr. 58 dt. 30.09.2020).

PBA 2021-2023 me planin buxhetor 2021, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Në 000/lekë

Nr.	Emërtimi	Plan përfundimtar 2021	Sipas PBA 2021-2023	Ndryshimi
1	Shpenzime për pagat (600+601) (nga te ardhur e grant i pakkush e spec)	528,946	521,157	7,789
2	Shpenzime (602.604.609) (nga ardhura e grant i	445,499	373,616	71,883

	pakushtez e specif)			
3	Investime Bashkia (nga te ardhura e grant I pakushtez)	282,200	170,644	111,556
4	Investime nga FZSH			
	Total I planit fillestar	1,256,645	1,065,417	191,228
	Shtesat nga Pushteti Qendror	765,395	-	765,395
5	Investime grant i kushtëzuar	300,623		300,623
6	Shpenzime për pagat (600+601)	14,699		14,699
7	Shpenzime (602.604.609)	450,074		450,074
	<i>Grant i kushtëzuar (230-231)</i>			
	Gjithsej	2,022,040	1,065,417	956,624

Burimi: Nga Përpunimi i të dhënave sipas planeve të paraqitura nga subjekti

Plani buxhetor vjetor 2021 është më i lartë se plani vjetor 2021 në PBA, në shumën 956,624 mijë lekë për arsye se :

- Në planin përfundimtar të vitit 2021 janë pasqyruar shpenzimet e financuara me fondet nga pushteti qendror, investime nga grant i kushtëzuar, shpenzime për paga dhe operative, në shumën 765,395 mijë lekë. Në fazat e përgatitjes së PBA fondet e kushtëzuara nuk janë të njohura/akorduara dhe nuk janë të llogaritura/të përfshira në planin buxhetor.
- Në planin përfundimtar të vitit 2021 janë pasqyruar shtesat e ndryshimet e bëra në buxhet gjatë vitit 2021, me burim financimi fondet e veta, në total shtesë 191,228 mijë lekë.

Në programet buxhetore është bërë shpërndarja e fondeve të vënë në dispozicion nga Pushteti Qendror të grandeve nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar, transfertës së kushtëzuar dhe fondeve të krijuar nga burimet e veta, për kryerjen e funksioneve të veta, ato të deleguara dhe të përbashkëta si dhe shpërndarjen e fondeve të grandeve.

Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit. Gjatë vitit si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, grandeve qeveritare, ndihma ekonomike, gjendja civile, shpërblime lindje, etj., të cilat nuk kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestare të vitit.

Gjatë viteve janë kryer ndryshime në buxhet (shtesa/ paksime). Këto lëvizje në rastet e lëvizjeve brenda të njëjtit artikull dhe brenda programit janë kryer me urdhër të Titullarit e përcaktuar kjo me VKB, ndërsa lëvizjet nga programi në program dhe nga një artikull në tjetrin janë kryer me Vendim të KB.

- Në hartimin e projekt buxhetit vjetor, janë marrë në konsideratë kërkesat e dokumentuara të sektorëve, por kryesisht realizimi i artikujve buxhetorë për vitin buxhetor paraardhës.

- Planifikimi dhe detajimi i buxhetit në nivel artikulli dhe nënartikulli, është bërë sipas nevojave të paraqitura dhe kërkesave për fonde buxhetore, duke u bazuar në kërkesat e udhëzimeve përkatëse “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.

- Akordimi fillestar i buxhetit dhe ndryshimet që kanë pësuar zërat e tij gjatë vitit, janë të rakorduara me Degën e Thesarit Berat dhe janë të raportuara periodikisht pranë degës së Thesarit dhe në MFE. Situacionet e shpenzimeve janë të plotësuara sipas klasifikimit buxhetor për të gjithë periudhën e audituar. Fondet e akorduara në planet buxhetore dhe ndryshimet e bëra në periudha të ndryshme, janë evidentuar dhe janë ndjekur në dinamikë, në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nënartikulli sipas shërbimeve dhe më vete për çdo njësi vartëse e sipas periudhave të planifikuara.

- Analiza e shpenzimeve buxhetore për artikuj dhe nënartikuj është bërë periodikisht mbi bazën e situacioneve mujore të konfirmuara nga Dega e Thesarit. Raportimi i realizimit të buxhetit është i shoqëruar me relacionin e realizimit të buxhetit duke argumentuar edhe shtesat e buxhetit gjatë periudhës ushtrimore për zërat e buxhetit të planifikuara dhe që nuk janë alokuar fonde që në fillim të çeljes së buxhetit.

Janë kryer ndryshime të vazhdueshme në buxhetin vjetor, veprime që tregojnë se planifikimi i buxhetit duhet të bëhet më i argumentuar, në mënyrë që gjatë vitit ndryshimet të jenë sa më të vogla.

Tabela e ndryshimeve në buxhet paraqitet në në aneksin nr. 1/1, bashkangjitur projektraportit të auditimit.

2.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit. Fondet e shpenzuara nga njëzia vendore për shkak të situatës Covid-19, miratimi i këtyre fondeve sipas kuadrit rregullator në fuqi.

Për zbatimet e buxheteve është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordimet përkatëse. Janë ruajtur kufijtë e miratuar të shpenzimeve në total dhe për çdo artikull e nënartikull sipas klasifikimit ekonomik.

Pasqyra e realizimit të treguesve të buxhetit për vitin 2020 dhe 2021, referuar raporteve të monitorimit (të ardhurat e veta vendore + transfertat e pakushtëzuar) paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve për vitin 2020 me të ardhurat e veta të Bashkisë Berat dhe transfertën e pakushtëzuar.

Bashkia Berat së bashku me njësitë vartëse. Vetëm me të ardhurat e veta vendore + transfertat e pakushtëzuar. Viti 2020.

Në 000/lekë

Art.	Emertimi	(1)	(2)	(3)	(4)	(6)	(7)=(6)-5)	
		Fakti i vitit para ardhës Viti 2019	PBA Plan Viti 2020	Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2020 (VKB 66, datë	Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2020	Fakti i 12-mujorit	Diferenca	% e realizimit
600	Paga	411,407	441,314	441,314	440,945	399,352	41,593	91%
601	Sigurime Shoqërore	68,380	72,972	72,972	72,992	66,538	6,454	91%
600+60	Paga +Sigurime	479,787	514,286	514,286	513,937	465,890	48,047	91%
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	150,534	344,389	344,389	382,588	227,310	155,278	59%
603	Subvencione	23,000	25,000	25,000	25,000	25,000	0	100%
604	Transferta Korente të Brendshme	1,458	3,060	3,060	3,960	3,945	15	100%
605	Transferta Korente të Huaja	0	0	0	0	0	0	
606	Transf. per Buxh. Fam. & Individ	4,267	15,081	15,081	34,647	5,156	29,491	15%
602-606	Shpenzime operative	179,259	387,530	387,530	446,195	261,411	184,784	59%
	Shpenzime Korrente	659,046	901,816	901,816	960,132	727,301	232,831	76%
230	Kapitale të Patrupëzuara	256	14,381	14,381	14,381	10,320	4,061	72%
231	Kapitale të Trupëzuara	245,005	159,073	159,073	160,290	78,968	81,322	49%
Totali	Shpenzime Kapitale	245,261	173,454	173,454	174,671	89,288	85,383	51%
Totali (korrente + kapitale)		904,307	1,075,270	1,075,270	1,134,803	816,589	318,214	72%

Burimi: Nga Përpunimi i të dhënave sipas planeve të paraqitura nga subjekti

Planifikimi dhe realizimi i buxhetit për vitin 2021

Bashkia Berat së bashku me njësitë vartëse. Vetëm me të ardhurat e veta vendore + transfertat e pakushtëzuar. Viti 2021

Në 000/lekë

Art.	Emertimi	1	2	3	4	5	(6)=(4)-(5)	Realizimi ne %
		Fakti i vitit paraardhes paraardhes Viti 2020	PBA Plan Viti 2021	Buxheti Vjetor Plan Filleshtar Viti 2021	Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2021	Fakti i 12-mujorit	Diferenca	
600	Paga	399,352	447,210	447,210	452,521	418,153	34,367	92%
601	Sigurime Shoqërore	66,538	73,947	73,947	76,425	69,380	7,046	91%
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	227,309	301,249	301,249	366,809	289,987	76,822	79%
603	Subvencione	25,000	27,000	27,000	33,000	33,000	0	100%
604	Transferta Korente të Brendshme	3,945	3,060	3,060	3,060	2,315	744.848	76%
605	Transferta Korente të Huaja	0	0	0	0	0	0	
606	Transf. per Buxh. Fam. & Individe	5,156	42,307	42,307	42,630	10,771	31,859	25%
Nen-Totali	Shpenzime Korrente	727,300	894,773	894,773	974,445	823,606	150,839	85%
230	Kapitale të Patrupëzuara	10,320	20,170	20,170	23,904	18,958	4,946	79%
231	Kapitale të Trupëzuara	78,969	150,474	150,474	258,296	136,948	121,348	53%
232	Transferta Kapitale	0		0	0	0	0	
Nen-Totali	Shpenzime Kapitale	89,288	170,644	170,644	282,200	155,906	126,294	55%
Totali (korrente + kapitale)		816,588	1,065,417	1,065,417	1,256,645	979,512	277,133	78%

Burimi: Nga Përpunimi i të dhënave sipas planeve të paraqitura nga subjekti

Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve për vitin 2020 vetëm me të ardhurat e veta vendore + transfertat e pakushtëzuar, Bashkia Berat së bashku me njësitë vartëse (analizë e cila mat saktë performancën e planifikimit dhe realizimit të buxhetit, pasi nuk përfshihen fondet që vijnë nga grantet):

Për vitin 2020, planifikimi i buxhetit për zërin e shpenzimeve me të ardhurat e veta vendore dhe transfertën e pa kushtëzuar, ka vlerën 1,134,803 mijë lekë, ndërsa realizimi në vlerën 816,589 mijë lekë, ose në masën 72%. Zëri shpenzime page dhe sigurime shoqërore është planifikuar në vlerën 513,937 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 465,890 mijë lekë, ose në masën 91%,

Zëri shpenzime operative (602+606) është planifikuar në vlerën 446,195 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 261,411 mijë lekë, ose në masën 59 %.

Zëri shpenzime kapitale (artikulli 230 dhe 231) është planifikuar në vlerën 174,671 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 89,288 mijë lekë, ose në masën 59 %.

Për vitin 2021, planifikimi i buxhetit për zërin e shpenzimeve me të ardhurat e veta vendore dhe transfertën e pa kushtëzuar, ka vlerën **1,256,645** mijë lekë, ndërsa realizimi në vlerën **979,512** mijë lekë, ose në masën 78%. Zëri shpenzime page dhe sigurime shoqërore është planifikuar në vlerën 528,946 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 487,533 mijë lekë, ose në masën 91%.

Zëri shpenzime operative (602+606) është planifikuar në vlerën 445,499 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 336,073 mijë lekë, ose në masën 75 %.

Zëri shpenzime kapitale (artikulli 230 dhe 231) është planifikuar në vlerën 282,200 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 155,906 mijë lekë, ose në masën 78 %.

Titulli i gjetjes: *Diferenca të dukshme midis vlerës së planifikuar të shpenzimeve buxhetore dhe vlerës së realizuar, për zërat të cilët mbulohen nga të ardhurat e veta.*

Situata: Nga auditimi u konstatohet se realizimi i shpenzimeve buxhetore vetëm me të ardhurat e vetë Bashkisë Berat së bashku me transfertat e pa kushtëzuara, për vitin 2020 dhe vitin 2021 kanë diferencë të dukshme me vlerën e planifikuar.

Për vitin 2020 planifikimi i shpenzimeve ka vlerën 1,134,803 mijë lekë, ndërsa realizimi vlerën 816,589 mijë lekë, ose në masën 72%, ndërsa për vitin 2021 planifikimi i shpenzimeve ka vlerën 1,256,645 mijë lekë, realizimi 979,512 lekë, ose në masën 78%.

Niveli i realizimit të investimeve të planifikuara, i cili është zëri më kryesor i buxhetit në lidhje me ndikimin që ka në ofrimin e të mirave publike ndaj komunitetit, është akoma më i ulët se mesatarja e realizimit të buxhetit. Për vitin 2020 investimet janë planifikuar në vlerën 174,671 mijë lekë, realizuar 89,288 mijë lekë, ose në masën 51 %, ndërsa për vitin 2021, vlera e planifikuar është 282,200 mijë lekë, realizuar 155,906 mijë lekë, ose në masën 55 %.

Ky mos realizim vjen si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave, që do të thotë se nga Bashkia Berat në fillim të vitit buxhetor planifikohen angazhime buxhetore, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifave vendore dhe ky planifikim nuk korrigjohet gjatë vitit, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat reale të realizuara.

Kriteri: Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me pikën (a) të nenit 5, si dhe nenin 46 të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

Efekti: Planifikimi i zërave të shpenzimeve dhe mos realizimi i tyre për shkak të planifikimit jo të mbështetur në të ardhurat reale, bënë që pritshmëritë sidomos në investime të mos përputhen me planifikimin, plotësimin e nevojave reale të planifikuara dhe ulje të performancës të njësisë vendore.

Shkaku: Planifikim i pa studiuar mire i buxhetit.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Bashkia Berat, nëpërmjet Drejtorisë së Menaxhimit Financiar dhe Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrë masa për një planifikim të studiuar të të ardhurave të veta, duke u mbështetur mbi parashikime të studiuar dhe realiste. Mbi bazën e këtyre të ardhurave të parashikohet edhe plani investimeve publike, me qëllim që investimet e planifikuara në buxhet të kenë burime financimi të sigurta për tu realizuar. Nëse gjatë vitit ka mosrealizim të të ardhurave të planifikuara, atëherë me vendim të këshillit bashkiak, duhet të korrigjohet edhe plani i shpenzimeve, brenda afateve që përcakton kuadri rregullator në fuqi

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi kryetari i bashkisë z. E. D., si dhe znj. R. Sh., me detyrë drejtore e Drejtorisë së Menaxhimit Financiar dhe të të Ardhurave, në cilësinë e nëpunësit zbatues, znj. A. Sh., me detyrë specialiste e buxhetit.

Për vitin 2020 në realizimin e ulët të të ardhurave, ka pasur ndikim edhe situata e pandemisë shkaktuar nga virusi Covid -19. Por për shkak të kësaj situatë nga Bashkia Berat duhet të ishin marrë në kohën e duhur masa për korrigjimin e buxhetit, si për zërin e të ardhurave edhe për zërin e shpenzimeve.

Konstatohet se për këtë qëllim Bashkia Berat ka trajtuar çështjen e uljes së të ardhurave dhe shpenzimeve, por në fund të vitit buxhetor, në muajin nëntor 2020. Për këtë çështje Titullari ka përcjellë në këshillin bashkiak propozimin për korrigjimin e buxhetit dhe me VKB nr.70,

datë 04.11.2020 është miratuar ulja e planit të të ardhurave dhe shpenzimeve me vlerën 209,458,000 lekë. Propozimi në fund të vitit buxhetor për korrigjimin e buxhetit, ka qenë i vonuar, formal dhe pa efekte reale, pasi deri në këtë moment janë marrë pothuaj të gjitha angazhimet buxhetore për shpenzimet mbi bazën e planit fillestar të të ardhurave.

Gjithashtu edhe gjatë vitit 2021 nuk është bërë analiza e zbatimit të buxhetit brenda muajit qershor dhe nuk është dalë në konkluzion nëse duhej rishikuar ose jo buxheti vjetor 2021.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Neni 46 -Rishikimi i zbatimit të buxhetit vendor, të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ku thuhet:

“Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore analizon zbatimin e buxhetit jo me vonë se data 30 qershor e çdo viti dhe, në rast se është e nevojshme, harton e propozon në këshillin e njësisë së vetëqeverisjes vendore ndryshimet në buxhet. Procedurat e shqyrtimit, miratimit dhe zbatimit të ndryshimeve u nënshtrohen të njëjtave rregulla të përcaktuara në nenet 5 dhe 40 të këtij ligji”.

Mos analizimi dhe mos korrigjimi i buxhetit brenda muajit qershor 2020 dhe 2021, ngarkon me përgjegjësi kryetarin e bashkisë z. E. D., si dhe znj. R. Sh., me detyrë drejtore e Drejtorisë së Menaxhimit Financiar dhe të të Ardhurave, në cilësinë e nëpunësit zbatues, znj. A. Sh., me detyrë specialiste e buxhetit.

Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve për vitin 2020 dhe 2021 Bashkia Berat pa njësiti vartëse (përfshirë të gjitha burimet e finanimi), sipas aktit të rakordimit me degën e thesarit.

Për vitin 2020, planifikimi i buxhetit për zërin e shpenzimeve, duke përfshirë edhe ndihmën ekonomike dhe PAK ka vlerën 1,215,034,210 lekë, ndërsa realizimi 886,261,899 lekë, ose në masën 73%.

Zëri paga dhe sigurime është planifikuar në vlerën 165,519,000 lekë dhe është realizuar në vlerën 143,446,579 lekë, ose në masën 87 %, zëri shpenzime operative (602) është planifikuar në vlerën 185,060,813 lekë dhe është realizuar në vlerën 118,043,304 lekë, ose në masën 64 %, zëri shpenzime kapitale (artikulli 230 dhe 231) është planifikuar në vlerën 330,703,081 lekë dhe është realizuar në vlerën 128,502,390 lekë, ose në masën 39 %.

Për vitin 2021, planifikimi i buxhetit për zërin e shpenzimeve, duke përfshirë edhe ndihmën ekonomike dhe PAK ka vlerën 1,420,940,125 lekë, ndërsa realizimi 1,226,171,742 lekë, ose në masën 86%.

Zëri paga dhe sigurime është planifikuar në vlerën 174,938,197 lekë dhe është realizuar në vlerën 160,887,807 lekë, ose në masën 92 %, zëri shpenzime operative (602) është planifikuar në vlerën 177,524,165 lekë dhe është realizuar në vlerën 145,228,500 lekë, ose në masën 82%, zëri shpenzime kapitale (artikulli 230 dhe 231) është planifikuar në vlerën 544,584,236 lekë dhe është realizuar në vlerën 446,019,793 lekë, ose në masën 82%.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërm janë në kundërshtim me pikën (a) të nenit 5, si dhe nenin 46 të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” dhe ngarkojnë me përgjegjësi kryetarin e bashkisë z. E. D., si dhe znj. R. Sh., me detyrë drejtore e Drejtorisë së Menaxhimit Financiar dhe të të Ardhurave, në cilësinë e nëpunësit zbatues, znj. A. Sh., me detyrë specialiste e buxhetit.

Niveli i mbulimit të shpenzimeve me të ardhurat e veta

Për vitin 2020. Njësia vendore nuk planifikon të ardhura për mbulimin e shpenzimeve për ndihmën ekonomike dhe PAK në vlerën 463,677,571 lekë (e cila zë 52% të buxhetit faktik vjetor), por vetëm administron këtë proces në lidhje me plotësimin e kriterëve nga përfituesit dhe hartimin e listave. Duke marrë parasysh këtë fakt, duke zbritur nga shpenzimet totale vlerën e ndihmës ekonomike dhe PAK, konstatohet se shpenzimet faktike totale për vitin

2020 janë në vlerën 422,584,328 lekë (886,261,899 - 463,677,571 lekë. Bazuar në këtë vlerë, mbulimi i shpenzimeve me të ardhurat e veta të njësisë vendore për vitin 2020 (pa transfertat e pa kushtëzuara) ka vlerën 221,005,116 lekë, ose në masën 52 % të shpenzimeve totale të realizuara.

Për vitin 2021. Për këtë periudhë (duke zbritur nga shpenzimet totale vlerën e ndihmës ekonomike dhe PAK), shpenzimet faktike totale janë në vlerën 787,451,252 lekë (1,226,171,742-438,720,490).

Bazuar në këtë vlerë, realizimi i mbulimit të shpenzimeve me të ardhurat e veta të njësisë vendore ka vlerën 222,502,497 lekë, ose në masën 28% të shpenzimeve totale të planifikuara (222,502,497 /787,451,252 *100).

Të dhënat e mësipërme për vitin 2020 dhe 2021, tregojnë për nivele të ulëta të mbulimit të shpenzimeve me të ardhurat e veta, të cilat kanë si shkak diferenca midis planifikimit dhe realizimit të të ardhurave.

Planifikimi i të ardhurave nga burimet e veta për vitin 2020 ka vlerën 528,209 mijë lekë, ndërsa realizimi ka vlerën 333,588 mijë lekë, ose në masën 63%. Për vitin 2021 planifikimi i të ardhurave nga burimet e veta ka vlerën 500,173 mijë lekë, ndërsa realizimi 412,235 mijë lekë, ose në masën 82%.

Për vitin 2020 në realizimin e ulët të të ardhurave, ka pasur ndikim edhe situata e pandemisë shkaktuar nga virusi Covid -19. Por për shkak të kësaj situatë nga Bashkia Berat duhet të ishin marrë në kohën e duhur masa për korigjimin e buxhetit, si për zërin e të ardhurave edhe për zërin e shpenzimeve.

Konstatohet se për këtë qëllim Bashkia Berat ka trajtuar çështjen e uljes së të ardhurave dhe shpenzimeve, por në fund të vitit buxhetor, në muajin nëntor 2020. Për këtë çështje Titullari ka përcjellë në këshillin bashkiak propozimin për korigjimin e buxhetit dhe me VKB nr.70, datë 04.11.2020 është miratuar ulja e planit të të ardhurave dhe shpenzimeve me vlerën 209,458,000 lekë. Propozimi në fund të vitit buxhetor për korigjimin e buxhetit, ka qenë i vonuar, formal dhe pa efekte reale, pasi deri në këtë moment janë marrë pothuaj të gjitha angazhimet buxhetore për shpenzimet mbi bazën e planit fillestar të të ardhurave.

Gjithashtu edhe gjatë vitit 2021 nuk është bërë analiza e zbatimit të buxhetit brenda muajit qershor dhe nuk është dalë në konkluzion nëse duhej rishikuar ose jo buxheti vjetor 2021.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Neni 46 -Rishikimi i zbatimit të buxhetit vendor, të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ku thuhet:

“Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore analizon zbatimin e buxhetit jo me vonë se data 30 qershor e çdo viti dhe, në rast se është e nevojshme, harton e propozon në këshillin e njësisë së vetëqeverisjes vendore ndryshimet në buxhet. Procedurat e shqyrtimit, miratimit dhe zbatimit të ndryshimeve u nënshtrohen të njëjtave rregulla të përcaktuara në nenet 5 dhe 40 të këtij ligji”.

Mos analizimi dhe mos korigjimi i buxhetit brenda muajit qershor 2020, në një situatë që dukshëm ka diktuar një korigjim të tillë, ngarkon me përgjegjësi kryetarin e bashkisë z. E. D., si dhe znj. R. Sh., me detyrë drejtore e Drejtorisë së Menaxhimit Financiar dhe të të Ardhurave, në cilësinë e nëpunësit zbatues, znj. A. Sh., me detyrë specialiste e buxhetit.

Duke ju referuar të gjitha fondeve, pavarësisht burimit të financimit, përfshirë edhe ndihmën ekonomike, analiza e planit dhe faktit të buxhetit për Bashkinë pa ndërmarrjet e vartësisë, është si vijon:

Nga auditimi u konstatohet se realizimi i shpenzimeve buxhetore për vitin 2020 dhe vitin 2021 **për Bashkinë pa ndërmarrjet e vartësisë** kanë diferenca të dukshme me vlerën e planifikuar. Për vitin 2020 planifikimi i shpenzimeve ka vlerën 1,215,034,210 lekë, realizimi 886,261,899 lekë, ose në masën 73%, ndërsa për vitin 2021 planifikimi i shpenzimeve ka vlerën 1,420,940,125 lekë, realizimi 1,226,171,742 lekë, ose në masën 86%.

Niveli i realizimit të investimeve të planifikuara, i cili është zëri më kryesor i buxhetit në lidhje me ndikimin që ka në ofrimin e të mirave publike ndaj komunitetit, është akoma më i ulët se mesatarja e realizimit të buxhetit. Për vitin 2020 investimet janë planifikuar në vlerën 330703081 lekë, realizuar 128502390 lekë, ose në masën 39 %, ndërsa për vitin 2021, vlera e planifikuar është 544,584,236 lekë, realizuar 446,019,793 lekë, ose në masën 82 %.

Ky mos realizim vjen si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave, që do të thotë se nga Bashkia Berat në fillim të vitit buxhetor planifikohen angazhime buxhetore, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifatat vendore dhe ky planifikim nuk korrigjohet gjatë vitit, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat reale të realizuara.

Duke ju referuar të gjitha fondeve, pavarësisht burimit të financimit, përfshirë edhe ndihmën ekonomike, analiza e planit dhe faktit të buxhetit për Bashkinë së bashku me ndërmarrjet e vartësisë, është si vijon:

Nga auditimi u konstatohet se realizimi i shpenzimeve buxhetore për vitin 2020 dhe vitin 2021 për Bashkinë së bashku me ndërmarrjet e vartësisë kanë diferenca të dukshme me vlerën e planifikuar. Për vitin 2020 planifikimi i shpenzimeve ka vlerën **1,787,519 mijë** lekë, realizimi **1,338,709 mijë** lekë, ose në masën 75%, ndërsa për vitin 2021 planifikimi i shpenzimeve ka vlerën **2,029,609 mijë** lekë, realizimi **1,734,762 mijë** lekë, ose në masën 85%.

Niveli i realizimit të investimeve të planifikuara, i cili është zëri më kryesor i buxhetit në lidhje me ndikimin që ka në ofrimin e të mirave publike ndaj komunitetit, është akoma më i ulët se mesatarja e realizimit të buxhetit. Për vitin 2020 investimet janë planifikuar në vlerën 342,890 mijë lekë, realizuar 137,185 mijë lekë, ose në masën 40 %, ndërsa për vitin 2021, vlera e planifikuar është 583,323 mijë lekë, realizuar 458,169 mijë lekë, ose në masën 79 %.

Ky mos realizim vjen si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave, që do të thotë se nga Bashkia Berat në fillim të vitit buxhetor planifikohen angazhime buxhetore, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifatat vendore dhe ky planifikim nuk korrigjohet gjatë vitit, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat reale të realizuara.

Të dhëna të hollshme në formë tabele për buxhetin përfundimtar plan-fakt bashkia pa ndërmarrjet e vartësisë, si dhe së bashku me ndërmarrjet e vartësisë jepen në aneksin nr. 1/2, bashkangjitur projektraportit të auditimit.

Miratimi dhe përdorimi i fondit rezervë, kontigjencës, emergjencë dhe fondet e shpenzuara për përballimin e situatës së pandemisë nga Covid 19

Bazuar në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe nenit 6 të ligjit nr. 9936, datë 26. 06. 2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, për të përballuar shpenzime të paparashikuara në buxhetin e njësisë të qeverisjes vendore, krijohet Fondi Rezervë.

Për të përballuar efektet e mosrealizimit të të ardhurave, nevojën e kryerjes së financimeve të reja dhe shtimin e financimeve mbi fondet e miratuara, të programeve ekzistuese krijohet Fondi i Kontigjencës.

Të dy këto fonde miratohen në masën deri në 3 (tre) % të vlerës së përgjithshme të fondeve të miratuara, duke përfshirë transfertat e kushtëzuara.

Fondet e Emergjencës planifikohen për të përballuar situata emergjente. Në zbatim të nenit 16 të ligjit nr. 8756 date 26.03.2001 “Për Emergjencat Civile ” të ndryshuar, të nenit 29 të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vëndore”, të pikës III/3 të VKM nr.329,datë 16.05.2012, “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për

mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore” – Parashikimi i fondeve të emergjencave civile dhe fondit rezervë është mbështetur në përvojën e viteve të mëparshme, ndërsa fondi i kontigjence parashikohet për herë të parë filluar nga viti 2017 dhe në vijim. Ndryshe nga sa më sipër, fondi i emergjencave civile planifikohet në shume totale minimalisht 4 % të totalit të buxhetit të Bashkisë, filluar nga viti 2020. Në vitin 2021, Pushteti Qendror me tranfertë specifike ka alokuar shumën 8,413 lekë, ndërsa diferenca sikurse e parashikon dhe udhëzimi i MPB nr 2841 datë 20/11/2020 është parashikuar nga të ardhurat e pushtetit vendor.

Nga Bashkia Berat në buxhetin e vitit 2020 është parashikuar fondi i emergjencës civile në vlerën 18,279,590 lekë, në masën 1.7% të buxhetit.

Me VKB Nr.66, datë 26.12.2019 është miratuar për vitin 2020 fondi rezervë, i kontigjencës, si dhe fondi i emergjencës në total lekë, si vijon:

- fondi rezervë nga granti në vlerën 0 lekë;
- fondi rezervë nga të ardhurat në vlerën 2,500,000 lekë;
- fondi kontigjencës nga granti në vlerën 0 lekë;
- fondi kontigjencës nga të ardhurat në vlerën 2,500,000 lekë;
- fondi i emergjencës civile në vlerën 2,500,000 lekë.

Shtuar nga e ardhura e trashëguar nga viti 2019 me VKB Nr. 14 datë 27.02.2020

- fondi kontigjencës nga granti i pakushtëzuar në vlerën 5,905,410 lekë;
- fondi kontigjencës nga të ardhurat në vlerën 3,649,290 lekë;
- fondi i mbrojtjes civile nga të ardhurat në vlerën 18,279,590 lekë.

Planifikimi dhe përdorimi si në tabelën e mëposhtme:

Në 000 lekë

Emertimi	Plan 2020	Fakt 2020
Fond Rezervë	2,500	0
Fond Emergjence (Familjet e dëmtuara nga tërmeti)	2,500	804
Fond Kontigjence	12,055	0
Mbrojtja Civile	18,280	7,670
Totali	35,334	8,474

-Vlera 804 mijë lekë është përdorur nga fondi i emergjencave civile dhe prej këtij fondi kanë përfituar 1 familje të dëmtuara nga tërmeti.

Me VKB Nr. 14, datë 27.02.2020 (konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Berat me shkresën Nr.189/1, datë 03.03.2020), është bërë alokimi në buxhetin e vitit 2020, i vlerës së fondit të emergjencës në masën 1.7% , në vlerën 18,279,590 lekë. Fondet e shtuara për të plotësuar 1.7% janë marrë nga të ardhurat e trashëguara nga viti 2019.

Këto burime të përdoren sipas nevojave me urdhër të titullarit, dhe Vendim të Këshillit Bashkiak, mbështetur në procesverbalet e komisionit sipas vazhdimësisë.

Pra, Bashkia Berat ka pasur në dispozicion për të shpenzuar nga fondi i emergjencave për situatën Covid 19, vlerën 18,279,590 lekë, prej të cilit është shpenzuar vlera 7,669,349 lekë, për objekte prokurimi:

Kontrata Nr.1651/1 datë 02.04.2020 me objekt “Blerje artikuj ushqimorë dhe jo ushqimorë për familjet në nevojë për përbalimin e gjendjes së fatkeqësisë natyrore shkaktuar nga virusi”, me operator ekonomik “K...” ShPK , me vlerë 7,088,410 lekë me TVSH . Përveç kësaj janë bërë dhe blerje me vlerë të vogël, për dezinfektantë, pajisje dezinfektuese dhe termometra në shumën totale 580,939 lekë.

1-“Blerje pako ushqimore për raste emergjence Covid 2019”, në vlerën e kontratës 3,456,250 lekë pa TVSH , ose vlerën 4,147,500 lekë me TVSH , zhvilluar në muajin maj 2020;

2- “Shërbime dezinfektimi pandemia Covid 2019”, në vlerën e kontratës 1,928,112 lekë pa TVSh , ose vlerën 2 313 734 lekë me TVSh , zhvilluar në muajin maj 2020.

Si përfundim, burimi i financimit të fondeve të planifikuara për shkak të situatës Covid 19, janë fondet “Për mbrojtjen civile”. Vlera e këtyre fondeve të miratuara dhe të shpenzuara për vitin 2020 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Në 000/lekë

Nr	Burimi i financimit	Vlera e planifikuar	Vlera e shpenzuar	Vlera e pa shpenzuar
1	Transfertë e pakushtëzuar		0	0
2	Transfertë specifike (e kushtëzuar)	0	0	0
3	Të ardhurat e veta	18,280	7,670	10,610
	Total	18,280	7,670	10,610

Me VKB Nr.81, datë 29.12.2020 është miratuar për vitin 2021 fondi rezervë, i kontigjencës, si dhe fondi i emergjencës në total lekë, si vijon:

- fondi rezervë nga granti në vlerën 0 lekë;
- fondi rezervë nga të ardhurat në vlerën 2,500,000 lekë;
- fondi kontigjencës nga granti në vlerën 0 lekë;
- fondi kontigjencës nga të ardhurat në vlerën 2,500,000 lekë;
- fondi i emergjencës civile në vlerën 2,500,000 lekë.
- fondi i mbrojtjes civile nga të ardhurat 19,445,000 lekë

Me shkresën nr.19697 prot., datë 20.10.2020 të Sekretarit të Përgjithshëm të MFE është bërë alokimi i transfertës specifike “Për mbrojtjen civile”, për vitin 2021 në vlerën 8,135,087 lekë, e cila është shpenzuar në shumën 4,635.376 lekë.

Si përfundim, burimi i financimit të fondeve të planifikuara për fondi rezervë, i kontigjencës, fondi i emergjencës dhe mbrojtjes civile për vitin 2021 në total lekë, si vijon:

Vlera e këtyre fondeve të miratuara dhe të shpenzuara për vitin 2021 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Në 000/lekë

Nr	Burimi i financimit	Vlera e planifikuar	Vlera e shpenzuar	Vlera e pa shpenzuar
1	Transfertë e pakushtëzuar	0	0	0
2	Transfertë specifike (e kushtëzuar)	8,135	4,635	3,500
3	Të ardhurat e veta	26,945	1,266	25,679
	Total	35,080	5,901	29,179

Planifikimi dhe përdorimi për vitin 2021 si në tabelën e mëposhtme:

Në 000 lekë

Emertimi	Plan 2021	Fakt 2021
Fond Rezervë	2,500	140
Fond Emergjence	2,500	1,126
Fond Kontigjence	2,500	0
Mbrojtja Civile	27,580	4,635
Totali	35,080	5,901

Vlera prej 4,635,376 lekë e cila është marrë nga fondi për mbrojtjen civile, është përfituar nga 9 familje, përfitim i cili është miratuar me VKB përkatëse.

Gjithashtu vlera prej 1,126,002 lekë e cila është marrë nga fondi i emergjencave civile, është përfituar nga 9 familje, përfitim i cili është miratuar me VKB përkatëse.

Subvencionet

Këto shpenzime përfaqësojnë shumën e subvencionuar për sh.a.“FK Tomori 1923”, ku Bashkia Berat zotëron 100% të aksioneve të shoqërisë.

Transferimi i fondeve është bërë sipas kërkesave të paraqitura çdo muaj nga sha FK Tomori 1923 për financimin e shpenzimeve të domosdoshme, për paga, sigurime, energji elektrike, uje.

Për vitin 2020 , shpenzime të planifikuara janë 25,000 mijë lekë, dhe të realizuara 25,000 mijë lekë, ose në masën 100 % e planit vjetor.

Për vitin 2021 shpenzime të planifikuara janë 33,000 mijë lekë, dhe të realizuara 33,000 mijë lekë, ose në masën 100 % e planit vjetor.

Realizimi i artikullit 603 Subvencione

Në 000 lekë

Art.	Emërtimi	viti 2020			viti 2021		
		Plan 2020	Fakt 2020	% realizi mit	Plan 2021	Fakt 2021	% realizi mit
603	Subvencione per FK Tomori	25,000	25,000	100%	33,000	33,000	100%

Kredia financiare

Nga Bashkia Berat është marrë kredi Financuar nga CEB –Projekti. Marrëveshja e nën-huasë është lidhur më datë 13.02.2008 ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Bashkisë Berat për Projektin “Ndërtimi e banesave me qëllim social” dhe likuidimi ka filluar në datën 19 Dhjetor 2014. Shuma totale e kredisë është 587,707 euro. Janë likuiduar brenda afateve të përcaktuara të gjitha këstet deri më 31.12.2021 në shumën totale 414,424.2 euro dhe stoku i mbetur më 31.12.2021 është 173,282.8 euro.

Raportet e monitorimit për zbatimin e buxhetit

Në udhëzimin nr. 22, datë 30.07.2018 “ Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e vetëqeverisjes vendore”, përcaktohet:

Pika 19. Nëpunësi autorizues i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgjigjet dhe raporton në këshillin e njësisë së vetëqeverisjes vendore për përgatitjen, kontrollin e brendshëm financiar publik, monitorimin, raportimin, kontabilitetin dhe auditimin e brendshëm të buxhetit, për të gjitha funksionet e njësive të vetëqeverisjes vendore. Pika 20. Nëpunësi autorizues i njësisë së vetëqeverisjes vendore i paraqet këshillit, sa herë që kërkohet, por jo më pak se tre raporte katërmujore të monitorimit të zbatimit të buxhetit.

Pika 22. Nëpunësi autorizues publikon raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit në faqen zyrtare të njësisë, brenda 30 ditëve pas përfundimit të periudhës së raportimit dhe një kopje e tyre i dërgohet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Pika 23. Nëpunësi autorizues, brenda 30 ditëve pas përfundimit të periudhës së raportimit duhet të dërgojë në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, raportet katër mujore dhe vjetore të monitorimit të zbatimit të buxhetit për performancën financiare

Veprimet e kryera nga Bashkia Berat në zbatim te kuadrit ligjor të mësipërm për raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit:

Për vitin 2020:

Raporti i monitorimit të zbatimit të buxhetit vjetor të vitit 2020 është dërguar në Ministrinë e Financave me shkresën tonë nr 1230 prot datë 26.02.2021.

Raportimi i periudhës është: Total Plan Buxheti i rishikuar (bashkia dhe njësitë shpenzuese) 1,134,803 mijë Lekë, Fakti 816,588 mijë Lekë , realizimi 72 %.

Bashkia : plan buxheti i rishikuar 562,318 mijë Lekë, Fakti 364,856 mijë Lekë, realizimi 65 %.

Njësitë e varësisë: plan buxheti i rishikuar 572,485 mijë Lekë, Fakti 451,733 mijë Lekë, realizimi 79 %.

Raporti i monitorimit të zbatimit të buxhetit të periudhës Janar - Gusht 2020 është dërguar në Ministrinë e Financave me shkresën tonë nr 4681 prot datë 30.09.2020.

Raportimi i periudhës është: Total Plan Buxheti vjetor i rishikuar (bashkia dhe njësitë shpenzuese) 1,163,760 mijë Lekë, Total Plan buxheti 8-mujor 932,616 mijë Lekë, Fakti 733,791 mijë Lekë , realizimi 79 %.

Bashkia : plan buxheti vjetor i rishikuar 638,702 mijë Lekë, Plan buxheti 8-mujor 512,425 mijë Lekë, Fakti 390,175 mijë Lekë, realizimi 76 %.

Njësitë e varësisë : plan buxheti vjetor i rishikuar 525,058 mijë Lekë, Plan buxheti 8-mujor 420,191 mijë Lekë, Fakti 343,616 mijë Lekë, realizimi 82 %.

Për vitin 2021

Raporti i monitorimit të zbatimit të buxhetit vjetor të vitit 2021 është dërguar në Ministrinë e Financave me shkresën tonë nr 1142 prot datë 28.02.2022.

Raportimi i periudhës është : Total Plan Buxheti i rishikuar (bashkia dhe njësitë shpenzuese) 1,256,645 mijë Lekë , Fakti 979,512 mijë Lekë , realizimi 78 %.

Bashkia: plan buxheti i rishikuar 653,777 mijë Lekë, Fakti 476,327 mijë Lekë, realizimi 73%.

Njësitë e varësisë : plan buxheti i rishikuar 602,868 mijë Lekë, Fakti 503,185 mijë Lekë, realizimi 83%

Raporti i monitorimit të zbatimit të buxhetit të periudhës Janar - Gusht 2021 është dërguar në Ministrinë e Financave me shkresën tonë nr 4878 prot datë 30.09.2021.

Raportimi i periudhës është: Total Plan Buxheti vjetor i rishikuar (bashkia dhe njësitë shpenzuese) 1,231,271 mijë Lekë , Total Plan buxheti 8-mujor 867,755 mijë Lekë, Fakti 598,036 mijë Lekë , realizimi 69 %.

Bashkia: plan buxheti vjetor i rishikuar 637,336 mijë Lekë, Plan buxheti 8-mujor 452,884 mijë Lekë, Fakti 269,164 mijë Lekë, realizimi 59 %.

Njësitë e varësisë : plan buxheti vjetor i rishikuar 593,935 mijë Lekë, Plan buxheti 8-mujor 414,881 mijë Lekë, Fakti 328,872 mijë Lekë, realizimi 79 %.

Nga të dhënat e mësipërme konstatohet se nuk janë hartuar tre raporte monitorimi 4 mujor, por një 8 mujor dhe një vjetor, në kundërshtim me kuadrin rregullator të cituar më lart, për të cilën mban përgjegjësi kryetari i Bashkisë Berat z. E. D., në cilësinë e nëpunësit autorizues dhe znj. R. Sh., me detyrë drejtore e Drejtorisë së Menaxhimit Financiar dhe të të Ardhurave, në cilësinë e nëpunësit zbatues, znj. A. Sh., me detyrë specialiste e buxhetit.

1.4.Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimeve gjyqësore, vendimeve të shpronësimit dhe niveli i realizimit të të ardhurave (faturat e pa likujduara të shoqërohen me listë analitike të detajuar me nr. fature, datë krijimi etj., sipas raportimit në MFE)

Detyrimet e prapambetura viti 2020

Titulli: Mos marrja e masave të duhura për uljen e vlerës së detyrimeve të prapambetura, viti 2020.

Situata: Bashkia Berat në datën 01.01.2020 ka pasur si çelje të vitit ushtrimor detyrime të prapambetura progresive vlerën 148,895,137 lekë, e cila ka si burim financimi të ardhurat e veta. Nga kjo vlerë në planin e buxhetit vjetor 2020 është planifikuar për likujdim gjatë vitit

2020 vlera 128,103,802 lekë, nga e cila është likuajduar vlera 92,817,555 lekë, ose 72% e vlerës së planifikuar, diferenca prej 56,077,582 lekë e pa likuajduar gjatë vitit 2020. Por gjatë vitit 2020 janë marrë angazhime të reja buxhetore pa pasur fonde në dispozicion, duke krijuar detyrime të reja të prapambetura në vlerën 86,004,848 lekë, duke e çuar në 31.12.2020 vlerën e detyrimeve të prapambetura me burim financimi të ardhurat e veta në 142,082,430 lekë, pothuaj përsëri në vlerën e tyre në fillim të vitit (me diferencë 6,812,707 lekë më pak më 31.12.2020 krahasuar me 31.12.2019).

Pra në total, gjatë vitit 2020 vlera e detyrimeve të prapambetura me burim financimi të ardhurat e veta në datën 31.12.2020, krahasuar me këtë vlerë në fillim të vitit ushtrimor (01.01.2020), është ulur me 6,812,707 lekë, ose në masën prej 5%.

Përveç sa më lartë më 31.12.2020 Bashkia Berat ka krijuar detyrime të tjera të reja gjatë vitit 2020, me burim financimi nga granti (Detyrime për zbatimin e vendime gjyqësore nga Ministra e Brendshme për punonjës të gjendjes civile), në vlerën 1,264,654 lekë, duke çuar vlerën totale të detyrimeve të prapambetura më 31.12.2020 në 143,347,084 lekë (142,082,430 + 1,264,654). Peshën kryesore të detyrimeve e zënë ato për investime në vlerën 82,948,474 lekë, pas së cilave vijjnë detyrime për mallra në vlerën 26,688,811 lekë, detyrime për shërbime në vlerën 23,133,611 lekë, detyrime për zbatimin e vendimeve gjyqësore në vlerën 8,459,994 lekë, detyrime të tjera në vlerën 851,540 lekë.

Kriteri: Marrja e angazhimeve buxhetore pa pasur fonde në dispozicion dhe krijimi i detyrimeve të prapambetura është në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të MFE nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 153-162, Rubrika - Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike, detyrimet kontraktuale midis palëve, nenin 52 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, pikat 82-91.

Ndikimi/Efekti: Likuidimi me ritme të ngadalta të detyrimeve të prapambetura, përveçse është moszbatim i kuadrit rregullator në fuqi, e vë nën vlerë vendore në kushtet e palës përgjegjëse ndaj kreditorëve. Ndodhur në kushtet kur është shkelur marrëveshja e përcaktuar në kontratë me kreditorët për afatin e kryerjes së këtyre pagesave, krijohen premisa që kreditorët nëpërmjet proceseve gjyqësore, përveç vlerës së detyrimit sipas situacionit dhe kontratës, të kërkojnë edhe përqindje të interesave etj., gjë e cila rrit kostot financiare në mënyrë artificiale.

Shkaku: Mos vendosja e fondeve buxhetor në masën e duhur në likuidimin e detyrimeve të prapambetura, si dhe krijimi i detyrimeve të reja gjatë vitit buxhetor.

Të dhëna të hollësishme për detyrimet e prapambetura më 31.12.2020 jepen në tabelën në vijim: Në lekë

Kodi i detyrimit të prapambetura.	Emërtimi i detyrimit të prapambetura	Detyrimi prapambetur progresiv më 31.12.2019	Vlera e planifikuar për likuidim në planin e buxhetit 2020 për detyrimet e prapambetura	Vlera e paguar gjatë vitit 2020 për detyrimin e prapambetur (vlera e paguar për kolonën 3)	Vlera e detyrimeve të trashëguara të pa paguara më 31.12.2020 (pa detyrimet e krijuara gjatë 2020)	Detyrim i prapambetur i krijuar vetëm gjatë vitit 2020 (situata më 31.12.2020)	Vlera totale e detyrimeve të prapambetur pa më 31.12.2020
1	2	3	4	5	6=3-5	7	8=6+7
I. Detyrime që kanë si burim financimi të ardhurat e veta							
4864100	Detyrime për vendime gjyqësore	21,817,714	21,817,714	21,817,714	0	8,459,994	8,459,994
4864200	Detyrime për shërbime	30,912,419	27,912,419	20,997,783	9,914,636	13,218,975	23,133,611
4864300	Detyrime për mirëmbajtje	0		0	0	0	0
4864400	Detyrime për investime	75,524,541	57,733,206	37,166,422	38,358,119	44,590,355	82,948,474
4865600	Detyrime për mallra	19,718,061	19,718,061	12,764,774	6,953,287	19,735,524	26,688,811
4864900	Detyrime të tjera	922,402	922,402	70,862	851,540	0	851,540
	Totali i detyrimeve që kanë si burim financimi të ardhurat e veta	148,895,137	128,103,802	92,817,555	56,077,582	86,004,848	142,082,430
II. Detyrime të prapambetura nga granti (FZHR etj (Ministritë e linjës)							
4864400	Detyrime nga FZHR etj	0		0	0	0	0
4864100	Detyrime për vendime gjyqësore (Min. e Brendshme për punonjës të GJ.Civile)	0		0	0	1,264,654	1,264,654
	Totali i detyrimeve që kanë si burim financimi Grantin	0		0	0	1,264,654	1,264,654
Detyrime në total nga të ardhurat e veta + granti		148,895,137		92,817,555	56,077,582	87,269,502	143,347,084

Detyrimet e prapambetura viti 2021

Titulli: Mos marrja e masave të duhura për uljen e vlerës së detyrimeve të prapambetura, viti 2021.

Situata: Bashkia Berat në datën 01.01.2021 ka pasur si çelje të vitit ushtrimor detyrime të prapambetura progresive me burim financimi të ardhurat e veta vlerën 142,082,430 lekë. Nga kjo vlerë në planin e buxhetit vjetor 2021 është planifikuar për likuidim gjatë vitit 2021 vlera 112,947,611 lekë, nga e cila është likuiduar vlera 104,762,695 lekë, ose 93% e vlerës së planifikuar, diferenca prej 37,319,735 lekë e pa likuiduar gjatë vitit 2021. Por gjatë vitit 2021 janë krijuar detyrime të reja të prapambetura në vlerën 58,207,485 lekë, duke e çuar në 31.12.2021 vlerën e detyrimeve të prapambetura me burim financimi të ardhurat e veta në 95,527,220 lekë.

Përveç sa më lartë më 31.12.2021 Bashkia Berat ka detyrime të prapambetura me burim financimi nga granti, të cilat janë detyrime për investime nga Ministria e Infrastrukturës në vlerën 75,056,351 lekë, e cila është krijuar gjatë vitit 2021, duke çuar vlerën totale të detyrimeve të prapambetura më 31.12.2021 në vlerën 170,583,571 lekë.

Pra në total, gjatë vitit 2021 vlera e detyrimeve të prapambetura me burim financimi të ardhurat e veta në datën 31.12.2021, krahasuar me këtë vlerë në fillim të vitit ushtrimor (01.01.2021), është ulur me 46,555,210 lekë, ose në masën prej 33%.

Peshën kryesore të detyrimeve që kanë si burim financimi të ardhurat e veta e zënë ato për investime në vlerën 75,938,443 lekë, të ndjekura nga detyrime për mallra në vlerën 11,002,467 lekë, ë, detyrime për zbatimin e vendimeve gjyqësore në vlerën 4,954,630 lekë, detyrime për shërbime në vlerën 3,380,140 lek.

Kriteri: Marrja e angazhimeve buxhetore pa pasur fonde në dispozicion dhe krijimi i detyrimeve të prapambetura është në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të MFE nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 153-162, Rubrika - Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike, detyrimet kontraktuale midis palëve, nenin 52 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, pikat 82-91.

Ndikimi/Efekt: Likuidimi me ritme të ngadalta të detyrimeve të prapambetura, përveçse është moszbatim i kuadrit rregullator në fuqi, e vë njësinë vendore në kushtet e palës përgjegjëse ndaj kreditorëve. Ndodhur në kushtet kur është shkelur marrëveshja e përcaktuar në kontratë me kreditorët për afatin e kryerjes së këtyre pagesave, krijohen premisa që kreditorët nëpërmjet proceseve gjyqësore, përveç vlerës së detyrimit sipas situacionit dhe kontratës, të kërkojnë edhe përqindje të interesave etj., gjë e cila rrit kostot financiare në mënyrë artificiale.

Shkaku: Mos vendosja e fondeve buxhetor në masën e duhur në likuidimin e detyrimeve të prapambetura, si dhe krijimi i detyrimeve të reja gjatë vitit buxhetor.

Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Berat dhe Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të marrin masa për likuidimin e vlerës së kontratave të lidhura midis Bashkisë Berat dhe kontraktorëve, sipas afateve të përcaktuar në kontratë, duke eliminuar në këtë mënyrë shkakun e krijimit të detyrimeve të prapambetura. Lidhja e kontratës të bëhet vetëm pasi fondi që parashikon procedura e prokurimit do të jetë në dispozicion (në llogarinë e thesarit) të autoritetit kontraktor. Për çdo procedurë prokurimi, urdhri i prokurimit të depozitohet menjëherë në degën e thesarit përpara zhvillimit të procedurës. Gjithashtu të marrë masa që gjatë zbatimit të buxhetit, prioritet të kenë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës.

Për mos marrjen e masave për likuidimin e detyrimeve të prapambetura dhe krijimin e detyrimeve të reja për periudhën 01.01.2020 -31.12.2021, ngarkohet me përgjegjësi kryetari i Bashkisë Berat z. E. D., në cilësinë e nëpunësit autorizues, znj. R. Sh., me detyrë drejtore e

Drejtorisë së Menaxhimit Financiar dhe të të Ardhurave, në cilësinë e nëpunësit zbatues, znj. A. Sh., me detyrë specialiste e buxhetit.

Të dhëna për fondet e pa përdorura dhe të trashëguara në fund të vitit buxhetor.

Fondet e trashëguara në 31.12.2018 për përdorim në vitin 2019 sipas rakordimit me thesarin (Llog. 520 në bilanc pa pjesën e llog 466)	Fondet e trashëguara në 31.12.2019 për përdorim në vitin 2020 sipas rakordimit me thesarin (Llog. 520 në bilanc pa pjesën e llog 466)	Fondet e trashëguara në 31.12.2020 për përdorim në vitin 2021 sipas rakordimit me thesarin (Llog. 520 në bilanc pa pjesën e llog 466)	Fondet e trashëguara në 31.12.2021 për përdorim në vitin 2022 sipas rakordimit me thesarin (Llog. 520 në bilanc pa pjesën e llog 466)
121,633,190	69,104,877	123,204,259	144,843,123

Të dhëna të hollësishme për detyrimet e prapambetura më 31.12.2021 jepen në tabelën në vijim:

Kodi i detyrimit te prapamb.	Emerimi i detyrimit te prapamb.	Detyrimi prapambetur progresiv më 31.12.2020	Vlera e planifikuar për likujdim në planin e buxhetit 2020 për detyrimet e prapambetura	Vlera e paguar gjatë vitit 2021 për detyrimin e prapambetur (vlera e paguar për kolonën 3)	Vlera e detyrimeve të trashëguara të pa paguara më 31.12.2021 (pa detyrimet e krijuara gjatë 2021)	Detyrim i prapambetur i krijuar vetëm gjatë vitit 2021 (situata më 31.12.2021)	Vlera totale e detyrimeve të prapambetur a më 31.12.2021
1	2	3	4	5	6=3-5	7	8=6+7
I. Detyrime që kanë si burim financimi të ardhurat e veta							
4864100	Detyrime për vendime gjyqësore	8,459,994	8,459,994	8,459,994	0	4,954,630	4,954,630
4864200	Detyrime për sherbime	23,133,611	23,133,611	19,753,471	3,380,140	0	3,380,140
4864300	Detyrime për mirembajtje	0		0	0	0	0
4864400	Detyrime për investime	82,948,474	55,052,545	50,247,769	32,700,705	43,237,738	75,938,443
4864400	Detyrime për nga Ministrite e Linjes (specifiko FZHR etj...)	0		0	0	0	0
4865600	Detyrime për mallra	26,688,811	25,701,461	25,701,461	987,350	10,015,117	11,002,467
4864900	Detyrime te tjera	851,540	600,000	600,000	251,540	0	251,540
	Totali i detyrimeve që kanë si burim financimi të ardhurat e veta	142,082,430	112,947,611	104,762,695	37,319,735	58,207,485	95,527,220
II. Detyrime te prapambetura nga granti (FZHR etj (Ministrite e linjës)							
4864400	Detyrime për Investime nga Ministrite e Linjes (Min. e Infrastruktures)	0		0	0	75,056,351	75,056,351
4864100	Detyrime për vendime gjyqësore (Min. e Brendshme per punonjes te GJ.Civile)	1,264,654		1,264,654	0	0	0
	Totali i detyrimeve që kanë si burim financimi Grantin	1,264,654		1,264,654	0	75,056,351	75,056,351
Detyrime ne total nga të ardhurat e veta + granti		143,347,084		106,027,349	37,319,735	133,263,836	170,583,571

Niveli i vështirësive financiare

Në UMFE nr.26, datë 27.09.2019 “Procedura për menaxhimin e vështirësisve financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore”, trajtohet shkalla e vështirësisë financiare dhe menaxhimi i këtyre vështirësive.

Gjithashtu në ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, datë 27.04.2017, kreu XI vështirësitë financiare dhe masat për zgjidhjen e tyre, neni 55 probleme financiare, pika 1, përcaktohet se: “Njësia e vetëqeverisjes vendore konsiderohet me probleme financiare kur në një muaj të caktuar të vitit buxhetor konstatohen vonesa prej më shumë se 30 ditësh në likuidimin e detyrimeve financiare ndaj palëve të treta dhe kur detyrimet e konstatuara dhe të papaguara përbëjnë 15 për qind të shpenzimeve vjetore të miratuara”.

Për Bashkinë Berat, totali i shpenzimeve të miratuara nga të ardhurat e veta me VKB për vitin 2021 ka vlerën **1,256,644,986** lekë, ndërsa stoku i detyrimeve të prapambetura nga të ardhurat e veta më 31.12.2021 (pa përfshirë detyrimet e FZHR), ka vlerën **95,527,220** lekë. Raporti i këtyre treguesve, pra raporti i stokut të detyrimeve të prapambetura me shpenzimeve totale të miratuara, ka vlerën 7.6 %, shifër që e klasifikon Bashkinë Berat në njësi të qeverisjes vendore me situatë normale të gjendjes financiare.

N.R	Emërtimi	Stoku në vlerë	Totali i shpenzimeve të miratuara për NJVQV-në	Stoku/Shpenzimeve totale të miratuara të NJQV-së
I	Borxhe (a+b)	0		
a	Hua afatgjatë	0		
b	Hua afatshkurtër	0		
II	Detyrime (a+b+c)	95,527,220		7.60%
a	Shpenzime korrente	14,634,147		
a,1	Mallra dhe shërbime	14,382,607		
a,3	Të tjera	251,540		
b	Shenzime kapitale	75,938,443		
b,2	Subjekte private	75,938,443		
c	Vendime gjyqësore	4,954,630		
c,1	Marrëdhënie pune	4,796,630		
c,4	Të tjera	158,000		
III	Totali (I+II)	95,527,220	1,256,644,986	7.60%

Burimi: Bashkia Berat

Efektet financiare në buxhet, si rezultat i zbatimit të vendimeve gjyqësore.

- Mbi pagesat e vendimet gjyqësore për dëmshpërblim page punonjësit e larguar nga puna

Në lekë

<i>Numri i vendimeve gjyqësore si çelje më 01.01.2020</i>	<i>Vlera e vendimeve gjyqësore si çelje më 01.01.2020</i>	<i>Numri i vendimeve gjyqësore të ardhura në financë gjatë vitit 2020</i>	<i>Vlera e vendimeve gjyqësore të ardhura në financë gjatë vitit 2020</i>	<i>Pagesa në lekë të kryera gjatë vitit 2020</i>	<i>Detyrimi në lekë më 31.12.2020</i>
23	12,784,694	13	12,873,918.00	16,211,833	9,446,779
<i>Numri i vendimeve gjyqësore si çelje më 01.01.2021</i>	<i>Vlera e vendimeve gjyqësore si çelje më 01.01.2021</i>	<i>Numri i vendimeve gjyqësore të ardhura në financë gjatë vitit 2021</i>	<i>Vlera e vendimeve gjyqësore të ardhura në financë gjatë vitit 2021</i>	<i>Pagesa në lekë të kryera gjatë vitit 2021</i>	<i>Detyrimi në lekë më 31.12.2021</i>
8	9,446,779	5	5,414,512	10,064,661	4,796,630

Mbi pagesat e vendimet gjyqësore për çështje të tjera të ndryshme

Në lekë

<i>Numri i vendimeve gjyqësore si çelje më 01.01.2020</i>	<i>Vlera e vendimeve gjyqësore si çelje më 01.01.2020</i>	<i>Numri i vendimeve gjyqësore të ardhura në financë gjatë vitit 2020</i>	<i>Vlera e vendimeve gjyqësore të ardhura në financë gjatë vitit 2020</i>	<i>Pagesa në lekë të kryera gjatë vitit 2020</i>	<i>Detyrimi në lekë më 31.12.2020</i>
6	9,033,020	3	277,869	9,033,020	277,869
<i>Numri i vendimeve gjyqësore si çelje më 01.01.2020</i>	<i>Vlera e vendimeve gjyqësore si çelje më 01.01.2020</i>	<i>Numri i vendimeve gjyqësore të ardhura në financë gjatë vitit 2020</i>	<i>Vlera e vendimeve gjyqësore të ardhura në financë gjatë vitit 2020</i>	<i>Pagesa në lekë të kryera gjatë vitit 2020</i>	<i>Detyrimi në lekë më 31.12.2020</i>
3	277,869	1	158,000	277,869	158,000

Titulli i Gjetjes: Efekte negative ne buxhet si rezultat i zbatimit të vendimeve gjyqësore.

Situata: Bashkia Berat për zbatimin e vendimeve gjyqësore për vitin 2020 ka shpenzuar vlerën 25,244,853 lekë, nga e cila vlera 16,211,833 i përket vendimeve gjyqësore me objekt dëmshpërblim page për largime nga puna të punonjësve për 22 raste, ndërsa vlera 9,033,020 lekë për 6 raste i përket vendimeve për çështje të tjera gjyqësore, si konstatim i pavlefshmërisë absolute të procesit të shpronësimit, dëmshpërblim dëmi etj.

Për zbatimin e vendimeve gjyqësore për vitin 2021 është shpenzuar vlerën 10,342,530 lekë, nga e cila vlera 10,064,661 lekë i përket vendimeve gjyqësore me objekt dëmshpërblim page për largime nga puna të punonjësve për 9 raste, ndërsa vlera 277,869 lekë për 3 raste i përket vendimeve për çështje të tjera gjyqësore, si shfuqizim akti e anulim vendimi.

Vlera totale **35,587,383 lekë** e shpenzuar për periudhën tetor 2019 - dhjetor 2021 nga Bashkia Berat, për zbatimin e vendimeve gjyqësore, **konsiderohet efekt financiar negativ në buxhet.**

Vendimet gjyqësore nuk janë analizuar nga Kryetari i Bashkisë dhe nuk është kërkuar prej Tij nxjerrja e përgjegjësive administrative për këto vendime. Analizimi i arsyeve të humbjeve të vendimeve gjyqësore dhe nxjerrja e përgjegjësive administrative për to, do të ndikonte pozitivisht në korrigjimin e praktikave të gabuara të ndjekura nga njësia vendore në proceset e largimit të punonjësve nga puna dhe për çështje të tjera gjyqësore, evidentimin e

procedurave të bëra gabim, në kundërshtim me kuadrin rregullator në fuqi, e si rezultat shmangien e tyre në të ardhmen dhe uljen e shpenzimeve financiare negative në buxhet.

Kriteri: Mos kryerja e kësaj analize nga Titullari është në kundërshtim me pikën nr. 60, të UMFE nr. 9, datë 20.03.2018, "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", i ndryshuar.

Ndikimi/Efekti: Proceset gjyqësore dhe humbja e çështjes së tyre nga njësia vendore, krijojnë efekte negative në buxhet.

Shkaku: Mos zbatimi i kriterëve ligjore në procesin e largimeve nga puna të punonjësve, si dhe shkelje e kuadrin rregullator në fuqi, gjë e cila sjellë hapjen e proceseve gjyqësore.

Rëndësia: Elartë.

Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Berat të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatohet, me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kanë sjellë humbjen e çështjes gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për çështjen e largimit të punonjësve nga puna dhe çështje të tjera, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet.

- *Pagesat e kryera për shpronësimet:*

Viti 2020

Nr.	Emërtimi i Objektivit të shpronësimit	VKM			Burimi i Financimit	Numri i pronave të shpronësuara		Shuma Lek	
		Nr.	Datë	Shuma Lek		Progr.	Fakt	Plan	Fakt
1	Zgjerimi i varrezave në fshatin Roshnik	21	15.01.2020	1,343,213	Fonde te veta	3	4	1,343,213	1,343,213
2	Sistemi i heqjes së mbeturinave publike në lagjen "Donika Kastrioti"	291	14.04.2020	476,121	Fonde te veta	1	1	476,121	476,121
Totali				1,819,334				1,819,334	1,819,334

Viti 2021

Nr.	Emërtimi i Objektivit të shpronësimit	VKM			Burimi i Financimit	Numri i pronave të shpronësuara		Shuma Lek	
		Nr.	Datë	Shuma Lek		Progr.	Fakt	Plan	Fakt
1	Rikonstruksion i rrugëve, trotuarëve dhe ndriçimit në lagjen "30 Vjetori", zona e ish pjeshkores	255	27.03.2020	13,836,109	Fonde të veta	44	28	13,836,109	8,890,032
2	Rikonstruksion dhe zgjerim i rruges "Muzak Topia"	43	27.01.2021	13,216,696	Buxheti I shtetit	31	31	13,216,696	13,216,696
Total				27,052,805				27,052,805	22,106,728

Në lidhje me shpronësimin me objekt "Rikonstruksion dhe zgjerim i rrugës "Muzak Topia", Bashkia Berat ka likuiduar në llogaritë direkte të përfituesve shumën 6,255,422 lekë dhe shumën e mbetur prej 6,961,274 lekë për 16 përfitues që nuk kanë plotësuar dokumentacionin e nevojshëm për likuidim, ose nuk kanë paraqitur kërkesë për pagesë, e ka derdhur në një llogari të posaçme në R. B., mbështetur në Akt-Marrëveshjen Nr. 3308 datë 24.06.2021, për t'u kaluar rast pas rasti në llogaritë e përfituesve pas plotësimit nga ana e tyre të dokumentave të kërkuar për likuidim. Nga shuma e derdhur në R. B. janë kaluar në llogaritë personale të 5 përfituesve shuma prej 1,269,556 lekë.

Gjendja në llogarinë e posaçme në datën 31.12.2021 është 5,691,718 lekë.

Celja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZHR, saktësia e raportimit buxhetor të tyre.

Për vitin 2020 janë financuar me fonde të buxhetit të shtetit 2 investime publike:

- Investimi me objekt “Ndërtimi i linjës kryesore të furnizimit me ujë të Nj. Ad. Velabisht”, me vlerë të kontratës 154,92 mijë lekë me TVSH . Për këtë investim financimi ka qenë i shtrirë në periudhën për 2020-2021-2022. Vlera e pa likuajduar ende për arsye të shtrirjes në kohë të kontratës, është 73,577 mijë lekë, fonde të cilat janë akorduar nga buxheti shtetit për vitin aktual.

- Investimi me objekt “Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitete të varfra e të pa favorizuara”, me financim për periudhën 2020-2021, bashkë financues edhe Bashkia Berat, me vlerë kontrate 8,503 mijë lekë, financim i përfunduar në vitin 2021.

Viti 2020. Në 000 lek

Nr	Objekti i prokurimit	Kontrata nr..datë	Vlera e plotë e kontratës me TVSH	Vlera e likuajduar 2020	Vlera e pa likuajduar	Arsyet e mos likuajdimit
1	Ndërtimi i linjës kryesore të furnizimit me ujë të Nj. Ad. Velabisht	Kontrata Nr. 2134 datë 29.06.2020	154,992	31,414	123,577	Fonde të akorduara nga buxheti shtetit për vitin aktual
2	Supervizim, Ndërtimi i linjës kryesore të furnizimit me ujë të Nj. Ad. Velabisht	Kontrata Nr. 3077/3 datë 06.07.2020	2,461	541	1,920	Realizuar pjesërisht
3	Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitete të varfra e të pafavorizuara (Bashkefinancim), v.2020-2021	Kontrata Nr. 3756/1 datë 22.09.2020	8,503	6,264	2,239	Kontrata 2020-2021

Për vitin 2021 ka vazhduar financimi i dy investimeve të filluar në vitin 2020, si dhe janë financuar investime të reja:

- Ujësjetësi i fshatit Duhanas, Lapardha 1, Otlak, Orizaj, për të cilën është lidhur kontrata Nr. 519/1 datë 04.02.2021, me vlerë 438,068 mijë lekë, financim i shtrirë deri në vitin 2024, likuiduar gjatë vitit 2021 vlera 219,349 mijë lekë, mbetur për periudhën në vijim për likuidim vlera 218,720 mijë lekë.

- Studim Projektim KUZ Lagja Uznovë Rajoni III dhe Fshati Duhanas, me vlerë 18,708 mijë lekë, likuiduar vlera 4,000 mijë lekë, mbetur për periudhën në vijim për likuidim vlera 14,708 mijë lekë, fonde të akorduara nga buxheti shtetit për vitin aktual.

- Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitete të varfra e të pa favorizuara (Bashkefinancim), investim i shtrirë për periudhën 2021-2022, me vlerë të kontratës 25,705 mijë lekë, likuiduar vlera 10,561 mijë lekë, mbetur për periudhën në vijim për likuidim vlera 15,143 mijë lekë

Viti 2021 në 000/ lekë

Nr	Objekti i prokurimit	Kontrata nr..datë	Vlera e plotë e kontratës me TVSH	Vlera e likuajduar 2021	Vlera e pa likuajduar	Arsyet e mos likuajdimit
1	Ndërtimi i linjës kryesore të furnizimit me ujë të Nj. Ad. Velabisht	Kontrata Nr. 2134 datë 29.06.2020	154,992	50,000	73,577	Fonde të akorduara nga b.shtetit për vitin aktual
2	Supervizim, Ndërtimi i linjës kryesore të furnizimit me ujë të Nj. Ad. Velabisht	Kontrata Nr. 3077/3 datë 06.07.2020	2,461	700	1,220	Fonde të akorduara nga b.shtetit për vitin aktual
3	Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitete të varfra e të pafavorizuara (Bashkefinancim),	Kontrata Nr. 3756/1 datë 22.09.2020	8,503	2,239	0	Përfunduar

	v.2020-2021					
4	Ujesjellesi i fshatit Duhanas, Lapardha 1, Otlak, Orizaj	Kontrate Nr. 519/1 datë 04.02.2021	438,068	219,349	218,720	Fonde te akorduara nga b.shtetit per vitin aktual
5	Supervizim, Ujesjellesi I fshatit Duhanas, Lapardha 1, Otlak, Orizaj	Kontrate Nr. 189/10 datë 24.02.2021	4,865	973	3,892	Fonde te akorduara nga b.shtetit per vitin aktual
6	Studim Projektim KUZ Lagja Uznove Rajoni III dhe Fshati Duhanas	Kontrate Nr. 241/12 datë 09.02.2021	18,708	4,000	14,708	Fonde te akorduara nga b.shtetit per vitin aktual
7	Shpronosim per interes publik rruga Muzak Topia	VKM Nr. 43 datë 27.01.2021	13,300	13,217	83	Ne zbatim
8	Kolaudim "Ndertim i linjës kryesore dhe shpërndarjes së furnizimit me ujë Njësia Administrative Velabisht"	Kontrata Nr. 3097/1 datë 14.06.2021	259	0	259	Ne zbatim
9	Permiresimi i banesave ekzistuese per komunitete te varfra e te pafavorizuara (Bashkefinancim), v.2021-2022	Kontrata Nr. 4785/3 datë 28.09.2021	25,705	10,561	15,143	Ne zbatim, kontrata 2021-2022

Faturat e palikuiduara në datën 31.12.2020 dhe 31.12.2021 paraqiten në aneksin nr. 1/3, bashkangjitur projektraportit të auditimit

2.2. Burimi i krijimit të të ardhurave, vlerësimi i mbledhjes së tyre

➤ Strukturat për administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore

Për vitin 2020 numri i përgjithshëm i punonjësve është miratuar me VKB nr. 120, datë 20.02.2020, "Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Berat dhe Institucioneve të Varësisë dhe funksioneve të transferuara për vitin 2020", ku përfshihet edhe struktura e Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, e cila sipas strukturës është e përbërë nga sektorë dhe në total ka 20 punonjës: ku 2 janë specialistë të vlerësimit të taksave dhe tarifave të biznesit, 1 specialist për njësitë dhe arkëtimet në sistem, 1 Inspektor të ardhurash të Tregut Industrial, 1 specialist i vlerësimit të taksave dhe tarifave për ambulancat, institucionet dhe parkimin, 2 specialist për inspektimin, kontrollin tatimor në terren, 2 specialist për taksat dhe tarifatat në lagje, 4 specialist për taksat dhe tarifatat në Njësitë Administrative, 3 specialist për mbledhjen dhe monitorimin e borxhit dhe 3 punonjës për parkimin dhe tregjet.

Për vitin 2021 numri i përgjithshëm i punonjësve është miratuar me VKB nr. 827, datë 15.12.2020, "Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Berat dhe Institucioneve të Varësisë dhe funksioneve të transferuara për vitin 2021", ku përfshihet edhe struktura e drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, e cila sipas strukturës nuk është e përbërë nga sektorë dhe në total ka 20 punonjës, ku 1 është Përgjegjës për Taksat dhe Tarifatat, 2 janë specialistë të vlerësimit të taksave dhe tarifave të biznesit, 1 është Specialist për inspektimin, kontrollin tatimor ne terren. 1 punonjës specialist për njësitë dhe arkëtimet ne sistem, 1 është specialist i vlerësimit të taksave dhe tarifave për ambulancat, institucionet dhe parkimin, 2 janë specialist për taksat dhe tarifatat në lagje, 4 janë specialist për taksat dhe tarifatat në Njësitë Administrative, 3 janë specialist për mbledhjen dhe monitorimin e borxhit, 1 punonjës për të ardhurat të Tregut Industrial si dhe 3 punonjës për parkimin dhe tregjet. respektivisht aneksi nr. 1 pika 2.6 bashkëlidhur projekt raportit të auditimit.:

Titulli gjetjes: *Mangësitë e konstatuara në plotësimin e strukturës për administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore*

Situata: Konstatohet se: struktura e DAV Bashkia Berat ka probleme dhe nuk është në funksion të realizimit e të ardhurave, pasi evidentohet mos krijimi i Sektorit të Masave Shtrenguese si një nga sektorët më të rëndësishëm në DAV Bashkia Berat, pasi evidentohet se një numër i lartë i detyrimeve të paarkëtuara (debitor), për 15,154 subjekte familjar dhe biznesi në vlerën 236,557 mijë lekë, nga e cila: subjekte fizik/juridik dhe institucioni shtetërore në vlerë 104,297 mijë lekë për 792 subjekte dhe abonentë familjarë në vlerë 132,259 mijë lekë për 14,362 abonent. Alternim i këtij sektori në përbërje të Sektorit të Kontrollit Terren është i papërshtatshëm, kjo nisur nga fakti se kanë natyra të ndryshme pune dhe se arkëtimi i debitorëve është procedurë më vetë dhe afate të përcaktuara.

- Gjithashtu konstatohet se në strukturën organizative të DAV Bashkia Berat, janë evidentuar mangësi në plotësimin e strukturës organizative me specialit respektivisht; Specialist në kontrollin e biznesit, Specialist për taksat dhe tarifave Njësine Administrative Sinje, Agjent për arkëtimet e taksave dhe tarifave të familjeve dhe bizneseve Njësine Administrative Otlak çka sjell mos evidentimin e subjekteve, mos llogaritjen e detyrimit fiskale për këto mos deklarime si dhe mos arkëtimin e të ardhurave, kjo për mungesë stafi, në kundërshtim me pikën (ç) të nenit 5 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar dhe në Kreun XI- “Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar”, nenet 88 – 104, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH” me ndryshime, si dhe Rregullore e Brendshme miratuar me shkresën nr. 737 prot datë 07.02.2018. Veprimet dhe mosveprimet ngarkojnë me përgjegjësi z. G. D. me pozicion Drejtor në Drejtorin e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse si dhe z. S. T. me pozicion Drejtore i Drejtorisë së Taksave Vendore.

Kriteri: Në përputhje me pikën (ç) të nenit 5 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar dhe në Kreun XI- “Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar”, nenet 88 – 104, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH” me ndryshime.

Ndikimi/Efekti: Mungesa e stafit dhe mos përshtatja e strukturës më natyrën e menaxhimit të të ardhurave, çojnë në mos realizim të të ardhurave dhe mungesë të tyre në buxheti e Bashkisë Berat.

Shkaku: Mos njohja e kuadrit ligjorë për ,menaxhimit e të ardhurave nga instancat drejtues Bashkia Berat.

Rëndësia: i lartë

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Berat në bashkëpunim me Drejtoria e Burimeve Njerëzore të marrë masa për plotësimin e stafit të DAV Bashkia Berat me specialit të fushës dhe përshtatja e strukturës sipas natyrës së menaxhimit të të ardhurave, duke krijuar Sektorin e Menaxhimit të Borxhit.

➤ **Parashikimi dhe realizimi i taksave dhe tarifave vendore sipas llojeve**

Titulli i gjetjes: Performancë e dobët në planifikimin dhe realizimin e disa zërave të të ardhurave për periudhën objekt auditimi.

Situata: Për vitin 2019, Bashkia Berat nuk ka miratuar paket të re fiskale por ka ushtruar aktivitetin me paketën fiskale të vitit 2015, miratuar me VKB nr. 57, datë 28.12.2015, e konfirmuar nga Prefekti. Nga të dhënat e pasqyrës aneks nr. 2 pika 2.6 bashkëlidhur projekt raportit të auditimit, shihet se për vitin 2019 të ardhurat nga 503,966 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 307,716 mijë lekë ose 61 %, për shkak të mosrealizimit në zëra të veçantë si taksa e rentës, taksa e ndikimit në infrastrukturë etj...

Për vitin 2020, Planifikimi fillestar është në vlerën 528,209 mijë lekë dhe realizimi është në vlerën 333,588 mijë lekë ose 63 %, sipas planit të ndryshuar janë në vlerën 318,752 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 333,588 mijë lekë ose 105 %.

Për vitin 2020, ndryshimet e bëra në të ardhurat totale të planifikuara sipas vendimit nr. 70 datë 04.11.2020 është bërë ndryshimi i VKB nr. 66 datë 26.12.2019 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Berat për vitin 2020 dhe PBA përfundimtare 2020-2022” duke ulur planifikimin. Ndryshime të cilat nuk janë pranuar nga Dega e Thesarit Berat referuar nenit 47 të ligjit Nr.9936, datë 26.6.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar.

Gjatë auditimit është konstatuar se tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël paraqitet me ulje nga njëra periudhë në tjetër (2020/2021), për vlerën **4,800 mijë lekë**, ulje kjo e paargumentuar nga DAV Bashkia Berat, taksat vendore me rritje nga njëra periudhë në tjetër (2020/2021), për vlerën **4,479 mijë lekë**, rritje kjo e paargumentuar nga DAV Bashkia Berat, tarifatat vendore me ulje nga njëra periudhë në tjetër (2020/2021), për vlerën **46,400 mijë lekë**, ulje kjo e paargumentuar nga DAV Bashkia Berat, etj... nisur nga fakti se dhe për vitin 2021 nuk ka pasur ndryshime të paketën fiskale, vlerë kjo e cila konsiderohet e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Berat, sipas pasqyrës aneks nr. 2 pika 2.6 bashkëlidhur projekt raportit.

Për vitin 2021, Bashkia Berat nuk ka miratuar paket të re fiskale por ka ushtruar aktivitetin me paketën fiskale të vitit 2020, miratuar me VKB nr. 60, datë 18.12.2019, e konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Berat me shkresën nr. 1550/1 datë 19.12.2019.

Nga të dhënat e **pasqyrës aneks 2** më poshtë, shihet se për vitin 2021 të ardhurat nga 500,173 lekë të planifikuara, janë realizuar 412,173 mijë lekë ose 82 %.

Për vitin 2021, ka pasur mos realizim në vlerën 87,938 mijë lekë, kryesisht në taksat e popullatës, si p.sh. taksa e tokës bujqësore, taksa e ndërtesës dhe tarifa e pastrim-gjelbërimit.

Nga intervistat e zhvilluara me punonjësit e Drejtorisë së të ardhurave, rezultoi se faktorët kryesorë të mos realizimit janë: 1. Niveli ekonomik-financiar i familjeve; 2. Emigrimi dhe migrimi; 3. Probleme të pronësisë si dhe 4. Edukimi fiskal i komunitetit për pagesën e taksave dhe tarifave vendore. Komuniteti nuk është ndërgjegjësuar për pagesën me vullnet të lirë të detyrimeve vendore. Për mosrealizimin gjatë viteve 2019 - 2021, një faktor i rëndësishëm për mos realizimin e zërave të të ardhurave si për popullatën, ashtu edhe për biznesin ishte pandemia Covid-19.

Për periudhën e audituar, evidencat e rakordimeve me thesarin janë nënshkruar nga: Kryetari i Bashkisë z. E. D., Drejtoresha e Financës znj. R. Sh., Specialiste e Financës znj. G. S., Specialiste e të Ardhurave dhe Bankës znj. A. Dh. si dhe znj. A. R., në cilësinë e specialistes të Degës së Thesarit Berat.

Referuar planit vjetor të miratuar dhe aktrakordimeve me Degën e Thesarit Berat, parashikimi dhe realizimi i të ardhurave vendore për vitin 2019 - 2021 janë paraqitur të detajuara në **Pasqyrën aneks nr. 2, pika 2.6 bashkëlidhur projekt raportit të auditimit.**

Konstatohet se për disa taksa dhe tarifa, realizimi paraqitet në vlera të ulta dhe për disa taksa dhe tarifa të tjera realizimi paraqitet shumë mbi planin, gjë që tregon se planifikimi i të ardhurave nuk është real, ka rezerva në planifikim ose fryrje të pritshmërisë së arkëtimeve, e cila kryesisht vjen për shkak të mosnjohjes së situatës dhe moskryerjes së rregullt të procedurave, gjë e cila ndikon negativisht në realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore, duke mos pasqyruar saktë burimin e të ardhurave.

Në këtë kontekst, është e rëndësishme të theksohet për vëmendjen e menaxhimit të lartë të Bashkisë Berat, që në procesin e planifikimit, menaxhimi nuk ka marrë në konsideratë mosrealizimet apo tejkalimet e mëparshme, në mënyrë që planifikimi në të ardhmen të bëhet mbi baza sa më reale, për të mos shkaktuar deficit në të ardhurat e arkëtuara dhe për pasojë mosrealizim të shpenzimeve, investimeve, mirëmbajtjeve, etj, në dëm të interesave të publikut.

Për sa më sipër, përgjegjësia është e z. E. D. me funksion Kryetar i Bashkisë Berat, z. S. T., me funksion Drejtor i Drejtorisë së Taksave Vendore.

Kriteri: Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligji nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 64, “Kompetencat dhe detyrat e kryetarit të Bashkisë”; ligji nr. 68/2017 datë 27.4.2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” i ndryshuar, neni 5, “Parime dhe rregulla të disiplinës fiskale dhe të financimit të funksioneve vendore”, neni 42, “Administrimi i mjeteve monetare”, pika 1, 2 dhe 4; neni 54, “Raportimi financiar” nënpika c, UMFE nr. 9 datë 20.03.2018, Kreu IV “Procedurat standarde për menaxhimin e të ardhurave” pika 200, UMFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kreu III, pika 32, Kreu II pika 2/a, b; Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar, ligji nr. 9920, datë 19/5/2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Ndikimi/Efekti: Mos planifikim i saktë i treguesve në planin e të ardhurave shkakton mangësi dhe probleme në likuidimin e shpenzimeve të kryera nga institucioni, si dhe është shkak kryesor për krijimin e detyrimeve të prapambetura.

Shkaku: Mos njohja e situatës nga strukturat përgjegjëse, neglizhenca dhe mosrespektimi i akteve ligjore e nënligjore në fuqi.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Bashkia Berat, gjatë hartimit të projektit/planit të buxhetit, të planifikojë saktë treguesit e planit të të ardhurave mbi baza reale, të kryejë në mënyrë të saktë kontabilizimin e të ardhurave në llogaritë kontabël dhe të sigurojë rregullsi dhe saktësi në raportimin dhe rakordimin e treguesve të realizimit të të ardhurave, në përputhje me raportimet e Degës së Thesarit sipas akt-rakordimeve të Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit.

➤ Agjentët tatimorë dhe rakordimet mujore me ta:

Titulli gjetjes: Mangësitë e konstatuara në dokumentacionin mbi aktivitetin e Agjentëve Tatimorë.

Situata: Në rregulloren e brendshme të institucionit nuk është përcaktuar personi i cili duhet të ketë për detyrë ndjekjen e arkëtimeve nga agjentët tatimorë dhe mbajtjen e aktrakordimeve me ta.

Të ardhurat nga agjentët tatimorë (Drejtoria Rajonale Tatimore Berat, në lidhje me TFTH; Drejtoria e Përgjithshme të Buxhetit, Drejtoria e Menaxhimit të Buxhetit, pranë Ministrisë së Financave, në lidhje me rentën minerare; AKSH-ja, në lidhje me taksën e ndikimit në infrastrukturë dhe DRSHTRR Berat, në lidhje me taksën vjetore të mjeteve të përdorura) derdhen automatikisht në fund të çdo muaji, për llogari të bashkisë Berat dhe konfirmohen nga Dega e thesarit Berat. Gjithashtu Bashkia Berat, duhet të marrë masa për evidentimin e diferencave të pa mbledhura sipas llojit të taksës/tarifës, të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj dhe të fillojë procedurat për gjëbajtjen e këtyre agjentëve tatimorë me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pa arkëtuara apo të shmangura sipas Nenin 117² të ligjit nr. 9920, dt. 19.5.2008, “Për Procedurat Tatimore”, ku parashikohet se “Dënimet për agjentët e mbajtjes së tatimit në burim, agjentët e taksave dhe agjentët e tarifave”.

Pjesa më e rëndësishme e të ardhurave që vilen me agjentët tatimorë është Ujësjellës-Kanalizime. Është shumë e rëndësishme të theksohet se vjelja e këtyre të ardhurave ka pasur përmirësime pas kontraktimit me Agjentin Tatimor, por ka një shumë të madhe debitorësh, e

² “Agjenti i mbajtjes së tatimit në burim, agjenti i taksave apo tarifave, që nuk arrin të mbajë, të llogarisë, të raportojë dhe të transferojë në Buxhetin e Shtetit tatimin në burim apo tatimet, taksat dhe tarifat e mbledhura, apo i shmangët mbledhjes së tyre, detyrohet të paguajë gjobë të barabartë me 50 për qind të shumës së plotë të tatimit, taksës apo tarifës së pambledhura apo të shmangur.”

cila së pari duhet të përcaktohet nëse është mangësi e planifikimit apo problem në vjelje dhe më pas të vazhdohet me procedurat përkatëse.

Konstatohet se sipas DAV Bashkia Berat, mos arkëtimet nga ana e Drejtoria Rajonale Vendore ASHK Berat, janë për shkak të anashkalimit të arkëtimit të këtyre detyrimeve për taksën e infrastrukturës, për të cilat nga Bashkia Berat është kërkuar vazhdimisht në rrugë zyrtare që të mos i kryejnë veprimet e regjistrimit të pronës nga këto lloj subjektsh, pa paraqitur dokumentin e pagesës së kësaj takse. Për sa më sipër, Bashkia Berat duhet të fillojë procedurat për të gjobitur Agjentin Tatimor ASHK në zbatim të dispozitës së mësipërme.

- Për rentën minerare, e cila rrjedh nga eksportet nuk është bërë rakordimi periodik i rregullt mujor me Drejtorin e Doganave dhe mbahet korrespondencë me Ministrinë e Financave.

- Për rentën e cila rrjedh nga shitjet brenda vendit, mbahet korrespondenca me Ministrinë e Financave dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 7 “Të drejtat dhe detyrimet e agjentit të mbajtjes së tatimit” dhe me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 15 “Parapagimi”, si dhe me UMF nr. 26, datë 04.09.2008 “Për taksat Kombëtare”.

Të ardhurat e vjela nga agjentët tatimorë gjatë periudhës së audituar janë paraqitur **në aneks nr. 3 pika 2.6 bashkëlidhur projekt raportit të auditimit.**

Kriteri: Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 7 “Të drejtat dhe detyrimet e agjentit të mbajtjes së tatimit” dhe me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 15 “Parapagimi”, si dhe me UMF nr. 26, datë 04.09.2008 “Për taksat Kombëtare”.

Ndikimi/Efekti: Mos njohja e situatës, çon në mungesë të ardhura për Bashkinë Berat

Shkaku: Mungesa e bashkëpunimit dhe mos zbatimit të kuadrit ligjorë.

Rëndësia: E Lartë

Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Berat, të marrë masa për evidentimin e diferencave të pa mbledhura nga Agjentët Tatimore, sipas llojit të taksës/tarifës, të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj dhe të fillojë procedurat për penalizmin e Agjentëve Tatimore me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pa mbledhura apo të shmangura.

Të krijojë bazën të dhënave për subjektet, tarifatat apo taksat të cilat mblidhen nga Agjentët Tatimore, të kryqëzojë informacionet me institucionin e tjera përkatëse dhe rakordimet të bëhen në fund të çdo muaji sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministria e Financave.

Titulli gjetjes: *KLSH-ja konstaton se nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Berat, nuk janë ndjekur të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e detyrimeve të pa arkëtuara (borxhi), dhe për të gjithë subjektet.*

Situata: Sipas të dhënave për strukturën organike të Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Berat, konstatohet se nuk ka një të ngritur një strukturë përgjegjëse për menaxhimin e borxhit (debitorëve nga taksat/ tarifatat vendore).

Referuar të dhënave të paraqitura nga kjo drejtori, detyrimet për taksat e tarifatat vendore për subjektet fizik/juridik dhe abonentë familjare paraqitet si vijon:

➤ **Detyrimet e familjarëve:**

Bashkia Berat ka lidhur kontratë me Ndërmarrjen e Ujësjellës Kanalizimeve Berat për vjeljen e detyrimeve të familjarëve mbi bazën e kontratave të ujit të pijshëm që abonentët familjarë kanë, evidentimit dhe regjistrimit të abonentëve të rinj duke plotësuar regjistrin e taksapaguesve familjarë, gjë e cila ka shkaktuar edhe mangësitë e mëdha dhe një numër të lartë debitorësh në lidhje me këto detyrime.

- Njoftimet e bëra për familjarët, masat e mara dhe masat shtrënguese

Shërbimi për familjet ofrohet në Zyrën me një ndalesë për qytetin dhe në Njësitë Administrative nga specialisti i ngarkuar për taksat dhe tarifave vendore.

Paketa Fiskale e bashkisë publikohet në faqen zyrtare të saj, ku të gjithë personat e interesuar mund të marrin informacion të gjerë në lidhje me taksat dhe tarifave vendore, nivelin e tyre, afatet e pagesave, përjashtimet përkatëse etj.

Shpërndarja e faturave dhe njoftimi i familjeve për detyrimet vendore, kryesisht është bërë nga specialistët e taksave si në mënyrë verbale ashtu dhe shkresore.

Për shërbimet që qytetarët kërkojnë të kryejnë në bashki, zakonisht kërkohet dokumentimi i shlyerjes së detyrimeve, nëpërmjet librezës së taksave vendore, me synim ndërgjegjësimin e tyre për pagesën e taksave dhe tarifave vendore në mënyrë vullnetare. Sa më sipër është e vetmja masë shtrënguese e aplikuar për vjeljen e detyrimeve të papaguara nga popullata.

Rezulton se më datën 31.12.2021 për mos pagesën e detyrimeve tatimore janë debitorë për abonentët familjar në vlerën **132,259,090 lekë, vlerë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Berat, nga mos arkëtimi i taksës dhe tarifave nga debitorët familjar deri në datën 31.12.2021.** veprime dhe mosveprime bien në kundërshtim me ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Kreut XI- “Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara”, të neneve 88 deri 104, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore”, të ndryshuar. Në mënyrë të përmbledhur debitorët familjar paraqiten në aneksin 4 dhe 5 pika 2.6 bashkëlidhur projekt raportit të auditimit.

➤ Taksa e tokës:

Nga ku rezulton se sipërfaqja gjithsej e tokës së ndarë sipas fshatrave dhe familjeve është 11,534 ha e ndarë sipas kategorive. Për këtë sasi toke të ndarë, referuar boniteti të tokës sipas fshatrave dhe çmimit për bonitet të miratuara në paketat fiskale me VKB nr. 60 datë 18.12.2019 planifikim i kësaj takse për një vit ushtrimorë duhej të ishte në vlerën **19,350 mijë lekë**, por në fakt nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Berat është planifikuar një vlerë prej **18,600 mijë lekë** ose më pak për shumën **750 mijë lekë** dhe për dy vite objekt auditivi në **shumën 1,500 mijë lekë**, një e ardhur munguar në buxhetin e Bashkisë Berat. Në mënyrë të detajuar pritshmëria e taksës së tokës bujqësore për vitet 2019 – 2021 paraqiten në aneksin nr. 6 pika 2.6 bashkëlidhur projekt raportit të auditimit.

Konstatohet se sipas ligjit 7501 “Për tokën”, janë trajtuar me tokë bujqësore gjithsej 9481 familje dhe 12,128 hektarë. Mesatarisht, për të gjithë periudhën objekt auditimi, taksa e tokës është arkëtuar rreth 65 %. Nga 12,128 familje të trajtuara me tokë bujqësore, 8,300 familje në vlerën debitorë **62,722,750 lekë vlerë e cila konsiderohet e ardhur e munguara për buxhetin e Bashkisë Berat.** Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me nenin 20, 21 dhe 22 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar.

➤ Bizneset, regjistrimi dhe mbajtja e të dhënave:

Administrimi i taksave vendore bëhet me program, ku janë të pasqyruara regjistrat, sipas aktiviteteve, njoftim detyrimet dhe pagesat, kjo si për subjektet fizik/juridik dhe abonentët familjarë. Nga të dhënat që kërkohen për auditim, konstatohet që programi është i saktë, pasi në informacionet që kërkohen të dhënat dalin të analizuar për çdo zë tatimor që Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Berat aplikon. Pasqyrimi i të dhënave fillon me çelje si debitor. Kamatëvonesat rigjenerohen nga sistemi në fund të çdo periudhe.

Referuar të dhënave të marra nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Berat, situata e lëvizjes së subjekteve paraqitet si më poshtë:

Biznesi	Gjendja në fillim			Regjistrime të reja			Mbyllur gjatë vitit			Gjendja në fund		
	2019	2020	2021	2019	2020	2021	2019	2020	2021	2019	2020	2021
I vogël/ madh	2324	2182	2,229	207	178	183	191	171	166	16	7	17
Ambulant	44	35	35									
OJF		16	19									

Institucione	43	43	43									
Totali	2411	2276	2326	207	178	183	191	171	166	16	7	17

Burimi: *Bashkia Berat*

➤ **Menaxhimi i borxhit nga taksat e tarifave vendore.**

Rezultoni se më datën 31.12.2021 për mos pagesën e detyrimeve tatimore janë debitorë subjektet e biznesit të vogël, biznesit të madh dhe subjekte shtetërore në vlerën **104,298,029 lekë, vlerë e cila konsiderohet e ardhur e munguara për buxhetin e Bashkisë Berat. Konstatohet se** struktura tatimore të Bashkisë Berat, për asnjë nga subjektet, ku megjithëse janë debitorë në vite dhe vlera të konsiderueshme, janë njoftuar dhe ri njoftuar për pagesën e detyrimeve si dhe janë nisur urdhër bllokimit e llogarive, por në asnjë rast nuk është kërkuar **kallëzim penal** bazuar në nenin 181, “Mos pagimi i taksave dhe tatimeve”, të Kodit Penal të RSH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 me ndryshime, ku përcaktohet se:

“Mospagimi i taksave dhe tatimeve brenda afatit të caktuar, me gjithë mundësinë e pagimit të tyre, nga personi ndaj të cilit janë marrë më parë masa administrative për këtë qëllim, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.”

Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar neni 9 “Të drejtat dhe përgjegjësitë” pika 1.3., ku përcaktohet se:

“1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë këto të drejta dhe përgjegjësi: 1.3. Të drejtën dhe përgjegjësinë e mbledhjes së të ardhurave dhe bërjes së shpenzimeve, sipas së cilës: a) krijojnë, mbledhin të ardhura dhe bëjnë shpenzime për përmbushjen e funksioneve të tyre; b) vendosin taksa vendore e tarifa për shërbimet, si dhe nivelin e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi; c) hartojnë, miratojnë dhe zbatojnë buxhetin e tyre; ç) mbajnë llogaritë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe ofrojnë informacione ose raporte financiare për hartimin dhe zbatimin e buxhetit për qeverisjen qendrore ose shtetasit.”

Neni 35, “Të ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta vendore”, me ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, si dhe me ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 “Për sistemin e taksave vendore”, Kreu II, Kreu IV, Kreu V, Kreu VII, etj. Në mënyrë të përmbledhur debitorët e subjekteve fizikë dhe juridike paraqiten në aneksin 7 pika 2.6 bashkëlidhur projekt raportit të auditimit.

Kriteri: Pikat 3,4, 5 dhe 5, të nenin 45 – “Çregjistrimi i subjekteve tatimore” dhe Kreun XI-Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshimet dhe Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshime; ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, me ndryshimet e mëvonshme, neni 181 -Mospagimi i taksave dhe tatimeve³.

Ndikimi/Efekti: Mos ndjekja e plotë e procedura për arkëtimin e detyrimeve, rrit nivelin e detyrimeve të paarkëtuara në fund të periudhave ushtrimore, si një e ardhur e munguar në buxhetin e bashkisë, ku në fund të vitit 2021 ka një vlerë afërsisht sa plani vjetore i të ardhurave të Bashkisë Berat.

Shkaku: Mos njohja dhe mos zbatimi i kuadrit ligjorë në fuqi, si dhe mungesa e një strukturë organizative të përshtatshme.

Rëndësia: i lartë

Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Berat, bazuar në nenin 70 pika 3 “E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimor për debitorët duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për

³ Mospagimi i taksave dhe tatimeve brenda afatit të caktuar, megjithëse mundësinë e pagimit të tyre, nga personi ndaj të cilit janë marrë më parë masa administrative për këtë qëllim, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.

taksat dhe tarifate vendore në vlerën **236,557 mijë lekë**, duke ndjekur procedurat si më poshtë vijon:

- a- Tu dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhrat e bllokimit të llogarive bankare.
- b- Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në AKSH (për pasuritë e paluajtshme).
- c- Në rast se bizneset private edhe pas njoftimeve zyrtare dhe dërgimit të urdhër bllokimeve në bankë nuk kryejnë pagesën e detyrimeve, pasi të merren masat administrative apo sekuestro, të bëhet kallëzim penal, bazuar në Kodin Penal të RSH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 me ndryshimet e mëvonshme, neni 181 “Mospagimi i taksave dhe tatimeve”.
- d- Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Berat, në bashkëpunim me Njësitë Administrative, të evidentojë listat emërore të debitorëve familjarë në mënyrë elektronike, duke të njoftojë nëpërmjet postës (dhe jo vetëm) familjet të cilët nuk kanë paguar detyrimet për taksën e tokës/ tarifën e pastrimit, ndriçimit, banesave dhe gjelbërimit.
- Të bashkëpunimet me QKB për mos lejimin e mbylljes së aktivitetit ose kalimi në pasiv të subjekteve me detyrime të paarkëtuara, të cilat kanë premisë për kalimin në debitorë pa shpresë arkëtimi, si dhe të kryhen kontrole të vazhdueshme në bashkëpunim dhe me Policinë Bashkiake për evidentimin dhe vjeljen e detyrimeve debitorë.

➤ **Të ardhurat dhe vlerat debitorë nga taksa e ndikimit në infrastrukturë:**

Titulli gjetjes: *KLSH konstatoj se Drejtoria e Planifikim Urban në bashkëpunim me Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Berat në lidhje me legalizimet dhe pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, nuk ka bërë të mundur arkëtimin e detyrimeve në vlerën **30,119,316 lekë**, shumë e cila përben të ardhur të munguar për Bashkinë.*

Situata: Nga auditimi i dokumentacionit që disponon Drejtoria e PZHU, Bashkia Berat në lidhje me legalizimet e ndërtimeve pa leje dhe listave që disponon për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, konstatohet se nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNIT Berat janë dërguar zyrtarisht me shkresë lista e qytetarëve shoqëruar me leje legalizimi dhe destinuar për regjistrim në ZVRPP (ASHK) Berat.

Konkretisht për periudhën nga 01.01.2017 deri më 31.12.2021, sipas listave të vëna në dispozicion me leje legalizimi dhe kryqëzimi i tyre me personat që kanë bërë të mundur likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturës, rezulton se detyrimi për këtë taksë është në vlerën **43,115,950 lekë** për 1291 persona, kanë paguar detyrimet 381 persona me vlerë **12,996,634 lekë** dhe kanë mbetur për likuidim deri datë 31.12.2021 gjithsej **910** persona me vlerë **30,119,316 lekë**, e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Berat (*sipas listës të administruar në CD*).

Natyra e debitorëve	Detyrime gjithsej 2016-2021		Arkëtuar deri 31.12.2021		Debitorë me 31.12.2021	
	Pers on	Lekë	Per son	Lekë	Person	Lekë
Taksa infrastrukture (legalizim)	1291	43,115,950	381	12,996,634	910	30,119,316

Nga dokumentacioni i paraqitur konstatohet se Bashkia Berat nuk ka të evedentuar subjektet të cilat janë pajisur me leje legalizimi nga aluizni përpara vitit 2017 si dhe nuk u evidentuan raste që Bashkia Berat jetë drejtuar ASHK Dega Berat, për bllokimin e pasurisë dhe mos kryerjen veprimeve hipotekore ose bllokimin e marrjes së lejes së legalizimit dhe certifikatës pa bërë më parë pagesën taksës së ndikimit në infrastrukturë. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me nenin 27 pika (d), të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje,,,”; VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për

përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim” i ndryshuar, pika 5 dhe ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave vendore”, i ndryshuar, neni 27- *Taksa e ndikimit në infrastrukturë*, pika 2/1.

Kriteri: Me nenin 27 pika (d), të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje,,,”; VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim” i ndryshuar, pika 5 dhe ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave vendore”, i ndryshuar, neni 27- *Taksa e ndikimit në infrastrukturë*, pika 2/1.

Ndikimi/Efekti: Mos arkëtimi i detyrimeve taksës së ndikimit në infrastrukturës nga ndërtimet pa leje, ka çuar në mungesë të ardhurash në vlerën **30,119,316 lekë**, për buxhetin e Bashkisë

Shkaku: Mos kryerja e akt-rakordimeve midis Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Berat dhe ASHK Rajonale Berat, për ndjekjen e procedurave ligjore për arkëtimin e detyrimeve.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Drejtoria e Planifikim Urban në bashkëpunim me Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet pa leje në vlerën **30,119,316 lekë** ndaj **910** personave.

- Drejtoria e Planifikim Urban në bashkëpunim me Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, për personat të cilat nuk kanë kryer pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet pa leja, t’i kërkojnë Drejtorisë Rajonale Vendore ASHK Berat vendosjen e urdhër kufizimit mbi pasurinë, deri në pagesës e taksës së ndikimit në infrastrukturë.

➤ **Pajisja me autorizime e subjekteve që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre:**

Sipas dokumentacionit të venë në dispozicion nga Drejtoria e Shërbimeve dhe e licencave, rezulton se në territorin e Bashkisë Berat dhe në Njësitë Administrative në vartësi Otlak, Velabisht, Sinjë dhe Roshnik, ushtrojnë aktivitetin 23 subjekte të cilat tregtojnë me pakicë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre dhe 1 subjekt që tregton me shumicë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre. *Në mënyrë të detajuar paraqiten në aneksin nr. 6 pika 2.6 bashkëlidhur projekt raportit të auditimit.*

Titulli gjetjes: *Lejimi i subjekteve që tregtojnë hidrokarbure me Licencë të bashkisë dhe papaguar tarifën në zbatim të VKM nr. 344, datë 19.04.2017.*

Situata: Nga auditimi i dokumentacionit mbi pasjen me Liçensë tregtimi për subjektet që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre, u konstatua se ka mangësi në plotësimin e të dhënave të këtyre subjekteve në përgjithësi dhe debitorëve në veçanti, si mos aplikimin e tarifës së licencës dhe lejimin e subjekteve të ushtrojnë aktivitet pa paguar këtë taksë dhe mos ndjekjen e detyrimeve për subjektet të cilat janë pajisur dhe nuk e kanë paguar tarifën.

Sipas dokumentacionit të venë në dispozicion nga Drejtoria e Shërbimeve dhe e Licencave, rezulton se në territorin e Bashkisë Berat dhe në Njësitë Administrative në vartësi Otlak, Velabisht, Sinjë dhe Roshnik, ushtrojnë aktivitetin 23 subjekte të cilat tregtojnë me pakicë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre dhe 1 subjekt që tregton me shumicë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre.

Nga 23 subjekte janë pajisur me autorizim 10 subjekte, nga të cilat 2 subjekte janë përpara periudhës objekt auditimi si dhe janë pajisur me licenca/autorizime të reja subjekti 8 subjekte të cilat tregtojnë me pakicë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre, kanë mbyllur aktivitetin e

tyre 3 subjektet të cilat nuk ushtrojnë më aktivitetin në tregtimin me pakicë të hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre si dhe nuk janë licensure me leje tregtim karburanti, gjithsej **10 subjekte** të cilët ushtrojnë aktivitet dhe papaguar detyrimin fiskal në vlerën **8,950,000 lekë** e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Berat si dhe **në dy raste janë nënshkruar akt marrëveshje me subjektet** për pagimin me këste të detyrimeve. *Në mënyrë të detajuar paraqiten në aneksin nr. 8 pika 2.6 bashkëlidhur projekt raportit të auditimit.*

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:

1) Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar neni 35.
2) VKM nr. 170, datë 25.4.2002 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, kapitulli II dhe kapitulli III, pika 4.

3) VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar kapitulli II, pika 1; germa “b”, dhe pika 9, ndryshuar me VKM nr. 344, datë 19.04.2017, kapitulli II, pika 1; germa “b” dhe pika 9 dhe 15 ku citohet:

15.1 Në përputhje me legjislacionin në fuqi, organi që ka për detyrë të japë licencën informon, menjëherë, inspektoratin shtetëror përgjegjës dhe bashkëpunon me të për marrjen e masave të bllokimit të veprimtarisë së subjekteve që ushtrojnë, pa licencë, aktivitetin e tregtimit me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse, për përdorim nga konsumatorët fundorë dhe ngarkohen me përgjegjësi grupi i punës sipas Urdhrit nr. 08 datë 13.01.2020 “Për zbatimin e procedurës për dhënien e licencave për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse”, ndryshuar me Urdhrin nr. 188 datë 26.03.2021 dhe Urdhrin nr. 328 datë 15.06.2021, z. L. B. me pozicion Zv/kryetar i Bashkisë për periudhën 13.01.2020 e në vijim, z. S. T., me pozicion Drejtore i Drejtorisë së Taksave Vendore për periudhën 13.01.2020 e në vijim, znj. M. S. me pozicion e përgjegjëses së Sektorit të Menaxhimit të Pronave dhe Strehimit për periudhën 13.01.2020 deri më 15.06.2021, znj. D. S. me pozicion Specialiste e Menaxhimit dhe Mjedisit për periudhën 13.01.2020-15.06.2021, znj. E. T. me pozicion Specialiste në Drejtorin Juridike për periudhën 13.01.2020 e në vijim, z. E. K. me pozicion Drejtor i Emergjencave, Pronave, Transportit dhe Shërbimeve për periudhën 26.03.2021 e në vijim.

Kriteri: Në kundërshtim me nenin 35 të ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar, kapitulli II dhe kapitulli III, pika 4. e VKM nr. 170, datë 25.4.2002 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar si dhe kapitulli II, pika 1; germa “b”, dhe pika 9, ndryshuar me VKM nr. 344, datë 19.04.2017, kapitulli II, pika 1; germa “b” dhe pika 9 dhe 15 të VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar.

Ndikimi/Efekti: Mos ndjekja e procedurës për dhënien e Liçensë së tregtimit të karburanteve, çon në mungesë të ardhura për Bashkinë Berat me vlerë **8,950,000 lekë**.

Shkaku: Mungesa e bashkëpunimit dhe mos ndjekja e të gjitha rrugëve administrative e ligjore për mos lejimin e ushtrimit të aktivitet pa dokumentacion të rregullt.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Drejtoria e Shërbimeve dhe e Licencave në bashkëpunim me Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore dhe Policinë Bashkiake, Bashkia Berat, të ndjekë të gjitha rrugët administrative e ligjore për pajisen me liçensa të subjekteve që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre dhe arkëtimin e tarifës së pataksuar prej **8,950,000 lekë** ndajë **10 subjekteve**, sipas pasqyrës Aneks nr. 8 pika 2.6 bashkëlidhur projekt raportit të auditimit.

➤ ***Të ardhurat dhe vlerat debitore nga veprimtaritë e ndryshme dhe përdorimi i aseteve të Bashkisë Berat:***

Titulli i gjetjes: Të ardhura të munguara nga dhënia me qira e aseteve të Bashkisë, si troje, toka bujqësore.

Situata: Nga auditimi në lidhje me arkëtimin e të ardhurave nga dhënia me qira të ambienteve për periudhën 01.10.2019 deri me 31.12.2021, u konstatua se Bashkia Berat nuk ka lidhur kontrata të reja me subjektet po ka vazhduar me kontratat e mëparshme duke i rinovuar afatin sipas kontratave fillestare. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se bashkia procesi i administrimit dhe mbledhje së të ardhurave nga kontratat e qirave administrohet nga *Spektori i Menaxhimit të pronave dhe Strehimit i cili* administron 13 kontrata në vlerë 7,768,546 lekë në vite, nuk kanë shlyer detyrimet e kontratës, 3 subjekte **në vlerën gjithsej 379,893 lekë me pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e njësisë vendore veprime në papajtueshmëri me nenin 12, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar dhe kushtet e kontratave të lidhura, VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfitëozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”; etj.**

Në mënyrë të detajuar paraqitet në aneksin nr. 9 pika 2.6 bashkëlidhur projekt raportit të auditimit

Kriteri: Ligji nr. 7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar; Ligji nr. 48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”; VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfitëozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”; etj.

Ndikimi/Efekti: Ndikim negativ në buxhetin e Bashkisë Berat në vlerën **379,893 lekë** (pa llogaritur kamatëvonesat).

Shkaku: Mosndjekja e procedurave nga strukturat përgjegjëse. Mangësi në përcaktimin specifik të detyrave dhe mungesë e personelit përgjegjës.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Bashkia Berat të marrë masa për të llogaritur detyrimin total të papaguar (duke llogaritur kamatëvonesat) dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej **379,893 lekë**, duke llogaritur dhe shtuar vlerën e kamatëvonesave për të gjitha rastet e detyrimeve të pa arkëtuara në afat, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit ndaj debitorëve. **(Për problemet e mësipërme është mbajtur akt-konstatimin nr. 11, datë 15.04.2022)**

3. Vlerësimi i raportimit financiar

Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin nëse pasqyrat financiare për vitin 2021, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.

➤ ***Baza ligjore për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e pasqyrave financiare është:***

Për vitin 2020 dhe 2021 nga njësia shpenzuese “**Bashkia Berat**” për hartimin e pasqyrave financiare dhe përgatitjen e llogarive vjetore është mbështetur në Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme, i ndryshuar. Lidhur me operacionet buxhetore, është rakorduar dhe konfirmuar nga Dega e Thesarit Berat si dhe nuk ka patur në asnjë rast kontestime.

➤ ***Rakordimi i pasqyrave financiare me thesarin dhe bankat e nivelit të dytë si dhe me treguesit e realizimit të buxhetit.***

Për vitin 2020 dhe 2021 nga verifikimi për çdo muaj i ditarit kontabël të bankës sipas natyrës për shpenzimet e klasës 6 dhe klasës 2 me akt rakordimin e thesarit mbi bazë ekstrate banke (dokumenti i nxjerrjes së llogarisë nga thesari për çdo muaj) për shumat për çdo llogari dhe në total mujor e vjetor rezultoi se nuk ka diferenca. Për këtë janë përdorur ditari i bankës i mbajtur sipas natyrës për autorizimet buxhetore (çeljet) dhe përdorimi fondeve sipas llojit të shpenzimeve.

Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikues si dhe sigurimi i informacionit kontabël, përgatitjen e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit.

➤ ***Pohimet e testeve të kryera rreth mbajtjes së kontabilitetit të Aparatit Bashkisë***

Si rezultat i testeve të kryera pohojmë se:

- Kontabiliteti është mbajtur i plotë për të gjitha veprimet kontabël të rezultuara nga kryerja e veprimeve ekonomike, mbi bazën e dokumentacionit bazë dhe justifikues.
- Në këtë bashki, kontabiliteti është organizuar dhe mbahet në mënyrë informatike në program “*Excel*”
- Janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore për kontabilitetin.
- Azhurnimet e veprimeve ekonomike janë në mënyrë kronologjike dhe kontabilizimet e tyre janë kryer në ditarët e bankës, të arkës, magazinës, të pagave etj por nuk janë mbajtur partitarët për llogaritë kreditore e debitorë. Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentat vërtetuese.
- Në tërësi organizimi i mbajtjes së kontabilitetit ka mundur nxjerrjen e gjendjeve të llogarive sipas klasave, nisur nga dokumentet bazë justifikuese, të cilat janë të dhëna bazë të hyra në kontabilitet.
- Plotësimi i dokumenteve bazë e justifikues është bërë në mënyrë të plotë, pasi përshkruajnë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin me të dhënat të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Kështu; dokumentat vërtetues si Urdhër-shpenzimi, fletë hyrjedaljet, mandat arkëtimet e pagesat, janë të hartuara me të gjitha elementet që kërkon formati i miratuar. Këto dokumente shoqërohen nga dokumente autorizues si kërkesat për financim për veprimet ekonomike të kryera nga drejtoritë përkatëse të miratuar sipas shkallës së hierarkisë, detyrave e përgjegjësisive, duke argumentuar shkakun e veprimit të shoqëruar me urdhrat apo vendimet e organeve drejtuese, kontratat, dokumentat kryesore të procedurave të prokurimit, akt-marrëveshjet etj. Bashkëlidhur këtij dokumentacioni janë dokumentat vërtetues të shpenzimit si faturat, listpagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet, shkresat etj.
- Informacioni kontabël është përgatitur mbi bazën e një kontabiliteti të quajtur të angazhimeve (ose në bazë të të drejtave të konstatuara), duke dhënë elementet e nevojshme për të vlerësuar gjendjen pasurore, gjendjen financiare dhe rezultatet e njësisë ekonomike.

➤ ***Baza e dhënies së opinionit së Raportimit Financiar. Pohimet mbi saktësinë e paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare.***

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, u analizuan treguesit e pasqyrave financiare të Bashkisë për aktivitetin ekonomik - financiar për vitin 2020 dhe vitin 2021.

Pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim

Përkatësia: Transaksionet dhe ngjarjet që janë të regjistruara kanë ndodhur dhe i përkasin subjektit.

Plotësia: Të gjitha transaksionet dhe ngjarjet që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar, përveç rastit të kontratave të investimeve në vlerë të plotë dhe vlerës së faturave të palikujduara për investime në fund të vitit ushtrimor 2020 dhe 2021.

Saktësia: Shumat dhe të dhëna të tjera lidhur me transaksionet e regjistruara dhe ngjarjet janë regjistruar në mënyrë të përshtatshme

Periudha: Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në periudhën e saktë kontabël, përveç disa rasteve të shpenzimeve të kryera për investime, të cilat janë regjistruar në momentin e çeljes së fondeve dhe mbërritjes së faturës.

Klasifikimi: Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në llogaritë e duhura.

Ligjshmëria dhe rregullsia: Janë në përputhje me ndarjet buxhetore në dispozicion

Pohimet rreth gjendjeve të llogarive në fund të periudhës

Ekzistenca: Asetet, detyrimet dhe fondet e veta ekzistojnë

Të drejtat dhe detyrimet: Subjekti mban ose kontrollon të drejtat për asetet, detyrimet dhe janë obligimet e subjektit.

Plotësia: Të gjitha asetet dhe fondet e veta janë regjistruar dhe të analizuar përsa i përket aseteve e ish-Komunave. Ndërsa detyrimet janë regjistruar të gjitha në mbyllje të vitit ushtrimor, pra janë të paraqitura të plota në bilanc.

Pohimet rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese

Transaksionet, të drejtat dhe detyrimet: Ngjarjet e shpalosura, transaksionet, si dhe çështje të tjera që kanë ndodhur i përkasin subjektit.

Plotësia: Të gjitha informacionet shpjeguese që duhet të ishin përfshirë në pasqyrat financiare janë përfshirë.

Klasifikimi dhe kuptueshmëria: Informacioni financiar është paraqitur në mënyrë të përshtatshme dhe të përskruara, ndërsa mungojnë shënimet që të shprehin paqartësitë e ndodhura .

Saktësia dhe vlerësimi: Informacioni financiar dhe të tjera në përgjithësi është dhënë në mënyrë të drejtë dhe në sasinë e duhur.

Pasqyrat financiare janë përgatitur nga Drejtoria Financës. **Gjatë fazës së ekzekutimit në terren, u kryen teste të detajeve dhe teste thelbësore, nga ku u konstatua se, janë mbartur saktë tepricat e llogarive dhe se tepricat në çelje për vitin 2021 rakordojnë me tepricat në mbyllje të vitit 2020.**

Nga verifikimi i gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2020-2021 rezulton se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kundrojnë me formatet anekse pjese e PF, si dhe llogaritë sintetike kundrojnë me ato analitike;

Totali i Aktivit për vitin 2021 është **1,366,998,293 lekë** dhe për vitin 2020 është **1,136,964,885 lekë**, i paraqitur në formatin 1 dhe i zbërthyer në llogari, sipas **Aneksit nr. 1 pika 3** bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

Në lidhje me verifikimin e vlerave të pasqyruara në llogaritë e pasqyrave të pozicionit financiar të vitit ushtrimor 2020 dhe të vitit 2021, të saktësisë dhe besueshmërisë së tyre, u audituan referencat e llogarive të aktivit dhe të pasivit, si në vijim.

A.Aktivitet.

I. Rubrika, aktivet afat shkurtra.

1.Nënrubrika, mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre, gjendja e llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” me 31.12.2020 paraqitet në vlerën **198,377,476 lekë** dhe në më 31.12.2021, paraqitet në vlerën **229,144,408 lekë**, e cila përfaqësojnë vlerën e fondeve që trashëgohen në vitin e ardhshëm. Referuar aktit të rakordimit me Degën e Thesarit Berat, kjo llogari është **për vlerën 145,005,643 lekë, përsa i përket llogarisë 85** ”Rezultati i veprimtarisë së ushtrimit” **dhe llogaria 466** “Kreditorë për mjete në ruajtje” është në vlerën **84,301,285 lekë**.

Kjo vlerë sipas aktit të rakordimit me Degën e Thesarit, është e analizuar si vijon:

Nr.	Llogaria	2020	2021
1	Llogaria 520 "Disponibilitete në thesar"	198,377,476	66,492,289
2	Llogaria 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje"	75,173,217	84,301,285
3	Llogaria 85 "Rezultati i veprimtarisë së ushtrimit"	123,204,259	144,869,683

Referuar aktit të rakordimit me Degën e Thesarit Berat, për vitin 2020 është në vlerën 123,204,259 lekë dhe për vitin 2021 është në vlerën 144,869,683 **lekë**, e analizuar si më poshtë:

Nr	Përshkrimi i Operacioneve	Viti 2020	Viti 2021
1	Transfertat Specifike (Kap. 1)	47,244,788	67,507,911
2	Granti i pakushtëzuar (Kap. 1)	27,742,343	8,291,068
3	Të ardhurat të realizuara [Pjesm Insti] (Kap. 5)	45,831,677	58,426,380
A	Shuma [Kapitull 1+5]	120,818,809	134,225,359
1	Sponsorizime (Kap 6)	2,385,449	10,644,323
B	Total [Kapitull 1+5+6]	123,204,259	144,869,683

Nga auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2020 dhe 2021 rezultoi se llogaria 520 "Disponibilitete në Thesar" ka si kundër parti llogarit 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje" dhe llogarinë 85 "Rezultati i veprimtarisë së ushtrimit" duke i zbritur "Ndryshimin e gjendjes së inventarit". Nga analiza e formatit nr. 2 të pasqyrave financiare rezultoi se llogaria 85 "Rezultati i veprimtarisë së ushtrimit" është në vlerën **138,588,335 lekë, e kuadruar me të dhënat** e Degës së Thesarit në përputhje me UMF nr. 8, datë 9.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar.

2.Nënrubrika, gjendje e inventarit qarkullues, gjendja e llogarisë 31 "Materiale", në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2020 paraqitet në vlerën 3,675,692 lekë, ndërsa në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2021 paraqitet në vlerën 2,947,549 lekë. Vlerat e kësaj llogarie janë të barabarta me vlerën e dokumentuar në aktin e rakordimit në fund të çdo viti të mbajtur midis magazinierit, përgjegjësit të financës dhe drejtorit të financës.

-Gjendja e llogarisë **32 "Inventar i imët"** në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2020 paraqitet në vlerën 14,387,301 lekë, ndërsa në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2021 paraqitet në vlerën 15,277,964 lekë. Vlerat e kësaj llogarie janë të barabarta me vlerën e dokumentuar në aktin e rakordimit në fund të çdo viti të mbajtur midis magazinierit, përgjegjësit të financës dhe drejtorit të financës.

3.Nënrubrika, llogaritja të arkëtueshme, gjendja e llogarisë 423, 429 "Personeli, paradhënie, deficite, gjoba" në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2020 paraqitet në vlerën 1,486,771 lekë, ndërsa në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2021 paraqitet në vlerën 0 lekë. Referuar ditarit të veprimeve të ndryshme rezultonte vlera prej 1,486,771 lekë është kredituar llogaria 423, 429 "Personeli, paradhënie, deficite, gjoba" dhe është debituar llogaria 468 "Debitorë të ndryshëm" Në këtë llogari janë pasqyruar gjoba të ndryshme, nuk ka patur ndryshime midis dy viteve.

-Gjendja e llogarisë **468 "Debitorë të ndryshëm"** në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2020 paraqitet në vlerën 337,303,321 lekë, ndërsa në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2021 paraqitet në vlerën 365,251,315 lekë, të cilat janë detyrimet e subjekteve të ndryshme ndaj bashkisë për taksa, tarifa vendore dhe detyrime të lëna nga aktet e kontrolleve të ndryshme të papaguara deri në 31.12.2021. Në mënyrë të përmbledhur është e analizuar sipas aneksit nr. 2 pika 3 bashkëlidhur projekt raportit të auditimit.

Titulli gjetjes: Mos zbatim i kuadrit të përgjithshëm të përgatitjes së pasqyrave financiare i llogarisë **468 "Debitorë të ndryshëm"**

Situata:

Llogarinë **468 “Debitorë të ndryshëm”** të pasqyrave të pozicionit financiar të vitit 2021, paraqitet në vlerën **365,251,315 lekë**, e cilat përfaqësojnë detyrimet e të tretëve ndaj Bashkisë.

Nga analiza e kësaj llogarie konstatohet se vlera prej **62,019,852 lekë**, e trashëguar nga vitet e mëparshme, nuk është e analizuar me dokumentacion në mënyrë analitike, me pretendimin se është e trashëguar nga ish Komunat qysh nga vitit 2015, kohë në të cilën u krye zbatimi i reformës administrative e territoriale, ku ish Komunat u përthithën nga Bashkia Berat, me të drejtat dhe detyrimet e tyre. Nga Drejtoria e Financës nuk janë marrë masa për gjetjen e origjinës dhe arkëtimin e kësaj vlere. Veprimi dhe mosveprimi është në kundërshtim me UMFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, kapitulli II, pika 6. “Pika 6. Njësitë e qeverisjes së përgjithshme mbajnë kontabilitetin e tyre mbështetur në dokumentet kontabël bazë dhe justifikues, të cilët dallohen në:

- *Dokumente bazë justifikuese (faturë blerje/ shitjeje, fletëhyrje/dalje, mandatarkëtim/pagesë), të prodhuara manualisht ose nëpërmjet programeve informatike dhe shërbejnë për kryerjen e regjistrimeve fillestare të çdo ngjarjeje dhe veprimi ekonomik në librat e kontabilitetit.*

- *Urdhër shpenzimi/urdhërpagesa që përdoren në marrëdhëniet e njësive të qeverisjes së përgjithshme me degën përkatëse të thesarit, për paraqitjen e kërkesave për kryerjen e një shpenzimi apo ekzekutimin e një pagese, nëpërmjet Sistemit Informatik Financiar të Qeverisë (SIFQ).*

- *Libra kontabiliteti, ditarë kontabiliteti, si dhe pasqyra financiare, që janë mbartës ose përmbledhës të regjistrimeve të kryera në kontabilitet.*

- *Dokumente të tjera kontabiliteti, ku përfshihet çdo mbartës tjetër i informacionit kontabël dhe që nuk klasifikohet në asnjë nga grupet e mësipërme”. Me hollësisht trajtuar në aneksin nr.3 pika 3 bashkëlidhur projekt raportit të auditimit.*

Kriteri:Kapitulli II, pika 6.UMFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar

Ndikimi/Efekti:Mbajtja e kontabilitetit pa u mbështetur në dokumenta justifikues.

Shkaku:Mos zbatim i kuadrit të përgjithshëm të përgatitjes së pasqyrave financiare

Rëndësia: E mesme

Rekomandimi:Drejtoria e Financës, të marrë masa për sistemimin e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” për evidentimin dhe dokumentimin në mënyrë analitike për diferencën në vlerën **62,019,852 lekë**, sipas aneksin nr.3 pika 3 bashkëlidhur projekt raportit të auditimit.

-Gjendja e llogarisë **4342 “Operacione me shtetin, të drejta”** (debitorë) më 31.12.2020 paraqitet në vlerën 41,350,918 lekë, më 31.12.2021 paraqitet në vlerën 26,509,146 lekë.

Nga analiza e llogarisë **4342 “Operacione me shtetin, të drejta”** për vitin 2020 dhe 2021 është e analizuar si vijon:

NR.	EMERTIMI	Gjendje 31.12.2020	Gjendje 31.12.2021
1	Paga Personeli llogaria42	9,257,179	8,971,593
2	Tatim page tatim ne burim llogaria 431	862,160	948,905
3	Sigurimet Shoqërore llogaria 435	2,769,158	2,815,711
4	Sigurime Shëndetësore llogaria 436	372,228	376,541
5	Furnitorëllogaria.401-408	908,232	6,768,151
6	Kreditore të ndryshëm llogaria. 467	27,181,961	6,628,245
	TOTALI	41,350,918	26,509,146

Nuk rezulton diferencë midis vlerës pasqyruar në llogarinë **4342 “Operacione me shtetin, të drejta” dhe vlerës të pasqyruara në 6 (gjashtë) llogarive pasive**, pra në vitin 2020 dhe 2021 është, e njëjtë me vlerën e pasqyruar në aktivin e pasqyrave të pozicionit financiar.

4.Nënrubrika, të tjera aktive afatshkurtra, gjendja e llogarisë **486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”**, më 31.12.2020 paraqitet në vlerën 113,627,868 lekë, kurse më 31.12.2021 paraqitet në vlerën 157,160,681 lekë, të cilat përfaqësojnë detyrimet e prapambetura të pa likuiduara ndaj të tretëve është bërë në *përputhje me UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kap. III, pika 42 dhe Aneksi –1, Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publike*, e analizuar sipas aneksit nr. 4 pika 3 bashkëlidhur projekt raportit.

Titulli gjetjes: *Për vitin ushtrimore 2021 llogaria 202 “Studime dhe Kërkime” paraqitet në vlerën 52,591,859 lekë, që i përket 17 projekt-studimeve e cila nuk është shpërndarë sipas llojit të aktiveve materiale, ku janë kryer investimet, pavarësisht se punimet kanë përfunduar në vitet e mëparshme.*

Situata: Gjendja e llogarisë **202 “Studime dhe kërkime”**, më 31.12.2020 paraqitet në vlerën 37,444,849 lekë, ndërsa më 31.12.2021 paraqitet në vlerën 52,591,859 lekë, me rritje në vlerën 15,147,010 lekë Nga analiza e kësaj llogarie u **konstatua se vlera 52,591,860 lekë** e aktiveve afatgjata jo materiale e paraqitur në gjendjen e llogarisë 202 “*Studime dhe Kërkime*”, për 67 projekt-studime për investime të kryera nuk është shpërndarë sipas llojit të aktiveve materiale, ku janë kryer investimet, pavarësisht se punimet kanë përfunduar në vitet e mëparshme. Për këtë vlerë ekziston inventar kontabël dhe fizik dhe ruajtja e tyre është bërë në arkiv në çdo dosje teknike të tenderave sipas investimit të kryer në aktivet materiale afatgjatë. Për këto vlere duhet të kryhen veprimet kontabël për kalimin e vlerës së tyre si vlerë e shtuar çdo aktivitet afatgjatë material mbi të cilën është kryer investimi mbi bazën e këtyre projekt-studimeve. Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me Udhëzim e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik” **Pika 2. Klasa 2**, “Aktivet afatgjata” (përbërja dhe trajtimi kontabël) e cila përcakton: “*Trajtimet kontabël për AAGJM-në, lidhen me njohjen fillestare të aktivitetit, si dhe vlerësimin e mëposhtëm:*

a) *Njohja fillestare - AAGJM-ja, duhet të plotësojnë kriteret e njohjes në pasqyrën e pozicionit financiar, pra, duhet të vlerësohen me kosto që janë:*

- *Kostoja e blerjes së bashku me taksat e importit;*

- *Kosto të tjera të drejtpërdrejta deri në sjelljen e aktivitetit në vendndodhje apo dhe kosto të tjera që i shtohen nga prodhimi i elementeve të aktivitetit (**kosto projektimi**, paga dhe kontribute për prodhimin e elementeve të aktivitetit, materiale të përdorura për këto elemente, kosto transporti, kosto instalimi, kosto testimi etj.).*

Aktivet afatgjata jo materiale përcaktohen dhe klasifikohen të tilla si: programet kompjuterike, markat, patentat, licencat, të drejtat e përdoruesit etj. Mund të ketë aktive me karakteristika si të AAGJM-së ashtu edhe të AAGJ/JM-së. Në këto raste, ato klasifikohen në varësi të karakteristikave dominuese. Shembull, një program kompjuterik (soft) përfshihet në AAGJM, nëse është pjesë përbërëse e pajisjeve kompjuterike, në të kundërt (pra, kur nuk është pjesë), trajtohet si AAGJ/JM”

Kreu II. “Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” **Pika 16/b. d** të cilat përcaktojnë: “*Për regjistrimin në kontabilitet të operacioneve të funksionimit, ndiqet procedura e mëposhtme:*

b) Për shpenzimet e njohura të investimeve bëhet regjistrimi kontabël si më poshtë:

- Debitohet llogaria përkatëse e investimeve (të grupit 23); dhe

- Kreditohet llogaria përkatëse e detyrimeve (klasa 4).

d) Në rastin e kapitalizimit të aktiveve afatgjata, të përfituara nëpërmjet shpenzimeve të investimeve (të regjistruar sipas pikës “b” më sipër), bëhet regjistrimi kontabël si më poshtë:

- Debitohet llogaria përkatëse e grupit 20 ose 21 të aktiveve afatgjata; dhe - Kreditohet llogaria përkatëse e investimeve (grupi 23). e analizuar sipas aneksit nr. 5 pika 3 bashkëlidhur projekt raportit të auditimit.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi znj. R. Sh. me detyrë Drejtoresh në Drejtorinë Ekonomike dhe të Ardhurave.

Kriteri: Udhëzim e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” **Aneksi 1** “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik” **Pika 2. Klasa 2**, “Aktivet afatgjata” (përbërja dhe trajtimi kontabël), me **VKM nr 783**, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standarteve dhe rregullave kontabël”, Seksioni II “Aktivet e Qendrushme Patrupëzuar” **Pika 1/b** “Klasifikimi kontabël” e cila ndër të tjera përcakton se: “Shpenzimet e kërkimeve të aplikuara dhe të zhvillimit - **Llogaria 202**” “Studime dhe Kërkime”.

Impakti: Mos pasqyrim i saktë i vlerës së plotë të aktiveve afatgjata materiale dhe pozicionimit të pasaktë në llogari të shpenzimeve të studim-projektimit me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të Aktiveve Afatgjata Materiale, duke paraqitur risk në besueshmërinë dhe përdorimin e tyre nga subjektet e interesuara.

Shkaku: Drejtoria e Financës nuk ka marrë masat e nevojshme për saktësimin në kontabilitet të operacioneve të funksionimit në lidhje me procesin e kapitalizimit të aktiveve.

Rëndësia: E mesme

Rekomandimi: Drejtoria e Financës të kryejë veprimet e sistemimit në kontabilitet për shpërndarjen e vlerës së studim-projektiveve sipas investimeve të kryera dhe për çdo lloj aktivi afatgjatë material si pjesë e kostos së tij, duke kredituar llog. 202 “Studime dhe Kërkime” dhe debituar llogaritë përkatëse të klasës 21 për vlerat e mbetura koresponduese, në mënyrë që aktivet sipas llojit të paraqiten në vlerë të plotë.

2. Nënrubrika, aktive afatgjata materiale.

-Gjendja e llogarisë **210 “Toka, Troje, Terrene”** në datën 31.12.2020, paraqitet në vlerën 33,502,064 lekë, në 31.12.2021 paraqitet po në vlerën 33,502,064 lekë e pa ndryshuar. Në këtë llogari pasqyrohen vlerat e investimeve të kryera ndër vite, e analizuar në mënyrë kontabël sipas aneksit nr 6 pika 3 bashkëlidhur projekt raportit të auditimit.

-Llogaria 211 “Pyje kullota plantacione” për vlerën kontabël historike **728,000 lekë**. Kjo llogari, periudhës objekt auditimi vit 2020-2021, nuk ka pasur shtesa ose pakësime.

-Gjendja në llogarinë **212 “Ndërtime e konstruksione”** më 31.12.2020, paraqitet në vlerën 488,068,403 lekë, më 31.12.2021 gjendja e kësaj llogarie rezulton 614,959,791 lekë e cilat përfaqëson vlerën e investimeve të kryera ndër vite për ndërtime e rikonstruksione dhe shtesat gjatë periudhës, paksimet janë vetëm për vlerën e amortizimit. Gjendja e kësaj llogari në mënyrë të përmbledhur është analizuar si vijon: (767,380,119-152,420,328) = 614,959,791 lekë vlera neto, e analizuar në mënyrë kontabël sipas aneksit nr 7 pika 3 bashkëlidhur projekt raportit të auditimit.

-Gjendja në llogarinë **213 “Rrugë, rrjete vepra ujore”** më 31.12.2020, paraqitet në vlerën 144,488,382 lekë, më 31.12.2021 gjendja e kësaj llogarie rezulton 169,000,545 lekë, e cilat përfaqëson vlerën e investimeve të kryera ndër vite për rrugë, rrjete dhe vepra ujore si dhe shtesat gjatë periudhës, e analizuar në mënyrë kontabël sipas aneksit nr 8 pika 3 bashkëlidhur projekt raportit të auditimit.

- Nga analiza e llogarisë **213 “Rrugë, rrjete vepra ujore”** bazuar edhe në listën e aktiveve afat gjata materiale në mënyrë analitike, **konstatohet se:**

a) Në përlllogaritjen e amortizimit vjetor të aktiveve afatgjata për vitet 2020 dhe për vitin 2021 nuk është respektuar norma e amortizimit prej 5%. Veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar pika 36.

b) Nuk është pasqyruar vlera e saktë për çdo aktiv afat gjatë që ka pësuar ndryshime gjatë periudhës së mëpasshme nëpërmjet kryerjes së investimeve shtesë, si vlera e rikonstrukcioneve të objekteve, vlera mbikëqyrjes dhe kolaudimit të objekteve, pasi përmirësimet, **riparimet dhe mirëmbajtjet** e aktiveve që kanë një kosto të mëpasshme, duhet ti shtohen kostos fillestare të AAGJM-së. Veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim të UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar, kapitulli II, pika 11, aneksi 1, pika 2 Klasa 2, germa ‘b’.

-Gjendja e llogarisë **214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune”** më 31.12.2020 paraqitet në vlerën 3,177,521 lekë, më 31.12.2020 paraqitet në vlerën 2,912,418 lekë, e cila paraqet vlerën e objekteve të investimeve të kryera ndër vite, shtesat gjatë periudhës dhe paksimet nga amortizimi. Gjendja e kësaj llogari në mënyrë të përmbledhur është analizuar si vijon:

Nr	Emërtimi	Vlera Kontabel	Amortizimi i akumuluar 31.12.2021	Vlera Neto
1	Bashkia	291,386	229,864	61,522
2	program rregjistrimi të kerkesave dhe ankesave	86,400	5,688	80,712
3	MZSH	6,603,994	3,833,810	2,770,184
	Shuma	6,981,780	4,069,362	2,912,418

Burimi: Drejtoria e financës dhe të ardhurave

-Gjendja e llogarisë **215 “Mjete transporti”** më 31.12.20120 paraqitet në vlerën 11,662,496 lekë, dhe më 31.12.2020 paraqitet në vlerën 74,939,453 lekë. e analizuar në mënyrë kontabël sipas aneksit nr 9 pika 3 bashkëlidhur projekt raportit të auditimit.

-Gjendja e llogarisë **218 “Inventar ekonomik”**, më 31.12.2020 paraqitet në vlerën 14,870,512 lekë, më 31.12.2021 paraqitet në vlerën 18,420,175 lekë, e cila paraqet vlerën e objekteve të investimeve të kryera ndër vite dhe shtesat dhe paksime gjatë viteve 2020 dhe 2021, sipas listës analitike që disponon sektori i financës. Në mënyrë të përmbledhur paraqitet si vijon, sipas listës analitike të sektorit të financës.

Nr	Emërtimi	Vlera Kontabel	Amortizimi i akumuluar 31.12.2021	Vlera Neto
1	Bashkia	33,629,867	23,466,769	10,163,098
2	Shu	511,550	481,735	29,815
3	Banesat sociale	3,216,000	2,135,835	1,080,165
4	Nj.Administrative	11,374,502	8,389,125	2,985,377
5	MZSH	4,849,154	687,432	4,161,721
	Shuma	53,581,073	35,160,897	18,420,176

Burimi: Drejtoria e financës dhe të ardhurave

Për vitin 2021 gjendja e llogarisë **219 “Amortizimi i Aktiveve të Qëndrueshme të Trupëzuara”**, amortizimi i AQT-ve nuk pasqyrohet në pasqyrën e pozicionit financiar në bilanc, pasi AQT-të paraqiten me vlerën neto të tyre, por vlerat historike dhe vlerat neto paraqiten në formatin 7/a dhe 7/b(gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me vlerë historike dhe vlerë neto). Llogaritja e amortizimit është bazuar në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatim mbi të ardhurat”, i ndryshuar; si dhe UMFE nr. 08, datë 09.03.2019”

Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësisive të Qeverisjes së Përgjithshme”. (Më hollësisht trajtuar në pasqyrën aneks nr. 10 pika 3 llogaritja e amortizimit bashkëlidhur projekt raportit të auditimit.

3.Nënrubrika, aktive afatgjata financiare, ku bëjnë pjesë referencat e llogarive 25 “Huadhënie e nën huadhënie” dhe 6 “Pjesëmarrje në kapitalin e vetë”, nuk janë kryer veprime të tilla, për rrjedhojë gjendja e tyre në pasqyrat e pozicionit financiar, për vlerën kontabël historike **79,075,000 lekë**. Kjo llogari, periudhës objekt auditimi vit 2020-2021, nuk ka pasur shtesa ose pakësime.

Titulli gjetjes: Mos kontabilizimi i aksioneve të ndërmarrjes Ujësjiellës Kanalizime Berat SHA në llogarinë 26 “Aktive afatgjata financiare”

Situata: Bashkia Berat, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, më 31/12/2022 paraqitet si aksionare me 65.32% të aksioneve të Ujësjiellës Kanalizime Berat SHA ndërsa Bashkia Berat paraqitet si aksionare me 34.68% të aksioneve të Ujësjiellës Kanalizime Berat SHA, e cila është shoqëri aksionare me objekt “Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij. Mirëmbajtja e sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm. Prodhimi ose blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve. Shërbimi i grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura. Mirëmbajtja e sistemeve të ujërave të ndotura, si dhe impianteve të pastrimit të tyre”. Shoqëria duhet të realizojë çdo lloj operacioni financiar apo tregtar që lidhen direkt apo indirekt me objektin e saj, brenda kufijve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi”. Numri i aksioneve është 1,000 me vlerë nominale 876,860 dhe kapital në vlerë monetare prej 876,860,000 lekë. Referuar ekstraktit historik Bashkia Berat zotron 572,787 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej 572,787,000 lekë , ose 65.32 % të aksioneve në pjesëmarrje të Bashkisë Berat në “Ujësjiellës Kanalizime Berat SHA. Referuar bilancit kontabël 2020-2021, më konkretisht në llogarinë 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” paraqitet në vlerën 79,075,000 lekë me një nënvlerësim të llogarisë 26 Pjesëmarrje në kapitalet e veta” në vlerën 797,785,000 lekë. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me Urdhrin e Ministrit nr. 64 datë 22.07.2014 “Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuar” me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5 “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata jo materiale” pika 55, 56, 57 si dhe me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr.14 “Trajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje”. Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi znj. R. Sh. me detyrë Drejtoresh në Drejtorinë Ekonomik dhe të Ardhurave,

Kriteri: Ligji nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, Urdhrin e MF nr. 64, datë 22.7.2014 “Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuar”, me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit nr. 5 “Aktivet afatgjata Materiale dhe Aktivet afatgjata Jo materiale”, pika 55,56 dhe 57.

Ndikimi/Efekti: Mos regjistrimi në kontabilitet dhe deformim i informacionit financiar mbi gjendjen kontabël të paraqitur në pasqyrat e pozicionit financiare viti 2021, të llog 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta”, gjendje kjo e nën vlerësuar me vlerë 572,787,000 lekë.

Shkaku: Mos zbatim i kuadrit ligjorë në fuqi.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Bashkia Berat, nëpërmjet Nënpunësit zbatues të merren masa për sistemimin në kontabilitet dhe regjistrimin e pjesëmarrjes 65.32% në kapitalin e aksioneve tek “Ujësjiellës Kanalizime Berat Sh.a me vlerë 572,787,000 lekë, në debi të llog. 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” dhe kredi të llogarisë financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

4.Nënrubrika, investime.

Llogaria (230; 231) “Investime”, për (AAJM/AAM) sipas të dhënave të paraqitura në pasqyrën e pozicionit Financiar për periudhën raportuese ushtrimore 2021 paraqiten me vlerë

1,666,664,462 lekë, ku nga vlera prej 1,435,645,871 lekë gjendje më 31.12.2020 kemi një shtesë për vlerën 231,018,591 lekë.

Për investimet e kryera gjatë vitit 2021 është debituar llogarinë (231) dhe kredituar llogaritë Klasa (4) Në fund të vitit me kapitalizimin e tyre është kredituar llogaria (231) dhe janë debituar llogaritë (20) dhe (21) “Aktive afatgjata”.

Titulli gjetjes: *Pasqyrimi i gabuar i llogarisë 231 “Investime”*

Situata: Nga të dhënat e vëna në dispozicion nga Drejtoria e Planifikimit Urban, Lejeve dhe Monitorimit të Investimeve rezulton se për përiudhën objekt auditimi 01.10.2019 deri më 31.12.2021 në Bashkinë Berat rezultoi 4 investime në proces që nuk janë mbyllur brenda vitit ushtrimor 2021, respektivisht: 1. Objekti - Ujësjiellësi Velabisht me vlerë kontrate 154,991,516 lekë; 2. Objekti - Ujësjiellësi i fshatit Duhanas, fshati Lapardha 1, Otlak dhe Orizaj, Bashkia Berat me vlerë kontrate 438,06,428 lekë; 3. Objekti - Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara me vlerë kontrate 32,130,929 lekë; 4. Objekti - Përmirësimi i shtresave rrugore në segmentet rrugore Rruga Antipatrea, Kryqëzimi Spitali Rajonal-Kryqëzimi i By Pass me vlerë kontrate 27,386,832 lekë. Në mënyrë të detajuar paraqitet në aneksin nr 11 pika 3 bashkëlidhur projekt raportit të auditimit. Nga analiza e llogarisë 231 “Investime në proces” rezultonse Drejtoria e Financës nuk disponon dokumente analitike justifikuese në marrjen në dorëzim të objekteve sipas kontratave përkatëse, për të dokumentuar dhe vërtetuar vlerën e pasqyruar në pasqyrat e pozicionit financiar, të vitit 2021. Drejtoria e Financës ka bërë kapitalizimin e aktiveve për pjesën e parashikuar për tu likuajduar në buxhet dhe jo për vlerën e situacionit përfundimtar si dhe nuk disponon të dhëna analitike për objektet të cilat nuk janë marë në dorëzim nga bashkia sipas aneksit nr. 10 pika 3. bashkëlidhur projekt raportit të auditimit. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim të UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, kapitulli II, pika 6; 11, aneksi 1, pika 2 Klasa 2, nënpika 2.1, paragrafi, - Trajtimi kontabël dhe funksionimi i grupit 20, "Aktive afatgjata materiale" dhe pika 33 dhe UKM nr. 2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe neneve 55 dhe 56, të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

Kriteri: UMF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësitë të Qeverisjes së Përgjithshme” dhe UKM nr. 2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe neneve 55 dhe 56, të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

Ndikimi/Efekti: Nuk paraqesin një situatë të saktë të llogarive të pasqyrave financiare

Shkaku: Mos zbatim i akteve ligjore të kontabilitetit, si dhe parimeve kontabël.

Rëndësia: I mesëm

Rekomandimi:

Drejtoria e Financës të marë masa për sistemin në kontabilitet të llogarisë (231) në llogaritë (212) ose (213), sipas objekteve pasi një pjesë e tyre janë mbyllur dhe duhet të kapitalizohet në aktive afatgjata materiale.

II. Rubrika, pasivet afat shkurtra.

1.Nënrubrika, llogari të pagueshme, gjendja e llogarive të 401-408 “Furnitorë dhe llogari të lidhura me to”, të 42 “Personeli e llogari të lidhura me to”, -të 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim-taksa”, të 435 “Detyrime ndaj shtetit për sigurime shoqërore”, të 436 “Detyrime ndaj shtetit për sigurime shoqërore”, të 467”Kreditorë të ndryshëm janë të barabarta me gjendjen e

Ilogarisë 4342 “Operacione me shtetin” në vlerën 41,350,918 lekë për vitin 2020 dhe në vlerën 26,509,146 lekë për vitin 2021, e analizuar si vijon:

NR.	EMERTIMI	Gjendje 31.12.2020	Gjendje 31.12.2021
1	Paga Personeli Ilogaria42	9,257,179	8,971,593
2	Tatim page tatim ne burim Ilogaria 431	862,160	948,905
3	Sigurimet Shoqërore Ilogaria 435	2,769,158	2,815,711
4	Sigurime Shëndetësore Ilogaria 436	372,228	376,541
5	Furnitorë Ilogaria.401-408	908,232	6,768,151
6	Kreditorë të ndryshëm Ilogaria. 467	27,181,961	6,628,245
	TOTALI	41,350,918	26,509,146

Nuk rezulton diferencë midis vlerës pasqyruar në llogarinë **4342 “Operacione me shtetin, të drejta” dhe vlerës të pasqyruara në 6 (gjashtë) llogarive pasive**, pra në vitin 2020 dhe 2021 është, e njëjtë me vlerën e pasqyruar në aktivin e pasqyrave të pozicionit financiar.

-Gjendja e Ilogarisë 401-408 **“Furnitorë e Ilogari të lidhura me to”**, në 31.12.2020 paraqitet në vlerën 908,232 lekë ndërsa në 31.12.2021 paraqitet në vlerën 6,768,151 lekë, për 6 subjekte e cila përfaqëson detyrimet e Bashkisë ndaj të tretëve më 31.12.2021. Gjendja e Ilogarisë (401-408) **“Furnitorë e Ilogari të lidhura me to”**, përbëhet nga fatura të palikujduara për detyrime në (investime/ mallra) të muajit Nëntor-Dhjetor, por që likuidohen në muajin janar të vitit pasardhës e analizuar si vijon;

Detyrime me fonde te Buxhetit te Shtetit	Nr. fature	Dt. Fature	4864100 vend.gjyqes	4864200 Sherbime	4864400 Investime	4864500 Mirembajtje	4864600 Mallra	4864903 Transfer ta tek individet	Totali leke
Gega Center Karburant	2701/2021	08.11.2021					386,352		386,352
Gega Center, karburant MZSH	3961/2021	11.12.2021					190,584		190,584
PTN, Pllaka Betoni	44	24.12.2021					363,600		363,600
Prestige Reklama, Printime	70	24.12.2021		15,000					15,000
Gentian Droboniku Antifrizë MZSH	49	24.12.2021					13,050		13,050
Rej shpk, Ujesjellesi Duhanas, Lapardha (Buxh. I Sht.)	111/2021	14.12.2021			5,799,565				5,799,565
Totali detyrime per rakordim me thesarin			0	15,000	0	0	953,586	0	6,768,151

Burimi: Drejtoria e financës dhe të ardhurave

-Gjendja e Ilogarisë 42 **“Detyrime ndaj personelit”** në 31.12.2021 paraqitet në vlerën 8,971,593 lekë e cila paraqet detyrimet për pagat e punonjësve për muajin dhjetor 2021, por që likuidohen në muajin janar të vitit pasardhës

-Gjendja e Ilogarisë **431 “Detyrime ndaj shtetit tatim taksa”** në 31.12.2021 paraqitet në vlerën 948,905 lekë detyrimet për tatimin mbi të ardhurat nga punësimi për muajin dhjetor 2021, por që likuidohen në muajin janar të vitit pasardhës

-Gjendja e Ilogarisë **435 “Sigurime shoqërore”** në 31.12.2021 paraqitet në vlerën 2,815,711 lekë detyrimet për kontributin e sigurimeve shoqërore për muajin dhjetor 2021, por që likuidohen në muajin janar të vitit pasardhës

-Gjendja e Ilogarisë **436 “Sigurime shëndetësore”** në 31.12.2021 paraqitet në vlerën 376,541 lekë detyrimet për kontributin e sigurimeve shëndetësore për muajin dhjetor 2021, por që likuidohen në muajin janar të vitit pasardhës

Krahasuar me list pagesat e muajit dhjetor të vitit 2021 dhe me evidencën e shpenzimeve të muajit janar të vitit 2020, vlerat e Ilogarive 42, 431, 435, 436 rakordojnë dhe janë të njëjta me përmbledhësen e listë pagesave dhe evidencën e shpenzimeve.

Titulli gjetjes: Mbi kontabilizimin e Ilogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”.

Situata:

- Llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”, më 31.12.2020, paraqitet në vlerën 75,173,217 lekë, më 31.12.2021 paraqitet në vlerën 84,301,285 lekë, të cilat përfaqësojnë detyrime të Bashkisë ndaj subjekteve të ndryshme për garanci punimesh në objekte të ndryshme. Nga analiza të llogarië, **konstatohet se:**

- Për vitin 2021 Drejtoria e Financës ka të dokumentuar ngurtësimet gjatë vitit 2021 në vlerën 84,301,285 lekë për 114 subjekte. Gjatë vitit 2021 shesta janë në vlerën **22,225,434 lekë** dhe likuidimet e kryera në vlerën **13,097,336 lekë** për 6 subjekte. Sipas akt rakordimeve midis Bashkisë dhe degës së thesarit.

- Për 74 objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim nga Bashkia, në vlerën 63,016,632 lekë, sipas aneksit nr.12, pika 3, bashkëlidhur projekt raportit të auditimit, nuk është bërë zhbllokimi i tyre, pasi fondet gjenden të ngurtësuar në degën e Thesarit, për të cilat është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës. Nga Drejtoria e Urbanistikës dhe e Financës, nuk janë marrë masa për zhbllokimin e këtyre fondeve, nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës së mësipërme, ose përdorimin për interes publik të këtyre fondeve, bazuar në kushtet e kontratës të lidhur me subjektet sipërmarrëse.

Veprimet e mosveprimet në kundërshtim me UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar Kap. III, pikat 30, 50.

pika 30. “Çdo njësi e qeverisjes së përgjithshme kryen verifikimin fizik të aktiveve dhe elementeve të tjera, konform kriterëve të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore, si dhe saktëson vërtetësinë e llogarive të të drejtave e të detyrimeve ndaj të tretëve. Mbi këtë bazë, në kontabilitet, bëhen veprimet për sistemimin e diferencave të gjendjes fizike me gjendjen kontabël për llogari të vitit kontabël që mbyllet”,

Pika 50. “Tepricat e llogarisë 520, “Disponibilitete në thesar” dhe të llogarisë 466, “Kreditorë për mjete në ruajtje” duhet të vërtetohen me akt rakordim me thesarin, një kopje e të cilit i bashkëngjitet llogarisë vjetore. Në akt rakordim, tepricat duhet të paraqiten të strukturuar sipas natyrës së të ardhurave të trashëguara (të ardhurat e papërdorura, si të çelura ashtu edhe ato të paçelura, mjetet në ruajtje, sponsorizimet dhe pjesën e grantit që trashëgohet)”,

UKM nr. 3, datë 15.02.2011 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kap. II, pika 10.

Pika 10. Në përfundim të periudhës së garancisë, investitori, kolaudatori, mbikëqyrësi dhe zbatuesi i punimeve bëjnë kontrollin përfundimtar të veprës. Për difektet që nuk janë ndrequr gjatë periudhës së garancisë së punimeve të ndërtim-montimit, investitori llogarit koston e ndreqjes së tyre dhe bën ndalesën nga vlera e garancisë së punimeve.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me znj. A. Sh. me detyrë Specialist Buxheti si person i ngarkuar për ndjekjes dhe çlirimin e garancive.

Kriteri:Baza ligjore mbi të cilën është vlerësuar situata e cila paraqet parregullsi janë: UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, ndryshuar me udhëzimin nr. 5 datë 21.02.2022 Kap. III, pikat 30, 50.

Ndikimi/Efekti:Mos regjistrimi në kontabilitet dhe deformim i informacionit financiar për sa i përket gjendjes kontabël të paraqitur në Pasqyrat e Pozicionit Financiar për vitin 2021 të llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”.

Shkaku:Mos zbatim i udhëzimit nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit Urban, Lejeve dhe Monitorimit të Investimeve, të marrë masa për të bërë sistemimin e llogarisë 466 “Kreditore për mjete nën ruajtje”, duke rakorduar drejtoritë njëra me tjetrën çdo muaj mbi balancat e llogarisë 466, si dhe duke njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të sistemuar dhe pastruar garancitë të cilat tashmë u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit përkatës.

-Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm” më 3.12.2020 paraqitet në vlerën 140,809,829 lekë dhe më 31.12.2021 paraqitet në vlerën 163,788,926 lekë me një ritje në vlerën (22,979,097) lekë e cila është e zërthyer në mënyrë analitike, për Bashkinë Berat dhe Njësitë Administrative në varësi. Nga analiza e kësaj llogarie rezulton se vlera debitorë e kësaj llogarie, është e **kuadruar me shumën e llogarive kreditore në Aktiv të bilancit, respektivisht llogarinë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”** në shumën totale **157,160,681 lekë** si dhe llogarinë 4342 “Operacione me shtetin (Të drejta)” në **vlerën 6,628,245 lekë**, të cilat janë faturat që nuk i ka kaluar afati 60 ditor. *Veprimet e mësipërme janë në përputhje të kërkesave të UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kap. III, pika 42 dhe Aneksi –1, Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik.*

Evidenca e aktiveve të qëndrueshme dhe regjistrimi i tyre në pronësi të Bashkisë Berat

Titulli gjetjes: *Mungesa e sektorit të menaxhimit të aseteve si dhe e regjistrimit analitik të aktiveve të qëndrueshme dhe regjistrimi i tyre në pronësi të Bashkisë Berat*

Situata: Për vitin 2020 struktura organizative është miratuar me Vendim të Kryetarit të Bashkisë nr. 120, datë 20.02.2020, “Për miratimin e strukturës së administratës së bashkisë dhe të njëjve shpenzuese në varësi të Bashkisë Berat për vitin 2020” i ndryshuar. **për vitin 2021** struktura organizative është miratuar me Vendim të Kryetarit të Bashkisë nr.827, datë 15.12.2020 “Për miratimin e strukturës së administratës së bashkisë dhe të njëjve shpenzuese në varësi të Bashkisë Berat për vitin 2021. Konstatohet se në strukturën aktuale organizative të bashkisë Berat nuk është krijuar sektori i Menaxhimit dhe Administrimit të Aseteve nuk janë ngritur grupet e punës për përcaktimin e misionit dhe detyrat e tyre për administrimin e aseteve (toka, pyje, kullota, ndërtesa etj.), dhe për këtë arsye procesi i administrimit të tyre nuk është realizuar në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi. Kjo strukturë duhet të realizonte marrjen në dorëzim të aseteve, zbatimin e procedurave të transferimit në NJQV, vënien në efikasitet të ndërtesave, tokës bujqësore produktive dhe jo produktive sipas sipërfaqeve faktikë, duke rritur mundësinë e të ardhurave nga dhënia me qira. Për të gjitha asetet nuk është hapur regjistër kontabël, në kundërshtim me kapitullin III “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”, pika 26 dhe 27 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 8, të ligjit nr. 8743, datë 22.02.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, i ndryshuar, VKM nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore”, transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, Udhëzimin nr.3, datë 18.07.2002 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme të shtetit nga njësitë e qeverisjes vendore”, si dhe Udhëzimit të Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit nr. 15, datë 30.06.2003 “Për mënyrën e paraqitjes nga njësitë e qeverisjes vendore të kërkesave për transferim në pronësi të tyre, të pronave të paluajtshme publike”

Bashkisë Berat, me VKM nr. 834, datë 21.11.2012 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në Bashkinë Berat, të Qarkut Berat”, i është miratuar lista inventarit me në total 2948 prona. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se me

VKB nr. 24, datë 01.06.2012, ka vendosur miratimin e listës së pronave të paluajjtshme shtetërore që ndodhen në territorin e Bashkisë Berat. Kjo listë fillon me numër 1 (një) dhe mbaron me nr. 2895 (dymijë e tetëqind e nëntëdhjet e pesë) dhe përbëhet me 265 (dyqind e gjashtëdhjetë e pesë) fletë ndryshuar me;

- VKM nr.238/2015 Bashkisë Berat i janë transferuar 8 prona sipas lista së inventarit bashklidhur, gjithsej një flet.

- VKM nr.915/2015 Bashkisë Berat i janë transferuar 5 prona sipas lista së inventarit bashklidhur, gjithsej një flet.

- VKM nr.1049/2015 Bashkisë Berat i janë transferuar 1 prona sipas lista së inventarit bashklidhur, gjithsej një flet.

- VKM nr. 366/2016 Bashkisë Berat i janë transferuar 2 prona sipas lista së inventarit bashklidhur, gjithsej një flet.

- VKM nr.104/2016 Bashkisë Berat i janë transferuar 1 prona sipas lista së inventarit bashklidhur, gjithsej një flet.

- VKM nr.291/2020 Bashkisë Berat i janë transferuar 1 prona sipas lista së inventarit bashklidhur, gjithsej një flet.

- VKM nr.266 / 2021 Bashkisë Berat i janë transferuar 3 prona sipas lista së inventarit bashklidhur, gjithsej një flet.

- VKM nr. 569 / 2021 Berat i janë transferuar 3 prona sipas lista së inventarit bashklidhur, gjithsej një flet.

Ish Komunës Sinjë sot Njësia Administrative Sinjë e Bashkisë Berat, me VKM nr. 920, datë 02.07.2008 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajjtshme shtetërore të Komunës Sinjë, të Qarkut Berat”, i është miratuar lista inventarit me 285 prona nga të cilat 220 prona në pronësi dhe 63 prona në përdorim. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se me VKB nr. 9, datë 31.01.2018, ka vendosur miratimin e listës së pronave të paluajjtshme shtetërore që ndodhen në territorin e Njesisë Administrative Sinjë, në Bashkinë Berat. Kjo listë fillon me numër 1 (një) dhe mbaron me nr 341 (treqind e dyzet e një) dhe me shkresë nr. 820, datë 12.02.2018 është dërguar Ministrisë së Punëve të Brendshme , Agjencisë së Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike, transferimin e listës përfundimtare të pronave.

Ish Komunës Otlak sot Njësia Administrative Otlak e Bashkisë Berat, me VKM nr. 248 datë 27.03.2013 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajjtshme shtetërore të Komunës Otlak, të Qarkut Berat”, i është miratuar lista inventarit me 1478 prona nga të cilat 1165 prona në pronësi dhe 313 prona në përdorim. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se me VKB nr. 67, datë 07.05.2019, ka vendosur miratimin e listës së pronave të paluajjtshme shtetërore që ndodhen në territorin e Njesisë Administrative Otlak, në Bashkinë Berat. Kjo listë fillon me numër 1 (një) dhe mbaron me nr. 1585 (njëmijë e tetëqindë e tetëdhjet e pesë), konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Berat, me shkresë nr. 603/1, datë 10.05.2019. Me shkresë nr. 1998/1 prot, datë 12.05.2019 është dërguar, Ministrisë së Punëve të Brendshme , Agjencisë së Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike, transferimin e listës përfundimtare të pronave.

Ish Komunës Velabisht sot Njësia Administrative Velabisht e Bashkisë Berat, me VKM nr. 1410 datë 22.10.2008 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajjtshme shtetërore të Komunës Velabisht, të Qarkut Berat”, i është miratuar lista inventarit me 2540 prona nga të cilat 2465 prona në pronësi dhe 75 prona në përdorim. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se me VKB nr. 124, datë 25.10.2018, ka vendosur miratimin e listës së pronave të paluajjtshme shtetërore që ndodhen në territorin e Njesisë Administrative Velabisht, në Bashkinë Berat. Kjo listë fillon me numër 1 (një) dhe mbaron me nr. 2570 (dymijë e pesëqindë e shtatëdhjet), konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Berat, me shkresë nr. 2565/1 prot datë 29.10.2018. Me shkresë nr. 812/1 prot, datë 14.05.2019 është dërguar,

Ministrisë së Punëve të Brendshme , Agjencisë së Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike, transferimin e listës përfundimtare të pronave.

Ish Komunës Roshnik sot Njësia Administrative Roshnik e Bashkisë Berat, me VKM nr. 879 datë 12.12.2007 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të Komunës Roshnik, të Qarkut Berat”, i është miratuar lista inventarit me 640 prona në pronësi. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se me VKB nr. 26, datë 26.07.2016, ka vendosur miratimin e listës së pronave të paluajtshme shtetërore që ndodhen në territorin e Njësies Administrative Roshnik, në Bashkinë Berat. Kjo listë fillon me numër 1 (një) dhe mbaron me nr. 640 (gjashtëqind e dyzetë), listë e cila nuk i është dërguar Ministrisë së Punëve të Brendshme, Agjencisë së Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike, transferimin e listës përfundimtare të pronave.

Përsa i përket pronave të Kaluara me VKM në Njësitet Administrative (Sinjë, Otlak, Roshnik dhe Velabisht) nuk janë kryer veprime për marrjen në dorëzim dhe pasqyrimin në inventar dhe kontabilitet; nuk është ngritur grup pune për përgatitjen e dokumentacionit teknik të aseteve në pronësi dhe në përdorim, për të realizuar regjistrimin e pronave pranë ZVRPP (ASHK) Berat; nuk ka rakordim me ZVRPP (ASHK) Berat, për asetet pronë e Komunës, pasi nuk është marrë në dorëzim harta treguese e objekteve pronë e Komunës; nuk ka të dhëna dhe rakordim për objektet e privatizuar dhe evidencë të pronarëve që nuk kanë shlyer troje; nuk kanë filluar procedurat për përgatitjen e dokumentacionit ligjor për verifikimin dhe regjistrimin e pronave të paluajtshme publike dhe marrjen në dorëzim të aseteve, si dhe nuk është aplikuar në ZVRPP për regjistrimin e tyre. Mosveprimet e mësipërme janë në shkelje të kërkesave të ligjit nr. 33-2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, dhe UMF-së nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitet e sektorit publik”, kap. III, pika 30 ku citohet: “Formati i regjistrimit të aktiveve hartohet në vartësi të llojit të tyre afatgjatë apo afatshkurtër si dhe grupit përkatës brenda llojit. Kërkesat minimale që duhet të përmbajë regjistri i aktiveve në vartësi të llojit, përfshijnë: datën e hyrjes ose të marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritjen të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.” dhe pika 35/a ku citohet: “Dokumentet vërtetues- vërtetojnë kryerjen në fakt dhe në mënyrë kronologjike, të veprimeve ekonomike. Të tilla janë fletëhyrjet, faturat, situacionet e shpenzimeve, fletëdaljet mandate arkëtimet, mandate pagesat, procesverbalet dhe të tjera akte me natyrë verifikues shpenzimi.” si dhe neni 37 i ligjit 20/2020 “Për Përfundimin e Proceseve Kalimtare të Pronësisë në Republikën e Shqipërisë” Kreu IV.

Në mënyrë të përmbledhur pronat e kaluara me VKM dhe të regjistruara në ASHK paraqiten si më poshtë:

Nr.	Bashkia/ Njesite	Nr. Pronave në Inventar	Nr. i Praktikave të Certifikuara Deri Dhjetor 2019	Nr. Praktikave të Certifikuara 2020-2021	Prona të pa Rregjistruara
1	Bashkia Berat	2757	49	2	2706
2	Njësia Administrative Sinjë	285			285
3	Njësia Administrative Otlak	1478			1478
4	Njësia Administrative Velabisht	2540			2540
5	Njësia Administrative Roshnik	640			640
	Totali	7700	49	2	7659

Burimi: Bashkia Berat

Në mënyrë të detojuar pronat të cilat janë regjistruar gjatë periudhës objekt auditimi në ASHK, si vijon:

Nr	Emertimi Pasurisë	Zona kadastral	Nr Pasurise	Indeksi I harte	Nr. rregjis	Siperfaqia sipas V.K.M.		Data e aplikimit	Vertetim ose certifikate Hipoteke	Siperfaqia sipas Faktit	
						Truall	Ndert			Truall	Ndert

								Nr. Dt.			
1	Qendra Kulturore	8502	12/280	BR-K-6	00008 750	514.8	565.5	7750;16/ 7/20	Çertifikat	514.8	309.5
2	Truall per nd banesash per te pastrehet	8502	24/227	BR-M-8	00001 221	3930.3	0	5104;09/ 06/2021	Çertifikat	3930.3	0

Burimi: Bashkia Berat

Nga auditimi rezultoi se, për periudhën object auditimi janë certifikuar në total 2 prona sipas tabelës së sipërcituar si dhe përpara vitit 2019 janë certifikuar 49 prona objekte inventari në ndërtesa e konstruksione të administruara llog.(212) pasuri e paluajtshme (*sasi e vlerë*) pjesa e konsiderueshme e tyre prej 7659 prona (*trajtuar analitikisht*) nuk janë të regjistruara në kontabilitet dhe pasqyrat financiare në aktiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, pasi 49 objekte janë të trashëguara nga (*ish/komunat*) NJSH, ndërsa 2 objekte janë transferuar me VKM e sipërcituara dhe janë të pajisura me certifikat pronësie.

Konstatohet se sipas të dhënave të vëna në dispozicion nga Drejtoria e Shërbimeve, Emergjencave civile dhe Pronave, u konstatua se një pjesë e pronave janë regjistruar nga Bashkia Berat në Drejtorinë rajoneve të ASHK Berat, por pa vlerë. Kështu gjithsej janë regjistruar 51 prona por pa vlerë, gjë e cila vështirëson procesin e kontabilizimit në pasqyrat financiare si asetet të Bashkisë Berat. Për rrjedhojë kontabilizimi i AAM, të cilat përfaqësojnë pasuri të paluajtshme nuk është mbështetur në dokumentacionin e duhur. *Veprime dhe mosveprime bien në kundërshtim me VKM nr. 510, datë 10.06.2015 "Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme", Kreu (VI) "Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme" dhe veprim në mospërputhje me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" me ndryshime, Kreu (III), pika 35 dhe Kreu (II), pika (16) Veprime dhe mosveprime ngarkojnë me përgjegjësi z. E. D. në cilësinë e Nënpunësit Autorizues, znj. M. S. , me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Menaxhimit të pronave dhe Strehimit për periudhën e auditimit. 01.10.2019-31.12.2021 si dhe znj R. Sh. me detyrë Drejtoresh e Financës dhe të Ardhurat në cilësinë e Nënpunësit Zbatues.*

Kriteri: Baza ligjore mbi të cilën është vlerësuar situata e cila paraqet parregullsi janë; ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", me pika 26 dhe 27, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", të VKM nr. 529, datë 08.06.2011 "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiotezë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", i ndryshuar, në mënyrë që kjo njësi vendore të mund të realizonte të ardhura nga vënia në funksion e këtyre aseteve, si dhe të VKM nr. 500, datë 14.08.2001 "Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore". Ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005, "Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor", të ndryshuar.

Ndikimi/Efekti: Mos regjistrimi në kontabilitet dhe deformim i informacionit financiar për sa i përket gjendjes kontabël të paraqitur në Pasqyrat e Pozicionit Financiar.

Shkaku: Mungesa e sektorit të menaxhimit të aseteve si dhe e regjistrimit analitik të aktiveve të qëndrueshme dhe regjistrimi i tyre në pronësi të Bashkisë Berat

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Bashkia Berat, të marrë masa për krijimin e strukturës së menaxhimit të aseteve, duke përcaktuar në rregulloren e brendshme detyrat konkrete për evidentimin, inventarizimin, vlerësim dhe regjistrimin e pronave në ZVRPP.

- Të krijohet regjistri i pronave të paluajtshme të kaluara në pronësi, apo në përdorim të Bashkisë Berat sipas VKM.

- Drejtorin e Financës në cilësinë e Nënpunësit Zbatues, të ndërmarr të gjitha procedurat ligjore për vlerësimin 51 prona të certifikuara në ASHK Berat, por pa vlerë respektive si dhe paraqitjen e vlerës së këtyre aktiveve në Pasqyrën e Pozicionit Financiar të njësisë publike vendore Bashkia Berat më 31.12.2022.

-Testimi i llogarisë 600 “Pagat dhe shpërblime”

Nr.	Emertimi	2019		2020		2021	
		PLAN 31.12.2019	FAKT 31.12.2019	PLAN 31.12.2020	FAKT 31.12.2020	PLAN 31.12.2021	FAKT 31.12.2021
1.	Funksionar Politik	11	11	13	11	13	9
2.	Administrator te Lagjeve Njesive Administrative	7	6	7	7	7	7
3.	Sekretar I Përgjithshëm	1	0	1	1	1	1
4.	Drejtor Drejtorie	8	7	10	5	10	7
5.	Përgjegjës Sektori	8	8	8	7	10	8
6.	Specialist i kategorisë III-b	43	40	59	52	55	50
7.	Specialist i Kategorisë IV-a	17	16	16	16	16	15
8.	Punonjës me kod pune IV-a	10	10	9	9	10	10
9.	Punonjës me kod pune III-b	1	1	2	2	2	2
10.	Punonjës Mbështetës	10	10	11	10	12	11
11.	Inspektoriati Vendor i mbrojtjes së Territorit	3	3	4	4	4	3
12.	Policia Bashkiake	16	14	16	16	16	15
Totali Aparatim dhe Njesite Administrative		135	126	156	140	156	138

Për vitin 2019 numri i punonjësve është miratuar me Vendim të Kryetarit të Bashkisë nr.925, datë 26.11.2018 “Për miratimin e strukturës së administratës së bashkisë dhe të njësive shpenzuese në varësi të Bashkisë Berat për vitin 2019 “, i ndryshuar. Miratuar në total numri 135 + 13 punonjës të QKB dhe Gjendjes Civile = 148 punonjës gjithsej, në fakt janë paguar sipas listë pagesave gjithsej 139 punonjës, nuk ka tejkallim të numrit të punonjësve.

Për vitin 2020 numri i punonjësve është miratuar me Vendim të Kryetarit të Bashkisë nr.120, datë 20.02.2020 “Për miratimin e strukturës së administratës së bashkisë dhe të njësive shpenzuese në varësi të Bashkisë Berat për vitin 2020 “, i ndryshuar. Miratuar në total numri 156 + 13 punonjës të QKB dhe Gjendjes Civile = 169 punonjës gjithsej, në fakt janë paguar sipas listë pagesave gjithsej 153 punonjës, nuk ka tejkallim të numrit të punonjësve.

Për vitin 2021 numri i punonjësve është miratuar me Vendim të Kryetarit të Bashkisë nr.827, datë 15.12.2020 “Për miratimin e strukturës së administratës së bashkisë dhe të njësive shpenzuese në varësi të Bashkisë Berat për vitin 2021 “, i ndryshuar. Miratuar në total numri 156 + 13 punonjës të QKB dhe Gjendjes Civile = 169 punonjës gjithsej, në fakt janë paguar sipas listë pagesave gjithsej 151 punonjës, nuk ka tejkallim të numrit të punonjësve.

-Referuar kërkesave të VKM nr. 177 datë 08.03.2017, struktura e Bashkisë Berat është miratuar me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë të sipërcituara.

Sipas listë pagesave të muajve janar 2019, shtator 2020 dhe nëntor 2021 konstatohet se është zbatuar struktura sipas vendimeve miratues.

Listë pagesat janë të firmosura nga Drejtori i Financës znj. R. Sh. dhe Specialisti i pagave.

Është përgatitur përmbledhësja e listë pagesave e cila është e firmosur nga Drejtori i Financës dhe nga Kryetari Bashkisë; Z. E. D.

Janë mbajtur listë prezencat dhe janë të firmosura nga Përgjegjësi i Burimeve Njerëzore z. G. D. dhe nga Sekretari i Përgjithshëm znj. A. T.

Hartimi i listë pagesave mbi bazën e listë prezencave të nënshkruara nga përpiluesi, për vitin 2019- 31.12.2021.

Me përzgjedhje u audituan listë pagesat e periudhës (Maj-Qershor 2020, Tetor-Dhjetor 2020 dhe Janar-Mars 2021) dhe konstatohet se ato plotësohen konform rregullave të përcaktuara të

cilat janë plotësuar mbi bazën e listë prezencave mujore të nënshkruara nga znj. G. D. Nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore është hartuar përmbledhësja në përputhje me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995,” Kodi i Punës”, i ndryshuar.

Ndalesat për tatimin mbi të ardhurat personale dhe kontributit të sigurimeve shoqërore të punonjësve të Bashkisë Berat, janë në përputhshmëri me kërkesat e ligjit nr. 8438, datë 28.11.2008 "Për tatimin mbi të ardhurat", me ndryshime dhe ligjit nr. 9136, datë 11.09.2003 "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në RSH".

Mallra dhe shërbime (llogaria 602)

Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve dhe ngjarjeve të kryera nëpërmjet bankës në lekë

Transaksionet financiare të kryera nëpërmjet bankës janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarin e bankës në bazë të urdhër-shpenzimeve të cilat ishin të nënshkruara nga nëpunësi autorizues dhe zbatues të konfirmuar nga nëpunësi i Thesarit dhe të vulosura nga të dy palët.

Përpilimi i urdhër-shpenzimeve ishte i bazuar në dokumentet vërtetues dhe autorizues sipas natyrës së shpenzimit si urdhër prokurimi, procesverbale, oferta, kontrata, fatura e furnitorit, preventiva, situacione, fletëhyrje, listpagesat, deklaratimet e tatimit mbi të ardhurat, formularët e përlllogaritjeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si nga punëdhënësi dhe nga punonjësi etj. Vlerat e shënuara në urdhër-shpenzim përputhen me vlerat e këtyre dokumenteve financiare që mbështesin këtë shpenzim.

Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës është bërë në mënyrë të saktë sipas destinacionit dhe sipas natyrës së shpenzimeve.

Totali i shpenzimeve mujore dhe progresive kuadronin me konfermat bankare mujore. Nga verifikimi një për një i shumave të urdhër-shpenzimeve për periudhën 12-mujore rezultoi se totali është i barabartë me shumën e totale të shpenzimeve të akt-rakordimit përfundimtar të shpenzimeve me thesarin. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës sipas destinacionit dhe natyrës së shpenzimeve është bërë i saktë. Në fund të çdo viti ushtrimor është bërë rakordimi i llogarive që preken dhe është bërë prerja e artikujve kontabël.

Në analizë: Në formatin nr. 2 “Pasqyra e përformancës financiare” paraqet llogaritë e të ardhurave dhe shpenzimeve me klasifikim sipas natyrës ekonomike të pasqyruara PF për vitin 2021 është e analizuar sipas aneksit nr. 12 pika 3 bashkëlidhur projekt raportit të auditimit.

Në formatin nr. 2 “Të Ardhurat” janë paraqitur llogaritë financimi nga buxheti i shtetit për vitin 2021 (grant) në vlerën **554,504,462.21 lekë**. Të ardhurat e realizuara nga kjo njësi vendore në vlerën **210,473,334 lekë** sipas aktit të rakordimit me Degën e Thesarit Berat.

Perfshirja në kete format të PF e gjendjes të të ardhurave sipas llogarive analitike është bërë nga jashte sipas ditarit të azhornuat nga drejtoria e taksave e tarifave vendore. Gjendja e seciles llogari te te ardhurave rakordon me vlerat e paraqitura ne llogarite analitike te aktit te rakordimit me Degën e Thesarit Berat

Për vitin 2021 totali i të ardhurave në vlere është **904,353,734 lekë** dhe totali shpenzimeve është në vlerën **759,348,091 lekë**. Diferenca e tyre në vleren **145,005,643 lekë rakordon me gjendjen e llog.85 “Rezultatit e ushtrimit”**.

Pasqyrat e konsoliduara në nivel të vetëqeverisjes vendore me të gjitha njësitë e varësisë.

Bashkia Berat për vitet 2020 ka hartuar pasqyrat e konsoliduara në nivel të vetëqeverisjes vendore me të gjitha njësitë e varësisë, për ti dhënë një pamje të strukturuar të informacionit kontabël të periudhës raportuese për aktivet, detyrimet, aktivet neto, fondet neto, të ardhurat, shpenzimet dhe fluksin e mjeteve monetare konfirmuar me shkresën nr. 568 prot. datë 30.06.2021, ndërsa për vitin 2021 pasqyrat e konsoliduara në nivel të vetëqeverisjes vendore me të gjitha njësitë e varësisë është brenda afatit ligjor. **Në vartësi të Bashkisë Berat janë katër Njësi vartëse.** Pasqyrat e pozicionit financiar për periudhën e viteve 2020, të Njësive ekonomike në vartësi të Bashkisë Berat, janë dorëzuar në degën e thesarit Berat, Veprimet

janë në respektim të kërkesave të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollit”; neni 9,pika 4, germa “d”, neni 12 pika 2. germa “b”

Ligji nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollit”, neni 9, pika 4, germa “d” dhe neni 12, pika 2, germa “b”. UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, kapitulli II, pikat 98; 99; 100; 101, germa “b”,pika 118.

4.1. Mbi planifikimin, realizimin, zhvillimin e procedurave të prokurimeve publike.

Në zbatim të pikës nr.4 të programit të auditimit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Dosjet shkresore të prokurimeve.
- Dokumentacioni elektronike në sistemin e Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Regjistri i parashikimit të prokurimit publik
- Regjistri i realizimit të prokurimit publik, etj.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar rezulton që:

Për periudhën tetor 2019 - dhjetor 2021 janë zhvilluar 21 procedura prokurimi me vlerë të lartë, me fond limit 753,794,193 lekë, vlerë të lidhjes së kontratës 700,176,889 lekë dhe diferencë midis tyre në vlerën 53,617,304 lekë.

Për periudhën tetor-dhjetor 2019 janë zhvilluar 2 procedura me vlera të larta, me fond limit 12,480,833 lekë, vlerë të lidhjes së kontratës 11,514,500 lekë dhe diferencë midis tyre në vlerën 966,333lekë.

Për vitin 2020 janë zhvilluar 11 procedura me vlera të larta, me fond limit 588,671,790 lekë, vlerë të lidhjes së kontratës 575,690,733 lekë dhe diferencë midis tyre në vlerën 12,981,056 lekë.

Për vitin 2021 janë zhvilluar 8 procedura me vlera të larta, me fond limit 152,641,570 lekë, vlerë të lidhjes së kontratës 112,971,656 lekë dhe diferencë midis tyre në vlerën 39,669,914 lekë.

Për të realizuar administrimin në mënyrë të vazhdueshme të procesit të prokurimit, përgatitjen e dokumenteve të tenderit dhe mbledhjen e të gjitha materialeve të nevojshme, që u bashkëlidhen atyre e të tjera detyra që lidhen me procedurat e prokurimit publik, nga Titullari i Autoritetit Kontraktor Bashkia Berat për vitin 2019, 2020 dhe 2021 nuk është caktuar personi përgjegjës për prokurimin, veprim në kundërshtim me nenin 57 -Personi përgjegjës për prokurimin dhe njësia e prokurimit, të VKM 14 “ datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku thuhet: “*Titullari i autoritetit kontraktor, në fillim të vitit, cakton me urdhër të veçantë personin/ personat përgjegjës për prokurimin dhe dërgon emrin/emrat respektivë në Agjencinë e Prokurimit Publik*”. Rregjistri i realizimit te prokurimeve publike për periudhën tetor 2019 dhjetor 2021 pasqyrohet në aneksin nr.4/1, bashkangjitur projektraportit të auditimit.

Të ndara sipas llojit të procedurës së prokurimit dhe natyrës, procedurat e zhvilluara paraqiten si vijon:

Lloji i procedurës	Nr. Proc	Fondi limit pa TVSh	Kontrata pa TVSh	Diferenca e fondi limit me vlerën e kontratës
Periudha tetor-dhjetor 2019				
Hapura	1	9,247,500	8,480,000	767,500
Kërkesë me propozim	1	3,233,333	3,034,500	198,833
SHUMA	2	12,480,833	11,514,500	966,333

Sipas natyrës së objektit	Nr.	Fondi limit pa TVSh	Kontrata pa TVSh	Diferenca e fondi limit me vlerën e kontratës
Ne fushën e ndërtimeve				
Në shërbime/ blerje, etj	2	12,480,833	11,514,500	966,333
Viti 2020				
Hapura	4	539,712,948	528,504,273	11,208,675
Kërkesë me propozim	5	23,146,937	21,594,452	1,552,485
Negocim pa shpallje	1	5,914,000	5,907,008	6,992
Sherbim Konsulence	1	19,897,905	19,685,000	212,905
SHUMA	11	588,671,790	575,690,733	12,981,057
Sipas natyrës së objektit	Nr.	Fondi limit pa TVSh	Kontrata pa TVSh	Diferenca e fondi limit me vlerën e kontratës
Ne fushën e ndërtimeve	4	531,864,420	521,569,793	10,294,626
Në shërbime/ blerje, etj	7	56,807,370	54,120,940	2,686,431
SHUMA	11	588,671,790	575,690,733	12,981,057
Viti 2021				
Hapura	4	115,335,639	100,804,283	14,531,356
Kërkesë me propozim	2	7,898,686	6,813,928	1,084,758
Sherbim Konsulence	2	29,407,245	27,883,150	1,524,095
SHUMA	8	152,641,570	135,501,361	17,140,209
Sipas natyrës së objektit	Nr.	Fondi limit pa TVSh	Kontrata pa TVSh	Diferenca e fondi limit me vlerën e kontratës
Ne fushën e ndërtimeve	2	63,054,732	49,598,134	13,456,598
Në shërbime/ blerje, etj	6	89,586,838	85,903,227	3,683,611
SHUMA	8	152,641,570	135,501,361	17,140,209

Burimi: Përpunuar nga KLSH sipas regjistrit të prokurimeve ë subjektit

Procedurat e audituara

1.Mbi zbatimin e procedurave ligjore në tenderin me objekt “Ujesjellesi i fshatit Duhanas, fshati Lapardha 1, Otlak dhe Orizaj, Bashkia Berat”, me vlerë të fondit limit 372,286,076 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2020.

Burimi i Financimit vënë në dispozicion nga buxheti i shtetit, financiar për vitet 2020-2024. Afati i realizimit të punimeve 6 muaj sipas DST.

“Ujesjellesi i fshatit Duhanas, fshati Lapardha 1, Otlak dhe Orizaj, Bashkia Berat”, Numri i referencës së procedurës: REF-80099-11-26-2020		
1.Urdhër Prokurimi nr.55, datë 25.11.2020, nr.5688 prot.	3. Njësia e Prokurimit, ngritur me urdhrin nr.55, datë 25.11.2020: A. Zh., F. K., M. S.	4.Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: Urdhër nr. prot., datë: P. S., L. B., E. M.
2.Lloji i Procedurës së Prokurimit: “Procedurë e hapur”		
5.Fondi Limit (pa TVSh) 370,988,933	6.Oferta fituese:“ BOE R... sh.p.k dhe 2... ShPK, me vlerë 365,057,023 leke (pa TVSh)	7.Diferenca me fondin limit 5,931,910 lekë (pa TVSh)
8. Data e hapjes së tenderit: 08.01.2021	9.Burimi Financimit: Buxheti i shtetit	10.Operatoret Ekonomik a)Pjesëmarrës në tender:1 OE

		b)S'kualifikuar - c) Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime: AK: Nuk ka patur ankesa	12. Përgjigje ankesës nga AK:	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP:
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
14.Lidhja e kontratës Nr. nr.519/1 prot, datë 04.02.2021	15.Vlera e kontratës: 365,057,023 leke (pa TVSh), 438,068,428 lekë me TVSh	16. Likuiduar vlera 219,348,658 lekë me TVSh . Diferenca për periudhën 2022-2024

Agjencia Kombëtare e Ujësjetës Kanalizime dhe Infrastrukturës së Mbetjeve, me shkresën nr. 5639 prot., datë 23.11.2020 (të dhëna të Bashkisë Berat), me lëndë “ Dërgohet miratimi i objektit për programin “ Furnizimi me ujë dhe kanalizime”, ka njoftuar Bashkinë Berat se me vendimin e këshillit teknik nr.46, datë 13.11.2020, ka miratuar projekt zbatimin për objektin “Ujësjetësi i fshatit Duhanas, fshati Lapardha 1, Otlak dhe Orizaj, Bashkia Berat”, me vlerë të plotë 446,743,291 lekë me TVSh , vetëm për ndërtim montim (372,286,076 lekë pa TVSh). Vlera e plotë e objektit do të financohet në vitet 2021 – 2024.

Sipas shkresës së mësipërme për vitin 2021 do të alokohen 8,348,658, lekë për ndërtim dhe 73,410 lekë për supervizim punimesh.

Bazuar në VKM nr. 354, datë 11.05.2016, “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin e territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim, është bërë ndarja e fondit si vijon: Vlera e plotë e objektit 452,340,397 lekë me TVSh , ndërtim montim 446,743,291 lekë me TVSh , drejtim punimesh 4,867,049 lekë me TVSh , Kolaudim punimesh 730,057 lekë me TVSh .

Hartimi i kriterëve të DST.

Me urdhrin e prokurimit nr. 55, datë 25.11.2020 të titullarit të AK z. E. D., është përcaktuar njësia e prokurimit e përbërë nga znj. F. A., juriste, me detyrë specialiste e prokurimeve, znj. A. Zh., ekonomiste, me detyrë specialiste e prokurimeve, znj. M. S., inxhinierë (specialiste e fushës), me detyrë përgjegjëse e sektorit të pronave dhe strehimit social.

Konstatohet se specialisti i fushës znj. M. S., ka formim inxhinier ndërtimi, profil i cili nuk përputhet tërësisht me zërat e fushës së objektit të prokurimit, i cili është ndërtim ujësjetësi.

Në rastin konkret të ndërtimit të ujësjetësit ka qenë e nevojshme që si specialisti i fushës të jetë edhe një inxhinier hidro.

Në këtë rast nga Titullari i Autoritetit Kontraktor z. E. D. është vepruar në kundërshtim me kërkesat e nenit 57, pika 2 të VKM 914, datë 29.12.2014, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, ku thuhet:

Për çdo procedurë prokurimi, në varësi të specifikës së objektit të prokurimit, titullari i autoritetit kontraktor krijon njësinë e prokurimit, në përbërje të së cilës është personi përgjegjës për prokurimin, i caktuar në fillim të vitit dhe të paktën një specialist fushe në rast se kërkohen njohuri të specializuara për objektin e prokurimit. Në raste të tjera, titullari i autoriteti kontraktor cakton në përbërjen e njësisë së prokurimit, përveç personit përgjegjës për prokurimin, një ose disa persona të tjerë, me arsim të lartë.

Urdhri i prokurimit është i pa vulosur në Degën e Thesarit Berat, në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, “Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike” pika 154 ku përcaktohet: “Kërkesa për shpenzim i drejtohet Nëpunësit Autorizues dhe për dijeni Nëpunësit Zbatues. Në rastet kur kërkesa është e lidhur me një proces blerje apo kryerje shërbimi i dërgohet strukturës përgjegjëse për prokurimet në njësinë shpenzuese. Struktura përgjegjëse për prokurimet kryen kontrollet e nevojshme krahasuese me kërkesat e planifikuara dhe planin e prokurimit të miratuar në procesin e planifikimit të buxhetit. Në rast të kërkesave të reja, të paplanifikuara më parë, kërkohet

miratimi paraparak i Nëpunësit Autorizues të njësisë. Në përfundim të procesit njofton Nëpunësin Zbatues të njësisë për urdhërin e prokurimit, i cili autorizohet nga struktura përgjegjëse e Thesarit në degë përpara se të fillojë procesi i prokurimit.”.

Për mos vulosjen e urdhërit të prokurimit në thesar mban përgjegjësi nëpunësi zbatues znj. R. Sh.

Titulli: Në procesverbalin e mbajtur nga njësia e prokurimit, nuk është bërë argumentimi i kriterëve të veçanta për kualifikim të DST që lidhen me kapacitetin teknik. Janë vendosur kriterë të cilët nuk janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, elementë të cilët kanë efekt në kufizimin e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomik.

Situata: Nga njësia e prokurimit është hartuar procesverbali nr.5688/2 prot., datë 27.11.2020 “Për hartimin e dokumentave të procedurës së prokurimit “Ujësjetësi i fshatit Duhanas, fshati Lapardha 1, Otlak dhe Orizaj, Bashkia Berat.

Nga auditimi konstatohet së në procesverbalin e mbajtur nga njësia e prokurimit, nuk është bërë argumentimi i kriterëve të veçanta për kualifikim të DST që lidhen me kapacitetin teknik, në kundërshtim me kërkesat e pikës 2, neni 61, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, ku thuhet: Hartimi i kërkesave të veçanta për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret e vlerësimit (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit”.

Në kriteret e veçanta të DST, pika 2.3 të seksionit “Për kapacitetin teknik”, është vendosur kriteri se operatorët ekonomik duhet të dëshmojnë se disponojnë licencë profesionale NP - 2 – D.

Referuar VKM Nr.42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, licenca NP - 2 – D shërben për ndërtime civile dhe industriale për vlera të punimeve sipas preventivit nga 101 milion lekë deri në 200 milion lekë. Në këtë VKM shpjegohet se: “Ndërtime civile e industriale konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje të sakta në objekte ku zhvillohen aktivitetet njerëzore të drejtpërdrejta ose jo, kompletimi me strukturat e nevojshme dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar godina banimi, shkolla, zyra, kazerma ushtrie, teatro, stadione, godina industriale, godina për parkim, burgje, stacione hekurudhore dhe metroje, godina aeroporti me ndonjë punim special në betonarme të thjeshtë ose të parandëruar, betonim të tavaneve të hollë, membrana, kupola, depozita të varura, sillos dhe ndërtime të larta me strukturë me karakteristika të veçanta e komplekse”.

Nga auditimi i zërave të projektit të ujësjetësit, konstatohet se ka shumë pak zëra punimesh të cilat të kërkojnë nevojën e kategorisë (D) të kësaj llojë licence. Të gjitha punimet e ndërtimit në preventiv që kryesisht janë beton i armuar në vend, armimi i betoneve, punime murature dhe suvatime, për të cilat ka qenë e nevojshme licenca NP - 2 – A (sipas vlerave në lekë të punimeve të kryera për çdo kategori punimi vlera 0-20 milion lekë). Që të justifikohet vendosja në DST e licencës NP - 2 – D, duhet që vlera e punimeve për ndërtime civile dhe industriale në preventiv të jetë 101 milion lekë deri në 200 milion lekë, por zërat e punimeve nuk e plotësojnë këtë vlerë.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të raportit përfundimtar të auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacion (për aktet e konstatimit) protokolluar në KLSH me shkresën nr.55/5 datë 26.04.2022, si dhe nëpërmjet postës elektronike në adresën b...m...@klsh.org.al datë 22.04.2022, nga znj. A. Zh., znj.F. K., znj.M. S., anëtare të njësisë së prokurimit.

Gjithashtu “Mbi projektraportin e auditimit”, nga të njëjtët persona si më sipër, nga subjekti i audituar është paraqitur observacion, nëpërmjet postës elektronike në adresën b...m...@klsh.org.al datë 20.06.2022, protokolluar në KLSH me nr. 55/9 prot, datë 06.06.2022, ku janë shprehur të njëjtat objeksione, si ato të bëra për përmbajtjen e akteve të konstatimit. Në të dy rastet observacionet janë të njëjta, nuk ka argumente shtesë në observacionet e bëra për projektraportin e auditimit. Për të dy rastet, nga subjekti i audituar janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: Në lidhje me kriterin për licencën profesionale NP-2-D (Inxhinier ndërtimi) që duhet të ketë operatori ekonomik, vendosur te pika 2.3 të “Seksionit për kapacitetin teknik “ shprehem se ky kriter është i domosdoshëm për faktin se në preventivin e punimeve të objektit janë parashikuar punime ndërtimi civile konkretisht –Punimet për pusetat e betonit dhe punimet “Stacioni i pompave te Depo e Baterisë”

C	Beton I armuar ne vend
C.1	F.V Beton sipas klases perkatese
C 1.1	Beton nen themele, C7/10
C 1.2	Bordure anesore C12/15 perreth godines se stacionit te pompave
C 1.4	Beton per trare themeli, b/a, C 20/25
C 1.4.1	Kollona b/a monolite C 20/25, h ~ 4m
C 1.4.2	Trare e arkitrare b/a C20/25, h ~ 4m
C 1.4.3	Soleta te plota, b/a C 20/25, h ~ 4m
C 1.4.4	Soleta te plota b/a C 20/25, dysheme
C 4	Armimi I Betoneve
C 4.1	Hekur Armimi Klasa B500B
C 4.1.1	F V hekur betoni periodik, Ø 6 - 10 mm
C 4.1.2	F V hekur betoni periodik, Ø > 10 mm
G	Punime ne Ndertesa
G 1	Punime Murature dhe Suvatime
G 1.1	Muratura
G 1.1.1	Mure me tulla te plota te zakonshme H-3m, M25
G 2	Lyerje me Boje dhe hidroizolime
G2.1	Boje hidroplastike per ambientet e brendshme
G2.2	Boje hidroplastike per ambientet e jashtme
G2.3	Hidroizolim me praimer bituminoz+I shtrese leter katrama, cilesia I 4mm+I shtrese leter katrama, cilesia I 4.5kg granil
G 9	Rifinitura
G.9.1	Siperfaqe te brendshme
G9.1.1	Suvatim I brendshem mur tulle h~4m me krah, llac perzier M-25
G.9.2	Siperfaqe te jashtme
G9.2.1	Suva solete, h ~ 4 m me drejtues, me krah
G9.2.2	Suva e zakonshme fasade mure tulle lartesi mbi 8m
G.9.3	Dysheme
G9.3.1	Shtrese me pllaka gres porcelanato dysheme
G9.3.2	Plintues importi, h=10cm
G 12	Punime Drenazhimesh
G.12.1	Ulluk shkarkimi vertikal xingato, ø100mm
G.12.2	Kasete shkarkimi me llamarine xingato
G 7	Dyer dhe Dritare
G 7.2	Dritare
G 7.2.2	Dritare d/alumini dyfish xham.
G 7.4	Dyer

Qëndrimi i grupit të auditimit: Në observacionin e bërë keni argumentuar nevojën e licencës N.P - 2 Ndërtime civile dhe industriale, por jo të kategorisë (D), por të kategorisë (A) dhe për këtë arsye observacioni juaj është marrë pjesërisht në konsideratë. Pra duhet licencë N.P – 2A dhe jo N.P -2D

- Në DST për drejtuesit teknik nuk është vendosur kriteri i kërkuar nga VKM Nr.42, datë 16.1.2008, ku thuhet: “Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë marrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohet të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit”.

• Në pikën 2.3.4 të kapacitetit teknik është kërkuar 1 inxhinier mjedisi, por ky kriter rezulton i pa argumentuar në procesverbalin e mbajtur nga njësia e prokurimit dhe i **panevojshëm**. Nga auditimi i projektit të procedurës së prokurimit, rezulton se nuk ka zëra punimesh të cilët të kenë lidhje me nevojën e inxhinierit të mjedisit.

Çështjet që lidhen me mjedisin janë ezauruar: gjatë procesit të studimit dhe të projektimit, nëpërmjet hartimit të preventivit, specifikimeve teknike, projektit, relacioneve teknike dhe raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis, por edhe nga kërkesa në DST se: operatori ekonomik duhet të paraqesë një çertifikatë që vërteton sistemin e menaxhimit të mjedisit, (një) nga inxhinierat e kërkuar në DST duhet të jete i pajisur me certificate vleresimin e ndikimit ne mjedis.

1-Prendimi i subjektit: Kriteri për inxhinier mjedisi, vendosur te pika 2.3.4 te “Seksionit për kapacitetin teknik“, shprehemi se ky kriter është i nevojshëm për faktin se në preventivin e punimeve te objektit janë parashikuar “Rivendosja e sipërfaqeve të gjelbërta” nga B 6.1- B 6.5 për të katër fshatrat. Kërkesa për certifikatat e “Vlerësimit i ndikimit në mjedis” është detyrim ligjor pasi zona ku do të kryhen punimet është zonë pyjesh dhe kullotash të shumta, ku gjatë punimeve duhet pasur kujdes i veçantë për mbrojtjen e mjedisit. Kriteri i mësipërm është vendosur në përputhje me nenin 46 pika 1 germa “b” të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 : Për prokurimit publik” i ndryshuar ku parashikohet se: operatorët ekonomik, për te marre pjese në procedura Operatori ekonomike, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, organizative, makineritë, pajisjet e aseteve të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është parashikuar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objekti të kontratës.

2-Prendimi i subjektit: Kriteri për mjekun nuk është vendosur nga specialisti i fushës, pasi nuk ka lidhje me njohuritë në fushën e punimeve të ndërtimit, por nga Juristi i Njesisë së Prokurimit.

1-Qëndrimi i grupit të auditimit: Në observacionin e bërë për të argumentuar nevojën për inxhinier mjedisi, nuk keni dhëna fakte dhe argumente të reja. Është sqaruar nga audituesi në aktin e konstatimit se është bërë studimi për mjedisin dhe çdo gjë tjetër që lidhet me të, është përcaktuar se ku do të kalojë edhe linja e ujësjellësit, etj. dhe keni kërkuar që një nga inxhinierët duhet të jete i pajisur me certifikatë vlerësimit e ndikimit ne mjedis. Kërkesa për inxhinier tjetër të profilit mjedis është e pa nevojshme. Për arsye se nuk keni fakte dhe prova të reja, observacioni juaj për inxhinierin e mjedisit nuk merret në konsideratë.

2-Qëndrimi i grupit të auditimit: *Për pretendimin që ngrini për mjekun, keni të drejtë, prandaj për këtë nuk keni ju përgjegjësi por juristi i njësisë së prokurimit i cili në projekt raport është ngarkuar me përgjegjësi.*

• Sugjerimi i bërë nga APP për mjekun nuk është marrë në konsideratë nga njësia e prokurimit.

Për këtë kriter sqarohet se: Në kriteret e veçanta të DST, pika 2.3.4 të seksionit “Për kapacitetin teknik”, është vendosur kriteri se operatorët ekonomik duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar, të vërtetuar me kontratë noteriale pune të vlefshme, Urdhër mjeku, diplomë, libreze pune, cv_1 **(një) mjek të përgjithshëm.**

Kjo kërkesë nga njësia e prokurimit është argumentuar bazuar në VKM Nr.108, datë 9.2.2011 “Për aftësi që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë” (i ndryshuar).

Së pari: Bazuar në Vendimin Nr. 632, datë 15.7.2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 108, datë 9.2.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë”, si dhe bazuar në numrin e punonjësve që është kërkuar në DST, nuk plotësohen kriteret që OE të sigurojnë shërbimin mjekësor në ndërmarrje nëpërmjet mjekut të punës (staf i brendshëm i shoqërisë), por nëpërmjet mjekut të punës të kontraktuar nga jashtë.

Së dyti: Kjo kërkesë nga njësia e prokurimit nuk është argumentuar, nuk ka lidhje me preventivin e punimeve, me natyrën e kontratës, kriteri i pa nevojshëm. Kriteri është në kundërshtim me përcaktimet e pikës 1, të nenit 46, të LPP dhe pikës 2, të nenit 26, të VKM nr.914, datë 29.12.2014, që çdo kriter i veçantë duhet të jetë në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës. Nuk ka element të kontratës që të bëjnë të jetë e nevojshme kërkesa për mjek. Autoriteti kontraktor nuk mund të kërkojë që operatorët ekonomik ti vërtetojnë se plotësojnë çdo detyrim që ata kanë për funksionimin e tyre si shoqëri private. Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë vetëm plotësimin e kriterëve që kanë lidhje me zbatimin e kontratës. Organizimi i shërbimit mjekësor nga operatorët ekonomik është një çështje që ju përket atyre dhe organeve të tjera kontrolluese të këtij elementi (Inspektorati i Punës etj.) dhe jo çështje e verifikimit nga autoritetit kontraktor, përderisa mjeku nuk lidhet me natyrën e kontratës, që do të thotë me elementët e punimeve të preventivit.

• Në kriteret e veçanta të DST, pika 2.3.5 të seksionit “Për kapacitetin teknik”, është kërkuar që operatori/et ekonomike ofertues duhet të kenë të punësuar si staf teknik 1 specialist ekspert zjarrfikës.

Kriteret kualifikues për një specialist ekspert zjarrfikës, përveçse është i pa argumentuar teknikisht në procesverbalin e mbajtur nga njësia e prokurimit, është jo në përputhje me natyrën e kontratës, **i pa nevojshëm. Në projekt nuk rezultojnë zëra punimesh të cilat të lidhen me nevojën e specialistit zjarrfikës.**

Referuar ligjit nr. 152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”, roli i ekspertit zjarrfikës nuk është në përpjesëtim me natyrën e kontratës, në kuptim të nenit 46, pika 1 të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar. Nga ana tjetër në DST është kërkuar që një nga inxhinierët e kërkuar të jetë i pajisur me certifikatë për parandalimin dhe mbrojtjen nga zjarri, e cila është e mjaftueshme për zbatimin e rregullave të sigurimit teknik për mbrojtjen nga zjarri.

Referuar ligjit nr. 152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”, neni 39 thuhet:

1. Projekti për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin është pjesë përbërëse e dokumentacionit që kërkohet për lëshimin e lejes së zhvillimit/ndërtimit.

3. Projektimi, ndërtimi, rikonstrukcioni dhe vënia në përdorim e veprave dhe strukturave të ndryshme, ndërtesave, rrjetit rrugor, elektrik, ujësjellës-kanalizimeve, pyjeve e kullotave, zonat e mbrojtura etj., bëhen në përputhje me kërkesat e këtij ligji dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.

4. Projektet për të gjitha llojet e ndërtimeve dhe administrimin e zonave të mbrojtura etj., përfshijnë edhe projektin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin“.

Pra mbrojtja nga zjarri është hartuar që në fazën e projektit nga projektuesi dhe është ky i fundit që ka përcaktuar të gjitha detajet teknike që bëjnë të mundur mbrojtjen nga zjarri.

Pretendimi i subjektit: Pika 4. Në pikën 2.3.5 të kapacitetit teknik është kërkuar si staf teknik 1 specialist ekspert zjarrfikës si dhe një nga inxhinieret te jetë i pajisur me certifikatë për parandalimin dhe mbrojtjen nga zjarri. Për këtë sqarojmë se: Kriteri i mësipërm është vendosur në përputhje me nenin 46 pika 1 germa “b” të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006: “Për prokurimit publik” i ndryshuar.

Kërkesa për specialist zjarrfikës si dhe certifikatat e parandalimit dhe mbrojtës nga zjarri është detyrim ligjor pasi zona ku do të kryhen punimet është zonë pyjesh dhe kullotash të shumta, ku gjatë punimeve duhet pasur kujdes i veçante për mbrojtjen e mjedisit.

Qëndrim i grupit të auditimit: Është sqaruar në aktin e konstatimit që nevoja për çdo kriter duhet të jetë e lidhur me një zë të caktuar në preventiv. Nëse bie zjarr gjatë kryerjes së punimeve (si pretendoni ju), nuk është detyra juaj të shuani zjarrin, por e strukturave të tjera të specializuara për këtë qëllim. Detyra e çdo punonjësi është që të zbatojë rregullat e sigurimit teknik, për parandalimin e rënies së zjarrit. Për arsye se nuk keni fakte dhe prova të reja observacioni juaj për çështjen e nevojës së zjarrfikësit nuk merret në konsideratë.

• Në kriteret e veçanta të DST, pika 2.3.3 të seksionit “Për kapacitetin teknik”, është kërkuar: operatori duhet të dëshmojë se ka të punësuar mesatarisht të paktën **120** punonjës, për periudhën **qershor – tetor 2020**.

Nga njësia e prokurimit nuk është bërë argumentimi për numrin e kërkuar prej 120 të punonjësve. Duke parë natyrën dhe tipologjinë e kontratës, konstatohet një numër i konsiderueshëm punonjësish pa përcaktuar profesionin e tyre, pra objektin e punës së tyre (përveç inxhinierëve dhe specialistëve të mësipërm).

Jo vetëm numri i punonjësve 120, por edhe kriteri se ofertuesit duhet të dëshmojnë se i kanë të punësuar këta 120 punonjës për **periudhën 5 mujore qershor – tetor 2020, është i pa argumentuar në procesverbalin e mbajtur nga njësia e prokurimit dhe i pa nevojshëm**. Punonjësit e kërkuar do të marrin pjesë në realizimin e kontratës së ardhshme e cila do të lidhet pas zhvillimit të prokurimit publik dhe për këtë mjafton që OE të vërtetojë qoftë edhe muajin e fundit se ka numrin e nevojshëm të punonjësve të kërkuar. Nuk sjellë asnjë dobi, asnjë ndryshim për autoritetin kontraktor nëse OE vërteton që i ka punonjësit e kërkuar për 5 muajt e fundit, apo vetëm për një muaj. Vendosja e kriterit për afatin 5 mujor, qershor – tetor 2020 është diskriminues, përjashton nga konkurimi operatorë të tjerë ekonomik që mund ti kenë po kaq punonjës por për një periudhë më të vogël kohe. Nuk është vendosur zgjidhje alternative se një pjesë prej punonjësve të kërkuar mund të jenë edhe kontratë pune të përkohshme për kohëzgjatjen e procedurës së prokurimit. Nga APP i është rekomanduar autoritetit kontraktor, që të korrigjohet kriteri që 120 punonjësit e kërkuar duhet të jenë në listëpagesën e shoqërisë për një periudhë 5 mujore, por ky rekomandim nuk është marrë në konsideratë nga njësia e prokurimit. Nga njësia e prokurimit është vendosur afati 5 mujor i ekzistencës së 120 punonjësve në listëpagesën e shoqërisë, nga ana tjetër nuk është shoqëruar ky kriter me argumentim se përse duhet të jetë ky afat 5 mujor, për çfarë i shërben AK.

Janë kërkuar 7 inxhinier, për të cilët është kërkuar të jenë në listëpagesë, si dhe të paraqitet kontrata e punës dhe diploma. Përderisa është kërkuar që inxhinierët të jenë në listëpagesë, si dhe të paraqitet diploma, **nuk është e nevojshme të vendoset kriteri për kontratën e**

punës. Autoriteti kontraktor nuk verifikon funksionimin e shoqërisë për cdo element të saj dhe për cdo detyrim që ajo ka, por vetëm për ato që lidhen me realizimin e kontratës.

Numri 120 i punonjësve të kërkuar është i pa argumentuar dhe nuk përkon me shumën e punonjësve të kërkuar për secilin pozicion pune të përshkruar në DST.

Numri i punonjësve të nevojshëm në tender del si shumatore e numrit të punonjësve të kërkuar në DST për secilin pozicion pun, ku përcaktohet dhe detyra që do të kryej punonjësi. Nga auditimi i DST konstatohet se janë përcaktuar 34 punonjës sipas pozicioneve të punës si vijon:

Nr	Profesioni/pozicioni I punës	Numri i punonjësve të kërkuar
1	Inxhinier	7
2	Mjek	1
3	Ekspert zjarrëfikës	1
4	Shofer	8
5	Muratorë	1
6	Karpentier	3
7	Saldator	1
8	Elektracist	1
9	Hidraulik	1
10	Specialist ndërtimi	3
11	Bojaxhi	1
12	Manovratore mjetesh të rënda	6
	Total	34

Nga sa më sipër, sipas përshkrimit që është bërë në DST sipas pozicioneve të punës së punonjëse, numri i tyre del 34 punonjës, nga 120 të kërkuar në total. Diferenca prej 86 punonjës nuk ka përshkrime në DST se çfarë pune do të kryejnë gjatë zbatimit të kontratës.

I-Pretendimi i subjektit: Pika 5. Kriteri që operatori ekonomik të ketë të paktën 120 punonjës, përcaktuar pika 2.3.3 të “Seksionit për kapacitetin teknik” është i nevojshëm, argumentimi është si më poshtë:

7 Inxhinierë

Grupet e punës të ndara sipas zonave për të katër fshatrat : A, B, C, D, E

Grupi A përbëhet nga 6 grupe në terren që përbëhen nga:

- 2 Kamion vetshkarkues me kapacitet 3.5 ton
- 1 Eskavator me goma me kovë 1 m³
- 1 robot (Bob Cat)
- 1 Kompakter elektrik
- 3 Punëtorë të pakualifikuar
- 1 Ekspert montimi dhe saldimi të tubave

Gjithsej 9 punonjës/ grup x 6 grupe = 54 punonjës Grupi A

Grupi B përbëhet nga 3 grupe

- 2 Kamion vetshkarkues me kapacitet 3.5 ton
- 1 Eskavator me goma me kovë 1 m³
- 1 robot (Bob Cat)
- 1 Kompakter elektrik
- 3 Punëtorë të pakualifikuar
- 1 Ekspert montimi dhe saldimi të tubave

Gjithsej 9 punonjës/ grup x 3 grupe = 27 punonjës Grupi B

Grupi C përbëhet nga 1 grup

- 1 Kamion vetshkarkues me kapacitet 3.5 ton

- 1 Eskavator me goma me kovë 1 m³
- 1 Specialist saldimi
- 2 Kompakter elektrik
- 3 Punëtorë të pakualifikuar
- 1 Betoniere

Gjithsej 9 punonjës/ grup x 1 grup = 9 punonjës Grupi C

Grupi D përbëhet nga 1 grup

- 1 Kamion vetshkarkues me kapacitet 3.5 ton
- 1 Eskavator me goma me kovë 1 m³
- 1 Betonier
- 2 Kompakter elektrik
- 3 Punëtorë të pakualifikuar
- 1 Ekspert montimi dhe saldimi të tubave

Gjithsej 9 punonjës/ grup x 1 grup = 9 punonjës Grupi D

Grupi E përbëhet nga 3 grupe për rikthimin e rrugëve në gjëndjen fillestare

- 1 Kamion vetshkarkues me kapacitet 3.5 ton
- 1 Autobot për shplarjen e rrugëve
- 3 Punëtorë të pakualifikuar

Gjithsej 5 punonjës/ grup x 3 grup = 15 punonjës Grupi E

Shuma e punonjësve Grupi A+B+C+D+E=54+27+9+9+15=114+7 inxhinier= 121 punonjës

Pretendimi i subjektit Pika 5/1. Periudha e punësimit të punonjësve qershor- tetor 2020, nuk është vendosur nga specialisti i fushës, pasi nuk ka lidhje me njohuritë në fushën e punimeve të ndërtimit, por nga Ekonomisti i Njësisë së Prokurimit i cili sqaron se: Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohëzgjatje **Qershor – Tetor 2020** është gjykuar se tregon besueshmëri për autoritetin kontraktor. Kërkesa për kohe të plote siguron autoritetin kontraktor që subjekti paguan sigurimet shoqërore për të paktën pagën baze për fuqinë punëtore duke siguruar qëndrueshmëri të fuqisë punëtore. Pavarësisht nga ditët e punës që realizon në muaj një punëtor sipas ligjit 7703 date 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, nën 10 pagesa për sigurimet shoqërore behet për të gjithë muajin dhe llogaritet mbi pagën bruto. Shume subjekte regjistrojnë punëtor për 1 ose dy dite pune dhe i deklarojnë përsëri në fillim të çdo muaj duke rritur faktikisht numrin e fuqisë punëtore. Po të krahasosh FDP real me FDP e llogaritur me kohe të plote kupton numrin mesatar të punonjësve

1-Qëndrim i grupit të auditimit: Në observacion ju pretendoni se ka pasur nevojë për 86 punonjës të pa kualifikuar, por një kërkesë për punonjës të kësaj kategorie nuk është pjesë e DST. Ju nuk mund të fusni nevojën për punonjës të tjerë, tani që ka përfunduar tenderi dhe jashtë atyre pozicioneve që keni kërkuar në DST. Në DST nuk janë kërkuar punonjës të pa kualifikuar dhe as nuk është përcaktuar puna që ata do të kryejnë. Për këtë arsye observacioni juaj për këtë çështje nuk merret në konsideratë.

2-Qëndrim i grupit të auditimit (Për pikën 5/1). Autoriteti kontraktor ka të drejtë të kërkojë numrin e punonjësve për realizimin e kontratës, e cila vjen si kohë pas zhvillimit të procedurës së prokurimit. Për të gjykuar për këtë, listëpagesa e muajit të fundit është e mjaftueshme. Autoriteti kontraktor nuk ka detyrë të kontrollojë rregullshmërinë e subjektit për detyrimet që ka me organet tatimore, sepse kjo kryhet nga vetë këto organe. Aq më tepër që në DST është kërkuar edhe paraqitja e vërtetimit për shlyerjen e detyrimeve që operatorët ekonomik kanë në organet tatimore.

Autoriteti Kontraktor nuk ka të drejtë të kërkojë që operatorët ekonomik të vërtetojnë nëse plotëson ose jo një detyrim ligjor që ata kanë, por që nuk lidhet me tenderin që zhvillohet.

Për arsye se nuk keni fakte dhe prova të reja, observacioni juaj lidhur periudhën e punësimit të punonjësve qershor- tetor 2020 nuk qëndron dhe për këtë ngarkohet me përgjegjësi anëtare e njësisë së prokurimit, ekonomiste znj. A. Zh.

• Në kriteret e veçanta të DST, pika 2.3.10 të seksionit “Për kapacitetin teknik”, është kërkuar që operatori ekonomik të ketë në pronësi ose me qira mjete dhe makineri si me poshte:

Nr	Lloji i Makinerive/Pajisje	Sasia	Pronësia
1	Kamiona vetshkarkues 18- 25 ton kap. mbajtes	Cope 4	në pronësi ose me qira
2	Kamioncina deri 5 ton kap. mbajtes	Cope 4	në pronësi ose me qira
3	Autobot uji me kapacitet jo me pak se 10.000 litra	Cope 2	në pronësi ose me qira
4	Kamion me vinc	Cope 2	në pronësi ose me qira
5	Autobetoniere	Cope 2	në pronësi ose me qira
6	Minifadrome	Cope 2	në pronësi ose me qira
7	Ekskavator me zinxhir	Cope 4	në pronësi ose me qira
8	Sonde per shpime horizontale per kalim tubash nen trasene e rruges	Cope 1	në pronësi ose me qira
9	Sonde per shpime vertikale per kalim tubash nen trasene e rruges	Cope 1	në pronësi ose me qira
10	Aparature elektronike per kontrollin e presionit,	Cope 2	në pronësi ose me qira
11	Kompresor ajri	Cope 2	në pronësi ose me qira
12	Cekic pneumatik per thyerjen e zonave shkembore	Cope 1	në pronësi ose me qira
13	Motobetoniere	Cope 4	në pronësi ose me qira
14	Mini ekskavator	Cope 3	në pronësi ose me qira
15	Motogjenerator/gjenerator	Cope 2	në pronësi ose me qira
16	Aparatura per bashkim tubacionesh me metoden “Elektro Fusion Joint”	Cope 4	në pronësi ose me qira
17	Rula	Cope 2	në pronësi ose me qira
18	Rul me kompresor	Cope 1	në pronësi ose me qira
19	Pompa uji	Cope 2	në pronësi ose me qira
20	Pompe betoni	Cope 1	në pronësi ose me qira
21	Fadroma me goma	Cope 1	në pronësi ose me qira
22	Ekskavator me goma	Cope 1	në pronësi ose me qira
23	Tokmak	Cope 1	në pronësi ose me qira
24	Grejder	Cope 1	në pronësi ose me qira
25	Fabrike Betoni/pajisur me leje mjedisore	Cope 1	në pronësi ose me qira, kontrata funizimim
26	Saldatrice/motosaldatrice	Cope 1	në pronësi ose me qira
27	GPS (Total station)	Cope 1	në pronësi ose me qira
28	Matrapik	Cope1	në pronësi ose me qira
29	Rimorkiator per levizjen e mjeteve	Cope 1	në pronësi ose me qira
30	Buldozer	Cope 2	në pronësi ose me qira
31	Jelekë	Cope 100	në pronësi ose me qira
32	Prozhektorë ndriçimi	Cope 10	në pronësi ose me qira
33	Komplet i ndihmës së shpejtë	Cope 10	në pronësi ose me qira
34	Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt	Cope 20	në pronësi ose me qira

(Lista e makinerive, pas korrigjimeve të bëra sipas rekomandimeve të APP)

Për numrin dhe llojin e makinerive të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Berat, nga APP është rekomanduar: Mbështetur në tipologjinë e objektit të kontratës që prokurohet, rekomandojmë që AK të rivlerësojë kërkesat për numrin e lartë të mjeteve të gërmimit dhe të kamionëve të kërkuar, si dhe në rast se i qëndron kriterit, të mire argumentojë teknikisht nevojën.

Në zbatim të rekomandimit të APP, është bërë ndryshimi si vijon:

- Është ulur numri i kamionëve vetëshkarkues 18- 25 ton kapacitet mbajtës, nga 5 në 4 copë;

- Është ulur numri i kamionçinave deri 5 ton kapacitet mbajtes, nga 5 në 4 copë;
- Është ulur numri i kamionëve me vinç, nga 3 në 2 copë;
- Është ulur numri i ekskavator me zinxhir, nga 5 në 4 copë;
- Është ulur numri i moto betoniereve nga 5 në 4 copë;
- Është ulur numri i mini eskavatorve nga nga 4 në 3 copë;
- Është ulur numri i rulave nga 3 në 2 copë;
- Është ulur numri fadromave me goma nga 3 në 1 copë;

Në procesverbalin e mbajtur nga njësia e prokurimit nuk është bërë argumentimi teknik i nevojës për llojin dhe numrin e secilës makineri të kërkuar. Numri imakinereive të kërkuara nuk është argumentuar në procesverbalin e mbajtur për hartimin e kriterëve të DST. Cdo makineri e vendosur duhej të argumentohej në lidhje me volumin e punimeve, orët e punës, grafikun e punimeve.

- Nuk është argumentuar nevoja për numrin e kamionëve vetëshkarkues dhe kamionçinave. Në DST janë kërkuar: 4 kamionëve vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 18- 25 ton, 4 kamionçina me kapacitet mbajtës deri deri 5 ton. Konstatohet një numër i lartë i **kamionëve vetëshkarkues dhe të kamionçinave**, ndërkohë që objekti i prokurimit nuk e justifikon, pasi pjesa më e madhe e dheut që del nga gërmimet do të përdoret përsëri për mbulimin e tubacioneve.

Nuk është argumentuar nevoja për **mjete gërmimi**. Për këtë qëllim janë kërkuar një numër i lartë mjetesh si: ekskavator me zinxhir copë 4, minieskavator copë 3, fadromë me goma copë 1, ekskavator me goma copë 1, buldozer copë 2. Numri i mësipërm është i pa argumentuar.

- Janë kërkuar 2 auto betoniere, 4 moto betoniere, është kërkuar fabrike betoni/pajisur me leje mjedisore, në pronësi ose me qira, kontrata furnizomini, por bazuar në natyrën e procedurës së prokurimit dhe zërat dhe volumet e punimeve nuk justifikojnë kërkesat e mësipërme.

- Gjithashtu është kërkuar që operatori ekonomik të ketë fabrike betoni/pajisur me leje mjedisore, në pronësi, me qira ose kontratë furnizimi, kërkesë e pa argumentuar dhe në proporcion të zhdrejte me volumin e punimeve që do të kryhen me beton (pjesa me e madhe janë puseta). Betoni është një mall lehtësisht i gjendshëm në treg dhe nuk është e nevojshme që të vendoset një kriter i tillë, aq më tepër që natyra e tenderit nuk është ndërtim objekti me volume të shumta betoni, por ndërtim ujësjellësi.

- Në kriteret e veçanta të DST, pika 2.3.11 të seksionit “Për kapacitetin teknik”, është vendosur kriteri se operatorët ekonomik duhet të paraqesë akt - marrëveshje / vet deklarin me prodhuesin/distributorin e shitjes, për furnizimin me tubo (te specifikuar ne preventivin e punimeve), ku te specifikohet se ne rast te shpalljes fitues ne procedurën e prokurimit operatori ekonomik do te furnizohet me material tubo gjate gjithë periudhës te realizimit të kontratës. Operatori ekonomik do te paraqesë vetë deklarin se prodhuesi i materialit tubo është konfort sistemeve te menaxhimit te cilesise dhe ne rast se operatori ekonomik shpalljes fitues do te paraqesë ISO 9001, ISO 14001, PASS 99:2012 ose ekuivalente te tyre te vlefshme të prodhuesit nga te cilet furnizohen.

Konstatohet se kërkohet prej operatorit ekonomik ofertues që të deklarojë për llogari të prodhuesit, kriter i pa mbështetur ligjrisht, si dhe është kërkuar që të paraqiten certifikatat ISO nga prodhuesi (pra nga të tretë), i cili nuk është pjesëmarrës në tender.

- Në pikën 2.3.13, të kapacitetit teknik nga AK ka kërkuar: “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, operatorët ekonomikë duhet të jenë të pajisur me licencat/lejet të lëshuara nga QKL me kod...III.7.B (Shpues profesionist për ujë)”.

Nga auditimi i preventivit nuk konstatohen zëra punimesh të cilat të kenë lidhje me licencën e mësipërme të kërkuar në DST.

Nëpërmjet postës elektronike nga APP është rekomanduar heqja e kësaj licence, por nga Autoriteti Kontraktor nuk është hequr kjo kërkesë, edhe pse rezulton e pa argumentuar, e pa nevojshme, e pa lidhur me aftësinë zbatuese dhe natyrën e kontratës.

1-Pretendimi i subjektit: Pika 6.Argumentimi i numrit dhe llojit të mjeteve:

1.Kamion vetëshkarkues 18-25 ton kapaciteti mbajtës, copë 4, në pronësi ose me qira.

Sipas preventivit të zbatimit të punimeve sasia e gërmimeve 559 183 m3.

*Afati i grafikut të punimeve 6 muaj , 6 muaj x 21dit/pune ne muaj = 126 dit/pune ton*km/ditë4438*

rruge/dite4

*ton*km rruge/ditë 250*

*ton*km rruge/ditë/ 1 kamion1000,*

Për transportin e 4438 m3 dherash /1000 duhen 4 kamiona.

- *Kamionçina deri 5 ton kapaciteti mbajtës, copë 4 ne distance te 5 km do të përdoren per transportin e materialeve te mbushjes se shtratit te kananaleve dhe mbushjes mbas vendosjes se tubacionit , të materialeve për përgatitjen e betonit dhe llacit si dhe te tubacioneve dhe rakorderive të ndryshme.*

Sipas preventivit të zbatimit të punimeve vetëm sasia e materialit mbushës te kanalit eshte 44264 m3.

Afati i grafikut të punimeve 6 muaj , 6 muaj x 21dit/pune ne muaj = 126 dit/pune

*ton*km/ditë351*

rruge/dite 3

*ton*km rruge/ditë 28*

*ton*km rruge/ditë/ 1kamion 85 , 351/85 = 4 kamionçina.*

- *Argumentimi për mjetet e gërmimit :*

-Ekskavator me zinxhir janë kërkuar 4 cope ,për arsyen se objekti: Ujësjiellësi i fshatit Duhanas, fshati Lapardha 1, Otllak dhe Orizaj shtrihet në dy Njësi Administrative, në katër fshatra apo zona të cilat janë larg nga njëra –tjetra me shumë se 15 km nga volume i punimeve dhe grafiku i përfundimit të punimeve 6 muaj, për realizimin e këtij investimi ,punimet do të kryhen njëkohësisht në të katër zonat, prandaj ne kemi kërkuar nga 1 eskavator per çdo zone punimesh.

- Mini ekskavator për rrugët e ngushta 3 copë, 1 copë zona Lapardha, 1 copë zona Otllak dhe zona Orizaj dhe 1 copë zona që është më larg Zona Duhanas.

-Fadromë me goma 1 copë për punimet e depove.

-Eskavator me goma copë 1, për e skarifikimit dhe përhapjes se çakell-stabilizant, për grupin që do të punojë për rikthimin e rrugëve në gjendjen fillestare.

-Buldozer me goma copë 2, nga 1 copë për çdo punim në depo (Depo e Baterive dhe Depo Duhanas) për skarifikimin dhe përhapjen e çakëllit për rrugët e aksesit.

-Autobetoniere 2 copë, për mos ndërprerjen e procesit të betonimit ne të dy zonat Lapardha dhe Duhanas.

-Motobetniere 4 copë, nga një copë për çdo zonë për punimet e betonit.

- *Argumenti per kerkimin e sondës për shpime horizontale:*

Ky lloj mjete pune është i domosdoshëm pasi në preventive janë parashikuar punime per ndertim mikrotuneli.

5	Kalimi i rruges me Mikrotunel
H.2.5	Ndertim Mikrotuneli me te gjitha aksesoret per kalimin e rruges me tubacion celiku DN150, L=14m

Sonda për shpime vertikale eshte kerkuar per shkak se ne preventive janë parashikuar punime si çarje rruge, trotuari, pusetash etj.

▪ Kriteri jone per fabrike betoni ne pronesi, me qira ose kontrate furnizimi nuk është një kriter i panevojshëm, përderisa në preventivin e punimeve janë parashikuar punime betoni, konkretisht te stacioni i depos si dhe per ndërtimin e pusetave, për më tepër që operatorët të kishin kontrata furnizimi e cila përben një kërkesë minimale për të garantuar kryerjen e punimeve sipas grafikut.

▪ Kriteri për paraqitje nga operatori ekonomik të akt-marrëveshjes/vet deklarim me prodhuesin /distributorin e shitjes, për furnizim me tubo (të specifikuara në preventivin e punimeve) ne rast të shpalljes fitues ne procedurën e prokurimit mjekun ,nuk është vendosur nga specialisti i fushës, pasi nuk ka lidhje me njohërite në fushën e punimeve të ndërtimit, por nga Juristi i Njesise se Prokurimit.

▪ Kriteri për pajisjen e operatorit ekonomik me licencat /leje të lëshuara nga QKL “Shpues profesionistë uji” argument është:

Bazuar ne tipologjinë e punime te ndërtimit për Ujësjellësit e fshatrave dhe zonës informale (kodrinore), per ndërtimin e linjës se ujësjellësve ne këto zona operatori ekonomik duhet te jete i pajisur me kete lloj license per shpues profesionist per përdorim potencial te pusit.

1.Shpuesi profesionist për ujë, që e ushtron veprimtarinë mbi bazë tregtare, duhet të jetë i pajisur me licencën e parashikuar në kategorinë III.7 të shtojcës së ligjit për licencat. Kjo veprimtari licencohet sipas ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë ”, të ndryshuar.

Kemi rreth 50 000 m3 germim për te cilin do të nevojitet makineri si kamiona, eskavator, cekic pneumatic për thyerjen e zonave shkembore, pasi një kamion mund te bëjë 3-4 rrugë në ditë në varësi të pikës së shkarkimit të caktuar ose të vendit ku do të marri materialet inerte, atehere është llogaritur që nevojiten sasia e mësipërme e mjeteve të trenasportit.

Kamioncinat me kapacitet me te vogël nevojiten për transportin e materialeve të ndërtimit si cimento, hekur apo edhe te zhvendosjes se pajisjeve dhe veglave.

Janë rreth 5000 m3 materiale inerte per tu shpërndarë me eskavator, fadroma, drejder minifadroma e minieskavator dhe ngjeshur me rrula, prandaj duke ju referuar manualit teknik te cmimeve, nisur nga oret e punes se nje makinerie na rezulton qe duhen fadroma , eskavatorete dhe rrulat.

Gjithashtu në prevetiv janë parashikuar rreth 1000 m3 beton, për transportin e se cilës janë parashikuar 2 autobetoniere, vibrator betony, pompe betony, fabrike betoni pajsieur me leje mjedisore si dhe kontrate furnizimi me nje fabrike betoni.

Qëndrim i grupit të auditimit:

Në observacionin e bërë jeni shprehur dy herë në mënyra të ndryshme për sasinë e gërmimeve: a) sipas preventivit te zbatimit të punimeve sasia e gërmimeve 559 183 m3ë

b) kemi rreth 50 000 m3 germim për te cilin do të nevojitet makineri si kamiona, eskavator....

Përvec se keni dy të dhëna kontradiktore, nuk keni shpjeguar se cilat janë sipas preventivit (sipas numrave të analizës) zërat e punimeve të gërmimit që përbëjnë këtë sasi që ju pretendoni. Nga auditimi i preventivit konstatohet se zërat e punimeve të gërmimit me krahe dhe makineri përbëjnë një sasi gërmimesh prej 30,778 m3, sipas listës së mëposhtme:

Numri i analizës dhe emërtimi i gërmimit	Sasia në m3
3.89/aB.1.1 Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m ³ , ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet m3	2,559.57

3.45/1B.1.1.1 Germim kanalesh ne toke te zakonshme, me krahe, me seksion deri 0.75 m ² m ³	521.6
3.90/aB.1.1.2 Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m ³ , ne kanale gjeresi deri 2 m, prani uji, kategoria III, me shk ne mjet m ³	2,692.80
3.89/aB.1.1 Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m ³ , ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet m ³	907.17
3.45/1B.1.1.1 Germim kanalesh ne toke te zakonshme, me krahe, me seksion deri 0.75 m ² m ³	100.8
3.89/aB.1.1 Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m ³ , ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet m ³	5.4
3.45/1B.1.1.1 Germim kanalesh ne toke te zakonshme, me krahe, me seksion deri 0.75 m ² m ³	0.6
3.89/aB.1.1 Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m ³ , ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet m ³	2,097.48
3.45/1B.1.1.1 Germim kanalesh ne toke te zakonshme, me krahe, me seksion deri 0.75 m ² m ³	488.92
3.90/aB.1.1.2 Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m ³ , ne kanale gjeresi deri 2 m, prani uji, kategoria III, me shk ne mjet m ³	2,302.80
3.89/aB.1.1 Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m ³ , ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet m ³	1,079.56
3.45/1B.1.1.1 Germim kanalesh ne toke te zakonshme, me krahe, me seksion deri 0.75 m ² m ³	119.95
3.89/aB.1.1 Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m ³ , ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet m ³	8.1
3.45/1B.1.1.1 Germim kanalesh ne toke te zakonshme, me krahe, me seksion deri 0.75 m ² m ³	0.9
3.89/aB.1.1 Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m ³ , ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet m ³	2,186.24
3.45/1B.1.1.1 Germim kanalesh ne toke te zakonshme, me krahe, me seksion deri 0.75 m ² m ³	115.07
3.90/aB.1.1.2 Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m ³ , ne kanale gjeresi deri 2 m, prani uji, kategoria III, me shk ne mjet m ³	848
3.89/aB.1.1 Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m ³ , ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet m ³	6,033.11
3.45/1B.1.1.1 Germim kanalesh ne toke te zakonshme, me krahe, me seksion deri 0.75 m ² m ³	716.12
2.47/an B.1.1.3 Germim shkemb mesatar me çekiç me ekskavator me zinxhir m ³	411.97
3.89/aB.1.1 Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m ³ , ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet m ³	1,031.67
3.45/1B.1.1.1 Germim kanalesh ne toke te zakonshme, me krahe, me seksion deri 0.75 m ² m ³	114.63
3.89/aB.1.1 Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m ³ , ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet m ³	2.7
3.45/1B.1.1.1 Germim kanalesh ne toke te zakonshme, me krahe, me seksion deri 0.75 m ² m ³	0.3
3.89/aB.1.1 Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m ³ , ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet m ³	120
2.5 B1.1.2 Germim e mbushje dheu me krah kategoria III, per themele ,h=1.5 m m ³	45
3.89/aB.1.1 Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m ³ , ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet m ³	72
2.5 B1.1.2 Germim e mbushje dheu me krah kategoria III, per themele ,h=1.5 m m ³	380
3.89/aB.1.1 Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m ³ , ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet m ³	1,705.02
3.45/1B.1.1.1 Germim kanalesh ne toke te zakonshme, me krahe, me seksion deri 0.75 m ² m ³	2,557.54
3.89/aB.1.1 Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m ³ , ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet m ³	621.31
3.45/1B.1.1.1 Germim kanalesh ne toke te zakonshme, me krahe, me seksion deri 0.75 m ² m ³	931.97
Total	30,778.30

Jeni shprehur se një kamion mund të bëjë 3-4 rrugë në ditë pa dhënë shpjegime se si keni dalë në këtë konkluzion, ndërkohë që nga auditimi i preventivit konstatohet se transporti me kamion është nga 5 deri në 10 km (citorj preventivin: a- Transporti i materialit të mbetur nga gërmimet me kamion deri në 10 km; b-Transporti i materialit të mbetur nga gërmimet me kamion deri në 5 km). Sipas pretendimit tuaj, një kamion bënë 3 – 4 rrugë, që duke marrë një mesatare prej 7.5 km distancë përshkrimi, kjo do të thotë se mesatarisht një kamion duhet të përshkojë një rrugë për transportin e mbeturinave prej 30 km, për të cilën nevojitet

mesatarisht 30 minuta. Përderisa distanca e transportit është 5 – 10 km atëherë numri i rrugëve të transportit të një kamioni duhet të jetë shumë më i madh se 3-4 në ditë.

Gjithashtu nuk keni dhënë shpjegime se si e llogaritët sasinë e m³ në ton, pasi kapaciteti i kërkuar i kamionëve është në ton, ndërsa ju nuk keni shpjeguar se sa m³, përbëjnë 18-25 ton që është kapaciteti i një kamioni.

Keni kërkuar 4 kamionçina me kapacitet mbajtës deri deri 5 ton, por nga auditimi i preventivit, nuk ka asnjë zë punimi që të jetë llogaritur për tu kryer me kamionçinë.

Edhe për mjetet e tjera keni dhënë në përgjithësi argumente, por pa bërë llogaritë e nevojshme, sipas manualeve teknike të punimeve.

Keni bërë argumentimin për sondë, i cili lidhet me një zë të caktuar punimesh në preventiv.

Për sa më sipër nuk keni dhënë argumente bindëse për kriteret e tjera teknike, mjetet, paisjet dhe për këtë arsye observacioni juaj nuk merret në konsideratë.

Kriteri: Veprimet dhe mos veprimet e mësipërme në hartimin e kriterëve të veçanta të DST, bien në kundërshtim me kërkesat e nenit 26, pika 5 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe nenin 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ku respektivisht thuhet: (VM 914): neni 26: “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

(LPP, neni 46): Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jo diskriminuese:

b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

Kriteret e vendosura që rezultojnë të pa nevojshme dhe të pa lidhura ma natyrën e kontratës janë gjithashtu diskriminuese, kriteret të cilat kanë efekt në kufizimin e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomik në tender, të vendosura në kundërshtim me nenin 20 të LPP ku përcaktohet: “Autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo kriter, kërkesë apo procedurë, që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, që përbën diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktorëve ose ndaj kategorive të tyre.

Ndikimi: Kufizim i pjesëmarrjes së operatorëve ekonomik në tender.

Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit rregullator në fuqi për hartimin e kriterëve të veçanta të DST.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Berat të analizojë arsyet dhe të nxjerrë përgjegjësitë e anomalive të konstatuara në hartimin e kriterëve të veçanta të DST. Njësia e prokurimit në cdo procedurë të jap argumentim për cdo kriter të veçantë për kualifikim që lidhen me kapacitetin teknik dhe jo vetëm, të vendosur në DST dhe argumentet të dokumentohen me procesverbal.

Për anomali të konstatuara në hartimin e kriterëve të kapacitetit teknik, ngarkohet me përgjegjësi specialiste e fushës, hartuese e këtyre kriterëve, anëtare e njësisë së prokurimeve znj. M. S., me detyrë përgjegjëse e sektorit të pronave dhe strehimit social, për kriteret e mjekut ngarkohet me përgjegjësi anëtare e njësisë së prokurimeve znj. F. A., juriste, me

detyrë specialiste e prokurimeve, ndërsa për kriterin e periudhës së punësimit të punonjësve qershor- tetor 2020, ngarkohet me përgjegjësi znj. A. Zh., ekonomiste, anëtare e njësisë së prokurimeve.

Vlerësimi i ofertave nga KVO

Me urdhrin nr.56, datë 25.11.2020, të të titullarit të AK z. E. D., është ngritur komisioni ivlerësimit të ofertave (KVO), i përbërë nga z. L. B., kryetar, me detyrë N/Kryetar i Bashkisë (arkitekt), si dhe anëtarët z. P. S. me detyrë Drejtor i Drejtorisë Juridike (jurist), znj. E. M., me detyrë specialiste e prokurimeve (ekonomiste).

Në tender ka marrë pjesë vetëm një operatorë ekonomik, BOE R... sh.p.k & 2...ShPK, me vlerë të ofertës ekonomike 365,057,023 lekë, i cili është kualifikuar dhe shpallur fitues, sipas të dhënave të mëposhtme:

Nr	Operatorët pjesëmarrë në tender	Vlera e ofertës pa TVSH	Kualifikimi nga KVO	NIPT
1	R... sh.p.k & 2...ShPK	365,057,023	Kualifikuar, fitues	

Midis dy operatorëve ekonomikë është hartuar kontrata e bashkëpunimit në të cilën është përcaktuar se operatori ekonomik “R...”, ShPK do të kryej 30% të zërave të punimeve të preventivit, ndërsa 2... ShPK, 70% të këtyre zërave.

Gjithashtu është hartuar edhe prokura e posaçme, ku përfaqësues është caktuar shoqëria “R...” ShPK .

Titulli: Kualifikim i operatorit ekonomik i cili nuk plotëson kriteret e vendosura në DST.

Situata: Në kriteret e veçanta të kapacitetit teknik, pika 2.3.10 të DST, është kërkuar që operatori ekonomik të ketë në pronësi ose me qira 4 kamionë vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 18- 25 ton.

Operatori ekonomik 2... ShPK sipas shtojcës nr.10 mbi disponimin e makinerive, ka deklaruar se zotëron 1 kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 ton, mjetin Iveco Magirus. Ky OE ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar në DST vetëm për kamionin e mësipërm.

Bazuar në faktin se operatori ekonomik 2... ShPK do të kryej 70% të zërave të punimeve të preventivit, duhet që të vërtetojë se zotëron 3 kamionë me kapacitet mbajtës 18- 25 ton, por në fakt ka paraqitur dokumentacion vetëm për 1 kamion, duke mos përmbushur kriterin e pikës 2.3.10 të kapacitetit teknik të DST për 2 kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 ton.

Bazuar në kontratën e bashkëpunimit, në të cilën është përcaktuar se OE “R...” ShPK do të kryej 30% të zërave të punimeve të preventivit, duhet që ky operatorë ekonomik të vërtetojë se zotëron 1 kamion me kapacitet mbajtës 18- 25 ton, nga 4 kamion të kërkuar në total.

Operatori ekonomik OE “R...” ShPK sipas shtojcës nr.10, deklarata mbi disponimin e makinerive, ka deklaruar se nuk zotëron në pronësi asnjë kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 ton. Përveç kësaj, nga dokumentacioni i dorëzuar në SPE vërtetohet se OE “R...” ShPK nuk ka paraqitur dokumentacion (leje qarkullimi, siguracion etj.), nëpërmjet të cilit të vërtetojë se zotëron kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 ton.

Por, nëpërmjet shtojcës 10, deklarata mbi disponimin e makinerive, është deklaruar se OE “R...” ShPK ka marrë me qira 4 nga këto mjete me kapacitet mbajtës 18- 25 ton.

Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur konstatohet se për këtë qëllim është lidhur kontrata noteriale me datë 18.12.2020, me numër repertori 2337, në të cilën qiradhënës është

shoqëria “Gj...” ShPK, ndërsa qiramarrës shoqëria “ R...” ShPK. Objekt i kësaj kontrate është dhënia me qira e 4 kamionëve vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 18- 25 ton.

Nga verifikimi i dokumentacionit për të katër kamionat vetëshkarkues me kapacitet 18-25 ton, të marrë me qira nga OE “R...” ShPK, konstatohet se për këto mjete nuk përmbushet kriteri i pikës 2.3.10 të kapacitetit teknik, te seksioni i kriterëve të veçanta të DST, në të cilin është kërkuar që operatori ekonomik “*Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet ...leja e transportit që lëshohet nga njësia vendore*”.

Nga dokumentacioni i paraqitur konstatohet se të katër mjetet e marra me qira janë të pajisur (nga Bashkia Tiranë) me certifikatë për transporte mallrash brenda vendit për llogari të vet. Pra këto mjete, nuk kanë certifikatë për transport mallrash me qira dhe për të tretë dhe për këtë arsye nuk mund të përdoret nga OE “ R...” ShPK, pasi kuadri rregullator në fuqi nuk lejon dhënien e tyre me qira pa këtë certifikatë.

Për sa më sipër, dokumentacioni i katër kamionëve vetëshkarkues me kapacitet 18-25 ton të marrë me qira, nuk plotësojnë kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “*Për transportet rrugore*”, neni 1, 3, 5 dhe Kreut III.1, “*Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë*”, nenet 41 dhe 44, si dhe Kreut III.2, “*Transporti i mallrave për vete*”, nenet 45, 46, dhe 47, bëhet qartësisht ndarja midis këtyre mënyrave të transportit dhe përcaktohet ndalimi i secilës nga mënyrat e transportit pa pajisjen me licencën përkatëse. Konkretisht në ligjin e mësipërm parashikohet si vijon:

Neni 3, paragrafi 3.13 dhe 3.14 të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, i ndryshuar, parashikohet se: 3.13. Transport për vete: transporti i mallrave me kamion, në ardhje ose në kthim, vetëm për llogari të veprimtarisë së vet. Në këtë rast transporti është vetëm një veprimtari ndihmëse e veprimtarisë kryesore, e cila vërtetohet sipas ligjeve në fuqi. 3.14. Transport për të tretë dhe me qira: transporti i mallrave me kamion për persona fizikë a juridikë të tjerë ose dhënia e kamionit me qira.

Neni 41: *Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë është i ndaluar të kryhet pa licencën përkatëse.*

Neni 44: *Llojet e transportit të mallrave me qira dhe për të tretë, të cilat mund të kryhen pa licencë, përcaktohen me udhëzim të veçantë të Ministrisë.*

Gjithashtu dokumentacioni i katër kamionëve vetëshkarkues me kapacitet 18-25 ton të marrë me qira, nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në DST për *lejen e transportit që lëshohet nga njësia vendore*, pasi mungesa e certifikatës për të tretë dhe me qira, vjen në kundërshtim me nenin 11 të udhëzimit nr.15, datë 24.07.2007 "Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor", të ndryshuar udhëzimit nr.11, datë 18.12.2009, ku thuhet:

a) *Në rastin kur një mjet i marrë me qira nuk ndryshon fushën e operimit (për të tretë ose me qira ose për llogari të vet) për të cilën ai është pajisur me certifikatë, ai nuk pajiset me certifikatë të re, për pasojë, mjeti do të operojë me certifikatën e lëshuar për subjektin transportues që e ka dhënë atë me qira.*

b) *Në rastin kur një subjekt transportues për të tretë ose me qira merr me qira një mjet të pajisur me certifikatë për llogari të vet, ai duhet të pajisë mjetin me certifikatë për të tretë ose me qira.*

c) *Një subjekt transportues për llogari të vet mund të marrë me qira një mjet të pajisur me certifikatë për të tretë ose me qira pa qenë nevoja për ta pajisur atë me certifikatë të re.*

Ne vijim paraqiten mjetet e marra me qira dhe certifikata e paraqitur për secilin mjet:

Kamioni, në pronësi të shoqërisë Gj... ShPK. Certifikata 11957/1, datë 15.3.2018 me afat deri më vitin 2024 (Leja e transportit) lëshuar nga Bashkia Tiranë është “Për transport mallrash brenda vendit për llogari të vet”.

Kamioni, në pronësi të shoqërisë Gj... ShPK. Certifikata (Leja e transportit) nr.32522, datë 3.9.2018, me afat deri më vitin 2023 lëshuar nga Bashkia Tiranë është “Për transport mallrash brenda vendit për llogari të vet”.

Kamioni, në pronësi të shoqërisë Gj... ShPK. Certifikata (Leja e transportit) nr.32522/1, datë 3.9.2018, me afat deri më vitin 2023 lëshuar nga Bashkia Tiranë është “Për transport mallrash brenda vendit për llogari të vet”.

Kamioni, në pronësi të shoqërisë Gj... ShPK. Certifikata (Leja e transportit) nr.11957, datë 15.3.2019, me afat deri më vitin 2024 lëshuar nga Bashkia Tiranë është “Për transport mallrash brenda vendit për llogari të vet”.

Për sa më sipër BOE “2... & R...” ShPK nuk përmbush kriterin e pikës 2.3.10 të kapacitetit teknik të DST, në të cilin janë kërkuar 4 kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 ton, pasi operatori ekonomik “2...” ShPK duhet që të vërtetojë se zotëron 3 kamionë me kapacitet mbajtës 18- 25 ton, por në fakt ka paraqitur dokumentacion vetëm për 1 kamion, ndërsa operatori ekonomik “R...” ShPK duhet që të vërtetojë se zotëron 1 kamionë me kapacitet mbajtës 18- 25 ton, por në fakt dokumentacioni i paraqitur prej tij për katër nga këto mjete, nuk është i plotë për asnjë prej tyre, për shkak të mungesës së certifikatës për të tretë ose me qira.

Në pikën 2.3.10 të kapacitetit teknik të DST, është kërkuar eskavator me goma copë 1. Për përmbushjen e këtij kriteri nga operatori ekonomik “2...” ShPK ka paraqitur minieskavator me goma Caterpillar M313D për të cilin është paraqitur deklarata doganore e datës 10.04.2017 dhe foto e mjetit, por nuk është paraqitur leja e qarkullimit; certifikatën e kontrollit teknik; siguracionin; leja e transportit që lëshohet nga njësia vendore.

Nga operatori tjetër ekonomik “R...” ShPK për plotësimin e kriterit për eskavator me goma, është lidhur kontrata noteriale me datë 18.12.2020, me numër repertori 2337, në të cilën qiradhënës është shoqëria “Gj...” ShPK, ndërsa qiramarrës shoqëria “R...” ShPK. Objekt i kësaj kontrate është dhënia me qira e eskavatorit me goma, për të cilin është paraqitur certifikatën e pronësisë; leja e qarkullimit; certifikatën e kontrollit teknik; siguracioni, por nuk është paraqitur leja e transportit që lëshohet nga njësia vendore, duke mos përmbushur kriterin e vendosur në pikën 2.3.10 të kapacitetit teknik të DST. Pra, BOE “2... & R...” ShPK nuk përmbush kriterin e pikës 2.3.10 të kapacitetit teknik të DST, në të cilin është kërkuar 1 mjet eskavator me goma, pasi asnjë nga dy operatorët që kanë krijuar bashkimin e operatorëve ekonomik nuk e plotëson këtë kriter.

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:

Në tenderin me objekt “Ujësjetësi i fshatit Duhanas, fshati Lapardha 1, Otllak dhe Orizaj, Bashkia Berat”, me vlerë të fondit limit 372,286,076 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2020, ka marrë pjesë vetëm një operatorë ekonomik, BOE “2... & R...” ShPK, me vlerë të ofertës ekonomike 365,057,023 lekë pa TVSH, i cili nuk plotëson të gjitha kriteret e veçanta të DST, por është kualifikuar dhe shpallur fitues. KVO nuk duhet të kishte kualifikuar këtë BOE dhe nuk duhet ti kishte propozuar Titullarit të Autoritetit Kontraktor shpalljen e tij fitues. KVO duhet të kishte propozuar anulimin e tenderit.

Kriteri: Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, sipas neneve të mëposhtëm:

- neni 24 “Anulimi i një procedure prokurimi”, pika nr.1, germa (ç), ku thuhet :

*“Autoriteti kontraktor **anulon procedurën e prokurimit** vetëm (ç) nëse asnjë nga ofertat e paraqitura nuk përputhet me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit”*

neni 46 “Kualifikimi i ofertuesve”, pika 1, ku thuhet:

*Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, **duhet të kualifikohen**, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret ..., që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme,*

për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese.

- nenin 53 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3 dhe pika 5 ku thuhet:

“3. Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji. 5. Autoriteti kontraktor nuk e pranon një ofertë: a) kur ofertuesi nuk është i kualifikuar; c) kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit”;

- neni 55, “Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese”, pika 1, germa a, ku thuhet:

“oferta fituese duhet të jetë: a) **oferta që**, në bazë të kërkesave dhe kriterëve të përcaktuara në dokumentet e tenderit, **plotëson kërkesat e objektit të prokurimit me çmimin më të ulët.**

Ndikimi: Veprimet e mësipërme kanë sjellë lidhjen e një kontrate me vlerë 365,057,023 lekë pa TVSH, me një OE i cili nuk plotëson kriteret e vendosura në DST dhe është shpallur fitues në papajtueshmëri me legjislacionin e prokurimit publik.

Shkaku: Mos respektim i kërkesave ligjore lidhur me hartimin e kriterëve të veçanta të DST.

Rëmdësia: e lartë.

Rekomandim: Titullari i AK të analizojë arsyet e anomalive të KVO lidhur me kualifikimin e operatorve ekonomik të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura në DST, të nxjerrë përgjegjësitë dhe të marrë masa që në të ardhmen të eliminohen praktika të tilla nga KVO.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi KVO: z. L. B., kryetar, me detyrë n/kryetar i Bashkisë (arkitekt), si dhe anëtarët z. P. S. me detyrë drejtor i Drejtorisë Juridike (jurist), znj. E. M., me detyrë specialiste e prokurimeve (ekonomiste).

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të raportit përfundimtar të auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacion (për aktet e konstatimit) me shkresën protokolluar në KLSH me nr.55/5 datë 26.04.2022, si dhe nëpërmjet postës elektronike në adresën b...m...@kllsh.org.al datë 22.04.2022, nga z. L. B., z. P. S. dhe znj. E. M., anëtarë të KVO. Gjithashtu “Mbi projektraportin e auditimit”, nga të njëjtët persona si më sipër, nga subjekti i audituar është paraqitur observacion, nëpërmjet postës elektronike në adresën b...m...@kllsh.org.al datë 20.06.2022, protokolluar në KLSH me nr. 55/9 prot, datë 06.06.2022 ku janë shprehur të njëjtat objeksione, si ato të bëra për përmbajtjen e akteve të konstatimit. Në të dy rastet observacionet janë të njëjta, nuk ka argumente shtesë në observacionet e bëra për projektraportin e auditimit. Për të dy rastet, nga subjekti i audituar janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: Në lidhje me konstatimin “Çertifikata e transportit për mjetet autobote dhe 2 mjete autovinç” sqarohet se operatori ekonomik për 2 mjete autobote ka paraqitur kontratë noteriale me nr. 1030 rep dhe 620 kol datë 04.07.2018 të lidhur me z.A. D., shoqëruar edhe me dokumentacionin ligjor të këtij mjete, ku përfshihesh edhe certifikata e transportit sipas kërkesave të kërkuara në DST.

Në zbatim të ligjit nr. 8308 datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, Kreu III, 1, mjete rezultojnë me certifikatën e transportit dhe bazuar në kontratën noteriale të dorëzuar për këto mjete është arritur në konkluzionin që ky operator i plotëson kushtet për t’u kualifikuar. Pra vërtetësia e aktin është konfirmuar nga noteri (noter- këshilltar ligjor për kryerjen e disa veprimeve juridike që me dispozita nuk u janë lënë organeve të tjera shtetërore).

Gjithashtu sqarohet se komisioni i vlerësimit të ofertave në vlerësimin e kësaj pike është mbështetur në kontratën noteriale dhe se zbatimi për pajisjen me certifikatë në zbatim të ligjit nr. 8308 datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore” për transportin e mallrave nuk është

kompetencë e organeve të vetëqeverisjes vendore por e institucioneve të tjera që i ngarkon ligji.

I njejtë qëndrim mbahet edhe për mjetin autovinç, i cili është paraqitur nëpërmjet kontratës noteriale nr. rep. 1516 dhe 723 kol. me datë 10.07.2020. Në zbatim të ligjit nr. 8308 datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, Kreu III, 1, mjeti rezulton me certifikaten e transportit dhe bazuar në kontratën noteriale të dorëzuar për këto mjete është arritur në konkluzionin që ky operator i plotëson kushtet për t’u kualifikuar. Përsa më sipër bazuar në kërkesat në DST ku përcaktohet se “Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit dhe certifikatën e transportit të lëshuar nga bashkia përkatëse”, është arritur në përfundim që këto mjete janë në rregull me kërkesat e vendosura në DST.

Oëndrimi i Grupit të auditimit: Në aktin e konstatimit dhe në këtë material është sqaruar se mjetet e paraqitura nuk plotësojnë një nga kriteret e përcaktuara në DST, që është leja e transportit që lëshohet nga njësia vendore, duke mos përmbushur kriterin e vendosur në pikën 2.3.10 të kapacitetit teknik të DST.

Për arsye se nuk keni paraqitur fakte dhe prova të reja observacioni juaj nuk merret në konsideratë.

2.Mbi zbatimin e procedurave ligjore në tenderin me objekt “Ndërtimi i linjës kryesore dhe shpërndarjes së furnizimit me ujë të Njesisë Administrative Velabisht Bashkia Berat”, me vlerë të fondit limit 131,138,064 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2020”

Afati i zbatimit të kontratës 4 muaj nga data e lidhjes së kontratës. Financimi për 2020-2021-2022

Numri i referencës së procedurës: REF-55654-04-06-2020		
1.Urdhër Prokurimi nr. 20, datë 30.03.2020, nr.1627 prot	3. Njësia e Prokurimit , ngritur me urdhrin nr. 20, datë 30.03.2020: A. Zh., F. K., E. N.	4.Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: Urdhër nr.21, datë 30.03.2020, nr,1627 prot., L. B., E. M., V. K.
2.Lloji i Procedurës së Prokurimit: “Procedurë e hapur”		
5.Fondi Limit (pa TVSh) 131,138,064	6.Oferta fituese: E...A... sh.p.k & V... C... sh.p.k & LL... sh.p.k & E... sh.p.k, me vlerë 129,159,597 lekë pa TVSh	7.Diferenca me fondin limit 1,978,467 (pa TVSh)
8. Data e hapjes së tenderit: 12.05.2020	9.Burimi Financimit: Buxheti i Shtetit	10.Operatoret Ekonomik a)Pjesëmarrës në tender:3 OE b)S’kualifikuar 2 OE c) Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime: AK: Nuk ka patur ankesa		13.Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP:
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
14.Lidhja e kontratës Nr. nr. 2134/6 prot, datë 29.06.2020	15.Vlera e kontratës: 129,159,597 lekë pa TVSh	16. Likuiduar në datën 05.04.2022 vlera 81,414,368 lekë

Hartimi i kriterëve të DST

Me urdhrin e prokurimit nr. 20, datë 30.03.2020 të titullarit të AK z. E. D., është përcaktuar njësia e prokurimit e përbërë nga znj. F. A., juriste, me detyrë specialiste e prokurimeve, znj. A. Zh., ekonomiste, me detyrë specialiste e prokurimeve, znj. E. N. (A.), inxhinierë gjeologe (specialiste e fushës), me detyrë specialiste për planifikimin e territorit dhe regjistrin elektronik.

Urdhri i prokurimit është i pa vulosur në Degën e Thesarit Berat, në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat

standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, “Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike” pika 154 ku përcaktohet: “Kërkesa për shpenzim i drejtohet Nëpunësit Autorizues dhe për dijeni Nëpunësit Zbatues. Në rastet kur kërkesa është e lidhur me një proces blerje apo kryerje shërbimi i dërgohet strukturës përgjegjëse për prokurimet në njësinë shpenzuese. Struktura përgjegjëse për prokurimet kryen kontrollet e nevojshme krahasuese me kërkesat e planifikuara dhe planin e prokurimit të miratuar në procesin e planifikimit të buxhetit. Në rast të kërkesave të reja, të paplanifikuara më parë, kërkohet miratimi paraprak i Nëpunësit Autorizues të njësisë. Në përfundim të procesit njofton Nëpunësin Zbatues të njësisë për urdhrin e prokurimit, i cili autorizohet nga struktura përgjegjëse e Thesarit në degë përpara se të fillojë procesi i prokurimit.”.

Për mos vulosjen e urdhrin të prokurimit në thesar mban përgjegjësi nëpunësi zbatues znj. A. Sh.

Konstatohet se specialisti i fushës znj. E. N., ka formim inxhinier gjeolog, profil i cili nuk përputhet me fushën e objektit të prokurimit, i cili është ndërtim ujësjellësi, aq më tepër që në preventiv nuk ka zëra punimesh që të lidhen me inxhinierin gjeolog. Znj. E. N. për shkak të profilit arsimor nuk ka njohuri të specializuara për objektin e prokurimit, nuk ka pasur eksperiencë të mëparshme në procedurat e prokurimit përsa i përket hartimit të kriterëve dhe nuk ka kryer trajnime për këtë qëllim (sipas deklaramentit verbal të saj).

Në rastin konkret të ndërtimit të ujësjellësit ka qenë e nevojshme që specialisti i fushës të jetë inxhinier hidro dhe inxhinier ndërtimi (për punimet e ndërtimit).

Në këtë rast nga Titullari i Autoritetit Kontraktor z. E. D. është vepruar në kundërshtim me kërkesat e nenit 57, pika 2 të VKM 914, datë 29.12.2014, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, ku thuhet:

Për çdo procedurë prokurimi, në varësi të specifikës së objektit të prokurimit, titullari i autoritetit kontraktor krijon njësinë e prokurimit, në përbërje të së cilës është personi përgjegjës për prokurimin, i caktuar në fillim të vitit dhe të paktën një specialist fushe në rast se kërkohen njohuri të specializuara për objektin e prokurimit. Në raste të tjera, titullari i autoritetit kontraktor cakton në përbërjen e njësisë së prokurimit, përveç personit përgjegjës për prokurimin, një ose disa persona të tjerë, me arsim të lartë.

Urdhri i prokurimit është i pa vulosur në Degën e Thesarit Berat, në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, “Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike” pika 154 ku përcaktohet: “Kërkesa për shpenzim i drejtohet Nëpunësit Autorizues dhe për dijeni Nëpunësit Zbatues. Në rastet kur kërkesa është e lidhur me një proces blerje apo kryerje shërbimi i dërgohet strukturës përgjegjëse për prokurimet në njësinë shpenzuese. Struktura përgjegjëse për prokurimet kryen kontrollet e nevojshme krahasuese me kërkesat e planifikuara dhe planin e prokurimit të miratuar në procesin e planifikimit të buxhetit. Në rast të kërkesave të reja, të paplanifikuara më parë, kërkohet miratimi paraprak i Nëpunësit Autorizues të njësisë. Në përfundim të procesit njofton Nëpunësin Zbatues të njësisë për urdhërin e prokurimit, i cili autorizohet nga struktura përgjegjëse e Thesarit në degë përpara se të fillojë procesi i prokurimit. Kërkesa për shpenzim i drejtohet nëpunësit autorizues dhe për dijeni nëpunësit zbatues”.

Titulli: Mos argumentimi i kriterëve të veçanta për kualifikim të DST që lidhen me kapacitetin teknik, si dhe vendosja e kriterëve të cilat nuk janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, elementë të cilët kanë efekt në kufizimin e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomik

Situata: Nga njësia e prokurimit është hartuar procesverbali nr.1627/1 prot., datë 06.04.2020 (shënuar me laps këto të dhëna) “Për hartimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit. Nga auditimi konstatohet së në procesverbalin e mbajtur nga njësia e prokurimit, nuk është

bërë argumentimi i kriterëve të veçanta për kualifikim të DST që lidhen me kapacitetin teknik, në kundërshtim me kërkesat e pikës 2, neni 61, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, ku thuhet: *Hartimi i kërkesave të veçanta për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret e vlerësimit (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit”.*

- Në pikën 2.3.c të kapacitetit ekonomik dhe financiar të kriterëve të veçanta të DST, është vendosur kriteri që operatorët ekonomik duhet të paraqesin Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me shkrim nga administratori se subjekti ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitet për periudhën vitet, 2018 2019 dhe këstet e maturuara të vitit 2020 sipas afateve të përcaktuara në ligjin 9632/2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. Kësaj deklaratë duhet t’i bashkëngjiten të gjithë vërtetimet që dëshmojnë se operatori ekonomik **ka paguar detyrimet përkatëse**, në vendet ku ka ushtruar apo ushtron aktivitet për këtë periudhë.

Nga auditimi konstatohet se në DST është kërkuar të përmbushen nga operatorët ekonomik dy kriterë për të vërtetuar të njëjtin detyrim:

a) është kërkuar një deklaratë me shkrim nga administratori se subjekti ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore;

b) Kësaj deklaratë duhet t’i bashkëngjiten të gjithë vërtetimet që dëshmojnë se operatori ekonomik ka paguar detyrimet përkatëse.

Është lehtësisht e kuptueshme se kriteri i paraqitjes së deklaratës me shkrim nga administratori se subjekti ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, është kriter **i pa nevojshëm**, i pa argumentuar si nevojë për tu vendosur në DST, sepse ky kriter ka krijuar mbivendosje (dublim) me kriterin tjetër ku është kërkuar **vërtetimet që dëshmojnë se operatori ekonomik ka paguar detyrimet përkatëse. Përderisa janë kërkuar këto vërtetime, deklarata nga administratori nuk sjell asnjë elementë shtesë për AK, pasi vërtetojnë të njëjtin gjë.** Kriteri i paraqitjes së deklaratë me shkrim nga administratori se subjekti ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, rrit në mënyrë artificiale dokumentet e kërkuara prej operatorëve ekonomik, duke jua vështirësuar atyre këtë proces, si dhe është në kundërshtim me. Hartimi i kriterit të mësipërm është në kundërshtim me nenin 46 të LPP, si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, nenin 26 pika 5, dhe nenin 61, pika 2.

Për këtë kriter mbajnë përgjegjësi dy anëtarët e njësisë së prokurimit znj. F. A., juriste, me detyrë specialiste e prokurimeve, znj. A. Zh., ekonomiste.

• Në kriteret e veçanta të DST, pika 2.3.3 të seksionit “Për kapacitetin teknik”, është kërkuar se operatori ekonomik **për të provuar se ka përvojën e duhur** duhet të dëshmojë se ka të punësuar mesatarisht të paktën **170** (njëqind e shtatëdhjetë) punonjës, me kohe të plotë, **për periudhën tetor 2019–mars 2020.**

Nga njësia e prokurimit nuk është bërë argumentimi për numrin e kërkuar prej 170 të punonjësve. Duke parë natyrën dhe tipologjinë e kontratës, konstatohet një numër i konsiderueshëm punonjësish pa përcaktuar profesionin dhe objektin e punës për të gjithë numrin 170.

Jo vetëm numri i punonjësve 170, por edhe kriteri se ofertuesit duhet të dëshmojnë se i kanë të punësuar këta 170 punonjës për **periudhën 6 muajore tetor 2019–mars 2020, është i pa argumentuar në procesverbalin e mbajtur nga njësia e prokurimit, si dhe kriteri i pa nevojshëm. Numri i punonjësve nuk provon përvojën e duhur të mëparshme (si është**

argumentuar në DST vendosja e periudhës mujore), por i shërben realizimit të kontratës. Punonjësit e kërkuar do të marrin pjesë në realizimin e kontratës së ardhshme e cila do të lidhet pas zhvillimit të prokurimit publik dhe për këtë mjafton që OE të vërtetojë qoftë edhe muajin e fundit se ka numrin e nevojshëm të punonjësve të kërkuar. Nuk sjellë asnjë dobi, asnjë ndryshim për autoritetin kontraktor nëse OE vërteton që i ka punonjësit e kërkuar për 6 muajt e fundit, apo vetëm për një muaj. Vendosja e kriterit për afatin 6 mujor, qershor – tetor 2020 është diskriminues, përjashton nga konkurimi operatorë të tjerë ekonomik që mund ti kenë po kaq punonjës por për një periudhë më të vogël kohe. Nuk është vendosur zgjidhje alternative se një pjesë prej punonjësve të kërkuar mund të jenë edhe kontratë pune të përkohshme për kohëzgjatjen e procedurës së prokurimit. Nga APP i është rekomanduar autoritetit kontraktor që operatorët të vërtetojnë numrin e duhur të punonjësve për muajin e fundit, si dhe nuk është e domosdoshme që të gjithë punonjësit të jenë me kohë të plotë në listëpagesë, por kjo nuk është korigjuar nga specialisti i fushës.

Nga njësia e prokurimit (specialisti i fushës) është vendosur afati 6 mujor i ekzistencës së 170 punonjësve në listëpagesën e shoqërisë, nga ana tjetër nuk është shoqëruar ky kriter me argumentim se përse duhet të jetë ky afat 6 mujor, se për çfarë i shërben AK. Operatori ekonomik mund të lidh kontratë edhe përpara zhvillimit të tenderit me një punonjës i cili mund të mos jetë fare i punësuar deri në këtë moment dhe kjo gjë është tërësisht në rregull për realizimin e kontratës për AK, por nuk është parashikuar kjo mundësi jashtë listëpagesës. Janë kërkuar inxhinier mjedisi 2 (dy) (ku te paktën njeri të jete pajisur me certificate lëshuar nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis), 1 specialist për punime ne prani te ujit, por rezulton se zërat e kërkuar të punimeve sipas preventivit nuk parashikojnë llojet e punimeve të cilat të bëjnë të nevojshme kërkesën për punonjësit e mësipërm, dukë e bërë këtë kërkesë të pa nevojshme dhe të pa lidhur ngushtë me objektin e prokurimit.

Kriteri është në kundërshtim me përcaktimet e pikës 1, të nenit 46, të LPP dhe pikës 2, të nenit 26, të VKM nr.914, datë 29.12.2014, që çdo kriter i veçantë duhet të jetë në përputhje me natyrën, aftësinë zbatuese dhe përmasën e kontratës.

- Është kërkuar që Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë të administratorit të shoqërisë si drejtuesit teknik disa inxhinier, midis të cilëve edhe **1 Inxhinier Gjeolog**, por ky profesion nuk ka lidhje me natyrën e zërave të punimeve (ndërkohë që në kërkesën për natyrën e degës së inxhinierëve nuk është kërkuar inxhinieri gjeolog pasi nuk është e nevojshme).

- Nga auditimi i preventivit konstatohet se janë parashikuar punime të natyrës elektrike në seksionin “Ndërtimi i kabinës shtyllore "100 KVA”, por në hartimin e kriterëve të veçanta të DST nuk është kërkuar asnjë specialist i fushës elektrike.

- Është kërkuar që operatori ekonomik duhet të ketë 1 (nje) Specialist ekspert zjarrfikës ne fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin, dëshmuar me kontrata noteriale e punës dhe certifikata përkatëse e dhënë nga Drejtoria MZSH, te figurojnë ne listepagesat e shoqërisë Tetor 2019 – Mars 2020, si dhe dhe 2 (dy) Inspektore Cilësie me background Inxhinierik si Inspektor Cilësie te specializuar per kontrollin e cilësisë se punimeve përputhje me standardet e cilësisë sipas ISO 9001-2015.

Kriteret kualifikues për një specialist ekspert zjarrfikës, përveçse është i pa argumentuar teknikisht në procesverbalin e mbajtur nga njësia e prokurimit, është jo në përputhje me natyrën e kontratës, **i pa nevojshëm.**

Nga auditimi i projektit nuk rezultojnë zëra punimesh të cilat të lidhen me nevojën e specialistit zjarrfikës.

Referuar ligjit nr. 152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”, roli i ekspertit zjarrfikës nuk është në përpjesëtim me natyrën e kontratës, në kuptim të nenit 46, pika 1 të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar. Nga ana tjetër në DST është kërkuar që një nga inxhinierët e kërkuar të jetë i pajisur me certifikatë për

parandalimin dhe mbrojtjen nga zjarri, e cila është e mjaftueshme për zbatimin e rregullave të sigurimit teknik për mbrojtjen nga zjarri.

Referuar ligjit nr. 152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”, neni 39 thuhet:

1. Projekti për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin është pjesë përbërëse e dokumentacionit që kërkohet për lëshimin e lejes së zhvillimit/ndërtimit.

3. Projektimi, ndërtimi, rikonstruksioni dhe vënia në përdorim e veprave dhe strukturave të ndryshme, ndërtesave, rrjetit rrugor, elektrik, ujësjellës-kanalizimeve, pyjeve e kullotave, zonat e mbrojtura etj., bëhen në përputhje me kërkesat e këtij ligji dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.

4. Projektet për të gjitha llojet e ndërtimeve dhe administrimin e zonave të mbrojtura etj., përfshijnë edhe projektin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin“.

Pra mbrojtja nga zjarri është hartuar që në fazën e projektit nga projektuesi dhe është ky i fundit që ka përcaktuar të gjitha detajet teknike që bëjnë të mundur mbrojtjen nga zjarri.

Kriteret kualifikues për 2 (dy) Inspektore Cilësie me background Inxhinierik si Inspektor Cilësie të specializuar për kontrollin e cilësisë së punimeve përputhje me standardet e cilësisë sipas ISO 9001-2015, përveçse është **i pa argumentuar teknikisht** në procesverbalin e mbajtur nga njësia e prokurimit, është jo në përputhje me natyrën e kontratës, **i pa nevojshëm**. Për të marrë garanci se punimet e kontratës do të kryhen me cilësi, njësia e prokurimit ka hartuar kriteret e veçanta të DST. KVO ka kualifikuar dhe shpallur fitues operatorin ekonomik, për arsye se ka krijuar bindjen se OE përmbush plotësisht kriteret e vendosura në DST. Pra kontrata është lidhur me një operatorë të kualifikuar përse i përket kapacitetit teknikisht dhe cdo lloj kapaciteti tjetër. Nga ana tjetër, kontrolli i cilësisë, saktësisë së punimeve nuk bëhet nga vetë kontraktori, por nga autoriteti kontraktor, nëpërmjet mbikëqyrësit të punimeve. Pra nuk mund të jap garanci për cilësinë e punimeve të veta, vetë kontraktori.

- Në pikën 2.3.5 të kapacitetit teknik të kriterëve të veçanta të DST është kërkuar që OE të kenë certifikatë SSH EN 13331-1:2002 (Për veshjen e kanaleve), por nga auditimi i preventivit të punimeve nuk rezultojnë zëra punimesh që të kenë lidhje me nevojën e kësaj certifikatë. Kriter i pa nevojshëm, pa argumentuar teknikisht dhe që nuk ka lidhje me natyrën e kontratës.

- Në pikën 2.3.5 të kapacitetit teknik të kriterëve të veçanta të DST është vendosur kriteri që stafi i drejtuesve teknik i shoqërisë të ketë në përbërje: Inxhinier Ndërtimi 3 (tre), Inxhinier Hidroteknik 3 (tre), Inxhinier Gjeodet 3(tre), Inxhinier Mjedisi 2 (dy) (ku të paktën njeri të jete i pajisur me certifikatë lëshuar nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedisi).

Secili prej pjesëtarëve të drejtuesve teknik të mësipërm, duhet të jetë në listëpagesat të paktën për periudhën tetor 2019 – mars 2020 si dhe të figurojnë në licensën e shoqërisë.

Është trajtuar më lartë se kriteri që stafi i inxhinierëve duhet të jetë në listëpagesat të paktën për periudhën tetor 2019 – mars 2020 është i pa nevojshëm, i pa argumentuar, diskriminues. Sipas këtij kriteri një operatorë ekonomik i cili mund të paraqesë ofertë me një çmim më të ulët se operatorët e tjerë, por nuk e ka stafin e inxhinierëve për të gjithë periudhën e kërkuar, duhet të skualifikohet nga KVO, ndërkohë që domosdoshmëria e periudhës tetor 2019 – mars 2020, nuk lidhet me asnjë argument që ti shërbejë zbatimit të kontratës.

- Është kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar, të vërtetuar me kontratë noteriale pune të vlefshme, urdhër mjeku, diplomë, libereze pune, cv dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë 12 muajt e fundit.

Së pari: Bazuar në Vendimin Nr. 632, datë 15.7.2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 108, datë 9.2.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e

sigurisë dhe të shëndetit në punë”, si dhe bazuar në numrin e punonjësve që është kërkuar në DST, nuk plotësohen kriteret që OE të sigurojnë shërbimin mjekësor në ndërmarrje nëpërmjet mjekut të punës (staf i brendshëm i shoqërisë), por nëpërmjet mjekut të punës të kontraktuar nga jashtë.

Së dyti: Kjo kërkesë nga njësia e prokurimit nuk është argumentuar, nuk ka lidhje me preventivin e punimeve, me natyrën e kontratës, kriteri i pa nevojshëm. Kriteri është në kundërshtim me përcaktimet e pikës 1, të nenit 46, të LPP dhe pikës 2, të nenit 26, të VKM nr.914, datë 29.12.2014, që çdo kriter i veçantë duhet të jetë në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës. Nuk ka element të kontratës që të bëjnë të jetë e nevojshme kërkesa për mjek. Autoriteti kontraktor nuk mund të kërkojë që operatorët ekonomik ti vërtetojnë se plotësojnë çdo detyrim që ata kanë për funksionimin e tyre si shoqëri private. Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë vetëm plotësimin e kriterëve që kanë lidhje me zbatimin e kontratës. Organizimi i shërbimit mjekësor nga operatorët ekonomik është një çështje që ju përket atyre dhe organeve të tjera kontrolluese të këtij elementi (Inspektorati i Punës etj.) dhe jo çështje e verifikimit nga autoritetit kontraktor, përderisa mjeku nuk lidhet me natyrën e kontratës, që do të thotë me elementët e punimeve të preventivit.

Numri 170 i punonjësve të kërkuar është i pa argumentuar dhe nuk përkon me shumën e punonjësve të kërkuar për secilin pozicion pune të përshkruar në DST.

Numri i punonjësve të nevojshëm në tender del si shumatore e numrit të punonjësve të kërkuar në DST për secilin pozicion pune, ku përcaktohet dhe detyra që do të kryej punonjësi. Nga auditimi i DST konstatohet se është përcaktuar pozicion pune për 34 punonjës sipas pozicioneve të punës si vijon:

Nr	Profesioni/pozicioni I punës	Numri i punonjësve të kërkuar
1	Inxhinier	10
2	Mjek	1
	Teknik ndërtimi	3
	Automakinist	4
3	Buldozeriste	3
4	Eskavatoriste	9
	Shoferë	8
	Hidraulik	5
	Mekanik	2
	Hekurkthyes	2
5	Muratorë	5
	Hekurkthyes	2
	Specialist per punime ne prani te ujit	1
	Specialist montim tubash hdpe	1
6	Karpentier	4
7	Saldator	4
	Specialist ekspert zjarrefikes	1
	Inspektore Cilesie	2
	Shuma	67

Nga sa më sipër, sipas përshkrimit që është bërë në DST sipas pozicioneve të punës së punonjëse, numri i tyre del 67 punonjës, nga 170 të kërkuar në total. Diferenca prej 103 punonjës nuk ka përshkrime në DST se çfarë pune do të kryejnë gjatë zbatimit të kontratës.

Në pikën 2.3.5 të kapacitetit teknik të kriterëve të veçanta të DST është kërkuar që operatori ekonomik duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës. Kërkohen të jenë në dispozicion këto mjete pune sipas tabelës në vijim:

Lloji i Makinerive	Pronësia	Sasia
Kamiona vetshkarkues me kapacitet mbi 18 ton	në pronësi ose me qira	Cope 4

Kamiona vetshkarkues min 7.5-18 ton	në pronësi ose me qira	Cope 6
Kamioncina vetshkarkues min 1.5-5 ton	në pronësi ose me qira	Cope 5
Autovinc	në pronësi ose me qira	Cope 3
Autobitumatrice	në pronësi ose me qira	Cope 1
Autobot uji	në pronësi ose me qira	Copë 2
Autobetoniere	në pronësi ose me qira	Copë 2
Autopompe betoni	në pronësi ose me qira	Copë 2
Motobetoniere kantieri 1.5-3 m3	në pronësi ose me qira	Cope 2
Pompa uji	në pronësi ose me qira	Cope 2
Fadroma me goma	në pronësi ose me qira	Copë 2
Minifadrome	në pronësi ose me qira	Cope 1
Ekskavator me goma	në pronësi ose me qira	Copë 2
Ekskavator me zinxhir	në pronësi ose me qira	Copë 4
Cekic pneumatik per thyerjen e betoneve	në pronësi ose me qira	Cope 1
Mini ekskavator	në pronësi ose me qira	Copë 1
Trancher	nëpronësiose me qira	Copë 1
Motogjenerator,gjenerator	në pronësi ose me qira	Cope 2
Saldatrice, motosaldatrice	në pronësi ose me qira	Cope 2
Sharre per prejirje tuba betoni	në pronësi ose me qira	Cope 1
Aparatura per bashkim tubacionesh me metoden “Elektro Fusion Joint” PE nga DN 25- DN 315	në pronësi ose me qira	Cope 2
Aparature bashkimi nyje dhe ne zona te vecanta me “Elektrofuzion”	në pronësi ose me qira	Cope 2
Kompresor ajri	në pronësi ose me qira	Cope 2
Tokmak	në pronësi ose me qira	Cope 1
Grejder	në pronësi ose me qira	Copë 1
Rul me kompresor	në pronësi ose me qira	Copë 1
Rrul ngjeshes 5 ton	në pronësi ose me qira	Cope 1
Asfaltoshtrues	në pronësi ose me qira	Copë 1
Matrapik	në pronësi ose me qira	Copë 2
Rimorkiator per levizjen e mjeteve	në pronësi ose me qira	Copë 1
Nyje thyerje materiale inerte e pajisur me leje mjedisore	në pronësi ose me qira	Copë 1
Fabrike Asfalti pajisur me leje mjedisore	në pronësi ose me qira/ kontrate furnizimi	Copë 1
Fabrike Betoni pajisur me leje mjedisore	në pronësi ose me qira/kontrata furnizimi	Copë 1
Pompe stacionere per hedhje betoni (shoqeruar me foto)	nëpronësiose me qira	Copë 1
Sistem Ëellpoint/ekuivalent per heqje ujrash (shoqeruar me foto)	Në pronësi ose me qira	Copë 1

Konstatohet se është kërkuar nyje thyerje materiale inerte e pajisur me leje mjedisore, në pronësi ose me qira, pa përfshirë opsionin e kontratës së furnizimit.

Kërkesat për nyje thyerje materiale inerte e pajisur me leje mjedisore, fabrike asfalti pajisur me leje mjedisore në pronësi ose me qira/ kontrate furnizimi, fabrike betoni pajisur me leje mjedisore në pronësi ose me qira/ kontrate furnizimi, **janë kërkesa të pa nevojshme të cilat nuk ka në lidhje me përmasat dhe natyrën e kontratës**, pasi nuk justifikohen me volumin e vogël të natyrës së punimeve me të cilën lidhen kërkesat e mësipërme. Përveç sa më sipër për çështjen e sigurimit të betonit janë kërkuar edhe dy autobetoniere.

- Në pikën 2.3.5 të kapacitetit teknik të kriterëve të vecanta të DST është kërkuar që operatori ekonomik: Per fabrikën e asfalto betonit bazuar ne VKM Nr 628 date 15.07.2015 nga koha e prodhimit, transportit, shtrimit nuk duhet qe te kaloje me shume se 2 ore.

Vendosja e këtij kriteri të pa nevojshëm është i pa argumentuar ligjërisht dhe teknikisht. Autoriteti kontraktor ka për detyrë të kërkojë që betoni i cili do të sillet të jetë brenda parametrave të duhur dhe këto parametra AK duhet ti kontrollojë që të jenë sipas kërkesave që ka përcaktuar, por nuk ka të drejtë të përcaktojë vendndodhjen e fabrikës së asfalto betonit, pasi operatorët ekonomik kanë mjete dhe teknologji nëpërmjet së cilës arrijnë ta sjellin materialin e kërkuar nga distanca më të mëdha dhe brenda parametrave të duhur.

Në procesverbalin e mbajtur nga njësia e prokurimit nuk është bërë argumentimi teknik i nevojës për llojin dhe numrin e secilës makineri të kërkuar. Numri i makinerive të kërkuara nuk është argumentuar në procesverbalin e mbajtur për hartimin e kriterëve të DST. Çdo makineri e vendosur duhej të argumentohej në lidhje me volumin e punimeve, orët e punës, grafikun e punimeve.

Nuk është argumentuar nevoja për numrin e kamionëve vetëshkarkues. Në DST janë kërkuar gjithsej 10 copë kamionë vetëshkarkues dhe 5 copë kamionçina me kapacitete te ndryshme si: 4 kamionë vetëshkarkues me kapacitet mbi 18 ton, 6 kamionë vetëshkarkues me kapacitet mbajtës minimumi 7.5-18 ton, kamionçina vetëshkarkuese me kapacitet mbajtës minimumi 1.5-5 ton. Konstatohet një numër i lartë i **kamionëve vetëshkarkues dhe të kamionçinave**, ndërkohë që objekti i prokurimit nuk e justifikon, pasi pjesa më e madhe e dheut që del nga gërmimet do të përdoret përsëri për mbulimin e tubacioneve.

Për anomali të e konstatuara në hartimin e kriterëve të kapacitetit teknik, ngarkohet me përgjegjësi znj. F. A., juriste, me detyrë specialiste e prokurimeve, znj. A. Zh., ekonomiste, me detyrë specialiste e prokurimeve, znj. E. N. (A.), inxhinierë gjeologe (specialiste e fushës), me detyrë specialiste për planifikimin e territorit dhe regjistrin elektronik (secili anëtar i nësisë së prokurimit ka përgjegjësi për natyrën e kriterit që lidhet me fushën profesionale të tij).

Kriteri: Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me kërkesat e nenit 26, pika 5 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe nenin 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ku respektivisht thuhet: (VM 914): neni 26: “*Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.*

(LPP, neni 46): *Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese:*

b) *aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.*

Të gjitha kriteret e vendosura që rezultojnë të pa nevojshme dhe të pa lidhura ma natyrën dhe madhësinë e kontratës janë gjithashtu diskriminuese, kriteret të cilat kanë efekt në kufizimin e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomik në tender, të vendosura në kundërshtim me nenin 20 të LPP ku përcaktohet: “Autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo kriter, kërkesë apo procedurë, që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, që përbën diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktorëve ose ndaj kategorive të tyre”.

Ndikimi: Kufizim në pjesëmarrjen e operatorve ekonomik dhe ulje e konkurrencës

Rendësia: E lartë

Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Berat të analizojë arsyet dhe të nxjerrë përgjegjësitë e anomalive të konstatuara në hartimin e kriterëve të veçanta të DST. Njësia e prokurimit në cdo procedurë të jap argumentim për cdo kriter të veçantë për kualifikim që lidhen me kapacitetin teknik dhe jo vetëm, të vendosur në DST dhe argumentet të dokumentohen me procesverbal.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të raportit përfundimtar të auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacion (për aktet e konstatimit) me shkresën protokolluar në KLSH me nr.55/5 datë 26.04.2022, si dhe nëpërmjet postës elektronike në adresën b...m...@klsh.org.al datë 22.04.2022, nga znj. A. Zh., znj. F. K. (A.), znj. E. N. (A.), anëtare të njësisë së prokurimit. Gjithashtu “Mbi projektraportin e auditimit”, nga të njëjtët persona si më sipër, nga subjekti i audituar është paraqitur observacion nëpërmjet postës elektronike në adresën b...m...@klsh.org.al datë 20.06.2022, protokolluar në KLSH me nr.55/9 prot, datë 06.06.2022, ku janë shprehur të njëjtat objeksione, si ato të bëra për përmbajtjen e akteve të konstatimit. Në të dy rastet observacionet janë të njëjta, nuk ka argumente shtesë në observacionet e bëra për projektraportin e auditimit. Për të dy rastet, nga subjekti i audituar janë shprehur objeksionet si më poshtë:

1: Në lidhje me konstatimin në pikën 2.3.3. të kapacitetit teknik të DST është kërkuar që operatori ekonomik për te provuar se ka përvojën e duhur duhet te dëshmoje se ka punësuar mesatarisht të paktën 170 (njëqinde e shtatëdhjetë) punonjës me kohë të plotë për periudhën tetor 2019-mars 2020. Numri i punonjesve dhe qendrueshmeria e tyre ne pune me kohezgjatje tetor – Mars 2020 eshte gjykuar se tregon bazueshmeri per autoritetin kontraktor. Kerkesa per kohe te plote siguron autoritetin kontraktor qe subjekti paguan sigurimet shoqerore per te pakten pagen baze per fuqine punetore duke siguruar qendrueshmeri te fuqise punetore. Pavaresisht nga ditet e punes qe realizon ne muaj nje punetor sipas ligjit 7703 date 11.5.1993, "Per sigurimet shoqerore ne Republiken e Shqiperise", te ndryshuar, neni 10 pagesa per sigurimet shoqerore behet per te gjithë muajin dhe llogaritet mbi pagen bruto. Shume subjekte regjistrojne punetor per 1 ose dy dite pune dhe i deklarojne perseri ne fillim te cdo muaj duke rritur fiktivisht numrin e fuqise punetore. Po te krahasosh FDP real me FDP e llogaritur me kohe te plote kupton numrin mesatar te punonjesve.

Zbatimi i projektit është zhvilluar në periudhën e pandemisë dhe parashikimi për numrin e punonjësve active nuk mund të ishte I mundur plotësisht, pasi një pjesë përfitonin pa aftësi për pune për shkak të pandemisë Covid-19. Ky arsyetim të con drejt kërkesës për fuqi punëtore krahu potencialisht reserve. Linjat e shpërndarjes se furnizimit me tuba Ø 90, Ø 63, Ø 50 janë shtruar në terrene rrugicash të ngushta gje që pamundëson hapësirën e manovrimit të mjeteve të automatizuara dhe kanalet në pjesën me te madhe do hapeshin me punëtorë krahu (sikur edhe ka ndodhur).

Për të hapur linja për shkak të hapësirës se ngushtë të rrugicave nuk mund të punonin me shumë se nje grup me tre punëtore krahu.

Terreni i hapjes me punëtore krahu ka qene kryesisht shkëmbor, gjë qe rrit shkallën e vështorisë dhe rendimentin e punës për hapjen e kanalit. Duke mbajtur parasysh periudhën e shkurtër për realizimin e projektit kërkoheshin mbi 20-30 grupe pune me nga 2-3 punëtore për hapjen e trasesë së kanalit.

2: Në lidhje me konstatimin për Inxhinier Gjeolog sqarojmë se: Linjat e shpërndarjes janë shtruar në kanale të thella të hapura në terren shkëmbor të paqëndrueshme dhe me punëtore krahu, ishte i nevojshëm monitorimi pa ndërprerje i rrezikut të shembjes se shtresave. Ndërtimi i linjës puseta ura e Salillarit-depo grumbulluese, një pjesë kalon në trupin e digës të një baseni ujëmbledhës aktiv ndërtuar rreth viteve 1960. Trupi i digës është i ndërtuar me material vendi (pa mirëmbajtur vitet e fundit) dhe gjatë ndërtimit të linjës se re mund të

shembej duke krijuar katastrofe humane te papare. Në këto kushte duhet me doemos prezenca e një ing. gjoelog për të monitoruar gjatë zbatimit të këtij detaji.

3: Në lidhje me konstatimet për specialist zjarrfikës duhet mbajtur parasysh se përgjatë ndërtimit të linjës magjistrale të furnizimit (puseta) Ura e Salillarit depo grumbulluese-Velabisht dhe Linja Gorica-Velabisht aktualisht ndodhen 3 karburante aktive për furnizim automjete me hidrokarbure dhe GLP me nje risk të lartë pasi agjistrali kalonte shumë afer (për shkak të rrugëve të ngushta mund t'ja demonstroni me foto) linjave të furnizimit nga depo karburanti te automati furnizimit, nga depo te puseta e furnizimit te karburantit etj. Ndertimi i linjës depo Velabisht-Velabisht kalon pranë trasesë se TAP dhe duhej të monitorohej non stop shtrimi i linjës.

4: Në lidhje me konstatimet për inxhinierin e mjedisit sqarojmë se: Kërkesa e autoritetit kontraktor mbi përcaktimin e inxhinierit të mjedisit, është e bazuar në dispozitat ligjore përkatëse mbi ndërtimet dhe prokurimet. Zotërimi i pikave të licencës së shoqërisë (referuar kategorive të punimeve) për punimet e parashikuara në kontratën objekt prokurimi, që në rastin konkret përkon me N.P-12 A referuar në Kreun III, pika 1 të VKM-së nr. 42, datë 16.01.2008, ku pëcaktohet qartë se: “Licenca është dokument juridik e profesional, që i jep të drejtë disponuesit të saj të ushtrojë veprimtari të caktuar, sipas kategorive të punimeve të zbatimit, duke u mbështetur në profilin e diplomës universitare të individëve që punësohen në rolin e drejtuesit teknik të shoqërisë”, dikton qartësisht se zotërimi i kategorive të punimeve të zbatimit në licencat e shoqërive të ndërtimit, mbështetet në profilin e diplomës universitare të individëve që punësohen në rolin e drejtuesit teknik të shoqërisë, çka rrjedhimisht sjell se, për kategorinë e punimeve N.P. 12, të kërkohet inxhinierin e mjedisit te punësuar, i cili i zotëron ato. Kërkesa sa më sipër e autoritetit kontraktor per inxhinierin e mjedisit është e lidhur ngushtësisht me kategoritë e licencës se kërkua dhe është e nevojshme për realizimin me sukses të punës, për sa kohë që ajo është në përpjesëtim dhe e lidhur ngushtë me objektin e kontratës. Gjithashtu ujësjellësi është ndërtuar pranë dhe përgjatë rrjedhës se mesme te lumit Osum me një ekositem të zhvilluar dhe te mbrojtur si habitet. Dhe kjo kërkon prezencen e specialistit te mjedisit gjatë kohës së zbatimit të projektit.

5: Në lidhje me konstatimet për inxhinieret hidroteknike sqarojmë se: Zbatimi i projektit është zhvilluar në periudhën e pandemisë dhe parashikimi për numrin e inxhinierëve nuk mund të ishte i mundur plotësisht, pasi një pjesë përfitonin pa aftësi për pune për shkak të pandemisë Covid-19. Ky arsyetim të con drejt kërkesës për inxhinier hidroteknik potencialisht reserve. Gjithashtu projekti i zbatimit zhvillohej për një periudhë 4 mujore në tre komponente:

a. Shtimi i magjistralit ne dy drejtime 8250 m/l

b. Ndërtim i depos 500 m³

c. Shtrimi i linjave të shpërndarjes 18 793.4 m/l se bashku me pusetat e kolektoreve.

Këto tre komponente janë zhvilluar në mënyrë të pavarur në të njëjtën kohë gjë kërkonte prezencën e tre drejtuesve te specializuar në objekt.

6: Në lidhje me konstatimet për specialistët e kontrollit të materialeve duhet mbajtur parasysh se: Për shkak të rëndësisë se veprës dhe kompleksitetit të saj u kërkua të kishte me shumë se një filtër kontrolli për materialet e përdorura përveç filtrit të mbikëqyrësit dhe kolaudatorit. Në mungesë të specialistëve të tillë nga ana e UK Berat kjo gjë ju kërkua ta plotësonte sipërmarrësi më specialist të licensuar në DST. Prezenca e inxhinierit mekanik kishte të bënte me montimin e agregatëve në depon grumbulluese, në difektimin e mjeteve të ndërtimit dhe sigurisë se punës së tyre në objekt pasi ndërtimi i linjave bëhej në zona të ngushta të tej populluara me mjedise social-kulturore ne to si shkolla, kopshte etj aksesim i te cilave nga fëmijët dhe prindërit ishte shume pranë trasesë të shtrimit të linjave dhe automjeteve te ndërtimit.

7: Në lidhje me konstatimet për certifikatën SSH EN 13331-1:2002 (për veshjen e kanaleve) sqarojmë se ndërtimi i projektit do të realizohesh në një zone rurale dhe afer kanaleve të cilat ndodhet afer rrugës ku do të realizoheshin zërat e punimeve. Për këtë gjë nevojitesh që subjektet të ishin të specializuara edhe në rastet kur do të ishte e nevojshme ndërhyrja në këto kanale.

8: Në lidhje me konstatimet në pikën 2.3.5 të kapacitetit teknik në DST sqarojmë se:

Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale të shoqërisë i është kërkuar personeli i nevojshëm inxhinieri referuar zërave të preventivit të objektit për realizimin e kontratës në mbështetje të germës "b", të pikës 1 të nenit 46 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për "Prokurimin publik", i ndryshuar, ku përcaktohet se: "operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën" si dhe të nenit 44 pika 1 e Ligjit Nr 9643 për "Prokurimin Publik" ku përcaktohet se: "Në rastet e kontratave publike për shërbime apo punë si dhe të kontratave publike të furnizimit për shërbime shtesë dhe /ose veprimtari instalimi Autoritetet Kontraktore mund t'u kërkojnë personave juridikë të paraqesin në ofertë ose në kërkesën për pjesëmarrje emrat dhe kualifikimet profesionale përkatëse të personelit përgjegjës për zbatimin e kontratës në fjalë". Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij drejtues teknik. Dokumentacioni plotësues i kërkuar në kriteret e veçanta për kualifikim pjesë përbërëse e dokumenteve të tenderit sikundër janë kontratë pune e vlefshme, Cv apo qenësia e tyre në listpagesat e shoqërisë, janë vendosur për arsye se me paraqitjen e këtij dokumentacioni vërtetohet se këta drejtues teknikë apo punonjës janë operativë pranë Ofertuesve të mundshëm dhe në këtë mënyrë Autoriteti Kontraktor krijon bindjen se Operatorët ekonomikë pjesëmarrës zotërojnë personelin e nevojshëm për realizimin me sukses të objektit që prokurohet.

Gjithashtu në reference të frymës së ligjit për prokurimin publik dhe konkretisht të nenit 46/1/b, i cili përcakton se ofertuesit dhe rrjedhimisht fituesi i mundshëm, vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën është kërkuar një mjek bazuar në:

Në VKM nr. 742, datë 6.11.2003 "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.692, datë 13.12.2001 të Këshillit të Ministrave "Për masat e veçanta të sigurimit dhe të mbrojtjes së shëndetit në punë" është përcaktuar: "2/1. Punëdhënësi siguron funksionimin e shërbimit mjekësor, nëpërmjet mjekut të ndërmarrjes, në të gjitha subjektet që ushtrojnë veprimtari prodhuese, private ose shtetërore, vendase ose të huaja, juridike ose fizike. 2/2. Mjekët e ndërmarrjes pajisen me licencë profesionale nga Ministria e Shëndetësisë, në përputhje me vendimin nr.500, datë 23.11.1992 të Këshillit të Ministrave "Për dhënien e licencave për ushtrimin e profesionit në fushën e mjekësisë, në profesion të lirë privat", i ndryshuar. 2/3. Mjekët e ndërmarrjes merren në punë si nëpunës të ndërmarrjes dhe varen drejtpërdrejt nga punëdhënësi. Punëdhënësi e njeh mjekun me detyrat e shërbimit shëndetësor të ndërmarrjes dhe kërkon zbatimin e tyre, sipas legjislacionit të punës. Marrëdhëniet ndërmjet punëdhënësit dhe mjekut të ndërmarrjes përcaktohen në bazë të kontratës së punës që lidhin palët, në përputhje me legjislacionin në fuqi. [...] "12/1. Marrja në punë e mjekut është e detyrueshme për të gjitha subjektet, veprimtaria e të cilave klasifikohet sipas vendimeve nr.459, datë 22.7.1998 "Për substancat e rrezikshme", nr.419, datë 4.8.2000 "Për objektet e rrezikshme" dhe nr.207, datë 9.5.2002 "Për përcaktimin e punëve të vështira ose të rrezikshme" të Këshillit të Ministrave, pavarësisht nga numri i të punësuarve. 12/2. Për subjektet që nuk përfshihen në pikën 12/1 të këtij vendimi, marrja në punë e mjekut të ndërmarrjes është e detyrueshme për ato ndërmarrje, ku numri i të punësuarve është jo më pak se 15 punonjës.

12/3. Mjeku i ndërmarrjes mban përgjegjësi sipas ligjit për pasojat, që mund të vijnë nga moszbatimi i detyrave të përcaktuara sipas pikës 2/4 të këtij vendimi[...]. III.1.5. Referuar kriterit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor për disponimin nga ana e operatorëve ekonomikë të një mjeku në stafin e tyre teknik është plotësisht i mbështetur në aktet ligjore dhe siguron kontrollin shëndetësor në punë të punëmarrësve.

9: Në lidhje me mjetet e kërkuara nga ana jonë si fabrikë betoni, një thyerje material inerte, janë kërkuar për arsye të uljes së kostos, pasi këto mjete janë kërkuar në të gjitha format e lejueshme të legjislacionit në fuqi, ose në pronësi ose me një kontratë që të vërtetohet që kjo kontratë do të realizohet pa hasur vështirësi në zbatim për gjetjen e materialeve. Në të gjitha format edhe pse nuk është shkruar kontratë furnizimi nënkuptohet që mjaftueshëm një marrëveshje me një operator që ka në pronësi ose me qira këto mjete. Një formë tjetër që lehtësisht të realizohet ky kriter është ajo e bashkëpunimit ekonomik me një nga këto firmat që kanë këto mjete. Bazuar dhe në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006. "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, neni 46/b ku citohet se: "Aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës".

Te gjitha pikat e inerteve, fabrikave të betonit, fabrikat e asfaltit janë të detyruara të pasijen me licenca dhe leje mjedisore të tipit III.1.B si dhe dokumentacion që vërteton pronësinë dhe vendndodhjen (shtrirjen) e këtyre subjekteve. Autoriteti Kontraktor kërkon që të kenë marrëveshje vetëm me subjektet që janë 100% në përputhje me legjislacionin në fuqi. Për këtë arsye kërkohet që në çdo rast si në pronësi ashtu dhe me qira nyjet e inerteve, fabrikave e asfalto betonit të jene të pajisura me licenca dhe leje mjedisore të vlefshme që tregojnë aktivitet të ligjshëm.

Përsa i përket mjeteve të kërkuara janë kërkuar ato mjete që janë të nevojshme për zbatimin e kontratës në përputhje me preventivin dhe grafikun e kësaj procedure. Për kamionët dhe rrulat të cilat janë të domosdoshëm për natyrën e punimeve pasi kemi të bëjmë me gërmime dhe transport dhe si dhe rrulat për kapacitet nga me i madhi deri tek i vogli për ngjeshjen e shtresave të rrugës. Për mjetet e tjera duke mos kufizuar tonazhin, litrat, etj u kemi ardhur në ndihmë çdo operatori ekonomik pasi mendojmë që vendosja e saive kufizuese do të pengonte operatorët ekonomik që kanë në pronësi ose kanë më lehtë të gjejnë me qira një Autobot uji sesa një Autobot uji 5.5t nëse do shpreheshim në mënyrë formale në tonazh, e kështu me radhë për çdo mjet të kërkuar nga ana jonë. Kriter i vendosur nga ana jonë në përputhje me VKM nr. 914 datë 10.01.2007, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, neni 26, pika 8/c.

Kriteri i mësipërm është vendosur edhe në përputhje me parashikimet e nenin 26 pika 8 germa "c" të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" të ndryshuar, ku parashikohet se "Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon: c) dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Makinerite e mësipërme janë kërkuar në proporcion me kompleksitetin dhe volumet e punes që përmban preventivi i punimeve. Janë mjete të domosdoshme për realizimin e punimeve në kohe dhe afatin e përcaktuar në dokumentat standarde të tenderit.

Qëndrim i grupit të auditimit: Për sa trajtoni në observacion keni argumentuar nevojën për inxhinier mekanik. Për kundërshtitë e tjera nuk keni dhënë argumente teknike, fakte dhe prova të reja dhe për këtë arsye nuk merren në konsideratë. Argumentimi për anomalitë në

hartimin e kriterëve të DST nga audituesi janë bërë në aktin e konstatimit dhe është bërë pjesë edhe e këtij materiali. Ajo që ju kundërshtoni në observacion, janë argumentuar në aktin e konstatimit dhe për të mos krijuar përsëritje, nuk po i rishkruajmë (referohu më lartë rubrikës “Hartimi i DST”.

Vlerësimi i ofertave nga KVO

Me urdhrin nr.21, datë 30.03.2020, të të titullarit të AK z. E. D., është ngritur komisioni i vlerësimit të ofertave (KVO), i përbërë nga z. L. B., kryetar, me detyrë N/Kryetar i Bashkisë (arkitekt), si dhe anëtarët znj E. M., me detyrë specialiste e prokurimeve (ekonomiste), znj. V. K., me detyrë specialiste për monitorimin e investimeve dhe regjistrin elektronik. Në tender kanë marrë pjesë tre operatorë ekonomik, dy prej të cilëve janë skualifikuar, ndërsa BOE E...A... & V...C... & LL... & E...sh.p.k, me vlerë të ofertës ekonomike 129,159,597 lekë është kualifikuar dhe shpallur fitues, sipas të dhënave të mëposhtme:

Nr	Operatorët pjesëmarrë në tender	Vlera e ofertës pa TVSH	Kualifikimi nga KVO	NIPT
1	T... B... sh.p.k	111,023,814	S'kualifikuar	
2	K... sh.p.k	127,409,037	S'kualifikuar	
3	E...A... & V...C... & LL... & E... sh.p.k	129,159,597	Kualifikuar, fitues	

Arsyet e skualifikimit nga KVO të operatorit ekonomik “T... B...” ShPK

1.Mungon Deklarata mbi garantimin e zbatueshmerise se dispozitave ligjore ne marrëdhëniet e punës Shtojca8/1.

Nga auditimi konstatohet: Në listën e shtojcave të DST kjo deklaratë nuk është pjesë përbërëse e shtojcave

2.Ne Deklaratën e Kriterëve të Përgjithshme të Pranim/Kualifikimit nuk është vendosur emri i personit të anëtarit të organit administrative, aksioner ose ortak.

Kjo deklaratë nuk është kërkuar në DST. Megjithatë OE ka shënuar me vizë se nuk ka të tillë

3.Mungon deklarata me shkrim nga Administratori se subjekti ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore. Konsiderohet devijim i vogël, madje është një deklaratë e pa nevojshme sepse në DST është kërkuar që OE të paraqesin vërtetim që dëshmojnë se operatori ekonomik **ka paguar detyrimet përkatëse** për taksat dhe tarifat vendore në vendet ku ka ushtruar apo ushtron aktivitet për këtë periudhë. Këtë vërtetim OE e ka paraqitur dhe Autoriteti Kontraktor ka marrë siguri maksimale se operatori ekonomik nuk ka mangësi, problematikë për këtë kriter. Nëse për të njëjtin kriter kërkohen dy dokumente, të cilët edhe së bashku edhe të veçuar, vërtetojnë njësoj plotësimin e kriterit, atëherë nuk mund të vlerësohet mos plotësimi i kriterit mungesa e deklaratës, kur janë paraqitur vërtetimet që detyrimet janë paguar.

4.Nuk ka realizuar vlerën për punët e ngjashme në sektorin shtetëror dhe privat sipas objektit të prokurimit

5.Mungon licenca e shoqërisë NP 7.D Ujësjellës, vajsjelles, vepra kullimi e vaditje, N.S 9.A Punime Strukturore speciale, N.S 16.B Ndërtim i impianteve të ujit të pijshëm dhe pastrimit të tij.

Nga auditimi konstatohet se licencat e mësipërme mungojnë.

6.Mungon Licenca QKL III.2.B “Grumbullim, Transportim, Ruajtje, e mbetjeve Urbane”

Nga auditimi konstatohet se licenca e mësipërme mungon.

7. Mungojnë Liste-pagesat për periudhën Tetor 2019-Mars 2020 dhe deshmia mbi nr e punonjesve të pakten 170 punonjes dhe vërtetimi i leshuar nga Administrata Tatimore.

8. Mungesa te inxhinierave te kerkuar dhe dokumentave vertetues te tyre
9. Mjeku z. F. N. i mungon Libreza e Punes dhe CV.
10. Mungon stafi i punonjesve te kerkuar dhe dokumentat vertetues.
11. Mungon Deklarata e Administratorit te Shoqerise per Drejtuesit Teknik.
12. Mungon Specialisti ekspert zjarrfikes ne fushen e mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimin.
13. Mungojne dy inspektore cilesie me background Inxhnierik si Inspektor Cilesie.
14. Mungon OHSAS 45001:2018 Sistemi I menaxhimit dhe Sigurise ne Pune, ISO 3834-2:2006 Kerkesat e cilesise per saldimit e materialeve metalike, SSH EN 13331-1:2002 Per veshjen e kanaleve dhe ISO 1452-1:2009 Sistemet e tubacioneve plastike per furnizimin me uje.
15. Ka mungesa ne mjetet dhe paisjet e nevojshme
16. Mungon certifikata per mjetet qe transportojne mallra te rrezikshme
17. Mungon Deklarata me shkrim nga Administratori mbi vendndodhjen e mjeteve
18. Mungon Deklarata nga Administratori qe merr persiper me shpenzimet e veta mbi verifikimin e mjeteve perpara shpalljes se klasifikimit.
19. Mungojne dokumentacioni per vertetimin e Fabrikes se Betonit, Asfaltit dhe nyjet e inerteve ne pronesi ose me qera
20. Mungon Deklarata nga Administratori qe AK rezervon te drejten te verifikoje dhe kontrolloje ne cdo kohe deri ne perfundimin e kontrates mjetet e paisjet teknike te deklaruar sipas Shtojces nr.10
21. Mungon Deklarata nga Administratori qe dokumentat ne tender jane te sakta dhe nuk permbajne informacion te rreme.
22. Mungon grafiku i punimeve.

Nga auditimi konstatohet se mungon grafiku i punimeve

Arsyet e skualifikimit nga KVO të operatorit ekonomik “K...” ShPK

- 1.Nuk realizon xhiron e 3 viteve
- 2.Mungon deklarata me shkrim nga Administratori se subjekti ka paguar te gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore.
- 3.Nuk ka realizuar vleren per punet e ngjashme ne sektorin shteteror dhe privat sipas objektit te prokurimit
- 4.Mungon ne Licencen e Shoqerise NP 7.D Ujesjellesa, vajsjellesa, vepra kullimi e vaditje, N.P.11.A , N.S 9.A Punime Strukturore special, N.S 16.B Ndertim i impianteve te ujit te pijshem dhe pastrimit te tij.

Nga auditimi konstatohet se licencat e mësipërme mungojnë

- 5.Mungon Licenca QKL III.2.B “Grrumbullim, Transportim, Ruajtje e mbetjeve Urbane”.

Nga auditimi konstatohet se licenca e mësipërme mungon

- 6.Mungojne Liste-pagesat per periudhen Janar -Mars 2020 dhe deshmia mbi nr e punonjesve te pakten 170 punonjes dhe vertetimi i leshuar nga Administrata Tatimore.
- 7.Mungesa te inxhinierave te kerkuar dhe dokumentave vertetues te tyre
- 8.Mjeku z. B. Xh. i mungon Urdheri i Mjekut, Libreza e Punes dhe CV.
- 9.Mungon stafi i punonjesve te kerkuar dhe dokumentat vertetues.
- 10.Mungon Specialisti ekspert zjarrfikes ne fushen e mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimin.
- 11.Mungojne dy inspektore cilesie me background Inxhnierik si Inspektor Cilesie.
- 12.Mungojne certifikatat ISO të kerkuara.

Nga auditimi konstatohet certifikatat e mësipërme mungojnë

- 13.Ka mungesa ne mjetet dhe paisjet e nevojshme
- 14.Mungon certifikata per mjetet qe transportojne mallra te rrezikshme
- 15.Mungon Deklarata me shkrim nga Administratori mbi vendndodhjen e mjeteve

16.Mungon Deklarata nga Administratori qe merr persiper me shpenzimet e veta mbi verifikimin e mjeteve perpara shpalljes se klasifikimit.

17.Mungon Deklarata nga Administratori qe AK rezervon te drejten te verifikoje dhe kontrolloje ne cdo kohe deri ne perfundimin e kontrates mjetet e paisjet teknike te deklaruar sipas Shtojces nr.10

18.Mungon Deklarata nga Administratori qe dokumentat ne tender jane te sakta dhe nuk permbajne informacion te rreme.

Mbi kualifikimi nga KVO të bashkimit të operatorit ekonomik (BOE) E...A... & V...C... & Ll... & E...ShPK

Në datën 11.5.2020 është hartuar kontrata e posaçme ku është përcaktuar OE E...A... si përfaqësues i BOE, si dhe marrëveshja e përkohshme e bashkëpunimit në të cilën pjesëmarrja në përqindje është përcaktuar:

“E...” ShPK do të kontribuojë në masën 41%,

“E...A...” ShPK 40%,

“V... K...” ShPK 10%,

“Ll...” ShPK 9%. Në marrëveshje është përcaktuar që secila palë merr përsipër të realizojë sipas preventivit me indekset përkatëse, zërat e punimeve sipas preventivit dhe përvojës së secilës kompani. Përqindja në pjesëmarrje përfshin fuqinë punëtore, paisjet, kapacitetin financiar, nga secila shoqëri.

Nuk u konstatuan mangësi në plotësimin e kriterëve nga BOE fitues.

3.Mbi zbatimin e procedurave ligjore në tenderin me objekt “Blerje mjet zjarrfikës për MZSH”, me vlerë të fondit limit 9,247,500 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2019”.

Kohëzgjatja e kontrates, 21 dite nga nënshkrimi i kontrates

Numri i referencës së procedurës: REF-34652-08-30-2019		
1.Urdhër Prokurimi nr.44, datë 27.8.2019, nr.4404 prot.	3. Njësia e Prokurimit, ngritur me urdhrin nr.44, datë 27.8.2019, nr.4404 prot.: F. K., Rr. D., F. D.	4.Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: Urdhër nr.43, datë 27.8.2019, nr.4403 prot.,: A. Zh., G. B., L. B.
2.Lloji i Procedurës së Prokurimit: “Procedurë e hapur”		
5.Fondi Limit 9,247,500 lekë (pa TVSh)	6.Oferta fituese: T... sh.p.k, me vlerë 8,480,000 lekë pa TVSh	7.Diferenca me fondin limit 767,500 (pa TVSh)
8. Data e hapjes së tenderit: 02.10.2019	9.Burimi Financimit: Bashkefinancim midis Bashkise Berat dhe Ambasades Japoneze (projekti i financimit nga GGP)	10.Operatoret Ekonomik a)Pjesëmarrës në tender:7 OE b)S’kualifikuar 2 OE c) Kualifikuar 5 OE
11.Ankimime: AK: me nr 5233 Prot ,date 11.10.2019, ka marre pergjigje me shkresen Nr 5233/3 date 18.10.2019	APP: Jo	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP: Jo
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
14.Lidhja e kontratës	15.Vlera e kontratës: 10,176,000 leke me TVSh	16. Likuiduar vlera 10,176,000 lekë me TVSh

Fondi 9,247,500 është donacion i Qeverisë Japoneze. Me VKB nr.140, datë 7.12.2018 është miratuar vlera prej 2,200,000 lekë për mbulimin e kostove lokale TVSH .

Hartimi i kriterëve të DST

Me urdhrin e prokurimit nr.44, datë 27.8.2019, nr.4404 prot., të titullarit të AK z. E. D., është përcaktuar njësia e prokurimit e përbërë nga znj. F. K. (A.) juriste, me detyrë specialiste e prokurimeve, znj. Rr. D., ekonomiste, me detyrë ish specialiste e prokurimeve, aktualisht

specialiste ne sektorin e taksave dhe tarifave vendore, z. F. D., inxhinier mekanik, me detyrë përgjegjëse i sektorit mekanik në Agjencinë e Shërbimeve Publike.

Urdhri i prokurimit është i pa vulosur në Degën e Thesarit Berat, në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, “Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike” pika 154 ku përcaktohet: “*Kërkesa për shpenzim i drejtohet Nëpunësit Autorizues dhe për dijeni Nëpunësit Zbatues. Në rastet kur kërkesa është e lidhur me një proces blerje apo kryerje shërbimi i dërgohet strukturës përgjegjëse për prokurimet në njësinë shpenzuese. Struktura përgjegjëse për prokurimet kryen kontrollin e nevojshme krahasues me kërkesat e planifikuara dhe planin e prokurimit të miratuar në procesin e planifikimit të buxhetit. Në rast të kërkesave të reja, të paplanifikuara më parë, kërkohet miratimi paraprak i Nëpunësit Autorizues të njësisë. Në përfundim të procesit njofton Nëpunësin Zbatues të njësisë për urdhërin e prokurimit, i cili autorizohet nga struktura përgjegjëse e Thesarit në degë përpara se të fillojë procesi i prokurimit.”.*

Për mos vulosjen e urdhrin të prokurimit në thesar mban përgjegjësi zëpunësi zbatues znj. L. B., e cila ka ushtruar këtë detyrë prej 01.01.2019 - 25.03.2020.

Titulli: Mos argumentimi i kriterëve të veçanta për kualifikim të DST që lidhen me kapacitetin teknik, si dhe vendosja e kriterëve të cilët nuk janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, elementë të cilët kanë efekt në kufizimin e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomik.

Situata: Nga auditimi i kriterëve të veçanta të DST u konstatua se:

- Në pikën nr.2 të kriterëve të veçanta të kualifikimit është hartuar kriteri që operatorët ekonomik duhet të paraqesin “Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore vitin 2018,2019 sipas vendndodhjes se ushtrimit te veprimtarisë ne QKB”. Formulimi i këtij kriteri nuk është i plotë, pasi është kufizuar në një hapësirë kohore dy vjeçare, duke lënë pa përfshirë periudhën përpara vitit 2018 (detyrime të prapambetura në vite, nëse do të ketë nga operatorët). Gjithashtu viti buxhetor 2019 është ende i pa mbyllur dhe për vetë tipologjia e mënyrës së pagesës me këste të detyrimeve vjetore, bënë që pagesa e këstit të fundit mund të jetë gjatë muajve të parë të vitit pasardhës, që do të thotë se operatori ekonomik edhe pse është në përputhje me paketën fiskale, nuk i ka shlyer ende të gjitha detyrimet e vitit. Rekomandohet që në hartimin e këtij kriteri të mos përmendet periudhë kohore, por të kërkohet që operatorët ekonomik të paraqesin dokumentacion nëpërmjet të cilit të vërtetojnë se **nuk kanë detyrime për taksat dhe tarifat vendore ndaj njësisë vendore ku kanë kryer aktivitet** (vërtetim i cili mund të jetë brenda një periudhe 1-2 mujore përpara zhvillimit të tenderit). Ky paragraf nuk nënkupton një kriter të formuluar, por një orientim për mënyrën e formulimit të tij (Për analogji mund ti referoheni kriterit për pagesën e energjisë elektrike).

- Në shtojcën 10 të DST, në specifikimet teknike të mjetit që do të prokurohet, në lidhje me origjinën e mjetit, njësia e prokurimit ka përcaktuar se: “*Mjeti te jetë **prodhim perëndimor***” Vendosja e origjinës së mjetit në specifikimet teknike, është në kundërshtim me nenin 23/5 të LPP, ku parashikohet se: “Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, **origjinë specifike**, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “**ose ekuivalent**” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime”.

- Në seksionin 2.3 të kapacitetit teknik, pika 1.b, është vendosur kriteri se “*Operatori duhet te paraqesë një deklaratë garancie për një periudhe 1 vjeçare për defekte te paparashikuara për mjetin, në të cilën të jenë të përcaktuara qartë të gjitha kushtet e garancisë teknike të*

mjetit. Operatori duhet te paraqesë deklaratë se garanton servis të specializuar për riparimin e mjetit objekt prokurimi gjate periudhës se garancisë duke deklaruar dhe emrat e serviseve.

Nga sa më sipër konstatohet se njësia e prokurimit ka vendosur kriterin se në deklaratën e garancisë të jenë të përcaktuara qartë të gjitha kushtet e garancisë teknike të mjetit, por nga auditimi i DST, konstatohet se nuk janë parashikuar se çfarë kriteri përfshihet në kushtet e garancisë teknike të mjetit. Që operatori ekonomik të jap deklaratë se plotëson disa kushte/kritere, duhet më parë që këto kushte/kritere të jenë përcaktuar në DST. Një mangësi e tillë në DST vështirëson vendimmarrjen e KVO dhe lë hapësira për interpretime të ndryshme gjatë vlerësimit të ofertave. Mos përcaktimi i kriterëve të cilat përbëjnë kushtet e garancisë teknike të mjetit, është në kundërshtim me kërkesat e nenit 27, pika 3 ku thuhet: “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP-së”.

Në seksionin 2.3 të kapacitetit teknik, pika 1.b, të DST, është vendosur kriteri se: “*Operatori duhet te paraqesë deklaratë se garanton servis të specializuar për riparimin e mjetit objekt prokurimi gjate periudhës se garancisë duke deklaruar dhe emrat e serviseve*”, konstatohet kriter i pa argumentuar teknikisht dhe ligjërish. Periudha e garancisë përfshin detyrimin e operatorit ekonomik se për defektet për të cilat janë përgjegjësi e tij, që kanë ekzistuar përpara lidhjes së kontratës (defektet e fshehura etj). Kjo është përcaktuar në DST, pra rrisku i paraqitjes së defekteve për periudhën e garancisë është transferuar të operatori ekonomik furnizues/fitues. Kjo garanci është e mjaftueshme për Autoritetin Kontraktor.

Ky kriter është i pa argumentuar teknikisht dhe ligjërish, përtej nevojave reale të AK dhe nuk është në përpjesëtim dhe i lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese të kontratës. Operatori ekonomik ka për detyrim të përgjigjet për periudhën e garancisë për defekte të mundshme, por jo detyrimin e përcaktimit të serviseve në momentin e hartimit të DST. Edhe nëse jepet kjo deklaratë nga OE, ajo është e njëanshme, pra nuk ka miratimin e servisit dhe për këtë arsye nuk i jep asnjë garanci shtesë AK. Ky kriter nuk ka lidhje me aftësinë teknike të operatorit ekonomik për zbatimin e kontratës.

Kriteri: Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me kërkesat e nenit 27, pika 3 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe nenin 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ku respektivisht thuhet: (VM 914): Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.

(LPP): Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese:

b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

Pra, si shprehet edhe më lartë LPP, aftësia teknike ka të bëjë me aftësinë teknike të vetë operatorit ekonomik ofertues për realizimin e kontratës dhe jo me aftësinë teknike të serviseve (se në bashkëpunim me operatorin, marin angazhimin për riparimin e mjetit në rast difekti).

Bazuar në VKM 914, datë 2.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 61, ku përcaktohet se “*Hartimi i kërkesave të veçanta për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret e vlerësimit (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit*”, **për anomalitë e mësipërme, ngarkohet me përgjegjësi specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit z.**

F. D., inxhinier mekanik, me detyrë përgjegjës i sektorit mekanik në Agjencinë e Shërbimeve Publike.

Përsa i përket formulimit për kriterin e pagesës së taksave dhe tarifave vendore, duke gjykuar se nga njësia e prokurimit është arsyetuar se detyrimet për vitet e mëparshme konsiderohet të shlyera, nuk e konsiderojmë si anomali, por theksojmë nevojën e përmirësimit në formulim të këtij kriteri në të ardhmen.

Ndikimi: Kufizim i pjesëmarrjes së operatorve ekonomik dhe ulje e konkurrencës.

Shkaku: Mos respektim i kërkesave ligjore për hartimin e kriterëve të veçanta të DST.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Berat të analizojë arsyet dhe të nxjerrë përgjegjësitë e anomalive të konstatuara në hartimin e kriterëve të veçanta të DST. Njësia e prokurimit në cdo procedurë të jap argumentim për cdo kriter të veçantë për kualifikim që lidhen me kapacitetin teknik dhe jo vetëm, të vendosur në DST dhe argumentet të dokumentohen me procesverbal.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të raportit përfundimtar të auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacion (për aktet e konstatimit) me shkresën protokolluar në KLSH me nr.55/5 datë 26.04.2022, si dhe nëpërmjet postës elektronike në adresën b...m...@klesh.org.al datë 22.04.2022, nga znj. F. K., znj. Rr. D., z. F. D., anëtare të njësisë së prokurimit. Gjithashtu “Mbi projektraportin e auditimit”, nga të njëjtët persona si më sipër, nga subjekti i audituar është paraqitur observacion, nëpërmjet postës elektronike në adresën b...m...@klesh.org.al datë 20.06.2022, protokolluar në KLSH me nr.55/9 prot, datë 06.06.202, ku janë shprehur të njëjtat objeksione, si ato të bëra për përmbajtjen e akteve të konstatimit. Në të dy rastet observacionet janë të njëjta, nuk ka argumente shtesë në observacionet e bëra për projektraportin e auditimit. Për të dy rastet, nga subjekti i audituar janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: Së pari: Në lidhje me konstatimin në pikë 10 të DST është përcaktuar që mjeti të jetë “Mjeti të jetë prodhim perëndimor” sqarojmë se: Fondet të cilat do të zhvillohesh kjo procedurë prokurimi kanë qenë nga donator, konkretisht Ambasada Japoneze. Për këtë Bashkia Berat ka nënshkruar një kontratë granti me Ambasadën Japoneze, ku dhe janë zhvilluar takime për përmbushjen me sukses të këtij projekti. Theksojmë se gjatë zhvillimit të takimeve donator ka orientuar dhe ka vene si kusht kryesor që gjatë zhvillimit të procedurën të përcaktohesh që mjeti të ishte prodhim perëndimor. Në këto kushte autoriteti kontraktor Bashkia Berat ka respektuar kushtet e vendosura nga donatori në lidhje me mjetin pasi në kontratën e gratit është përcaktuar që donator ka të drejtën për të kërkuar një rimbursim nëse përfituesi shkel kontratën. Për mos të shkelur kontratën autoriteti kontraktor ka zbatuar kushtet e vendosura nga donatori Ambasada Japoneze.

Gjithashtu theksojmë se termi “prodhim perëndimor” nuk është as marke, as patente as emër dhe as vizatim dhe nuk bie në kundërshtim me nenin 25/5 të LPP.

Qëndrim i grupit të auditimit: Çdo procedurë prokurimi që zhvillohet në sistemin e prokurimit elektronik, pavarësisht burimit të financimit, i nënshtrohet rregullave të prokurimit publik. Termi “Prodhim perëndimor”, është përcaktim që përfshin shumë emra brenda dhe detyron KVO që në rast se një operatorë oferton me një mjet jo prodhim perëndimor, por që plotëson kriteret dhe specifikimet teknike të vendosura në DST, ta s’kualifikojë këtë operatorë. Janë specifikimet teknike dhe kriteret ato që përcakton AK. Fabrika e prodhimit mund të jetë nga cdo vend i mundshëm që prodhon mjetin e kërkuar. Çdo negociim me një donator, AK e bënë duke ju përmbajtur rregullave të prokurimit publik.

Për arsye se nuk keni fakte dhe prova të reja, kundërshtitë tuaja për këtë çështje nuk merren në konsideratë.

Pretendim i subjektit: *Së dyti:* Në lidhje me konstatimet në pikën 2.3 të DST të kapacitetit teknik, pika 1.b ku është vendosur “Operatori duhet të paraqesë një deklaratë garancie për një periudhë 1 vjeçare për defekte të paparashikuara për mjetin, në të cilën të jenë të përcaktuara qartë të gjitha kushtet e garancisë teknike të mjetit” dhe “Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë se garanton servis të specializuar për riparimin e mjetit objekt prokurimi gjatë periudhës së garancisë duke deklaruar dhe emrat e serviseve” sqarojmë se: Këto dy kërkesë të vendosura në DST kanë trajtën e një deklaratë që garanton autoritetin kontraktor në përmbushjen me sukses të kontratës. Nuk janë dy kritere në kapërcim të LPP dhe në kundërshtim por thjesht dy deklarata që të gjithë ofertuesit duhet ti plotësojnë në momentin e paraqitjes së ofertës së tyre. Në lidhje me deklaratën e garancisë theksojmë se mjeti është i tipit zjarrfikës, që është në shërbim 24 orë dhe në gatishmëri për çdo rast emergjent. Duke marrë në konsideratë të gjitha këto është gjykuar se ofertuesit duke të paraqesin deklaratën e garancisë shoqëruar kjo me kushtet teknike të këtij mjeti, me qëllim përmbushjen në një kohë sa më të shpejt dhe efikase nga ana e operatorit fitues që do të shpallej.

Edhe në lidhje me pikën e servisit është gjykuar që nëpërmjet një deklaratë ofertuesit të deklaronin që janë të gatshëm për të riparuar mjetin tek ai servis që do të deklaronin dhe qëllim kryesor i kësaj pike ka qenë vetëm përmbushja me sukses e kontratës nga ana e këtij të fundit. Këto dy kritere nuk ndikojnë aspak në zhvillimin e procedurës dhe në ofertuesit e mundshëm do të paraqisnin ofertat e tyre. Për më tepër në lidhje me këto nuk na janë sugjeruar për ndryshim/riformulim. Përsa përmendem më sipër sqarojmë se këto dy pika nuk janë vendosur në kundërshtim me nenin 27, pika 3 e VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar por janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Qëndrim i grupit të auditimit: Ju nuk keni dhënë argumente të mbështetura në bazë ligjore për kriterin e vendosur në DST lidhur me mos përcaktimi i kritereve të cilat përbëjnë kushtet e garancisë teknike të mjetit dhe deklaratë nga OE se garanton servis të specializuar për riparimin e mjetit objekt prokurimi gjatë periudhës së garancisë duke deklaruar dhe emrat e serviseve”.

Për arsye se nuk keni fakte dhe prova të reja observacioni juaj për këtë çështje nuk merret në konsideratë.

Vlerësimi i ofertave

Me urdhrin nr. 43, datë 27.8.2019 të titullarit të AK z. E. D. është përcaktuar komisioni i vlerësimit të ofertave i përbërë nga znj. A. Zh., ekonomiste, me detyrë specialiste e prokurimeve z. G. B., me detyrë ish specialist i prokurimeve, ndërprerë marrëdhëniet e punës me urdhrin n.80, datë 26.12.2019, z. L. B., me detyrë n/kryetar i Bashkisë Berat.

KVO në datën 15.11.2019 ka hartuar raportin përmbledhës në të cilin ka dokumentuar kualifikimin dhe skualifikimin e operatorëve ekonomik.

Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 7 operatorë ekonomik, prej të cilëve 2 janë skualifikuar dhe 5 janë kualifikuar. Nga operatorët e kualifikuar është shpallur fitues operatori ekonomik “T...” ShPK, me vlerën e ofertës ekonomike 8,480,000 lekë, e cila është vlera më e ulët nga ofertat e kualifikuara, sipas të dhënave në tabelën e mëposhtme:

Nr	Operatorët pjesëmarrës në tender	Vlera e ofertës pa TVSH	Vlerësimi nga KVO	NIPT
1	A... G... ShPK	6,950,000	S’kualifikuar	
2	R...K... ShPK	7,800,000	S’kualifikuar	
3	T... ShPK	8,480,000	Kualifikuar, fitues	

4	K...C... ShPK	8,800,000	Kualifikuar	
5	S... & C... C... ShPK	8,840,000	Kualifikuar	
6	S... 32 ShPK	8,887,000	Kualifikuar	
7	L... Sh.P.K	8,970,000	Kualifikuar	

Arsyet e skualifikimit nga KVO të Operatorit ekonomik "A... G..." ShPK:

• **Konstatim i KVO:** Kontrata e porosis faqja e parë që përmban specifikimet teknike të mjetit vitin e prodhimit, kilometrat dhe të tjera nuk është e vulosur nga noteri për të vërtetuar origjinalitetin e saj tek pjesët e kërkuara nga autoriteti kontraktor.

Nga auditimi konstatohet se operatori ekonomik "A... G..." ShPK ka hartuar kontratën e porosisë me shoqërinë A... K... H... I... E... (Gjermai) në të cilën specifikimet teknike si viti prodhimit, kilometrat, kambio, depozitë uji etj., rezultojnë të jenë të njëjta me ato të përcaktuara në DST. Kontrata e porosisë e hartuar në shqip, është e përkthyer nga përkthyes i njohur nga Ministria e Drejtësisë dhe është e noterizuar. Në aktin noterial përcaktohet: "...Vërtetohet firma e përkthyesit...i cili përktheu nga gjuha shqipe në gjermanisht dokumentin bashkëlidhur, e nënshkroi para meje dhe unë noteria e vërtetojë këtë akt me autenticitetin e nënshkrimit sipas ligjit nr.110, datë 20.12.2018".

Kontrata e porosisë në gjuhën shqipe është e njëjtë me kontratën e porosisë në gjuhën gjermane dhe kjo është vërtetuar nga përkthyesi me dokument origjinal (noteri, i cili vërteton firmën e përkthyesit). **Në gjuhën shqipe të gjitha faqet e kontratës së porosisë janë të vulosura dhe firmosura nga përkthyesi, si dhe kanë vulën e noterit.** Dokumenti të cilin shqyrton KVO është dokumenti në gjuhën shqipe (sepse për këtë qëllim është përkthyer) dhe jo dokumenti në gjuhën gjermane, i cili shërben për dy shoqëritë që kanë lidhur kontratën e porosisë. Pra për përmbajtjen e njëjtë të kontratës së porosisë në gjuhën shqipe dhe të së njëjtës kontratë të shprehur në gjuhën gjermane, shprehet përkthyesi dhe jo noteri.

Mungesa e vulës së noterit në faqen e parë të kontratës së porosisë në gjuhën gjermane (faqet e tjera të saj janë të vulosura), nuk përbën asnjë dyshim për të vërtetuar origjinalitetin e saj, sepse si u tha, kjo është vërtetuar nga përkthyesi te kontrata në gjuhën shqipe, të cilën duhet të merte në shqyrtim KVO. Dokumenti në gjuhë të huaj mund edhe të mos ishte ngarkuar fare në dokumentet e operatorit ekonomik dhe kjo nuk përbën mangësi të dokumentacionit. Pra si të jetë ngarkuar në sistemin elektronik të APP, dokumenti në gjuhë të huaj, si të mos jetë ngarkuar, dokumenti që duhet të marrë në shqyrtim KVO është ai në gjuhën shqipe.

Për sa më sipër pretendimi i KVO se Kontrata e porosis (në gjuhën gjermane), faqja e parë që përmban specifikimet teknike të mjetit vitin e prodhimit, kilometrat etj., nuk është e vulosur nga noteri për të vërtetuar origjinalitetin e saj tek pjesët e kërkuara nga autoriteti kontraktor, nuk qëndron.

KVO nuk ka mbajtur të njëjtin standard për shqyrtimin e dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik i shpallur fitues "T...", ShPK: Kontrata e porosisë e hartuar midis shoqërisë "T..." ShPK me administratore A. P. dhe shoqërisë "Y... B... M... L... S..." përfaqësuar nga administratori Sh. P., është e firmosur vetëm në faqen e fundit të saj, ndërsa faqet e tjera janë të pa firmosura dhe të pa vulosura nga palët, por në këtë rastë, KVO e ka quajtur të rregullt dokumentin.

- **Konstatim i KVO:** Mungojnë aparat prerës hidraulik i cili përdoret në raste të aksidenteve automobilistike 1 cope kompresor vaji, jastëk të ndryshëm ajri, litar të ndryshëm, barela, kuti të ndihmës së parë, leva të ndryshme për hapje konstruksionesh, aparat frymëmarrje të kompletuar me bombolat dhe maskat AP3, jo me pak se 6 cope, Tubo thithëse secila 20 ml, te përshtatshme për pompën, Tubo për luftimin e zjarrit 50 mm (diametri) i standardit evropian me gjatësi secili 20ml, gjithsej 200ml, te përshtatur për pompën, Tupo për luftimin e zjarrit 70 mm (diametri) i standardit evropian me gjatësi secili 20 ml linear, gjithsej 200ml, të përshtatur për pompën Tubat të jenë të pajisur me lidhëset përkatëse në të dy krahët

(standardit evropian), Degëzues të ndryshëm me 3 dhe 4 dalje, hedhëse uji 500 mm të ndryshme (kompakte, pulverizuese) gjithsej 10 cope. Hedhëse shkume të ndryshme 5 cope. Shkallë të ndryshme duralumini, çelësa për shtrëngimin e hedhëseve kërkuar ne shtojcën 10 nuk ka ndonjë dokumentacion (fatur) që i disponon këto pjesë.

Nga auditimi konstatohet se të gjitha paisjet e mësipërme janë pjesë përbërëse e mjetit zjarrfikës, pra ato nuk mund të veçohen nga mjeti e për to të vërtetohet më vete se ekzistojnë brenda mjetit. Mjeti zjarrfikës i ka këto paisje pjesë integrale të tij, për të realizuar qëllimin për të cilin është prodhuar që nga fabrika. Këto paisje nuk blihen më vete (përveçse kur dëmtohen). Pra një mjet zjarrfikës në tërësinë e vetë i përmban këto pjesë. Pretendimi i KVO se nuk ka dokumentacion (faturë) për të vërtetuar se disponon se ka blerë këto pjesë të qenësishme të mjetit zjarrfikës, nuk qëndron dhe është ekuivalente sikur të KVO të shprehet se nuk ka dokumentacion (faturë) që vërteton ka blerë goma, apo sirenë e të tjera të kësaj natyre për mjetin.

Nga operatori ekonomik “A...G...” ShPK është plotësuar deklarata për specifikimet teknike, sipas shtojcës nr.10 të DST, në të cilën përshkruhen specifikimet teknike sipas “A... G...” ShPK, të njëjta me ato të kërkuara në DST, si dhe deklarata mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas shtojcës nr.6, ku deklarohet se operatori përmbush të gjitha specifikimet teknike të kërkuara në DST nga Autoriteti Kontraktor.

Gjithashtu pretendimi i KVO nuk qëndron edhe për arsyet si vijon:

a- Në DST është përcaktuar se: “Autoriteti Kontraktor sqaron se OE i shpallur fitues ka 21 ditë kohe për të sjell mjetin pranë Bashkisë Berat, të kontrollohet fizikisht nëse është sipas specifikimeve të vendosura në DST ose jo, në momentin e dorëzimit mjeti duhet të jete i pajisur me dokumentet përkatëse (leje qarkullim, siguracjon mjeti, certifikatë pronësie, certifikatë e kontrollit teknik (SGS). Pra plotësimi ose jo i specifikimeve teknike të vendosura në DST është proces verifikimi pasi mjeti të dorëzohet pranë Autoritetit Kontraktor.

b- **Në DST nuk është përcaktuar paraqitja e asnjë dokumenti nga operatorët ekonomik,** në mënyrë që ata të vërtetojnë KVO në momentin e hapjes dhe vlerësimit të ofertave, se plotësojnë ose jo specifikimet teknike të vendosura në shtojcën nr.10. Atëherë si mund të gjykoj KVO se i plotëson ose jo specifikimet teknike operatori ekonomik dhe si mund të shprehet se nuk janë paraqitur fatura për blerjen e paisjeve të cilat janë pjesë integrale e mjetit, kur në DST nuk është kërkuar që këto fatura të paraqiten?

Procesi i verifikimit të mjetit për pjesët e tij përbërëse, midis të cilave janë edhe ato të mësipërme, është një proces verifikimi që i përket komisionit të marrjes në dorëzim të mallit, pra kur dorëzohet mjeti pranë Autoritetit Kontraktor.

KVO nuk ka mbajtur të njëjtin standard për shqyrtimin e dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik i shpallur fitues “T...” ShPK , pasi edhe ky operator ekonomik nuk ka paraqitur asnjë dokument (faturë etj.) për të vërtetuar se administron paisjet e mësipërme. Për të njëjtën mangësi që kanë dy operatorë ekonomik, njëri është skualifikuar (“A...G...” ShPK), ndërsa OE “T...”, ShPK nuk është skualifikuar (edhe pse ka vlerë të ofertës ekonomike më të lartë).

Mbështetur në standardet që KVO ka ndjekur në vlerësimin e dokumentacionit të operatorit ekonomik “A...G...” ShPK, duhet që sipas KVO të ishte skualifikuar edhe operatori ekonomik “T...” ShPK .

Titulli: Kualifikime dhe skualifikime të pa drejta në vlerësimin e ofertave të OE.

Situata: Në tenderin me objekt “Blerje mjet zjarrfikës për MZSH”, me vlerë të fondit limit 9,247,500 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2019” kanë marrë pjesë 7 operatorë ekonomik, midis të cilëve edhe operatori ekonomik “A... G...” ShPK, i renditur i pari, me vlerën më të ulët të ofertës ekonomike prej 6,950,000 lekë pa TVSH, i cili plotëson kriteret e vendosura në DST, por nga KVO ky operatorë ekonomik është skualifikuar padrejtësisht. Nga Autoriteti

Kontraktor është shpallur fitues operatori ekonomik “T...” ShPK, me vlerë të ofertës ekonomike 8,480,000 lekë pa TVSh .

Skualifikimi i Operatori ekonomik “A...G...” ShPK, i cili plotëson kriteret e vendosura në DST dhe kualifikimi dhe shpallja fitues e operatorit ekonomik “T...” ShPK, me vlerë të ofertës ekonomike më të lartë, **ka sjellë dëm ekonomik në vlerën 1,530,000 lekë pa TVSh, si diferencë midis dy ofertave të operatorëve ekonomik (8,480,000 -6,950,000).**

Për sa më sipër nga KVO nuk është siguruar mirëpërdorim i fondeve publike dhe trajtim i barabartë midis operatorëve ekonomik, nuk janë respektuar parimet e përzgjedhjes së operatorëve ekonomik dhe ofertës fituese. **Oferta e cila duhet të ishte shpallur fituese, pasi plotëson kriteret te përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ka çmimin më të ulët është skualifikuar padrejtësisht.**

Kriteri: Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me kërkesat e ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, sipas neneve të mëposhtëm:

- nenin 1 ku thuhet se “Qëllimi i këtij ligji është:.. b) të sigurojë mirë përdorim të fondeve publike.., d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik, ...

-nenin 2 “Parimet e përzgjedhjes”, ku thuhet “Përzgjedhja e fituesve të kontratave publike realizohet në përputhje me këto parime të përgjithshme: a) mos diskriminim dhe trajtim i barabartë i ofertuesve ose kandidatëve, c) barazi në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve;

- pikën 5, të nenit 53 “Shqyrtimi i ofertave”, ku thuhet: “Autoriteti kontraktor nuk e pranon një ofertë kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit”;

- nenin 55, ku thuhet: “Oferta fituese duhet të jetë: a) oferta që, në bazë të kërkesave dhe kriterëve të përcaktuara në dokumentet e tenderit, plotëson kërkesat e objektit të prokurimit **me çmimin më të ulët.**

Gjithashtu veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, i neni 2 ku thuhet: “Qëllimi i këtij ligji është përdorimi sa më eficient, efektiv dhe ekonomik i burimeve financiare publike, duke respektuar parimet e transparencës dhe të ligjshmërisë, si dhe shmangia e shpërdorimit, keqpërdorimit dhe vjedhjes së pasurisë.

Ndikimi: Si rezultat i devijimit nga kuadri rregullator në fuqi në vlerësimin dhe kualifikimin e operatorve ekonomik, është shkaktuar **dëm ekonomik në vlerën 1,530,000 lekë pa TVSh.**

Shkaku: Mos respektim i kuadrit rregullator në fuqi për vlerësimin e ofertave të OE.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Berat të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për arkëtimin e vlerës prej 1,530,000 lekë pa TVSh nga anëtarët e KVO: znj. A. Zh., ekonomiste, me detyrë specialiste e prokurimeve z. G. B., me detyrë ish specialist i prokurimeve, ndërprerë marrëdhëniet e punës me urdhrin n.80, datë 26.12.2019, z. L. B., me detyrë n/kryetar i Bashkisë Berat.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave: znj. A. Zh., ekonomiste, me detyrë specialiste e prokurimeve z. G. B., me detyrë ish specialist i prokurimeve, ndërprerë marrëdhëniet e punës me urdhrin n.80, datë 26.12.2019, z. L. B., me detyrë n/kryetar i Bashkisë Berat.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të raportit përfundimtar të auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacion (për aktet e konstatimit) me shkresën protokolluar në KLSH me nr.55/5 datë 26.04.2022, si dhe nëpërmjet postës elektronike në adresën b...m...@klshe.org.al datë 22.04.2022, nga znj. A. Zh., z. G. B., z. L. B., anëtare të KVO. Gjithashtu “Mbi

projektraportin e auditimit”, nga të njëjtët persona si më sipër, nga subjekti i audituar është paraqitur observacion, nëpërmjetë postës elektronike në adresën b...m...@klsh.org.al datë 20.06.2022, protokolluar në KLSH me nr.55/9 prot, datë 06.06.2022, ku janë shprehur të njëjtat objeksione, si ato të bëra për përmbajtjen e akteve të konstatimit. Në të dy rastet observacionet janë të njëjta, nuk ka argumente shtesë në observacionet e bëra për projektraportin e auditimit. Për të dy rastet, nga subjekti i audituar janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendim i subjektit: Në lidhje me konstatimin për skualifikimin e operatorit ekonomik A... G... ShPK, sqarojmë se nuk jemi dakort me akt konstatimin e audituesëve. Theksojme se pas hapjes së ofertave KVO ka vazhduar vlerësimin për këtë procedurë prokurimi sipas nenit 53 të LPP. Operatori ekonomik A... G... ShPK është skualifikuar për arsyet si më poshtë:

Mungojnë aparat prerës hidraulik i cili përdoret në raste të aksidenteve automobilistike 1 cope. Kompresor vaji, jastëk të ndryshëm ajri, litar të ndryshëm, barela, kuti të ndihmës së parë, leva të ndryshme për hapje konstruksionesh, aparat frymëmarrje të kompletuar me bombolat dhe maskat AP3, jo me pak se 6 cope, Tubo thithëse secila 20 ml, të përshtatshme për pompën. Tubo për luftimin e zjarrit 50 mm (diametri) i standardit evropian me gjatësi secili 20 ml, gjithsej 200 ml, të përshtatur për pompën.

Kontrata e porosis faqe e parë që përmban specifikimet teknike të mjetit vitin e prodhimit, kilometrat, dhe të tjera nuk është e vëlosur nga noteri për të vërtetuar origjinalitetin e saj tek pjesët e kërkuara nga autoriteti kontraktor.

Tubo për luftimin e zjarrit 70 mm (diametri) i standardit evropian me gjatësi secili 20 ml linear, gjithsej 200 ml, të përshtatur për pompën. Tubot të jenë të pajisur me lidhëset përkatëse në të dy krahët (standardit evropian), Degëzues të ndryshëm me 3 dhe 4 dalje, hedhëse uji 500 mm të ndryshme (kompakte, pulverizuese) gjithsej 10 cope hedhëse shkume të ndryshme 5 cope. Shkallë të ndryshme.

Specifikimet teknike të mjetit janë pjesë përbërëse e Dokumenteve Standarde të Tenderit, të hartuara nga grupi i punës me qëllim përmbushjen e tyre nga ofertuesit.

Në rastin konkret KVO ka mbajtur në konsideratë kontratën e porosisë që operatori A...G... ShPK duke i krahasuar lehtësisht me shtojcën e specifikimeve teknike.

Në nenin 53, pika 3 të LPP citohet: Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Konkretisht ishte lehtësisht e verifikueshme që ky operator ekonomik nuk i përmbushte specifikimet teknike të parashikuara në DST. Duke qenë se ky mjet ishte sponsorizuar nga Ambasada Japoneze dhe me qëllim për të mos rrezikuar rimbursimin nga kontrata e grantit nr.971/2 prot datë 01.03.2019 KVO ka gjykuar që ky operator ekonomik nuk i përmbush kushtet dhe kriteret për tu kualifikuar, pra kemi të bëjmë me një mjet tjetër të porositur nga operatori A...G... ShPK dhe jo sic ka qenë e specifikuar në DST. Për më tepër KVO ka konstatuar një sërë mangësish se pajisjet e mjetit të cilat luajnë një rol të rëndësishëm në aksionet e zjarrit dhe shpëtimit, qëllimi i të cilit do të përdoret mjeti. Theksojmë se një mjet zjarrfikës pa këto pajisje nuk është i dobishëm rrezikon të mos jetë efiçent në aksion. Për më tepër ky mjet ishte financim i Ambasadës Japoneze dhe ishte pikërisht donatori në përcaktimin kryesor të specifikimeve të mjetit. Deklarata sipas shtojcës 10 të operatorit A... G... ShPK bie në kundërshtim me kontratën e porosisë së mjetit të paraqitur nga vetë operatori. KVO për përmbushjen e specifikimeve teknike ka gjykuar mbi bazën e kontratës së porosisë të paraqitur nga ofertuesi. Në rastet e mos përmbushjes së tyre në kontratën e porosisë është kërkuar vërtetësia nëpërmjet faturave që ofertuesi disponon. Në kushtet kur operatori ekonomik A... G... ShPK nuk i ka përmbushur të gjitha parashikimet ligjore për tu kualifikuar si operator fitues, është skualifikuar nga KVO.

Për sa për mëndëm më sipër KVO ka vepruar sipas parashikimeve të nenit 53 të LPP pika 3.

Qendrim i grupit të auditimit: Në observacion ju keni përsëritur të njëjtat arsyetime që keni dhenë gjatë vlerësimit të ofertave. Për arsye se nuk keni dhenë argumente të reja ligjore, observacioni juaj nuk merret në konsideratë.

Lidhja dhe sigurimi i kontratës

Autoriteti Kontraktor ka kërkuar sigurim për ekzekutimin e kontratës, në vlerën 10 % e vlerës së kontratës. Në datën 02.12.2019 është bërë lidhja e kontratës midis AK dhe shoqërisë “T...” ShPK, në vlerën 11,407,200 lekë (me TVSh).

Në datën 02.12.2019 nga shoqëria “T...” ShPK është bërë sigurimi i kontratës në vlerën 1,017,600 lekë, ose në masën 10% e vlerës së kontratës, në përputhje me DST.

Marrja në dorëzim e mjetit

Për marrjen e mjetit në dorëzim nga Titullari i AK ka dalë urdhri nr.793, datë 27.11.2019, nr.5990 prot., “Për ngritjen e komisionit për kontrollin fizik të mjetit zjarrfikës”, në të cilin është përcaktuar komisioni i përbërë nga: z. E. C., inxhinier mekanik, me detyrë ish specialist në Drejtorinë e Bujqësisë, ndërprerë marrëdhëniet e punës në datën 18.10.2021, me urdhërin nr.562, datë 14.10.2021, z. S. H., mekanik, me detyrë inspektor i Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit (PMZSH), z. D. N., me detyrë drejtues mjeti në PMZSH,

Në urdhër është përcaktuar: **“Komisioni ngarkohet për kontrollin fizik të mjetit zjarrfikës nëse është sipas specifikimeve teknike të përcaktuara në dokumentet standarde të tenderit”.**

Në zbatim të urdhrit të mësipërm komisioni në datën 04.12.2019 ka mbajtur procesverbalin e marrjes në dorëzim të mjetit zjarrfikës. Në këtë procesverbal janë përshkruar këto të dhëna lidhur me specifikimet teknike të mjetit: marka Volvo, targa: Y...B AA8...G, numri i shasisë: YV2.....887, viti i prodhimit 2006, vëllimi cilindrik 5480 cm³, fuqia 162 kW, pesha 1500 kg, numri i vendeve 2.

Nga krahasimi i përshkrimit të të dhënave që ka bërë komisioni i marrjes në dorëzim të mjetit në procesverbalin e mbajtur prej tij, me të dhënat e specifikimeve teknike të DST, konstatohet se:

-Në specifikimet teknike të DST është kërkuar kapaciteti i kabinës jo me pak se 5 + 1 vende, ndërsa komisioni ka përshkruar se mjeti i dorëzuar ka numrin e vendeve 2.

Komisioni shpjegon se ky numër ka qenë në dokumentat shoqërues të mjetit, por në fakt mjeti ka 5+1 vende, gjë e cila është korrigjuar më vonë në lejen e qarkullimit nga strukturat përkatëse të kontrollit teknik. Për këtë u paraqit për verifikim leja e qarkullimit.

- **Në specifikimet teknike të DST volumi i motorit mbi 6000 cc – 7000 cc, ndërsa në procesverbal është përshkruar se mjeti i marrë në dorëzim ka vëllimin cilindrik 5480 cm³, pra më i vogël nga sa është kërkuar.**

- Në DST është kërkuar që mjeti të ketë një numër kilometrazhi jo me shume se 80,000 km, kapaciteti i depozitës së ujit të jetë jo me pak se 2000 litra, Kapaciteti i shkumës jo me pak se 200 litra, e të tjera kritere, por komisioni nuk është shprehur nëse plotësohen ose jo këto specifikime.

Në DST është përcaktuar se në momentin e dorëzimit mjeti duhet të jete i pajisur me dokumentet përkatëse. (leje qarkullim, siguracion mjeti, certifikatë pronësie, certifikatë e kontrollit teknik (SGS), por për plotësimin e këtyre kritereve komisioni nuk është shprehur.

Në DST janë përcaktuar gjithsej 34 specifikime teknike që duhet të plotësojë mjeti zjarrfikës, të cilat përshkruhen në vijim, por nga komisioni i marrjes së mjetit në dorëzim, janë përshkruar vetëm 8 specifikime, nga të cilat prej tyre nuk janë kërkuar në DST, pra janë përshkruar vetëm 3 specifikime teknike nga 34 të kërkuara në DST.

Specifikimet e kërkuara në DST janë si vijon:

Tipi i mjetit: Zjarrfikëse

Mjeti te jete Prodhim Perëndimor

Lloji i karburantit: Diezel

Kamio: Manual ose Automatik

Viti i prodhimit: 2006 e ne vazhdim

Nr. i kilometrazhit: jo me shume se 80 000 km

Depozite e ujit: jo me pak se 2000 litra

Gomat: Te përshtatur për mjetin zjarrfikës dhe ne gjendje te mire, jo me pak se 2 vjet vit prodhimi + Gome Rezerve

Kapaciteti i Kabines: Jo me pak se 5 + 1 vende

Volumi i motorit :Mbi 6000 cc – 7000 cc

Aksi i pasmem : Dopjo gome

Sistemi i frenimit: Sistem ABS

Mjeti duhet te kete sirene dhe sinjalet e nevojshme, paralajmërimi dhe ndriçimin, të ketë prozhektor te montuar ne pjesën e jashtme te galinës për pune gjate nates. **Estetik** e jashtme dhe e brendshme te jene ne gjendej te mire (pa gërvishtje, goditje)

Kapaciteti i shkumes : jo me pak se 200 litra

Tubat : Tub gome ne baraban mbi 20 ml + hedhësen

Pompa e ujit: pompe centrifugale, për shtytje dhe thithje, kapaciteti i përpunimit te pompës duhet te jete 1500 – 3000 litra ne min, me presion prej 8 – 12 bar.

Pompa centrifugale te jete pjese e mjetit zjarrfikës dhe ne funksion, te gjitha daljet e pompës duhet te jene te Standardeve Europiane.

Mjeti zjarrefikes duhet te jete i pajisur me :

- ✓ Aparat prerës Hidraulik i cili perdoret ne raste te aksidenteve automobilistike **1 cope**.
- ✓ Kompresor vaji
- ✓ Jastek te ndryshme ajri
- ✓ Litar te ndryshëm
- ✓ Barrela
- ✓ Kutu te Ndhmës se Pare
- ✓ Leva te ndryshme për hapje konstruksionesh.
- ✓ Aparat frymëmarrje te kompletuar me bombolat dhe maskat AP3, jo me pak se **6 cope**.

Mjeti zjarrefikes duhet te jete me pajisjet e luftimit te zjarrit.

- ✓ Tubo thithëse secila 20 ml, te përshtatshme për pompën.
- ✓ Tubo për luftimin e zjarrit 50 mm (diametri) i standardit evropian me gjatësi secili 20 ml, gjithsej 200 ml, te përshtatur për pompën
- ✓ Tubo për luftimin e zjarrit 70 mm (diametri) i standardit evropian me gjatësi secili 20 ml linear, gjithsej 200 ml, te përshtatur për pompën
- ✓ Tubot te jene te pajisur me lidhëset përkatëse ne te dy krahët (standardit evropian),
- ✓ Degëzues te ndryshëm me 3 dhe 4 dalje
- ✓ Hedhëse uji 500 mm te ndryshme (kompakte, pulverizuese) **gjithsej 10 cope**.
- ✓ Hedhëse shkume te ndryshme **5 cope**.
- ✓ Shkalle te ndryshme duralumini
- ✓ Çelësa per shtrëngimin e hedhëseve.

Automjeti duhet te ketë një ose dy barabanë qe përmban secila 50 ml, tub standarde me presion te larte me diametër 25/30 mm, dhe te lidhura direkt ne pompën centrifugale.

Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi komisioni marrjes në dorëzim të mjetit zjarrfikës: z. E. C., z. S. H., z. D. N.

Si përfundim: Komisioni i marrjes në dorëzim të mjetit nuk është shprehur nëse mjeti i dorëzuar nga operatori ekonomik “T...” ShPK plotëson ose jo specifikimet teknike të përcaktuara në DST, si dhe ka bërë një përshkrim të një numri shumë të vogël të specifikimeve teknike të mjetit të dorëzuar krahasuar me ato të kërkuara në DST. Komisioni ka bërë një kontroll fizik minimal të specifikimeve teknike të mjetit zjarrfikës dhe nuk është shprehur nëse mjeti i dorëzuar është sipas specifikimeve teknike të përcaktuara në dokumentet standarde të tenderit. Për sa në sipër komisioni i marrjes në dorëzim të mjetit nuk ka zbatuar urdhrin nr.793, datë 27.11.2019, nr.5990 prot. të Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Berat, në të cilin është përcaktuar se “Komisioni ngarkohet për kontrollin fizik të mjetit zjarrfikës nëse është sipas specifikimeve teknike të përcaktuara në dokumentet standarde të tenderit”.

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi komisioni i marrjes në dorëzim të mjetit: z. E. C., z. S. H., z. D. N.

Shqyrtimi i ankesave të operatorëve ekonomik

Titulli: Mos shqyrtim i ankesës së operatorit të skualifikuar nga KVO, nga komisioni i ngritur për këtë qëllim.

Situata: Janë bërë dy ankesa për këtë procedurë prokurimi:

- Në datën 10.10.2019 është paraqitur në SPE ankesa e operatorit ekonomik A... G... ShPK, protokolluar në Bashkinë Berat në datën 16.10.2019. Në ankesë kundërshtohet skualifikimi nga ana e KVO e këtij OE, duke cituar se plotëson të gjitha kriteret e vendosura në DST. Për shqyrtimin e ankesës nga Titullari i AK z. E. D. me urdhrin nr.699 datë 16.10.2019, nr.5233/1 prot., është ngritur komisioni i shqyrtimit të ankesës i përbërë nga: znj. E. M., z. P. S., z. S. H.

Komisioni për shqyrtimin e ankesës në datën 18.10.2019, ka mbajtur procesverbalin me nr.5233/2 në të cilin ka dalë në konkluzionin se “...specifikimet teknike të vendosura në DST nuk janë mbështetur në specifikimet teknike të kërkuara nga donatori në kontratën e grandit të nënshkruar midis Bashkisë Berat dhe Ambasadës së Japonisë në Republikën e Shqipërisë. Për sa më sipër nisur nga fakti që në kontratë shprehet që Donatori rezervon të drejtën për të kërkuar një rimbursim të një pjese ose të gjithë grantit nëse përfituesi shkel kontratën, për të mos rrezikuar prishjen e kontratës që sjellë si pasojë tërheqjen e grantit, të anulohet procedura e prokurimit.

Me shkresën nr.5233/3 prot., datë 18.10.2019, me lëndë “Kthim përgjigje “A...G...” ShPK, nga Titullari i AK z. E. D., i është kthyer përgjigje operatorit ekonomik “A... G...” ShPK, në të cilin thuhet se Autoriteti Kontraktor Bashkia Berat ka vendosur anulimin e procedurës së prokurimit (për arsyet e shpjeguara në procesverbalin e komisionit të shqyrtimit të anesës). Në datën 22.10.2019 është afishuar në sistemin e prokurimit elektronik anulimi i procedurës së prokurimit, me të cilën janë njohur operatorët ekonomik pjesëmarrës në tender.

- Në datën 24.10.2019 në Bashkinë Berat është protokolluar ankesa e operatorit ekonomik “T...” ShPK, me nr. 5442 prot., në të cilën kundërshtohet anulimi i procedurës së prokurimit nga Autoriteti Kontraktor, me pretendimin se anulimi i procedurës është i pa argumentuar, pasi nuk plotësohet asnjë nga kushtet që përcakton neni 24 “Anullimi i një procedure prokurimi”, i LPP.

Për shqyrtimin e ankesës së mësipërme nga Titullari i AK, z. E. D., ka dalë urdhri nr. 733, datë 28.10.2019, nr.5442/1 prot., “Për ngritjen e komisionit për shqyrtim ankese”, në të cilin është përcaktuar në komision: znj. M. Xh. me detyrë specialise, ndërprerë marrëdhëniet e punës më urdhërin nr. 773, datë 25.11.2019, z. E. Gj., me detyrë specialist i transportit, znj. A. Sh., me detyrë specialiste e buxhetit.

Në datën 29.10.2019 komisioni i shqyrtimit të ankesës ka hartuar vendimin nr.73311, nr.5442 prot, në të cilin ka dalë në përfundimin se **ankesa e operatorit ekonomik “T...” ShPK qëndron, pasi arsyeja e anulimit nuk është asnjë nga rastet e parashikuara në ligjin 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 24, pika 1.**

Pas këtij vendimi procedura ka vijuar të zhvillohet përsëri duke u rikthyer në SPE. Në datën 15.11.2019 është hartuar raporti përmbledhës i KVO, në të cilin evidentohen si operator të skualifikuar operatorët ekonomik “A...G...”, ShPK me vlerë të ofertës ekonomike 6,950,000 lekë dhe R... C... me vlerë të ofertës 7,800,000 lekë. Në datën 15.11.2019 është miratuar procedura e prokurimit nga Titullari i AK z. E. D. Formulari i njoftimit të fituesit në të cilin është njoftuar OE “T...” ShPK si fitues i kësaj procedure, mban datën 20.11.2019. Në datën 02.12.2019 është lidhur kontrata midis AK Bashkia Berat dhe operatorit Ekonomik “T...” ShPK në vlerën 10,176,000 lekë me TVSh.

Nga auditimi i certifikatës së pronësisë së mjetit konstatohet se mjeti ka kaluar në pronësi të Bashkisë Berat në datën 02.12.2019, në të njëjtën datë me lidhjen e kontratës dhe 2 ditë përpara se mjeti të merrej në dorëzim nga komisioni i ngritur për këtë qëllim (komisioni në datën 04.12.2019 ka mbajtur procesverbalin e marrjes në dorëzim të mjetit zjarrfikës).

Mjeti nuk mund të rregjistrohet në pronësi të Bashkisë Berat, pa u marrë ende në dorëzim nga grupi i caktuar për këtë qëllim, pasi nëse mjeti nuk plotëson specifikimet teknike të përcaktuara në DST, atëherë nuk do të merret në dorëzim dhe mjeti i kërkuar nuk do ofrohet nga ky operatorë ekonomik.

Në DST dhe kontratë nuk është përcaktuar qartë marrja në dorëzim e mjetit, pasi nuk janë përcaktuar fazat nëpër të cilat do të kalojë ky proces:

Si fazë e parë duhet të jetë dorëzimi i mallit pranë Autoritetit Kontraktor dhe verifikimi prej këtij të fundit nëse specifikimet teknike të mjetit përputhen më ato të kërkuara në DST, si dhe kolaudimi i mjetit nga AK (kryerja e provave të nevojshme të funksionimit të mjetit, paisjeve zjarrfikëse etj.).

Si fazë e dytë, pasi të jetë verifikuar se automjeti është në përputhje me specifikimet teknike, automjeti merret në dorëzim provizorisht nga Autoriteti Kontraktor dhe lidhet kontrata. Pas këtij momenti Autoriteti Kontraktor do të lejojë Kontraktuesin për tërheqjen e automjetit me qëllim kryerjen e procedurave të paisjes me targa dhe regjistrimin në emër të AK.

Si fazë e tretë, dorëzimi në mënyrë përfundimtare e mjetit dhe hartimi i procesverbalit përfundimtar.

- Nga shqyrtimi i ankesës së operatorit ekonomik “A... G...” ShPK konstatohet se: Komisioni i shqyrtimit të ankesës nuk ka shqyrtuar pretendimet që ngrihen nga operatori ekonomik në ankesën e tij drejtuar AK Bashkia Berat. Operatori nuk ankohet për dokumentet standarde të tenderit, nëse këto përputhen ose jo me kriteret e vendosura nga donatori, por ankohet për faktin se sipas pretendimit të tij, është skualifikuar në mënyrë të pa drejtë nga KVO, pretendim të cilin komisioni i shqyrtimit të ankesës nuk e ka marrë në analizë. Ky komision duhet të analizonte faktin nëse skualifikimi që i ka bërë KVO, është i drejtë ose jo dhe për këtë duhet të kishte dalë me një vendim të cilin duhet ta adresonte te Titullari i AK dhe personi përgjegjës për prokurimin.

Kriteri: Me veprimet dhe mos veprimet e tij komisioni i shqyrtimit të ankesës nuk ka zbatuar urdhrin e titullarit nr.699 datë 16.10.2019.

Ndikimi: Mos shqyrtimi i ankesës ka hequr mundësinë e mos skualifikimit pa të drejtë të operatorit “A... G...” ShPK i cili plotëson kriteret e DST, si dhe nuk i është dhënë Titullarit informacionin e duhur për një vendimmarrje të drejtë për ecurinë e mëtejshme të tenderit.

Shkaku: Mos zbatim i urdhërit të titullarit dhe kuadrit rregullator për procedurat e prokurimit publik.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Berat të marrë masa që në rastet e ankesave të bëra nga operatorët ekonomik për çështjet e procedurave të prokurimit publik, komisionet e ngritura për këtë qëllim të shqyrtojnë çështjet për të cilat pretendon ankimuesi dhe të informojnë Titullarin për konkluzionin e arritur.

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi komisioni shqyrtimit të ankesës: znj. E. M. me detyrë specialiste e prokurimeve, z. P. S., me detyrë drejtor i drejtorisë juridike, z. S. H., me detyrë inspektor i Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit (PMZSH).

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të raportit përfundimtar të auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacion (për aktet e konstatimit) me shkresën protokolluar në KLSH me nr.55/5 datë 26.04.2022, si dhe nëpërmjet postës elektronike në adresën b...m...@klsh.org.al datë 22.04.2022, znj. E. M., z. P. S., z. S. H., anëtare të komisionit për shqyrtimin e ankesës. Gjithashtu “Mbi projektraportin e auditimit”, nga të njëjtët persona si më sipër, nga subjekti i audituar është paraqitur observacion, nëpërmjet postës elektronike në adresën b...m...@klsh.org.al datë 20.06.2022, protokolluar në KLSH me nr.5/9 prot, datë 06.06.2022, ku janë shprehur të njëjtat objeksione, si ato të bëra për përmbajtjen e akteve të konstatimit. Në të dy rastet observacionet janë të njëjta, nuk ka argumente shtesë në observacionet e bëra për projektraportin e auditimit. Për të dy rastet, nga subjekti i audituar janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Prezantim i subjektit: Në lidhje me konstatimet për objektin e prokurimit “**Blerje mjet zjarrfikës për MZSH**” shqyrtimi i ankesave të operatorit ekonomik sqarojmë se: Në datën 10.10.2019 është paraqitur ankesa e operatorit ekonomik A...G... për kundërshtimi e vlerësimit të komisionit të vlerësimit të ofertave. Në lidhje me këtë ankesë është ngritur komisioni i shqyrtimit të ankesave në datën 18.10.2019, i cili ka shqyrtuar ankesën e këtij operatori ekonomik. Nga shqyrtimi është vërejtur që kjo procedurë prokurimi është zhvilluar bazuar në kontratën e grantit ndërmjet Bashkisë Berat dhe Ambasadës Japoneze me nr.971/2 prot datë 01.03.2019. Burimi i financimit ka qenë sponsorizim nga Ambasada Japoneze. Komisioni ka verifikuar kushtet dhe detyrimet e kontratës së grantit (kanë qenë të përfshira edhe disa specifikime të mjetit) dhe ka arritur në përfundim se disa nga specifikimet e përcaktuara në kontratën e grantit nuk përputheshin me specifikimet në DST. Në këto kushte nisur nga fakti që donator ka të drejtën për të kërkuar një rimbursim nëse përfituesi shkel kontratën, komisioni konkludoi që procedura duhesh anuluar për të mos rrezikuar fondet e donatorit. Në lidhje me këtë i është kthyer përgjigje operatorit ekonomik për vendimin dhe ky operator nuk e ka ankimuar me tej. Do të ishte e panevojshme dhe tërësisht në shkelje të kontratës së grantit nëse procedura nuk do të sqarohesh në ato momente dhe për më tepër nuk ka ndikuar aspak në vlerësimin e procedurës pasi ky operator mund ta kishte ankimuar me tej nëse do të ishte i bindur në kundërshtimet e autoritetit kontraktor. Veprimet e komisionit janë të arsyeshme dhe nuk duhen ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e komisionit të shqyrtimit të ankesave.

Oëndrim i grupit të auditimit: Komisioni nuk ka kryer detyrën për të cilën është ngritur, pra nuk ka shqyrtuar ankesën e operatorit ankimues, por ka bërë interpretime të tjera jashtë objektit të urdhërit. Komisioni nuk ka zbatuar urdhërin e titullarit të autoritetit kontraktor. Për arsye se nuk keni fakte dhe prova të reja, observacioni juaj për këtë çështje nuk merret në konsideratë.

Likujdimi i kontratës

Konstatohet se në DST është parashikuar se operatori duhet te paraqesë një deklaratë garancie për një periudhë 1 vjeçare për defekte të paparashikuara për mjetin pesë (5) për qind e depozitës do të mbahet deri në përmbushjen e kënaqshme të detyrimeve të kontratës. **Pra për riparimin e defekteve të mundshme gjatë një periudhë një vjeçare, Autoriteti Kontraktor Bashkia Berat, duhet të mbante të ngurtësuar 5% të vlerës së kontratës, por nga auditimi i procesit të pagesës konstatohet se ky veprim nuk është kryer nga nëpunësi autorizues z. E. D. dhe nëpunësi zbatues znj. A. Sh., duke vepruar në kundërshtim me kërkesat e DST dhe kontratën e lidhur. Likuidimi i mjetit është bërë me urdhër shpenzimit nr.166, datë 19.03.2020, vlera e likuiduar 10,176,000 lekë (së bashku me TVSh).**

4.Mbi zbatimin e procedurave ligjore në tenderin me objekt “Blerje karburant për nevojat e Bashkisë Berat dhe drejtorive në vartësi”, me vlerë të fondit limit 17,790,833 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2020”.

Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin: Sipas kërkesave të Bashkisë Berat dhe drejtorive vartëse deri në mbarimin e sasisë dhe vlerës së kontratës nga data e nënshkrimit të saj.

Numri i referencës së procedurës: REF-56158-04-14-2020		
1.Urdhër Prokurimi nr.26 datë 14.04.2020, nr.1775 prot.	3. Njësia e Prokurimit , ngritur me urdhrin nr.26 datë 14.04.2020: A. Zh., F. K. (A.), D. S.	4.Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: Urdhër nr. 27, nr.prot1715,datë 14.4.2020: L. B., P. S., E. M.
2.Lloji i Procedurës së Prokurimit: “Procedurë e hapur”		
5.Fondi Limit 17,790,833 lekë (pa TVSh)	6.Oferta fituese: G... C... G... ShPK , me vlerë 16,382,395 lekë pa TVSh	7.Diferenca me fondin limit 1,408,438 (pa TVSh)
8. Data e hapjes së tenderit: 20.05.2020	9.Burimi Financimit: Të ardhurat e veta	10.Operatoret Ekonomik a)Pjesëmarrës në tender: 2 OE b)S’kualifikuar 1 OE c) Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime: AK: nuk ka	APP	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP:
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
14.Lidhja e kontratës Nr. nr. 2546/2 prot, datë 09.06.2020	15.Vlera e kontratës: 19,658,873 leke (pa TVSh) dhe 9,658,873 lekë me TVSh	16. Kontrata realizuar në vlerën18,499,958 lekë., pa realizua vlera 1,158,915

Hartimi i kritereve të DST

Me urdhrin e prokurimit nr.26 datë 14.04.2020, të titullarit të AK z. E. D., është përcaktuar njësia e prokurimit e përbërë nga znj. F. K. (A.) juriste, me detyrë specialiste e prokurimeve, znj. A. Zh., ekonomiste, me detyrë specialiste e prokurimeve, znj. D. S., inxhinierë mjedisi, me detyrë Specialistë e Drejtorisë së Bujqësisë.

Urdhri i prokurimit është i pa vulosur në Degën e Thesarit Berat, në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, “Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike” pika 154 ku përcaktohet: “Kërkesa për shpenzim i drejtohet Nëpunësit Autorizues dhe për dijeni Nëpunësit Zbatues. Në rastet kur kërkesa është e lidhur me një proces blerje apo kryerje shërbimi i dërgohet strukturës përgjegjëse për prokurimet në njësinë shpenzuese. Struktura përgjegjëse për prokurimet kryen kontrollin e nevojshme krahasues me kërkesat e planifikuara dhe planin e prokurimit të miratuar në procesin e planifikimit të buxhetit. Në rast të kërkesave të reja, të paplanifikuara më parë, kërkohet miratimi paraprak i Nëpunësit Autorizues të njësisë. Në përfundim të procesit njofton

Nëpunësin Zbatues të njësisë për urdhërin e prokurimit, i cili autorizohet nga struktura përgjegjëse e Thesarit në degë përpara se të fillojë procesi i prokurimit.”

Për mos vulosjen e urdhrit të prokurimit në thesar mban përgjegjësi nëpunësi zbatues znj. R. Sh.

Titulli: Mos ndarja e kontratës në lote

Situata: Për hartimin e kriterëve të veçanta të DST, nga njësia e prokurimit është mbajtur procesverbali nr.1775/3 prot, datë 16.04.2020.

Nga auditimi konstatohet se në pikën 4 të seksionit 2.3 të kapacitetit teknik të kriterëve të veçanta të DST, është kërkuar që “Subjekti ofertues duhet të ketë minimalisht 1 automjet autobote në pronësi ose me qira, të vërtetuara me akt noterial, për plotësimin e kërkesave për furnizimin e kaldajave ...”. Pra nevojat e Autoritetit Kontraktor nuk janë vetëm për karburant për furnizimin e mjeteve të transportit, por edhe për karburant **për ngrohje**. Referuar nenit 15, pika 4, të ligjit nr.8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, përcaktohet se “**Stacioneve të shitjes së karburanteve u ndalohet të tregtojnë karburante për mjete transporti, detar e ajror, si dhe lende djegëse të lëngëta apo të gazta**”. Pra, stacioneve të shitjes së karburantit për automjete, u ndalohet të tregtojnë lëndë djegëse për përdorim ngrohje dhe për këtë arsye ka qenë e nevojshme që procedura e prokurimit të ndahej në lote.

Kriteri: Mos ndarja e kontratës në lote, është në kundërshtim me nenin 9, pika 5, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, ku parashikohet se: “Kontrata ndahet në lote, kur përbëhet nga punë, mallra apo shërbime, homogjene ose të ngjashme dhe kur vlera e kombinuar është e tillë që vetëm një numër i kufizuar operatorësh ekonomikë do të ishin në gjendje t’i siguronin ato. Kjo mënyrë mund të përdoret veçanërisht për të nxitur pjesëmarrjen e biznesit të vogël e të mesëm dhe për të ulur kostot administrative të autoritetit kontraktor.

Ndikimi: Kufizim në pjesëmarrje i OE.

Shkaku: Moszbatim i kuadrit rregullator në fuqi për procedurat e prokurimit publik.

Rëndësia: E lartë

Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi njësia e prokurimit: znj. F. K. (A.) znj. A. Zh., znj. D. S.

Vlerësimi i ofertave nga KVO

Me urdhrin nr.27, datë 14.04.2020 të titullarit të AK z. E. D., është përcaktuar komisioni i vlerësimit të ofertave i përbërë nga z. L. B., me detyrë N/Kryetar i Bashkisë (arkitekt), z. P. S. me detyrë Drejtor i Drejtorisë Juridike (jurist), znj. E. M., me detyrë Specialiste e Prokurimeve (ekonomiste).

KVO në datën 04.06.2020 ka hartuar raportin përmbledhës me nr,2261/4 prot., në të cilin ka dokumentuar kualifikimin dhe skualifikimin e operatorëve ekonomik.

Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 2 operatorë ekonomik, prej të cilëve një është skualifikuar dhe një është kualifikuar, sipas të dhënave në tabelën e mëposhtme:

Nr	Operatorët pjesëmarrë në tender	Marzhi i fitimit	Kualifikimi nga KVO	Vlera e oferts pa TVSh	NIPT
2	“O...” ShPK	5.3%	S’kualifikuar	14,855,147	
3	“G... C... G...” ShPK	16%	Kualifikuar, fitues	16,382,394	

Titulli:Skualifikim i padrejtë i OE i cili ka ofertën më të vogël dhe plotëson kriteret e vendosura në DST.

Situata: Arsyet e skualifikimit nga KVO të operatorit ekonomik “O...” ShPK :

Konstatohet se arsyet e skualifikimit të OE janë të formuluar jo qartë dhe nuk ju referohen si duhet seksioneve dhe pikave të kriterëve ashtu si ato janë vendosur në DST. Komisioni duhet të referohet kriterit të cilin nuk plotëson operatori ekonomik, të shkruaj se si është kërkuar ky

kriter në DST, në vijim të shpjegojë se çfarë dokumenti është kërkuar në DST për plotësimin e kriterit, çfarë dokumenti ka paraqitur operatori ekonomik në përmbushje të kriterit dhe çfarë mangësish ka ky dokument (ose në rastin kur nuk ka paraqitur dokument të përshkruaj këtë situatë). Kjo është e nevojshme si për të qartësuar operatorin ekonomik, por edhe Titullarin e Autoritetit Kontraktor i cili përpara se të miratojë raportin përmbledhës, duhet të ketë sigurinë dhe qartësinë e nevojshme lidhur me informacionin që përmban ky dokument.

KVO: A-Mungon deklarata qe te disponoj faqe Web. Në asnjë nga deklaratat e paraqitura nga operatori nuk deklarohet se disponohet nje faqe Web page ku shërbimin i ngarkimit te sasisë se karburantit te kryhet nga Operatori ekonomik drejt Autoritetit Kontraktor. Operatori ka paraqitur nje manual perdorimi por nuk ka deklaruar se e zotëron ose jo këtë program.

Nga auditimi konstatohet se në DST nuk është kërkuar që të lëshohet deklaratë nga operatorët ekonomik se disponojnë faqe Web.

Në DST është përcaktuar se: *Bazuar ne VKM Nr 561 date 29.07.2016 “Per Standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve te karburantit ne njesite e qeverisjes se pergjithshem”, Operatoret ekonomik pjesemarres duhet te ofrojne nje faqe menaxhimi te karburanteve (webpage), ku furnizimi dhe shpenzimi i karburantit per mjetet efektive te transportit te kryhet nepermjet kartes elektronike.*

Faqja e menaxhimit te karburanteve (webpage) duhet të ofrojë shërbimin e ngarkimit te sasisë se karburantit nga operatori ekonomik drejt Autoritetit Kontraktor, me qellim që rimbushja e kartave elektronike te personalizuar me targon e mjetit, si dhe administrimi i sasisë së karburantit.

Mos ofrimi i sherbimeve te kerkuara më sipër ne menyre elektronike nepermjet Faqes se menaxhimit te karburanteve (webpage), qe ofron cdo operator ekonomik pjesemarres perben kusht per skualifikim.

Sherbimi i menaxhimit te karburantit nepermejt faqes web dhe ofrimi i karatave elektronike do te verifikohen nga nje grup pune i autoritetit kontraktor pas vleresimit te ofertave“

Nga i gjithë kriteri i mësipërm konstatohet se:

a) Në DST **nuk është kërkuar që të lëshohet deklaratë nga operatorët ekonomik se disponojnë faqe web (si pretendon KVO), si dhe nuk është përcaktuar asnjë dokument që duhet të paraqesin operatorët ekonomik me anë të së cilit të vërtetohet për KVO, se operatorët duhet te ofrojne një faqe menaxhimi të karburanteve.**

b) Në DST është përcaktuar se: Shërbimi i menaxhimit te karburantit nëpërmjet faqes Web dhe ofrimi i karatave elektronike **do te verifikohen nga nje grup pune i autoritetit kontraktor pas vleresimit te ofertave**”. Pra KVO nuk gjykon dot për përmbushjen ose jo të kriterit të faqes Web sepse kjo gjë nuk është përcaktuar në DST.

Sqarojmë se nga operatori “O...” ShPK është paraqitur nje manual perdorimi për faqen Web, në të cilin është paraqitur sigla e këtij operatori dhe sigla e operatorit ekonomik “B...O...” ShA.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të raportit përfundimtar të auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacion (për aktet e konstatimit) me shkresën protokolluar në KLSH me nr.55/5 datë 26.04.2022, si dhe nëpërmjet postës elektronike në adresën b...m...@klsh.org.al datë 22.04.2022, nga z. L. B., z. P. S., znj. E. M., anëtarë të KVO. Gjithashtu “Mbi projektraportin e auditimit”, nga të njëjtët persona si më sipër, nga subjekti i audituar është paraqitur observacion, nëpërmjet postës elektronike në adresën b...m...@klsh.org.al datë 20.06.2022, protokolluar në KLSH me nr.5/9 prot, datë 06.06.2022, ku janë shprehur të njëjtat objeksione, si ato të bëra për përmbajtjen e akteve të konstatimit. Në të dy rastet observacionet janë të njëjta, nuk ka argumente shtesë në observacionet e bëra për prjektraportin e auditimit. Për të dy rastet, nga subjekti i audituar janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: Pika A: Në lidhje pse kemi skualifikuar operatorin ekonomik "O..." sh.p.k për kriterin që nuk disponon një faqe webi shprehemi si më poshtë:

-Në DST pika 2.3.4 është kërkuar se subjekti ofertues duhet të paraqes edhe deklaratat si më poshtë pika 5 e saj, bazuar në VKM nr.561 datë 29.07.2016 "Për standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" OE pjesëmarrës duhet të ofrojnë një faqe menaxhimi të karburanteve (webpage), ku furnizimi dhe shpenzimi i karburantit për mjetet efektive të transportit të kryhet nëpërmjet kartës elektronike (bashkëlidhur dhe dokumenti vërtetues fq.32 e DST).

Operatori ekonomik "O..." sh.p.k nuk e ka plotësuar këtë kriter pasi sic jemi shprehur te arsyet e skualifikimit ky OE ka paraqitur një manual përdorimi bashkë me subjektin "B... O..." sh.p.k e me siglat e tyre por nuk e ka deklaruar me deklaratë që e disponon këtë program dhe nuk ka paraqitur një marrëveshje me këtë subjekt. Gjithashtu të dy subjektet janë me NIPT të ndryshme.

Për pikën tjetër ku do të jetë një grup pune i AK pas vlerësimit të ofertave për përdorimin e kësaj faqe gjatë zbatimit të kontratës është dicka tjetër ku KVO-ja nuk ka lidhje. KVO-ja ka vlerësuar vetëm që sipas kriterëve të DST e disponon apo jo këtë faqe webi ky OE.

Arsyeja kryesore që kemi skualifikuar OE është se:- nese marrim të mirëqena konstatimet tuaja pikat nga B-E, OE "O..." sh.p.k nuk ka paraqit deklaratë që ka një marrëveshje me subjektin "B... O..." sh.p.k për shërbimin e menaxhimit të karburantit me një faqe webi pasi të dy kanë NIPT të ndryshme.

Nëse do shprehemi mbi kualifikimin e OE "G... C... G..." sh.p.k vlerësimi nga KVO-ja është bërë i drejtë pasi për pikat që ju konstatoni që duhet ta skualifikonim këtë OE nuk qëndrojnë si më poshtë:

-**Së pari** në lidhje me lejen e qarkullimit të mjetit AA0...T që është fotokopje e panoterizuar dhe e pavlefshme, theksojmë se OE ka paraqitur Kontratë qeraje nr. Rep.1643 datë 23.03.2020 të noterizuar dhe cdo faqe e shoqëruar me vulë lidhëse nga noteri (bashkëlidhur dhe dokumenti vërtetues).

Së dyti në lidhje me qartësinë e targës së mjetit te certifikata e transport mallrash të rrezikshëm brenda vendit, theksojmë që këtë përgjegjësi e mban noteri kur i është paraqitur dokumenti origjinal i tij dhe ne si komision nuk kemi të drejtë tu kërkojmë palëve të treta që nuk janë pjesë e kësaj procedure prokurimi dokumenta vërtetues. Për më tepër AK disponon dokumenta vërtetues fizike të këtij OE që ka protokolluar dhe janë të gjitha të noteruara.

Qëndrim i grupit të auditimit: Cështjet që ju trajtoni në observacion është e njëjtë me qëndrimin që keni mbajtur në vlerësimin e ofertave dhe për këto janë dhënë shpjegime nga audituesi në aktin e konstatimit dhe në këtë material, prandaj nuk po rivendosen këtu për të mos krijuar përsëritje. Ju nuk keni dhënë fakte dhe prova të reja dhe për këtë arsye observacioni juaj nuk merret në konsideratë.

KVO:B-Mungon data e dorëzimit te deklaratës ne "Listën e Shpërndarjes se Karburanteve"(e pa përditësuar). Formulimi nuk i referohet saktë dokumentit të duhur, pasi nuk bëhet fjalë për listën e shpërndarjes së karburanteve, por për pikat e karburanteve që operatori ekonomik ka në territorin e Republikës së Shqipërisë. Nga auditimi konstatohet se ky kriter nuk është kërkuar në DST. Gjithsesi operatori ekonomik ka paraqitur hartën e vendndodhjes së pikave të karburantit në Republikën e Shqipërisë, e cila është hartuar në dhjetor 2019, ose 5 muaj përpara zhvillimit të tenderit. Autoritetit Kontraktor nuk i nevojitet hartën e vendndodhjes së pikave të karburantit në Republikën e Shqipërisë, pasi ka kërkuar në seksionin 2.3 të kapacitetit teknik, pika nr. 2 dhe nr.3 që OE të kenë:

Pika 2: Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me licencë për Tregtim me pakice te karburanteve te lëshuar nga Pushteti Vendor **Bashkia Berat.**

Pika nr.3: Subjekti ofertues duhet te paraqesë një stacion te shitjes se karburanteve me pakice... Stacioni i Tregtimit me pakice duhet te jete brenda territorit te Bashkisë Berat . Pra në DST nuk është kërkuar që OE të kenë pika karburanti jashtë territorit të Bashkisë Berat.

KVO: C-Operatori ekonomik ka depozituar një kontratë për përmbushjen me sukses të një procedure furnizimi ku Mungon vula e subjektit ne Kontrate Furnizimit me Bashkinë Korçë.

Me këtë formulim jo të saktë, KVO pretendon se OE “O...” ShPK nuk plotëson kriterin e vendosur në seksionin e kapacitetit teknik, pika 1, në të cilin është kërkuar: *“Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës, në vlerën jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë: Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga institucioni shtetëror/ ose faturat tatimore ku të shënohen datat, shumat dhe sasisë e mallrave të furnizuara.*

Si duket qartë nga formulimi i kriterit, nuk është kërkuar në DST që operatorët ekonomik të paraqesin kontratë, ndërsa në kundërshtim me këtë fakt KVO ka përcaktuar si mos përmbushje kriteri, një kriter të pa vendosur në DST dhe ka interpretuar një dokument i cili nuk është kërkuar në DST, duke vepruar në kundërshtim me pikën 2 të nenit 55 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ku thuhet: *“Autoriteti kontraktor vlerëson dhe krahason ofertat e vlefshme, për të përcaktuar ofertën fituese, në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nuk duhet të përdoret asnjë kriter, që nuk është përfshirë në dokumentet e tenderit”.*

Gjithsesi, nga auditimi konstatohet se OE “O...” ShPK plotëson kriterin ku është përcaktuar se duhet të paraqes *“dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës, në vlerën jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit”*, sepse ka paraqitur vërtetim të lëshuar nga Kryetari i Bashkisë Korçë, në të cilin përshkruhet se në datën 04.03.2018 Bashkia Korçë ka lidhur kontratë furnizimi me shoqërinë “O...” ShPK për blerje karburant, loti i parë blerje naftë ne vlerën 33.5 milion lekë dhe loti i dytë blerje benzinë në vlerën 2.4 milion lekë. Ky dokument është i firmosur dhe i vulosur nga kryetari i Bashkisë Korçë dhe është dokumenti i kërkuar në DST.

Edhe kontrata të cilës i referohet KVO (edhe pse nuk është e nevojshme ti referohet as KVO dhe as grupi i auditimit, pasi nuk është kërkuar paraqitje kontrate në DST), është e rregullt, pasi është fotokopje e vulosur në çdo faqe me vulë të njomë nga Bashkia Korçë dhe ka shënimin e Kryetarit të Bashkisë: *“E njëjtë me origjinalin që ndodhet në Bashkinë Korçë”.*

KVO: D-Mungon deklarata nga subjekti ku te gjitha stacionet e furnizimit me karburant detyrimisht duhet te mbajnë te njëjtën logo. Operatori ekonomik ka paraqitur një liste shpërndarje te pikave ne gjithë Shqipërinë por me logon e B... O..., nuk vërtetohet me dokument qe OE ka marrëveshje me këtë subjekt.

Nga auditimi konstatohet se në DST është kërkuar: *“Te gjitha stacionet e furnizimit me karburant detyrimisht duhet te mbajnë te njëjtën Logo, çka do jete e vërtetuar me një deklaratë nga subjekti ku te paraqitet dhe logo e shoqërisë e cila do te jete ne këto stacione”.*

Subjekti “O...” ShPK nuk ka paraqitur deklaratën e mësipërme, por logo e shoqërisë është e pasqyruar në dokumentet e paraqitur nga operatori ekonomik. Në DST është kërkuar që operatorët ekonomik të kenë një pikë stacion furnizimi në territorin e Bashkisë Berat, për të cilën janë kërkuar edhe dokumentet përkatëse, pra nuk është kërkuar që të vërtetohet nga OE se kanë disa pika dhe jashtë teritorit të Bashkisë Berat. Për këtë arsye humbet kuptimi i kriterit që *“Të gjitha stacionet e furnizimit me karburant detyrimisht duhet te mbajnë të njëjtën Logo...”*, sepse është kërkuar një stacion, jo disa. Gjithashtu konstatohet, se: Si në kushtet ku është kërkuar vetëm një stacion, edhe në kushtet nëse do të kërkoheshin disa stacione, pavarësisht vendndodhjes, mos plotësimi i deklaratës nga operatori ekonomik, konsiderohet dukshëm devijim i vogël, pasi pasja e të njëjtës logo nuk sjellë asnjë dobi,

garanci apo siguri për AK për sigurimin e kontratës nga operatori ekonomik dhe anasjelltas, mos pasja e të njëjtës logo nuk sjellë asnjë pengesë për furnizimin e mallit e realizimin e kontratës.

Në këtë rast nga KVO është vepruar në kundërshtim me pikën 4 të nenit 53 dhe pikën 3 të nenit 55, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ku respektivisht thuhet:

Pika 4, neni 53: “Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të argumentuara, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit...”

Pika 3, neni 55: “Vlerësimi i ofertave bëhet vetëm në baza teknike dhe ekonomike”.

Mos pasja e së njëjtës logo, nuk është as element teknik dhe as element ekonomik, që të ketë ndikim në lëvrimin e mallit, realizimin e kontratës, apo që të ndryshojë thellësisht kërkesat e DST.

KVO: E-Ka mospërputhje të pikave të ushtrimit të aktivitetit në Shqipëri për stacionet e furnizimit me vet deklaraten që ka paraqitur OE dhe deklarimeve në ekstraktin e QKR të shoqërisë.

Nga auditimi konstatohet se KVO nuk është shprehur se cilin kriter të DST nuk plotëson operatori ekonomik “O...” ShPK . Përshkrimi që ka bërë KVO në këtë rast, si mos plotësim kriteri, nuk përkon me asnjë nga kriteret e vendosura në DST apo specifikimet teknike, pasi nuk është kërkuar që operatorët ekonomik të paraqesin deklaratë për pikat e ushtrimit të aktivitetit në Shqipëri dhe që kjo deklaratë duhet të përkojë me deklaratimet në ekstraktin e QKR të shoqërisë. Pra për sa pretendohet më sipër nga KVO, nuk është kërkuar në DST.

Nga KVO është vepruar në kundërshtim me pikën 2 të nenit 55 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ku thuhet: “Autoriteti kontraktor vlerëson dhe krahason ofertat e vlefshme, për të përcaktuar ofertën fituese, në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nuk duhet të përdoret asnjë kriter, që nuk është përfshirë në dokumentet e tenderit”.

Si përfundim: KVO duhet të kishte kualifikuar OE “O...” ShPK sepse plotëson kriteret dhe specifikimet teknike të vendosura në DST.

Mbi kualifikimin nga KVO të operatorit ekonomik “G... C... G...” ShPK

Nga auditimi konstatohet se OE “G... C... G...” ShPK nuk plotëson të gjitha kriteret e vendosura në DST dhe konkretisht:

OE “G... C... G...” ShPK nuk plotëson kriterin e vendosur në pikën nr.4 të seksionit të kapacitetit teknik të DST, ku thuhet: “*Subjekti ofertues duhet të ketë minimalisht 1 automjet (autobote) në pronësi ose të vertetuara me akt noterial, për plotësimin e kërkesave për furnizimin e kaldajave dhe mjeteve të renda të institucionit të cilat nuk mund të levizën nga vendi i punës, për keto automjete ofertuesi duhet të paraqesi dokumentacion të vlefshëm në datën e hapjes së ofertave si: Leje qarkullimi, Kolaudim (SGS), Police Sigurimi, Certifikata e transportit të lendeve të rrezikshme dhe pasaporta e dhomave, të cilat duhet detyrimisht të jenë deri në 30’000 litra”.*

Për përmbushjen e këtij kriteri **OE “G... C... G...” ShPK** ka paraqitur dokumentacionin për mjetin autobot me targa AA0...T, të marrë me qira nga shoqëria ”G... O...” ShPK, për të cilën ka lidhur kontratë qiraje noteriale. Leja e qarkullimit e këtij mjeti është fotokopje e pa noterizuar dhe si i tillë është një dokument i pa vlefshëm, pasi nuk përmbush kriterin e vendosur në DST ku thuhet: “*Të gjithë dokumentet duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumenteve të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim”.*

Gjithashtu certifikata për transport mallrash të rrezikshme Brenda vendit, e lëshuar nga “Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor Durrës”, ka targë mjeti të pa lexueshme në mënyrë të plotë, pasi numrat e kësaj targe kanë mbivendosje me numra të tjerë,

duke mos bërë të qartë targën e mjetit. Pjesa e lexueshme e targës është vetëm AA...IT. Pra ky dokument është i pa vlefshëm, pasi nuk vërteton se i përket mjetit autobot me targë AA0....T.

Kriteri: Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 1 “Objekti dhe qëllimi”, pika b, d, dh; nenin 2 “Parimet e përzgjedhjes”, pika a, c; nenin 53 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3; 5; nenin 55 “Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese”, të ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Efekti: Në tenderin me objekt prokurimi “Blerje karburant për nevojat e Bashkisë Berat dhe drejtorive në vartësi”, me vlerë të fondit limit 17,790,833 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2020” komisioni vlerësimi të ofertave ka kualifikuar dhe shpallur fitues operatorin ekonomik “G... C... G...” ShPK, me marzh fitimi 16%, ose vlerë të ofertës ekonomike 16,382,394 lekë i cili nuk i plotëson kriteret e vendosura në DST, si dhe ka s’kualifikuar padrejtësisht operatorin ekonomik “O...” ShPK me marzh fitimi 5.3%, ose vlerë të ofertës ekonomike 14,855,147 lekë i cili plotëson kriteret e vendosura në DST, duke shkaktuar **dëm ekonomik në vlerën 1,527,247 lekë si diferencë midis dy ofertave**. KVO duhet të kishte kualifikuar OE “O...” ShPK dhe duhet ti kishte propozuar Titullarit të AK shpalljen e tij fitues, si operatori ekonomik me ofertën më të suksesshme.

Shkaku: Mos zbatim i legjislacionit në fuqi për vlerësimin e ofertave të OE dhe shpalljen e fituesit.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandim: Kryetari i Bashkisë të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për arkëtimin e vlerës **1,527,247** lekë pa TVSh nga anëtarët e KVO: z. L. B., me detyrë N/Kryetar i Bashkisë, z. P. S. me detyrë Drejtor i Drejtorisë Juridike, znj. E. M., me detyrë Specialiste e Prokurimeve Publike.

Për sa më sipër, për kualifikimin dhe skualifikimin e pa drejtë të operatorëve ekonomik dhe dëmin ekonomik të shkaktuar, **ngarkohet me përgjegjësi KVO:** z. L. B., me detyrë N/Kryetar i Bashkisë, z. P. S. me detyrë Drejtor i Drejtorisë Juridike, znj. E. M., me detyrë Specialiste e Prokurimeve Publike.

5.Mbi zbatimin e procedurave ligjore në tenderin me objekt “Blerje mjete për nevojat e Drejtorisë së Bujqësisë”, me vlerë të fondit limit 4,050,000 lekë pa TVSH , zhvilluar në vitin 2020”.

Mjeti do të shfrytëzohet për germim dhe largim dherash dhe inertesh.

Kohëzgjatja e kontratës 10 dite nga nënshkrimi i kontratës.

Numri i referencës së procedurës: REF-50399-02-13-2020		
1.Urdhër Prokurimi nr. 1 , datë 12.02.2020, nr.825 prot.	3. Njësia e Prokurimit, ngritur me urdhrin nr. 1 , datë 12.02.2020, nr.825 prot., A. Zh., F. K., E. C.	4.Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: Urdhër nr. 2, datë 12.02.2020: A. Sh., Xh. C., F. D.
2.Lloji i Procedurës së Prokurimit: Kerkese për propozime me mjete elektronike		
5.Fondi Limit 4,050,000 (pa TVSh)	6.Oferta fituese: “M...2...6” ShPK , me vlerë 4,000,000 lekë pa TVSh	7.Diferenca me fondin limit 50,000 (pa TVSh)
8. Data e hapjes së tenderit: 02.03.2020	9.Burimi Financimit: Të ardhurat e veta	10.Operatoret Ekonomik a)Pjesëmarrës në tender:3 OE b)S’kualifikuar 2 OE c) Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime: AK: Ankesa ka, me nr 1382 Prot ,date 09.03.2020, ka marre pergjigje me shkresen Nr.1382/1 Prot date 12.03.2020.	APP	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP:
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		

14.Lidhja e kontratës nr.1626 prot., datë 30.03.2020	15.Vlera e kontratës: 4,800,000 lekë me TVSh	16. Likuiduar vlera 4,800,000 lekë me TVSh
---	--	--

Nga AK është bërë ftesë për 5 operatorë ekonomikë: A... 2 ShPK, G. D., T., E. K., Dh.

Hartimi i kriterëve të veçanta të DST

Me urdhrin e prokurimit nr.1, datë 2.02.2020 të titullarit të AK z. E. D., është përcaktuar njësia e prokurimit e përbërë nga znj. F. K. (A.) juriste, me detyrë specialiste e prokurimeve, znj. A. Zh., ekonomiste, me detyrë specialiste e prokurimeve, z. E. C. inxhinier mekanik, me detyrë ish specialist në Drejtorinë e Bujqësisë, ndërprerë marrëdhëniet e punës në datën 18.10.2021, me urdhrin nr.562, datë 14.10.2021.

Urdhri i prokurimit rezulton i vulosur nga dega e thesarit Berat.

Titulli: Në DST janë vendosur kriterë të cilët nuk janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, elementë të cilët kanë efekt në kufizimin e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomik.

Situata: Për hartimin e kriterëve të veçanta të DST nga njësia e prokurimit është mbajtur procesverbali nr. ska, datë 13.02.2020.

Nga auditimi i kriterëve të veçanta të DST u konstatua se: Në kriteret e veçanta të kualifikimit të DST, pika 2.3 të kapacitetit teknik (ndryshuar me Shtojcën “Mbi modifikimin dhe ndryshimin e dokumenteve të prokurimit”), është vendosur kriteri si vijon: “*OE duhet të paraqesë dokumentacion ligjor sipas Legjislacionit në RSH për ti garantuar AK furnizimin me mallin e kërkuar... OE në momentin që bën dorëzimin e mjetit duhet të paraqesë dokumentacionin e nevojshëm që vërteton se për mjetin janë paguar të gjitha detyrimet doganore në RSH*”. Formulimi i kriterit për kapacitetin teknik në këtë mënyrë nuk është i saktë dhe i plotë, sepse nuk ka përcaktuar se cilat janë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomik për të përmbushur kriterin e kërkuar. Është detyrë e njësisë së prokurimit, të përcaktojë dokumentet që duhet të dorëzojnë operatorët ekonomik për çdo kriter të vendosur në DST. Pra cili është dokumentacioni ligjor që duhet të paraqesin operatorët ekonomik në mënyrë që autoriteti kontraktor të garantohet për furnizimin me mallin e kërkuar? Cili është dokumenti që duhet të paraqesin operatorët ekonomik që vërteton se për mjetin janë paguar të gjitha detyrimet doganore në RSH? Këto duhet të përcaktohen në DST nga njësia e prokurimit.

Hartimi i pasaktë, i pa plotë i kriterit të mësipërm, bënë që të jenë të pa qartë operatorët ekonomik për llojin e dokumentit që do të dorëzojë, si dhe të jetë i pa qartë komisioni i vlerësimit të ofertave gjatë kualifikimit dhe vlerësimit të ofertave, duke lënë shkak për interpretime të ndryshme, pa u mbështetur në një standard të caktuar, i cili është dokumenti që duhet të përcaktohet në DST.

Kriteri: Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me kërkesat e nenit 27, pika 3 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, ku thuhet: “*Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.*”

Gjithashtu në kriteret e veçanta të kualifikimit të DST, pika 2.3 të kapacitetit teknik është vendosur kriteri që “*Operatori duhet të paraqesë deklaratë se garanton servis të specializuar për riparimin e mjetit objekt prokurimi gjatë periudhës së garancisë duke deklaruar dhe emrat dhe adresat e serviseve*”. Ky kriter është i pa argumentuar teknikisht dhe ligjërisht,

përtej nevojave reale të AK dhe nuk është në përpjesëtim dhe i lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese të kontratës. Operatori ekonomik ka për detyrim të përgjigjet për periudhën e garancisë për defekte të mundshme, por jo detyrimin e përcaktimit të serviseve në momentin e hartimit të DST. Edhe nëse jepet kjo deklaratë nga OE, ajo është e njëanshme, pra nuk ka miratimin e servisit dhe për këtë arsye nuk i jep asnjë garanci shtesë AK. Ky kriter nuk ka lidhje me aftësinë teknike të operatorit ekonomik për zbatimin e kontratës. Në nenin 46 të LPP, pika (b), përcaktohet se aftësia teknike ka të bëjë me aftësinë teknike të vetë operatorit ekonomik ofertues për realizimin e kontratës (në rastin konkret jo me aftësinë teknike të servisit që në bashkëpunim me operatorin, merr angazhimin për riparimin e mjetit në rast defekti).

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me kërkesat e nenit 27, pika 3 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe nenin 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ku respektivisht thuhet: (VM 914): Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.

(LPP): Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese:

b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

Bazuar në VKM 914, datë 2.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 61, ku përcaktohet se “*Hartimi i kërkesave të veçanta për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret e vlerësimit (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit*”, **për anomalitë e mësipërme, ngarkohet me përgjegjësi** specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit z. E. C., inxhinier mekanik, me detyrë ish specialist në Drejtorinë e Bujqësisë, ndërprerë marrëdhëniet e punës në datën 18.10.2021, me urdhrin nr.562, datë 14.10.2021.

Ndikimi: Kufizim në pjesëmarrjen e OE në tender, si dhe krijimin e sitatave subjektive në vlerësimin e ofertave nga KVO.

Shkaku: Mos zbatim i kuadrit rregullator në fuqi për hartimin e kriterëve të veçanta të DST.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Berat të analizojë arsyet dhe të nxjerrë përgjegjësitë e anomalive të konstatuara në hartimin e kriterëve të veçanta të DST. Njësia e prokurimit në cdo procedurë të jap argumentim për cdo kriter të veçantë për kualifikim që lidhen me kapacitetin teknik dhe jo vetëm, të vendosur në DST dhe argumentet të dokumentohen me procesverbal.

Në DST dhe kontratë nuk është përcaktuar qartë marrja në dorëzim e mjetit, pasi nuk janë përcaktuar fazat nëpër të cilat do të kalojë ky proces. Në DST është përcaktuar se: Kontrolli fizik i mjetit për përputhshmërinë e specifikimeve teknike të kërkuara në DST do të bëhet pas lidhjes së kontratës brenda 10 ditëve nga lidhja e saj.

Si fazë e parë duhet të jetë dorëzimi i mallit pranë Autoritetit Kontraktor dhe verifikimi prej këtij të fundit nëse specifikimet teknike të mjetit përputhen më ato

të kërkuara në DST, si dhe kolaudimi i mjetit nga AK (kryerja e provave të nevojshme të funksionimit të mjetit, etj.).

Si fazë e dytë, pasi të jetë verifikuar se automjeti është në përputhje me specifikimet teknike, automjeti merret në dorëzim provizorisht nga Autoriteti Kontraktor dhe lidhet kontrata. Pas këtij momenti Autoriteti Kontraktor do të lejojë Kontraktuesin për tërheqjen e automjetit me qëllim kryerjen e procedurave të paisjes me targa dhe regjistrimin në emër të Bashkisë Berat (pasi në DST është përcaktuar se mjete do të jetë i pajisur me targa nga operatori ekonomik fitues).

Si fazë e tretë, dorëzimi në mënyrë përfundimtare e mjetit dhe hartimi i procesverbalit përfundimtar midis AK dhe OE.

Nga auditimi i specifikimeve teknike të përcaktuara në DST, konstatohet se nuk është përcaktuar fuqia motorike e mjetit, e cila është një specifikim i rëndësishëm për efektivitetin dhe eficienten e punës që do të kryej.

Vlerësimi i ofertave

Me urdhrin nr.2, datë 12.02.2020 të titullarit të AK z. E. D., është përcaktuar komisioni i vlerësimit të ofertave i përbërë nga z. Xh. C., me detyrë specialist në Drejtorinë e Bujqësisë, z. F. D., inxhinier mekanik, me detyrë përgjegjës i sektorit mekanik në Agjencinë e Shërbimeve Publike, z. A. Sh., me detyrë Zv/Kryetar i Bashkisë

Titulli: Kulifikim dhe skualifikim i pa drejtë i OE.

Situata: KVO në datën 24.03.2020 ka hartuar raportin përmbledhës nr. 1575 prot., në të cilin ka dokumentuar kualifikimin dhe skualifikimin e operatorëve ekonomik.

Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 3 operatorë ekonomik, prej të cilëve 2 janë skualifikuar dhe 1 është kualifikuar. Nga operatorët e kualifikuar është shpallur fitues operatori ekonomik “M...2...6” ShPK, me vlerën e ofertës ekonomike 4,000,000 lekë, e cila është vlera më e lartë nga ofertat pjesëmarrëse në tender, sipas të dhënave në tabelën e mëposhtme:

Nr	Operatorët pjesëmarrë në tender	Vlera e ofertës pa TVSH	Kualifikimi nga KVO	NIPT
2	“L... B...”	3 875 000	S’kualifikuar	
3	“P...”	3 951 000	S’kualifikuar	
1	“M...2...6” ShPK	4 000 000	Kualifikuar, fitues	

Arsyet e skualifikimit nga KVO të operatorit ekonomik “L... B...” ShPK :

Operatori ekonomik “L... B...” ShPK me oferte ekonomike: 3,875,000 (tremilion e teteqind e shatedhjetë e pese mijë).

KVO: Dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik nuk është në formën e duhur sipas legjislacionit në RSH dhe për më tepër nuk garanton Autoritetin Kontraktor për furnizimin me mallin e kërkuar. Dokumentacionin është i korrigjuar, pa vula dhe firma dhe nuk ka faturë për likuidimin e mallit objekt prokurimi nëpërmjet bankave të huaja dhe bankave të RSH. Nisur nga dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik konstatohet se ky dokument për mjetin objekt prokurimi, i paraqitur në sistem nuk e vërteton që mjete posedohet nga ofertuesi. Vertetimi noterial i paraqitur vërteton firmën e përkthyesit dhe jo dokumentin origjinal. Në këto kushte dokumenti i paraqitur nga ofertuesi nuk e plotëson dhe e garanton Autoritetin Kontraktor për furnizimin e mallit.

Nga auditimi konstatohet se KVO ka skualifikuar OE “L... B...” ShPK për arsye se ky operator nuk ka paraqitur dokumentacion të saktë që të garantoj Autoritetin Kontraktor për furnizimin e mallit. Së pari sqarojmë se mënyra e të shprehurit të KVO duhet të jetë më e qartë, duke ju referuar konkretisht krierve të vendosura në DST, të cilat operatori ekonomik nuk i plotëson. Pra KVO duhet të shprehet se *operatori ekonomik nuk plotëson kriterin nr...të*

vendosur në seksionin nr...të DST, ku është kërkuar se.... Kjo duhet të kihet në konsideratë nga KVO në të ardhmen.

Për të garantuar Autoritetin Kontraktor për furnizimin e mallit, në DST është kërkuar: *Për mjetin operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin si më poshtë: OE duhet të paraqesë dokumentacion ligjor sipas Legjislacionit në RSH për ti garantuar AK furnizimin me mallin e kërkuar.*

Për të përmbushur plotësimin e kriterit të mësipërm OE “L... B...” ShPK ka paraqitur dokumentin bankar datë 28.02.2020, të Bank Polska Warszawa (Banka e Polonisë), ku është përcaktuar subjekti shitës P... G... S..., R... dhe subjekti blerës OE “L... B...” ShPK. Në dokument është përcaktuar se është blerë mjeti JBC08.....451, me vit prodhimi 2008, orë pune 4695, peshë 8300 kg. Dokumenti i paraqitur është në anglisht dhe në shqip, i përkthyer nga përkthyes zyrtar dhe vërtetuar firma e përkthyesit nga noteri.

Dokumenti i mësipërm garanton Autoritetin Kontraktor për furnizimin me mallin e kërkuar nga OE “L... B...” ShPK, pasi ky i fundit vërteton se ka blerë mjetin e kërkuar nga AK, aq më tepër që specifikimet teknike do të verifikohen imtësisht në momentin e dorëzimit të mjetit pranë komisionit që ngrihet për këtë qëllim.

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:

Në tenderin me object “Blerje mjeti për nevojat e Drejtorisë së Bujqësisë”, me vlerë të fondit limit 4,050,000 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2020, kanë marrë pjesë tre operatorë ekonomik. Nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Berat është kualifikuar dhe shpallur fitues operatori ekonomik “M...2...6” ShPK, me vlerë të ofertës ekonomike 4,000,000 lekë dhe është skualifikuar padrejtësisht operatori ekonomik “L... B...” ShPK me vlerë të ofertës ekonomike 3,875,000 lekë pa TVSH, i cili plotëson kriteret e vendosura në DST dhe është oferta me vlerën më të ulët.

Kriteri: Për sa më sipër nga KVO nuk është siguruar mirëpërdorim i fondeve publike dhe trajtim i barabartë midis operatorëve ekonomik, nuk janë respektuar parimet e përzgjedhjes së operatorëve ekonomik dhe ofertës fituese.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me kërkesat e ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, sipas neneve të mëposhtëm:

- nenin 1 ku thuhet se “Qëllimi i këtij ligji është:.. b) të sigurojë mirë përdorim të fondeve publike.., d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik, ...

-nenin 2 “Parimet e përzgjedhjes”, ku thuhet “Përzgjedhja e fituesve të kontratave publike realizohet në përputhje me këto parime të përgjithshme: a) mos diskriminim dhe trajtim i barabartë i ofertuesve ose kandidatëve, c) barazi në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve;

- pikën 5, të nenit 53 “Shqyrtimi i ofertave”, ku thuhet: “Autoriteti kontraktor nuk e pranon një ofertë kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit”;

- nenin 55, ku thuhet: “Oferta fituese duhet të jetë: a) oferta që, në bazë të kërkesave dhe kriteve të përcaktuara në dokumentet e tenderit, plotëson kërkesat e objektit të prokurimit **me çmimin më të ulët.**

Gjithashtu veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, i neni 2 ku thuhet: “Qëllimi i këtij ligji është përdorimi sa më eficient, efektiv dhe ekonomik i burimeve financiare publike, duke respektuar parimet e transparencës dhe të ligjshmërisë, si dhe shmangia e shpërdorimit, keqpërdorimit dhe vjedhjes së pasurisë.

Efekti: Anomalitë e mësipërme të kryera nga KVO në vlerësimin e ofertave, kanë sjellë dëm

ekonomik në vlerën 125,000 lekë pa TVSh, si diferencë midis dy ofertave të operatorëve ekonomik.

Shkaku: Mos zbatim i kuadrit rregullator në fuqi për vlerësimin e ofertave të OE dhe shpalljen e fituesit.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandim: Kryetari i Bashkisë të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për arkëtimin e vlerës 125,000 lekë pa TVSh nga anëtarët e KVO: z. Xh. Ç., me detyre specialist në Drejtorinë e Bujqësisë, z. F. D., inxhinier mekanik, me detyrë përgjegjës i sektorit mekanik në Agjencinë e Shërbimeve Publike, z. A. Sh., me detyrë Zv/Kryetar i Bashkisë.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave: z. Xh. Ç., me detyre specialist në Drejtorinë e Bujqësisë, z. F. D., inxhinier mekanik, me detyrë përgjegjës i sektorit mekanik në Agjencinë e Shërbimeve Publike, z. A. Sh., me detyrë Zv/Kryetar i Bashkisë.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të raportit përfundimtar të auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacion (për aktet e konstatimit) me shkresën protokolluar në KLSH me nr.55/5 datë 26.04.2022si dhe nëpërmjet postës elektronike në adresën b...m...@klsh.org.al datë 22.04.2022, nga z. A. Sh., z. Xh. Ç., z. F. D., anëtare të KVO. Gjithashtu “Mbi projektraportin e auditimit”, nga të njëjtët persona si më sipër, nga subjekti i audituar është paraqitur observacion, nëpërmjet postës elektronike në adresën b...m...@klsh.org.al datë 20.06.2022, protokolluar në KLSH me nr.55/9 prot, datë 06.06.2022 ku janë shprehur të njëjtat objeksione, si ato të bëra për përmbajtjen e akteve të konstatimit. Në të dy rastet observacionet janë të njëjta, nuk ka argumente shtesë në observacionet e bëra për prjektraportin e auditimit. Për të dy rastet, nga subjekti i audituar janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendim i subjektit: KVO në procedurën me objekt “Blerje mjeti për nevojat e Drejtorisë së Bujqësisë” ka qënë conform ligjit 9643,datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, ka ndjekur procedurën dhe ka arritur në kokluzion se Oferta e operatorit "L... B..." nuk është e saktë pasi nuk vërteton që operatori ka posedim të mjetin dhe nuk jep garanci KVO për përmbushjen të furnizimit të kërkuar.

Në faqen e porosisë ofertuese nuk rezulton e firmosur, mungon firma tek blerësi dhe kontrata ishte bosh.

Dokumenti vërtetues është i korigjuar dhe për më tepër nuk rezulton të ketë letër banke për porositjen e mjetit. Kontrata është e një forme që nuk e njeh legjislacioni shqiptar pasi kjo kontratë nuk ka objekt, qëllim, afat, detyrime palësh.

Dokumentet e sjella nuk janë bindëse për vërtetësinë e tyre si dhe çdo operator ekonomik mund të skanoj një dokument të tillë nga internet që ta përkthej, pasi notarja ka noterizuar vetëm përkthyesin dhe jo origjinalitetin e dokumentit.

Fotot e paraqitura nga operatori lehtësisht mund të gjenden në internet dhe mund të serviren sikur të ishte ky mjet. Këto foto nuk kanë paraqitur asnjë lidhje me distributorin. fotot janë pa datë të cilat munt vërtetojnë se OE nuk e disponon këtë mjet.

Qëndrim i grupit të auditimit: KVO nuk shqyrton dokumentin në anglisht, por atë të përkthyer në shqip. Është sqaruar kjo çështje nga audituesi në aktin e konstatimit, material i cili është pjesë edhe e këtij raporti. Për të mos krijuar përsëritje referoju materialit më lart në vlerësimin e ofertave. Ju nuk keni dhënë fakte dhe prova të reja dhe për këtë arsye observacioni juaj nuk merret në konsideratë.

6.Mbi zbatimin e procedurave ligjore në tenderin me objekt “Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete te varfëra dhe të pa favorizuara”, me vlerë të fondit limit 9,942,305 lekë pa TVSH , zhvilluar në vitin 2020”

Kohëzgjatja e kontratës 60 dite nga nënshkrimi i kontratës. Do të restaurohen gjithsej 14 banesa ekzistuese.

Numri i referencës së procedurës: REF-50399-02-13-2020		
1.Urdhër Prokurimi nr. 42, datë 10.08.2020	3. Njësia e Prokurimit, ngritur me urdhrin nr. 42 , datë 10.08.2020: A. Zh., F. K., M. S.	4.Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: Urdhër nr.41 datë 10.08.2020 P. S., L. B., E. M.
2.Lloji i Procedurës së Prokurimit: Kerkese per propozime me mjete elektronike		
5.Fondi Limit 9,942,305 (pa TVSh)	6.Oferta fituese: “Z...” ShPK , me vlerë 9,447,915 lekë pa TVSh	7.Diferenca me fondin limit 494,390 lekë (pa TVSh)
8. Data e hapjes së tenderit: 26.08.2020	9.Burimi Financimit: Të ardhurat e veta dhe Buxheti i Shtetit	10.Operatoret Ekonomik a)Pjesëmarrës në tender:1 OE b)S’kualifikuar 1 OE c) Kualifikuar - OE
11.Ankimime: AK: Jo	APP	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP:
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
14.Lidhja e kontratës nr.3756/10, datë 22.09.2020	15.Vlera e kontratës: 11,337,498 lekë me TVSh	16. Likuiduar 11,337,498 lekë me TVSh

Nga AK është bërë ftesë për 5 operatorë ekonomikë: A... 2 ShPK, G. D., T., E. K., Dh.

Hartimi i kriterëve të DST

Me urdhrin e prokurimit nr. 42, datë 10.08.2020 të titullarit të AK z. E. D., është përcaktuar njësia e prokurimit e përbërë nga znj. F. K. (A.) juriste, me detyrë specialiste e prokurimeve, znj. A. Zh., ekonomiste, me detyrë specialiste e prokurimeve, znj. M. S., inxhinierë ndërtimi, me detyrë përgjegjëse e sektorit të pronave.

Për hartimin e kriterëve të veçanta të DST, nga njësia e prokurimit është mbajtur procesverbali nr.3756/2, datë 10.08.2020.

Titulli: Mos argumentim i kriterëve të veçanta për kualifikim të DST që lidhen me kapacitetin teknik, si dhe vendosja e kriterëve të cilat nuk janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, elementë të cilët kanë efekt në kufizimin e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomik.

Situata: Nga auditimi i kriterëve të veçanta të DST u konstatua se:

- Në DST është përcaktuar kriteri se OE duhet të paraqesin “Një dokument qe vërteton se ka plotësuar detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore ku ka ushtruar aktivitetet per vitin 2018 dhe 2019”. Mënyra e formulimit të këtij kriteri është trajtuar edhe në procedurë tjetër prokurimi në këtë akt konstatimi. Gjithashtu me qëllim që AK të përmirësoj mënyrën e formulimit, theksojmë se nuk është e nevojshme periudha kohore që i referohet AK, pasi këto detyrime janë progresive dhe përfshijnë periudha ndoshta edhe më shumë se dy vjet. Për të shmangur këtë, është e mjaftueshme dhe e nevojshme që të kërkohet që OE nuk janë debitor për taksat dhe tarifat vendore, bazuar në detyrimet që rrjedhin nga paketa fiskale e njësive vendore ku kanë zhvilluar dhe zhvillojnë aktivitetet. Kjo përfshin dhe nënkupton çdo periudhë, si vitin buxhetor edhe periudhën përpara vitit buxhetor.

• Në pikën 3.1, të seksionit 3, licenca profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës, është kërkuar që OE të kenë licencën e shoqërisë N.S-8-A (Punime topogjeodezike).

Kërkesa për licencë nuk ka lidhje të ngushtë me objektin e prokurimit, sepse referuar lidhjes 3 “Shpjegime për kategoritë e ndërtimeve (punimeve) të përgjithshme”, të VKM nr.42, datë

16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, Punime topogjeodezike. Konsiderohet zbatimi i rëlvimeve topografike speciale që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, punime topogjeodezike në objekte inxhinierike, punime speciale gjeodezike; rrjeta mbështetëse dhe qëndrueshmëri terrenesh”.

Nga auditimi i zërave të punimeve të preventivit të hartuar nga AK, nuk konstatohet nevoja e licencës së mësipërme N.S-8-A. Për sa më sipër është në kundërshtim me përcaktimet e pikës 1, të nenit 46 të LPP dhe pikës 5, të nenit 26, të VKM nr.914, datë 29.12.2014, ku përcaktohet që cdo kriter i veçantë duhet të jetë në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës.

- Në pikën 5 të kapacitetit teknik të kriterëve të veçanta të DST është kërkuar që OE të paraqesin “Listpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohe nga legjislacioni ne fuqi për periudhën Janar 2020 – Qershor 2020 si dhe urdhërpagesat e secilit muaj”.

Paraqitja e urdhër pagesave është një kriter i cili e siguron AK se OE kanë shlyer detyrimet e tyre për sigurimet shoqërore dhe shëndetësorë, si dhe për TAP. Kjo gjë mund të realizohet vetëm më një vërtetim të cilin OE mund ta marrin nga organet përkatëse tatimore dhe nuk është e nevojshme që OE të ngarkojnë në sistem disa dokumente për plotësimin e këtij kriteri.

- Në pikën 6 të kapacitetit teknik të kriterëve të veçanta të DST është kërkuar:

“Operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet te ketë inxhinier drejtues teknik te përfshirë ne licencën e shoqërisë se ndërtimit me kontrate pune dhe ne listë pagesa te paktën 6 mujorin e fundit si me poshtë: Inxhinier Ndërtimi 1(një), Inxhinier Hidroteknik1 (një), Inxhinier elektrik 1 (një), Inxhinier Mekanik 1(një). Përcaktimi në këtë kriter nga AK i afatit kohor prej 6 muaj, pra që 4 inxhinierët e kërkuar duhet të jenë ne listë pagesa te paktën 6 mujorin e fundit, është i pa argumentuar dhe i pa nevojshëm. Përcaktimi i këtij afati kohor nuk i jep asnjë siguri shtesë AK për kapacitetin teknik të OE dhe për realizimin me sukses të kontratës prej tij. Është e mjaftueshme që këta punonjës të jenë në listë pagesën e shoqërisë, qoftë edhe në muajin e fundit (Nëse një OE plotëson kriteret e DST, por ka këta punonjës jo për 6-mujorin e fundit, por për 3 – mujorin e fundit, apo muajin e fundit, a duhet të s’kualifikohet OE?! Cili është ndryshimi nëse janë të punësuar në 6 – mujorin e fundit, apo në muajin e fundit?).

- Në pikën 6.2 të kapacitetit teknik të kriterëve të veçanta të DST është kërkuar që “Operatori ekonomik duhet të ketë ne stafin e tij 1 (nje) teknik topograf me kontrate pune, certificate aftësie profesionale, dëshmi kualifikimi për sigurimin teknik”.

Kërkesa për teknik topograf është e paargumentuar dhe e palidhur ngushtë me natyrën e kontratës, pasi objekti i prokurimit ka të bëjë me restaurime të banesave, të cilat nuk diktojnë nevojën e specialistit topograf (zërat e preventivit nuk janë të lidhur me nevojën për topograf).

-Në pikën 6.3 të kapacitetit teknik të kriterëve të veçanta të DST është kërkuar që “Operatori ekonomik duhet të ketë ne stafin e tij 2 (dy) **manovrator**, me kontrate pune, dëshmi aftësie profesionale, dëshmi kualifikimi per sigurimin teknik dhe polica e sigurimit”.

Vihet re pasaktësi në hartimin e kriterëve, pasi është kërkuar polica e sigurimit edhe për punonjësit (ndërkohë që është një dokument që paraqitet për mjetet e transportit). Kjo pasaktësi reflekton se duhet të rritet përgjegjshmëria gjatë hartimit të kriterëve të DST.

- Në pikën 6 dhe 6.4 të kapacitetit teknik të kriterëve të veçanta të DST është kërkuar respektivisht që operatorët ekonomik të kenë të punësuar për një periudhë 6-mujore (inxhinieri) dhe 3-mujore (mekaniku), një inxhinier mekanik dhe dy specialist mekanik (të mesëm).

Kërkesa për këta punonjës është e pa argumentuar teknikisht dhe ligjërish, si dhe e pa nevojshme, pasi nuk ka zëra punimesh që lidhen me nevojën e këtij profesioni.

- Në pikën 7 të kapacitetit teknik të kriterëve të veçanta të DST është kërkuar:

“Në përputhje me VKM nr.692 date 13.12.2001 "Per masat e veçanta të sigurimit dhe ruajtjes se shëndetit ne pune, te ndryshuar me VKM nr.742 date 06.11.2003 " te ketë te punësuar 1 (nje) mjek te pajisur me license, kjo te shoqërohet me Kontratë pune Noteriale, Leje Individuale per Ushtrimin e Profesionit te Mjekut dhe CV”. Baza ligjore të cilës i referohet AK për mjekun është e gabuar, sepse është shfuqizuar nga VKM nr. 632, datë 15.07.2015, e cila ka ndryshuar VKM nr. 108, datë 9.2.2011 “Për aftësi që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë”.

- Nga auditimi i kriterëve të kapacitetit teknik të DST, konstatohet se është kërkuar:

Operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet te kenë një punësim mesatar jo me pak se 40 (dyzetë) punonjësish, për periudhën janar 2020 – qershor 2020, si dhe një numër i konsiderueshëm mjetesh, të cilat janë të pa argumentuara teknikisht në procesverbalin e mbajtur për këtë qëllim. Për numrin e kërkuar nuk ka një argumentim i cili të lidhet me grafikun e punimeve, preventivim dhe orët e punës. Numri i punonjësve dhe numri i makinerive nuk janë në përputhje me përmasën e kontratës dhe zërave dhe volumit të punimeve, efektet e të cilave ndikojnë në kufizimin e pjesëmarrjes së ofertuesve të mundshëm, të cilët disponojnë kapacitetin teknik dhe profesional të nevojshëm për ekzekutimin e kontratës, me një numër më të ulët punonjësish dhe makinerish se ai i kërkuar në DST.

- Në pikën 8 të seksionit të kapacitetit teknik të kriterëve të veçanta të DST, kriteri **dëshmi për mjetet e pajisjet teknike**, janë kërkuar:

- Në total 4 kamionë vetëshkarkues, nga të cilët 3 kamionë vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 15-20 ton dhe 1 kamionë vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 10 ton, si dhe 3 copë kamionçina deri 3.5 ton, 1 kamionçinë 3.5-7.5 ton ndërkohë, të cilat nuk janë të argumentuara teknikisht.

Kapaciteti total i mjeteve kamion dhe kamioncinë vetëshkarkuese që është kërkuar në DST është 69 deri më 88 tonë

Nga auditimi i preventivit të hartuar për zbatimin e kontratës, konstatohet se zëri “Transport materiale ndërtimi, dheu me auto deri në 5 km, ka volumin e punimeve sipas banesave që do të restaurohet, si më poshtë vijon:

- a) Rikonstruksion i banesës së Y. M., sasia 6 m³;
- b) Rikonstruksion i banesës së A. C., sasia 9.3 m³;
- c) Rikonstruksion i banesës së B. R., 31 m³;

Pra janë gjithsej 46.3 m³ materiale ndërtimi dhe dheu për tu transportuar në distancën deri 5 km nga vendndodhja e punimeve.

- Janë kërkuar **4 mjete të rënda**: 1 Fadrome/Skrepe, 1 Minieskavator, 1 Minifadrome/Bobcat, 1 Eskavator me zinxhirë, kërkesa të cilat jo vetëm janë të pa argumentuara teknikisht, por numri i mjeteve të kërkuara nuk rakordon me numrin e punonjësve që shërbejnë për drejtimin e këtyre mjeteve, pasi në pikën 6.3 të kapacitetit teknik të kriterëve të veçanta të DST është kërkuar që “*Operatori ekonomik duhet te ket ne stafin e tij 2 (dy) manovrator*”. **Pra dy nga mjetet e kërkuara mbeten pa manovrator (drejtues mjeti).**

Kërkesa e pa argumentuar për 1 Eskavator me zinxhire, ka sjellë edhe kërkesën për 1 Rimorkiator, duke e shtuar më shumë numrin e mjeteve të cilat nuk kanë argumentim teknik. Nga ana tjetër kërkesa për rimorkiator, nuk është shoqëruar me kërkesën për drejtues mjeti për rimorkiator, elementë të cilët janë në kontradiktë me njëri-tjetrin.

- Për të plotësuar nevojën që kanë për ujë punimet që do të kryhen, të cilat janë kryesisht përgatitja e materialit për suvatime dhe shtresa përpara vendosjes së pllakave, pasi nuk ka përgatitje betoni për shkak se është parashikuar për këtë qëllim autobetoniere, janë kërkuar 2 autobote uji dhe 15 copë depozita uji me kapacitet 1000 litër secila. Kërkesa për 15 copë

depozita uji me kapacitet 1000 litër secila, është e pa argumentuar, pasi janë 14 banesa për restaurim dhe nëse do të nevojitej për secilën banesë një depozitë, atëherë maksimalisht do të duheshin 14 depozita uji.

Kërkesa për 2 autobote uji është e pa argumentuar, e pa lidhur me madhësinë e kontratës dhe nevojat reale të zbatimit të saj, pasi 15 copë depozita uji me kapacitet 1000 litër secila për 14 banesa që do të restaurohen, është i mjaftueshëm 1 autobus uji.

- Gjithashtu kërkesa për 2 autobote, është e pa shoqëruar me kërkesën për drejtues mjeti për 2 autobotet, dy elementë pjesë integrale e të njëjtit kriter që janë në kundërshtim me njëri-tjetrin. Si do të realizohet kontrata me mungesën e drejtuesve të mjetit?

- Janë kërkuar fabrikë betoni me QKL i copë, linje prodhimi për pllaka e bordura, fabrikë për prodhimin e dyerve dhe dritareve pvc dhe duralumini: në pronësi, me qira, ose kontratë furnizimi. Kriteri i mësipërm edhe pse janë vendosur alternativat edhe me kontratë furnizimi, është i pa argumentuar, për volumin e punimeve që do të kryhen, pasi betoni, pllakat dhe dyer e dritare alumini, janë mallra të cilat gjendet lehtësisht në treg dhe nuk është e nevojshme të paraqiten kontrata paraprake pronësie, kontrata qiraje, apo furnizimi.

Nga auditimi konstatohet se sasia e dyerve dhe dritareve duralumin që nevojiten për realizimin e kontratës, bazuar në preventivin e hartuar nga Autoriteti Kontraktor është 38.8 m², sasi e cila nuk justifikon kriterin e vendosur që operatorët ekonomik të dëshmojnë se kanë fabrikë për prodhimin e dyerve dhe dritareve pvc dhe duralumini: në pronësi, me qira, ose kontratë furnizimi. Gjithashtu nuk ka asnjë dritare apo derë me material pvc, por vetëm me duralumin, por fabrika është kërkuar edhe për prodhim dritare e dyer me pvc.

- Konstatohet se në rastet kur ka qenë e planifikuar në preventiv nevoja për dyer të brendshme druri, këto janë kërkuar dyer të brendshme druri importi (me formulimin: Furnizim vendosje dyer të brendshme druri importi, cilësi e parë). Përcaktimi i dyerve “Importi” është i pa argumentuar dhe nuk favorizon prodhimin vendas.

Sasia e dritareve dhe dyerve të kërkuara në preventiv:

Banesa e qytetares z. Y. M.:

-Furnizim vendosje dyer të brendshme druri importi, cilësi e parë, 5.7 m²

-Dritare duralumin dyfish xham, 7.5 m²;

-Dyer të blinduara importi, 2.1 m²

Banesa e qytetarit z. A. C.:

-Dyer duralumini tek xham, 3.6 m²

-Dyer duralumini dopjo xham, 1.9 m²

Banesa e qytetarit z. B. R.:

-Furnizim vendosje dyer të brendshme druri importi, cilësi e parë, 9 m²

-Dritare duralumin dyfish xham, 7.2 m²;

Banesa e qytetarit z. K. K.:

-Furnizim vendosje dritare druri, kas binari tek xham, 6.3 m²

Banesa e qytetarit z. P. D.:

-Furnizim vendosje dritare duralumini tek xham, 3.2 m²;

-Furnizim vendosje dyer duralumini pa xham, me mbushje d/a, 1.4 m²

Banesa e qytetarit z. M. K.:

-Furnizim vendosje dyer të brendshme druri importi, cilësi e parë, 6.7 m²;

Dyer dhe dritare duralumin dyfish xham, 14 m².

Në mënyrë të përmbledhur, sasi e dyerve dhe dritareve duralumin të kërkuara në preventiv, është sipas tabelës në vijim:

Emërtimi	Përfituesi	Sasia në m ²
Dritare duralumin dyfish xham	Y. M.	7.5
Dyer duralumini tek xham	A. C.	3.6
Dyer duralumini dopjo xham	A. C.	1.9
Dritare duralumin dyfish xham	B. R.	7.2

Furnizim vendosje dritare duralumini tek xham	P. D.	3.2
Furnizim vendosje dyer duralumini pa xham, me mbushie d/a	P. D.	1.4
Dyer dhe dritare duralumin dyfish xham	M. K.	14
Total sipërfaqja ne m2 për dyer dhe dritare duralumini		38.8

- Janë kërkuar 45 copë jelek dhe 45 cope kokore, ndërkohë që numri i kërkuar i punonjësve është kërkuar 40, si dhe janë kërkuar këpucë pune, por pa përcaktuar numrin e nevojshëm të palëve të tyre.

-Është kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë metodologji të detajuar te aktivitetit te ndërtimit (ofertuesi duhet te shpjegojnë te gjitha aktivitetet qe do te kryhen për te arritur realizimin e objektit), kriter i pa qartë dhe i pa argumentuar, diskriminues, kriter që kufizon pjesëmarrjen e operatorve ekonomik.

Konkluzion:

Nuk janë argumentuar kriteret për kapacitetin teknik të vendosura në DST, nuk janë dokumentuar me procesverbal dhe nuk janë bërë pjesë e DST këto argumente, të cilat duhet të shpjegojnë nevojën e vendosjes së kriterëve teknike. Kuadri rregullator në fuqi kërkon që ***cdo kriter i veçantë dhe specifikim teknik duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht***, si dhe të dokumentohet në një procesverbal.

Këto veprime janë në kundërshtim me pikën 2, të nenit 61 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, ku thuhet “*Hartimi i kërkesave të veçanta për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret e vlerësimit (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit.*

Kriteri: Janë vendosur kriteret të pa argumentuar teknikisht dhe ligjërisht, përtej nevojave reale të AK, të cilët nuk janë në përpjesëtim dhe të lidhur ngushtë me aftësinë zbatuese të kontratës, në kundërshtim me kërkesat e nenit 26, pika 5 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe nenin 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ku respektivisht thuhet: Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.

Kriteret e vendosura që rezultojnë të pa nevojshme dhe të pa lidhura ma natyrën e kontratës janë gjithashtu diskriminuese, kriteret të cilat kanë efekt në kufizimin e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomik në tender, të vendosura në kundërshtim me nenin 20 të LPP ku përcaktohet: “*Autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo kriter, kërkesë apo procedurë, që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, që përbën diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktorëve ose ndaj kategorive të tyre*”.

Ndikimi: Kufizim i OE në pjesëmarrje në tender dhe ulje e konkurrencës.

Shkaku: Moszbatim i kërkesave të kuadrit rregullator në fuqi për hartimin e kriterëve tëvecanta të DST.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Berat të analizojë arsyet dhe të nxjerrë përgjegjësitë e anomalive të konstatuara në hartimin e kriterëve të veçanta të DST. Njësia e prokurimit në cdo procedurë të jap argumentim për cdo kriter të veçantë për kualifikim që lidhen me kapacitetin teknik dhe jo vetëm, të vendosur në DST dhe argumentet të dokumentohen me procesverbal.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të raportit përfundimtar të auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacion (për aktet e konstatimit) me shkresën protokolluar në KLSH me nr.55/5 datë 26.04.2022, si dhe nëpërmjet postës elektronike në adresën b...m...@klsh.org.al datë 22.04.2022, nga znj. F. K. (A.) juriste, znj. A. Zh., ekonomiste, znj. M. S., inxhinieri ndërtimi, anëtare të njësies së prokurimit. Gjithashtu “Mbi projektraportin e auditimit”, nga të njëjtët persona si më sipër, nga subjekti i audituar është paraqitur observacion, nëpërmjet postës elektronike në adresën b...m...@klsh.org.al datë 20.06.2022, protokolluar në KLSH me nr. 55/9 prot, datë 06.06.2022, ku janë shprehur të njëjtat objeksione, si ato të bëra për përmbajtjen e akteve të konstatimit. Në të dy rastet observacionet janë të njëjta, nuk ka argumente shtesë në observacionet e bëra për projektraportin e auditimit. Për të dy rastet, nga subjekti i audituar janë shprehur objeksionet si më poshtë:

1-Prendim i subjektit: Në lidhje me konstatimet për pikën e licencës NS 8 A sqarojmë se: Kjo pike e licencës është mese e nevojshme me qëllim që subjekti të kryej punime te cilat janë te domosdoshme për rilevime dhe topografike për zbatimin e projektit dhe te punimeve. Punime të cilat janë të shpërndara në disa zona rurale në Qarkun e Beratit.

1-Qëndrim i grupit të auditimit: Në observacion, nuk keni dhënë argumente teknike për kërkesën në DST të licencës NS 8 A dhe për këtë qëllim kundërshtia juaj për këtë çështje nuk merret në konsideratë.

2-Prendim i subjektit: Për te provuar kapacitetet teknike dhe profesionale te shoqërisë është kërkuar personeli i nevojshëm inxhinierik referuar zërave te preventivit te objektit për realizimin e kontratës ne mbështetje te germës “b”, te pikës 1 të nenit 46 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij drejtues teknik të cilët kanë një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punimeve pasi ata janë përgjegjës për zbatimin e objektit sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij. Dokumentacioni plotësues i kërkuar në kriteret e veçanta për kualifikim pjesë përbërëse e dokumenteve të tenderit, sikundër janë, kontratë pune e vlefshme, CV apo qenësia e tyre në listpagesat e shoqërisë, janë vendosur për arsye se me paraqitjen e këtij dokumentacioni vërtetohet se këta drejtues teknikë apo punonjës janë operativë pranë Ofertuesve të mundshëm dhe në këtë mënyrë Autoriteti Kontraktor krijon bindjen se Operatorët ekonomikë pjesëmarrës zotërojnë personelin e nevojshëm për realizimin me sukses të objektit që prokurohet.

2-Qëndrim i grupit të auditimit: Në observacion, nuk keni dhënë argumente teknike për kriterin që 4 inxhinierët e kërkuar duhet të jenë ne listë pagesa te paktën 6 mujorin e fundit. Ky kriter është i pa argumentuar dhe i pa nevojshëm dhe për këtë arsye kundërshtia juaj për këtë çështje nuk merret në konsideratë.

3-Prendim i subjektit: Në lidhje me konstatimet për “Ekspert sigurie për mbrojtjen e shëndetit në punë” sqarojmë: Argumentimi mbi kriterin “Operatori ekonomik ofertues me qëllim respektimin e standardeve të sigurisë konform ligjit nr. 10237 datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr.312 date 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”, duhet të dëshmojë se ka pjesë të stafit të shoqërisë personel të trajnuar/certifikuar) punonjës arsyetohet se.....

Bazuar ne dispozitat e mësipërme janë detyrimet e punëdhënësit në përdorimin e pajisjeve të punës në lartësi Punëdhënësi, në rastet kur kryen punime të përkohshme në lartësi, të cilat nuk mund të realizohen në kushte sigurie dhe në kushte ekonomike të përshtatshme duke filluar që nga mungesa e vendit të përshtatshëm me qëllimin, zgjedh pajisjet e punës më të përshtatshme për të garantuar mbajtjen e kushteve të punës të sigurt, në përputhje me kriteret e mëposhtme: a) i jep prioritet masave mbrojtëse kolektive në lidhje me masat e mbrojtjes individuale; b) dimensionon pajisjet e punës, të përshtatshme me natyrën e punës

që duhet kryer, me sinjalizimet e parashikueshme dhe me qarkullim pa shkaktuar rrezik. Punëdhënësi zgjedh mënyrën më të përshtatshme për hyrjen në vendin e punës të përkohshëm në lartësi, në raport me frekuencën e qarkullimit, me disnivelelin dhe kohën e nevojshme për këtë. Rrugët e hyrjes duhet të lejojnë evakuimin në rast rreziku. Kalimi nga një sistem i hyrjes në platformë, struktura provizore, skela, ura dhe anasjelltas nuk duhet të sjellë rrezik rënie.

3-Qëndrim i grupit të auditimit: Kundërshtia juaj për këtë çështje merret në konsideratë për arye se keni dhënë argumentime ligjore.

4-Prendim i subjektit: Në lidhje me konstatimet në pikën 6.3 të kapacitetit teknik për teknik topograf sqarojmë se për te provuar kapacitetet teknike dhe profesionale te shoqërisë është kërkuar licenca profesionale e shoqërisë sipas përcaktimit të bërë në germën (a) te pikës 8 të Nenit 26, Seksioni II, Kreu III të VKM Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik (i ndryshuar), si dhe në mbështetje te Ligjit Nr.9643, date 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, Neni 46, pika 1, germat (a) dhe (b). Topografi kryen matjet topografike në terren.

4-Qëndrim i grupit të auditimit: Nuk keni bërë argumentim nga ana teknike për nevojën e topografit. Punimet janë të karakterit restaurues dhe kërkesa për topograf nuk lidhet me nevojën reale të zbatimit të kontratës, me asnjë nga zërat e preventivit. Observacioni për këtë çështje nuk merret në konsideratë.

5-Prendim i subjektit: Në lidhje me konstatimet për mekanik në pikën 6 dhe 6.4 të DST është i domosdoshme për ç’do ofertues bazuar për mjetet e nevojshme për ekzekutimin e kontratës. Gjithashtu duke ju referuar preventivit te punimeve për punime mekanike, sqarojmë se sipas zërave të preventivit dhe makinerive që duhet të përdoren për këto punime, montimin e pajisjeve dhe mirëmbajtjen e makinerive të punës, nevojiten specialist mekanik në objekt, duke garantuar A.K për zbatimin e punimeve me sukses dhe në kohë, si dhe pa shkaktuar ndonjë incident në punë.

5-Qëndrim i grupit të auditimit: Nuk keni bërë argumentim nga ana teknike për nevojën e mekanikut. Kërkesa për mekanik nuk lidhet me nevojën reale të zbatimit të kontratës, me asnjë nga zërat e preventivit. Observacioni për këtë çështje nuk merret në konsideratë.

6- Prendim i subjektit: Gjithashtu ne reference te frymës se ligjit për prokurimin publik dhe konkretisht te nenit 46/1/b, i cili përcakton se ofertuesit dhe rrjedhimisht fituesi i mundshëm, vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën është kërkuar një mjek bazuar ne:

Në VKM nr. 742, datë 6.11.2003 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.692, datë 13.12.2001 të këshillit të ministrave "për masat e veçanta të sigurimit dhe të mbrojtjes së shëndetit në punë" është përcaktuar: "2/1. Punëdhënësi siguron funksionimin e shërbimit mjekësor, nëpërmjet mjekut të ndërmarrjes, në të gjitha subjektet që ushtrojnë veprimtari prodhuese, private ose shtetërore, vendase ose të huaja, juridike ose fizike. 2/2. Mjekët e ndërmarrjes pajisen me licencë profesionale nga Ministria e Shëndetësisë, në përputhje me vendimin nr.500, datë 23.11.1992 të Këshillit të Ministrave "Për dhënien e licencave për ushtrimin e profesionit në fushën e mjekësisë, në profesion të lirë privat", i ndryshuar. 2/3.

6-Qëndrim i grupit të auditimit: Të gjitha ato që ju permendni në observacion, si kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, aftësitë organizative etj., janë jo të cdo llojë natyre, por vetëm ato të natyrës që ka lidhje me objektin e kontratës. Kërkesa për mjek nuk ka lidhje me nëtyren e kontratës. Observacioni për këtë çështje nuk merret në konsideratë.

7- Prendim i subjektit: Numri i punonjësve është përcaktuar bazuar ne grafikun e punimeve, preventivit dhe orët e punës qe duhen për te përcaktuar kontratën. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre ne pune me kohëzgjatje janar – qershor 2020 është

gjykuar se tregon besueshmëri për autoritetin kontraktor. Kërkesa për kohe te plote siguron autoritetin kontraktor që subjekti paguan sigurimet shoqërore për te paktën pagën baze për fuqinë punëtore duke siguruar qëndrueshmëri te fuqisë punëtore. Pavarësisht nga ditët e punës që realizon në muaj një punëtor sipas ligjit 7703 datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, nëni 10 pagesa për sigurimet shoqërore behet për te gjithë muajin dhe llogaritet mbi pagën bruto. Shume subjekte regjistrojnë punëtor për 1 ose dy dite pune dhe i deklarojnë përsëri në fillim të çdo muaj duke rritur fiktivisht numrin e fuqisë punëtore. Po te krahasosh FDP real me FDP e llogaritur me kohe te plote kupton numrin mesatar te punonjësve.

Sqarojmë se, numri i punonjësve është përcaktuar referuar volumeve te punës që do te kryhen, afatit te realizimit te kontratës objekt prokurimi si dhe grafikut te punimeve te përcaktuar nga autoriteti kontraktor me qëllim realizimin me sukses dhe në kohe te kontratës (70 janë ing dhe specialist dhe pjesa tjetër janë punëtorë).

Për te provuar kapacitetet teknike dhe profesionale te shoqërisë është kërkuar personeli i nevojshëm inxhinierik referuar zërave te preventivit te objektit për realizimin e kontratës në mbështetje te germës "b", te pikës 1 të nenit 46 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për "Prokurimin publik", i ndryshuar, ku përcaktohet se: "operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën" si dhe të nenit 44 pika 1 e Ligjit Nr 9643 për "Prokurimin Publik" ku përcaktohet se: "Në rastet e kontratave publike për shërbime apo punë si dhe të kontratave publike të furnizimit për shërbime shtesë dhe /ose veprimtari instalimi Autoritetet Kontraktore mund t'u kërkojnë personave juridikë të paraqesin në ofertë ose në kërkesën për pjesëmarrje emrat dhe kualifikimet profesionale përkatëse të personelit përgjegjës për zbatimin e kontratës në fjalë".

7-Qëndrim i grupit të auditimit: Ashtu si gjatë hartimit të kriterëve, edhe në këtë observacion ju nuk keni argumentuar teknikisht numrin e kërkuar të punonjësve, gjë e cila në cdo tender duhet të bëhet bazuar në maualet teknike, preventivin e punimeve, kohëzgjatjen e kontratës, orët e punës. Observacioni për këtë çështje nuk merret në konsideratë.

8- Pretendim i subjektit: Përsa i përket mjeteve të kërkuara janë kërkuar ato mjete që janë të nevojshme për zbatimin e kontratës në përputhje me preventivin dhe grafikun e kësaj procedure. Kriteri i vendosur nga ana jonë në përputhje me VKM nr. 914 datë 10.01.2007, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, nëni 26, pika 8/c.

Kriteri i mësipërm është vendosur në përputhje me nenin 46 pika 1 germa "b" të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik të ndryshuar, ku parashikohet se: Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përprjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jo diskriminuese; b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

Gjithashtu, kriteri i mësipërm është vendosur edhe në përputhje me parashikimet e nenin 26 pika 8 germa "c" të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" të ndryshuar, ku parashikohet se " Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon: c) dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Njësia e Prokurimit gjykon se mjetet e sipërcituara janë të nevojshme për kryerjen e punimeve dhe zbatimin e tyre në përputhje me afatet kohore të vendosura nga ana e autoritetit kontraktor, mjetet e mësipërme janë në proporcion me natyrën e punimeve, volumin e tyre dhe vlerën në tërësi të kontratës objekt prokurimi.

Makineritë e mësipërme janë kërkuar në proporcion me kompleksitetin dhe volumet e punës që përmban preventivi i punimeve. Jane mjete të domosdoshme për realizimin e punimeve në kohë dhe afatin e përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit.

Në lidhje me fabrikën e dyer dhe dritareve është vendosur bazuar në preventivin e punimeve për restaurimin e banesave në zona të ndryshme të territorit. Përsa i përket kërkesës për eskavator me zinxhirë, është kërkuar mjet tërheqës për transportin e tyre, është menduar dhe përlllogaritur çdo makineri sikur të jetë në kantier pa konsideruar mënyrat e transportit të tyre, duke i parë këto detaje të tepërta në dokumentacion, duke justifikuar edhe numrin e drejtuesve të mjeteve ete kërkuara.

Në lidhje me mjetet e kërkuara nga ana jonë si Fabrikë betoni, janë kërkuar për arsye të uljes së kostos, pasi këto mjete janë kërkuar në të gjitha format e lejueshme të legjislacionit në fuqi, ose në pronësi ose me një kontratë që të vërtetohet që kjo kontratë do të realizohet pa hasur vështirësi në zbatim për gjetjen e materialeve. Në të gjitha format edhe pse nuk është shkruar kontratë furnizimi nënkuptohet që mjaftueshëm një marrëveshje me një operator që ka në pronësi ose me qira këto mjete. Një formë tjetër që lehtësisht të realizohet ky kriter është ajo e bashkëpunimit ekonomik me një nga këto firmat që kanë këto mjete. Bazuar dhe në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006. "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, neni 46/b ku citohet se: "Aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës".

Te gjitha pikat e fabrikave të betonit janë të detyruara të pajisen me licenca dhe leje mjedisore të tipit III.1.B si dhe dokumentacion që vërteton pronësinë dhe vendndodhjen (shtrirjen) e këtyre subjekteve. Autoriteti Kontraktor kërkon që të kenë marrëveshje vetëm me subjektet që janë 100% në përputhje me legjislacionin në fuqi.

8-Qëndrim i grupit të auditimit: *Ashtu si gjatë hartimit të kriterëve, edhe në këtë observacion ju nuk keni argumentuar teknikisht numrin e kërkuar të makinerive dhe pajisjeve, gjë e cila duhet të bëhet bazuar në maualet teknike, preventivin e punimeve, kohëzgjatjen e kontratës, orët e punës. Baza ligjore që ju të kërkonin makineri dhe pajisje ekziston, por cilën pajisje do kërkonin dhe në çfarë sasive, ka të bëjë me argumentim teknik, i cili nuk është bërë nga ana juaj. Observacioni për këtë çështje nuk merret në konsideratë.*

Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi specialiste e fushës, anëtare e njësisë së prokurimit znj. M. S., hartuese e kriterëve teknike të DST.

Vlerësimi i ofertave

Me urdhrin nr.41, datë10.08.2020 të titullarit të AK z. E. D., është përcaktuar komisioni i vlerësimit të ofertave i përbërë z. L. B., me detyrë N/Kryetar i Bashkisë (arkitekt), z. P. S. me detyrë Drejtor i Drejtorisë Juridike (jurist), znj. E. M., me detyrë specialiste e prokurimeve (ekonomiste). KVO ka hartuar raportin përmbledhës në të cilin ka dokumentuar kualifikimin dhe skualifikimin e operatorëve ekonomik.

Titulli: Kualifikim dhe shpallje fitues e operatorit ekonomik, i cili nuk plotëson kriteret e veçanta të DST.

Situata: Në procedurën e prokurimit ka marrë pjesë vetëm një operator ekonomik, "Z..." ShPK, i cili është kualifikuar nga KVO dhe i është propozuar Titullarit për shpalljen e tij

fitues. Vlera e ofertës ekonomike të OE “Z...” ShPK është 9,447,915 lekë pa TVSh, ose 494,390 lekë (pa TVSh më pak se vlera e fondit limit).

- Në DST është kërkuar që OE të kenë 2 autobote, 2 mjete autovinç. Gjithashtu është kërkuar: *“Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (te vlefshme) dhe certifikatën e transportit të lëshuar nga bashkia përkatëse”.*

• Për plotësimin e kriterit të mësipërm për 2 autobote, shoqëria “Z...” ShPK, ka lidhur kontratë noteriale për marrje me qira të tre mjeteve autobot si vijon:

Kontratë noteriale me nr. 1030 Rep. dhe 620 Kol., të datës 04.07.2018, të lidhur me z. A. D., me vendndodhje në Lushnje, me anë të së cilës ka marrë me qira tre autoboteve. Të tre autobotet e marra me qira janë të pajisur nga Bashkia Lushnje me certifikatë për transporte mallrash brenda vendit për llogari të vet. Pra autobotet nuk janë të pajisur me certifikatë për transport mallrash me qira dhe për të tretë dhe për këtë arsye nuk mund të përdoret nga OE “Z...” ShPK, pasi kuadri rregullator në fuqi nuk lejon dhënien e tyre me qira.

Nga 2 mjete autobote të kërkuara, nuk ka dokumentacion të plotë për asnjë prej tyre

• Për plotësimin e kriterit për 2 mjete autovinç, shoqëria “Z...” ShPK, ka lidhur kontratë noteriale nr. repertori 1516, numër koleksioni 723, datë 10.07.2020 me qiradhënësin shoqëria 3... P..., për marrje me qira të një autovinçi.

Nga dokumentacioni i paraqitur konstatohet se ky mjet është i pajisur nga Bashkia Kuçovë me certifikatë për transporte mallrash brenda vendit për llogari të vet. Pra mjeti autovinç, nuk është i pajisur me certifikatë për transport mallrash me qira dhe për të tretë dhe për këtë arsye nuk mund të përdoret nga OE “Z...” ShPK, pasi kuadri rregullator në fuqi nuk lejon dhënien e tyre me qira. **Nga 2 mjete autovinç të kërkuara, ka paraqitur dokumentacion të rregullt vetëm për 1 mjet.**

Për sa më sipër, dokumentacioni i tre autoboteve, si dhe mjetit autovinç, të marrë me qira nuk plotësojnë kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 *“Për transportet rrugore”*, neni 1, 3, 5 dhe Kreut III.1, *“Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë”*, nenet 41 dhe 44, si dhe Kreut III.2, *“Transporti i mallrave për vete”*, nenet 45, 46, dhe 47, bëhet qartësisht ndarja midis këtyre mënyrave të transportit dhe përcaktohet ndalimi i secilës nga mënyrat e transportit pa pajisjen me licencën përkatëse, ku thuhet: *Neni 41: Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë është i ndaluar të kryhet pa licencën përkatëse.*

Neni 44: Llojet e transportit të mallrave me qira dhe për të tretë, të cilat mund të kryhen pa licencë, përcaktohen me udhëzim të veçantë të Ministrisë.

Gjithashtu dokumentacioni i mjetit me targa AA4...E i marrë me qira nuk plotëson kërkesat e përcaktuara nënin 11 të udhëzimit nr.15, datë 24.07.2007 *“Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor”*, të ndryshuar udhëzimit nr.11, datë 18.12.2009, ku thuhet:

a) Në rastin kur një mjet i marrë me qira nuk ndryshon fushën e operimit (për të tretë ose me qira ose për llogari të vet) për të cilën ai është pajisur me certifikatë, ai nuk pajiset me certifikatë të re, për pasojë, mjeti do të operojë me certifikatën e lëshuar për subjektin transportues që e ka dhënë atë me qira.

b) Në rastin kur një subjekt transportues për të tretë ose me qira merr me qira një mjet të pajisur me certifikatë për llogari të vet, ai duhet të pajisë mjetin me certifikatë për të tretë ose me qira.

c) Një subjekt transportues për llogari të vet mund të marrë me qira një mjet të pajisur me certifikatë për të tretë ose me qira pa qenë nevoja për ta pajisur atë me certifikatë të re.

Në rastin konkret, nëpërmjet dokumentacionit të dorëzuar vërtetohet se certifikata e të tre autoboteve është lëshuara vetëm për transport për vete, për kryerjen e transportit vetëm për llogari të veprimtarisë së z. A. D., pronar i autoboteve.

Në këtë mënyrë, kryerja e transportit me mjetet e mësipërme të marra me qira do të jetë në kushtet e kryerjes së transportit të mallrave pa licencën përkatëse, transport i cili në zbatim të legjislacionit të mësipërm është i ndaluar.

Si përfundim: Në tenderin me objekt “Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pa favorizuara”, me vlerë të fondit limit 9,942,305 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2020”, ka marrë pjesë vetëm operatori ekonomik “Z...” ShPK , me vlerë të ofertës ekonomike 9,447,915 lekë pa TVSh, i cili nuk plotëson të gjitha kriteret e vendosura në DST, por nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Berat është kualifikuar dhe shpallur fitues. KVO nuk duhet të kishte kualifikuar këtë operatorë ekonomik dhe nuk duhet ti kishte propozuar Titullarit të Autoritetit Kontraktor shpalljen e tij fitues. KVO duhet të kishte anuluar tenderin.

Kriteri: Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, sipas neneve të mëposhtëm:

- neni 24 “Anulimi i një procedure prokurimi”, pika nr.1, germa (ç), ku thuhet :

*“Autoriteti kontraktor **anulon procedurën e prokurimit** vetëm (ç) nëse asnjë nga ofertat e paraqitura nuk përputhet me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit”*

neni 46 “Kualifikimi i ofertuesve”, pika 1, ku thuhet:

*Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, **duhet të kualifikohen**, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret ..., që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese.*

- nenin 53 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3 dhe pika 5 ku thuhet: “3. Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, **vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit**, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji. 5. **Autoriteti kontraktor nuk e pranon një ofertë: a) kur ofertuesi nuk është i kualifikuar; c) kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit”;**

- neni 55, “Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese”, pika 1, germa a, ku thuhet:

*“oferta fituese duhet të jetë: a) **oferta që, në bazë të kërkesave dhe kriterëve të përcaktuara në dokumentet e tenderit, plotëson kërkesat e objektit të prokurimit me çmimin më të ulët.***

Ndikimi: Veprimet e mësipërme kanë sjellë lidhjen e kontratës me vlerë 9,942,305 lekë pa TVSH, me një OE i cili nuk plotëson kriteret e veçanta të DST dhe është shpallur fitues në papajtueshmëri me legjislacionin e prokurimit publik.

Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit rregullator në fuqi për vlerësimin e ofertave të OE.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandim: Titullari i AK të analizojë arsyet e anomalive të KVO lidhur me kualifikimin e operatorve ekonomik të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura në DST, të nxjerrë përgjegjësitë dhe të marrë masa që në të ardhmen të eliminohen praktika të tilla nga KVO

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi: Për kualifikimin dhe shpalljen fitues të OE “Z...” ShPK në kushtet kur nuk plotëson të gjitha kriteret e vendosura në DST, ngarkohet me përgjegjësi komisioni i vlerësimit të ofertave: z. L. B., me detyrë n/kryetar i Bashkisë (arkitekt), z. P. S. me detyrë drejtor i Drejtorisë Juridike (jurist), znj. E. M. me detyrë specialiste e prokurimeve (ekonomiste).

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të raportit përfundimtar të auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacion (për aktet e konstatimit) me shkresën protokolluar në KLSH me nr.55/5 datë 26.04.2022, si dhe nëpërmjet postës elektronike në adresën b...m...@klsh.org.al datë 22.04.2022, nga z. L. B., z. P. S., znj. E. M., anëtare të KVO. Gjithashtu “Mbi projektraportin e auditimit”, nga të njëjtët persona si më sipër, nga subjekti i audituar është paraqitur observacion, nëpërmjet postës elektronike në adresën b...m...@klsh.org.al datë 20.06.2022, protokolluar në KLSH me nr.55/9 prot, datë 06.06.2022, ku janë shprehur të njëjtat objeksione, si ato të bëra për përmbajtjen e akteve të konstatimit. Në të dy rastet observacionet janë të njëjta, nuk ka argumente shtesë në observacionet e bëra për projektraportin e auditimit. Për të dy rastet, nga subjekti i audituar janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendim i subjektit: Në lidhje me konstatimin “Çertifikata e transportit për mjetet autobote dhe 2 mjete autovinç” sqarojmë se operatori ekonomik për 2 mjete autobote ka paraqitur kontratë noteriale me nr. 1030 rep dhe 620 kol datë 04.07.2018 të lidhur me z. A. D., shoqëruar edhe me dokumentacionin ligjor të këtij mjeti, ku përfshihesh edhe certifikata e transportit sipas kërkesave të kërkuara në DST.

Në zbatim të ligjit nr. 8308 datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, Kreu III, 1, mjeti rezulton me certifikatën e transportit dhe bazuar në kontratën noteriale të dorëzuar për këto mjete është arritur në konkluzionin që ky operator i plotëson kushtet për t’u kualifikuar. Pra vërtetësia e aktin është konfirmuar nga noteri (noter- këshilltar ligjor për kryerjen e disa veprimeve juridike që me dispozita nuk u janë lënë organeve të tjera shtetërore).

Gjithashtu sqarojmë se komisioni i vlerësimit të ofertave në vlerësimin e kësaj pike është mbështetur në kontratën noteriale dhe se zbatimin për pajisjen me certifikatë në zbatim të ligjit nr. 8308 datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore” për transportin e mallrave nuk është kompetencë e organeve të vetëqeverisjes vendore por e institucioneve të tjera që i ngarkon ligji.

E njëjta qëndrim mbahet edhe për mjetin autovinç me targa AA 4...E e cila është paraqitur nëpërmjet kontratës noteriale nr. rep. 1516 dhe 723 kol me datë 10.07.2020. Në zbatim të ligjit nr. 8308 datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, Kreu III, 1, mjeti rezulton me certifikatën e transportit dhe bazuar në kontratën noteriale të dorëzuar për këto mjete është arritur në konkluzionin që ky operator i plotëson kushtet për t’u kualifikuar. Përsa më sipër bazuar në kërkesat në DST ku përcaktohet se “Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit dhe certifikatën e transportit të lëshuar nga bashkia përkatëse”, është arritur në përfundim që këto mjete janë në rregull me kërkesat e vendosura në DST.

Qëndrim i grupit të auditimit: Ju nuk keni dhënë asnjë fakt apo prove të re për të kundërshtuar konstatimin e audituesit të çështjes. Në observacion thuhet se KVO është mbështetur në kontratën noteriale. Ju do të mbështeteni në dokumentacionin e dorëzuar nga OE, i cili do të krahasohet me dokumentacionin e kërkuar në DST. Observacioni për këtë çështje nuk merret në konsideratë.

7.Mbi zbatimin e procedurave ligjore në tenderin me objekt “Rikonstruksion i rrugës “Inerte”, ndërtim ure b/a, Njësia Administrative Ollak, Bashkia Berat”, me vlerë të fondit limit 18,497,975 lekë pa TVSH , zhvilluar në vitin 2020”.

Kohëzgjatja e kontratës 4 muaj.

Numri i referencës së procedurës: REF-56394-04-17-2020

1.Urdhër	Prokurimi	nr.29,	3. Njësia e Prokurimit, ngritur me	4.Komisioni	i	Vlerësimit	të
-----------------	------------------	--------	---	--------------------	----------	-------------------	-----------

datë 10.04.2020, nr. 1798 prot.	urdhri nr. 29, datë 10.04.2020: A. Zh., F. K. (A.), B. K. (ing)	Ofertave: Urdhër nr. 1798/1 prot., datë 16.04.2020 L. B., E. M., A. Dh.
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit: E hapur, me mjete elektronike		
5. Fondi Limit 18,497,975 (pa TVSh)	6. Oferta fituese: “T... B...” ShPK , me vlerë 17,905,257 lekë pa TVSh	7. Diferenca me fondin limit 592,718 lekë (pa TVSh)
8. Data e hapjes së tenderit: 26.05.2020	9. Burimi Financimit: Të ardhurat e veta	10. Operatorët Ekonomik a) Pjesëmarrës në tender: 5 OE b) S’kualifikuar 4 OE c) Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime: AK: Jo	APP	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP:
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
14. Lidhja e kontratës nr. 2332/1 prot, datë 06.07.2020	15. Vlera e kontratës: 21,486,310 lekë me TVSH	16. Likuiduar vlera 21,486,310 lekë me TVSH

Hartimi i kriterëve të DST

Me urdhrin e prokurimit nr. 1798 prot., datë 16.04.2020, të titullarit të AK z. E. D., është përcaktuar njësi e prokurimit e përbërë nga znj. F. K. (A.) juriste, me detyrë specialiste e prokurimeve, znj. A. Zh., ekonomiste, me detyrë specialiste e prokurimeve, znj. B. K., me detyrë inxhinierë ndërtimi në Drejtorinë e Urbanistikës.

Urdhri i prokurimit është i pa vulosur në Degën e Thesarit Berat, në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, “Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike” pika 154 ku përcaktohet: “*Kërkesa për shpenzim i drejtohet Nëpunësit Autorizues dhe për dijeni Nëpunësit Zbatues. Në rastet kur kërkesa është e lidhur me një proces blerje apo kryerje shërbimi i dërgohet strukturës përgjegjëse për prokurimet në njësinë shpenzuese. Struktura përgjegjëse për prokurimet kryen kontrollet e nevojshme krahasuese me kërkesat e planifikuara dhe planin e prokurimit të miratuar në procesin e planifikimit të buxhetit. Në rast të kërkesave të reja, të paplanifikuara më parë, kërkohet miratimi paraprak i Nëpunësit Autorizues të njësisë. Në përfundim të procesit njofton Nëpunësin Zbatues të njësisë për urdhrin e prokurimit, i cili autorizohet nga struktura përgjegjëse e Thesarit në degë përpara se të fillojë procesi i prokurimit”.*

Për mos vulosjen e urdhrin të prokurimit në thesar mban përgjegjësi nëpunësi zbatues znj. R. Sh.

Titulli: Mos argumentimi i kriterëve të veçanta për kualifikim të DST që lidhen me kapacitetin teknik, si dhe vendosja e kriterëve të cilët nuk janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, elementë të cilët kanë efekt në kufizimin e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomik

Situata: Për hartimin e kriterëve të veçanta të DST, nga njësi e prokurimit është mbajtur procesverbali me nr. 1798/2 prot., datë 17.04.2020.

- Në pikën 2.3 për kapacitetin ekonomik dhe financiar të kriterëve të veçanta të DST është vendosur kriteri që operatorët ekonomik të paraqesin dokumentacion nëpërmjet të cilit të vërtetojnë se kanë xhiro mesatare e realizuar gjatë tre viteve të fundit (**2016, 2017, 2018**) duhet të mos jete jo me e vogël se 50% fondit limit.

Gjithashtu është kërkuar Operatori Ekonomik duhet të paraqesë kopje të bilanceve të tre viteve **2016, 2017, 2018**, të konfirmuara nga autoriteti përkatës, të shoqëruara nga akt ekspertizë e kryer nga Eksperti kontabel i autorizuar në përputhje me ligjin nr. 10091 datë 5.3.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe kontabilistit të miratuar”

Nga auditimi konstatohet se tenderi zhvillohet në datën **26.05.2020** dhe tre vitet e fundit nuk janë vitet e përcaktuar në DST nga njësia e prokurimit 2016, 2017 dhe 2018, por vitet 2017, 2018 dhe 2019, si për mesataren e xhiros edhe për bilancet. Vërtetimi i marrë për këtë qëllim nga OE "T... B..." ShPK (njëri prej operatorëve ekonomik pjesë e bashkimit të operatorve ekonomik të krijuar) ka datën **29.05.2019**, një vit përpara zhvillimit të tenderit.

Në vetvete kriteri është kontradiktor, pasi nga njëra anë i referohet si periudhë tre viteve të fundit, nga ana tjetër kur përcaktohen këto vite, nuk janë tre vitet e fundit 2017, 2018, 2019, por përcaktohen tre vite përpara vitit të fundit: 2016, 2017, 2018 (ndërkohë që bilancet janë mbyllur).

- Në pikën 2.3.c të kapacitetit ekonomik dhe financiar të kriterëve të veçanta të DST, është vendosur kriteri që operatorët ekonomik duhet të paraqesin:

- punë të ngjashme e realizuar në një kontratë të vetme në një vlerë jo më e vogël se

- 50%, të realizuar gjatë tri viteve të fundit **ku zërat e punimeve respektive plotësojnë kriteret minimale të preventivit të objektit në prokurim.**

Ose

- punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e kontratave të punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tri viteve të fundit është në një vlerë sa dyfishi i vlerës së fondit limit dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, **ku zërat e punimeve respektive plotësojnë kriteret minimale të preventivit të objektit në prokurim.**

Nga auditimi konstatohet se është vendosur kriteri që **"... zërat e punimeve respektive plotësojnë kriteret minimale të preventivit të objektit në prokurim", i cili është në kundërshtim me nenin 26 "Kontratat për punë publike", pika 6, në të cilin nuk kërkohet kriteri i vendosur nga njësia e prokurimit, por thuhet: "Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon: a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit. b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë tri viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.**

- Në pikën 2.3.c të kapacitetit ekonomik dhe financiar të kriterëve të veçanta të DST, është vendosur kriteri që operatorët ekonomik duhet të paraqesin **një deklaratë me shkrim nga administratori se subjekti ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore**, në vendet ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitet për periudhën vitet, 2018 dhe 2019 sipas afateve të përcaktuara në ligjin 9632/2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar.

Kësaj deklaratë duhet ti bashkëngjiten të gjithë vërtetimet që dëshmojnë se operatori ekonomik ka paguar detyrimet përkatëse për taksat dhe tarifa vendore, në vendet ku ka ushtruar apo ushtron aktivitet për këtë periudhë.

Nga auditimi konstatohet se në DST është kërkuar të përmbushen nga operatorët ekonomik dy kriteret për të vërtetuar të njëjtin detyrim:

a) është kërkuar një deklaratë me shkrim nga administratori se subjekti ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore;

b) Kësaj deklaratë duhet ti bashkëngjiten të gjithë vërtetimet që dëshmojnë se operatori ekonomik ka paguar detyrimet përkatëse.

Është lehtësisht e kuptueshme se kriteri i paraqitjes së deklaratës me shkrim nga administratori se subjekti ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, është kriter **i pa nevojshëm**, i pa argumentuar si nevojë për tu vendosur në DST, sepse ky kriter ka krijuar mbivendosje (dublim) me kriterin tjetër ku është kërkuar **vërtetimet që dëshmojnë se operatori ekonomik ka paguar detyrimet përkatëse. Përderisa janë kërkuar këto vërtetime, deklarata nga administratori nuk sjell asnjë elementë shtesë për AK, pasi vërtetojnë të njëjtin gjë.** Kriteri i paraqitjes së deklaratë me shkrim nga administratori se

subjekti ka paguar te gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, rrit në mënyrë artificiale dokumentet e kërkuara prej operatorëve ekonomik, duke jua vështirësuar atyre këtë proces, si dhe është në kundërshtim me nenin 46 të LPP, si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 26 pika 5, dhe neni 61, pika 2.

- Në pikën 2.3.2 të kapacitetit teknik, AK ka kërkuar: “Liçenca e shoqërisë e vlefshme për kategoritë e mëposhtme: **NP 12 A Punime të Inxhinierise së Mjedisit**;

Nga auditimi i dokumenteve teknike të procedurës së prokurimit (preventiv, projekt, specifikimet teknike), rezulton se zërat e punimeve nuk diktojnë nevojën e licencave NP 12 A.

Bazuar në VKM nr.42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, shpjegimi i licencës së mësipërme është si vijon: **NP-12 - Punime të inxhinierisë mjedisore - ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime të veprave dhe punimeve të veçanta ose të shpërndara në territor, dhe vlerësimit të kompaktësimit të zhvillimit të qëndrueshëm të ekosistemit, përfshirë të gjitha veprat dhe punimet e nevojshme për aktivitet botanik dhe zoologjik. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar procesin e riaftësimit natyror, botanik, faunistik, konservimin dhe riaftësimin e terrenit të përdorur për karriera e gurore, dhe të baseneve hidrografike, eliminimin e prishjes së ekuilibrave hidrogeologjike, nëpërmjet kthimit në toka buke të veprave për stabilizimin e shpateve dhe ripyllëzimeve të punimeve të sistemimit bujqësor dhe të veprave për rivegjetizimin e skarpateve rrugore, hekurudhor të karrierave dhe mbetjeve inerte”.**

Nuk ka zëra në preventivë për të bërë të nevojshme kërkesën për këtë licencë.

- Në në pikën 2.3.4 germa “a”, të kapacitetit teknik të kriterëve të veçanta të DST, është kërkuar që operatori ekonomik duhet të dëshmojë se ka drejtues teknik që do të angazhohet për realizimin e punimeve stafin e mëposhtëm:

1 (një) inxhinier mekanik, 1(një) inxhinier mjedisi, 1 automakinist, 2 mekanik, 1 ekspert për ndihmën e pare dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave, 1 specialist zjarrfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi, të cilat janë kërkesa të pa nevojshme dhe të pa argumentuara dhe nuk kanë lidhje me objektin dhe natyrën e kontratës, pasi nga auditimi i preventivit nuk konstatohen zëra punimesh që të bëjnë të nevojshme kërkesën për punonjësit e mësipërm.

Për sa i përket kërkesës për 1 ekspert për ndihmën e pare dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave, 1 specialist zjarrfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi, përveç sa më lartë, theksojmë se ligji 10 237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, ka për qëllim: *të garantojë sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit, nëpërmjet parandalimit të rreziqeve profesionale, eliminimit të faktorëve që përbëjnë rrezik dhe aksident, informimit, këshillimit, pjesëmarrjes së balancuar, në përputhje me ligjin, formimit të punëmarrësve e të përfaqësuesve të tyre.*

Në kuptim të ligjit të mësipërm, secili punëdhënës ka për detyrë të marrë masa për parandalimin e rrëziqeve profesionale etj., dhe për këtë merren masa duke qenë të informuar, instruktuar, etj., të gjithë punonjësit. Pra nuk e siguron mbrojtjen nga zjarri një punonjës i vetëm edhe pse ka marrë një certifikata për këtë qëllim, por përgatitja optimale që duhet të kenë të gjithë punonjësit për këtë qëllim. I njëjti argument është edhe për profesionet e tjera analog që është kërkuar specialist dhe për të cilin nuk ka zëra punimesh në preventiv. Kriteret për specialistët e mësipërm nuk përbëjnë kriteret teknike.

Për sa më sipër janë vendosur kriteret të pa argumentuar teknikisht dhe ligjërish, përtej nevojave reale të AK, të cilët nuk janë në përpjesëtim dhe të lidhur ngushtë me aftësinë zbatuese të kontratës, në kundërshtim me kërkesat e nenit 26, pika 5 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe nenin 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ku respektivisht thuhet: Kërkesat e

veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.

Mos përfshirja në kriteret e veçanta të DST të licencës **NP 12 A** Punime të Inxhinierisë së Mjedisit është sugjeruar edhe na APP, nëpërmjet e-mail it zyrtar, dërguar AK, por këto sugjerime nuk janë reflektuar nga njësia e prokurimit.

I njëjti konstatim sugjerohet të mbahet në konsideratë edhe në lidhje me kërkesën për disponimin e një inxhinieri mjedisi, si drejtues Teknik në licencën e shoqërisë, të kërkuar në pikën 2.3.4 gërma “a”, të kapacitetit Teknik”.

- Në pikën 2.3.3 të kapacitetit teknik, AK ka kërkuar: *“Për të provuar se ka përvojën e duhur, Operatori duhet të dëshmojë se ka të punësuar mesatarisht të paktën 70 punonjës, me kohë të plotë për periudhën Qershor 2019–Mars 2020.*

Referuar pikës 8/b të nenit 26 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ku parashikohet se AK kërkojnë: *“...dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit”*, sqarojmë se, Kriteri për fuqinë punëtore i shërben autoritetit kontraktor për të provuar vetëm kapacitetet teknike dhe profesionale të operatorit ekonomik, që **vlerësohen të nevojshme për të realizuar kontratën që prokurohet**. Ky kriter nuk është pjesë e kriterëve që vërtetojnë eksperiencën të suksesshme në realizimin e punimeve të ngjashme apo qëndrueshmërinë ekonomike e financiare të ofertuesit dhe për këtë arsye, vendosja e kriterit se punonjësit duhet të jenë *“me kohë të plotë për periudhën Qershor 2019–Mars 2020”*, është i pa argumentuar dhe i pa nevojshëm, në kundërshtim me pikën 8/b të nenit 26 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ku parashikohet se AK kërkon: *“...dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit”*, (Pra numri i punonjësve duhet për kontratën në vijim që do të lidhet pas shpalljes së fituesit dhe për këtë mjafton të vërtetohet edhe muaji i fundit për numrin e kërkuar të punonjësve, pasi nuk ka asnjë rendësi sasia e muajve të mëparshëm). Gjithashtu edhe për numrin 70 të punonjësve nuk janë dhënë argumentime. Fillimisht ky numër ka qenë 120 dhe me propozim të APP është ulur në 70, por nuk ka argumentim, as për faktin se ku kishte gabuar më parë AK që e kishte përcaktuar numrin e nevojshëm të punonjësve 120 dhe as argumentim pse u ul ky numër në 70. Mos argumentimi i numrit të punonjësve është në kundërshtim me kërkesat e nenit 61 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për rregullat e prokurimit publik”*, i ndryshuar, ku thuhet: ***çdo kriter i veçantë dhe specifikim teknik duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal.***

Numri i punonjësve të nevojshëm në tender del si shumatore e numrit të punonjësve për secilin pozicion pune të kërkuar në DST, ku përcaktohet dhe detyra që do të kryej punonjësi. Nga auditimi i DST konstatohet se janë përcaktuar 38 punonjës sipas pozicioneve të punës si vijon:

Profesioni/pozicioni I punës	Numri i punonjësve të kërkuar
Inxhinier	7
Mjek	1
Ekspert për ndihmën e parë dhe nderhyrjen ndaj emergjencave”	1
Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë	1
Specialist zjarrëfikës	1
Teknik ndërtimi	2
Murator	2
Hekurkthyes	1
Shofer	8
Muratorë	5
Mekanik	2

	Karpentier	2
	Automakinist	1
	Manovratore mjetesh të rënda	4
	Total	38

Nga sa më sipër, sipas përshkrimit që është bërë në DST sipas pozicioneve të punës së punonjëse, numri i tyre del 38 punonjës, nga 70 të kërkuar në total. Diferenca prej 32 punonjës nuk ka përshkrime në DST se çfarë pune do të kryejnë gjatë zbatimit të kontratës.

• Në pikën 2.3.4 të kapacitetit teknik të kriterëve të veçanta të DST, është kërkuar që operatori ekonomik të paraqesë dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 10). Lista e mjeteve të kërkuara nga AK, sipas tabelës së mëposhtme është e pa argumentuar, si për numrin e mjeteve edhe për kapacitetin e tyre.

Lloji i Makinerive	Pronësia	Sasia
Kamiona vetshkarkues me kap mbajtes mbi 20 ton	në pronësi ose me qira	Cope 2
Kamiona vetshkarkues me kap mbajtes 10-20 ton	në pronësi ose me qira	Cope 3
Kamiona vetshkarkues me kap mbajtes 5-10 ton	në pronësi ose me qira	Cope 1
Eskavator me zinxhire	në pronësi ose me qira	Cope 2
Kamioncine me kap mbatjes deri ne 3.5 ton	në pronësi ose me qira	Cope 1
Eskavator me goma	në pronësi ose me qira	Copë 2
Minieskavatore	në pronësi ose me qira	Copë 1
Gurëthyes, frontoje	në pronësi ose me qira	Copë 1
Autobetoniere	në pronësi ose me qira	Cope 4
Pompe betoni	në pronësi ose me qira	Cope 2
Fabrike asfalti	në pronësi ose me qira	Copë 1
Autobitumatrice	në pronësi ose me qira	Cope 1
Asfalto-shtruese	në pronësi ose me qira	Copë 2
Rrul gome-hekur kap jo më pak se 18 ton	në pronësi ose me qira	Copë 1
Rrul gome-hekur kap jo më pak se 12 ton	në pronësi ose me qira	Cope 1
Rrul gome-hekur kap jo më pak se 8 ton	në pronësi ose me qira	Copë 1
Rrul asfalti me gome kap jo më pak se 8 ton	Në pronësiose me qira	Copë 1
Kompresor	Në pronësiose me qira	Copë 1
Autobot uji me sprucator	në pronësi ose me qira	Cope 2
Fadrom kovë përpara dhe mbrapa	në pronësi ose me qira	Cope 1
Paisje për hekurthyes -tranxhe	në pronësi ose me qira	Cope 1
Vibrator	në pronësi ose me qira	Cope 2
Gjenerator	në pronësi ose me qira	Cope 1
Pompe për largim ujerash	në pronësi ose me qira	Cope 1
Moto pompe thithese vetembushese	në pronësi ose me qira	Cope 1
Minifadrom	në pronësi ose me qira	Copë 1
Sharre për prerje tubosh betoni	në pronësi ose me qira	Copë 1
Deflektometer ose pjaster dinamike për matjen e	në pronësi ose me qira	Cope 1
Kontenier Stacioner (zyre ne objekt)	në pronësi ose me qira	Cope 1
Impiante për thyerje dhe seleksionim materiale	në pronësi ose me qira	Copë 1
Fabrike betoni e pajisur me leje mjedisore	në pronësi ose me qira	Copë 1
Çekic pneumatik për thyerje e betoneve	në pronësi ose me qira	Copë 1

Gjithashtu në kriterin për numrin dhe llojin e mjeteve konstatohet se është kërkuar që OE duhet të paraqesin dokumentacion i cili vërteton se zotërojnë **2 copë eskavator me zinxhir**, por nuk është kërkuar mjet tërheqës në DST për realizimin e transportit të 2 mjeteve të kërkuara me zinxhirë.

• Në kapitullin 9 te specifikimet teknike, AK ka përfshirë punime elektrike, ku i referohet dhe markës: - Ndriçuesit Rrugor Prodhimi **italian "indy"**; Fuqia e llampës : **250W**; -Tipi i llampës: **SEMPIONE IP 547 250W**;- Ndriçuesit dekorativ; - Prodhimi **DISANO**; - Tipi **VISTA**; - Fuqia e llambës 250W; - Lloji i llampës **CLIMA IP 447 250W**. AK nuk ka përfshirë asnjë punim në preventivin e punimeve që ka lidhje me punime elektrike dhe për këtë arsye këto mallra janë të pa nevojshme, nuk kanë lidhje me objektin e kontratës.

Përcaktimi i emrave të markave, emri i vendit të prodhimit është bërë në kundërshtim me nenin 23/5 të LPP parashikohet se: "*Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët "ose ekuivalent" të përfshihen detyrimisht në këto specifikime". Kjo anomali është konstatuar edhe nga APP, e cila la sugjeruar korrektimin e saj, por nga AK nuk është bërë një gjë e tillë. Për anomali të e mësipërme në specifikimet teknike (emrin a markës, prodhuesit) mbajnë përgjegjësi hartuesit e specifikimeve teknike: z. S. Dh., z. A. Sh., z. G. S., z. A. Dh.*

Kriteri: Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat e pikës 2, neni 61, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për rregullat e prokurimit publik", i ndryshuar, nenit 26, pika 5, nenit 27, neni 61 pika 2 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për rregullat e prokurimit publik", i ndryshuar, si dhe nenin 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Ndikimi: Kufizim në pjesëmarrjen e OE në tender, ulje e konkurrencës.

Shkaku: Mos zbatim i kërkesave të kuadrit rregullator në fuqi për hartimin e kriterëve të veçanta të DST.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Berat të analizojë arsyet dhe të nxjerrë përgjegjësitë e anomalive të konstatuara në hartimin e kriterëve të veçanta të DST. Njësia e prokurimit në cdo procedurë të jap argumentim për cdo kriter të veçantë për kualifikim që lidhen me kapacitetin teknik dhe jo vetëm, të vendosur në DST dhe argumentet të dokumentohen me procesverbal

Për anomali të e konstatuara në hartimin e kriterëve të veçanta të DST ngarkohen me përgjegjësi: znj. F. K. (A.) juriste, me detyrë specialiste e prokurimeve, znj. A. Zh., ekonomiste, me detyrë specialiste e prokurimeve, znj. B. K., me detyrë inxhinierë ndërtimi në Drejtorinë e Urbanistikës (për kriteret e kapacitetit teknik dhe profesional).

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të raportit përfundimtar të auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacion (për aktet e konstatimit) me shkresën protokolluar në KLSH me nr.55/5 datë 26.04.2022, si dhe nëpërmjet postës elektronike në adresën b...m...@klsh.org.al datë 22.04.2022, nga znj. A. Zh., znj. F. K., znj. B. K. (ing), anëtare të njësisë së prokurimit. Gjithashtu "Mbi projektraportin e auditimit", nga të njëjtët persona si më sipër, nga subjekti i audituar është paraqitur observacion, nëpërmjet postës elektronike në adresën b...m...@klsh.org.al datë 20.06.2022, protokolluar në KLSH me nr.55/9 prot, datë 06.06.2022, ku janë shprehur të njëjtat objeksione, si ato të bëra për përmbajtjen e akteve të konstatimit. Në të dy rastet observacionet janë të njëjta, nuk ka argumente shtesë në observacionet e bëra për prjektraportin e auditimit. Për të dy rastet, nga subjekti i audituar janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

1-Specifikisht për pikën 2.3 të kapacitetit ekonomik në DST pika (a), është kërkuar: Xhiro mesatare e realizuar nga Operatori Ekonomik gjatë tre viteve të fundit 2016, 2017, 2018 duhet të mos jetë më e vogël se 50% fondit limit. Për sa me sipër sqarojmë se: procedura e prokurimit ishte parashikuar për tu zhvilluar në fillim të vitit 2020, konkretisht në muajin mars, vërtetuar kjo dhe me zërin e parashikuar në regjistrin e parashikimit të prokurimit publik. Përgatitja e dokumentave të tenderit është bërë para muajit mars me qëllim që në muajin në të cilin ishte parashikuar se do të zhvillohej procedura seti i dokumentave të tenderit të ishte gati. Në momentin e zhvillimit të procedurës ky lapsus nuk është kapur dhe nuk është bërë i mundur ndryshimi në shtojcën e hartuar për disa ndryshime në dokumentat e tenderit.

2-Në lidhje me konstatimin në pikën 2.3. të kapacitetit teknik për pikat e licensen NP 12 A Punime te inxhinierise se Mjedisit dhe NS 6 A Sinjalistika rrugore jo ndricuese sqarojme se: Per te provuar kapacitetet teknike dhe profesionale te shoqerise eshte kerkuar licenca profesionale e shoqerise sipas përcaktimit të bërë në germen (a) te pikes 8 të Nenit 26, Seksioni II, Kreu III të VKM Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik (i ndryshuar), si dhe në mbështetje te Ligjit Nr.9643, date 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, Neni 46, pika 1, germen (a) dhe (b). Kategorite per punimet e ndertimit dhe niveli per cdo kategori punimesh zbatimi jane percaktuar referuar zerave te preventivit te punimeve per kete objekt si dhe ne mbeshtetje te plote te Vendimit te Keshillit te Ministrave Nr.42, date 16.01.2008 “Per miratimin e rregullores per kriteret dhe procedurat e dhenies se licencave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike, qe ushtrojne veprimtari ndertimi”, (i ndryshuar).

Referuar ligjit nr.10431, date 09.06.2011 “Per mbrojtjen e mjedisit” neni 25, pika 3 percaktohet qarte se per cdo projekt duhet te kryhet vlerësimi i ndikimit ne mjedis i cili zbaton parimin e parandalimit qe ne fazën e hershme te miratimit të projektit me qëllim shmangien apo minimizimin e efekteve negative ne mjedis. Referuar sa me siper projekti I propozuar do te kete ne teresine e veprimtarisë së tij për ndertimin e objektit ndikim te vazhdueshem në mjedis duke patur parasysh dhe faktin që ndërtimi do të bëhet në zonë të banuar. Me qëllim zbatimin e raportit të VNM për ndikimin në mjedis gjatë gjithë procesit të punës dhe duke gjykuar se gjithë vepra gjate zbatimit te punimeve do te kete ndikim ne mjedis autoriteti kontraktor.

Rikonstruksioni i kësaj rruge është për tek venddepozitimi i mbetje te ngurta që po zhvillohesh në kuadër të projektit “Menaxhimi I mbetjeve te ngurta në Qarkun e Beratit” dhe është gjykuar që ofertuesit e mundshëm të ishin të pajisur me këtë pikë license dhe për më tepër kateriale e kërkuar është minimale “A” që lehtësisht përmmushet nga cdo subjekt që ka këtë objekt veprimtarie.

NS 6 A – sinjalistika rrugore jondricuese, kjo pike licence eshte vendosur referuar zerave te preventivit. Konkretisht ne preventiv ne piken 15 parashikohet Guardrail- N2 anesore me 2 valez. ne 1 ane, W2 + aksesor.

3- Në lidhje me konstatimin në pikën 2.3.3 të kapaciteti teknik në DST “Për të provuar se ka përvojën e duhur operatori duhet të dëshmojë se ka të punësuar mesatarisht të paktën 70 punonjës me kohë të plotë për periudhën Qershor 2019-Mars 2020”. Përsa i përket këtij argumentimi sqarojmë se: Numri i punonjësve është përcaktuar bazuar ne grafikun e punimeve, preventivit dhe orët e punës qe duhen per te përcaktuar kontratën. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre ne pune me kohëzgjatje Qershor – Mars 2020 eshte gjykuar se tregon besueshmëri për autoritetin kontraktor. Kërkesa për kohe te plote siguron autoritetin kontraktor qe subjekti paguan sigurimet shoqërore per te paktën pagën baze per fuqinë punëtore duke siguruar qëndrueshmëri te fuqisë punëtore. Pavarësisht nga ditët e punës që realizon ne muaj një punëtor sipas ligjit 7703 date 11.5.1993, “Per sigurimet

shoqerore ne Republikën e Shqipërisë", te ndryshuar, neni 10 pagesa për sigurimet shoqërore behet për te gjithë muajin dhe llogaritet mbi pagën bruto. Shume subjekte regjistrojnë punëtor per 1 ose dy dite pune dhe i deklarojnë përsëri ne fillim te cdo muaj duke rritur fiktivisht numrin e fuqisë punëtore. Po te krahasosh FDP real me FDP e llogaritur me kohe te plote kupton numrin mesatar te punonjësve.

Për te provuar kapacitetet teknike dhe profesionale te shoqërisë është kërkuar dëshmi për fuqinë punëtore te operatorit ekonomik te nevojshëm per realizimin e kontratës ne mbështetje te germës (b), pika 8 e Nenit 26, Seksioni II, Kreu III të VKM Nr. 914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik (i ndryshuar), si dhe në mbështetje te Ligjit Nr.9643, date 20.11.2006 "Për prokurimin publik", Neni 46, pika 1, germa (b). Sqarojmë se, numri i punonjësve është përcaktuar referuar volumeve te punës qe do te kryhen , afatit te realizimit te kontratës objekt prokurimi si dhe grafikut te punimeve te përcaktuar nga autoriteti kontraktor me qellim realizimin me sukses dhe ne kohe te kontratës (70 janë ing dhe specialist dhe pjesa tjetër janë punëtore).

Për te provuar kapacitetet teknike dhe profesionale te shoqërisë është kërkuar personeli i nevojshëm inxhinierik referuar zërave te preventivit te objektit për realizimin e kontratës ne mbështetje te germës "b", te pikës 1 të nenit 46 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për "Prokurimin publik", i ndryshuar, ku përcaktohet se: "operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën" si dhe të nenit 44 pika 1 e Ligjit Nr 9643 për "Prokurimin Publik" ku përcaktohet se: "Në rastet e kontratave publike për shërbime apo punë si dhe të kontratave publike të furnizimit për shërbime shtesë dhe /ose veprimtari instalimi Autoritetet Kontraktore mund t'u kërkojnë personave juridikë të paraqesin në ofertë ose në kërkesën për pjesëmarrje emrat dhe kualifikimet profesionale përkatëse të personelit përgjegjës për zbatimin e kontratës në fjalë".

4-Në lidhje me konstatimet në pikën 2.3.4 të DST për mjetet që operatori ekonomik të paraqese dëshmi për mjetet e pajisjet teknike sqarojme se:

Në lidhje me mjetet e kërkuara nga ana jonë si Fabrikë betoni, janë kërkuar për arsye të uljes së kostos, pasi këto mjete janë kërkuar në të gjitha format e lejueshme të legjislacionit në fuqi, ose në pronësi ose me një kontratë që të vërtetoj që kjo kontratë do të realizohet pa hasur vështirësi në zbatim për gjetjen e materialeve. Në të gjitha format edhe pse nuk është shkruar kontratë furnizimi nënkuptohet që mjaftueshëm një marrëveshje me një operator që ka në pronësi ose me qira keto mjete. Një formë tjetër që lehtësisht të realizohet ky kriter është ajo e bashkëpunimit ekonomik me një nga këto firmat që kanë këto mjete. Bazuar dhe në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006. "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, neni 46/b ku citohet se: "Aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës".

Te gjitha pikat e inerteve, fabrikave te betonit, fabrikat e asfaltit jane te detyruara te pajisen me licensa dhe leje mjedisore te tipit III.1.B si dhe dokumentacion qe vërteton pronësinë dhe vendndodhjen (shtrirjen) e ketyre subjekteve. Autoriteti Kontraktor kërkon qe te kene marrëveshje vetëm me subjektet qe janë 100% ne perputhje me legjislacionin ne fuqi. Per kete arsye kërkohet qe ne çdo rast si ne pronesi ashtu dhe me qira nyjet e inerteve, fabrikave e asfaltobetonit te jene te pajisura me licensa dhe leje mjedisore te vlefshme qe tregon aktivitet te ligjshëm.

Përsa i përket mjeteve të kërkuara janë kërkuar ato mjete që janë të nevojshme për zbatimin e kontratës në përputhje me preventivin dhe grafikun e kësaj procedure. Për kamionët dhe Rrulat të cilat janë te domosdoshëm për natyrën e punimeve pasi kemi te bëjmë me gërmime

dheu dhe transport dhe si dhe rrulat për kapacitet nga me i madhi deri tek i vogli për ngjeshjen e shtresave të rrugës. Për mjetet e tjera duke mos kufizuar tonazhin, litrat, etj u kemi ardhur në ndihmë çdo operatori ekonomik pasi mendojmë që vendosja e saivse kufizuese do të pengonte operatorët ekonomik që kanë në pronësi ose kanë më lehtë të gjejnë me qira një Autobot uji sesa një Autobot uji 5.5 t nëse do shpreheshim në mënyrë formale në tonazh, e kështu me radhë për çdo mjet të kërkuar nga ana jonë. Kriteri i vendosur nga ana jonë në përputhje me VKM nr. 914 datë 10.01.2007, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, neni 26, pika 8/c.

Kriteri i mësipërm është vendosur në përputhje me nenin 46 pika 1 germa "b" të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik të ndryshuar, ku parashikohet se: Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese:

b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimine objektit të kontratës.

Gjithashtu, kriteri i mësipërm është vendosur edhe në përputhje me parashikimet e nenin 26 pika 8 germa "c" të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" të ndryshuar, ku parashikohet se " Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon: c) dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Nj.P gjykon se mjetet e sipërcituara janë të nevojshme për kryerjen e punimeve dhe zbatimin e tyre në përputhje me afatet kohore të vendosura nga ana e autoritetit kontraktor, mjetet e mësipërrne janë në proporcion me natyrën e punimeve, volumin e tyre dhe vlerën në tërësi të kontratës objekt prokurimi.

Makinerite e mësipërme janë kërkuar në proporcion me kompleksitetin dhe volumet e punes që përmban preventivi i punimeve. Janë mjete të domosdoshme për realizimin e punimeve nëkohe dhe afatin e përcaktuar në dokumentat standarde të tenderit.

Përsë i përket kërkesës për 2 cope eskavator me zinxhirë, por nuk është kërkuar mjet tërheqës për transportin e tyre, është menduar dhe përlllogaritur cdo makineri sikur të jëtë në kantier pa konsideruar mënyrat e transportit të tyre, duke i parë këto detaje të tepërta në dokumnetacion.

Në lidhje me konstatimet 2.3.4 germa "a" të kapacitetit teknik është kërkuar:

Inxhinier mjedisi- Kërkesa e autoritetit kontraktor mbi përcaktimin e inxhinierit të mjedisit, është e bazuar në dispozitat ligjore përkatëse mbi ndërtimet dhe prokurimet. Zotërimi i pikave të licencës së shoqërisë (referuar kategorive të punimeve) për punimet e parashikuara në kontratën objekt prokurimi, që në rastin konkret përkon me N.P-12 A referuar në Kreun III, pika 1 të VKM-së nr. 42, datë 16.01.2008, ku përcaktohet qartë se: "Licenca është dokument juridik e profesional, që i jep të drejtë disponuesit të saj të ushtrijë veprimtari të caktuar, sipas kategorive të punimeve të zbatimit, duke u mbështetur në profilin e diplomës universitare të individëve që punësohen në rolin e drejtuesit teknik të shoqërisë", dikton qartësisht se zotërimi i kategorive të punimeve të zbatimit në licencat e shoqërive të ndërtimit, mbështetet në profilin e diplomës universitare të individëve që punësohen në rolin e drejtuesit teknik të shoqërisë, çka rrjedhimisht sjell se, për kategorinë e punimeve N.P. 12, të kërkohet inxhinierin e mjedisit të punësuar, i cili i zotëron ato. Kërkesa sa më sipër e autoritetit kontraktor për inxhinierin e mjedisit është e lidhur ngushtësisht me kategoritë e

licencës se kërkuara dhe është e nevojshme për realizimin me sukses të punës, për sa kohë që ajo është në përpjesëtim dhe e lidhur ngushtë me objektin e kontratës.

Automakinist- Gjithashtu për realizimin e objektit është kërkuar përdorimi i mjeteve të renda si eskavator, makineri asfalti autobetonire, etj. Me qëllim administrimin dhe përdorimin e makinerive të renda për punimet e ndërtimit që do të realizohen nga ana e operatorit ekonomik, si dhe disiplinimin e përdorimit të këtyre mjeteve në zbatim të rregullave të sigurimit teknik detyrimisht kërkohet një staf teknik i specializuar (automakinist- drejtues të makinerive të renda me ngritës. Mekanik- sqarojmë se sipas zërave të preventivit dhe makinerive që duhet të përdoren për këto punime, montimin e pajisjeve dhe mirëmbajtjen e makinerive të punës, nevojiten specialist mekanik në objekt, duke garantuar AK për zbatimin e punimeve me sukses dhe në kohë, si dhe pa shkakuar ndonjë incident në punë.

Është arsyetuar e nevojshme dhe të lidhur ngushtë me objektin e kontratës vendosja e kërkesës për Ekspert MKZ-je për operatorin ekonomik pasi në procesin e ndërtimeve të rikonstruksioneve dhe përshtatjeve të objekteve, është e nevojshme që operatori ekonomik të jete i trajnuar dhe certifikuar për mbrojtjen kundër zjarrit me qëllim ndjekjen e zbatimit të normave dhe rregullave në lidhje me ruajtjen e nxehtësisë në ndërtesa.

Ne Nenin 27 të ligjit Nr.8766, datë 05.04.2001 "Për mbrojtjen nga zjarri" (i ndryshuar), citohet sa me poshtë vijon: Projektimi, ndërtimi, rikonstruksioni dhe vënia në shfrytëzim e veprave dhe e objekteve të ndryshme, ndërtesave, rrjetit rrugor elektrik, ujësjellës-kanalizimeve etj. bëhen në përputhje edhe me kërkesat e këtij ligji, me normat dhe rregulloret për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin, me rregullat dhe normat ndërkombëtare teknike, si dhe me rregullat e përcaktuara në dispozita të veçanta

Referuar objektit të kësaj procedure prokurimi si dhe bazuar mbi këtë legjislacion detyruet, në funksion të kontrollit të zbatimit të projektit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin në ndërtimet e reja si dhe rikonstruksionin e ndërtesave ekzistuese është e nevojshme që operatori ekonomik të jete i licencuar mbi masat e mbrojtjes nga zjarri të ndërtesave pasi çdo vepër e përfunduar duhet të jete në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

Ky kriter është vendosur gjithashtu në përputhje të plote me Ligjin 9643, datë 20.11.2006 "Per Prokurimin publik" ,(i ndryshuar) Neni 46, pika 1 germa (a) dhe (b) si dhe pika 2, VKM Nr.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Kreu III, Seksioni II, Neni 30 si dhe me aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi për kërkesat teknike "Për mbrojtjen kundër zjarrit" në ndërtesat publike.

Argumentimi mbi kriterin "ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave" operatori ekonomik ofertues me qëllim respektimin e standardeve të sigurisë konform ligjit nr. 10237 datë 18.02.2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr.312 date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", duhet të dëshmojë se ka pjesë të stafit të shoqërisë personelle të trajnuar për ndërhyrjen e parë ndaj emergjencave.

Qëndrim i grupit të auditimit: 1-*Nëse DST janë hartuar më parë, ka qenë e nevojshme të bëheshin ndryshimet e duhura, pra të kërkohej xhiro mesatare vjetore për 3 vitet e duhura të fundit. Për arsye se nuk keni fakte dhe prova të reja kundërshtia juaj për këtë pikë nuk merret në konsideratë.*

2-*Keni dhënë argumente për nevojën e licencës NS 6 A – sinjalistika rrugore jondricuese, por jo për nevojën e licencës NP 12 A Punime të inxhinierise se Mjedisit, prandaj për këtë të fundit observacioni juaj nuk merret në konsideratë.*

3&4:*Në observacion keni thënë se numri i punonjësve është përcaktuar bazuar në grafikun e punimeve, preventivit dhe orët e punës që duhen për të përcaktuar kontratën, por ashtu si është thënë edhe në aktin e konstatimit nuk keni bërë llogaritje teknike për këtë.*

Gjithashtu nuk keni dhënë fakte dhe prova të reja për të argumentuar kriterin se “Për të provuar se ka përvojën e duhur operatori duhet të dëshmojë se ka të punësuar mesatarisht të paktën 70 punonjës me kohë të plotë për periudhën qershor 2019-mars 2020”.

Autoriteti kontraktor ka të drejtë të kërkojë numrin e punonjësve për realizimin e kontratës, e cila vjen si kohë pas zhvillimit të procedurës së prokurimit. Për të gjykuar për këtë, listëpagesa e muajit të fundit është e mjaftueshme. Autoriteti kontraktor nuk ka të drejtë të kontrollojë rregullshmërinë e subjektit për detyrimet që ka me organet tatimore, sepse kjo kryhet nga vetë këto organe. Aq më tepër që në DST është kërkuar edhe paraqitja e vërtetimit për shlyerjen e detyrimeve që operatorët ekonomik kanë në organet tatimore.

Autoriteti Kontraktor nuk ka të drejtë të kërkojë që operatorët ekonomik ti vërtetojnë nëse plotëson ose jo një detyrim ligjor që ata kanë, por që nuk lidhet me tenderin që zhvillohet.

Për arsye se nuk keni fakte dhe prova të reja, observacioni juaj lidhur periudhën e punësimit të punonjësve qershor- mars 2020 nuk qëndron. Po ashtu në observacionin tuaj për dëshmitë për paisjet dhe mjetet teknike keni përmendur vetëm bazën ligjore që ju jep të drejtën për të vendosur kriteret të tilla, por nuk keni paraqitur argumente teknike, të cilat të shpjegojnë lidhjen e ngushtë të kriterit, paisjes, makinerisë me zërin e preventivit, si dhe të numrit të tyre të kërkuar me llogaritjet e nevojshme sipas manualeve përkatës. Ju jepni argumente të tilla, si: është i nevojshëm mekaniku, sepse do të riparohet makinerinë nëse prishëm gjatë punës, por ky argument nuk qëndron, sepse nuk lidhet me natyrën e kontratës, zërat e preventivit. Nëse makineria do të ketë difekt, ajo do të riparohet në vendet e posacme për këtë, që janë serviset. Si mundet praktikisht të ketë mundësi që ta riparohet mekaniku makinerinë në kantier, apo te vendi i punës, nëse ajo prishet?!

Në observacion thuhet se kërkesa për ekspert zjarrfikës është bazuar në VKM Nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu III, Seksioni II, Neni 30 si dhe me aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi për kërkesat teknike “Për mbrojtjen kundra zjarrit” në ndërtesat publike. Pra i referoheni mbrojtjes nga zjarri në ndërtesa publike, ndërkohë që tenderi është rikonstruksion rruge.

Për arsye se nuk keni fakte dhe prova të reja kundërstitë tuaja nuk merren në konsideratë.

Vlerësimi i ofertave nga KVO

Me urdhrin nr.1798/1, datë 16.04.2020 të titullarit të AK z. E. D., është ngritur komisioni i vlerësimit të ofertave (KVO), i përbërë nga z. L. B., me detyrë n/kryetar i Bashkisë (arkitekt), znj. E. M., me detyrë specialiste e prokurimeve (ekonomiste), z. A. Dh., inxhinier, me detyrë specialist i kadastrës.

Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 5 operatorë ekonomik, prej të cilëve 4 janë skualifikuar dhe 1 është kualifikuar. Nga operatorët e kualifikuar është shpallur fitues bashkimi i operatorve ekonomik (BOE) T... B... & V... H... ShPK, me vlerën e ofertës ekonomike 17,905,258 lekë.

Nr	Operatorët pjesëmarrë në tender	Vlera e ofertës pa TVSH	Kualifikimi nga KVO	NIPT
1	BOE “M...& I...” ShPK	12,643,537	S’kualifikuar	
2	F... ShPK& SH... 07 ShPK	13,148,995	S’kualifikuar	
3	L... K... ShPK	14,421,163	S’kualifikuar	
4	BOE T... B... & V... H... ShPK	17,905,258	Kualifikuar, fitues	
5	K... ShPK	18,259,240	S’kualifikuar	

Arsyet e skualifikimit nga KVO të BOE “M...& I...” ShPK

KVO: Mungon Pompe Betoni

Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik nga BOE “M...& I...” ShPK , konstatohet se OE “I...” ShPKka lidhur kontratë me shoqërinë “L... B...” ShPK, për 1 Autopompë betoni, për të cilën është paraqitur i gjithë dokumentacioni kërkuar, **përveç certifikatës për dhënie me qira dhe përdorim nga të tretë.**

KVO: - Mjeti Autobot uji AA9...Y i mungon Pagesa e Taksës se mjetit;

-Mjeti Autobot uji AA9...L i mungon Pagesa e Taksës se mjetit

-Paisja per hekurthyese-tranxe paraqitur pa foto

-Vibrator i paraqitur pa foto; Motopompe thithëse vetëmbushëse paraqitur pa foto.

Nga auditimi konstatohet së pretendimet e KVO për mangësitë e mësipërme të BOE M...sh.p.k & I... sh.p.k, nuk qëndrojnë si mosplotësim kriteri të vendosur në DST, sepse nëse nuk është paraqitur pagesa e taksës së mjetit (i cili në fakt është vendosur në DST, por është një element plotësues dhe jo kryesor, fare i pa nevojshëm të kërkohej në DST), kjo nuk do të thotë që mjeti nuk ka dokumentacionin e nevojshëm për qarkullim në rrugë, pasi është paraqitur siguracioni dhe certifikata e kontrollit teknik, e cila nuk mund të lëshohet pa paguar taksën e qarkullimit rrugor të mjetit. Gjithashtu mos paraqitja e fotos, nuk është mos plotësim kriteri, pasi janë paraqitur dokumente të tjera të rëndësishme që vërtetojnë se OE i ka paisjet e kërkuara. Të gjitha këto shpjegime janë dhënë me qëllim që të kihet në konsideratë nga Autoriteti Kontraktor (KVO), në vijimësi gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave.

KVO: Mungon cekici pneumatic.

Nga auditimi konstatohet se nuk është paraqitur dokumentacion për çekiç pneumatik nga BOE.

8. Kokore mungojne 20 cope, nuk jane paraqitur me fature tatimore

9. Mungojne prozhektore ndricimi naten

10. Kulla e ndricimit paraqitur pa foto

11. Mungojne 39 tabela paralajmeruese qe nuk jane paraqitur me foto e fature tatimore

12. Staf i punonjesve te paraqitur (teknik ndertimi,murator, hekurthyes, shofere, mekanik, karpentier, automakinist, manovratore) kane mungesa ne dokumentacion si Kontrate Pune, Libreze Pune, Deshmi/Diplome, Deshmi kualifikimi te Sigurimit Teknik dhe per Manovratoret Leje Drejtimi Kategoria C dhe nuk plotesojne numrin e kerkuar nga AK.

13. Mjeku z. A. K. nuk i eshte bere rinovimi i Urdherit te Mjekut edhe pse eshte paraqitur nje deklarate nga operatori ku thote qe per shkak te situates se Covidit. Urdheri ka dal me date 20.04.2015 me te drejte rinovimi 5 vjecare. Mbaron me date 20.04.2020. Ne Urdher shkruhet se rinovimi behet dy muaj para afatit te skadimit. Keshtu rinovimi duhet te kryhej me date 20.02.2020 ku Pandemia nuk kish filluar ende.

14. Tek vertetimi i Administrates Tatimore ku eshte paraqitur numri i punonjesve mungon per muajin Mars 2020 deklarimi i nr te punonjesve per OE M... sh.p.k.

Nga auditimi konstatohet se BOE “M...&I...” ShPK nuk plotëson të gjitha kriteret e vendosura në DST.

Arsyet e skualifikimit nga KVO të BOE “F...” & Sh... 07” ShPK

KVO: Mungon pompe betoni 1 cope

Nga auditimi konstatohet se: Autobetoniere dhe pompe betoni me targa AA3...P dhe autopompë betoni me targa AA7...T me dokumentacion të rregullt. Pretendimi i KVO se mungon pompe betoni 1 cope, nuk qëndron.

KVO: Mungon kompresor 1 cope.

Nga auditimi konstatohet se për kompresor është paraqitur fatura tatimore me nr.12, datë .3.2012, blerës OE “Sh... 07” ShPK .

KVO: Mungon 1 Autobot uji me sprucator

Nga auditimi konstatohet se janë paraqitur 2 autobote me targa AA2...P me dokumentacion të rregullt, në pronësi të OE “Sh... 07” ShPK , si dhe autoboti me targa AA0...V i marrë me qira

nga OE "F..." ShPK, ku sipas kontratës noteriale me nr. repertori 940 dhe nr. koleksioni 331, ku qiradhënës është subjekti "R... B...", ShPK. Sipas ekstraktit të rregjistrimit tregtar, mjete me targa AA0...V është autobot uji (nuk është shënuar në kontratë ky specifikim). **Por për këtë mjet nuk është paraqitur leja e transportit që lëshohet nga njësia vendore. Kjo është e vetmja mangësi,** për të cilën KVO është shprehur në mënyrë shumë të shkurtuar, duke thënë se "mungon një autobot", ndërkohë që duhet të shprehej në mënyrë të hollësishme se për të plotësuar kriterin për autobotin e dytë, BOE ka paraqitur kontratën noteriale me subjektin..., në të cilën vërtetohet se ka marrë me qira mjedin... Për këtë mjet janë paraqitur këto dokumente..... Për këtë mjet mungojnë këto dokumente.....

Kjo mënyrë e të shprehurit të KVO është karakteristikë pothuaj në të gjithë tenderat e audituar.

4. Mungon Motopompe thithese vetmbushese 1 cope

Mungon Minifadrome 1 cope

Nga auditimi konstatohet se është paraqitur deklarata doganore për mjedin minifadrom, modeli "New Holland", til L-180.

6. Mungon sharre per prerje tubash betoni 1 cope

7. Mungon Kulle ndricimi naten 1 cope

Nga auditimi konstatohet se nuk është paraqitur dokumentacion për kullë ndriçimi.

8. Vibrator i paraqitur paraqitur pa foto

9. Gjenerator i paraqitur pa foto

10. Pompe per largim ujerash i paraqitur paraqitur pa foto

11. Paisjet (Kokore, fikse zjarri, prozhektore ndricimi naten, tabela paralajmeruese) jane paraqitur me fature tatimore, pa foto.

12. Per punonjesit e kerkuar (teknik ndertimi, murator, hekurthyes, shofer, mekanik, karpentier, automakinist, manovratore mjetesh te renda) nuk plotesojne dokumentacionet e kerkuar dhe te gjitha punonjesit jane pa Libreze Pune.

13. Mjeku z. A. Y. i operatorit "Sh... 07 sh.p.k" i mungon CV.

14. Mungon Deklarata nga Administratori i "Sh... 07 sh.p.k", qe subjekti ka paguar te gjitha detyrimet e taksave e tarifave vendore.

15. Mungon nga te dy operatoret Deklarata nga Administratori i shoqerise qe informacioni dhe dokumentat e paraqitur ne tender jane te sakta dhe nuk permbajne informacion te rreme, per penalizim konform parashikimeve te nenit 13 te LPP.

16. Nuk eshte paraqitur xhiroja per vitin 2016 nga te dy operatoret.

Arsyet e skualifikimit nga KVO të OE "L... K..." ShPK

KVO: Mungojne 2 Autobetoniere

Nga auditimi konstatohet se në DST janë kërkuar 4 autobetoniere. Për plotësimin e këtij kriteri OE "L... K..." ShPK ka lidhur kontratë qiraje me nr.1084 rep, nr.315 kol. Me shoqërinë "A... N..." ShPK, nëpërmjet së cilës ka marrë me qira dy autovetoniere me targa AA6...V dhe AA6...V, dokumentacioni i të cilave është i rregullt. Gjithashtu me shoqërinë "A...N..." ShPK ka lidhur kontratën noteriale të qirasë nëpërmjet së cilës ka marrë me qira auto betonierën me targa G...4B, për të të cilën është paraqitur i gjithë dokumentacionin e kërkuar.

OE "L... K..." ShPK ka lidhur kontratë noteriale me shoqërinë "M..." ShPK nëpërmjet së cilës ka marrë me qira autobetonieren me targa AA5...T. **Ky mjet nuk është i pajisur me certifikatë për transportë mallrash me qira dhe për të tretë, por vetëm me certifikatë për transport mallrash për llogari të vet dhe për këtë arsye nuk plotëson kushtet ligjore për tu përdorur nga OE "L... K..." ShPK.**

KVO: Mjetit kamionçinë me targa AA1...D i mungon leja e transportit.

Nga auditimi konstatohet se në DST është kërkuar 1 kamionçinë me kap mbajtës deri ne 3.5 ton. Për plotësimin e këtij kriteri OE ka paraqitur kamionçinën me targa AA1...D, në pronësi të OE "L... K..." ShPK. Nga të dhënat e lejes së qarkullimit të mjetit, konstatohet se masa maksimale e autorizuar (nr. 23 në lejen e qarkullimit), është 3500 kg, ndërsa masa e mjetit bosh (nr. 24 në lejen e qarkullimit) është 2350 kg. Diferenca midis tyre jep ngarkesën maksimale që duhet të transportojë mjeti, e cila është 1150 kg. Referuar nenit 46 të ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998 "Për transportet rrugore", i ndryshuar, ku thuhet se "Dispozitat e këtij ligji nuk zbatohen për mjetet me kapacitet transportues nën 1500 kg", rezulton se mjeti kamionçinë me targa AA1...D nuk ka detyrimin ligjor për tu pajisur me leje/certifikatë transporti. **Për këtë arsye pretendimi i KVO nuk qëndron.**

3. Mungon fatura tatimore per pompe betoni paraqitur vetem me foto
4. Mungon Minifadroma 1 cope eshte paraqitur mjet Bobcat
5. Sharre per prerje tubash betony paraqitur pa foto
6. Deflektometer ose pjaster per matjen e ngjeshjes se shtresave rrugore paraqitur pa foto
7. Kontenier ose zyre ne objekt paraqitur pa foto
8. Stafi i punonjesve te paraqitur (teknik ndertimi, murator, hekurthyes, shofere, mekanik, karpentier, manovratore) kane mungesa ne dokumentacion si Kontrate Pune, Libreze Pune, Deshmi/Diplome, Deshmi kualifikimi te Sigurimit Teknik dhe per Manovratoret Leje Drejtimi Kategoria C dhe nuk plotesojne numrin e kerkuar nga AK.

Arsyet e skualifikimit nga KVO të operatorit ekonomik "K..." ShPK

KVO është shprehur vetëm me një fjali: Operatorit ekonomik i mungon gjithë dokumentacioni i kërkuar per realizimin e kësaj procedure.

Nga auditimi i plotësimin të kriterit të numrit të punonjësve, konstatohet se operatori ekonomik "K..." ShPK , nuk e plotëson këtë kriter, sepse në listëpagesat e araqitura ka mesatarisht 26 punonjë, ndërkohë që në DST janë kërkuar 70 punonjës.

Mbi kualifikimin nga KVO të BOE "T... B... & V... H..." ShPK

Titulli: Kualifikim dhe shpallje fitues e operatorit ekonomik i cili nuk plotëson kriteret e vendosura në DST

Situata: Në kontratën e bashkëpunimit të hartuar midis dy operatorve ekonomik është përcaktuar se OE "T... B..." ShPK do të realizojë 90% të punimeve, ndërsa OE "V... H..." ShPK do të realizojë 10 të punimeve. Të dy operatorët ekonomik do të realizonë përqindjet e mësipërme mbi secilin zë të preventivit, pasi nuk janë përcaktuar zëra të vecantë për njërin, apo tjetrin operator. Përfaqësues i BOE është caktuar OE "T... B..." ShPK.

• Në pikën 2.3.2 të seksionit kapaciteti teknik të kriterëve të vecanta të SDT, është vendosur kriteri që "Ofertuesi duhet te disponojë licencë QKL III.2.B "Grumbullim, Transportim e mbetjeje Urbane".

Nga auditimi konstatohet se kjo licencë është paraqitur vetëm nga OE "V... H..." ShPK, por jo nga OE "T... B..." ShPK. Mangësia e mësipërme është në kundërshtim me kërken e prcaktuar në DST për paraqitjen e kësaj licence dhe nenin 74 - Bashkimi i operatorëve ekonomikë, pika 3, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për rregullat e prokurimit publik", i ndryshuar, ku thuhet: "Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje".

Një nga arsyet e skualifikimit të OE "T... B...", në procedurën e prokurimit me objekt "Ndërtimi i linjës kryesore dhe shpërndarjes se furnizimit me ujë te Njësisë Administrative

Velabisht Bashkia Berat”, me vlerë të fondit limit 11,646,530 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 12.05.2020, është mungesa e licencës QKL III.2.B “Grumbullim, Transportim, Ruajtje, e mbetjeve Urbane”, ndërsa në këtë procedurë konstatohet se nuk është evidentuar kjo mangësi, duke vepruar me dy standarde, ndërkohë që dy nga anëtarë e KVO janë të njëjtë në të dy procedurat e zhvilluara (znj. E. M. dhe z. L. B.).

• Në pikën 2.3 germa (c) seksioni “Per kapacitetin ekonomik dhe financiar” të kriterëve të vecanta të DST është vendosur kriteri që operatori ekonomik duhet te paraqese një deklaratë me shkrim nga administratori se subjekti ka paguar te gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, ne vendet ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitetet per periudhen vitet, 2018 2019 sipas afateve te percaktuara ne ligjin 9632/2006 “Per sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. Kesaj deklarate duhet t’i bashkengjiten te gjithe vertetimet qe deshmojne se operatori ekonomik ka paguar detyrimet perkatese, ne vendet ku ka ushtruar apo ushtron aktivitetet per kete periudhe.

Nga auditimi i konstatohet se OE ”T... B...” ShPK ka zhvilluar aktivitetet edhe në Bashkinë Divjak për periudhën 25.07.2017 deri më 10.05.2018, për arsye se është shpallur fitues në procedurën e prokurimit “Rikonstruksion dhe zgjerim i rrugës Divjakë – Gërmenj, Bashia Divjakë”, vërtetuar me formularin e vlerësimit të paraqitur nga vetë operatori ekonomik në SPE, për të dëshmuar përvojën në punë të mëparshme të ngjashme.

OE “T... B...” ShPK nuk ka paraqitur vërtetim se ka shlyer detyrimet për taksat dhe tarifat vendore në Bashkinë Divjakë, për periudhën 01.01.2018 deri më 10.05.2018, në kundërshtim me kërkesën e paraqitur në DST, pika 2.3, germa (c) seksioni “Per kapacitetin ekonomik dhe financiar” të kriterëve të vecanta të DST. Kjo mangësi nuk është evidentuar nga KVO.

• Në pikën 2.3.3 të kapacitetit teknik të kriterëve të veçanta të DST, është vendosur kriteri: “Për te provuar se ka përvojë e duhur, operatori duhet te dëshmojë se ka te punësuar mesatarisht të paktën **70 (shtatëdhjetë)** punonjës, me kohe te plot, për periudhën Qershor 2019–Mars 2020 të dëshmuar me vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj në periudhën e mësipërme”.

Meqenëse në kontratën e bashkëpunimit të hartuar midis dy operatorëve ekonomik është përcaktuar se OE “T... B...” ShPK do të realizojë 90% të punimeve, si rrjedhojë ky operatorë në përpjesëtim me përqindjen e punimeve të caktuar në kontratë, duhet të ketë 90% të numrit të punonjësve të kërkuar në DST, pra duhet të ketë mesatarisht 63 punonjës për periudhën Qershor 2019–Mars 2020.

Për plotësimin e kriterit të mësipërm, nga operatori ekonomik ”T... B...” ShPK, është paraqitur vërtetim nga Drejtoria Rajonale Tatimore Berat, i cili përmban datën 01.05.2020, nga auditimi i të cilit konstatohet se OE ”T... B...” ShPK ka të punësuar mesatarisht për periudhën e kërkuar 38 punonjë dhe jo 63, duke mos plotësuar kriterin e numrit të punonjësve të kërkuar në DST me një diferencë të konsiderueshme prej 25 punonjës..

Të dhënat e paraqitura në vërtetimin e lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Berat, paraqitur në SPE nga OE ”T... B...” ShPK, paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Nr	Periudha tatimore	Numri i kontribuesve
1	Qershor 2019	40
2	Korrik 2019	37
3	Gusht 2019	37
4	Shtator 2019	38
5	Tetor 2019	36
6	Nëntor 2019	36
7	Dhjetor 2019	37
8	Janar 2020	40
9	Shkurt 2021	38

10	Mars 2021	40
	Numri mesatar i punonjësve	38

Në pikën 2.3.4 të kapacitetit teknik të kriterëve të veçanta të DST, është vendosur kriteri: *“Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar, të vërtetuar me kontratë noteriale pune të vlefshme, Urdhër mjeku, diplomë, libeze pune, cv dhe të figurorë në listëpagesat e shoqërisë I (një) mjek të përgjithshëm”*. Për përmbushjen e këtij kriteri në dokumentacionin e paraqitur nga OE “T... B...” ShPK ka lidhur kontratë noteriale punësimi me mjekun z. F. N., por nga dokumentacioni i kërkuar në DST, OE “T... B...” ShPK nuk ka paraqitur librezën e punës dhe CV për mjekun F.N. Theksojmë se një nga arsyet e skualifikimit të OE “T... B...” ShPK, në procedurën e prokurimit me objekt *“Ndërtimi i linjës kryesore dhe shpërndarjes së furnizimit me ujë te Njësisë Administrative Velabisht Bashkia Berat”*, me vlerë të fondit limit 11,646,530 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 12.05.2020, është mungesa e librezës së punës dhe CV për të njëjtin mjek, pra për z. F. N., ndërsa në këtë procedurë konstatohet se nuk është evidentuar kjo mangësi, duke vepruar me dy standarde, ndërkohë që dy nga anëtarët e KVO janë të njëjtë në të dy procedurat e zhvilluara (znj. E. M. dhe z. L. B.). Për rrjedhojë kriteri konsiderohet i pa plotësuar.

- Në pikën 2.3.4 të kapacitetit teknik të kriterëve të veçanta të DST, është vendosur kriteri se operatori ekonomik duhet të ketë minimumi 90 copë kokore pune. Meqenëse në kontratën e bashkëpunimit të hartuar midis dy operatorëve ekonomik është përcaktuar se OE “T... B...” ShPK do të realizojë 90% të punimeve, si rrjedhojë ky operatorë në përpjesëtim me përqindjen e punimeve të caktuar në kontratë, duhet të ketë vërtetojë se ka 80 kokore pune. Për përmbushjen e këtij kriteri në dokumentacionin e paraqitur nga OE “T... B...” nëpërmjet faturës tatimore nr.72, datë 15.04.2020, vërtetohet se ka blerë 50 kokore pune dhe jo 80. Për rrjedhojë kriteri konsiderohet i pa plotësuar.

- Në pikën 2.3.4 të kapacitetit teknik të kriterëve të veçanta të DST, është vendosur kriteri se operatori ekonomik duhet të ketë 1 (një) punonjës që të disponojë certifikatë si *“Specialist zjarrfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi”*. Ky kriter nuk plotësohet nga operatori ekonomik “T... B...” ShPK pasi nuk ka paraqitur asnjë dokument lidhur me këtë kriter.

- Në pikën dëshmi për mjetet e pajisjet teknike të seksionit të kapacitetit teknik është kërkuar një autobitumatrice, .. 2 asfaltoshtruese..., të cilat janë paraqitur nga OE “V...H...” ShPK, i cili mbulon 10% të punimeve, por ky kriter duhet të plotësohet nga OE “T... B...” ShPK, i cili mbulon 90% të punimeve. Njëra prej asfaltoshtrueseve është me goma, por nuk është paraqitur dokumentacioni i kërkuar në DST, si leje qarkullimi, siguracion etj.

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:

BOE “T... B... & V... H...” ShPK nuk plotëson të gjitha kriteret e veçanta të vendosura në DST dhe për këtë arsye KVO nuk duhet të kishte kualifikuar këtë operatorë ekonomik, por duhet ta kishte skualifikuar. KVO nuk duhet ti kishte propozuar Titullarit të Autoritetit Kontraktor shpalljen e BOE “T... B... & V... H...” ShPK fitues. Për arsye se asnjë nga pesë operatorët ekonomik pjesëmarrës në tender nuk plotëson kriteret e vendosura në dokumentet standarde të tenderit, KVO duhet të kishte anuluar tenderin. Konstatohet se KVO ka vepruar me dy standarde, nuk ka krijuar trajtim të barabartë midis operatorëve ekonomik, por trajtim diskriminues midis tyre, pasi 4 operatorë ekonomik të cilët janë konstatuar me mangësi në plotësimin e kriterëve të vendosura në DST janë skualifikuar, ndërsa BOE “T... B... & V... H...” ShPK, në kushtet e mos plotësimi të kriterëve të DST, është kualifikuar si ofertë e suksesëshme (ofertën ekonomike më e lartë se 3 prej OE të skualifikuar).

Kriteri: Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, sipas neneve të mëposhtëm:

-neni 1, pika 2, germë (b), ku thuhet: “Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit public”.

-neni 2, pika (a) dhe (c), ku thuhet: Përzgjedhja e fituesve të kontratave publike realizohet në përputhje me këto parime të përgjithshme:

a) mosdiskriminim dhe trajtim i barabartë i ofertuesve ose kandidatëve;

c) barazi në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve

- neni 24 “Anulimi i një procedure prokurimi”, pika nr.1, germa (ç), ku thuhet :

“Autoriteti kontraktor **anulon procedurën e prokurimit** vetëm (ç) nëse asnjë nga ofertat e paraqitura nuk përputhet me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit”

neni 46 “Kualifikimi i ofertuesve”, pika 1, ku thuhet:

Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, **duhet të kualifikohen**, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret ..., që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese.

- neni 53 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3 dhe pika 5 ku thuhet:

“3.Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, **vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji. 5. Autoriteti kontraktor nuk e pranon një ofertë: a) kur ofertuesi nuk është i kualifikuar; c) kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit”;**

- neni 55, “Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese”, pika 1, germa a, ku thuhet:

“oferta fituese duhet të jetë: a) **oferta që**, në bazë të kërkesave dhe kriterëve të përcaktuara në dokumentet e tenderit, **plotëson kërkesat e objektit të prokurimit me çmimin më të ulët.**

Ndikimi: Veprimet e mësipërme kanë sjellë lidhjen e një kontrate me vlerë 17,905,258 lekë pa TVSH, me një OE i cili nuk plotëson kriteret e vendosura në DST dhe është shpallur fitues në papajtueshmëri me legjislacionin e prokurimit publik.

Shkaku: Mos zbatim i legjislacionit në fuqi për vlerësimin e ofertave të OE.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandim: Titullari i AK të analizojë arsyet e anomalive të KVO lidhur me kualifikimin e operatorve ekonomik të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura në DST, të nxjerrë përgjegjësitë dhe të marrë masa që në të ardhmen të eliminohen praktika të tilla nga KVO.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi: z. L. B., me detyrë n/kryetar i Bashkisë (arkitekt), znj. E. M., me detyrë specialiste e prokurimeve (ekonomiste).z. A. Dh., inxhinier, me detyrë specialist i kadastrës.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të raportit përfundimtar të auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacion (për aktet e konstatimit) me shkresën protokolluar në KLSH me nr.55/5 datë 26.04.2022, si dhe nëpërmjet postës elektronike në adresën b...m...@klsh.org.al datë 22.04.2022, nga z. L. B., znj. E. M., z. A. Dh., anëtarë të KVO. Gjithashtu “Mbi projektraportin e auditimit”, nga të njëjtët persona si më sipër, nga subjekti i audituar është paraqitur observacion, nëpërmjet postës elektronike në adresën b...m...@klsh.org.al datë 20.06.2022, protokolluar në KLSH me nr.55/9 prot, datë 06.06.2022, ku janë shprehur të njëjtat objeksione, si ato të bëra për përmbajtjen e akteve të konstatimit. Në të dy rastet observacionet janë të njëjta, nuk ka argumente shtesë në observacionet e bëra për

prjektraportin e auditimit. Për të dy rastet, nga subjekti i audituar janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: Mbi kualifikimin e Operatorit ekonomik BOE “T... B... & V... H...” sh.p.k.

Të dy OE kanë nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi ne nr.Rep 821 datë 20.05.2020 ku palët shprehen se kanë rënë dakort që të bëjnë ndarjen e punëve respektivisht: Shoqëria “V... H...” shp.k në masën 10% dhe Shoqëria”T... B...” sh.p.k në masën 90 % të punimeve.

Në pikën 2.3.2 të DST seksionit kapaciteti teknik te kriterëve të vecanta kërkohet kriteri që “Ofertuesi duhet të disponoj Licencë QKL III.2.B “Grumbullim, Transportim e mbetjeve urbane”.

Në kuadër të një marreveshje bashkëpunimi që kanë palët me njera-tjetrën kjo pikë është përmbushur nga BOE për plotësimin e këtij kriteri. (bashkëlidhur kopje e Licensës).

Gjithashtu kemi vlerësuar e për Mjekun z. E. M. e specialistin zjarrfikës z. G. H. që janë pjesë e stafit të operatorit “V... H...”sh.p.k që mjafton ta ketë një nga operatorët e BOE që të plotësohen kriteret.

Në pikën 2.3 gërma (c) të DST është kërkuar që duhet të paraqitet një deklaratë me shkrim që OE ka paguar detyrimet e taksave e tarifave vendore, në vendet ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitetet për periudhën 2018,2019.

Nga ana juaj është konstatuar se mungon kjo deklaratë për punë të ngjashme që ka kryer subjekti ‘T... B...’ ShPK në Bashkinë Divjakë për periudhën 25.07.2017 deri më 10.05.2018

Në SPE ky operator ka ngarkuar vërtetimin nga Bashkia Divjakë se ka paguar tarifave vendore per vitin 2018 për kantierin e ndodhur në qytetin Divjakë më datë 05.07.2018 shoqëruar ky me vërtetim dhe me formularin e vlerësimit nga Bashkia Divjakë për punën e kryer. (bashkëlidhur kopje e formular vlerësimi e vërtetimi i taksave).

Oëndrim i grupit të auditimit: Ju nuk keni bërë asnjë argumentim ligjor, për të kundërshtuar situatën e përshkruar nga audituesi në aktin e konstatimit dhe në këtë raport. Për këtë arsye onservacioni juaj nuk merret në konsideratë.

8. Procedura e prokurimit me objekt “Studim Projektimi KUZ Lagjja Uznovë, Rajoni nr.3 dhe fshatit Duhanas”, Bashkia Berat, zhvilluar në vitin 2020

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Studim Projektimi KUZ Lagjja Uznovë, Rajoni nr.3 dhe fshatit Duhanas”, Nr. Ref. 80524, datë 01.12.2020.		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 58, datë 27.11.2020	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Nr. 58, datë 27.11.2020	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. 57, datë 27.11.2020
2. Lloji i Procedurës – “Shërbim Konsulence”	Njësia e Prokurimit 1. F. A., Jurist (Personi përgjegjës) 2. A. Zh., ekonomiste 3. M. S., inxhinier (specialist i fushës)	1. L. B., Kryetar (arkitekt) 2. P. S., Anëtar (jurist) 3. E. M., Anëtar (ekonomist)
5. Fondi Limit (pa TVSh) 15,931,120 lekë.	6. Oferta fituese (pa TVSh) BOE “K... P...” SHPK & “N... G...” SHPK & “G... A...” me ofertë 15,590,000 lekë pa tvsh, sipas kontratës nr. 241/12, datë 09.02.2021 me afat nga lidhja e kontratës deri në datën 30 ditë.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 341,120 lekë ose 2.1 %.
8. Data e hapjes së tenderit Datë 21.12.2020	9. Burimi Financimit Buxheti i Bashkisë Berat 2021-2024	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 2 OE/BOE b) S’kualifikuar 0 OE/BOE, c) Kualifikuar 2 OE/BOE
11. Ankimime; Nuk ka Ka ankesë AK- nr. 5876, datë 09.12.2020	12. Përgjigje Ankesës nga AK, nuk ka Shkresa nr. 5876/4, datë 11.12.2020	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP nuk ka

Burimi i të dhënave: Bashkia Berat

Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar:

Kjo procedurë është tender i “Shërbim Konsulence”, me vlerë 15,931,120 lekë pa TVSH, i cili do të financohet nga Buxheti i vitit 2021-2022.

Mbi përlllogaritjen e fondit limit dhe përgatitjen e detyrës së projektimit, vendosjen e termave të referencës:

Për përlllogaritjen e fondit limit, në dosje nuk administrohet asnjë dokument për caktimin e një grupi pune. Në dosjen e prokurimit administrohet Detyra e Projektimit, e hartuar nga Drejtoria e Planifikimit Urban, Lejeve dhe Monitorimit të Investimeve dhe e nënshkruar nga ark. z. L. B., ing. znj. E. N. dhe ing. znj. R. V.

Bashkëlidhur detyrës së projektimit është edhe përlllogaritja e fondit limit (e integruar, vulosur në çdo fletë me vulën e Bashkisë Berat). Nga auditimi i përlllogaritjes së fondit limit, rezulton se është marrë pa asnjë referencë teknike të dokumentuar kostoja e llogaritshme 199,904,106 lekë pa TVSH për lagjen Uznovë dhe 98,158,293 lekë pa TVSH për fshatin Duhanas, duke bërë llogaritjen e fondit limit të projektimit veçmas për secilin nënobjekt respektivisht 9,285,473 lekë pa TVSH për KUZ Uznovë dhe 6,645,647 lekë pa TVSH për fshatin Duhanas, ose 15,931,120 lekë gjithsej. Llogaritja e fondit limit si dy objekte të ndara, është e paargumentuar teknikisht dhe ka rritur fiktivisht fondin limit të këtij objekti prokurimi. Nga rillogaritja e fondit limit, sipas rrugës së ndjekur nga hartuesit e fondit limit, në zbatim të VKM Nr. 354, datë 11.5.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”, seksioni III, “Vepra inxhinierike”, neni 38, grupi tarifor III, fondi limit i këtij objekti do të jetë 11,325,188 lekë me TVSH minimumi dhe 13,066,278 lekë maksimumi, mesatarja 12,195,733 lekë, ose 3,735,387 lekë më shumë se fondi i planifikuar i projektimit, duke marrë për bazë koston e llogaritshme prej 298,062,399 lekë (199,904,106 lekë + 98,158,293 lekë) të marrë nga AK. Nisur nga fakti që oferta ekonomike fituese është 15,590,000 lekë, diferenca me këtë vlerë prej **3,394,267 lekë** (15,590,000 lekë - 12,195,733 lekë), **është dëm ekonomik ndaj buxhetit të Bashkisë Berat**. Ky veprim ngarkon me përgjegjësi hartuesit e fondit limit ark. z. L. B.

Mbi kriteret e kualifikimit

Kriteret e kualifikimit janë vendosur nga Njësia e Prokurimit me procesverbalin me nr. 5730 prot., datë 01.12.2020. Për kriteret e kualifikimit është bërë ankesa e protokolluar në Bashkinë Berat me nr. 5876, datë 09.12.2020 nga OE “S...S... K...” SHPK, i cili kundërshton kriteret në lidhje me kategoritë e licencës, me disponueshmërinë e stafit teknik, numrin e të punësuarve, etj. Me Urdhrin nr. 819, datë 09.12.2020 të Kryetarit të Bashkisë z. E. D., është bërë pezullimi i procedurës dhe ngritja e komisionit për shqyrtimin e ankesës. Me procesverbalin nr. 5876/2, datë 11.12.2020 komisioni i shqyrtimit të ankesës ka konkluduar në marrjen pjesërisht në konsideratë të ankesës, duke reflektuar modifikimet me shtojcën nr. 1, datë 14.12.2020, e cila është hedhur edhe në SPE. Me Urdhrin nr. 834, datë 21.12.2020 është hequr pezullimi i procedurës së prokurimit.

Nga auditimi i këtyre kriterëve, rezulton se janë vendosur kriteret të pranueshme.

Mbi vlerësimin e ofertave

Me Urdhrin nr. 57, datë 27.12.2020 të Titullarit të AK z. E. D., është ngritur komisioni i hapjes dhe vlerësimit të ofertave me përbërje: z. L. B., Kryetar (arkitekt), z. P. S., Anëtar (jurist) dhe znj. E. M., Anëtar (ekonomist).

Vendosja në përbërje të KVO-së të z. L. B., është në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 58, sipas të cilit “...*Personat përgjegjës për hartimin e dokumenteve të tenderit nuk mund të emërohen anëtarë të komisionit të vlerësimit të ofertave...*”, pasi z. L. B. figuron si anëtar i hartimit të

Detyrës së Projektimit dhe përllogaritjes së fondit limit, të cilat janë pjesë e Dokumenteve të Tenderit.

Gjithashtu, vendosja në KVO e dy antarëve që nuk janë ekspertë të fushës së objektit që prokurohet, bie në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, nenin 37 “Shërbimi i Konsulencës”, pika 4/b, sipas të cilës “Titullari i autoritetit kontraktor apo personi i autorizuar nxjerr urdhër për krijimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, siç përcaktohet në nenin 58 të këtyre rregullave. Në rastin e shërbimit të konsulencës, të gjithë anëtarët e komisionit duhet të jenë ekspertë të fushës së objektit që prokurohet”. Veprimi i mësipërm mbart riskun për një vlerësim joprofesional dhe të papranueshëm të ofertave dhe ngarkon me përgjegjësi titullarin e AK z. E. D.

AK, ka aplikuar procedurën e prokurimit të llojit “Shërbim Konsulencë”. Nisur nga verifikimi në SPE dhe procesverbali i hapjes së ofertave nr. 5730/5 prot, datë 21.12.2020, kanë paraqitur interes dhe kanë marrë në pjesë në procedurë 2 OE, me ofertat e mëposhtme:

Nr.	OE pjesëmarrës	Vlerësimi teknik	Vlera e Ofertës
3	BOE “K...P...” SHPK & “N... G...” SHPK & “G... A...”	95 pikë	15,590,000
4	“H...” SHPK	83 pikë	15,750,000

Burimi i të dhënave: Bashkia Berat
Punoi: KLSH

Në dosje administrohet procesverbali për vlerësimin e ofertave me nr. 5730/6 prot, datë 23.12.2020.

Nga auditimi rezulton se nga KVO ka kualifikuar për fazën e dytë:

- BOE “K... P...” SHPK & “N... G...” SHPK & “G... A...” SHPK, për shkak se mungon licenca e OE S..., mungojnë certifikatat ISO të OE “I...” SHPK dhe është propozuar i njejt person si ing gjeolog dhe ekspert mjedisi.
- OE “H...” SHPK.

Për dy operatorët e kualifikuar është bërë ftesa për propozim respektivisht me nr. 5730/7 prot. dhe nr. 5730/8 prot., datë 30.12.2020.

Me procesverbalin nr. 241/1 prot., datë 15.01.2021 është mbyllur faza e dytë e prokurimit, për vlerësimin e propozimit teknik të shoqërive të kualifikuara. Sipas këtij procesverbali janë vlerësuar BOE “K... P...” SHPK & “N... G...” SHPK & “G... A...” me 95 pikë dhe OE “H...” SHPK me 83 pikë, të dyja me pikëzimin e mjaftueshëm (> 70 pikë) për të vazhduar hapjen e ofertave ekonomike. Me shkresat nr. 241/2 dhe 241/3 prot, datë 15.01.2021.2021 janë njoftuar shoqëritë e kualifikuara për vlerësimin e propozimit teknik.

Me procesverbalin nr. 241/5, datë 17.01.2021 është bërë mbyllja e fazës së tretë. Në këtë procesverbal, pas hapjes së ofertave ekonomike, të cilat rezultuan BOE “K... P...” SHPK & “N... G...” SHPK & “G... A...” me 15,590,000 lekë pa TVSH dhe OE “H...” SHPK me 15,750,000 lekë pa TVSH, është bërë llogaritja e pikëve totale të marra nga ofertuesit. Sipas këtij procesverbali janë klasifikuar BOE “K... P...” SHPK & “N... G...” SHPK & “G... A...” me 95.8 pikë dhe OE “H...” SHPK me 86.4 pikë, duke klasifikuar si fitues BOE “K... P...” SHPK & “N... G...” SHPK & “G... A...”. Me shkresat 241/6 dhe 241/7 prot, datë 18.01.2021 është bërë njoftimi i klasifikimit përfundimtar.

Me shkresën nr. 241/8 prot, datë 26.01.2021 është hartuar Raporti Përmbledhës i prokurimit, i cili është miratuar me shkresën nr. 241/9, datë 26.01.2021.

Me shkresën nr. 241/12, datë 09.02.2021 është lidhur kontrata me BOE “K... P...” SHPK & “N... G...” SHPK & “G... A...”, me vlerë të kontratës 18,708,000 lekë me TVSH dhe me afat 30 ditë nga nënshkrimi i kontratës.

Nga auditimi në dosjen e prokurimit dhe në SPE, rezulton se dokumentacioni ekonomiko-tekniko-ligjor i paraqitur nga Operatorët Ekonomikë pjesëmarrës në tender, janë konform kërkesave të përcaktuara në DT.

- Në procesverbalin nr. 241/1 prot., datë 15.01.2021, për vlerësimin e propozimit teknik, anëtarët e KVO-së nuk kanë shpjeguar me detaje vlerësimin për propozimin teknik, sipas nënplikave të përcaktuara në Dokumentet e Tenderit, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, nenin 37 “Shërbimi i Konsulencës”, pika 4/ë/ii sipas të cilës “...Secili prej anëtarëve të komisionit të vlerësimit të ofertave duhet të shpjegojë në detaje vlerësimin e tij...”.

Përsa sipër, vlerësimi teknik mbart riskun për të qenë vlerësim subjektiv. Ky veprim ngarkon me përgjegjësi anëtarët e KVO-së z. L. B., Kryetar, z. P. S. dhe znj. E.M., anëtarë.

Ndikimi/efekti: Ngritja e KVO-së në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore të PP. Vlerësimi i ofertave në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore të PP

Shkaku: Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore të PP.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Nga ana e titullarit të Bashkisë Berat të merren masa që në procedurat e prokurimit “Shërbim Konsulencë” zyrtarët e prokurimeve të zgjidhen ekspertë të fushës së objektit që prokurohet me qëllim realizimin me objektivitet të procedurës së prokurimit, si dhe për argumentimin e saktë të vlerësimit të ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të raportit përfundimtar të auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacion (për aktet e konstatimit) protokolluar në KLSH me nr. 55/7 prot, datë 28.04.2022, nga antarët e Njësisë së Përlllogaritjes së Fondit Limit dhe antarët e KVO.

Gjithashtu “Mbi projektraportin e auditimit”, nga të njëjtët persona është paraqitur observacion, nëpërmjetë postës elektronike në adresën b...m...@klesh.org.al datë 20.06.2022, protokolluar në KLSH me nr.55/9 prot, datë 06.06.2022, ku janë shprehur të njëjtat objeksione, si ato të bëra për përmbajtjen e akteve të konstatimit. Në të dy rastet observacionet janë të njëjta, nuk ka argumente shtesë në observacionet e bëra për projektraportin e auditimit. Për të dy rastet, nga subjekti i audituar janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: 1. Mbi përlllogaritjen e fondit limit, përgatitjen e detyrës së projektimit dhe vendosjen e termave të referencës: Objekti “Studim Projekti KUZ, Lagjia Uznove, Rajon nr. 3 dhe fshati Dahanas”, Bashkia Berat” është i përbërë nga 2 nën objekte:

a. KUZ lagja Uznove Rajoni Nr.3

b. KUZ fshati Dahanas

Të dy nënobjektet nuk kanë lidhje me njëri tjetrin pasi paraqesin dy zona krejt të vecanta dhe larg njëra tjetrës, të cilat kanë kërkesa të ndryshme projektimi sipas të gjitha fazave të parashikuara në VKM nr.354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim” që nga Faza I”.

Analiza e detyrës së projektimit/termat e referencës” deri te faza VI “Preventivi përfundimtar”. Në detyrën e projektimit është kërkuar të përgatiten dy projekte zbatimi të vecanta te pajisura me relacionet, specifikimet teknike, preventivat, VNM etj. Si rrjedhojë duke qëne dy objekte krejtësisht të ndarë nga njeri tjetri kostot e llogaritshme të tyre nuk mund të bashkohen bashkë për të përlllogaritur fondin limit për objektin: “Studim Projekti KUZ, Lagjia Uznove, Rajon nr. 3 dhe fshati Dahanas”, Bashkia Berat. Në lidhje me përlllogaritjen e vlerës së prokuruar të fondit limit theksojmë se është përgatitur nga anëtari z. L. B. dhe jo nga anëtarët e tjera, znj. E. N. dhe znj. R. V.

Qëndrim i grupit të auditimit: Grupi i auditimit sqaron se pretendimet e subjektit në lidhje me kërkesat e ndryshme të projektimit për dy nënobjektet, duhet të ishin marrë në konsideratë nga Autoriteti Kontraktor që në përcaktimin e detyrës së prokurimit, duke i trajtuar si dy objekte të veçanta. Duke qenë se i ka trajtuar si një objekt, me dy nënobjekte, fondi limit duhet të ishte llogaritur me konston e llogaritshme totale. Në rilloaritjen e grupit të auditimit, është konsideruara grupi tarifor më i lartë, me kërkesa më të larta projektimi. Përsa sipër, ky pretendim nuk merret në konsideratë. Në lidhje me përgjegjësinë, observacioni merret në konsideratë, duke ngarkuar me përgjegjësi vetëm antarin e grupit për përlllogaritjen e fondit limit z. L. B.

Pretendimi i subjektit:2. Komisioni i Vleresimit të Ofertave, bazuar ne aktet ligjore dhe VKM-së nr. 914, dt. 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ka vlerësuar procedurën me objekt: “Studim Projektim KUZ, Lagjia Uznove, Rajon nr. 3 dhe fshati Dahanas”, Bashkia Berat, konform kërkesës ligjore dhe referuar dokumenteve standarte të tenderit. Nëpërmjet proces-verbalit me nr. 5370, prot. dt 01.12.2020 KVO ka analizuar vlerësimin teknik të operatorëve bazuar në përvojën për punë të ngjashme, kapacitetin ekonomik dhe certifikatat e standarteve të cilësisë, përfaqshjen teknike të propozuar dhe metodologjinë sipas planit të punës, grafikun e dorëzimit të projektit si dhe organizmin e stafit. Gjithashtu është marrë në konsideratë kualifikimi i përgjithshëm i stafit dhe eksperiencia në fushë përkatëse. Të gjitha këto elemente kanë arritur në përfundimin e vlerësimit të pikëve, sipas vlerësimit të bërë nga KVO, duke respektuar parimet e ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimit Publik” i ndryshuar. Bazuar për sa më sipër. nuk jemi dakord me akt konstatimin Nr 2.

Për arsyet sa më sipër kundërshtojmë konkluzionin tuaj për vlerësim të gabuar të procedurës së prokurimit për këtë objekt. KVO ka zbatuar me përpikmëri kriteret e kërkuara për këtë procedurë, në zbatim të legjislacionit në fuqi ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar.

Qëndrim i grupit të auditimit: Grupi i auditimit, në lidhje me këtë pikë të observacionit, sqaron se nga observuesit nuk është kthyer përgjigje në lidhje me mënyrën e vlerësimit të ofertave të cituara në aktkonstatim, të cilat janë bërë në kundërshtim me legjislacionin e PP. Përsa sipër, ky pretendim nuk merret në konsideratë.

9. Procedura e prokurimit me objekt “Hartim projekti” Ura e Re mbi lumin Osum dhe rikonstrukcion i rruges Gorice-Bilce”, Bashkia Berat, zhvilluar në vitin 2021

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Hartim projekti” Ura e RE mbi lumin Osum dhe rikonstrukcion i rruges Gorice-Bilce “, Nr. Ref. 83888, datë 13.01.2021.		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 07, datë 12.01.2021	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Nr. 07, datë 12.01.2021	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. 8, datë 12.01.2021
2. Lloji i Procedurës – “Shërbim Konsulence”	Njësia e Prokurimit 1. A. Zh., ekonomiste (Personi përgjegjës) 2. F. A., Jurist 3. M. S., inxhinier (specialist i fushës)	4. A. Sh., Kryetar (agronom) 5. P. S., Anëtar (jurist) 6. E. M., Anëtar (ekonomist)
5. Fondi Limit (pa TVSh) 13,476,125 lekë.	6. Oferta fituese (pa TVSh) BOE “K... P...” SHPK & “T...” SHPK & “G... A...” me ofertë 12,293,150 lekë pa tvsh, sipas kontratës nr. 2169/1, datë 23.04.2021 me afat nga lidhja e kontratës deri në datën 60 ditë.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 1,182,975 lekë ose 8.8 %
8. Data e hapjes së tenderit Datë 01.02.2021	9. Burimi Financimit Buxheti i Bashkisë Berat 2021-2022	10. Operatoret Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 4 OE/BOE b) S’kualifikuar 2 OE/BOE, c) Kualifikuar 2 OE/BOE
11. Ankimime; Nuk ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK, nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo

Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar:

Kjo procedurë është tender i “Shërbim Konsulencë”, me vlerë 13,476,125 lekë pa TVSH, i cili do të financohet nga Buxheti i vitit 2021-2022.

Mbi përlllogaritjen e fondit limit, përgatitjen e detyrës së projektimit dhe vendosjen e termave të referencës:

Për përlllogaritjen e fondit limit, më Urdhrin nr. 857, datë 31.12.2020 është ngritur grupi i punës me përbërje ark. z. L. B., kryetar, ing. znj. V. Z. dhe ing. znj. R. V., anëtare. Në dosjen e prokurimit administrohet Detyra e Projektimi e nënshkruar nga antarët e grupit të punës.

Mbi vlerësimin e ofertave

Me Urdhrin nr. 08, datë 12.01.2021 të Titullarit të AK z. E. D., është ngritur komisioni i hapjes dhe vlerësimit të ofertave me përbërje: z. A. Sh., Kryetar (agronom), z. P. S., Anëtar (jurist) dhe znj. E. M., Anëtar (ekonomist). Vendosja në KVO e tre antarëve që nuk janë ekspertë të fushës së objektit që prokurohet, bie në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, nenin 37 “Shërbimi i Konsulencës”, pika 4/b, sipas të cilës “*Titullari i autoritetit kontraktor apo personi i autorizuar nxjerr urdhër për krijimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, siç përcaktohet në nenin 58 të këtyre rregullave. Në rastin e shërbimit të konsulencës, të gjithë anëtarët e komisionit duhet të jenë ekspertë të fushës së objektit që prokurohet*”. Veprimi i mësipërm mbart riskun për një vlerësim joprofesional dhe të papranueshëm të ofertave dhe ngarkon me përgjegjësi titullarin e AK z. E. D.

AK, ka aplikuar procedurën e prokurimit të llojit “Shërbim Konsulencë”. Nisur nga verifikimi në SPE dhe procesverbali i hapjes së ofertave nr. 175/4 prot, datë 01.02.2021, kanë paraqitur interes dhe kanë marrë në pjesë në procedurë 4 OE, me ofertat e mëposhtme:

Nr.	OE pjesëmarrës	Vlerësimi teknik	Vlera e Ofertës
1	“S... A... E...” SHPK & “4... E... 79” & “I...” & “S... R...” SHPK		
2	“G...” & P...2...1” & “U...” SHPK		
3	BOE “K... P...” SHPK & “T...” SHPK & “G... A...”	95 pikë	12,293,150
4	“N... G...” SHPK	83 pikë	12,532,796

Në dosje administrohet procesverbali për vlerësimin e ofertave me nr. 175/6 prot, datë 10.02.2021.

Nga auditimi rezulton se nga KVO ka skualifikuar për fazën e dytë:

- BOE “S... A... E...” SHPK & “4... E... 79” & “I...” & “S... R...” SHPK, për shkak se mungon licenca e OE S..., mungojnë certifikatat ISO të OE “I...” SHPK dhe është propozuar i njëjti person si ing gjeolog dhe ekspert mjedisi.

-BOE “G...” & P...2...1” & “U...” SHPK, për shkak se eksperiti i mjedisit nuk figuron ne listepagesë, Mungon kontratat e punës me një nga drejtuesit teknike, inxhinieri mekanik, inxhinieri hidroteknik, inxhinieri elektrik dhe inxhinieri gjeolog nuk figurojnë në listepagesa.

Janë kualifikuar për fazën e II, BOE “K... P...” SHPK & “T...” SHPK & “G... A...” dhe OE “N... G...” SHPK.

Për dy operatorët e kualifikuar është bërë ftesa për propozim respektivisht me nr. 175/7 prot. dhe nr. 175/8 prot., datë 18.02.2021.

Me procesverbalin nr. 175/10 prot., datë 11.03.2021 është mbyllur faza e dytë e prokurimit, për vlerësimin e propozimit teknik të shoqërive të kualifikuara. Sipas këtij procesverbali janë vlerësuar BOE “K... P...” SHPK & “T...” SHPK & “G... A...” me 95 pikë dhe OE “N...G...” SHPK me 83 pikë, të dyja me pikëzimin e mjaftueshëm (> 70 pikë) për të vazhduar hapjen e ofertave ekonomike. Me shkresat nr. 175/11 dhe 175/12 prot, datë 11.03.2021 janë njoftuar shoqëritë e kualifikuara për vlerësimin e propozimit teknik.

Me procesverbalin nr. 184/14, datë 17.03.2021 është bërë mbyllja e fazës së tretë. Në këtë procesverbal, pas hapjes së ofertave ekonomike, të cilat rezultuan BOE “KKG Projekt” SHPK & “T...” SHPK & “G... A...” me 12,293,150 lekë pa TVSH dhe OE “N... G...” SHPK me 12,532,796 lekë pa TVSH, është bërë llogaritja e pikëve totale të marra nga ofertuesit. Sipas këtij procesverbali janë klasifikuar BOE “K... P...” SHPK & “T...” SHPK & “G... A...” me 96.39 pikë dhe OE “N... G...” SHPK me 86.4 pikë, duke klasifikuar si fitues BOE “K... P...” SHPK & “T...” SHPK & “G... A...”. Me shkresat 1583 dhe 1583/1 prot, datë 18.03.2021 është bërë njoftimi i klasifikimit përfundimtar.

Me shkresën nr. 1583/4 prot, datë 26.03.2021 është hartuar Raporti Përmbledhës i prokurimit, i cili është miratuar me shkresën nr. 1583/5, datë 29.03.2021.

Me shkresën nr. 2169/1, datë 23.04.2021 është lidhur kontrata me BOE “K... P...” SHPK & “T...” SHPK & “G... A...”, me vlerë të kontratës 14,751,780 lekë me TVSH dhe me afat 60 ditë nga nënshkrimi i kontratës.

Nga auditimi në dosjen e prokurimit dhe në SPE, rezulton si më poshtë:

- OE “N... G...”, ka paraqitur në zbatim të pikës 2.3.3 të KVK si ekspert mjedisi, z. K. B. (edhe arkitekt), i cili nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se nuk është i pajisur me licencën III.2.A – “Kategoria shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis”, të kërkuar në Dokumentet e Tenderit.

Sa sipër, kualifikimi i këtij OE është i padrejtë. Me skualifikimin e këtij OE, në zbatim të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, nenin 37 “Shërbimi i Konsulencës”, pika 4/dh, sipas të cilës “*Autoriteti kontraktor shqyrton kualifikimet e kandidatëve që kanë shprehur interes në bazë të kriterëve për kualifikim jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë nga data e hapjes së procedurës. Në përfundim të kësaj faze, kandidatët e kualifikuar përshihen në një listë të shkurtër, e cila duhet të përmbajë të paktën 2 (dy) kandidatë*”, KVO duhet të kishte bërë propozimin tek titullari i AK për anulimin e procedurës dhe fillimin e një procedure të re. Ky mosveprim ka sjellë lidhjen e një kontrate me vlerë 14,751,780 lekë me TVSH me një OE, i cili është shpallur fitues në papajtueshmëri me legjislacionin e PP.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, sipas neneve të mëposhtëm:

- Neni 1, pika 2, germa (b), ku thuhet:

“Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik”.

- Neni 2, pika (a) dhe (c), ku thuhet:

Përzgjedhja e fituesve të kontratave publike realizohet në përputhje me këto parime të përgjithshme:

a) *mosdiskriminim dhe trajtim i barabartë i ofertuesve ose kandidatëve;*

....

c) *barazi në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve.*

- Në procesverbalin nr.175/10 prot., datë 11.03.2021, për vlerësimin e propozimit teknik, anëtarët e KVO-së nuk kanë shpjeguar me detaje vlerësimin për propozimin teknik, sipas nën pikave të përcaktuara në dokumentet e tenderit, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, nenin 37 “Shërbimi i Konsulencës”, pika 4/ë/ii sipas të cilës “...Secili prej anëtarëve të komisionit të vlerësimit të ofertave duhet të shpjegojë në detaje vlerësimin e tij...”.

Përsa sipër, vlerësimi teknik mbart riskun për të qenë vlerësim subjektiv. Ky veprim ngarkon me përgjegjësi anëtarët e KVO-së z. A. Sh., Kryetar, z. P. S. dhe znj. E. M., anëtarë.

Ndikimi/efekti: Ngritja e KVO-së në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore të PP. Vlerësimi i ofertave në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore të PP

Shkaku: Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore të PP.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Nga ana e titullarit të Bashkisë Berat të merren masa që në procedurat e prokurimit “Shërbim Konsulencë” zyrtarët e prokurimeve të zgjidhen ekspertë të fushës së objektit që prokurohet me qëllim realizimin me objektivitet të procedurës së prokurimit, si dhe për argumentimin e saktë të vlerësimit të ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të raportit përfundimtar të auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacion (për aktet e konstatimit) protokolluar në KLSH me nr. 55/7 prot, datë 28.04.2022, nga antarët e Njësisë së Përlllogaritjes së Fondit Limit dhe antarët e KVO. Gjithashtu “Mbi projektraportin e auditimit”, nga të njëjtët persona është paraqitur observacion, nëpërmjetë postës elektronike në adresën b...m...@klesh.org.al datë 20.06.2022, protokolluar në KLSH me nr. 55/9 prot, datë 06.06.2022, ku janë shprehur të njëjtat objeksione, si ato të bëra për përmbajtjen e akteve të konstatimit. Në të dy rastet observacionet janë të njëjta, nuk ka argumente shtesë në observacionet e bëra për projektraportin e auditimit. Për të dy rastet, nga subjekti i audituar janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: KVO ka kualifikuar për në fazën e II, BOE “K... P...” ShPK & “T...” SHPK & “G... A...” dhe OE “N... G...” SHPK . Përsa i përket studimit në dosjen prokurimit per OE “N... G...” ShPK, e cila nuk ka paraqitur licensen e ekspertit të mjedisit z. K. B. nuk jemi dakort. KVO bazuar në dokumentacion e përparitur nga ky operator në sistemin e prokurimit elektronik ka rezultuar se operatori “N... G...” ka paraqitur si ekspert mjedisi z. K. B., arkitekt i cili rezulton të jete i certifikuar në fushën profesionale lidhur me ndikim në mjedis. Në këto rrethana komisioni i vlerësimit të ofertave duke gjykuar se ky operator e përmbush qëllimin për të cilën i është kërkuar në DST, ka vazhduar me hapat e metejshëm të procedurës sipas LPP dhe nenit 37 “Shërbim Konsulencë” të VKM-së nr. 914, dt 29.12.2014. “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Në përfundim të kësaj faze janë kualifikuar dy kandidatë për vlerësimin e propozimit teknik. Ky vlerësim është shpjeguar sipas procesverbalit të komisionit të vlerësimit të ofertave nr.175/10, datë 11.03.2021.

KVO ka analizuar vlerësimin teknik të operatorëve bazuar në përvojën për punë të ngjashme, kapacitetin ekonomik dhe certifikatat e standarteve të cilesise, përfaqshjen teknike të propozuar dhe metodologjinë sipas planit të punës, grafikun e dorezimit të projektit si dhe organizimin e stafit. Gjithashtu është marrë në konsideratë kualifikimi i pergjithshëm i stafit dhe eksperiencia në fushë perkatese. Të gjitha këto elemente kanë arritur në përfundimin e vlerësimit të pikëve, sipas vlerësimit të bërë nga KVO, duke respektuar parimet e ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Për arsyet sa më sipër kundërshtojmë konkluzionin tuaj për vlerësim të gabuar të procedurës së prokurimit për këtë objekt. KVO ka zbatuar me përpikmëri kriteret e kërkuara për këtë procedurë, në zbatim të legjislacionit në fuqi ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar.

Oendrim i grupit të auditimit: Grupi i auditimit në lidhje me këtë pikë të observacionit sqaron se OE “N... G...”SHPK për z. K. B. ka paraqitur vetëm certifikatën për hartimin e VNM dhe nuk ka paraqitur licencën III.2.A – “Kategoria shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis”, të kërkuar në Dokumentet e Tenderit. Përsa sipër, ky pretendim nuk merret në konsideratë.

10. Procedura e prokurimit me objekt “Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara”

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara.		
1. Urdhër Prokurimi: nr. 4263 prot. datë 19.08.2021	3. Hartuesit e D. Tenderit: nr. 4263 datë 19.08.2021	4. Komisioni i V. Ofertave: nr. 4263/1, datë 19.08.2021
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “E hapur”	E. M. – Jurist A. P. – Ekonomiste M. S.– Inxhiniere	L. B. – Kryetar P. S. – Anëtar E. M. – Anëtare
5. Fondi Limit (pa TVSh) 27,789,747 lekë	6. Oferta fituese (pa TVSh): 26,775,773 lekë (Z... shpk)	7. Diferenca me fondin limit: (pa TVSh) 1,013,974 lekë
8. Data e hapjes së tenderit: 14.09.2021	9. Burimi Financimit Buxheti i shtetit + bashkisë	10. Operatorët Ekonomikë: a) Pjesëmarrës në tender, 2 OE b) Kualifikuar 1 OE, c) S’kualifikuar 1 OE
11. Ankimime AK – s’ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK – s’ka	13. Përgjigje Ankesës nga KKP

Titulli i Gjetjes: *Moszbatim i legjislacionit në fuqi mbi Prokurimin Publik në shpalljen e ofertës fituese, në tenderin e zhvilluar me objekt “Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara”, Bashkia Berat”, me fond limit 27,789,747 lekë pa TVSh.*

Situata: Nga Autoriteti Kontraktor (AK) Bashkia Berat, nuk është bërë e mundur që ky urdhër prokurim të konfirmohet në Degën e Thesarit, për të siguruar garancinë e fondeve dhe mos krijimin e vlerave të papaguara në përfundim të kontratës, veprime në kundërshtim me udhëzimin plotësues nr. 4, datë 25.01.2021 të MF “Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2021”, ku përcaktohet se:

“Dega e Thesarit kryen kontrollin e totalit të fondeve të paraqitura në regjistrin e prokurimeve me totalin e fondeve të miratuara në buxhetin e njësisë dhe, vetëm pasi vulozet nga Thesari urdhri i prokurimit, njësia mund të fillojë procesin e prokurimit në Agjencinë e Prokurimeve Publike”.

“Të gjithë urdhrat e prokurimit që nxirren gjatë vitit për mallrat, shërbimet dhe investimet duhet të paraqiten në degën e Thesarit, së bashku me ftesën për prokurim, të cilat duhet: (i) t’i përmbahen listës së prokurimeve të dorëzuar në Thesar, (ii) të kontrollohen për përputhshmëri me regjistrin e prokurimeve dhe të vulozen nga dega e Thesarit, përpara procedimit, sipas rregullave të prokurimit publik”.

Me shkresën nr. 4263/5 prot., datë 31.08.2021, është bërë pezullimi i kësaj procedure prokurimi për arsye që të bëhen disa ndryshime dhe saktësime në lidhje me dokumentat standarde të tenderit pas sugjerime të APP.

Me shtojcën nr. 4263/6 prot., datë 01.09.2021, janë bërë modifikimet si më poshtë vijon:

Ishte	Bëhet
<p>Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij si drejtues teknik të shoqërisë, inxhinierët e mëposhtëm:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Inxhinier Ndërtimi 1(një) • Inxhinier Hidroteknik1 (një) • Inxhinier Gjeodet 1 (një) • Inxhinier elektrik 1 (një) • Inxhinier Mekanik 1(një) 	<p>Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij si drejtues teknik të shoqërisë, inxhinierët e mëposhtëm:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Inxhinier Ndërtimi 1(një) • Inxhinier Hidroteknik1 (një) • Inxhinier Gjeodet 1 (një) • Inxhinier elektrik 1 (një)
<p>Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit (regjistrat tregtarë, sipas nenit 77, pika 1/a dhe 2, të LPP-së) dhe të ketë në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit.</p>	<p>Hiqet</p>
<p>2.3.3 b) b) Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij personel të kualifikuar/çertifikuar si:</p> <p>➤1 (një) punonjës përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë, i cili të jetë i çertifikuar “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë” në përputhje me klauzolat e ligjit nr.10327 date 18.02.2010 <i>“Për sigurinë dhe shëndetin në punë”</i> dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 <i>“Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”</i>.</p> <p>c) Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë në stafin e tij: me kontratë pune, diplomë, CV.</p> <p>➤Arkitekt 1 (një)</p> <p>➤Operatori ekonomik duhet të disponojë një nga inxhinierët të paisur me certifikatë për “Përgjegjës siguri për mbrojtjen e shëndetit në punë”</p> <p>➤Operatori ekonomik duhet të disponojë një specialist të paisur me certifikatë “Ekspert për ndihmën e parë dhe nderhyrjen ndaj emergjencave”</p> <p>Operatori ekonomik duhet të disponojë një specialist të paisur me certifikatë “Për punime në lartësi”.</p>	<p>Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij personel të kualifikuar/çertifikuar si:</p> <p>1 (një) punonjës përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë, i cili të jetë i çertifikuar “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë” në përputhje me klauzolat e ligjit nr.10327 date 18.02.2010 <i>“Për sigurinë dhe shëndetin në punë”</i> dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 <i>“Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”</i>.</p> <p>c) Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë në stafin e tij: me kontratë pune, diplomë, CV.</p> <p>➤Arkitekt 1 (një)</p> <p>➤Operatori ekonomik duhet të disponojë një specialist të paisur me certifikatë “Për punime në lartësi”.</p>

Dokumentet e tenderit janë hartuar me procesverbalin nr.4263/3 prot., datë 19.08.2021.

Kërkesat e veçanta për kualifikim nuk janë argumentuar nga ana e NJHDT, por vetëm janë listuar si të tilla, veprim në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, nenin 61, “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, pika 2, paragrafi 2, në të cilin kërkohet që:

“Në çdo rast, hartimi i kriterëve për kualifikim dhe specifikimet teknike duhet të argumentohen dhe të dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre.”

Nga auditimi i tyre u konstatuan kërkesa në kundërshtim me Ligjin e Prokurimit Publik dhe akte të tjera ligjore që kanë lidhje me procedurën e prokurimit sa vijon:

Operatori ekonomik duhet të disponojë:

Në DT janë kërkuar: Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentet e mëposhtme:

- Formulari i vlerësimit nga AK sipas shtojcës nr.9, shoqëruar me:
- Aktin e kolaudimit;
- Situacioni përfundimtar;
- Aktin e marrjes në dorëzim të punimeve.

➤ **Kërkesa për paraqitjen e aktit të marrjes në dorëzim**, është kërkesë e tejkualuar e VKM nr. 914, datë 29.12.2014, nenin 26 “Kontratat për punë publike” të VKM nr.914 dt. 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, pasi akti i marrjes në dorëzim bëhet për një periudhë kohore 1 – 2 vjeçare, duke tejkualuar në këtë mënyrë afatin tre vjeçar të periudhës së kërkuar. Gjithashtu në zbatim të nenit 26, pika 6 të VKM nr.914, të ndryshuar parashikohet se:

Autoriteti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik ku të shënohen vlera, koha dhe natyra e punës së bërë dhe çdolloj dokumenti tjetër, që parashikohet në legjislacionin në fuqi, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Sa më sipër kjo kërkesë e pengon OE për të marrë pjesë në garë për një punë për të cilën ende nuk e kanë marrë certifikatën e marrjes në dorëzim.

➤ Operatori ekonomik duhet të ketë fuqi minimale punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, me një numër prej mesatarisht **45 punonjës**. Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën **Mars 2021 - Qershor 2021**.

Sqarojmë se ky numër punonjësish i kërkuar më sipër, nuk është argumentuar me zberthimin e preventivit dhe grafikun e punimeve. Gjithashtu nuk është kërkuar muaji i fundit përpara datës së zhvillimit të kësaj procedure prokurimi që është data 14.09.2021.

➤ Operatori ekonomik duhet të ketë në dispozicion apo mund t’i vihen në dispozicion mjetet e pajisjet teknike të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, si më poshtë (sipas formularit përmbledhës të vetëdeklarimit):

Mjetet	Sasia	Gjendja
Kamiona vetshkarkues kapacitet mbajtës 15-20 ton	2 copë	Pronësi ose me qera
Kamion vetshkarkues kapacitet mbajtës deri 10 ton	1 copë	Pronësi ose me qera
Autovinxh	1 copë	Pronësi ose me qera
Kamioncine deri 3.5 ton	3 copë	Pronësi ose me qera
Kamioncine 3.5-7.5 ton	1 copë	Pronësi ose me qera
Fadrome/Skrep	1 copë	Pronësi ose me qera
Minieskavator	1 copë	Pronësi ose me qera
Minifadrome/Bobcat	1 copë	Pronësi ose me qera
Autobetoniere	1 copë	Pronësi ose me qera
Eskavator me zinxhire	1 copë	Pronësi ose me qera
Rimorkiator	1 copë	Pronësi ose me Qera ose me kontratë bashkpunimi
Elektrosaldatrice	1 copë	Pronësi ose me qera
Autobote uji	2 copë	Pronësi ose me qera
Fabrik Betoni me QKL	1 copë	Pronësi ose me qera ose kontratë furnizimi

Linje prodhimi per Pllaka e bordura	1 copë	Pronësi ose me qera ose kontratë furnizimi
Fabrikë për prodhimin e dymve dhe dritareve pvc dhe duaralumin	1 copë	Pronësi ose me qera ose kontratë furnizimi

Sqarojmë se ky numër mjetesh i kërkuar më sipër, nuk është argumentuar me zërthimin e preventivit dhe grafikun e punimeve.

Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 1, 2, 20, 23 dhe pikën 1 dhe 3 të nenit 46 të ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe ngarkojnë me përgjegjësi NJP, të përbërë nga z. E. M., znj. A. P. (Zh.) dhe znj. M. S.

Tenderi është hapur me procesverbalin nr.4263/8 prot., të datës 14.09.2021. Në të kanë marrë pjesë dhe janë vlerësuar nga KVO sa më poshtë vijon:

Nr	Operatori Ekonomik	Vlera e ofruar	Vlerësimi i KVO
1	Z... shpk	26,775,773	Kualifikuar/Fitues
2	E...	Nuk ka ofertë	S’kualifikuar pasi nuk ka paraqitur asnjë dokument në sistem.

Sipas raportit përmbledhës me nr. 4263/11 datë 27.09.2021, rezulton se kanë marrë pjesë 2 operatorë ekonomik. Është s’kualifikuar operatori ekonomik i cili nuk ka paraqitur asnjë dokument në sistem dhe është kualifikuar dhe shpallur fitues operatori tjetër ekonomik.

Kontrata midis Autoritetit Kontraktor dhe operatorit ekonomik të shpallur fitues “Z...” shpk, është lidhur me nr.4785/3 prot., datë 28.09.2021.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të OE “Z...” shpk, i cili është shpallur fitues nga KVO, rezultuan këto mangësi:

Në DST është kërkuar sa më poshtë vijon:

2.3.1 Përvojë të suksesshme në realizimin e të paktën:

a. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet (*pa TVSH*) dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

ose

b. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet (*pa TVSH*).

Operatori ekonomik “Z...” shpk për plotësimin e këtij kriteri ka paraqitur këto kontrata:

1-Kontrata e lidhur me bashkinë Berat, me nr. 465 prot., datë 16.05.2019, me objekt “Rikonstruksioni i konviktit të djemve të shkollës ‘Kristo Isak’, Berat”, me vlerë 25,637,620 lekë me TVSh.

2-Kontrata e lidhur me bashkinë Kuçovë, me nr.3050 prot., datë 12.09.2018, me objekt “Rikonstruksioni i objekteve të komunitetit Rom dhe Egjiptiane Kuçovë dhe banues në zona rurale”, me vlerë 14,574,632 lekë me TVSh.

3- Kontrata e lidhur me bashkinë Cërrik, me nr.3151 prot., datë 26.09.2018, me objekt “Rehabilitim/Përforsim banese ekzistuese”, me vlerë 20,834,535 lekë me TVSh.

OE “Z...” shpk, nuk ka pasqyruar në Ekstraktin historik të QKR-së këto vende të zhvillimit të biznesit si dhe hapjen e niptit sekondar. Operatori ndonëse zhvillon aktivitetet biznesi në vendndodhje të ndryshme nga selia, nuk i ka pasqyruar në ekstraktin e QKR-së, si vende zhvillimi të biznesit ku do të duhej të pajisej edhe me NIPT sekondar për këto vende të tjera zhvillimi biznesi, e më tej të paguante detyrimet vendore e të pajisej me vërtetim për secilin prej këtyre njërive. Personi i tatueshëm që ushtron veprimtari në adresa (vendndodhje) të ndryshme biznesi, pajiset me certifikatë regjistrimi për çdo adresë, e cila ka një NIPT “unik”. Mosregjistrimi vjen në kundërshtim me ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” nenin 40, nenin 3.1/a.b.c te ligjit nr. 131/2015 “Për qendrën kombëtare të biznesit”, si dhe ligjin nr. 9723 dt.03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”. Gjithashtu, rezulton se ky operator ekonomik duke mos hapur niptin sekondar në Bashkinë Berat, është debitor ndaj kësaj Bashkie.

Në DST është kërkuar sa më poshtë vijon:

➤ Operatori ekonomik duhet të ketë në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion mjetet e pajisjet teknike të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, si më poshtë (sipas formularit përmbledhës të vetëdeklarimit):

Mjetet	Sasia	Gjendja
Kamiona vetshkarkues kapacitet mbajtës 15-20 ton	2 copë	Pronësi ose me qera
Kamion vetshkarkues kapacitet mbajtës deri 10 ton	1 copë	Pronësi ose me qera
Autovinxh	1 copë	Pronësi ose me qera
Kamioncine deri 3.5 ton	3 copë	Pronësi ose me qera
Kamioncine 3.5-7.5 ton	1 copë	Pronësi ose me qera
Fadrome/Skrep	1 copë	Pronësi ose me qera
Minieskavator	1 copë	Pronësi ose me qera
Minifadrome/Bobcat	1 copë	Pronësi ose me qera
Autobetoniere	1 copë	Pronësi ose me qera
Eskavator me zinxhire	1 copë	Pronësi ose me qera
Rimorkiator	1 copë	Pronësi ose me Qera ose me kontratë bashkpunimi
Elektrosaldatrice	1 copë	Pronësi ose me qera
Autobote uji	2 copë	Pronësi ose me qera
Fabrik Betoni me QKL	1 copë	Pronësi ose me qera ose kontratë furnizimi
Linje prodhimi per Pllaka e bordura	1 copë	Pronësi ose me qera ose kontratë furnizimi
Fabrikë për prodhimin e dyerve dhe dritareve pvc dhe duaralumin	1 copë	Pronësi ose me qera ose kontratë furnizimi

Për plotësimin e këtij kriteri operatori ekonomik “Z...” shpk ka paraqitur shtojcën 8 ‘Mbi disponimin e makinerive’, ka paraqitur këtë kontratë noteriale si më poshtë vijon:

1-Kontratë noteriale me nr. 661 Rep., dhe 346 Kol., të datës 19.02.2021 të lidhur me z. N. P., me anë të së cilës ka marrë me qira kamionin me targa AA 7...M.

Në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, neni 1, 3, 5 dhe Kreut III.1, “Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë”, nenet 41, 42, 43 dhe 44, si dhe Kreut III.2, “Transporti i mallrave për vete”, nenet 45, 46, dhe 47, bëhet qartësisht ndarja midis këtyre mënyrave të transportit dhe përcaktohet ndalimi i secilës nga mënyrat e transportit pa pajisjen me licencën përkatëse.

Në rastin konkret, nëpërmjet dokumentacionit të dorëzuar vërtetohet se certifikata e mjetit të mësipërm të cilën e disponon z. N. P. sipas lejes së qarkullimit, është **specifike dhe e lëshuar vetëm për transport për vete, për kryerjen e transportit të mallrave me kamion, vetëm për llogari të veprimtarisë së z. N. P.**

Në këtë mënyrë, kryerja e transportit të mallrave nga ana e shoqërisë “Z...” sh.p.k. me kamionin e z. N. P. do të jetë në kushtet e kryerjes së transportit të mallrave me qira dhe për të tretë pa licencën përkatëse, transport i cili në zbatim të nenit 41 të ligjit “Për transportet rrugore” është i ndaluar.

Për sa më sipër KVO nuk duhet të kishte kualifikuar operatorin ekonomik “Z...” shpk, dhe nuk duhet t’i kishte propozuar titullarit për shpalljen fitues të tij. KVO duhet të kishte anuluar tenderin dhe moskryerja e këtij veprimi është në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, sipas nenit të mëposhtëm:

- neni 76 “Kriteret detyruese për s’kualifikim”, pika nr.3, gërma (ë), ku thuhet :

“operatori ekonomik ka paraqitur deklaratat të rreme në dhënien e informacionit të kërkuar për të vërtetuar mungesën e arsyeve për skualifikim ose për plotësimin e kriterëve të përzgjedhjes, ka fshehur një informacion të tillë ose nuk është në gjendje të dorëzojë dokumentet provuese sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit;”

- neni 98 “Anulimi i një procedure prokurimi”, pika 1, gërma (b) ku thuhet:

Në procedurat me një fazë nuk është dorëzuar asnjë ofertë e përshtatshme;

Mos anulimi i procedurës dhe shpallja fitues e OE “Z...” shpk, i cili nuk i plotëson kriteret e DST ka shkaktuar lidhjen e një kontrate me vlerë **26,775,773 lekë** me një OE, i cili është shpallur fitues në papajtueshmëri me legjislacionin e PP dhe ngarkon me përgjegjësi KVO e përbërë nga: z. L. B., z. P. S. dhe znj. E. M.

Kriteri: Legjislacioni në fuqi për Prokurimin Publik.

Ndikimi/Efekt: Lidhjen e një kontrate me vlerë **26,775,773 lekë** me një OE, i cili është shpallur fitues në papajtueshmëri me legjislacionin e PP.

Shkaku: Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandim: Nga ana e Bashkisë Berat të merren masa për vendosjen e kriterëve të DST në përputhje me objektin e prokurimit si dhe për eliminimin e këtyre praktikave të shpalljes fitues të OE që nuk plotësojnë kriteret e miratuara në DST.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të projekt raportit të auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni mbi akt konstatimin nr. 9 datë 15.04.2022 protokolluar në KLSH me shkresën nr.55/5 datë 26.04.2022, si dhe nëpërmjet postës elektronike në adresën h...i...@klsh.org.al datë 22.04.2022, nga z. E. M., znj. A. Zh., ekonomiste si dhe znj. M. S., inxhinierë ndërtimi, anëtare të njësies së prokurimit, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Gjithashtu “Mbi projektraportin e auditimit”, nga të njëjtët persona është paraqitur observacion, nëpërmjet postës elektronike në adresën h...i...@klsh.org.al datë 20.06.2022, protokolluar në KLSH me nr.55/9 prot, datë 06.06.2022, ku janë shprehur të njëjtat objeksione, si ato të bëra për përmbajtjen e akteve të konstatimit, si më poshtë vijon:

1-Prendim i subjektit: Në lidhje me kërkesën për paraqitjen e aktit të marrjes në dorëzim nuk është një kërkesë e tejkualuar por në përputhje me aftësitë teknike dhe profesionale të ofertuesve pasi në DST rezulton se për punët e ngjashme është kërkuar një periudhë 5-vjeçare që ofertuesit kanë realizuar. Kjo kërkesë është vendosur në bazë të nenit 77, pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5.

1-Qëndrim i grupit të auditimit: Kërkesa për paraqitjen e aktit të marrjes në dorëzim, është kërkesë e tejkualuar e VKM nr. 914, datë 29.12.2014, nenin 26 “Kontratat për punë publike” të VKM nr.914 dt. 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, pasi akti i marrjes në dorëzim bëhet për një periudhë kohore 1 – 2 vjeçare, duke tejkualuar në këtë mënyrë afatin tre vjeçar të periudhës së kërkuar. Gjithashtu në zbatim të nenit 26, pika 6 të

VKM nr.914, të ndryshuar, për këtë qëllim kundërshtia juaj për këtë çështje nuk merret në konsideratë.

2-Prendim i subjektit: Në lidhje me konstatimin me pikën 2.3.4 të DST që i përket fuqisë minimale punëtore të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, me një numër prej mesatarisht 45 punonjës. Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Mars 2021- Qershor 2021 sqarojmë se: Kjo kërkesë është vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Vendosja e këtij kriteri për fuqinë punëtore është bërë në përputhje me zerat dhe volumet e preventivit, me afatin e zbatimit të punimeve sipas grafikut të punimeve, që është perlllogaritur në një kohë të shkurtër i cili kërkon fuqi punëtore të shtuar dhe me mjetet e kërkuara për zbatimin me sukses të kësaj kontrate.

2-Qëndrim i grupit të auditimit: Në observacion, nuk keni dhënë argumente teknike që i përket fuqisë minimale punëtore të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, me një numër prej mesatarisht 45 punonjës. Ky kriter është i pa argumentuar dhe për këtë arsye kundërshtia juaj për këtë çështje nuk merret në konsideratë.

3-Prendim i subjektit: Në lidhje me konstatimet për mjetet pika 2.3.6 në DST sqarojmë se kjo kërkesë është vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e punonjësve dhe të mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë analizuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas zerave të preventivit dhe specifikimeve teknike të hartuara nga specialistet e fushës.

3-Qëndrim i grupit të auditimit: Ashtu si gjatë hartimit të kriterëve, edhe në këtë observacion ju nuk keni argumentuar teknikisht numrin e kërkuar të makinerive dhe pajisjeve, gjë e cila duhet të bëhet bazuar në maualet teknike, preventivin e punimeve, kohëzgjatjen e kontratës, orët e punës. Baza ligjore që ju të kërkonti makineri dhe pajisje ekziston, por cilën pajisje do kërkonti dhe në çfarë sasive, ka të bëjë me argumentim teknik, i cili nuk është bërë nga ana juaj. Observacioni për këtë çështje nuk merret në konsideratë.

Observacionet e paraqitura nga KVO

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të projektraportit të auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresën protokolluar në KLSH me nr.55/5 datë 26.04.2022, si dhe nëpërmjet postës elektronike në adresën elektronike h...i...@klsh.org.al dhe b...m...@klsh.org.al datë 22.04.2022, nga z. L. B., z. P. S., znj. E. M., anëtare të KVO.

Gjithashtu “Mbi projektraportin e auditimit”, nga të njëjtët persona është paraqitur observacion, nëpërmjet postës elektronike në adresën h...i...@klsh.org.al datë 20.06.2022, protokolluar në KLSH me nr.55/9 prot, datë 06.06.2022, ku janë shprehur të njëjtat objeksione, si ato të bëra për përmbajtjen e akteve të konstatimit, si më poshtë vijon:

1.Prendim i subjektit: Në lidhje me niptin sekondar të paregjëtruar të operatorit ekonomik sqarojmë se hapja/mbyllja e niptit sekondar është përgjegjësi e administratës tatimore dhe vjelja e detyrimit të taksave vendore është kompetencë e njësisë së vetëqeverisjes vendore bazuar në ligjin nr.139-2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”. Përsa më sipër komisioni i

vlerësimin të ofertave ka gjykuar dhe vlerësuar pagimin e taksave referuar nipteve sekondare të paraqitur në Ekstraktin historik të QKB për operatorin ekonomik.

2. Pretendim i subjektit: Në lidhje me konstatimin “Certifikatë e transportit për mjetin me targa AA 7...M” sqarohet se operatori ekonomik për mjetin me targa AA 7...M ka paraqitur kontratë noteriale me nr. 661 rep dhe 346 kol datë 19.02.2021 të lidhur me z. N. P., shoqëruar edhe me dokumentacionin ligjor të këtij mjeti, ku përfshihesh edhe certifikata e transportit sipas kërkesave të kërkuara në DST.

Në DST të kësaj procedure është kërkuar: Për mjetet e siguruara me qera, të vërtetohet me kontratën e qerave të noterizuar, e vlefshme periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Komisioni i vlerësimin të ofertave në momentin e shqyrtimit të ofertave është referuar tek kontrata e qirasë e cila është e vlefshme brenda periudhës së ekzekutimit të kontratës. Pra vërtetësia e aktin është konfirmuar nga noteri (noter- këshilltar ligjor për kryerjen e disa veprimeve juridike që me dispozita nuk u janë lënë organeve të tjera shtetërore). Për plotësimin e këtij kriteri nga NJHDT është kërkuar vetëm kontratë qiraje noteriale, document të cilën operatori ekonomik e ka paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik.

Gjithashtu sqarohet se komisioni i vlerësimin të ofertave në vlerësimin e kësaj pike është mbështetur në kontratën noteriale dhe se zbatimin për pajisjen me certifikatë në zbatim të ligjit nr. 8308 datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore” për transportin e mallrave nuk është kompetencë e organeve të vetëqeverisjes vendore por e institucioneve të tjera që i ngarkon ligji.

Oëndrim i grupit të auditimit: Ju nuk keni dhënë asnjë fakt apo prove të re për të kundërshtuar konstatimin e audituesit të çështjes. Në observacion thuhet se KVO është mbështetur në kontratën noteriale. Ju do të mbështeteni në dokumentacionin e dorëzuar nga OE, i cili do të krahasohet me dokumentacionin e kërkuar në DST. Observacioni për këtë çështje nuk merret në konsideratë.

11. Procedura e prokurimit me objekt “Blerje produkte ushqimore për kopshtet, çerdhet dhe konviktin”, zvilluar në vitin 2021.

1-Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: Blerje produkte ushqimore për kopshtet, çerdhet dhe konviktin.		
1. Urdhër Prokurimi: nr. 25 prot. datë 05.01.2021	3. Hartuesit e D. Tenderit: nr. 25 datë 05.01.2021	4. Komisioni i V. Ofertave: nr. 25/1, datë 05.01.2021
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “E hapur”	F. A. – Juriste A. Zh. – Ekonomiste R. Ç. – Sp. e fushës	L. B. – Kryetar P. S. – Anëtar E. M. – Anëtare
5. Fondi Limit (pa TVSh) 34,813,878 lekë	6. Oferta fituese (pa TVSh): 34,411,595 lekë (S... T... shpk)	7. Diferenca me fondin limit: (pa TVSh) 402,283 lekë
8. Data e hapjes së tenderit: 15.02.2021	9. Burimi Financimit Buxheti i bashkisë	10. Operatorët Ekonomikë: a) Pjesëmarrës në tender, 3 OE b) Kualifikuar 1 OE, c) S’kualifikuar 2 OE
11. Ankimime AK – s’ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK – s’ka	13. Përgjigje Ankesës nga KKP

Me datë 05.01.2021, Titullari i Autoritetit Kontraktor, z. E. D., ka nxjerrë urdhërin nr. 25 prot., për prokurimin me objekt “Blerje produkte ushqimore për kopshtet, çerdhet dhe konviktin”, fond i cili është vënë në dispozicion nga buxheti i bashkisë. Fondi limit është 34,813,878 lekë pa TVSH.

Me shtojcën nr. 25/4 prot., datë 18.01.2021, pas rekomandimeve të APP, janë bërë modifikimet si më poshtë vijon:

Ishte	Bëhet
<p>2.1 Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë: Licence të leshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit, Kodi II.1.A(1) Prodhim, perpunim shperndarje me shumice e ushqimeve per njerez. Liçencë të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Liçensimit, Kodi II.1.B, Shitje me shumice e ushqimeve me origjine shtazore (per njerez). Licence të leshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit Kodi II.1.C “Prodhimi primar me shumicë”.</p>	<p>2.1 Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë: Licence të leshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit, Kodi II.1.A(1) Prodhim, perpunim shperndarje me shumice e ushqimeve per njerez. Liçencë të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Liçensimit, Kodi II.1.B, Shitje me shumice e ushqimeve me origjine shtazore (per njerez).</p>
<p>Magazine ushqimore dhe ambiente frigoriferike në pronësi të pajisur me license QKL kodin II.1.B, Leje mjedisore për magazinimin frigoriferik të produkteve ushqimore me kodin III.1.A, akt-miratim higjeno sanitar, certifikatën e dezinfektimit 3D si dhe foto të ambienteve të ushtrimit të aktivitetit ose në rastet e disponimit me kontrate qiraje ose marrëveshje bashkëpunimi duhet të paraqitet kontrata e qirasë noteriale/ marrëveshja e bashkëpunimit noteriale e cila të tregojë qarte lidhjen e zyrtarizuar midis ofertuesit dhe prodhuesit ku ky i fundit duhet të përmbajë të dhëna të plota si: telefon, email, website, etj, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi.</p> <p>Furre buke në pronësi të pajisur me leje higjeno sanitare, leje mjedisore e tipit C me kodin III.1.A, license QKL me kodin II.1.A.(1), si dhe certifikatën e dezinfektimit 3D si dhe raport analizen e ujit të rrjetit , ose në rastet e disponimit me kontrate qiraje ose marrëveshje bashkëpunimi duhet të paraqitet kontrata e qirasë noteriale ose marrëveshjes së bashkëpunimi noteriale e cila të tregojë qarte lidhjen e zyrtarizuar midis ofertuesit dhe prodhuesit ku ky i fundit duhet të përmbajë të dhëna të plota si: telefon, email, ëbsite, etj, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi.</p> <p>Njësi prodhimi bulmeti në pronësi të pajisur me: leje higjeno sanitare, Leje mjedisore me kodin III.1.B (për trajtimin dhe përpunimin e qumështit), License lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit (QKB) me kodin II.1.A.(1) dhe II.1.B; ose në rastet e disponimit me kontrate qiraje ose marrëveshje bashkëpunimi duhet të paraqitet kontrata e qirasë noteriale ose marrëveshjes së bashkëpunimi noteriale e cila të tregojë qarte lidhjen e zyrtarizuar midis ofertuesit dhe prodhuesit ku ky i fundit duhet të përmbajë të</p>	<p>Magazine ushqimore dhe ambiente frigoriferike në pronësi të pajisur me license QKL kodin II.1.B, akt-miratim higjeno sanitar, certifikatën e dezinfektimit 3D si dhe foto të ambienteve të ushtrimit të aktivitetit ose në rastet e disponimit me kontrate qiraje ose marrëveshje furnizimi duhet të paraqitet kontrata e qirasë noteriale/ marrëveshje e furnizimit noteriale e cila të tregojë qarte lidhjen e zyrtarizuar midis ofertuesit dhe prodhuesit.</p> <p>Furre buke në pronësi të pajisur me leje higjeno sanitare, license QKL me kodin II.1.A.(1), si dhe certifikatën e dezinfektimit 3D si dhe raport analizen e ujit të rrjetit , ose në rastet e disponimit me kontrate qiraje ose marrëveshje furnizimi duhet të paraqitet kontrata e qirase noteriale/ marrëveshja e furnizimit noteriale e cila të tregojë qarte lidhjen e zyrtarizuar midis ofertuesit dhe prodhuesit.</p> <p>Njësi prodhimi bulmeti në pronësi të pajisur me: leje higjeno sanitare, Leje mjedisore me kodin III.1.B (për trajtimin dhe përpunimin e qumështit), License lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit (QKB) me kodin II.1.A.(1) dhe II.1.B; ose në rastet e disponimit me kontrate qiraje ose marrëveshje furnizimi duhet të paraqitet kontrata e qirasë noteriale/ marrëveshja e furnizimit noteriale e cila të tregojë qarte lidhjen e zyrtarizuar midis ofertuesit dhe prodhuesit.</p> <p>Thertore në pronësi të pajisur me: leje higjeno sanitare, Leje mjedisore me kodin III.1.B (therje kafshësh), License lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit (QKL) me kodin II.1.A.(1) (thertore). Për thertoren të paraqitet vërtetimi nga AKU që thertorja është funksionale (në kuadër të nismave qeveritare në këtë fushë); ose në rastet e disponimit me kontrate qiraje ose marrëveshje bashkëpunimi duhet të paraqitet kontrata e qirasë noteriale ose marrëveshje furnizimi duhet të paraqitet kontrata e qirasë</p>

dhëna te plota si: telefon, email, ëbsite (nëse ka), etj, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi.

Thertore ne pronësi te pajisur me: leje higjeno sanitare, Leje mjedisore me kodin III.1.B (therje kafshësh), License lëshuar nga Qendra Kombetare e Licensimit (QKL) me kodin II.1.A.(1) (thertore). Për thertoren te paraqitet vërtetim nga AKU qe thertorja është funksionale (në kuadër te nismave qeveritare në këtë fushe); ose ne rastet e disponimit me kontrate qiraje ose marrëveshje bashkëpunimi duhet te paraqitet kontrata e qirasë noteriale ose marrëveshjes se ashkëpunimit noteriale e cila të tregojë qarte lidhjen e zyrtarizuar midis ofertuesit dhe prodhuesit ku ky i fundit duhet të përmbajë të dhëna të plota si: telefon, email, ëbsite (nëse ka), etj, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi.

Kompleks stallor ne pronësi te pajisur me certifikatë pronësie, Leje mjedisore me kodin III.1.B (mbarështim kafshësh), License lëshuar nga Qendra kombëtare e Licensimit (QKL) me kodin II.3.C; ose ne rastet e disponimit me kontrate qiraje ose marrëveshje bashkëpunimi duhet te paraqitet kontrata e qirasë noteriale ose marrëveshjes se bashkëpunimi noteriale e cila te tregojë qarte lidhjen e zyrtarizuar midis ofertuesit dhe prodhuesit ku ky i fundit duhet te përmbajë të dhëna te plota si: telefon, email, ëbsite (nëse ka), etj, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi.

Kompleks pularie në pronësi të pajisur me License lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit (QKL) me kodin II.1.A.1 (prodhim, ambalazhim, etiketim e shpërndarje me shumice e vezëve), Leje mjedisore me kodin III.1.B (rritje intensive e shpendëve). ose ne rastet e disponimit me kontrate qiraje ose marrëveshje bashkëpunimi duhet te paraqitet kontrata e qirasë noteriale ose marrëveshjes se bashkëpunimi noteriale e cila te tregojë qarte lidhjen e zyrtarizuar midis ofertuesit dhe prodhuesit ku ky i fundit duhet të përmbajë të dhëna te plota si: telefon, email, ëbsite (nëse ka), etj, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi.

Sere për prodhimin e perimeve të freskëta ne pronësi te pajisur me: Dokument pronësie te seres dhe License lëshuar nga Qendra kombëtare e Licensimit (QKB) me kodin II.1.C; ose ne rastet e deponimit me kontrate qiraje ose marrëveshje bashkëpunimi duhet te paraqitet kontrata e qirasë

noteriale/ marrëveshja e furnizimit noteriale e cila te tregojë qarte lidhjen e zyrtarizuar midis ofertuesit dhe prodhuesit.

Kompleks stallor ne pronësi te pajisur me certifikatë pronësie, Leje mjedisore me kodin III.1.B (mbarështim kafshësh), License lëshuar nga Qendra kombëtare e Licensimit (QKL) me kodin II.3.C; ose ne rastet e disponimit me kontrate qiraje ose marrëveshje bashkëpunimi duhet te paraqitet kontrata e qirasë noteriale ose marrëveshje furnizimi duhet te paraqitet kontrata e qirasë noteriale/ marrëveshja e furnizimit noteriale e cila te tregojë qarte lidhjen e zyrtarizuar midis ofertuesit dhe prodhuesit

Kompleks pularie ne pronësi te pajisur me License lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit (QKL) me kodin II.1.A.1 (prodhim, ambalazhim, etiketim e shpërndarje me shumice e vezëve), Leje mjedisore me kodin III.1.B (rritje intensive e shpendëve). ose ne rastet e disponimit me kontrate qiraje ose marrëveshje furnizimi duhet te paraqitet kontrata e qirasë noteriale/ marrëveshja se furnizimit noteriale e cila te tregojë qarte lidhjen e zyrtarizuar midis ofertuesit dhe prodhuesit.

Sere për prodhimin e perimeve te fresketa në pronësi të pajisur me: Dokument pronësie te seres dhe License lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit (QKB) me kodin II.1.C; ose ne rastet e disponimit me kontrate qiraje ose marrëveshje furnizimi duhet te paraqitet kontrata e qirasë noteriale/ marrëveshja se furnizimit noteriale e cila te tregojë qarte lidhjen e zyrtarizuar midis ofertuesit dhe prodhuesit.

noteriale ose marrëveshjes se bashkëpunimi noteriale e cila te tregojë qarte lidhjen e zyrtarizuar midis ofertuesit dhe prodhuesit ku ky i fundit duhet të përmbajë të dhëna te plota si: telefon, email, ëbsite (nëse ka), etj, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi.	
--	--

Dokumentet e tenderit janë hartuar me procesverbalin nr.25/3 prot., datë 06.01.2021.

Kërkesat e veçanta për kualifikim janë argumentuar nga ana e NJHDT dhe pas modifikimeve të bëra si më sipër nuk rezultuan kërkesa në kundërshtim me Ligjin e Prokurimit Publik dhe akte të tjera ligjore.

Tenderi është hapur me procesverbalin nr.25/5 prot., të datës 15.02.2021. Në të kanë marrë pjesë dhe janë vlerësuar nga KVO sa më poshtë vijon:

Nr	Operatori Ekonomik	Vlera e ofruar	Vlerësimi i KVO
1	S... T...	17,205,797 (për 1 vit)	Kualifikuar/Fitues
2	S...S...	21,536,150 (për 1 vit)	S’kualifikuar për mangësi në dokumentacion: ISO 22000:2005 Për sistemin e menaxhimit të sigurisë ushqimore, kjo ISO është shfuqizuar. Vërtetimi i OSHEE nr.158 prot, dt 12.02.2021 ka përfshirë dy kontrata për shlyerjen e detyrimeve ndërkohë ne ekstrktin e QKB figuron se subjekti ka me shumë se dy vende të ushtrimit të aktivitetit. Mungon vërtetimi nga AKU për thertoren. Për mjetet e paraqitura mungojnë çertifikatat e transportit. Mungon leja e drejtimit për një drejtues të mjetit.
3	G...	Nuk ka ofertë	S’kualifikuar pasi nuk ka paraqitur asnjë dokument në sistem.

Sipas raportit përmbledhës me nr. 25/8 datë 26.02.2021, rezulton se kanë marrë pjesë 3 operatorë ekonomikë. Janë s’kualifikuar 2 operatorë ekonomikë për mangësi në dokumentacion dhe është kualifikuar dhe shpallur fitues operatori ekonomik me vlerën më të ulët të ofertës.

Marrëveshja kuadër midis Autoritetit Kontraktor dhe operatorit ekonomik të shpallur fitues “S... T...” shpk, është lidhur me nr.1380/1 prot., datë 08.03.2021.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të OE “S... T...” shpk, i cili është shpallur fitues, arrihet në konkluzionin se ky operator i plotëson të gjitha kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të vendosura në DST dhe vendimi i KVO për shpalljen e tij fitues është i drejtë.

4.2. Mbi zbatimin i kontratave të punëve publike

Në zbatim të pikës 4.4 të Programit të Auditimit nr. 55/1, datë 18.01.2022, i ndryshuar, në Bashkinë Berat, nga ana e audituesve të KLSH-së, u analizua regjistri i investimeve të përfunduara në periudhën e auditimit. Nga kjo analizë, janë përzgjedhur për auditim objektet në bazë të vlerës së kontratës si më poshtë:

Nr	Objekti	Kontraktori	Vlera e kontratës (me TVSH)	Shënime
1	Ndërtim i linjës kryesore dhe shpërndarjes së furnizimit me ujë të Njësisë Administrative Velabisht	“E...A...” SHPK & “V...K...” SHPK & “L...” SHPK & “E...” SHPK	154,991,516	Audituar

2	Ndërtim rrjeti KUZ në fshatin Lapardha 1, Lapardha 2 dhe fshatin Drobonik	“M...” SHPK & “E...” SHPK	28,867,632	Audituar
3	Rruga e Inerteve	T... B...	21,486,309.5	Audituar, pa probleme.

I. “Ndërtim rrjeti KUZ në fshatin Lapardha 1, Lapardha 2 dhe fshatin Drobonik”, Bashkia Berat)

Kontratat

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës për punë publike me nr. 2047/1 prot datë 14.05.2019 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Berat, të përfaqësuar nga Titullari z. E. D. dhe Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë “M...” SHPK & “E...” SHPK, me përfaqësues z. M. M., me licencë profesionale NZ 0440/22. Vlera e kontratës është 28,867,632 lekë me TVSH, nga të cilat 8,564,584 lekë me TVSH do të financohen në vitin 2019. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 120 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës së mbikëqyrjes (30 ditë në vitin 2019).

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas aktit pa nr. prot, pa datë, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me OE “M...” SHPK me përfaqësues z. P. M., me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 3119/2 dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 692,823 lekë me tvsh.

Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 5086/1 prot., datë 21.10.2020, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me shoqërinë “C... G...” SHPK, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 2049/7, dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 85,713 lekë me TVSH. Vonesa në fillimin e procesit të kolaudimit (pothuajse 1 vit nga data e përfundimit të punimeve), është në kundërshtim me UKM Nr.3, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, kapitulli II, “Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, pika 2, sipas të cilës “Kolaudatori ose grupi i kolaudimit caktohet nga investitori, i cili duhet t’ia komunikojë, me shkrim, këtë person apo grup personash, Sekretariatit Teknik të KRRT-së, pranë zyrës dhe seksionit urbanistik përkatës në rreth, brenda 30 ditëve nga data e përfundimit të punimeve. Punëdhënësi duhet të përcaktojë, gjithashtu, në marrëveshje me mbikëqyrësin dhe kolaudatorin (ose grupin e kolaudimit), mënyrën dhe afatet e procesit të kolaudimit”. Ky veprim ngarkon me përgjegjësi titullatin e Bashkisë Berat, z. E. D.

Për marrjen e përkohshme në dorëzim të objektit, me Urdhërin nr. 838 datë 22.12.2020 të kryetarit të Bashkisë Berat, është ngritur grupi i punës me përbërje ing. znj. V. K., ing. z. A. Dh. dhe ark. z. G. Gj., të cilët kanë hartuar certifikatën e marrjes së përkohshme në dorëzim të objektit në datën 27.01.2021, ose më shumë se 7 muaj nga dalja e urdhërit.

Projektpreventivi

- Për këtë objekt, administrohet në dosje Leje Infrastrukturore, me nr. 2982, datë 20.06.2019.
- Projekti i zbatimit është hartuar për pjesë të ndryshme ing. z. V. D., “T...” SHPK dhe nga Drejtoria e Planifikimit Urban të Bashkisë Berat dhe është miratuar nga ish titullari i Bashkisë Berat, Z. P. S. me Vendimin nr. 57, datë 15.01.2018.

Zbatimi i punimeve

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet kanë nisur me datë 25.06.2019 dhe kanë përfunduar me datë 25.10.2019, ose brenda afatit kontraktual të përfundimit të punimeve, përfshirë amendamentin e kontratës.

-Me shkresën pa nr. prot, datë 26.06.2019, sipërmarrësi i punimeve ka relatuar për domosdoshmërinë e ndryshimeve në projektpreventivin fillestar. Pas shqyrtimit të këtij relacioni, Mbikëqyrësi i punimeve i ka dërguar investitorit Bashkia Berat kërkesën për miratimin e preventivit të ndryshuar (tabelës së balancimit të punimeve). Pas kësaj kërkesë, është hartuar dhe miratuar “Procesverbali mbi miratimin e tabelës së balancimit të volumit të

punimeve”, i nënshkruar edhe nga Kryetari i Bashkisë Berat, z. E. D. Janë miratuar ndryshimet në volume (shtesa/pakësime) në vlerën 3,565,960 lekë me TVSH.

Nga verifikimi në terren të objektit, rezulton se edhe pas ndryshimeve në projekt, gropa septike në fshatin Lapardha 1, me vlerë të situacionuar 913,030 lekë pa TVSH, nuk është në funksion, pasi është e veçuar dhe e pa lidhur me rrjetin e ndërtuar të KUZ, duke mos qenë në eficientë. Për pasojë vlera e nënobjektit prej 1,095,636 lekë me TVSH, përbën shpenzim jo eficient dhe jo efektiv të fondeve të Bashkisë Berat. Përsa sipër, ngarkohet me përgjegjësi Kryetari i Bashkisë Berat, z. E. D.

Titulli i Gjetjes 1:	Mosvënie në eficientë të një nënobjekti në objektin “Ndërtim rrjeti KUZ në fshatin Lapardha 1, Lapardha 2 dhe fshatin Drobonik”, Bashkia Berat.
Situata:	Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se gropa septike në fshatin Lapardha 1, e cila është ndërtuar me vlerë të situacionuar 913,030 lekë pa TVSH, është e veçuar dhe e pa lidhur me rrjetin e ndërtuar të KUZ, duke mos qenë në eficientë.
Kriteri:	Miratimi i ndryshimeve të projektpreventivit pa argument teknik, në kundërshtim me UKM Nr .2, datë 13.5.2005, “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” Kreu I, Pika 7, 7.1.
Ndikimi/Efekt:	Si pasojë e veprimeve të mësipërme, objekti nuk është në eficientë të plotë, duke shkaktuar përdorim jo sipas parimit të 3 E-ve të fondeve të Bashkisë Berat.
Shkaku:	Miratim i ndryshimeve të projektpreventivit pa argument teknik.
Rëndësia:	I lartë.
Rekomandime:	Kryetari i Bashkisë Berat, nëpërmjet stafit të inxhinierëve teknik, të marrë masa që në të ardhmen, të miratojë ndryshimet e projektpreventivit, vetëm në rast se ato janë të argumentuara teknikut, në mënyrë që të mos ndryshojnë në thelb kushtet kryesore të projektit, si dhe të përmirësojnë treguesit e veprës, duke i bërë ato sa më eficiente.

- Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Projekt i zbatimit, preventivi bazë dhe i ndryshuar,
2. Situacionet pjesore dhe Situacioni përfundimtar,
3. Libreza e masave,
4. Ditarit të punimeve, etj.

Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Ndërtim rrjeti KUZ në fshatin Lapardha 1, Lapardha 2 dhe fshatin Drobonik”, Bashkia Berat				
14.Lidhja e kontratës Nr. 2047/1 prot datë 14.05.2019	15.Vlera e kontratës (me tvsh) 28,867,632 lekë BOE fitues “M...” SHPK & “E...” SHPK		16.Likuiduar deri dt	
17- Situacioni Përfundimtar -Vlera me tvsh 28,801,680 lekë -Vlera pa tvsh 24,001,400 lekë	18.Afati i kontratës në dite Parashikuar 120 ditë , Zbatuar 120 ditë. Fillimi punimeve: 25.06.2019 Përfundimi punimeve : 25.10.2020		19. Zgjatja e kontratës Nuk ka	
20. Mbikëqyrësi i punimeve OE “M...” SHPK	Licenca Nr: MK 3119/2	Kontrata pa nr. prot, pa datë	Likuiduar lekë	Pa likuiduar
21. Kolaudatori i punimeve OE “C... G...” SHPK	Licenca Nr: MK 2049/7	Kontrata nr. 5086/1 prot., datë 21.10.2020	Likuiduar (.....lekë)	Pa likuiduar (..... lekë)
22.Akt Kolaudimi Datë 27.10.2020	23.Akt i marrjes në dorëzim dt 23.11.2020		24. Fletë Hyrja Nr.... datëlekë (për mallrat)	

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës

të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **1,245,690 lekë pa tvsh**.

Titulli i Gjetjes 1:	Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin “Ndërtim rrjeti KUZ në fshatin Lapardha 1, Lapardha 2 dhe fshatin Drobonik”, Bashkia Berat, nga zbatuesi i punimeve BOE “M...” SHPK & “E...” SHPK, për zërat e punimeve I.1.1, I.1.2, I.1.12, I.2.2, I.3.2, I.5.8, II.1.1, II.1.2 dhe III.4.
Situata:	Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se: -Ka patur diferenca në volume dhe çmime në zërat e punës “Gërmim dheu për kanal kat IV”, “Gërmim dheu tokë e forte për puseta dhe gropë septike”, “Shtresë çakulli (zhavorr) 15 cm”, “Beton C 16/20 për muret t=20 cm”, “Shtresë rëre natyrore mbi tubo t=20 cm”, për pasojë vlera e këtyre diferencave janë përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.
Kriteri:	Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projektpreventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me: - Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12. - Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3. - Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 2047/1 prot datë 14.05.2019. - Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit pa nr. prot, pa datë. - Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve, sipas aktit me nr. 5086/1 prot., datë 21.10.2020.
Ndikimi/Efekti:	Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Berat.
Shkaku:	Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit dhe kolaudatorit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projektpreventivit.
Rëndësia:	I lartë.
Rekomandime:	Nga Bashkia Berat të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 1,245,690 lekë pa tvsh nga BOE “M...” SHPK & “E...” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 2047/1 prot datë 14.05.2019 me objekt “Ndërtim rrjeti KUZ në fshatin Lapardha 1, Lapardha 2 dhe fshatin Drobonik”, <i>Bashkia Berat</i> , vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

Në mënyrë të përmbledhur për këtë investim rezultoi se **i janë likuiduar tepër në vlerën 1,245,690 lekë pa tvsh** sipërmarrësit të punimeve për punime të pakryera, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore.

Lidhur me objektin e mësipërm, me shkresën e protokolluar në KLSH me nr. 55/11 prot, datë 14.06.2022, është observuar nga sipërmarrësi i punimeve, si më poshtë:
Pretendimi i subjektit:
1. Volume Gërmimesh
Këto diferenca, sipas grupit të auditimit, vijnë nga kontrolli i librit të masave me sasi të e

raportuara në situacion. Për këtë zë punimesh nuk është bërë kontroll fizik në objekt por theksohet se thellësia mesatare është rreth 1.2 m. Në të gjitha profilet e projektit të firmosur dhe vulosur nga Bashkia Berat dhe që është zbatuar, thellësia është mbi 1.5 m mesatarisht. Punimet e gërmimit janë sipas profilit të projektit dhe sipas librit të masave.

Opinion i grupit të auditimit:

Grupi i auditimit ka dalë në konkluzionin e cituar, pasi ka bërë verifikimin e librit të masave dhe projektit të azhurnuar (profilin gjatësor), ku mesatarja e lartësisë së gërmimit është rreth 1.22 m, ose sipërfaqja mesatare 1 m^2 . Përsa sipër, ky pretendim nuk merret në konsideratë.

Pretendimi i subjektit:

2. Shtresë Cakulli

Në observacionin e parë kemi sqaruar me hollësi që vepra e pastrimit në Fshatin Lapardha Nr. 2, nuk ka qenë në projektin që na u dha për zbatim. Kjo vepër është dhënë shumë më vonë dhe u hap rrugë e re dhe është fakt që është shtruar më çakull, mbasi nuk ishte I mundur ndërtimi në vendin që na u dorëzua nga investitori dy muaj pasi kishim filluar kontratën.

Opinion i grupit të auditimit:

Grupi i auditimit ka dalë në konkluzionin e cituar, pasi ka bërë verifikimin e librit të masave dhe projektit të azhurnuar dhe ka nxjerr si diferencë volumi vetëm volumin e llogaritur për gjatësinë e kanalit nga pik 53 – pik 48/2. Kjo nuk ka lidhje me rrugën e bërë për tek vepra e pastrimit, por me një lapsus të bërë në librin e masave për distancën ndërmjet këtyre piketave, e cila është marrë 452.6 ml nga 150.5 ml, që është sipas projektit të azhurnuar dhe miratuar. Pjesa tjetër e librit të masave është konsideruar e mirëqenë. Përsa sipër, ky pretendim nuk merret në konsideratë.

Pretendimi i subjektit:

3. Betone

Jemi mirënjohës që pranoni sugjerimin tonë për këtë zë pune, por do dedeshëm që të na kompesoni për sasinë reale për diferencë mbi $15 \text{ m}^3 \times 9000 = 135,000$ lekë për të dy veprat e pastrimit. Për sasinë faktike dhe jo për atë që kemi raportuar në dëm te vehtes tonë.

Opinion i grupit të auditimit:

Grupi i auditimit, pas shqyrtimit të observacionit, sqaron se nuk është në tagrin tonë tju certifikojmë punimet e kryera nga ana jonë (është mbikëqyrësi dhe më pas investitori që certifikojnë punën e paraqitur nga ana e sipërmarrësit), por të rekomandojmë masa për shkeljet e gjetura gjatë zbatimit të punimeve. Por mbështetur edhe në observacionin tuaj mbi aktkonstatimin, volumi i pretenduar si më tepër, nuk është kaq sa keni cituar në observacion. Përsa sipër, ky pretendim nuk merret në konsideratë.

Pretendimi i subjektit:

4. Përsa i përket zërit shtresë rere, e kemi pranuar që herën e parë për sasinë që ju zbrisni.

Opinion i grupit të auditimit:

Grupi i auditimit i qëndron gjetjes së konstatuar.

II. “Ndërtim i linjës kryesore dhe shpërndarjes së furnizimit me ujë të Njësisë Administrative Velabisht”, Bashkia Berat

Kontratat

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës për punë publike me nr. 2134/6 prot datë 29.06.2020 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Berat, të përfaqësuar nga Titullari z. E. D. dhe Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë “E...A...” SHPK & “V... K...” SHPK & “Ll...” SHPK & “E...” SHPK, me përfaqësues z. B. M., me licencë profesionale NZ 3279/15.

Vlera e kontratës është 154,991,516 lekë me TVSH, financim i vitit 2020-2021-2022. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 120 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës së mbikëqyrjes. Janë hartuar Amendamentet me nr. 3077/6 prot., datë 07.07.2020 dhe nr. 3665/2 prot., datë 01.09.2020, pa datë të përcaktuar për shtyrjen e afatit të punimeve, me arsyen që është bërë ndryshim rrënjësor i projektit.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 3077/3 prot., datë 06.07.2020, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me OE "G... E..." SHPK me përfaqësues G. B., me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 2812/3 dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 2,460,644 lekë me tvsh.

Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 3097/1 prot., datë 14.06.2021, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me shoqërinë "F... S..." SHPK, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 3429, dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 216,213 lekë me TVSH. Vonesa në fillimin e procesit të kolaudimit (rreth 100 ditë nga data e përfundimit të punimeve), është në kundërshtim me UKM Nr.3, datë 15.2.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar, kapitulli II, "Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit", pika 2, sipas të cilës "Kolaudatori ose grupi i kolaudimit caktohet nga investitori, i cili duhet t'ia komunikojë, me shkrim, këtë person apo grup personash, Sekretariatit Teknik të KRRT-së, pranë zyrës dhe seksionit urbanistik përkatës në rreth, brenda 30 ditëve nga data e përfundimit të punimeve. Punëdhënësi duhet të përcaktojë, gjithashtu, në marrëveshje me mbikëqyrësin dhe kolaudatorin (ose grupin e kolaudimit), mënyrën dhe afatet e procesit të kolaudimit". Ky veprim ngarkon me përgjegjësi titullarin e Bashkisë Berat, z. E. D.

Në dosje nuk administrohet asnjë dokumentacion për marrjen e përkohshme në dorëzim të objektit. Ky veprim është në kundërshtim me UKM Nr .2, datë 13.5.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit", kreu II, pika 10.2, sipas të cilës "...Sipërmarrës i është përgjegjës për drejtimin, mbajtjen në gatishmëri, riparimin, mirëmbajtjen, ruajtjen e punimeve të ndërtim-montimit të objektit e të kantierit, deri në nënshkrimin e procesverbalit të kolaudimit. Objekti merret në dorëzim në datën e nënshkrimit të procesverbalit të kolaudimit". Përsa sipër, ngarkohet me përgjegjësi Kryetari i Bashkisë Berat z. E.

Projektpreventivi

- Për këtë objekt, administrohet në dosje Leje Infrastrukurore, me nr. 9, datë 08.01.2021.

Në dosje nuk administrohet Oponenca teknike e objektit, në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar me Ligjin nr. 3/2020, neni 3, sipas të cilit "Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve do të kryhet nga institutet shtetërore ose ente të tjera, të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimeve, për të gjitha:

a) ndërtimet publike;

b) ndërtimet jopublike, me vlerë të preventuar, së paku, 100 milionë lekë;

c) objektet me akses publik"

Për veprimin e mësipërm ngarkohet me përgjegjësi Autoritetin Kontraktor.

- Projekti i zbatimit është hartuar nga Bashkia Berat nga grupi i projektimit i përbërë prej ing. Hidro znj. D. T., Ing. znj. A. K., ing. z. F. T., Ing. z. G. S., ing. z. S.Dh. dhe ing. Gjeodet z. A. Dh. Projekti i administruar në dosjen teknike nuk është i nënshkruar nga grupi i projektimit dhe është i miratuar nga titullari i Bashkisë Berat, z. E. D.

Zbatimi i punimeve

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se pas disa shtyrjesh për fillimin e punimeve, ato kanë nisur me datë 02.11.2020 dhe kanë përfunduar me datë 02.03.2021, ose brenda afatit kontraktual të përfundimit të punimeve, përfshirë amendamentin e kontratës.

- Me procesverbalin pa datë të saktë, të vitit 2020, është bërë ndërprerja e punimeve për shkak të ndryshimit të pikës së lidhjes së rrjetit të ujësjellësit, i propozuar nga sipërmarrësi, me qëllim kalimin nga furnizimi me ngritje mekanike në furnizim me rrjedhje të lirë.

-Me shkresën pa nr. prot, pa datë, sipërmarrësi i punimeve ka relatuar për domosdoshmërinë e ndryshimeve në projektpreventivin fillestar. Pas shqyrtimit të këtij relacioni, Mbikëqyrësi i punimeve i ka dërguar investitorit Bashkia Berat kërkesën për miratimin e preventivit të ndryshuar (tabelës së balancimit të punimeve). Pas kësaj kërkesë, është hartuar dhe miratuar “Procesverbali mbi miratimin e tabelës së balancimit të volumit të punimeve”, i nënshkruar edhe nga Kryetari i Bashkisë Berat, z. E. D. Janë miratuar ndryshimet në volume (shtesa/pakësime) në vlerën 139,591,297.81 lekë me TVSH, ose 90% e vlerës totale. Nuk ka asnjë dokument (relacion teknik) me llogaritjet për ndryshimet e dimensioneve dhe llojeve të tubacionit. Në dosje nuk ka asnjë korrespondencë ndërmjet palëve të nënshkrimit të ndryshimeve dhe grupit të projektimit. Ndryshimi pothuajse total i projektit, mbart riskun që projekti i miratuar dhe i tenderuar për ndërtimin e ujësjellësit mund të ketë patur mangësi teknike, por mund të ketë ndikuar edhe në pjesëmarrjen në procedurën e prokurimit të këtij objekti.

Në dosje administrohen analizat e çmimeve të zërave të rinj të punimeve, të cilat janë të panënshkruara dhe për të cilat nuk ka asnjë shkresë për ngritjen e grupit të punës për negociimin e çmimeve, para miratimit të ndryshimeve të kryera në objekt. Nga auditimi i disa analizave të çmimeve, konstatohet se çmimet dhe sasi të për elementët e kostos (punëtori, transport, makineri, material) nuk janë të argumentuara. Nuk është e argumentuar teknikisht vendosja në analizën e zërit “Ndërtim pusete tip 1”, e 2 nënzërave “FV pjesë çmontuese DN 200 mm, Pn 16 Bar” dhe “FV pjesë çmontuese DN 200 mm, Pn 16 Bar” me çmime respektive 32,330 lekë/copë dhe 8494 leke/copë, të cilat për 11 puseta e situacionuara kapin vlerën 449,064 lekë pa TVSH. Nuk është argumentuar teknikisht sasia e paparashikuar në preventivin fillestar dhe e situacionuar e zërit “FV tuba gize” prej 1850 kg, me vlerë 1,171,050 lekë me TVSH.

Këto veprime janë në kundërshtim me UKM Nr .2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, kreu ii “Zbatim i punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, pika 8.3, sipas të cilës “Çmimet jashtë kontratës caktohen sipas analizave teknike në fuqi, me vlerën ekonomike më të mirë” dhe ngarkon me përgjegjësi mbikëqyrësin e punimeve dhe titullarin e Bashkisë Berat.

Nga verifikimi në terren të objektit, rezulton se tubacioni i situacionuar me DN 200 mm dhe t= 14.7 mm me vlerë të situacionuar 31,350,000 lekë, është vendosur jo sipas preventivit të ripunuar, por me t=11.9 mm. Gjithashtu edhe tubacioni i situacionuar me DN 63 mm dhe t= 4.7 mm me vlerë të situacionuar 5,348,392 lekë, është vendosur jo sipas preventivit të ripunuar, por me t=4 mm. Nga sa sipër, **vlera e tyre prej 36,698,392 lekë me TVSH, përbën shpenzim jo me efektivitet të fondeve të Bashkisë Berat dhe ngarkon me përgjegjësi sipërmarrësin dhe mbikëqyrësin e punimeve.**

Gjithashtu, edhe pas rreth 8 muajve nga kolaudimi i objektit, ky objekt nuk e kryen funksionin për të cilën është planifikuar të kryhej ky investim, furnizimin me ujë të komunitetit. Nga sa më sipër, ndryshimet e projektit kanë sjellë mosfunksionimin e objektit dhe për pasojë përdorimin pa efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike të Bashkisë Berat prej 154,991,516 lekë me TVSH.

Përsa sipër, ngarkohet me përgjegjësi Kryetari i Bashkisë Berat, z. E. D.

Titulli i Gjetjes 1:

Mosvënie në efikasitet të objektit “Ndërtim i linjës kryesore dhe shpërndarjes së furnizimit me ujë të Njësisë Administrative Velabisht”, Bashkia Berat.

Situata:	Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se ky objekt me vlerë të situacionuar 154,991,516 lekë me TVSH, nuk e kryen funksionin për të cilën është planifikuar të kryhej ky investim, furnizimin me ujë të komunitetit.
Kriteri:	Miratimi i ndryshimeve të projektpreventivit pa argument teknik, në kundërshtim me UKM Nr .2, datë 13.5.2005, “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” Kreu I, Pika 7, 7.1.
Ndikimi/Efekti:	Si pasojë e veprimeve të mësipërme, objekti nuk është në efikasitet të plotë, duke shkaktuar përdorim jo sipas parimit të 3 E-ve të fondeve të Bashkisë Berat.
Shkaku:	Miratim i ndryshimeve të projektpreventivit pa argument teknik.
Rëndësia:	I lartë.
Rekomandime:	Kryetari i Bashkisë Berat, nëpërmjet stafit të inxhinierik, të marrë masa që në të ardhmen, të miratojë ndryshimet e projektpreventivit, vetëm në rast se ato janë të argumentuara teknikisht, në mënyrë që të mos ndryshojnë në thelb kushtet kryesore të projektit, të përmirësojnë treguesit e veprës, duke i bërë ato sa më eficiente, për t’i shërbyer komunitetit në kohë.

- Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Projekt i zbatimit, preventivi bazë dhe i ndryshuar,
2. Situacionet pjesore dhe Situacioni përfundimtar,
3. Libreza e masave,
4. Ditarit të punimeve, etj.

Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Ndërtim i linjës kryesore dhe shpërndarjes së furnizimit me ujë të Njësisë Administrative Velabisht”, Bashkia Berat				
14.Lidhja e kontratës Nr. 2134/6 prot datë 29.06.2020	15.Vlera e kontratës (me tvsh) 154,991,516 lekë BOE fitues “E...A...” SHPK & “V... K...” SHPK & “L...” SHPK & “E...” SHPK		16.Likuiduar deri dt 81,414,368 lekë me TVSH	
17- Situacioni Përfundimtar -Vlera me tvsh 154,991,516 lekë -Vlera pa tvsh 129,159,596 lekë	18.Afati i kontratës në dite Parashikuar 120 ditë , Zbatuar 120 ditë. Fillimi punimeve: 03.11.2020 Përfundimi punimeve : 02.03.2021		19. Zgjatja e kontratës Amendamentet janë me nr. 3077/6 prot, datë 07.07.2020 dhe 3665/2 prot., datë 01.09.2020, pa shtyrje të përcaktuar të afatit të punimeve	
20. Mbikëqyrësi i punimeve OE “G... E...” SHPK	Licenca Nr: MK 3119/2	Kontrata me nr. 3077/3 prot, datë 06.07.2020	Likuiduar lekë	Pa likuiduar
21. Kolaudatori i punimeve OE “F... S...” SHPK	Licenca Nr: MK 3429	Kontrata nr. 3097/1 prot., datë 14.06.2021	Likuiduar (.....lekë)	Pa likuiduar (..... lekë)
22.Akt Kolaudimi Datë 16.08.2021	23.Akt i marrjes në dorëzim Nuk ka		24. Fletë Hyrja Nr.... datëlekë (për mallrat)	

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **863,960 lekë pa tvsh.**

Titulli i Gjetjes 2:	Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin “Ndërtim i linjës kryesore dhe shpërndarjes së furnizimit me ujë të Njësisë Administrative Velabisht”, Bashkia Berat, nga zbatuesi i punimeve BOE “E...A...” SHPK & “V... K...” SHPK & “L...” SHPK & “E...” SHPK, për zërat e punimeve I.1, I.10,
-----------------------------	--

	I.13, I. 14, II.1.7+8 dhe II.3.5.
Situata:	Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se: -Ka patur diferenca në volume dhe çmime në zërat e punës “Gërmim dheu kanalesh në tokë të fortë me krahë me seksion 0.75 m ² ”, “Shtresë betoni C 12/15, t=10 cm”, “Shtresë rëre natyrore 20 cm”, “Mbushje kanali me zhavorr lumi”, “Shtresë stabilizanti 10 cm”, etj., për pasojë vlera e këtyre diferencave janë përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.
Kriteri:	Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projektpreventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me: - Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12. - Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3. - Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 2134/6 prot datë 29.06.2020. - Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 3077/3 prot, datë 06.07.2020. - Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve, sipas aktit me nr. 3097/1 prot., datë 14.06.2021.
Ndikimi/Efekti:	Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Berat.
Shkaku:	Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit dhe kolaudatorit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projektpreventivit.
Rëndësia:	I lartë.
Rekomandime:	Nga Bashkia Berat të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 863,960 lekë pa tvsh nga BOE “E...A...” SHPK & “V... K...” SHPK & “L...” SHPK & “E...” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 2047/1 prot datë 14.05.2019 me objekt “Ndërtim i linjës kryesore dhe shpërndarjes së furnizimit me ujë të Njësisë Administrative Velabisht”, <i>Bashkia Berat</i> , vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

Në mënyrë të përmblodhur për këtë investim rezultoi se **i janë likuiduar tepër në vlerën 863,960 lekë pa tvsh** sipërmarrësit të punimeve për punime të pakryera, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Z. G. B. me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;
2. Z. S. B. me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara;

Lidhur me objektin e mësipërm, me shkresën me nr extra, datë 08.06.2022, e protokolluar në KLSH me nr. 55/10 prot, datë 10.06.2022, është observuar nga mbikëqyrësi i punimeve z. G. B.

Pretendimi i subjektit:

1. Në lidhje me zerin e punes “Shtresë betoni C12/15 t=10cm Ashtu sikundër keni verifikuar edhe ju në dokumentet e dosjes së praktikës librezat e masave janë në përputhje me sasinë 184 m³ të hartuar në situacionin përfundimtar. Mosdakortësimi juaj vjen për faktin se ju në një vizitë të limituar kohore disaorëshë, i keni kërkuar, ndër

shumë çështje të tjera, t'ju demostojë dhe këtë rast. Mqs përgjigjja e inxhinierit mbikëqyrës nuk ju ka karijuar bindjen e plotë, po ju vemë në dispozicion një album më të plotë të fotove të punimeve të kryera për këtë zë pune, të shoqëruar edhe me akset e linjave ku është realizuar ky proces pune, me shpresën se do t'jua krijojë bindjen që kjo punë është realizuar. Po kështu, po ju saktësojmë se veshja me beton nuk është kryer vetëm në siërfaqe te rregullta, pasi i tillë është edhe konturi që është riaftësuar pas vendosjes së tubit. Po kështu në aksin e linjës së dërgimit DN2000, Pk 80-Pk125, për shkak të vendosjes së linjës elektrike 20 kv në trasenë ku do të shtrihet linja e ujësjellësit, u zhvendos gjurma e shtrimit të linjës, duke prekur kuletën e rrugës dhe më pas ribërë me beton për ta jellë në gjendjen fillestare (referojuni fotove).

Opinioni i grupit të auditimit:


Grupi i auditimit, pas shqyrtimit të dokumentacionit shoqërues (fotot), merr në konsideratë argumentet dhe do ti reflektojë në tabelën e diferencës së volumeve.

Pretendimi i subjektit:

3. Në lidhje me zërin e punes “Shtrese stabilizanti 10 cm”, ashtu siç e keni përcaktuar edhe ju, ky zë punimesh nuk ka qenë i parshikuar në preventivin fillestar, pasi ka shërbyer si plotësues për ndërtimin e rrugës provizore që të mundësonte ndërtimin e depos 500 m³. Kjo rrugë është me pjerrësi të madhe dhe që pas ndërtimit të depos, nuk ka patur kush detyrimin për ta mirëmbajtur dhe kuptohet që pas dy sezone shirash nga ndërtimi i rrugës e deri në momentin e auditit, nuk kishte se si stabilizanti të qëndronte në vend, pasi rruga nuk ishte e shtruar me binder e asfalt. Për tju bindur për këtë, ne po ju vemë në dispozicion krahas librezave edhe një album me foto për tju qartësuar sesi ka qenë rruga para dhe pas ndërhyrjes dhe përdorimit të çakullit dhe stabilizantit në këtë aks.

Opinioni i grupit të auditimit:

Grupi i auditimit pas shqyrtimit të observacionit dhe dokumentacionit bashkëlidhur, sqaron se në vizitën në vend në prani të inxhinierit mbikëqyrës, nuk kishte asnjë gjurmë të materialit stabilizant, i librezuar dhe situacionuar si shtresë me t=10 cm, por vetëm të shtresës së çakullit (bazuar në granulometrinë e materialit ekzistues), të cilën e kemi konsideruar të mirëqenë. Përsa sipër, ky pretendim nuk merret në konsideratë. Më poshtë është fotoja e bërë në objekt.



Pretendimi i subjektit:

5. Nga verifikimi i librit të masave, rezulton se volumi i zërit: Mbushje kanali me zhavorr lumi del si shumë e tre volumeve (dhe jo e dy volumeve) dhe shuma totale është 11075.3 m³, i njëjtë me volumin e situacionuar:

Volumi 1 = 945 m³, faqe 453-459

Volumi 2 = 2529.9 m³, faqe 460-473

Volumi 3 = 7600.4 m³, faqe 474-478

Theksojmë se faqja 455 e librezës është e njëjtë me faqen 454 (është printuar 2 herë) por nuk është përlogaritur si volum (shuma 1-6 = 945 m³, faqe 459)

Bashkëlidhur fotokopje e librezës së masave.

Qëndrim i grupit të auditimit:

Grupi i auditimit, pas shqyrtimit të observacionit, merr në konsideratë argumentet dhe do ti reflektojë në tabelën e diferencës së volumeve.

5. Mbi planifikimin dhe zhvillimin e territorit

1- Auditimi mbi shqyrtimin e kërkesave në zbatimin e procedurave ligjore në marrjen e vendimeve për leje zhvillimore ndërtimi në pronë private dhe publike.

Zyra e Planifikimit të Territorit në Bashkinë Berat ka ushtruar funksionet dhe detyrat e saj bazuar në ligjin nr. 107/2014 datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar si dhe V.K.M.-së nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, të ndryshuar me V.K.M.-në nr. 271 datë 06.04.2016 “Për një ndryshim në V.K.M.-në nr. 408 datë 13.05.2015”.

Bazuar në sa më sipër, gjatë vitit 2020 dhe 2021 janë miratuar 16 Vendime për Leje Ndërtimi të Ri nga të cilat 2 Leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe me të madhe se 250 m² dhe 14 Leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe deri në 250 m², gjatë vitit 2020 deri 2021, të cilat në mënyrë të përmbledhur janë paraqitur në aneksin nr.1 pika 5 bashkëlidhur projekt raportit të auditimit.

Leje të ndërtimit për ndërtim të ri, me sipërfaqe më të madhe se 250 m² për vitin 2020-2021

Nga dokumentacioni i sipër cituar rezulton se për periudhën objekt auditimi Janar 2020 – Dhjetor 2021 janë miratuar gjithsej 2 leje e ndërtimit me sipërfaqe më të madhe se >250 m², të cilat u audituan të teta, nga ku rezultuan me problem 2 leje e ndërtimit me sipërfaqe më të madhe se >250 m², Në mënyrë të detajuar paraqiten lejet si vijon:

VITI 2020

1. Çështja me nr.4689 prot. datë 07.10.2020, sipas aplikimit në sistemin e_leje.

Objekti: “Godine Banimi dhe Shërbimi 1,4 dhe 8 kate dhe 1 kate Parkimi Nëntokë ” në Lagjen “Donika Kastrioti”, Bashkia Berat.

Leje Zhvillimi: Vendim nr. 701 i Kryetarit të Bashkisë Berat me zhvillues “z. A. D.” Nr. pasurie 19/98, ZK 8503, me sipërfaqe 1054 m², prej të cilës 1054 m² truall, Nr. pasurie 19/156, ZK 8503, me sipërfaqe 387 m², prej të cilës 387 m² truall, sipas kontratës së sipërmarrjes nr. 1129 Rep., 445 Kol., date 19.09.2020.

Leje ndërtimi : Vendim Nr. 809, datë 27.11.2020 të Kryetarit të Bashkisë Berat

Me zhvillues: “z. A. D.”

Të dhëna për pasurinë:

Pasuria me kontratën sipërmarrjes nr. 1129 Rep., 445 Kol., date 19.09.2020 me nr. pasurie 19/98, ZK 8503, me sipërfaqe 1054 m², prej të cilës 1054 m² truall, ne pronësi të z. A. D. dhe nr. pasurie 19/156, ZK 8503, me sipërfaqe 387 m², prej të cilës 387 m² truall ne pronësi të z. R. B., zhvillues z. A. D.

Të dhëna mbi objektin e miratuar

Njësia Strukturore: c.2.2a/4

Përcaktimet sipas. C.2.2a/4	Projekt -propozimi
	1441 m2 truall
Përdorimi i lejuar : Banim	Banim +Shërbim
Sipërfaqja maksimale për ndërtim : 50%	720 m2
K.sh.t max = 50%	49.9 %
Imax = Sipas PDV për njësinë strukturore c.2.2a/4	
H max = 26 m	8 kate/ 26 m2

- **Lartësia e objektit.**

Objekti është me 1 kate nëntoke me një sipërfaqe prej 1034 m² është destinuar për parkim., dhe Njësitë e shërbimit kanë një sipërfaqe prej 720 m² të vendosura në katin përdhe. Sipërfaqja e katit tip të banimit është 720 m² nga kati i parë deri në katin e trete. Në katin e katërt objekti është tërhequr 3.75m dhe 3.55m për arsye të respektimit të distancave të përcaktuara në PDV. Në një kat ka shtatë apartamente dhe pesë apartament. Tipologjia e apartamenteve është 3+1,2+1 dhe 1+1. Në organizimin e apartamenteve parësore ka qenë zgjidhja funksionale, konceptimi i apartamenteve me hapësira optimale si ndarjet zonale brenda tyre.

- **Mënyra e llogaritja e taksës së ndikimit në infrastrukturë.**

Llogaritja e taksës së ndikimit në infrastrukturë për objektin e mësipërm është bërë sipas Udhëzimit nr. 3, date 28.12.2016 “Për llogaritjen e kostos mesatare të ndërtimit sipas Entit Kombëtar”, dhe sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 60, date 18.12.2019 “Për sistemimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Berat”.

Llogaritjes se koston së ndërtimit të banesave nga Enti kombëtar i banesave për vitin 2020:

Kosto mesatare e ndërtimit çmimit të shitjes/m²: 41 400 leke/m²

Sipërfaqe e ndërtimit kati nën tokë: 1034 m²

sipërfaqe e ndërtimit kati përdhe: 720 m²

Sipërfaqe banimi: 4461 m²

Në rastin e ndërtimeve të destinuara për qëllime banimi apo për njësi tregtimi dhe shërbimi, të cilat kryhen nga shoqëri ndërtimi

a. Me destinacion banim	5 % e çmimit të shitjes për m2
b. Me destinacion grazhd	5 % e çmimit të shitjes për m2
c. Me destinacion njësi shërbimi (lokale, dyqane etj...)	6 % e çmimit të shitjes për m2

Sipërfaqe Banimi 4461m² x 41400 leke/m² x 5% = 9,234,270 lekë.

Sipërfaqe Shërbimi 720 m² x 41400 leke/m² x 1.5% x 6% = 2,682,720 leke.

Sipërfaqe Garazhi 1034 m² x 41400 leke/m² x 0.7% x 5% = 1,498,266 leke.

Fasada :3642 m² x 30 lekë/m² = 109,260 leke.

Referuar akt marrëveshjes me nr. 1955 repertori dhe nr.892 koleksioni e datës 26.11.2020 e nënshkruar midis shoqërisë A... C... 2...6 dhe Bashkisë Berat nga Kryetari i Bashkisë Berat z. E. D. kanë rënë dakord që në zbatim të ligjit 22/2018 “Për strehimin social” detyrimin prej 3% sipas nenit 19 ta konvertojnë në lekë sipas çmimit të referencës së sitjes për zonën. Në llogaritjen e bërë nga Drejtoria e Planifikimit Urban subjekti ka paguar **4,732,020 lekë.**

(3810.02m² * 3% =114.3 m² * 41,400), të cilat kanë kaluar për programin social.
Shuma totale e paguar është **15,256,536 lekë**

Situata:

Nga auditimi i lejes së ndërtimit miratuar me Vendimin nr. 809, datë 27.11.2020 të Kryetarit të Bashkisë Berat konstatohet se nga Drejtoria e Planifikimit Urban dhe IMTV nuk janë mbajtur akt kontrolle me subjektin zhvillues; mbikëqyrësi e punimeve dhe firma zbatuese të punimeve të ndërtimit Veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me nenin 27/1 të VKM nr. 408 datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores se Zhvillimit të Territorit të ndryshuar si dhe nenin 51 107 të ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e Territorit”

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi sipas funksioneve; z. L. B. me detyrë zv/ Kryetar i Bashkisë në cilësinë e Drejtor të Planifikimit Urban dhe z. F. M. me detyrë ish/Kryeinspektor i IMTV

Kriteri:

Baza ligjore mbi të cilën është vlerësuar situata e cila paraqet parregullsi janë; Ligji nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e Territorit” dhe VKM nr. 408 datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores se Zhvillimit të Territorit.

Impakti:

Mos respektimi i rregullores së miratuar nga nuk ka siguruar zhvillimin e qëndrueshëm të territorit duke mos krijuar kushte të përshtatshme e të drejta dhe shanse të barabarta për banim.

Shkaku:

Mos respektimi i përcaktimeve të Ligjin Nr.107 datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” të ndryshuar, të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit” të ndryshuar si dhe Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Berat

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi

Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit, të marrin masa që në vazhdimësi të miratimit të lejeve të ndërtimit të mbahen aktet e kontrollit.

VITI 2021

1. Çështja me nr.2201 prot. datë 20.05.2021, sipas aplikimit në sistemin e leje.

Objekti: “**GODINE BANIMI DHE SHERBIMI 1, 6 DHE 8 KATE DHE 1 KAT PARKIM NENTOKESOR**” në Lagjen “Donika Kastrioti”, Bashkia Berat.

Leje Zhvillimi: Vendim nr. 271 i Kryetarit të Bashkisë Berat me zhvillues “F... Shpk” Nr. pasurie 19/246 ZK 8503, me sipërfaqe 869 m², prej të cilës 137.27 m² ndertës, në pronësi të z. G. P. nr. pasurie 19/247, ZK 8503, me sipërfaqe 897 m², prej të cilës 897 m² truall, në pronësi z. D. Sh. sipas kontratës se sipërmarrjes nr. 1945 Rep., 883 Kol., date 24.11.2020.

Leje ndërtimi: Vendim Nr. 377, datë 01.07.2021 të Kryetarit të Bashkisë Berat

Me zhvillues: “F... Shpk”

Të dhëna për pasurinë:

Pasuria me kontratën sipërmarrjes nr. 1945 Rep., 883 Kol., date 24.11.2020 me nr. pasurie 19/246, ZK 8503, me sipërfaqe 869 m², prej të cilës 137.27 m² ndertës, ne pronësi të z. G. P. dhe nr. pasurie 19/247, ZK 8503, me sipërfaqe 897 m², prej të cilës 897 m² truall ne pronësi të z. D. Sh., zhvillues Z. F... Shpk.

Të dhëna mbi objektin e miratuar

Njësia Strukturore: c.2.2a/4

Përcaktimet sipas. C.2.2a/4	Projekt -propozimi
	1793 m ² truall
Përdorimi i lejuar : Banim	Banim +Shërbime

Sipërfaqja maksimale për ndërtim : 50%	611 m ²
K.sh.t max = 50%	34 %
Imax = Sipas PDV për njesin strukturore c.2.2a/4	
H max = 26 m	8 kate/ 26 m ²

- **Lartësia e objektit.**

Objekti është me 1 kate nëntoke me destinuar për parkim., dhe Kati përdhe është i ndarë në dy hapësira të ndryshme nga pikëpamja funksionale, po ashtu dhe volumetrike. Pjesa e banimit zë 348 m² nga 611 m² që është sipërfaqja totale e këtij kati. Pjesa e banimit zhvillohet në kuotën + 0.85 m. Në këtë kat ndodhen 5 apartamente 1+1. Pjesa e shërbimeve është 263 m² dhe ndodhet në kuotën ±0.00

Kati Tip (1,2,3,4,5)

Kati tip zhvillohet në 5 kate dhe ka nga 8 apartamente në kat dhe ka një sipërfaqe prej 611 m² në kat. Tipologjitë e apartamenteve janë: 3+1 – 1 Apartament ; 2+1- 3 Apartamente dhe 1+1- 4 Apartamente. Në organizimin e apartamenteve parësore ka qenë zgjidhja funksionale si dhe konceptimi i hapësirave të nevojshme për ndarjen e brendshme të tyre.

Kati Gjashtë dhe Shtatë

Dy katet e fundit të objektit janë nga 400m² secili dhe janë më të tërhequr nga pjesa tjetër e volumnit për të respektuar distancat nga PDV si dhe për të ruajtur intensitetin e ndërtimit.

Në katin e gjashtë dhe të shtatë hapësira organizohet me 5 apartamente në kat.

Kati i gjashtë : 3+1- 1 Apartament; 2+1- 2 Apartamente dhe 1+1- 2 Apartamente

Kati i shtatë: 2+1- 3 Apartamente dhe 1+1 – 2 Apartamente.

- **Mënyra e llogaritja e taksës së ndikimit në infrastrukturë.**

Llogaritja e taksës së ndikimit në infrastrukturë për objektin e mësipërm është bërë sipas Udhëzimit nr. 3, date 28.12.2016 “Për llogaritjen e kostos mesatare të ndërtimit sipas Entit Kombëtar”, dhe sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 60, date 18.12.2019 “Për sisteminim e taksave dhe tarifave vendore ne Bashkinë Berat”.

Llogaritjes se koston së ndërtimit të banesave nga Enti kombëtar i banesave për vitin 2020:

Kosto mesatare e ndërtimit çmimit të shitjes/m²: 41 400 leke/m²

Sipërfaqe e ndërtimit kati nën tokë: 622 m²

sipërfaqe e ndërtimit kati përdhe: 959 m²

Sipërfaqe banimi: 4203 m²

Në rastin e ndërtimeve të destinuara për qëllime banimi apo për njësi tregtimi dhe shërbimi, të cilat kryhen nga shoqëri ndërtimi

a. Me destinacion banim	5 % e çmimit të shitjes për m ²
b. Me destinacion garazhd	5 % e çmimit të shitjes për m ²
c. Me destinacion njësi shërbimi (lokale, dyqane etj...)	6 % e çmimit të shitjes për m ²

Sipërfaqe Banimi 4203 m² x 41400 leke/m² x 5% = 8,700,210 lekë.

Sipërfaqe Shërbimi 263 m² x 41400 leke/m² x 1.5% x 6% = 979,938 leke.

Sipërfaqe Garazhi 622 m² x 41400 leke/m² x 0.7% x 5% = 901,278 leke.

Fasada: 2889 m² x 30 lekë/m² = 86,670 leke.

Referuar akt marrëveshjes me nr. 1509 repertori dhe nr.713 koleksioni e datës 26.11.2020 e nënshkruar midis shoqërisë “F...” SHPK dhe Bashkisë Berat nga Kryetari i Bashkisë Berat z. E. D. kanë rënë dakord që në zbatim të ligjit 22/2018 “Për strehimin social” detyrimin prej 3% sipas nenit 19 ta konvertojnë në lekë sipas çmimit të referencës së shitjes për zonën. Në llogaritjen e bërë nga Drejtoria e Planifikimit Urban subjekti ka paguar 4,569,318 lekë. (3679m² * 3% =110,37 m² * 41,400), të cilat kanë kaluar për programin social.

Shuma totale e paguar për sipërfaqen e re të ndërtimit është: **15,237,414 lekë**

Situata: Nga auditimi i lejes së ndërtimit miratuar me Vendimin nr. 377, datë 01.07.2021 të Kryetarit të Bashkisë Berat konstatohet se nga Drejtoria e Planifikimit Urban dhe IMTV nuk janë mbajtur aktet e kontrole me subjektin zhvillues; mbikëqyrësi e punimeve dhe firma zbatuese të punimeve të ndërtimit Veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me nenin 27/1 të VKM nr. 408 datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit të ndryshuar si dhe nenin 51 107 të ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e Territorit”.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi sipas funksioneve; z. L. B. me detyrë zv/ Kryetar i Bashkisë në cilësinë e Drejtor të Planifikimit Urban dhe z. G. H. me detyrë ish/Kryeinspektor i IMTV

Kriteri: Baza ligjore mbi të cilën është vlerësuar situata e cila paraqet parregullsi janë; Ligji nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e Territorit” dhe VKM nr. 408 datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit.

Impakti: Mos respektimi i rregullores së miratuar nga nuk ka siguruar zhvillimin e qëndrueshëm të territorit duke mos krijuar kushte të përshtatshme e të drejta dhe shanse të barabarta për banim.

Shkaku: Mos respektimi i përcaktimeve të Ligjit Nr.107 datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” të ndryshuar, të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit” të ndryshuar si dhe Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Berat

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit, të marrin masa që në vazhdimësi të miratimit të lejeve të ndërtimit të mbahen aktet e kontrollit.

2. Auditimi i Lejeve Infrastrukturore

Nga auditimi i Lejeve Infrastrukturore rezultoi se për periudhën objekt auditimi nga 13 leje infrastrukturore të miratuara nga Kryetari i Bashkisë Berat në 10 prej tyre është zhvillues Bashkia Berat, në tre raste nuk është zhvillues Bashkia Berat. Në 2 raste është zhvillues OSHE për të cilat është paguar taksa e ndikimit në infrastrukturë në 1 rrastë subjekte zhvillues nuk është Bashkia Berat për të cilën nuk është paguar taksa e ndikimit në Infrastrukturë. Lejet infrastrukturore paraqiten në aneksin nr. 2 pika 5 bashkëlidhur projekt raportit të auditimit.

Titulli i gjetjes: Mos llogaritja e taksës së infrastrukturës në masën 0.1% nga investimet jo me fondet e Bashkisë Berat dhe ku përfitues nuk është Bashkia Berat.

Situata: Referuar informacionit të marrë në DPZHU Bashkia Berat, rezulton se për periudhën objekt auditimi në territorin e Bashkisë Berat janë miratuar në total 13 leje infrastrukturore të cilat korrespondojnë me investimet e kryera në Bashki për periudhën 01.10.2019-31.12.2021. Nga auditimi i sistemit e-leje rezultoi se në Bashkinë Berat po kryhen investime ku investitor dhe zhvillues nuk është Bashkinë Berat, (Ujësjetllës Kanalizime Berat –Kuçovë ShA), për të cilën DAV Bashkia Berat nuk ka mundur përlllogaritjen e taksës së ndikimit në infrastrukturë të investimeve, konkretisht objektet:

- “Rikonstruksioni i Rrjetit të Furnizimit me Ujë dhe Sistemit të Kanalizimeve në Qytetin e Berat” me vlerë preventivi prej 10,426,746 euro;

Nga auditimi i sistemit e leje, miratimi i lejes është bërë pa paguar taksën e ndikimit në infrastrukturë në vlerën 0.1% sipas paketës fiskale. Vlera e investimeve sipas preventivit është 10,426,746 euro x 121 kursi i këmbimit x 0.1% = **1,261,636 lekë, e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Berat.**

Kriteri: VKB nr. 57, datë 28.12.2015 “Për miratimin e paketës fiskale, viti 2019”, në masën 0.1% të vlerës së investimit.

Impakti: Ndikim negativ në të ardhurat e buxhetit të Bashkisë Berat për vlerën **1,261,636 lekë.**

Shkaku: Mungesa e bashkëpunimit midis drejtorive, Bashkia Berat.

Rëndësia: E lartë

Për këtë rekomandojmë: Drejtoria e të Ardhurave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikim Urban, të marrë masa për llogaritjen e saktë të detyrimeve nga taksa e infrastrukturës në masën 0.1% për investimet që zhvillues nuk është Bashkia Berat, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjor për arkëtimin e detyrimit në vlerën **1,261,636 lekë**.

6. Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit të Njesisë Vendore (IMTV).

-Mbi krijimin e organizimin e Inspektoratit Mbrojtjes të Territorit.

Struktura e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor të Bashkisë Berat (IMTV) për vitin 2020 është miratuar me Vendim të Kryetarit të Bashkisë Nr. 120, datë 21.02.2020 “Për miratimin e strukturës organike të Aparatit të Bashkisë” për vitin 2020, i përbërë nga 4 punonjës, nga të cilët 1 kryeinspektor dhe tre inspektore. **Për vitin 2021** është miratuar me Vendim të Kryetarit të Bashkisë 827, datë 15.12.2020 “Për miratimin e strukturës organike të Aparatit të Bashkisë për vitin 2020, i përbërë nga 4 punonjës, nga të cilët 1 kryeinspektor dhe tre inspektore, në fakt aktualisht në punë janë dy punonjës në përmbledhur paraqitet në aneksin nr. 1 pika 6 bashkëlidhur projekt raportit të auditimit.

Emërimet e 1 (një) k/Inspektori në strukturën e IMT është në papajtueshmëri me kriteret e përcaktuara në ligjin nr. 9780 datë 16.07.2007 “Për Inspektimin e Ndërtimit”, i ndryshuar me ligjin nr. 183/2014 “Për inspektimin e ndërtimit” neni 11 “Arsimimi i kryeinspektorëve dhe inspektorëve të inspektoratit të mbrojtjes së territorit”, ku përcaktohet se: “Kryeinspektorët dhe inspektorët në nivel kombëtar dhe qeverisjes vendore duhet të kenë arsimin e lartë të nevojshëm profesional në fushat e drejtësisë, inxhinierisë së ndërtimit, arkitekturës, urbanistikës, konstruksionit, transportit, teknologjisë së materialeve, gjeologjisë, hidrogeologjisë dhe mjedisit.

Përshkrimi i situatës për periudhën 01/10/2019– 31/12/2021

Në ushtrimin e detyrave funksionale të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor Bashkia Berat për periudhën objekt auditimi, aktiviteti i veprimtarisë së punës në terren i cili është pasqyruar dhe dokumentuar me procesverbale konstatimi dhe për më tej me vendime pezullimi punimesh dhe vendime për prishje objekti të ndërtuar pa leje ndërtimi, në mënyrë të përmbledhur paraqiten në tabelën në vijim.

Nr.	Emërtimi i vendimit	Sasia
1	Vendime për pezullim punimesh ndërtim me afat 10 ditor	0
2	Vendime për pezullim punimesh ndërtim me afat 60 ditor	0
3	Vendime për prishje objektsh	8
4	Vendime për gjoba	30
5	Vendim për kallëzim penal	4

Burim: Bashkia Berat.

Titulli i gjetjes: Krijimi i debitorëve nga mos arkëtimi i gjobave të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV) në vlerën 6,700,000 lekë

Situata:

Periudhën objekt auditimi nga Inspektorati Mbrojtjes Territorit Bashkia Berat janë vendosur 31 gjoba në vlerën **9,585,000 lekë**, nga të cilat është arkëtuar vlera **2,885,000 lekë**, duke mbetur pa u arkëtuar vlera **6,700,000 lekë**, e cila përben të **ardhur të munguara për buxhetin e Bashkisë sipas aneksit nr. 2 pika 6 bashkëlidhur projekt raportit të auditimit**. Sa më sipër rezulton se për të gjitha praktikant IMT-ja, nuk kanë ndjekur të gjitha rrugët ligjore, me qëllimin arkëtimin e detyrimeve, në kundërshtim me:

a-neni 16, i ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve", me ndryshime, **përcaktohet se:** -Gjoha paguhet nga kundërvajtësi brenda 5 ditëve nga dita që vendimi ka marrë formë të prerë. Pas kalimit të këtij afat paguhet kamatë 2 për qind për çdo ditë vonesë, **deri në një muaj.** Kur edhe pas këtij afati nuk kryhet pagesa, vendimi ekzekutohet në rrugë gjyqësore sipas ligjit.

-**Neni 15**-(Ndryshuar dy fjalitë e para me ligjin nr. 9794, datë 23.7.2007, neni)(Ndryshuar fjalia e fundit me ligjin nr. 9826, datë 1.11.2007, neni 2)(Shtuar një paragraf në fund të nenit me ligjin nr.10 324, datë 23.9.2010, neni 3);

- **Nenet**, 9, 22 dhe 30, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative".

Kriteri:

Neni 16, i ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve", me ndryshime; **Neni 15**-(Ndryshuar dy fjalitë e para me ligjin nr. 9794, datë 23.7.2007, neni)(Ndryshuar fjalia e fundit me ligjin nr. 9826, datë 1.11.2007, neni 2)(Shtuar një paragraf në fund të nenit me ligjin nr.10 324, datë 23.9.2010, neni 3); - **Nenet**, 9, 22 dhe 30, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative".

Shkaku: Mos vjelja e gjobave të vendosura nga IMT -ja si dhe mos zbatimi i procedurave për prishjen e objekteve pa leje

Ndikimi/Efekti: Mungesë të ardhurash nga mos arkëtimi i penalieteve dhe prishje të planit urbanistik nga ndërtimet pa leje dhe në kundërshtim me lejet e ndërtimit.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV) dhe Drejtoria Juridike, të marrin masat dhe të kërkojnë në Gjykatë të marrin masa për kthimin e vendimeve të gjobave në tituj ekzekutiv duke llogaritur edhe kamat vonesat në masën 60% mbi shumën e gjobës së papaguar sipas **aneksit nr. 2 pika 6 bashkëlidhur projekt raportit të auditimit.**

Titulli i gjetjes: Mos zbatimi i vendimeve të mara nga IMTV për prishjen e objekteve pa leje ndërtimi.

Situata: Për periudhën objekt auditimi, IMT Bashkia Berat, ka mbajtur procesverbal konstatimi dhe procesverbal vendim prishje, në 10 raste për objektet pa leje sipas aneksit nr. 3 pika 6 bashkëlidhur projekt raportit të auditimit. Rezulton se IMT Bashkia Berat nuk është marrë asnjë masë tjetër për prishjen e ndërtimeve dhe kthimin e gjendjes në situatën e mëparshme, për të cilat IMT duhej të vepronte në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9780/2007 "Për inspektimin e ndërtimit", i ndryshuar. Veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me ligjin nr.9780, datë 16.07.2007 "Për inspektimin e ndërtimit" i ndryshuar dhe konkretisht neni 10 ,veprim i cili ngarkon me përgjegjësi K/Inspektorin z. G. H. ish K/Inspektorin z. F. M. si dhe inspektorin z. S. B.

Kriteri: Neni 10 i ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 " Për inspektimin e ndërtimit" i ndryshuar dhe VKM-së nr. 862, datë 05.12.2007 "Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga IKMT dhe INUV" i ndryshuar.

Shkaku: Moszbatimi i procedurave për prishjen e objekteve pa leje.

Ndikimi/Efekti: Mungesa e besueshmërisë në funksionimin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Inspektorati i Mbrojtjes Territorit në bashkëpunim me Policinë Bashkiake, të marrë masa që për rastet e ndërtimeve të paligjshme (pa leje ndërtimi), ndajë të cilave është mbajtur procesverbal prishje objekti, dhe kthimin në gjendjen fillestare të truallit, duke zbatuar vendimin e prishjes së objektit. Në rast kundërshtimi ndajë personave përgjegjës, të ndiqen procedurat ligjore, duke kërkuar bërjen e kallëzimit penal ndajë shkelësve.

7. Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm

Objekti i këtij akt verifikimi është zbatimi i rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e fundit, dërguar në Bashkinë Berat me shkresën nr. 241/51 datë 13.04.2021.

Nga verifikimi rezultoi: Në bazë të programit të auditimit nr. 610, prot, datë 25.06.2020 të Kontrollit të Lartë të Shtetit, është bërë “Verifikimi i zbatimit të rekomandimeve dërguar në Bashkinë Berat me shkresën nr. nr.606/9, datë 30.12.2019”. Gjendja e tyre paraqitet si vijon:

a . Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 14 masa organizative, nga të cilat janë pranuar plotësisht 14 masa, nga të pranuarat janë zbatuar 2 masa, janë në proces zbatimi 9 masa organizative dhe 3 masa organizative nuk janë zbatuar.(respektivisht rekomandimet nr. 11 dhe 13)

b. Për shpenzime në kundërshtim me principet e 3 E-të është rekomanduar që të analizohet në një masë në vlerën 19,171,364 lekë, e pranuar dhe për shkeljet e konstatuar nga komisionet e prokurimit Komisioni disiplinor i Bashkisë Berat është në proces për ecurinë e masave disiplinore.

c. Për shpërblim dëmi janë rekomanduar 6 masa me vlerë 8,946,578 lekë, janë dërguar njoftimet detyrimet subjekteve si dhe janë kërkuar në Gjykatën përkatëse me kërkesë padi vjeljen e detyrimeve sipas shkresave bashkëlidhur për 4 subjekte në vlerën 7,742,670 lekë, 1 subjekt në vlerën 1,015,520 lekë, duhet të kryente punimet, por është brenda afatit të garancisë, certifikata e garancisë më datën 10.10.2018,afati i garancisë për 2 vjet deri më datën 10.10.2020, ndërsa për 1 subjekt në vlerën 188,400 lekë, edhe pse është bërë njoftimi ende nuk ka kryer pagesën.

d. Për të ardhura të munguara janë rekomanduar 5 masa me vlerë 404,506 mijë lekë, respektivisht nga taksave vendore, në vlerën 309,188 mijë lekë, nga moslidhja e kontratave për sipërfaqe pyjore pronë e bashkisë në vlerën 75,504 mijë lekë, dhe mos arkëtimi i vendimeve të gjobave të IMTV në vlerën 38,650 mijë lekë, ku nga verifikimi rezulton se masat e rekomanduara për të ardhurat e munguara janë në proces zbatimi.

e. Nga KLSH, janë rekomanduar 3 masa administrative me gjobë për një mbikëqyrës dhe dy kolaudatorë punimesh, ku nga verifikimi rezultoi se nga Kryeinspektori i IMTV, Bashkia Berat, për të 3 personat janë vendosur Gjobë gjithsejtë në shumën 1,050,000 lekë, respektivisht një mbikëqyrës në shumën 50,000 lekë dhe 2 kolaudatorët me nga 500,000 lekë secili. Gjobat janë kontabilizuar ndërsa një Kolaudator ka kundërshtuar në Gjykatë, vendimin e Gjobës të IMTV.

Nga verifikimi rezulton se KLSH ka dërguar në Bashkisë Berat, rekomandimet e auditimit me shkresën e saj nr. 606/9 prot, datë 30.12.2019, protokolluar në *Bashkinë Berat*, me shkresën nr.4378/7, datë 06.01.2020, ndërsa nga *Bashkia Berat*, për zbatim e rekomandimeve të KLSH nuk ka kthyer përgjigje.

Pa zbatuar

Nga verifikimi rezulton se përfundimet e auditimit i janë dërguar subjektit të audituar *Bashkinë Berat*, me shkresën e Kryetarit të KLSH nr 606/9 prot, datë 30.12.2019, protokolluar në *Bashkinë Berat*, me shkresën nr.4378/7, datë 06.01.2020, dhe duhet të raportonte në KLSH brenda 6 muajve ose brenda datës 06.07.2020.*Pra, Bashkia Berat ka raportuar në KLSH me shkresën Nr.1777/2 prot, datë 14.04.2020, mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda 6 muajve sipas kërkesave të përcaktuara në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014“Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30-Rekomandimet e KLSH-së dhe ecuria e zbatimit, pika 2, ku përcaktohet se:* Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna.

Zbatuar

Nga verifikimi rezulton se Bashkia Berat ka hartuar planin e veprimit të zbatimit të rekomandimeve të dërguara nga KLSH me shkresën nr.1777/2 prot datë 14.04.2020 por

pavarësisht se janë diskutuar rekomandimet në Këshillin e Bashkisë dhe plani i veprimit është kërkuar nga Këshilli Bashkiak Berat, ndërkohë është paraqitur materiali në Këshillin Bashkiak pra **ka raportuar rregullisht në këshillin e njësisë** (këshillin bashkiak), në përputhje me ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Neni 50-Auditimi i jashtëm ku përcaktohet se: 5. Për të gjitha raportet e auditimit të jashtëm, të kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit apo auditues të tjerë ligjorë, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të raportit të auditimit dhe raporton rregullisht në këshillin e njësisë.

Zbatuar

Titulli i gjetjes: *Bashkia Berat ka vijuar punën me zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.*

Situata: Për sa sipër në mbështetje të shkronjave (a) dhe (b) e nenit 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin e Lartë të Shtetit”, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit me **Vendimin nr. 128, datë 24.11.2020, ka vendosur ripërsëritjen e tyre**, duke rikërkuar marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të cilat janë konsideruar në proces zbatimi dhe rekomandimet e pa zbatuara.

Pavarësisht auditimit që KLSH ka kryer për zbatimin e rekomandimeve, mbështetur në nenin 30, pika 2 dhe 3 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **Bashkia Berat ka detyrim ligjor që brenda 20 ditëve nga data e marrjes së kërkesës**, duhet të raportoni me shkrim pranë KLSH, mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të rikërkua, dërguar në Bashkinë Berat me shkresën nr. 601/56 datë 04.12.2020 në të cilin ka **rikërkuar** zbatimin e rekomandimeve të cilat kanë qenë të pa zbatuara dhe në proces zbatimi si vijon;

- Për përmirësimin e gjendjes janë rikërkuar 11 masa organizative, nga të cilat është zbatuar 2 masa, janë në proces zbatimi 8 masa organizative dhe nuk është zbatuar 1 masa organizative.

-Për shpërblim dëmi janë rikërkuar 2 masa me vlerë 1,203,900 lekë, është në proces gjyqësorë 1 masa në vlerë 188,400 lekë dhe në proces zbatimi 1 masë në vlerë 1,015,500 lekë.

A. MASA ORGANIZATIVE:

Nga 11 masa organizative të rikërkua janë zbatuar 2 masa organizative, janë në proces 8 masa dhe nuk është zbatuar 1 masa organizative si vijon:

1.2.1 Rekomandimi: Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV) dhe Drejtoria Juridike, Bashkia Berat, bazuar në nenet 151 dhe 152, të “Kodit Procedurës Civile në RSH”, të marrin masat dhe të kërkojë në Gjykatë rivendosjen në afat për 31 vendime gjobë për ndërtimet e pa ligjshme, të vendosura për periudhën 01.01.2015, deri më datën 31.10.2017, për shumën **20,650,000 lekë**, (duke llogaritur edhe kamat vonesat në masën 60%, mbi shumën e gjobës së papaguar, bazuar në nenin 16 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve” i ndryshuar). **Aneksi nr. 2 bashkëlidhur.**

b. Njëherazi Bashkia Berat Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV) dhe Drejtoria Juridike të marrin masa për kthimin në tituj ekzekutiv të 125 vendimeve të gjobave në vlerën **38,650,000 lekë**, në zbatim të nenit 24-*Shndërrimi i vendimit për kundërvajtjen administrative në titull ekzekutiv*, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative (duke llogaritur edhe kamat vonesat në masën 60%, mbi shumën e gjobës së papaguar, bazuar në nenin 16 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve” i ndryshuar). **Aneksi nr. 1.bashkëlidhur.**

1.2.2 Nga verifikimi rezultoi se: Në Planin e masave të hartuar nga Bashkia Berat me nr. 1777/1 Prot datë 23.04.2020, ky rekomandim është pranuar dhe do të ndiqet nga IMTV-ja dhe Drejtoria Juridike. Aktualisht IMTV Berat ka nisur procesin e kërimit pranë Gjykatës së Shkallës së parë për lëshimin e urdhrave ekzekutiv të gjobave të vitit 2018 dhe të vitit 2019, sipas aneksit nr. 1 pika 7 bashkëlidhur projekt raportit të auditimit.

Në proces Zbatimi

2.3.1 Rekomandimi: Bashkia Berat (Drejtoria e Financës), bazuar në; Udhëzimin plotësues të Ministrisë Financave nr. 02, datë 10.01.2018 “Për buxhetin e vitit 2018”, pikat 82-91 “Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore” dhe Udhëzimin plotësues të Ministrisë Financave nr. 01, datë 17.01.2019 “Për buxhetin e vitit 2019”, pikat 106-110, “Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”, dhe pikat 116-117-*Raportimi i detyrimeve të prapambetura në njësitë e qeverisjes vendore*” të paraqesë në mbledhjen e këshillit bashkiak, një material për gjendjen e faturave të pa likuiduara në vite, të hartojë një grafik duke zbatuar të gjitha radhën e pagesave për vlerën duke zbatuar të gjitha radhën e pagesave për vlerën prej 14,090,017, nga e cila vlera e faturave të palikujduara në shumën **5,028,282** lekë dhe vendime gjyqësore për shumën prej **9,061,735** lekë (**Bashkëlidhur Aneksi nr.8 mbi gjendjen e faturave të palikujduara me datën 30.09.2019**)

3.2 Nga verifikimi rezultoi se: Sipas të dhënave të vena në dispozicion rezulton se Bashkia Berat (Aparati) rezulton se më datën 31.12.2021 ka detyrime të prapambetura në vlerën 170,583,571 lekë, nga 143,347,084 leke që ka qënë më datën 31.12.2020 duke u shtuar detyrimet e prapambetura në vlerën 27,236,487 lekë. Shuma e detyrimeve të prapambetura më datën 31.12.2021 është në vlerën 170,583,571 lekë e cila përbëhet 157,160,681 lekë janë detyrime të aparatit dhe 13,422,890 lekë janë detyrime të njësive shpenzuese. Detyrimet e bashkive janë të ndara në 4,954,630 lekë janë detyrime për vendime gjyqësore, 150,994,794 lekë janë detyrime për investime, vlera 959,717 lekë janë mallra dhe vlera 251,540 lekë janë detyrime për të tjera shpenzime operative. Trajtuar më hollësisht në pikën 2 të programit të auditimit.

Në proces zbatimi

3.4.1. Rekomandimi: Bashkia Berat, nëpërmjet Drejtorisë së Planifikimit, Zhvillimit së Territorit të marrë masa si dhe të ndjek të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet pa leje në vlerën **26,225,134** lekë.

3.4.2 Nga verifikimi rezultoi se: Në Planin e Masave të hartuar nga Bashkia Berat me Nr. 1778 prot, datë 14.04.2020 është pranuar rekomandimi për zhdëmtim duke ngarkuar për ndjekje të këtij rekomandimi Drejtorinë e Planifikimit, Zhvillimit të Territorit.

-Nga Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit të Territorit me shkresën nr. 67 prot. date 08.01.2020 drejtuar Agjencisë Shtetërore e Kadastrës, Drejtorisë Vendore Berat kërkesë për bashkëpunim, për të cilën kërkojnë tu pezullohet vazhdimi i procedurës për legalizim të objektit deri në pagesën e saj nga personat bashkangjitur lista e përfituesve që nuk janë paraqitur pranë Bashkisë Berat për të paguar taksën vendore të ndikimit në infrastrukturë.

-Deri më datë 01.04.2022 nga 26,225,134 lekë të lëna për arkëtim nga Rekomandimet e KLSH-së që u takon 704 personave, nga 164 persona është arkëtuar shuma 5,992,123 lekë, ose realizuar në masën 23%. Arkëtimet vazhdojnë. Trajtuar më hollësisht në pikën 2.6 të programit të auditimit.

Në proces zbatimi

5.6.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore **Bashkia Berat**, të marrë masa për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore në vlerën **267,055,110** lekë. Bazuar në nenin 70 pika 3 “E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”, të ligjit nr. 9920, datë

19.05.2008 “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të nxirren njoftim vlerësimet tatimore për debitorët dhe të **ndiqen rrugët e mëposhtme:**

a) Tu ridërgohen bankave urdhrat e bllokimit të llogarive në banka, bazuar në nenin 90 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ”Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar

5.6.2 Nga verifikimi rezultoi se: Në zbatim të planin të masave të hartuar nga Bashkia Berat me nr. 1778 Prot datë 14.04.2020, ky rekomandim do të ndiqet nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave.

Refruar llogarisë 468 “Debitor të ndryshëm”, në pasqyrat financiare të vitit 2021 janë evidentuar detyrimet debitorë të Bashkisë Berat, Njësive Administrative, Ujësjellësit, debitorët nga njësitë vartëse , debitorët e KLSH-së, debitorët e IMTV-së, Policisë Bashkiake etj,

Nga auditimi i Drejtorisë së Taksave mbi arkëtimin e detyrimeve të mësipërme janë ndjekur rrugët e mëposhtme:

-Janë nxjerrë njoftimet tatimore për debitorët.

-Janë ridërguar bankave urdhrat e bllokimit të llogarive në banka, bazuar në nenin 90 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar etj.

Në mënyrë të përmbledhur debitorët e taksave vendore paraqiten si më poshtë:

Nr.	Emertimi	Gjendja 31.12.2018	Shtesa 2019	Arketime	Detyrimi 31.12.2019 + gjobe + kamate	Arketime 2020	Detyrimi 2020	Detyrimi 31.12.2020 + gjobe + kamate	Arketime 2021	Detyrimi 2021	Detyrimi 31.12.2021 + gjobe + kamate
1	Bashkia	58,721,511	13,061,752	7,785,726	63,997,537	5,211,578	30,356,963	89,142,922	16,736,810	31,891,917	104,298,029
2	NJA. Velabisht	26,592,567	16,679,178	10,997,660	32,274,085	6,269,994	10,222,331	36,226,422	6,754,526	10,053,020	39,524,916
3	NJA Otllak	40,439,816	26,160,674	20,979,919	45,620,571	5,758,883	5,581,128	45,442,816	4,418,853	11,838,362	52,862,325
4	NJA Roshnik	4,713,162	3,969,642	2,897,273	5,785,531	836,066	1,694,931	6,644,396	940,403	1,578,096	7,282,089
5	NJA Sinje	18,481,409	7,103,352	4,409,303	21,175,458	3,040,964	5,231,977	23,366,471	3,157,108	5,050,926	25,260,289
6	Debitorë familjare Bashkia	11,143,254	1,358,055	790,168	11,711,141	519,466	2,517,128	13,708,803	1,403,864	4,720,251	17,025,190
8	Debitorë tregu Industrial	429,876	10,320,000	9,138,945	1,610,931	1,533,711		77,220			77,220
9	Hapesirat Publike		233,220		233,220			233,220			233,220

Shënim: Burim i të dhënave Bashkia Berat.

Në proces zbatimi

7.9.1 Rekomandimi: Nga Bashkia Berat, të merren masa duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e detyrime të paraqitura në vlerën **75,504,000 lekë** dhe lidhjen e kontratave me subjektet “B...07” me vlerë 8,470,000 lekë, “T... B...” me vlerë 13,310,000 lekë, “B... S...” me vlerë 20,207,000 lekë, “P... R... e S...” me vlerë 13,915,000 lekë, “E...” me vlerë 11,132,000lekë, “T... E...” me vlerë 8,470,000 lekë.

7.9.2 Nga verifikimi rezultoi se: Në Planin e masave të hartuar nga Bashkia Berat me nr. 1777/1 Prot datë 23.04.2020, ky rekomandim do të ndiqet nga Drejtoria e Bujqësisë, Administrimit të Pyjeve, Kullotave, Ujërave e Shërbimit Veterinar dhe Drejtoria Juridike si vijon:

Drejtorja e Bujqësisë, Administrimit të Pyjeve, Ujërave dhe Shërbimit Veterinar pas planit të veprimtimit mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH ka filluar procedurat administrative për lajmërimin e çdo subjekti me njohjen e detyrimeve kundrejt bashkisë Berat si në njoftimet me nr. 157, 158,160,161,162.170, datë 26.02.2020 për tu paraqitur pranë

D.B.A.P.U&SH për marrjen e faturave për arkëtimin dhe derdhjen në buxhetit e Bashkisë Berat. Në datën 26.06.2021 me shkresa me nr. 157/1,158/1,160/1,161/1,162/1,170/1 janë Ri njoftuar subjektit për njoftimin e detyrimit dhe lidhjen e kontratave për shfrytëzimin e fondit pyjor /kullor në territorin e Bashkisë Berat. Gjendja e tyre paraqitet si vijon:

Subjekti “T...E...” shpk me shkresën me nr. 1956/1 prot datë 11.03.2019 nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit drejtuar Bashkisë Berat për përgatitjen e raportit tekniko-financiar për kryerjen e aktivitetit minerar për heqjen nga fondi pyjor /kullor ka zhvilluar procedurën ligjore dhe me vendim të Këshillit Bashkiak 69 datë 07.05.2019, ka dhënë dakortësinë për vijimin e procedurave për heqjen nga fondi pyjor dhe kullor publik për veprimtaritë minerare dhe gjeologjike për shfrytëzimin e gurit gëlqeror. Subjekti nuk ka lidhur kontratë për rrugën auto- pyjore pasi parcelat e shfrytëzimit janë anës rrugës kryesore.

Subjekti “T...B...” shpk me shkresën me nr. 3155/1 prot datë 01.10.2021 nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit drejtuar Bashkisë Berat për përgatitjen e raportit tekniko-financiar për kryerjen e aktivitetit minerar për heqjen nga fondi pyjor/kullor ka zhvilluar procedurën ligjore dhe me vendim të Këshillit Bashkiak nr. 48 datë 01.07.2021, ka dhënë dakortësinë për vijimin e procedurave për heqjen nga fondi pyjor dhe kullor publik për veprimtaritë minerare dhe gjeologjike për shfrytëzimin e gurit gëlqeror he për vitin 2021. Subjekti nuk ka lidhur kontratë për rrugën auto- pyjore pasi parcelat e shfrytëzimit janë anës rrugës kryesore.

Subjekti “K...” shpk me shkresën nr. 4799/1 prot datë 22.07.2021 nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit drejtuar Bashkisë Berat për përgatitjen e raportit tekniko-financiar për kryerjen e aktivitetit minerar për heqjen nga fondi pyjor /kullor ka zhvilluar procedurën ligjore dhe me Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 75 datë 18.10.2021, ka dhënë dakortësinë për vijimin e procedurave për heqjen nga fondi pyjor dhe kullor publik për veprimtaritë minerare dhe gjeologjike për shfrytëzimin e gurit gëlqeror. Subjekti nuk ka lidhur kontratë për rrugën auto- pyjore pasi parcelat e shfrytëzimit janë anës rrugës kryesore.

Subjekti “E...shpk” pas njoftimeve ka dorëzuar pranë D.B.A.P.U&SH dokumentacionin shoqëruar të procedurës për pezullimin e lejes minerare me nr. 1597 datë 19.11.2012 , në objektin Kostren pasi nuk kanë kërkesa tregu për shtijen e produkteve dhe nga akt kontrollet nga sektori pyjor ky subjekt rezultoi se e ka pezulluar punimet.

Subjekti “S... & G... shpk” në bazë të dokumenteve të qendrës Kombëtare të Biznesit i cili rezultoi si subjekt pezull më datë 28.07.2018 dhe nga akt kontrollet nga sektori pyjor ky subjekt rezultoi se e ka pezulluar punimet.

Subjekti “P... R... e S...” nga njoftimet e bëra nga drejtorja subjekti nuk është paraqitur pranë drejtorisë dhe nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion për lejet minerare dhe lejet mjedisore. dhe nga akt kontrollet nga sektori pyjor ky subjekt rezultoi se e ka pezulluar punimet.

Subjekti “B...S... shpk” në bazë të dokumenteve që ndodhen pranë zyrës juridike Bashkia Berat ka paditur këtë të fundit dhe në Gjykatën e shkallës së Parë , Berat është shpallur fitues i Çështjes dhe gjykimi vazhdon në Gjykatën e Apelit .

Subjekti “H... F...” në bazë të listës zyrtare të AKBN-së për vitin 2022 rezultoi si subjekt me vendodhje Bashkia Berat , por nga akt kontrollet e specialisteve të pyjeve ky subjekt rezultoi me vendodhjen në Bashkinë Dimal, emërtimi i vendburimit Bistovic.

Në proces zbatimi

8.10.1 Rekomandimi: Bashkia Berat të marrë masa të menjëhershme për arkëtimin e shumës 15,300,000 lekë për subjektet e tregimit me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë, në zbatim të, VKM nr. 344, datë 19.04.2017, kapitulli II, pika 1; germa “b” dhe pika 9.

8.10.2 Nga verifikimi rezultoi se: Në Planin e masave të hartuar nga Bashkia Berat me nr. 1777/1 Prot datë 23.04.2020, ky rekomandim do të ndiqet nga Drejtorja e Emergjencave Civile, Pronave dhe Transportit dhe Drejtorja e Financës dhe të Ardhurave. Me urdhrin e

brendshëm të Kryetarit të Bashkisë nr. 08 date 13.01.2020, është ngritur komisioni për zbatimin e procedurës për dhënien e licencave për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim. Sipas dokumentacionit të venë në dispozicion nga Drejtoria e Shërbimeve dhe e licencave, në lidhje me subjektet e tregtimit të karburanteve që ushtrojnë aktivitet në territorin e Bashkisë Berat dhe në Njësitë Administrative në varësi Otlak, Velabisht, Sinjë dhe Roshnik, ushtrojnë aktivitetin 23 subjekte të cilat tregtojnë me pakicë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre dhe 1 subjekt që tregon me shumicë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre, Nga verifikimi rezulton se nga vlera debitorë 18,200,000 lekë, është arkëtuar vlera 9,250,000 lekë si dhe nuk janë licencuar me leje tregtim karburanti, gjithsej **8 subjekte** të cilët ushtrojnë aktivitet dhe papaguar detyrimin fiskal në **vlerën 8,950,000 lekë** e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Berat sipas **aneksi nr. 8 pika 2.6 bashkëlidhur projekt raportit të auditimit.**

Në proces zbatimi

9.11.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës në Bashkinë Berat të kryejë veprimet e kontabilizimit për vlerë të plotë të kontratave për mallra e shërbime në momentin e nënshkrimit të tyre.

9.11.2 Nga verifikimi rezultoi se: Në planin e masave të hartuar nga Bashkia Berat me nr. 1777/1 Prot datë 15.04.2022, ky rekomandim po ndiqet nga Drejtoria e Financës dhe të Ardhurave.

Pa zbatuar

11.14.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë të marrë masa me Burimet Njerëzore për rivlerësimin e situatës në bazë të rishikimit të menaxhimit dhe kontrollit të riskut për shkallën e realizimit të objektivave sipas strategjisë, përfshirjen e strukturave drejtuese në vendimmarrjet relevante, plotësimin në masë më të madhe të nevojave për trajnime si të stafit drejtues dhe ai i nivelit specialist.

11.14.2 Nga verifikimi rezultoi se: Në planin e masave të hartuar nga Bashkia Berat me nr. 1778 Prot datë 14.04.2020, ky rekomandim po ndiqet nga të gjitha Drejtoritë e Bashkisë dhe njësitë varëse të saj duke hartuar regjistrin e riskut nga çdo ndërmarrje, drejtori e sektorë. Mbi bazën e risqeve të identifikuar po bëhet vlerësimi dhe monitorimi i tij me qëllim eliminimin e faktorëve që kanë penguar dhe pengojnë arritjen e objektivave të përcaktuara. Mbi bazën e risqeve të njëjësive nga koordinatori e deleguar e riskut nëpërmjet bashkëveprimit të aktiviteteve në lidhje me menaxhimin e risqeve do të përgatisë dhe përditësoj regjistrin e riskut të Bashkisë Berat.

Me Urdhër të Brendshëm të Titullarit të Bashkisë nr. 491 datë 17.07.2020 është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) dhe Ekipi i Menaxhimit të Programeve (EMP) "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2021-2023" në zbatim të ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008" Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Edhe për vitin 2020 Bashkia Berat sqaron se do gjendet mundësi për pjesëmarrje sa më të madhe në trajnime, ndonëse e kufizon këtë gjë përhapja e koronavirusit.

Në proces zbatimi

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:

Për masa shpërblim dëmi **KLSH i ka rekomanduar Titullarit të njësisë publike (Bashkia Berat)**, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **8,946,578 lekë**.

Bashkia Berat në zbatim të rekomandimeve të KLSH, ka bërë kontabilizimin në llogarinë 468-debitorë të Pasqyrave Financiare më datën 31.12.2019 (bilanci vjetor 2019). vlera **7,931,078 lekë** dhe nuk është kontabilizuar vlera prej **1,015,500 lekë**, konkretisht rekomandimi nr. 6.1. dhe deri në datën e verifikimit janë në proces gjyqësor 4 rekomandime në vlerën 7,742,678 lekë respektivisht rekomandimi nr. 2.1, 3.1, 4.1 dhe rekomandimi 5.1, është në proces zbatimi 1 rekomandim në vlerën 1,015,500 dhe nuk është zbatuar rekomandimi nr. 1.1, si vijon: Nga 2 masa shpërbllim dëmi të rikërkuara, 1 masë në vlerë 188,400 lekë është në proces gjyqësorë dhe është në proces zbatimi 1 masë në vlerën **1,015,500 lekë** si më poshtë:

1.1.1. Rekomandim: Bashkia Berat, drejtorja e financës, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative dhe gjyqësore arkëtimin e shumës **188,400 lekë** si sigurim kontrate OE “K... 04” SHPK të shpallur fitues për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje materialesh elektrike”, bazuar kjo në LPP dhe të Udhëzimit nr. 914 datë 29.12.2014 neni 24.

1.1.2 Nga verifikimi rezultoi se: Në Planin e Masave të hartuar nga Bashkia Berat me Nr. 1778 prot, datë 14.04.2020 janë pranuar të gjitha rekomandimet për zhdëmtim duke ngarkuar për ndjekje të këtij rekomandimi Drejtorinë e Financës dhe të Ardhurave.

Për arkëtimin e shumës së mësipërme deri më datën e akt verifikimit të zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, nr. 606/9, datë 30.12.2019, prot. hyrje ne Bashkinë Berat nr. 4378/7, datë 06.01.2020, është vepruar si më poshtë:

-Me shkresën e Kryetarit të Bashkisë Berat z. E. D. nr. 2339, prot, datë 26.05.2020 është njoftuar subjekti “K... 04” me administrator z. Gj. Zh., për të zhdëmtuar shumën **188,400 lekë** si detyrim i sigurimit të kontratës nga mos lidhja e kontratës nga ky i fundit.

- Nga subjekti, deri në periudhën e auditimit nuk është arkëtuar detyrimi i mësipërm.

- Nga Drejtorja e Financës dhe të Ardhurave të Bashkisë Berat me shkresën nr. 2357, datë 24.05.2020 i është drejtuar Drejtorisë Juridike të Bashkisë Berat, për ndjekjen e procedurave ligjore (ngritjen e padive), për të bërë të mundur vjeljen e detyrimit të mësipërm.

Konstatohet se në vijim të shkresës së sipërcituar Drejtorja Juridike ka vazhduar procedurat ligjore dhe me shkresën nr. 5284 prot datë 29.10.2020 i është drejtuar Gjykatë Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, konfirmuar flet thirrje së gjykatës me nr. akti 1355 datë 13.11.2020. Ky rekomandim do të konsiderohet i zbatuar dhe realizimi në proces.

Në proces zbatimi

6.1. Rekomandim: Të merren masa nga Bashkia Berat, që t’i kërkojë Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE) “T...” SHPK & “B... B” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit të punimeve në kontratën me nr. 2538 prot, datë 13.04.2016, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative që, shuma prej **1,015,500 lekë pa TVSH të realizohet në objekt brenda periudhës së garancisë së defekteve**. Realizimi i punimeve duhet të konfirmohet zyrtarisht nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia Berat, Mbikëqyrësi i punimeve si dhe Kolaudatori i punimeve të objektit (Në rast të kundërt, moskryerja e punimeve sipas Projektit të Zbatimit dhe specifikimeve teknike, do të konsiderohet dëm ekonomik dhe duhet të zhdëmtohet nga sipërmarrësi i punimeve).

2.6.2 Nga verifikimi rezultoi se: Deri në momentin e auditimit datë 15.04.2022 nuk është marrë objekti në dorëzim (Nuk është marrë certifikata përfundimtare e marrjes ne dorëzim të punimeve). Pra nuk është ciluar 5 % i garancisë së riparimit të defekteve që mund të lindin në objekt për periudhën 2 vjecare të garancisë pas periudhës të marrjes së përkohshme të punimeve. (punimet janë në proces, bashkëlidhur certifikata e garancisë më datën 10.10.2018, afati i garancisë për 2 vjet deri më datën 10.10.2020, bashkëlidhur edhe akt verifikimi datë 14.08.2020 dhe fleta e parë e kontratës nr.2538, datë 1304.2016).

Në proces zbatimi

(Në mënyrë të përmbledhur zbatimi i masave të rikërkuara paraqitet në aneksin nr. 2 pika 7 bashkëlidhur projekt raportit të auditimit)

Kriteri: Ligji Nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15, “Të drejtat e KLSH”, germa j), Shkresa Nr 601/56 datë 04.12.2020 “Për zbatimin e rekomandimeve të rikërkuara, në Bashkinë Berat”.

Shkaku: Mos ndjekja e gjitha procedurave për të bërë të mundur arkëtimin e vlerës 1,015,500 lekë.

Ndikimi/Efekti: Ndikon në të ardhurat e buxhetit të Bashkisë Berat.

Rëndësia: *E Lartë*

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Berat të analizojë situatën e mos zbatimit plotësisht të rekomandimeve të dërguara nga KLSH-ja me shkresën Nr. 601/56 datë 04.12.2020, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave përgjegjës, si dhe të hartojë plan pune të veçantë e të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për rizbatimin e plotë të tyre.

8. Të ndryshme të dala gjatë auditimit

Ankesa nr. 1 Objekti i këtij verifikimi është ankesat e paraqitura nga znj. D. B. në institucionin e Kontrollit të Lartë të Shtetit si vijon;

-Shkresa nr. 173/2, datë 25.02.2021 drejtuar Kontrollit të Lartë të Shteti

-Shkresa nr. 738, datë 30.06.2021 drejtuar Kontrollit të Lartë të Shteti

-Shkresa nr. 738/7, datë 06.08.2021 drejtuar Kontrollit të Lartë të Shteti

Kronologjia e ngjarjes

Bashkia Berat në vijimësi të korespondencës lidhur me problematikën e qytetares znj. D. B. për ndërtimin pa leje të qytetarit z. R. B. mbi ndërtesën e saj private, Bashkisë Berat i është drejtuar me ankesë znj. D. B., banuese në Berat, në Lagjen “Muzakaj”, për ndërtimin e një objekti nga z. R. B., mbi banesën e saj, i cili rrezikon edhe shembjen e banesës. IMT, Bashkia Berat, me shkresën nr. 2870/1 prot, datë 31.05.2018, njoftoi znj. D. B. se punimet të cilat po kryheshin nuk janë punime të cilat kërkojnë leje ndërtimi. IMT së bashku me Kryeinspektorin e Policisë Bashkiake verifikuan në vend situatën dhe mbajtën procesverbal bllokimi me nr. Serie 003067, datë 04.06.2018, sipas të cilit u konstatua se:

z.R. B. po bënte suvatime të brendshme dhe dy kollona përforcuese.

Grupi i kontrollit vendosi:

Bllokimin e menjëhershëm të veprimtarisë ekonomike të subjektit për periudhën deri në përfundimin e aplikimit për ndërtim.

Me shkresën nr.2879/1 prot, datë 06.06.2018 njoftoi znj. D. B. se pas verifikimit në terren në datën 01.06.2018, vendosën pezullimin e punimeve në objektin e z.R. B. Në zbatim të kërkesës së znj. D. B., Ministria e Infrastrukturës dhe Energjitikës i ka dërguar Bashkisë Berat, Raportin Teknik (Ekspertizë teknike) për objektin në pronësi të z. A. dhe D. B.

IMT Bashkia Berat kërkoi informacion nga Agjensia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Berat lidhur me objektin dhe rezultoi se objekti ishte në proces legalizimi me dosjen nr.4843, datë 04.12.2014.

Me shkresën e datës 24.06.2019, nr.3000/2 prot, Drejtoria e Përgjithshme e ASHK-së, i drejtohet Drejtorisë Vendore të ASHK-së Berat, për marrjen e masave për trajtimin dhe vlerësimin e pajtueshmërisë së objektit informal me kriteret kualifikuese për legalizim, bazuar në VKM nr.820, datë 01.04.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshmërisë për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesa anësore dhe /ose në lartësi, në ndërtimet pa leje”, i ndryshuar.

IMT, Bashkia Berat, me shkresën e datës 10.06.2019, i ka kërkuar ASHK-së Berat të shprehet lidhur me legalizimin ose jo të objektit informal si dhe me shkresën e datës 24.09.2019, nr.4861 prot, IMT kërkon të merren masa për vlerësimin e pajtueshmërisë së objektit informal, bazuar në ligjin nr.9482, datë 03.04.2006, “Për legalizimin e, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar dhe VKM nr.280, datë 01.04.2015 “Për

përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtimet me leje, i ndryshuar.

Agjensia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Berat, me shkresën nr.2966 prot, datë 12.06.2020 merr vendimin e skualifikimit të objektit informal nga procesi i legalizimit, pasi ky objekt nuk i plotëson kriteret kualifikuese.

Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Berat, nga verifikimet e shumta që ka bërë në objektin përkatës, për shkak të terrenit të vështirë në të cilin ndodhet objekti, mungesës së mjeteve dhe burimeve njerëzore, e ka patur të pamundur të marrë masa pasi rrezikohen një sërë ndërtesash të tjera përreth ndërtesës përkatëse. Për këtë arsye Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Berat, i është drejtuar Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit me shkresën nr.4520 prot, datë 22.09.2020, duke i kërkuar bashkëpunim në sigurimin e mjeteve dhe burimeve njerëzore për të kryer ndërhyrjen në objekt. Më pas, me shkresën nr.6141 prot, datë 24.12.2020, i është drejtuar Drejtorisë së Planifikimit Urban, Lejeve dhe Monitorimit të Investimeve, Bashkia Berat, ku i kërkon mjetet e nevojshme dhe punonjës të specializuar në fushën e ndërtimit në mënyrë që të kryhet prishja e objektit informal dhe ti jepet përfundimisht zgjidhje këtij problemi.

Bashkia Berat, me shkresë nr. 3680 prot., datë 12.07.2021 i është drejtuar z. A. B., bashkëshortit të shtetasës znj. D. B. ku e njofton për fillimin e procedurës për zhvendosjen nga vendbanimi për shkak të zbatimit të vendimit për prishjen e objektit nr.278 datë 07.07.2021, pasi banesa e tij ndodhet poshtë këtij objekti dhe është e rrezikuar. Procedurat e zhvendosjes kanë vazhduar duke u gjetur një vendbanim për këtë shtetase dhe Bashkia Berat subvencionon kontratën e qirasë. Aktualisht kjo shtetase bashkë me bashkëshortin janë zhvendosur nga banesa e rrezikuar.

Ndërsa për sa i përket shtetasit z. R. B., Bashkia Berat, me shkresën nr.3681 prot., datë 12.07.2021 i është drejtuar këtij shtetasi ku e njofton për fillimin e procedurës për zhvendosjen nga vendbanimi për shkak të zbatimit të vendimit për prishjen e objektit nr.278 datë 07.07.2021, por ky shtetas nuk pranon të zhvendoset nga banesa e tij.

Në bazë të Vendimit nr.361 datë 29.05.2019 *“Për përcaktimin e procedurave të zhvendosjes së individëve\ familjeve nga vendbanimi a strehimi i tyre, në rastet të parashikuara në ligj, dhe të bashkëpunimit institucional”*. Bashkia Berat po vazhdon kryerjen e të gjitha hapave të nevojshme që nga njoftimi i personave që do zhvendosen nga objekti, kërkimi i një banese për strehim, kontaktimin me persona privatë pasi prej tre vitesh në Bashkinë Berat nuk kemi të regjistruar asnjë banesë private, ndërsa banesat sociale janë të gjitha të banuara nga persona në nevojë.

Siç e theksuam edhe më lart, personi nuk pranon të largohet nga shtëpia edhe pse Bashkia Berat është në kontakte të vazhdueshme me agjenci imobiliare për të gjetur një banesë, por ende nuk ka dakortësi në çmim pasi e tejkalon fondin e përcaktuar me ligj për subvencionimin e qirasë.

Bashkia Berat me urdhër të Kryetarit të Bashkisë nr.400 datë 12.07.2021 (bashkëlidhur), ka ngritur një grup pune për fillimin e procedurave për zhvendosjen e familjeve nga vendbanimet e tyre në një ambient të përshtatshëm në mënyrë që të realizohet prishja e objektit. Paralelisht IMT ka ndjekur procedurat me mbajtjen e proces-verbalit, vendimit për dënimin me gjobë dhe vendimin për prishje të objektit, (bashkëlidhur), si dhe shkresën nr.3581 prot., datë 07.07.2021 për njoftimin e këtij vendimi (bashkëlidhur). IMT i ka kërkuar bashkëpunim dhe mbështetje edhe drejtorive të tjera në Bashkinë Berat, konkretisht, Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Policisë Bashkiake, Drejtorisë së Emergjencave Civile si dhe Drejtorisë së Shërbimit Social (bashkëlidhur). Bashkia Berat, me shkresën nr. 3680 prot., datë 12.07.2021 (bashkëlidhur), i është drejtuar z. A. B., bashkëshortit të shtetasës znj. D. B. ku e njofton për fillimin e procedurës për zhvendosjen nga vendbanimi për shkak të zbatimit të vendimit për prishjen e objektit nr.278 datë 07.07.2021, pasi banesa e tij ndodhet poshtë

këtij objekti dhe është e rrezikuar. Proçedurat e zhvendosjes kanë vazhduar duke u gjetur një vendbanim për këtë shtetase dhe Bashkia Berat subvencionon kontratën e qirasë. Aktualisht kjo shtetase bashkë me bashkëshortin janë zhvendosur nga banesa e rrezikuar.

Ndërsa për sa i përket shtetasit z. R. B., Bashkia Berat, me shkresën nr.3681 prot., datë 12.07.2021 (bashkëlidhur), i është drejtuar këtij shtetasi ku e njofton për fillimin e proçedurës për zhvendosjen nga vendbanimi për shkak të zbatimit të vendimit për prishjen e objektit nr.278 datë 07.07.2021, por ky shtetas nuk pranon të zhvendoset nga banesa e tij. Kjo zhvendosje do të kryhet sipas Vendimit nr.361 datë 29.05.2019 *“Për përcaktimin e proçedurave të zhvendosjes së individëve/familjeve nga vendbanimi a strehimi i tyre, në rastet të parashikuara në ligj, dhe të bashkëpunimit institucional”*, ku përcaktohen mënyra dhe afatet e zhvendosjes. Më pas, me shkresën 3681\1 datë 16.09.2021 (bashkëlidhur), Bashkia Berat e njofton këtë shtetas se ka marrë me qira një ambient për strehimin e familjes së tij në një apartament me strukturë 1+1, kati i katërt, pallat5kt, lagjja “Kushtrim” dhe i kërkon të paraqitet pranë kësaj bashkie për kryerjen e proçedurave të mëtejshme ligjore.

Konstatohet se

Aktualisht, IMT ndodhet në proces gjyqësor me shtetasin z. R. B. me objektin: “Pezullimin e akteve administrative nr. 278 datë 07.07.2021 për prishjen e objektit të Kundërligjshëm” si dhe aktin nr.197 datë 07.07.2021 “Vendim për Dënimin me Gjobë”. IMT, në datën 20.09.2021 me shkresën protokolluar në Bashkinë Berat nr.4642, është njoftuar nga avokatja e shtetasit z. R. B. mbi pranimin e kërkesës së paditësit për marrjen e masës së sigurimit të padisë dhe pezullimin e zbatimit të vendimit nr.278 datë 07.07.2021 “Për Prishjen e objektit të Kundërligjshëm”, nxjerrë nga IVMT Bashkia Berat.

Në zbatim të nenit 36 të Kodit të Proçedurës Civile, sipas të cilit “Asnjë institucion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje civile që është duke u gjykuar nga gjykata” Për këtë arsye, grupi i auditimit në Bashkinë Berat, nuk mund të shprehet për ankesën tuaj.

Ankesa nr. 2 Objekti i këtij akt verifikimi është ankesat e paraqitura nga z. K. L. përfaqësuar nga avokati z. R. N. në institucionin e Kontrollit të Lartë të Shtetit si vijon;

-Shkresa nr. 293/1, datë 21.04.2021 protokolluar në Kontrollit të Lartë të Shteti

-Shkresa nr. 640, datë 04.06.2021 protokolluar në Kontrollit të Lartë të Shteti

Kronologjia e ngjarjes në mënyrë të përmbledhur:

Pretendimet e paraqitura nga z. R. N.

Në vazhdim të shkresës nr. 2472/1prot, datë 14.05.2021 dërguar nga Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Berat, në Kontrollin e Lartë të Shtetit, po bëj sqarimet e mia në lidhje me të pavërtetat e kësaj shkrese deri në elementët e falsifikimit.

Procesverbali i mbajtur nga dy inspektorët, vërteton se kemi të bëjmë me një letër bakalli, i cili nuk sqaron se për cilën lejë është mbajtur ky procesverbal (nr. 2020/4 datë 05.06.2019 apo nr. 2707 datë 28.06.2019). Në këtë procesverbal është sqaruar me një rresht të gjithë veprimtarinë kriminale, që po ndodh me atë ndërtim, i cili po zhvillohet mbi pronë private të ligjshme.

Leja 2020/4 datë 05.06.2019 që është bashkëngjitur, pavarësisht se janë në kundërshtim flagrant me ligjin, është "lejë për rikonstrukcion pa ndryshim funksioni", ndërkohë në datën 28.07.2020 është prishur objekti totalisht pa asnjë lejë prishje dhe nuk është marrë asnjë masë nga IMT Berat.

Këtë e vërteton procesverbali i mbajtur nga oficeri i policisë gjyqësore, pranë komisariatit të Beratit, i dorëzuar tashmë në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Berat.

➤ Në këtë procesverbal "nr. 1 datë 15.12.2020" është korrigjuar emri i subjektit, gjë e cila të bën të dyshosh që nuk është mbajtur në terren për subjektin G., por mund të jetë përdorur procesverbali i një subjekti tjetër.

➤ leja nr. 2707 dalë 28.06.2019 është brenda afatit 24 mujor dhe ku është bërë njoftim për fillimin e punimeve me nr. 4009/2 datë 06.08.2019, ndërkohë që leja shprehet qartë në diapozitivin e saj, pika 3 dhe 4.

➤ Pika 3 thotë që "afati i fillimit të punimeve është deri në një vit nga data e lëshimit të kësaj leje. Kjo lejë është e pavlefshme nëse zhvilluesi nuk fillon punimet e ndërtimit brenda afatit një vjeçar pas lëshimit të saj, bazuar në nenin 40 të ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014, për planifikimin dhe zhvillimin e territorit.", ndërkohë që mbi pasurinë "ish menca" kanë filluar punimet në datën 28.07.2020, që i bie një vit e një muaj më vonë nga data e dhënies së lejes. Ndërkohë që mbi pasurinë "ish menca" ka pronë private të kthyer me vendimin e komisionit, ka të drejtë parablerje për objektin, ku me prishjen e objektit na kanë hequr dhe mundësinë e të drejtës së parablerjes, por edhe apartament mbi mencë me lejë ndërtimi të më përparshme nga po Bashkia Berat.

➤ Pika 4 e diapozitivit të lejes së ndërtimit m. 2707 datë 28.06.2019 shprehet se " nëse ndërtimi ka filluar pas kalimit të afatit njëvjeçar apo vijon edhe pas përfundimit të afatit të përfundimit të punimeve, punimet konsiderohen të paligjshme", ndërkohë pas ankesës time të bërë në mënyrë sistematik që nga 30.07.2020, për shkatërrimin e pronës private nuk është marrë asnjë masë as nga Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit, as nga Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit.

Përsa i përket lejes nr. 2020/4 e cila kishte tejkalar afatet për përfundimin e punimeve" ju sqaroj se kjo leje si leja e mësipërme jo vetëm që kishte kaluar afatet, por kjo lejë:

a. Është dhënë për zhvillues Bashkinë Berat me titull leje "Lejë ndërtimi për rikonstrukcion pa ndryshim funksioni". Në datën 28.07.2020 në mëngjes në mënyrë të dhunshme dhe në kushtet e flagrancës është shkatërruar veranda e z. K. L. që ishte dhe soleta e ish mensës, pa një lejë prishje dhe nga persona të paidentifikuar. Në fillim të prishjes së objektit por dhe në fund nuk u vendos asnjë tabelë ku të vendoseshin të gjitha të dhënat e nevojshme të përcaktuar me VKM. Ashtu siç ishte përcaktuar dhe në titull të lejes nuk kishim të bënim me rikonstrukcion të katit të parë, por me shkatërrimin total të gjysmës së katit të parë i cili kishte konstrukcion gur me murre mbajtës.

Nga kjo ndërhyrje brutale dhe pa asnjë procedurë teknike, ka dalë jashtë funksionit kati i dytë i z. K. L. i cili ka pësuar plasaritje të mureve si dhe ka humbur qëndrueshmërinë e tij. Procesverbali i mbajtur nga policia që i është deleguar prokurorisë Berat por dhe fotot më poshtë vetëtojnë këto që po them.

b. Gjoha e vendosur me nr. 188 datë 15.12.2020, për subjektin "G..." shpk ose është vendosur për lejen 2020/4 datë 05.06.2019 e Cila është për Bashkinë Berat ose është vendosur për lejen 2707 datë 28.06.2019, pasi as në procesverbal as në gjobë nuk është specifikuar për cilën lejë është konstatuar shkelja.

Nuk e besoj që gjoha e paguar nga "G..." shpk të jetë vendosur për një lejë që i është dhënë Bashkisë Berat. Pretendimi në shkresë se subjekti ka bërë pagesën e gjobës nuk qëndron, pasi leja 2020/4 është dhënë me zhvillues Bashkinë Berat.

Përsa më sipër për të hetuar pretendimet në shkresë në kundërshtim me çfarë është shkrojtur në procesverbal dhe gjobë ngelet të hetojë Prokuroria e Beratit.

Të nderuar drejtues, unë besoj që hije ditë drejtësie do triumfojë përpara kësaj veprë kriminale, që ka ndodhur në qendër të Beratit, e cila është 150 metra nga Policia e rrethit të Beratit, 213 metra nga Bashkia Berat, 114 metra nga Prokuroria e Rrethit Berat dhe 35 metra nga Gjykata e Rrethit Berat, ku është shkatërruar një pronë e ligjshme shekullore dhe ku institucionet heshtin.

1. Vazhdojë të ngelem në pritje të reagimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, për të hetuar këtë shkelje të Bashkisë Berat, ku një sipërfaqe ndërtimi "ish konvikti i vajzave 3 kat", që i ka kaluar bashkisë me kusht për ta përdorur për realizimin e programeve arsimore është dhënë me emfiteozë për hoteleri-turizëm duke anashkaluar pronarin legjitim të trajtuar me Vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave nr. 348 datë 23.02.1996.

2. Vazhdojë të ngelem në pritje të reagimit nga Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, për të hetuar dhe parandaluar mosveprimin e IMT Berat si dhe për të pezulluar punimet, referuar nenit 9 pika a dhe nenit 10 të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 ndërhyrjen e Inspektoriatit Kombëtar Mbrojtjes së Territorit, pasi zona ku unë kam shtëpinë dhe është shkatërruar është zonë e "Trashëgimisë Kulturore dhe Muzetë".

3. Vazhdojë të ngelem në pritje të reagimit nga Inspektoriati Mbrojtjes së Territorit, për tu kthyer në ligjshmëri, pasi mbyllë sytë në favor të zaptuesit duke i dhënë kohë që të ngrihet objekti, pavarësisht se rrënohet prona e ligjshme me lejë ndërtimi nga e njëjta bashki 15 vjet re parë.

4. Vazhdojë të ngelem në pritje nga Policia e Shtetit Shqiptar, për të ushtruar kompetencat e saj për mbrojtjen e territorit, pasi në pasurinë time ka më shumë se një vit që ndërhyhet duke e pushtuar në kundërshtim me ligjin.

Nga auditimi i ushtruar në Bashkinë Berat sipas Programit të Auditimit nr. 55 datë 18.01.2022 protokolluar në Bashkinë Berat me shkresën nr. 326 prot datë 19.01.2022 u konstatua se Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkalles së Pare Berat, ka reregjistruar procedimin penal me numër 506 viti 2020 për veprën penale "Shkatërrimi i pronës" parashikuar nga neni 150 i Kodit Penal, me kallëzues shtetasin z. K. L. dërguar Bashkisë Berat me shkresën nr. 2666/1 prot datë 26.07.2021 ku i kërkon informacion Bashkia Berat në lidhje me procedurën e ndjekur në miratimin e lejes me nr. 2020/4 date 05.06.2019 "Leje ndërtimi për rikonstrukcion pa ndryshim funksioni" për objektin në pasurinë me numër 12/140, objekti cili i është dhënë me emfiteoze "G..." SHPK me 14.08.2018. Gjithashtu çështja ndodhet në gjykatë referuar nr. të çështjes 31157-02020-84-2020. **Theksojmë faktin se në zbatim të nenit 36 të Kodit të Procedurës Civile, theksohet fakti se "Asnjë institucion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje civile që është duke u gjykuar nga gjykata"** Për këtë arsye, grupi i auditimit në Bashkinë Berat, nuk mund të shprehet për këtë ankesë.

GJETJET DHE REKOMANDIMET

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Bashkia Berat nuk ka ngritur një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash të shkruara për këtë qëllim. Në rregulloren e brendshme nuk janë përcaktuar qartë detyrat dhe funksionet për çdo pozicioni pune, nuk është bërë përditësimi i saj duke mos reflektuar ndryshimet strukturore të bëra për periudhën objekt auditimi. Edhe pse janë miratuar regjistrat e riskut, bashkia nuk ka hartuar një strategji në menaxhimin e riskut, nuk ka politika dhe praktika që të garantojnë ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të stafit, duke u mjaftuar vetëm me trajnimet e organizuara nga ASPA, duke mos hartuar dhe zhvilluar programe trajnimesh në njësinë vendore. Nuk janë hartuar programe për ngritjen dhe zhvillimin profesional të stafi si dhe nuk janë planifikuar pozicione me status "ekselent", si dhe pozicione me status "Grup i veçantë", ku përfshihen 17 kategori të ndryshme. Grupi i Menaxhimit Strategjik, nuk ka miratuar plane zhvillimi strategjike me afat jo më pak se sa 5 vjet, nuk ka programe të licencuara e për rrjedhojë programet me të cilat punohet nuk garantojnë mbrojtjen e të dhënave të sistemit elektronik. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", neni 16, 20, 21, 22, nenin 32 të ligjit nr. 68/2017" Për financat e vetëqeverisjes. vendore",

urdrin e Kryeministrit nr.164 datë 05.10.2017. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqet 14-23 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1. Rekomandim: Nga Kryetari i Bashkisë Berat të merren masa për njohjen nga stafi të ligjit për MFK dhe manualit përkatës të tij, për hartimin dhe miratimin e strategjisë të risqeve, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit, të hartohet dhe të miratohet gjurma e auditimit me qëllim menaxhimin e riskut.

1.2. Rekomandimi: Nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore të merren masa për përditësimin e rregullores duke përcaktuar qartë detyrat dhe funksionet për çdo pozicioni pune, të hartojë programe të trajnimeve për ngritjen profesionale të stafit.

Deri më 31.10.2022

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të veprimtarisë së njësive së auditit të brendshëm, u konstatua se kjo njësi ka ushtruar veprimtarin e saj me 2 auditues, nga 3 që përcakton kuadri ligjor. Nuk është realizuar numri i auditimeve konform planit vjetor të auditimeve dhe planeve strategjike të miratuara.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 114/2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqet 14-23 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Berat të marrë masa për plotësimin e strukturës së njësive së auditit të brendshëm me tre punonjës dhe kjo strukturë të realizojë numrin e auditimeve të planifikuara në planet vjetore.

Deri më 31.10.2022

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatohet se realizimi i shpenzimeve buxhetore me të ardhurat e vetë Bashkisë Berat së bashku me transfertat e pa kushtëzuara, për vitin 2020 dhe vitin 2021 kanë diferencë të dukshme me vlerën e planifikuara.

Për vitin 2020 planifikimi i shpenzimeve ka vlerën 1,134,803 mijë lekë, ndërsa realizimi vlerën 816,589 mijë lekë, ose në masën 72%, ndërsa për vitin 2021 planifikimi i shpenzimeve ka vlerën 1,256,645 mijë lekë, realizimi 979,512 lekë, ose në masën 78%.

Niveli i realizimit të investimeve të planifikuara, i cili është zëri më kryesor i buxhetit në lidhje me ndikimin që ka në ofrimin e të mirave publike ndaj komunitetit, është akoma më i ulët se mesatarja e realizimit të buxhetit. Për vitin 2020 investimet janë planifikuara në vlerën 174,671 mijë lekë, realizuar 89,288 mijë lekë, ose në masën 51 %, ndërsa për vitin 2021, vlera e planifikuara është 282,200 mijë lekë, realizuar 155,906 mijë lekë, ose në masën 55 %.

Ky mos realizim vjen si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave, që do të thotë se nga Bashkia Berat në fillim të vitit buxhetor planifikohen angazhime buxhetore, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifave vendore dhe ky planifikim nuk korrigjohet gjatë vitit, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat reale të realizuara. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me pikën (a) të nenit 5, si dhe nenin 46 të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën nr.2.1, faqe 24-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

3.1.Rekomandim: Bashkia Berat, nëpërmjet Drejtorisë së Menaxhimit Financiar dhe Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrë masa për një planifikim të studiuar të të ardhurave të veta, duke u mbështetur mbi parashikime të studiuar dhe realiste. Mbi bazën e këtyre të ardhurave të parashikohet edhe plani investimeve publike, me qëllim që investimet e planifikuara në buxhet të kenë burime financimi të sigurta për tu realizuar.

Në vijimësi

4.Gjetje nga auditimi: Vlera e detyrimeve të prapambetura me burim financimi të ardhurat e veta në datën 31.12.2021 është 95,527,220 lekë, krahasuar me vlerën në fillim të vitit ushtrimor prej 142,082,430 lekë, është ulur me 46,555,210 lekë, ose në masën prej 33%.

Edhe pse janë marrë masa të mira për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura gjatë vitit 2021, konstatohet fenomeni i krijimit të detyrimeve të reja gjatë vitit buxhetor për të gjithë periudhën e auditimit. Peshën kryesore të detyrimeve që kanë si burim financimi të ardhurat e veta e zënë ato për investime prej 75,938,443 lekë, të ndjekura nga detyrime për mallra në vlerën 11,002,467 lekë, detyrime për zbatimin e vendimeve gjyqësore në vlerën 4,954,630 lekë, detyrime për shërbime në vlerën 3,380,140 lek, të tjera 251,540 lekë.

Detyrimet e prapambetura janë krijuar nga mos realizimi i të ardhurave dhe nga marrja e angazhimeve buxhetore pa pasur fonde në dispozicion, veprime të cilat janë në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të MFE nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 153-162, Rubrika - Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike, detyrimet kontraktuale midis palëve, nenin 52 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, pikat 82-91. *(Më hollësisht trajtuar në pikën nr.2.1, faqe 24-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

4.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Berat dhe Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave, të marrin masa për likuidimin e vlerës së kontratave të lidhura midis Bashkisë Berat dhe kontraktorëve, sipas afateve të përcaktuar në kontratë, duke eliminuar në këtë mënyrë shkakun e krijimit të detyrimeve të prapambetura. Lidhja e kontratës të bëhet vetëm pasi fondi që parashikon procedura e prokurimit do të jetë në dispozicion (në llogarinë e thesarit) të autoritetit kontraktor. Për çdo procedurë prokurimi, urdhri i prokurimit të depozitohet menjëherë në degën e thesarit përpara zhvillimit të procedurës.

Menjëherë dhe në vijimësi

5.Gjetje nga auditimi: Konstatohet se Bashkia Berat nuk ka krijuar Sektor të Masave Shtrenguese si një nga sektorët më të rëndësishëm në arkëtimin e të ardhurave pasi në këtë institucion evidentohet një numër i lartë i detyrimeve të, prej 15,154 taksapagues të kategorisë familjare dhe private në vlerën 236,557 mijë lekë.

Gjithashtu konstatohet se struktura organizative e Drejtorisë së të Ardhurave Vendore nuk është plotësuar me të gjithë specialistët, pasi mungojnë në këtë strukturë specialisti për kontrollin e biznesit, specialisti për taksat dhe tarifatat në Njësinë Administrative Sinje, agjenti për arkëtimet e taksave dhe tarifave të familjeve dhe bizneseve në Njësinë Administrative Otllak, mangësi të cilat ndikojnë në realizimin e objektivave në arkëtimin e të ardhurave.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me pikën (ç) të nenit 5 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar dhe në Kreun XI- “Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar”, nenet 88 – 104, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH” me ndryshime, si dhe Rregullore e Brendshme miratuar me shkresën nr. 737 prot datë 07.02.2018. *(Më hollësisht trajtuar në pikën nr.2.2, faqe 49-59 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

5.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Berat në bashkëpunim me Drejtoria e Burimeve Njerëzore të marrë masa për plotësimin e stafit të Drejtorisë së të Ardhurave Vendore me të gjithë specialistët që ka miratuar në strukturë si dhe të krijohet Sektor të Masave Shtrenguese.

Brenda vitit 2022

6.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatuan diferenca të dukshme midis planifikimit dhe realizimit të të ardhurave. Për vitin 2019 të ardhurat nga 503,966 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 307,716 mijë lekë ose në masën 61 %, për shkak të mosrealizimit në zëra të veçantë si taksa e rentës, taksa e ndikimit në infrastrukturë etj...

Për vitin 2020, planifikimi është në vlerën 528,209 mijë lekë dhe realizimi në vlerën 333,588 mijë lekë ose 63 %.

Gjatë auditimit është konstatuar se tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël paraqitet me ulje nga njëra periudhë në tjetër (2020/2021), për vlerën **4,800 mijë lekë**, taksat vendore me rritje nga njëra periudhë në tjetër (2020/2021), për vlerën **4,479 mijë lekë**, tarifatat vendore me ulje nga njëra periudhë në tjetër (2020/2021), për vlerën **46,400 mijë lekë**, ulje dhe ngritje të cilat janë të pa shoqëruara me argumentim nga Bashkia Berat.

Për vitin 2021, Bashkia Berat nuk ka miratuar paket të re fiskale por ka ushtruar aktivitetin me paketën fiskale të vitit 2020, miratuar me VKB nr. 60, datë 18.12.2019.

Për vitin 2021 të ardhurat nga 500,173 lekë të planifikuara, janë realizuar në vlerën 412,173 mijë lekë ose 82 %.

Për vitin 2021, ka pasur mos realizim në vlerën 87,938 mijë lekë, kryesisht në taksat e popullatës, si taksa e tokës bujqësore, taksa e ndërtesës dhe tarifa e pastrim-gjelbërimit.

Veprime dhe mosveprime bien në kundërshtim me Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligji nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 64, “Kompetencat dhe detyrat e kryetarit të Bashkisë”; ligji nr. 68/2017 datë 27.4.2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” i ndryshuar, neni 5, “Parime dhe rregulla të disiplinës fiskale dhe të financimit të funksioneve vendore”, neni 42, “Administrimi i mjeteve monetare”, pika 1, 2 dhe 4; neni 54, “Raportimi financiar” nën-pika c, UMFE nr. 9 datë 20.03.2018, Kreu IV “Procedurat standarde për menaxhimin e të ardhurave” pika 200, UMFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kreu III, pika 32, Kreu II pika 2/a, b; Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar, ligji nr. 9920, datë 19/5/2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën nr.2.1, faqe 24-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

6.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Berat dhe Drejtoria e të Ardhurave të marrin masa për një planifikim sa më realist të të ardhurave, mbështetur në realizimet faktike të viteve të mëparshëm dhe në numrin e taksapaguesve, me qëllim që të zvogëlohet sa më shumë diferenca midis planifikimit dhe realizimit të të ardhurave. Kjo shmang edhe marrjen e angazhimeve buxhetore mbi bazën e një plani të pa realizueshëm në fakt.

Menjëherë dhe në vijimësi

7.Gjetje nga auditimi: Nga të dhënat e paraqitura nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, të ardhurat nga agjentët tatimorë (Drejtoria Rajonale Tatimore Berat, në lidhje me tatimin e thjeshtuar mbi fitimin; Drejtoria e Përgjithshme të Buxhetit, pranë Ministrisë së Financave, në lidhje me rentën minerare; AKSH-ja, në lidhje me taksën e ndikimit në infrastrukturë dhe DRSHTRR Berat, në lidhje me taksën vjetore të mjeteve të përdorura), derdhen automatikisht në fund të çdo muaji, për llogari të Bashkisë Berat nuk ka krijuar bazë të plotë të dhënash për detyrimet që vilen nëpërmjet agjentëve tatimorë, në bazë të të cilave të bëjë akt-rakordimet. Në lidhje me mosrealizimet e taksave nga agjentët tatimorë, Bashkia Berat, duhet të marrë masa për evidentimin e diferencave të pa mbledhura sipas llojit të taksës/tarifës, të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj dhe të fillojë procedurat për gjobitjen e këtyre agjentëve tatimorë me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pa arkëtuara apo të shmangura sipas Nënin 117⁴ të ligjit nr. 9920, dt.

⁴ “Agjenti i mbajtjes së tatimit në burim, agjenti i taksave apo tarifave, që nuk arrin të mbajë, të llogarisë, të raportojë dhe të transferojë në Buxhetin e Shtetit tatimin në burim apo tatimet, taksat dhe tarifatat e mbledhura, apo i shmangët mbledhjes së tyre, detyrohet të paguajë gjobë të barabartë me 50 për qind të shumës së plotë të tatimit, taksës apo tarifës së pambledhura apo të shmangur.”

19.5.2008, “Për Procedurat Tatimore”, ku parashikohet se “Dënimet për agjentët e mbajtjes së tatimit në burim, agjentët e taksave dhe agjentët e tarifave”.

Për rentën minerare, e cila rrjedh nga eksportet nuk është bërë rakordimi periodik i rregullt mujor me Drejtorin e Doganave dhe nuk mbahet korrespondencë me Ministrinë e Financave.

Për rentën e cila rrjedh nga shitjet brenda vendit, nuk mbahet korrespondenca me Ministrinë e Financave dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 7 “Të drejtat dhe detyrimet e agjentit të mbajtjes së tatimit” dhe me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 15 “Parapagimi”, si dhe me UMF nr. 26, datë 04.09.2008 “Për taksat Kombëtare (Më hollësisht trajtuar në pikën nr.2.2, faqe 49-59 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1.Rekomandim: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrë masa për të kryer rakordimin periodik mujor me agjentët tatimorë, për të evidentuar gjendjen reale të të ardhurave që përfiton Bashkia Berat nga taksat që mbledhen nga këta agjentë. Për agjentët tatimorë që nuk realizojnë mbledhjen e saktë të ardhurave, Bashkia të fillojë procedurat për penalizmin e tyre me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pa mbledhura apo të shmangura..

Menjëherë dhe në vijimësi

8.Gjetje nga auditimi: Në fund të vitit 2021 gjendja e llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm”, paraqitet në vlerën 365,251,315 lekë, e cilat përfaqësojnë detyrimet e të tretëve ndaj Bashkisë Berat. Nga analiza e llogarisë konstatohet se për vlerën 62,019,852 lekë, e trashëguar nga vitet e mëparshme, nuk ka dokumentacion me pretendimin se është e trashëguar nga ish komunat qysh nga vitit 2015. Drejtoria e Financës nuk ka marrë masa për evidentimin e këtyre debitorëve dhe arkëtimin e kësaj vlere, veprime dhe mosveprime në kundërshtim me UMFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësisive të Qeverisjes së Përgjithshme”, kapitulli II, pika 6. (Më hollësisht trajtuar në pikën nr.3, faqe 60-76 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

8.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës të marrë masa për evidentimin e debitorëve ndaj Bashkisë Berat në vlerën 62,019,852 lekë, për të cilën deri tani mungon dokumentacioni analitik.

Deri më 31.10.2022

9.Gjetje nga auditimi: Gjendja e llogarisë 202 “Studime dhe kërkime” më 31.12.2020 paraqitet në vlerën 37,444,849 lekë, ndërsa më 31.12.2021 paraqitet në vlerën 52,591,859 lekë, me rritje prej 15,147,010 lekë. Nga analiza e kësaj llogarie u konstatua se vlera 52,591,860 lekë e aktiveve afatgjata jo materiale për 67 projekt-studime për investime të kryera nuk është shpërndarë sipas llojit të aktiveve materiale ku janë kryer investimet, pavarësisht se punimet kanë përfunduar dhe janë marrë në dorëzim në vitet e mëparshme. Për këto vlera duhet të kryhen veprimet kontabël për kalimin e vlerës së tyre si vlerë e shtuar çdo aktivi afatgjatë material mbi të cilën është kryer investimi mbi bazën e këtyre projekt-studimeve. Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me Udhëzim e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik” Pika 2. Klasa 2, “Aktivet afatgjata”. (Më hollësisht trajtuar në pikën nr.3, faqe 60-76 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

9.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës të kryejë veprimet e sistemimit në kontabilitet për shpërndarjen e vlerës së studim-projektiveve sipas investimeve të kryera dhe për çdo lloj aktivi afatgjatë material si pjesë e kostos së tij, duke kredituar llog. 202 “Studime dhe Kërkime” dhe debituar llogaritë përkatëse të klasës 21 për vlerat e mbetura koresponduese, në mënyrë që aktivet sipas llojit të paraqiten në vlerë të plotë.

Deri më 31.10.2022

10.Gjetje nga auditimi: Nga të dhënat ë vëna në dispozicion nga Drejtoria e Planifikimit Urban, Lejeve dhe Monitorimit të Investimeve rezulton se për periudhën objekt auditimi 01.10.2019 deri më 31.12.2021 në Bashkinë Berat rezultojnë 4 investime në proces që nuk janë mbyllur brenda vitit ushtrimor 2021, respektivisht: 1. Objekti - Ujësjiellësi Velabisht me vlerë kontrate 154,991,516 lekë; 2. Objekti - Ujësjiellësi i fshatit Duhanas, fshati Lapardha 1, Otlak dhe Orizaj, Bashkia Berat me vlerë kontrate 438,06,428 lekë; 3. Objekti - Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pa favorizuara me vlerë kontrate 32,130,929 lekë; 4. Objekti - Përmirësimi i shtresave rrugore në segmentet rrugore Rruga Antipatrea, Kryqëzimi Spitali Rajonal-Kryqëzimi i By Pass me vlerë kontrate 27,386,832 lekë.

Nga analiza e llogarisë 231 "Investime në proces" rezulton se Drejtoria e Financës nuk disponon dokumente analitike justifikuese në marrjen në dorëzim të objekteve sipas kontratave përkatëse, për të dokumentuar dhe vërtetuar vlerën e pasqyruar në pasqyrat e pozicionit financiar, të vitit 2021. Drejtoria e Financës ka bërë kapitalizmin e aktiveve për pjesën e parashikuar për tu likuiduar në buxhet dhe jo për vlerën e situacionit përfundimtar si dhe nuk disponon të dhëna analitike për objektet të cilat nuk janë marrë në dorëzim nga bashkia sipas aneksit nr. 10 pika 3. bashkëlidhur raportit të auditimit. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim të UMF nr. 8, datë 9.03.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme*", kapitulli II, pika 6; 11, aneksi 1, pika 2 Klasa 2, nënpika 2.1, paragrafi, - Trajtimi kontabël dhe funksionimi i grupit 20, "Aktive afatgjata materiale" dhe pika 33 dhe UKM nr. 2, datë 08.05.2003 "*Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit*", i ndryshuar dhe neneve 55 dhe 56, të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "*Për financat e vetëqeverisjes vendore*". (Më hollësisht trajtuar në pikën nr.3, faqe 60-76 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës të marrë masa për sistemimin në kontabilitet të llogarisë (231) në llogaritë (212) ose (213), sipas objekteve pasi një pjesë e tyre janë mbyllur dhe duhet të kapitalizohet në aktive afatgjata materiale.

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2022

11.Gjetje nga auditimi: Bashkia Berat në Qendrën Kombëtare të Biznesit, më 31/12/2022 paraqitet si aksionare me 65.32% të aksioneve të Ujësjiellës Kanalizime Berat SHA ndërsa paraqitet si aksionare me 34.68% të aksioneve të Ujësjiellës Kanalizime Berat SHA, me NUIS "J62...66T" e cila është shoqëri aksionare me objekt "Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij. Numri i aksioneve është 1,000 me vlerë nominale 876,860 dhe kapital në vlerë monetare prej 876,860,000 lekë. Referuar ekstraktit historik Bashkia Berat zotëron 572,787 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej 572,787,000 lekë, ose 65.32 % të aksioneve në pjesëmarrje të Bashkisë Berat në "Ujësjiellës Kanalizime Berat ShA. Referuar bilancit kontabël 2020-2021, më konkretisht në llogarinë 26 "Pjesëmarrje në kapitalet e veta" paraqitet në vlerën 79,075,000 lekë me një nënvlerësim të llogarisë 26 Pjesëmarrje në kapitalet e veta" në vlerën 797,785,000 lekë. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me Urdhrin e Ministrit nr. 64 datë 22.07.2014 "Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuar" me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5 "Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivët Afatgjata jo materialë" pika 55, 56, 57 si dhe me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr.14 "Trajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje". (Më hollësisht trajtuar në pikën nr.3, faqe 60-76 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

11.1.Rekomandimi: Nëpunësi zbatues të marrë masa për sistemimin në kontabilitet dhe regjistrimin e pjesëmarrjes 65.32% në kapitalin e aksioneve tek "Ujësjiellës Kanalizime Berat ShA me vlerë 572,787,000 lekë, në debi të llog. 26 "Pjesëmarrje në kapitalet e veta" dhe kredi të llogarisë financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2022

12.Gjetje nga auditimi: Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”, më 31.12.2021 paraqitet në vlerën 84,301,285 lekë, të cilat përfaqësojnë detyrime të Bashkisë ndaj subjekteve për garanci punimesh në objekte të ndryshme. Për 74 objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim nga Bashkia, në vlerën 63,016,632 lekë, sipas aneksit nr.12, pika 3, bashkëlidhur raportit të auditimit, nuk është bërë likuidimi i tyre, pasi fondet gjenden të ngurtësuara në degën e Thesarit, për të cilat është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës. Nga Drejtoria e Urbanistikës dhe e Financës, nuk janë marrë masa për likuidimin e këtyre fondeve për operatorët ekonomik që kanë kryer punimet, nuk janë njoftuar këta operatorë për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës së mësipërme. Veprimet e mosveprimet në kundërshtim me UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme*”, i ndryshuar Kap. III, pikat 30, 50. (Më hollësisht trajtuar në pikën nr.3, faqe 60-76 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

12.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit Urban, Lejeve dhe Monitorimit të Investimeve, të marrë masa për të bërë sistemimin e llogarisë 466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje”, duke rakorduar drejtoritë njëra me tjetrën çdo muaj mbi balancat e llogarisë 466, si dhe duke njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të sistemuar dhe pastruar garancitë të cilat tashmë u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit përkatës.

Deri më 31.10.2022

13.Gjetje nga auditimi: Konstatohet se në strukturën aktuale organizative të Bashkisë Berat nuk është krijuar sektori i Menaxhimit dhe Administrimit të Aseteve, nuk janë ngritur grupet e punës për përcaktimin e misionit dhe detyrat e tyre për administrimin e asetëve (toka, pyje, kullota, ndërtesa etj.) dhe për këtë arsye procesi i administrimit të tyre nuk është realizuar në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi. Kjo strukturë duhet të realizonte marrjen në dorëzim të asetëve, zbatimin e procedurave të transferimit në NJQV, vënien në efikasitet të ndërtesave, tokës bujqësore produktive dhe jo produktive sipas sipërfaqeve faktikë, duke rritur mundësinë e të ardhurave nga dhënia me qira. Për të gjitha asetet nuk është hapur regjistër kontabël, në kundërshtim me kapitullin III “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”, pika 26 dhe 27 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 8, të ligjit nr. 8743, datë 22.02.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, i ndryshuar, VKM nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore”, transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, Udhëzimin nr.3, datë 18.07.2002 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme të shtetit nga njësitë e qeverisjes vendore”, si dhe Udhëzimit të Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit nr. 15, datë 30.06.2003 “Për mënyrën e paraqitjes nga njësitë e qeverisjes vendore të kërkesave për transferim në pronësi të tyre, të pronave të paluajtshme publike. (Më hollësisht trajtuar në pikën nr.3, faqe 60-76 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

13.1.Rekomandimi: Bashkia Berat, të marrë masa për krijimin e strukturës së menaxhimit të asetëve, duke përcaktuar në rregulloren e brendshme detyrat konkrete për evidentimin, inventarizimin, vlerësim dhe regjistrimin e pronave në ZVRPP.

Brenda vitit 2022

14.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se për periudhën objekt auditimi janë certifikuar në total 2 prona si dhe përpara vitit 2019 janë certifikuar 49 prona objekte inventari në ndërtesa e konstruksione të cilat nuk janë të pasqyruara në llogaritë përkatëse të AAM. Gjithashtu përsa i përket pronave të kaluara me VKM në Bashkia Berat dhe Njësitë Administrative (Sinjë, Otlak, Roshnik dhe Velabisht), në total 7659 prona të cilat nuk janë të

regjistruara, nuk ka të dhëna dhe rakordim për objektet e privatizuara dhe evidencë të pronarëve që nuk kanë shlyer troje, nuk kanë filluar procedurat për përgatitjen e dokumentacionit ligjor për verifikimin dhe regjistrimin e pronave të paluajtshme publike dhe marrjen në dorëzim të aseteve si dhe nuk është ngritur grup pune për përgatitjen e dokumentacionit teknik të aseteve në pronësi dhe në përdorim, për të realizuar regjistrimin e pronave pranë ZVRPP (AShK) Berat. Veprime dhe mosveprime bien në kundërshtim me VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme”, Kreu (VI) “Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme”; UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” me ndryshime, Kreu (III), pika 35 dhe Kreu II, pika 16. *(Më hollësisht trajtuar në pikën nr.3, faqe 60-76 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

14.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë të marrë masa për ngritjen e një grupi për verifikimin faktik të pronave të kaluara me VKM si dhe të krijohet regjistri i pronave të paluajtshme të kaluara në pronësi, apo në përdorim të Bashkisë Berat.

14.2.Rekomandimi: Drejtorin e Financës në cilësinë e Nëpunësit Zbatues, të ndërmarr të gjitha procedurat ligjore për vlerësimin e 51 pronave të certifikuara në AShK Berat, por pa vlerë respektive si dhe paraqitjen e vlerës së këtyre aktiveve në Pasqyrën e Pozicionit Financiar të njësisë publike vendore Bashkia Berat më 31.12.2022.

Deri më 31.12.2022

15.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se në 4 raste në procedurat e prokurimit publik janë kualifikuar dhe shpallur fitues operatorë ekonomik të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura në dokumentet standarde të tenderit, konkretisht si vijon:

1-Në procedurën e prokurimit me objekt “Ujësjellësi i fshatit Duhanas, fshati Lapardha 1, Otlak dhe Orizaj, Bashkia Berat”, me vlerë të fondit limit 372,286,076 lekë pa TVSH , zhvilluar në vitin 2020, ka marrë pjesë vetëm një operatorë ekonomik, BOE “2... & R...” ShPK, me vlerë të ofertës ekonomike 365,057,023 lekë pa TVSH, i cili nuk plotëson të gjitha kriteret e veçanta të DST, por është kualifikuar dhe shpallur fitues.

Veprimet e mësipërme kanë sjellë lidhjen e kontratës me vlerë 365,057,023 lekë pa TVSH, me një OE i cili është shpallur fitues në papajtueshmëri me legjislacionin e prokurimit publik.

2- Në procedurën e prokurimit me objekt “Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pa favorizuara”, me vlerë të fondit limit 9,942,305 lekë pa TVSh , zhvilluar në vitin 2020”, ka marrë pjesë vetëm operatori ekonomik “Z...” ShPK, me vlerë të ofertës ekonomike 9,447,915 lekë pa TVSh , i cili nuk plotëson të gjitha kriteret e vendosura në DST, por nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Berat është kualifikuar dhe shpallur fitues. Veprimet e mësipërme kanë sjellë lidhjen e kontratës me vlerë 9,942,305 lekë pa TVSH , me një OE i cili nuk plotëson kriteret e DST dhe është shpallur fitues në papajtueshmëri me legjislacionin e prokurimit publik.

3- Në procedurën e prokurimit me objekt “Rikonstruksion i rrugës “Inerte”, ndërtim ure b/a, Njësia Administrative Otlak, Bashkia Berat”, me vlerë të fondit limit 18,497,975

lekë pa TVSH , zhvilluar në vitin 2020”, kanë marrë pjesë 5 operatorë ekonomik, të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura në DST, por nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Berat është kualifikuar dhe shpallur fitues BOE “T... B... & V... H...” ShPK , i renditur i katërti, i cili nuk plotëson të gjitha kriteret e veçanta të vendosura në DST.

Veprimet e mësipërme kanë sjellë lidhjen e një kontrate me vlerë 17,905,258 lekë pa TVSH , me një OE i cili nuk plotëson kriteret e DST dhe është shpallur fitues në papajtueshmëri me legjislacionin e prokurimit publik.

4- Në procedurën e prokurimit me objekt “Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pa favorizuara” Bashkia Berat” me vlerë të fondit limit 27,789,747 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2021”, ka marrë pjesë 2 OE dhe vetëm operatori ekonomik “Z...” ShPK, ka paraqitur ofertës ekonomike me vlerë 26,775,773 lekë pa TVSh , i cili nuk plotëson

të gjitha kriteret e vendosura në DST, por nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Berat është kualifikuar dhe shpallur fitues. Veprimet e mësipërme kanë sjellë lidhjen e kontratës me vlerë 26,775,773 lekë pa TVSH, me një OE i cili nuk plotëson kriteret e DST dhe është shpallur fitues në papajtueshmëri me legjislacionin e prokurimit publik. Në të gjitha rastet e mësipërme KVO nuk duhet të kishte kualifikuar operatorët ekonomik, por duhet ti kishte propozuar Titullarit të Autoritetit Kontraktor skualifikimin e tyre dhe anulimin e tenderit.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, sipas neneve të mëposhtëm: neni 24 “Anulimi i një procedure prokurimi”, pika nr.1, germa (ç), neni 46 “Kualifikimi i ofertuesve”, pika 1, neni 53 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3 dhe pika 5, neni 55, “Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese”, pika 1, germa (a). *(Më hollësisht trajtuar në pikën nr.4.1, faqe 76-183 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

15.1.Rekomandim: Titullari i AK të analizojë arsyet e anomalive të KVO lidhur me kualifikimin e operatorëve ekonomik të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura në DST, të nxjerrë përgjegjësitë dhe të marrë masa që në të ardhmen të eliminohen praktika të tilla nga KVO.

Menjëherë dhe në vijimësi

16.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se në procedurat e prokurimit me objekt: “Ujësjetillësi i fshatit Duhanas, fshati Lapardha 1, Otlak dhe Orizaj”, me vlerë të fondit limit 372,286,076 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2020, “Ndërtimi i linjës kryesore dhe shpërndarjes së furnizimit me ujë të Njësisë Administrative Velabisht Bashkia Berat”, me vlerë të fondit limit 131,138,064 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2020, “Blerje mjet zjarrfikës për MZSH”, me vlerë të fondit limit 9,247,500 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2019, “Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pa favorizuara”, me vlerë të fondit limit 9,942,305 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2020, “Rikonstruksion i rrugës “Inerte”, ndërtim ure b/a, Njësia Administrative Otlak”, me vlerë të fondit limit 18,497,975 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2020”, në procesverbalin e mbajtur nga njësia e prokurimit, nuk është bërë argumentimi i kriterëve të veçanta për kualifikim të DST që lidhen me kapacitetin teknik, në kundërshtim me kërkesat e pikës 2, neni 61, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar. Gjithashtu në këto procedura prokurimi janë vendosur kriteret të cilët nuk janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, elementë të cilët kanë efekt në kufizimin e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomik. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme në hartimin e kriterëve të veçanta të DST, bien në kundërshtim me kërkesat e, nenit 26, pika 5, nenit 27, neni 61 pika 2 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe nenin 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Në dy procedurat e mësipërme me natyrë ndërtim i linjës së ujësjetillësit, në të cilët kërkohet njohuri të specializuara për kriteret e kapacitetit teknik, formimi profesional i specialistit të fushës (i cili është inxhinier ndërtimi dhe inxhinier gjeolog), nuk përputhet plotësisht me natyrën e objektit të prokurimit (inxhinier hidro), veprim në kundërshtim me kërkesat e nenit 57, pika 2 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën nr.4.1, faqe 76-183 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

16.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Berat të analizojë arsyet dhe të nxjerrë përgjegjësitë e anomalive të konstatuara në hartimin e kriterëve të veçanta të DST. Njësia e prokurimit në çdo procedurë të jap argumentim për çdo kriter të veçantë për kualifikim që lidhen me kapacitetin teknik dhe jo vetëm, të vendosur në DST dhe argumentet të dokumentohen me procesverbal. Të gjitha kriteret e vendosura, të kenë lidhje të ngushtë me përmasat e natyrën e kontratës.

16.2.Rekomandim: Titullari i AK të marrë masa që në procedurat e prokurimit të cilat kërkojnë njohuri të specializuara lidhur me kapacitetin teknik, formimi profesional i specialistit të fushës të ketë përputhje me natyrën e objektit të prokurimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

17.Gjetje nga auditimi: Në tenderin me objekt “Blerje mjet zjarrfikës për MZSH”, me vlerë të fondit limit 9,247,500 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2019”, komision i marrjes në dorëzim të mjetit nuk ka kryer kontrollin e plotë fizik të mjetit zjarrfikës dhe nuk është shprehur nëse mjeti i dorëzuar nga operatori ekonomik “T...” ShPK plotëson ose jo specifikimet teknike të përcaktuara në DST. Numri i specifikimeve teknike të mjetit të dorëzuar, për të cilat është shprehur komisioni, është shumë i vogël krahasuar me ato të kërkuara në DST. Komisioni nuk ka dhënë sigurinë e duhur nëse mjeti zjarrfikës i dorëzuar është sipas specifikimeve teknike të përcaktuara në dokumentet standarde të tenderit. Për sa më sipër komisioni i marrjes në dorëzim të mjetit nuk ka zbatuar urdhrin nr.793, datë 27.11.2019, nr.5990 prot. të Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Berat. *(Më hollësisht trajtuar në pikën nr.4.1, faqe 76-183 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

17.1.Rekomandim: Nga Kryetari i Bashkisë Berat të merren masa që në rastet e marrjes së mallrave në dorëzim, komisionet e ngritura për këtë qëllim, të bëjnë identifikimin dhe ballafaqimin e të gjitha specifikimeve teknike të mjetit, me ato të vendosura në dokumentet standarde të tenderit.

Menjëherë dhe në vijimësi

18.Gjetje nga auditimi: Në tenderin me objekt “Blerje mjet zjarrfikës për MZSH”, me vlerë të fondit limit 9,247,500 lekë pa TVSH , zhvilluar në vitin 2019”, konstatohet se komisioni i shqyrtimit të ankesës nuk ka trajtuar pretendimin e operatorit ekonomik “A... G...” ShPK, që lidhet me skualifikimin pa të drejtë të tij nga KVO. Komisioni ka anashkaluar këtë shqyrtim dhe është shprehur për çështje të tjera të DST, të cilat nuk kanë lidhje me çështjen e ankesës. Me veprimet dhe mos veprimet e tij komisioni i shqyrtimit të ankesës nuk ka zbatuar urdhrin e titullarit nr.699 datë 16.10.2019, si dhe nuk i ka dhënë këtij të fundit informacionin e duhur për një vendimmarrje të drejtë për ecurinë e mëtejshme të tenderit. Ky komision duhet të analizonte faktin nëse skualifikimi që ka bërë KVO, është i drejtë ose jo dhe për këtë duhet të kishte dalë me një vendim të cilin duhet ta adresonte te Titullari i AK dhe personi përgjegjës për prokurimin. *(Më hollësisht trajtuar në pikën nr.4.1, faqe 76-183 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

18.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Berat të marrë masa që në rastet e ankesave të bëra nga operatorët ekonomik për çështjet e procedurave të prokurimit publik, komisionet e ngritura për këtë qëllim të shqyrtojnë çështjet për të cilat pretendon anketuesi dhe të informojnë Titullarin e AK për konkluzionin e arritur, në mënyrë që ky informacion të shërbejë për vendimmarrjen e mëtejshme të procesit të prokurimit publik nga Titullari.

Menjëherë dhe në vijimësi

19.Gjetje nga auditimi: Për të realizuar administrimin në mënyrë të vazhdueshme të procesit të prokurimit, përgatitjen e dokumenteve të tenderit dhe mbledhjen e të gjitha materialeve të nevojshme, që u bashkëlidhen atyre e të tjera detyra që lidhen me procedurat e prokurimit publik, nga Titullari i Autoritetit Kontraktor Bashkia Berat për vitin 2019, 2020 dhe 2021 nuk është caktuar personi përgjegjës për prokurimin, veprim në kundërshtim me nenin 57 - Personi përgjegjës për prokurimin dhe njësia e prokurimit, të VKM 14 “ datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën nr.4.1, faqe 76-183 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

19.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Berat të marrë masa për përcaktimin e personit përgjegjës për prokurimin me qëllim administrimin në mënyrë të vazhdueshme të procesit të prokurimit, përgatitjen e dokumenteve të tenderit dhe mbledhjen e të gjitha materialeve të

nevojshme, që u bashkëlidhen atyre e të tjera detyra që lidhen me procedurat e prokurimit publik.

Menjëherë

20.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjeve të prokurimit publik për procedurat “Shërbim konsulence” me objekt “Studim Projektimi KUZ Lagjja Uznovë, Rajoni nr.3 dhe fshatit Duhanas” dhe “Hartim projekti Ura e re mbi lumin Osum dhe rikonstruksion i rrugës Gorice-Bilce”, është ngritur KVO me anëtarë që nuk janë ekspertë të fushës së objektit që prokurohet, por me profesion agronom (edhe kryetar i KVO-së), jurist, ekonomist. Vendosija në KVO e antarëve që nuk janë ekspertë të fushës së objektit që prokurohet, bie në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, nenin 37 “Shërbimi i Konsulencës”, pika 4/b (*Më hollësisht trajtuar në pikën nr.4.2, faqe 184-193 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

20.1.Rekomandim: Nga Kryetari i Bashkisë Berat të merren masa që në procedurat e prokurimit “Shërbim Konsulence”, zyrtarët e prokurimeve të zgjidhen ekspertë të fushës së objektit që prokurohet, t me qëllim realizimin me objektivitet të procedurës së prokurimit, si dhe për argumentimin e saktë të vlerësimit të ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

21.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Ndërtim rrjeti KUZ në fshatin Lapardha 1, Lapardha 2 dhe fshatin Drobonik” dhe “Ndërtim i linjës kryesore dhe shpërndarjes së furnizimit me ujë të Njësisë Administrative Velabisht”, Bashkia Berat, u konstatua se për këto objekte, ka vonesa në fillimin e procesit të kolaudimit (respektivisht 1 vit dhe 100 ditë nga data e përfundimit të punimeve), veprim ky në kundërshtim me UKM Nr.3, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, kapitulli II, “Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, pika 2 (*Më hollësisht trajtuar në pikën nr.4.2, faqe 184-193 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

21.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Berat, të marrë masa që nëpërmjet grupeve të punës, të realizojë në kohë kolaudimin dhe më pas marrjen në dorëzim të veprave ndërtimore, me qëllim vënien në punë në kohë dhe mirëmbajtjen e tyre, për t’i shërbyer komunitetit me investimet e kryera.

Menjëherë dhe në vijimësi

22. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjes së prokurimit dhe të dhënave në SPE për procedurën e prokurimit me objekt “Hartim projekti Ura e RE mbi lumin Osum” dhe “Rikonstruksion i rrugës Gorice-Bilce”, rezulton që OE “N... G...”, ka paraqitur në zbatim të pikës 2.3.3 të KVK si ekspert mjedisi, z. K. B. (edhe arkitekt), i cili nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se nuk është i pajisur me licencën III.2.A – “Kategoria shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis”, të kërkuar në DT, duke bërë kualifikimin e tij në kundërshtim me legjislacionin e PP.

Me skualifikimin e këtij OE, në zbatim të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, nenin 37 “Shërbimi i Konsulencës”, pika 4/dh, KVO duhet të kishte bërë propozimin tek titullari i AK për anulimin e procedurës dhe fillimin e një procedure të re. Ky mosveprim ka sjellë lidhjen e një kontrate me vlerë 14,751,780 lekë me TVSH me një OE, i cili është shpallur fitues në papajtueshmëri me legjislacionin e PP (*Më hollësisht trajtuar në pikën nr.4.2, faqe 184-193 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

22.1.Rekomandim: Titullari i Bashkisë Berat dhe KVO, të marrin masa për eliminimin e rasteve të mësipërme, duke analizuar arsyet e kualifikimit të padrejtë të operatorëve ekonomikë, të cilët nuk plotësojnë kriteret e DST, në mënyrë që në të ardhmen të mos përsëriten veprime të tilla.

Menjëherë dhe në vijimësi

23.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të procedurave për dhënie të lejeve të ndërtimit u konstatuan mangësi në miratimin e dy lejeve si vijon:

- Çështja me nr.4689 prot. datë 07.10.2020 dhe lejes së ndërtimit nr. 809, datë 27.11.2020 me objekt “Godine banimi dhe shërbimi 1,4 dhe 8 kate dhe 1 kate parkimi nëntokë”;

- Çështja me nr.2201 prot. datë 20.05.2021 dhe lejes së ndërtimit nr. 377, datë 01.07.2021 me objekt “Godine banimi dhe shërbimi 1, 6 dhe 8 kate dhe 1 kate parkimi nëntokë”;

Referuar sistemit e-Leje rezultojnë për lejet e sipërcituara nuk janë mbajtur aktet e kontrollit me subjektin zhvillues; mbikëqyrësin e punimeve dhe firmën zbatuese të punimeve të ndërtimit në kundërshtim me nenin 27/1 të VKM nr. 408 datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit të ndryshuar si dhe nenin 51 107 të ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e Territorit”. (Më hollësisht trajtuar në pikën nr.5, faqe 193-198 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

23.1.Rekomandim: Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, të marrin masa që në vazhdimësi të miratimit të lejeve të ndërtimit të mbahen aktet e kontrollit sipas përcaktimeve ligjore.

Menjëherë dhe në vijimësi

24.Gjetje nga auditimi: Për periudhën objekt auditimi, IMT Bashkia Berat ka mbajtur procesverbal konstatimi dhe procesverbal vendim prishje, në 10 raste për objektet pa leje sipas aneksit nr. 3 pika 6 bashkëlidhur raportit të auditimit. Rezultojnë se nga IMT nuk është marrë asnjë masë tjetër për prishjen e ndërtimeve pa leje dhe kthimin e gjendjes në situatën e mëparshme, në kundërshtim me nenin 10 të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”, i ndryshuar dhe VKM-së nr. 862, datë 05.12.2007 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga IKMT dhe INUV”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën nr.6, faqe 198-200 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

24.1.Rekomandimi: Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit në bashkëpunim me Policinë Bashkiake, të marrë masa që për rastet e ndërtimeve të paligjshme (pa leje ndërtimi), ndajë të cilave është mbajtur procesverbal prishje objekti dhe kthimin në gjendjen fillestare të truallit, duke zbatuar vendimin e prishjes së objektit. Në rast kundërshtimi ndajë personave përgjegjës, të ndiqen procedurat ligjore, duke kërkuar bërjen e kallëzimit penal ndajë shkelësve.

Menjëherë dhe në vijimësi

25.Gjetje nga auditimi: Për zbatimin e rekomandimeve për përmirësimin e gjendjes nga auditimi i fundit të kryer në Bashkinë Berat, dërguar nga KLSH me shkresën nr. 601/56 datë 04.12.2020, u konstatua se Bashkia Berat nuk ka kthyer përgjigje brenda afatit 20 ditor, si dhe nuk ka hartuar një plan veprimi të ri për masat e ri kërkuara, në kundërshtim me pikën 2 të nenit 30 të ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Nga 11 masa organizative të ri kërkuara janë zbatuar 3 masa, janë në proces 7 masa dhe nuk është zbatuar 1 masë organizative.

Nga 2 masa shpërblim dëmi në vlerën 1,203,900 lekë, është në proces gjyqësorë 1 masë në vlerën 188,400 lekë dhe në proces zbatimi 1 masë në vlerë 1,015,500 lekë. (Më hollësisht trajtuar në pikën nr.7, faqe 200-207 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

25.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Berat të analizojë situatën dhe të nxjerrë përgjegjësitë për mos zbatimin e plotë të rekomandimeve të dërguara nga KLSH me shkresën nr. 601/56 datë 04.12.2020, si dhe të hartojë plan pune të veçantë për zbatimin e shtatë masave organizative të cilat janë në proces, një masë organizative të pa zbatuar, një masë shpërblim dëmi në vlerën 1,015,500 lekë.

Menjëherë

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 germa (b) dhe (c) –*Të drejtat e KLSH* dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe pikën 93, të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, **nga Titullari i Njësisë Publike**, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. **Nëpunësi zbatues** të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabël përfundimtare, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **8,686,164 lekë** si më poshtë:

1.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i përlllogaritjes së fondit limit të objektit “Studim Projektimi KUZ Lagjja Uznovë, Rajoni nr.3 dhe fshatit Duhanas”, zhvilluar në vitin 2021, rezulton se është marrë pa asnjë referencë teknike të dokumentuar kostoja e llogaritshme 199,904,106 lekë pa TVSH për lagjen Uznovë dhe 98,158,293 lekë pa TVSH për fshatin Duhanas, duke bërë llogaritjen e fondit limit të projektimit veçmas për secilin nën objekt respektivisht 9,285,473 lekë pa TVSH për KUZ Uznovë dhe 6,645,647 lekë pa TVSH për fshatin Duhanas, ose 15,931,120 lekë gjithsej. Llogaritja e fondit limit si dy objekte të ndara, është e paargumentuar teknikisht dhe ka rritur fiktivisht fondin limit të këtij objekti prokurimi. Nga rillogaritja e fondit limit, sipas rrugës së ndjekur nga hartuesi i fondit limit, fondi limit i këtij objekti do të jetë 12,195,733 lekë, ose 3,735,387 lekë më shumë se fondi i planifikuar i projektimit. Për sa më sipër, diferenca prej **3,394,267 lekë** midis ofertës ekonomike fituese 15,590,000 lekë me vlerën e fondit limit që duhet të ishte llogaritur në fakt 12,195,733 lekë, është dëm ekonomik ndaj buxhetit të Bashkisë Berat (*Më hollësisht trajtuar në pikën nr.4.2, faqe 184-193 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1.Rekomandim: Nga Bashkia Berat të merren të gjitha masat e duhura ligjore për arkëtimin e vlerës prej **3,394,267 lekë pa TVSh** nga z. L. B., në cilësinë e hartuesit të fondit limit të objektit “Studim Projektimi KUZ Lagjja Uznovë, Rajoni nr.3 dhe fshatit Duhanas”, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e llogaritjes së gabuar të fondit limit.

Deri më 31.10.2022

2.Gjetje nga auditimi: Në tenderin me objekt “Blerje mjet zjarrfikës për MZSH”, me vlerë të fondit limit 9,247,500 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2019 kanë marrë pjesë 7 operatorë ekonomik, midis të cilëve edhe operatori ekonomik “A... G...” ShPK, i renditur i pari, me vlerën më të ulët të ofertës ekonomike prej 6,950,000 lekë pa TVSh, i cili plotëson kriteret e vendosura në DST, por nga KVO ky operatorë ekonomik është skualifikuar padrejtësisht. Nga Autoriteti Kontraktor është shpallur fitues operatori ekonomik “T...” ShPK, me vlerë të ofertës ekonomike 8,480,000 lekë pa TVSh. Skualifikimi i operatorit ekonomik “A... G...” ShPK, i cili plotëson kriteret e vendosura në DST dhe kualifikimi dhe shpallja fitues e operatorit ekonomik “T...” ShPK, me vlerë të ofertës ekonomike më të lartë, ka sjellë **dëm ekonomik në vlerën 1,530,000 lekë pa TVSh**, si diferencë midis dy ofertave të operatorëve ekonomik.

Për sa më sipër nga KVO nuk është siguruar mirë përdorim i fondeve publike dhe trajtim i barabartë midis operatorëve ekonomik, nuk janë respektuar parimet e përzgjedhjes së operatorëve ekonomik dhe ofertës fituese. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 1 “Objekti dhe qëllimi”, pika b, d, dh; nenin 2 “Parimet e përzgjedhjes”, pika a, c; nenin 53 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3; 5; nenin 55 “Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese”, të ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe kërkesat e ligjit

nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, neni 2. (Më hollësisht trajtuar në pikën nr.4.1, faqe 76-183 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Berat të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për arkëtimin e vlerës prej **1,530,000 lekë** pa TVSh nga anëtarët e KVO: znj. A. Zh., ekonomiste, me detyrë specialiste e prokurimeve z. G. B., me detyrë ish specialist i prokurimeve, ndërprerë marrëdhëniet e punës me urdhrin n.80, datë 26.12.2019, z. L. B., me detyrë zv/kryetar i Bashkisë Berat.

Deri më 31.10.2022

3.Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit me objekt “Blerje karburant për nevojat e Bashkisë Berat dhe drejtorive në vartësi”, me vlerë të fondit limit 17,790,833 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2020, komisioni vlerësimit të ofertave ka kualifikuar dhe shpallur fitues operatorin ekonomik “G... C... G...” ShPK, me marzh fitimi 16%, ose vlerë të ofertës ekonomike 16,382,394 lekë i cili nuk i plotëson kriteret e vendosura në DST, si dhe ka s’kualifikuar padrejtësisht operatorin ekonomik “O...” ShPK me marzhë fitimi 5.3%, ose vlerë të ofertës ekonomike 14,855,147 lekë, i cili plotëson kriteret e vendosura në DST. Veprimet e KVO kanë shkaktuar **dëm ekonomik në vlerën 1,527,247 lekë si diferencë midis dy ofertave**. KVO duhet të kishte kualifikuar OE “O...” ShPK dhe duhet ti kishte propozuar Titullarit të AK shpalljen e tij fitues. Për sa më sipër nga KVO nuk është siguruar mirë përdorim i fondeve publike dhe trajtim i barabartë midis operatorëve ekonomik, nuk janë respektuar parimet e përzgjedhjes së operatorëve ekonomik dhe ofertës fituese.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 1 “Objekti dhe qëllimi”, pika b, d, dh; nenin 2 “Parimet e përzgjedhjes”, pika a, c; nenin 53 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3; 5; nenin 55 “Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese”, të ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, neni 2. (Më hollësisht trajtuar në pikën nr.4.1, faqe 76-183 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për arkëtimin e vlerës **1,527,247 lekë** pa TVSh nga anëtarët e KVO: L. B., me detyrë n/kryetar i Bashkisë Berat, z. P. S. me detyrë drejtor i Drejtorisë Juridike, znj. E. M., me detyrë specialiste e prokurimeve publike.

Deri më 31.10.2022

4.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Ndërtim rrjeti KUZ në fshatin Lapardha 1, Lapardha 2 dhe fshatin Drobonik”, Bashkia Berat, me vlerë të kontratës 28,867,632 lekë me TVSh, realizuar në vitin 2020, fituar nga BOE “M...” ShPK & “E...” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të situacionuara, por të pakryera në fakt në vlerën **1,245,690 lekë pa TVSh, e cila konsiderohet dëm ekonomik**.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 2047/1 prot datë 14.05.2019 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Berat dhe BOE “M...” ShPK & “E...” ShPK. (Më hollësisht trajtuar në pikën nr.4.2, faqe 184-193 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1.Rekomandim: Nga Bashkia Berat të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **1,245,690 lekë pa TVSh** nga BOE “M...” ShPK & “E...” ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 2047/1 prot datë 14.05.2019, me objekt “Ndërtim rrjeti KUZ në fshatin Lapardha 1, Lapardha 2 dhe fshatin Drobonik”, Bashkia Berat, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Deri më 31.10.2022

5.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Ndërtim i linjës kryesore dhe shpërndarjes së furnizimit me ujë të Njësisë Administrative Velabisht”, Bashkia Berat, zhvilluar në vitin 2020, me vlerë të kontratës me 154,991,516 lekë TVSh, fituar nga BOE “E...A...” ShPK & “V... K...” ShPK & “Ll...” ShPK & “E...” ShPK,

rezultuan diferenca në volume pune të situacionuara, por të pakryera në fakt në vlerën **863,960 lekë pa TVSh, e cila konsiderohet dëm ekonomik.**

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 2134/6 prot datë 29.06.2020 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Berat dhe BOE “E...A...” ShPK & “V... K...” ShPK & “L...” ShPK & “E...” ShPK. *(Më hollësisht trajtuar në pikën nr.4.2, faqe 184-193 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1.Rekomandim: Nga Bashkia Berat të merren masa për arkëtimin e vlerës **863,960 lekë pa TVSh** nga BOE “E...A...” ShPK & “V... K...” ShPK & “L...” ShPK & “E...” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 2134/6 prot datë 29.06.2020, me objekt “Ndërtim i linjës kryesore dhe shpërndarjes së furnizimit me ujë të Njësisë Administrative Velabisht”, Bashkia Berat, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Deri më 31.10.2022

6.Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit me objekt “Blerje mjeti për nevojat e Drejtorisë së Bujqësisë”, me vlerë të fondit limit 4,050,000 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2020, është kualifikuar dhe shpallur fitues operatori ekonomik “M...2...6” ShPK, me vlerë të ofertës ekonomike 4,000,000 lekë dhe është skualifikuar padrejtësisht operatori ekonomik “L... B...” ShPK me vlerë të ofertës ekonomike 3,875,000 lekë pa TVSh, i cili plotëson kriteret e vendosura në DST dhe është oferta me vlerën më të ulët. Veprimet e KVO kanë shkaktuar **dëm ekonomik në vlerën 125,000 lekë pa TVSh, si diferencë midis dy ofertave të operatorëve ekonomik.** Për sa më sipër nga KVO nuk është siguruar mirë përdorim i fondeve publike dhe trajtim i barabartë midis operatorëve ekonomik, nuk janë respektuar parimet e përzgjedhjes së operatorëve ekonomik dhe ofertës fituese.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 1 “Objekti dhe qëllimi”, pika b, d, dh; nenin 2 “Parimet e përzgjedhjes”, pika a, c; nenin 53 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3; 5; nenin 55 “Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese”, të ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, neni 2. *(Më hollësisht trajtuar në pikën nr.4.1, faqe 76-183 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

6.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për arkëtimin e vlerës **125,000 lekë pa TVSh** nga anëtarët e KVO: z. Xh. Ç., me detyre specialist në Drejtorinë e Bujqësisë, z. F. D., inxhinier mekanik, me detyrë përgjegjës i sektorit mekanik në Agjencinë e Shërbimeve Publike, z. A. Sh., me detyrë zëvendës kryetar i Bashkisë Berat.

Deri më 31.10.2022

C. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË TYRE

1.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Ndërtim i linjës kryesore dhe shpërndarjes së furnizimit me ujë të Njësisë Administrative Velabisht”, Bashkia Berat, u konstatua se ky objekt me vlerë të situacionuar 154,991,516 lekë me TVSH, edhe pasi janë miratuar ndryshimet në volume (shtesa/pakësimi) në vlerën 139,591,298 lekë me TVSh, ose 90% të vlerës totale, përsëri nuk e kryen funksionin për të cilën është planifikuar të kryhej ky investim. Mos funksionimi i objektit ka sjellë mos furnizimin me ujë të komunitetit, si dhe **përdorimin pa efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike prej 154,991,516 lekë me TVSh.** *(Më hollësisht trajtuar në pikën nr.4.2, faqe 184-193 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Berat, nëpërmjet stafit inxhiniero-teknik, të marrë masa që në të ardhmen të miratojë ndryshimet e projekt preventivit, vetëm në rast se ato janë

të argumentuara teknikut, në mënyrë që të mos ndryshojnë në thelb kushtet kryesore të projektit, të përmirësojnë treguesit e veprës, duke i bërë ato sa më eficiente, për t'i shërbyer komunitetit në kohë. Të marrë masa për vendosjen në funksionim të linjës kryesore dhe shpërndarjes së furnizimit me ujë.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Bashkia Berat për zbatimin e vendimeve gjyqësore për vitin 2020 ka shpenzuar vlerën 25,244,853 lekë, nga e cila vlera 16,211,833 i përket vendimeve gjyqësore me objekt dëmshpërblim page për largime nga puna të punonjësve për 22 raste, ndërsa vlera 9,033,020 lekë për 6 raste i përket vendimeve për çështje të tjera gjyqësore, si konstatim i pavlefshmërisë absolute të procesit të shpronësimit, dëmshpërblim dëmi etj.

Për zbatimin e vendimeve gjyqësore për vitin 2021 është shpenzuar vlera 10,342,530 lekë, nga e cila 10,064,661 lekë i përket vendimeve gjyqësore me objekt dëmshpërblim page për largime nga puna të punonjësve për 9 raste, ndërsa vlera 277,869 lekë për 3 raste i përket vendimeve për çështje të tjera gjyqësore, si shfuqizim akti e anulim vendimi.

Për vitin 2020 dhe 2021 nga Bashkia Berat për zbatimin e vendimeve gjyqësore pavarësisht objektit të dëmshpërblimit, është shpenzuar vlera **35,587,383 lekë, e cila konsiderohet efekt financiar negativ në buxhet.**

Vendimet gjyqësore nuk janë analizuar nga Kryetari i Bashkisë dhe nuk është kërkuar prej Tij nxjerrja e përgjegjësi administrative për këto vendime. Analizimi i arsyeve të humbjeve të vendimeve gjyqësore dhe nxjerrja e përgjegjësi administrative për to, do të ndikonte pozitivisht në korrigjimin e praktikave të gabuara të ndjekura nga njësia vendore në proceset e largimit të punonjësve nga puna dhe për çështje të tjera gjyqësore, evidentimin e procedurave të bëra gabim, në kundërshtim me kuadrin rregullator në fuqi, e si rezultat shmangien e tyre në të ardhmen dhe uljen e shpenzimeve financiare negative në buxhet.

Mos kryerja e kësaj analize nga Titullari është në kundërshtim me pikën nr. 60, të UMFE nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar (*Më hollësisht trajtuar në pikën nr.2.1, faqe 24-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Berat të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatohen, me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kane sjellë humbjen e çështjes gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për çështjen e largimit të punonjësve nga puna dhe çështje të tjera, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet.

Deri më 31.10.2022

3. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi në terren të objektit “Ndërtim i linjës kryesore dhe shpërndarjes së furnizimit me ujë të Njesisë Administrative Velabisht”, Bashkia Berat, rezultojnë se tubacioni i situacionuar me DN 200 mm dhe t= 14.7 mm, është vendosur jo sipas preventivit të ripunuar, por me t=11.9 mm. Gjithashtu edhe tubacioni i situacionuar me DN 63 mm dhe t= 4.7 mm, është vendosur jo sipas preventivit të ripunuar, por me t=4 mm. Nga sa sipër, vlera e tyre prej 36,698,392 lekë me TVSH, përbën shpenzim jo me efektivitet të fondeve të Bashkisë Berat. (*Më hollësisht trajtuar në pikën nr.4.2, faqe 184-193 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

3.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Berat, nëpërmjet strukturave teknike të bashkisë, të marrë masa për eliminimin e rasteve të mësipërme, duke ushtruar kontrole periodike gjatë realizimit të kontratave të realizuara me fondet publike, në mënyrë që të realizohen objekte që ti shërbejnë komunitetit me efektivitet, për një kohë sa më të gjatë dhe në mënyrë cilësore.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i sistemit e-leje rezultoi se në Bashkinë Berat po kryhen investime ku investitor dhe zhvillues nuk është Bashkinë Berat, por Ujësjetillës Kanalizime Berat –Kuçovë ShA, për të cilën Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia

Berat nuk ka mundësuar përllogaritjen e taksës së ndikimit në infrastrukturë të investimeve, konkretisht objektet:

- “Rikonstruksioni i rrjetit të furnizimit me ujë dhe sistemit të kanalizimeve në qytetin e Beratit” me vlerë preventivi prej 10,426,746 euro, për të cilën nuk është bërë llogaritja dhe pagesa e taksën së ndikimit në infrastrukturë në vlerën **1,261,636 lekë, e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Berat**. Veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me VKB nr. 57, datë 28.12.2015 “Për miratimin e paketës fiskale, viti 2019”. (Më hollësisht trajtuar në pikën nr.5, faqe 193-198 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1.Rekomandim: Drejtoria e të Ardhurave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikim Urban, të marrë masa për llogaritjen e saktë të detyrimeve nga taksa e infrastrukturës në masën 0.1% për investimet që zhvillues nuk është Bashkia Berat, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjor për arkëtimin e detyrimit në vlerën **1,261,636 lekë**.

Deri më 31.10.2022

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se për periudhën objekt auditimi nga Inspektorati Mbrojtjes Territorit Bashkia Berat janë vendosur 31 gjoba në vlerën 9,585,000 lekë, nga të cilat janë arkëtuar 2,885,000 lekë, mbetur pa arkëtuar vlera 6,700,000 lekë, e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë, paraqitur analitikisht në aneksin nr. 2 pika 6 bashkëlidhur raportit të auditimit. Sa më sipër rezulton se për të gjitha praktikat IMT-ja, nuk ka ndjekur të gjitha rrugët ligjore, me qëllimin arkëtimin e detyrimeve, në kundërshtim me nenin 16, i ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve”, me ndryshime, nenet, 9, 22 dhe 30, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”. (Më hollësisht trajtuar në pikën nr.6, faqe 198-200 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1.Rekomandimi Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor dhe Drejtoria Juridike, të marrin masat dhe të kërkojë në Gjykatë, kthimin e vendimeve të gjobave në tituj ekzekutiv, duke llogaritur edhe kamat vonesat në masën 60% mbi shumën e gjobës së papaguar sipas aneksit nr. 2, pika 6, bashkëlidhur raportit të auditimit.

Deri më 31.10.2022

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezulton se Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, nuk ka marrë masa të plota për arkëtimin e debitorëve, pasi në datën 31.12.2021 rezulton një vlerë e pa arkëtuar prej **236,557 mijë lekë**, e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Berat, e krijuar nga mos pagesa e kategorisë së taksapaguesve familjarë dhe privat.

Vlera e detyrimit nga taksapaguesit familjar është 132,259,090 lekë, nga e cila detyrimi për taksën e tokës bujqësore është 62,722,750 lekë, ndërsa vlera e detyrimit nga taksapaguesit privat është 104,298,029 lekë.

Veprimet e mos veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Pikat 3,4, 5 dhe 5, të nenin 45 – “Çregjistrimi i subjekteve tatimore” dhe Kreun XI-Mbledhja me forcë e detyrimit tatimore të papaguar, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshimet dhe Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshime; ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, me ndryshimet e mëvonshme, neni 181 -Mospagimi i taksave dhe tatimeve. (Më hollësisht trajtuar në pikën nr.2.2, faqe 49-59 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1.Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimore për debitorët duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve në vlerën **236,557 mijë lekë**, si më poshtë vijon:

a-Tu dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhrat e bllokimit të llogarive bankare.

b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në AKSh (për pasuritë e paluajtshme).

c-Në rast se bizneset private edhe pas njoftimeve zyrtare dhe dërgimit të urdhër bllokimeve në bankë nuk kryejnë pagesën e detyrimeve, pasi të merren masat administrative apo sekuestro, të bëhet kallëzim penal, bazuar në Kodin Penal të RSh, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 me ndryshimet e mëvonshme, neni 181 “Mospagimi i taksave dhe tatimeve”.

d-Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Berat, në bashkëpunim me Njësitë Administrative, të evidentojë listat emërore të debitorëve familjarë në mënyrë elektronike, duke të njoftojë nëpërmjet postës (dhe jo vetëm) familjet të cilët nuk kanë paguar detyrimet për taksën e tokës/ tarifën e pastrimit, ndriçimit, banesave dhe gjelbërimit.

Deri më 31.10.2022

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit që disponon Drejtoria e PZHT, Bashkia Berat në lidhje me legalizimet e ndërtimeve pa leje dhe listave që disponon për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, konstatohet se nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNIT Berat janë dërguar zyrtarisht me shkresë lista e qytetarëve shoqëruar me leje legalizimi dhe destinuar për regjistrim në ZVRPP (AShK) Berat.

Për periudhën nga 01.01.2017 deri më 31.12.2021, sipas listave të vëna në dispozicion me leje legalizimi dhe kryqëzimi i tyre me personat që kanë bërë të mundur likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturës, rezulton se detyrimi për këtë taksë është në vlerën **43,115,950 lekë** për 1291 persona, nga e cila kanë paguar detyrimet 381 persona me vlerë **12,996,634 lekë** dhe kanë mbetur për likuidim deri datë 31.12.2021 gjithsej **910** persona me vlerë **30,119,316 lekë**, e cila konsiderohet e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Berat.

Nga dokumentacioni i paraqitur konstatohet se Bashkia Berat nuk ka të evidentuar subjektet të cilat janë pajisur me leje legalizimi nga ALUIZNI përpara vitit 2017 si dhe nuk u evidentuan raste që Bashkia Berat ti jetë drejtuar AShK për bllokimin e pasurisë dhe mos kryerjen veprimeve hipotekore ose bllokimin e marrjes së lejes së legalizimit dhe certifikatës pa bërë më parë pagesën taksës së ndikimit në infrastrukturë. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me nenin 27 pika (d), të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje,,,”; VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim” i ndryshuar, pika 5 dhe ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave vendore”, i ndryshuar, neni 27- *Taksa e ndikimit në infrastrukturë, pika 2/1. (Më hollësisht trajtuar në pikën nr.2.2, faqe 49-59 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

7.1.Rekomandim: Drejtoria e Planifikim Urban në bashkëpunim me Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet pa leje në vlerën **30,119,316 lekë** ndaj **910** personave si dhe t’i kërkojnë Drejtorisë Rajonale Vendore AShK Berat, vendosjen e urdhër kufizimit mbi pasurinë, deri në pagesës e taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Deri më 31.10.2022

8.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit mbi pasjen me licencë tregtimi për subjektet që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre, u konstatua se ka mangësi në plotësimin e të dhënave të këtyre subjekteve në përgjithësi dhe debitorëve në veçanti, si mos aplikimin e tarifës së licencës dhe lejimin e subjekteve të ushtrojnë aktivitet pa paguar këtë taksë dhe mos ndjekjen e detyrimeve për subjektet të cilat janë pajisur dhe nuk e kanë paguar tarifën.

Sipas dokumentacionit të venë në dispozicion nga Drejtoria e Shërbimeve dhe e Licencave, rezulton se në territorin e Bashkisë Berat dhe në Njësitë Administrative në vartësi Otlak, Velabisht, Sinjë dhe Roshnik, ushtrojnë aktivitetin 23 subjekte të cilat tregtojnë me pakicë dhe 1 subjekt që tregton me shumicë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre. Nga 23 subjekte janë pajisur me autorizim 10 prej tyre, kanë mbyllur aktivitetin 3 subjekte, ndërsa nuk janë

licensuar me leje për tregtim karburanti 10 subjekte, si pasojë e të cilës janë krijuar të ardhura të munguara në vlerën 8,950,000 lekë, paraqitur në mënyrë analitike në aneksin nr. 8 pika 2.6 bashkëlidhur raportit të auditimit.

Në dy raste janë nënshkruar akt marrëveshje me subjektet për pagimin me këste të detyrimeve, veprim i pa mbështetur ligjërisht nga Bashkia Berat.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar neni 35, VKM nr. 170, datë 25.4.2002 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, kapitulli II dhe kapitulli III, pika 4, VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar kapitulli II, pika 1; germa “b”, dhe pika 9, ndryshuar me VKM nr. 344, datë 19.04.2017, kapitulli II, pika 1; germa “b” dhe pika 9 dhe 15. *(Më hollësisht trajtuar në pikën nr.2.2, faqe 49-59 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

8.1.Rekomandim: Drejtoria e Shërbimeve dhe e Licencave në bashkëpunim me Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, të ndjekë të gjitha rrugët ligjore për pajisen me liçensa të subjekteve që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre, si dhe arkëtimin e tarifës për këtë licencë në vlerën **8,950,000 lekë**, për 10 subjekte, sipas aneksit nr. 8 pika 2.6 bashkëlidhur raportit të auditimit.

Deri më 31.10.2022

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i arkëtimit të të ardhurave nga dhënia me qira e objekteve, u konstatua se nuk kanë shlyer detyrimet e kontratës 3 subjekte, gjithsej në vlerën **379,893 lekë me pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e njësisë vendore** (sipas aneksit nr.9 pika 2.6 bashkëlidhur raportit të auditimit). Veprimet e mësipërme janë në papajtueshmëri me nenin 12, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar dhe kushtet e kontratave të lidhura. *(Më hollësisht trajtuar në pikën nr.2.2, faqe 49-59 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

9.1.Rekomandim: Bashkia Berat të marrë masa, duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore, për arkëtimin e vlerës prej **379,893 lekë**, nga tre subjektet debitor, sipas aneksit nr.9 pika 2.6 bashkëlidhur raportit të auditimit, duke llogaritur dhe shtuar edhe kamatëvonesat, në përputhje me kushtet e kontratës.

Deri më 31.10.2022

10. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi në terren të objektit “Ndërtim rrjeti KUZ në fshatin Lapardha 1, Lapardha 2 dhe fshatin Drobonik”, Bashkia Berat, rezultoi se, edhe pas ndryshimeve në projekt, të kërkuara nga sipërmarrësi dhe të miratuara nga investitori, grupa septike në fshatin Lapardha 1, me vlerë të situacionuar 913,030 lekë pa TVSH , nuk është në funksion, pasi është e veçuar dhe e pa lidhur me rrjetin e ndërtuar të KUZ, duke mos qenë në efencë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën nr.4.2, faqe 184-193 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

10.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Berat, nëpërmjet stafit të inxhiniero-teknik, të marrë masa që në të ardhmen, të miratojë ndryshimet e projekt preventivit, vetëm në rast se ato janë të argumentuara teknikisht, në mënyrë që të mos ndryshojnë në thelb kushtet kryesore të projektit, si dhe të përmirësojnë treguesit e veprës, duke i bërë ato sa më eficente.

Menjëherë dhe në vijimësi

D. MASA ADMINISTRATIVE

I. Referuar parregullsive dhe shkeljeve të konstatuara në procedurat e prokurimeve publike, si dhe përgjegjësisë individuale të evidentuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në nenet 13 dhe 72 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, si

dhe bazuar në nenin 15 shkronjat (c dhe ç) dhe nenin 30 të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Prokurimit Publik, që për procedurat e prokurimit publik të cilat janë zhvilluar bazuar në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave administrative (dënim me gjobë) në raport me shkeljet e konstatuara në procedurat e prokurimeve publike, apo rekomandimin Autoritetit Kontraktor (për marrjen e masave disiplinore) ndaj **12 punonjësve**, anëtarë të njësisë së prokurimit (hartues të dokumenteve standarde të tenderit) dhe anëtarë të komisionit të vlerësimit të ofertave, për shkeljet e trajtuara në raportin përfundimtar të auditimit, në procedurat e prokurimit, si më poshtë:

1. Znj. M. S. inxhinierë, me detyrë përgjegjëse e sektorit të pronave dhe strehimit social, në cilësinë e anëtares së njësisë së prokurimit, specialiste e fushës dhe hartuese e kriterëve të kapacitetit teknik, për shkeljet e konstatuara në dy procedura prokurimi me objekt:

- “Ujësjiellësi i fshatit Duhanas, fshati Lapardha 1, Otlak dhe Orizaj, Bashkia Berat”, me vlerë të fondit limit 372,286,076 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2020.

- “Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete te varfëra dhe të pa favorizuara”, me vlerë të fondit limit 9,942,305 lekë pa TVSh , zhvilluar në vitin 2020”.

2. Znj. F. A., juriste, me detyrë specialiste e prokurimeve, në cilësinë e anëtares së njësisë së prokurimit dhe hartuese e kriterëve të veçanta të DST, për shkeljet e konstatuara në dy procedura prokurimi me objekt:

- “Ujësjiellësi i fshatit Duhanas, fshati Lapardha 1, Otlak dhe Orizaj, Bashkia Berat”, me vlerë të fondit limit 372,286,076 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2020.

- “Ndërtimi i linjës kryesore dhe shpërndarjes se furnizimit me ujë të Njësisë Administrative Velabisht Bashkia Berat”, me vlerë të fondit limit 131,138,064 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2020”.

3. Znj. A. Zh., ekonomiste, me detyrë specialiste e prokurimeve, në cilësinë e anëtares së njësisë së prokurimit dhe hartuese e kriterëve të veçanta të DST, për shkeljet e konstatuara në tre procedura prokurimi me objekt:

- “Ujësjiellësi i fshatit Duhanas, fshati Lapardha 1, Otlak dhe Orizaj, Bashkia Berat”, me vlerë të fondit limit 372,286,076 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2020.

- “Ndërtimi i linjës kryesore dhe shpërndarjes se furnizimit me ujë të Njësisë Administrative Velabisht Bashkia Berat”, me vlerë të fondit limit 131,138,064 lekë pa TVSh , zhvilluar në vitin 2020”.

- “Blerje mjet zjarrfikës për MZSh”, me vlerë të fondit limit 9,247,500 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2019 (në cilësinë e anëtres së komisionit të vlerësimit të ofertave).

4. Z. L. B., arkitekt, me detyrë zëvendës kryetar i Bashkisë Berat, në cilësinë e kryetarit të komisionit të vlerësimit të ofertave, për shkeljet e konstatuara në pesë procedura prokurimi me objekt:

